

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i katërbëdhjetë)

Nga fillimi i sures "Hixhr" deri në fund të sures "Nahl"

TIRANË, 2021

Titulli: **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuzi i katërmbëdhjetë)

Autori: *Eruditi, juristi dhe komentuesi*

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Vullnet MERJA**

E përktheu nga arabishtja: **Agim REÇAJ & Haxhi Selim STAF** *(Allahu e mëshiroftë!)*

E redaktoi: **Klodiana SMAJLAJ & Dorina BASHA**

Korrektura letrare: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja grafike & Kapaku: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

Surja “El Hixhr”

Sure “El Hixhr” është surja e 15-të e rënditur në Kur’anin
Famëlartë dhe ka zbritur në Mekë. Numri i ajeteve të saj është
99-të.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Përmbajtja e sures

Shumica e komentuesve të Kur'anit janë të mendimit se kjo sure është shpallur në Mekë. Kjo është surja e pesëdhjetë e dytë, që iu shpall të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) në Mekën e shenjtë, siç e ka përmendur Ibn Nedijmi në librin “El Fehres”, nën subjektin “Tarijkhul Kur'an”. Kjo sure përmban 99 ajete, shifër për të cilën kanë rënë dakord të gjithë komentuesit e Kur'anit.

Surja, në kontekstin dhe përmbajtjen e saj, nuk ndryshon nga suret e tjera të mëparshme mekase. Siç e kemi thënë më parë, suret e zbritura në Mekë përmbajnë ajete rreth bazave të fesë, siç janë: Njësimi dhe Bota Tjetër, si dhe heqje vërejtjeje për idhujtarët, gjynahqarët dhe të padrejtët. Gjithashtu, surja “El Hixhr” përmban rrëfime nga popujt e mëparshëm, ku jepen mësimet e këshilla që e ndriçojnë njeriun në jetën e tij të përditshme.

Ajetet e kësaj sureje mund t'i përmbledhim në shtatë grupe:

1- ajetet që flasin për zanafillën e botës së ekzistencës dhe të besimit në të nëpërmjet meditimit në sekretet e krijimit.

2- ajetet që kanë lidhje me Botën Tjetër dhe me dënimin e njerëzve të shthurur.

3- ajetet që flasin për rëndësinë e Kur'anit, duke e konsideruar si një libër qiellor.

4- ajetet që i tërheqin vërejtjen njerëzimit nëpërmjet rrëfimit të krijimit të Ademit dhe rebelimit të Iblisit, si dhe sqarimit për ndëshkimin e rebelimit.

5- ajetet që tërheqin vërejtjen nëpërmjet shpalosjes së tregimeve e rrëfimeve kur'anore, ku flitet për gjërat që u kanë ndodhur popujve të Lutit, Salihut dhe Shuajbit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

6- ajetet e vërejtjes, të përgëzimit, këshillimit dhe kërcënimit.

7- ajetet ku i thuhet Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) që të bëjë durim dhe të jetë i qëndrueshëm përballë intrigave e kërcënimeve, veçanërisht përballë asaj që po ndodhte në Mekë.

Emri i kësaj sureje është përzgjedhur nga ajeti 80, në të cilin përmendet populli i Salihut me banorët e Hixhrit, historinë e të cilëve kjo sure e ka trajtuar në pesë ajete dhe është e vetmja sure që i ka përmendur ata me këtë emër. Me lejen e Zotit, këtë detaj do ta trajtojmë më hollësisht në komentimin e ajeteve 80-84.

Ajetet 1 – 5

الر تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ وَقُرْآنٍ مُبِينٍ، رَبَّمَا يُودُّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْ
كَانُوا مُسْلِمِينَ، ذَرَهُمْ يَأْكُلُوا وَيَتَمَتَّعُوا وَيُلْهِهِمُ الْأَمَلُ فَسَوْفَ
يَعْلَمُونَ، وَمَا أَهْلَكْنَا مِنْ قَرْيَةٍ إِلَّا وَلَهَا كِتَابٌ مَعْلُومٌ، مَا تَسْبِقُ مِنْ
أُمَّةٍ أَجَلَهَا وَمَا يَسْتَأْخِرُونَ.

“Elif Lâm Râ. Këto janë vargjet e Librit, të Kur'anit të qartë!”

“Do të vijë Dita (e Kiametit), kur mohuesit do të dëshirojnë që të ishin mysli-manë.”

“Lëri ata që të hanë e të kënaqen dhe le t'i mashtrojë shpresa; ata do ta marrin vesh!”

“Ne nuk kemi zhdukur asnjë vend, pa i ardhur koha e caktuar.”

“Asnjë popull nuk mund as ta shpejtojë, as ta ngadalësojë afatin (e shkatërrimit të vet).”

Komentimi

Shpresat e rreme!

Edhe kjo është një tjetër sure që fillon me germa të ndara, “**Elif Lām Râ**”, për të qartësuar edhe një herë se fjalët e këtij Libri të dritës së qiellit në errësirën e banorëve të tokës, nuk janë gjë tjetër veçse po të njëjtat germa të alfabetit, që i shprehin të gjitha gjuhët e njerëzve, e megjithatë, asnjë krijesë nuk mund të ndërtojë apo formojë fjali si të Kur’anit Famëlartë. Ky është kulmi i sfidës së mrekullueshme të All’llahut, për të cilën Ai i Lartësuar thotë: “**Këto janë vargjet e Librit, të Kur’anit të qartë!**”.

Siç e dimë, fjala “*tilke*” që do të thotë *këta, këto*, është përemër dëftor që tregon për *larg*. Në këtë rast, është e domosdoshme të përdorej përemri dëftor “*hadhihi*”, që tregon për afër, sepse Kur’ani është një libër që ne e kemi në duart tona. Por gjuha arabe - sikurse e kemi shpjeguar edhe më parë - e lejon këtë mënyrë të shprehuri për të treguar madhështinë e asaj që tregohet. Kështu, qëllimi me këtë shprehje është se Kur’ani Famëlartë ka një pozitë të lartë.

Po ashtu, edhe përdorimi i fjalës “Kur’an” në trajtën e pashquar, ka për qëllim të tregojë madhështinë e këtij libri qiellor. Për të përshkruar Kur’anin përdoret fjala “*mubijjn*”, që do të thotë *i qartë*, sepse ai shpalos të vërtetat dhe qartëson të vërtetën nga e kota.

Supozimi i disa komentuesve se fjala “*kitab*” - “*libër*”, ka për qëllim Teuratin dhe Ungjillin, është shumë larg të vërtetës.

Më pas, All'llahu i Lartësuar u heq vërejtjen atyre që vazhdojnë të bëjnë shkatërrime e që i kundërshtojnë argumentet e qarta të Tij, dhe i lajmëron ata se do të pendohen kur t'u hiqet perdja në Ditën e Kiametit, për atë që punuan në këtë botë si rezultat i mosbesimit, fanatizmit të verbër dhe kokëfortësisë. Për këtë, All'llahu thotë: **“Do të vijë Dita (e Kiametit), kur mohuesit do të dëshirojnë që të ishin myslimanë.”**

Fjala “*jeueddu*” ka kuptimin *shpresë* apo *dëshirë*, siç ka ardhur në tefsirin “*Mijzan*”, ndërsa fjala “*leu*” që do të thotë *sikur të ishin*, është argument i dëshirës së tyre për të qenë myslimanë në atë kohë kur është e pamundur që të rikthehen edhe një herë në këtë botë, për të pohuar atë që kanë mohuar. Kjo tregon se dëshira e tyre do të shprehet në Botën Tjetër, pasi t'u paraqiten rezultatet e veprave të tyre.

Këtë kuptim e përforcon edhe transmetimi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ku thuhet: “*Ditën e Gjykimit, një lajmëtar thërret - e të gjitha krijesat e dëgjojnë - se do të hyjë në Xhennet vetëm ai që ka qenë mysliman, e në atë çast të gjitha krijesat do të dëshironin që të ishin myslimanë.*”¹

Transmetohet se i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: “*Kur të tubohen banorët e zjarrit në Xhehennem dhe bashkë me ta edhe ata që dëshiron All'llahu prej myslimanëve, jobesimtarët i pyesin myslimanët: “A nuk keni qenë ju myslimanë?” “Po, sigurisht që kemi qenë!” - përgjigjen*

¹ Tefsiri “*Mexhmaul Bejan*”, vëll. 3, f. 328. Gjithashtu, hadithi i parë citohet në tefsirin “*Nuruth Thekalejn*”, nga tefsiri i “*Ajashit*”, dhe e ka përmendur “*Fakhr Razi*” në tefsirin e tij. Një hadith që i ngjason hadithit të dytë, me një ndryshim të lehtë, është përmendur në tefsirin e “*Tabarijut*”.

myslimanët. Ata i pyesin sërish: "A nuk ju ka bërë dobi Islami, që jeni me ne në zjarr të Xhehennemit?" Myslimanët përgjigjen: "Kemi pasur gjynahe (të mëdha) dhe u dënuam prej tyre". Ky pranim i mëkatit dhe i neglizhimit, si dhe mallkimi i armiqve bëhen shkak që All'llahu t'i dëgjojë se çfarë thonë. All'llahu i Lartësuar urdhëron që ndjekësit e Islamit të nxirren nga zjarri. Në atë moment, jobesimtarët thonë: "Ah sikur të ishim edhe ne myslimanë!"¹

Mbase në aparençë këto ajeteve kur'anore u drejtohen mohuesve në brendinë e të cilëve është i ndezur prushi i natyrës së pastër (*el fitratu*). Kur dëgjuan nga Profeti ajetet kur'anore që përputheshin me kordat e zemrës, atyre iu zbutën zemrat dhe dëshiruan që të ishin myslimanë. Por, fanatizmi i tyre i verbër, kokëforcia e tyre dhe përfitmjet e tyre materiale, i penguan ata që të pranonin thirrjen e vërtetë. Kështu, ata qëndruan në mohimin e tyre dhe litarët e këtij mohimi i tërhoqën ata drejt humbjes.

Një besimtar, i cili bëri një udhëtim në Evropë, ka thënë: "Një herë takova një të krishterë, që ishte njeri i drejtë. Pasi i sqarova disa veçori të fesë tonë, ai mbeti i habitur dhe tha: "Ju përgëzoj nga zemra për madhështinë e fesë që keni, por çfarë të bëjmë? Rrethanat shoqërore na kanë detyruar që të devijojmë!"

Në historinë islame lexojmë atë çfarë i ka ndodhur Çezarit të romakëve kur i ka shkuar lajmësi i Pejgamberit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Thuhet se Çezari ia shfaqti besimin e tij lajmëtarit fshehurazi dhe donte që ta thirrte edhe popullin e tij në fenë e Teuhidit – Njehsimit. Por, ai kishte frikë nga populli i tij dhe mendoi t'i testonte ata duke i kërkuar tellallit që të lajmëronte se mbreti e kishte lënë fenë e krishterë dhe po

¹ Burimi i mësipërm.

ndiqte fenë e Muhamedit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ushtarët erdhën të armatosur dhe rrethuan kështjellën e tij, por ai urdhëroi tellallin që të thërriste: “Çezari deshi të provonte durimin që keni ndaj fesë tuaj. Kthehuni, sepse ai është i kënaqur me ju!”. Më pas, lajmëtarit të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) i tha: “Unë kam frikë për pushtetin tim. Vërtet e di se shoku juaj është Profet i dërguar, është ai që ne e kemi pritur dhe e kemi të përmendur në librat tanë, por unë i frikësohem Romës për veten time. Sikur të mos ishte kështu, unë me siguri do ta pasoja atë!”¹

Sido që të jetë, ndërmjet dy komentimeve nuk ka kundërshti, pasi ka mundësi që ajeti të përmbajë pendimin e një pjese të jobesimtarëve në të dyja botët (në këtë botë dhe në Botën Tjetër) dhe marrjen në konsideratë të pamundësisë së tyre për t'u kthyer në fenë islame në këtë botë për arsye të ndryshme.

Pastaj vjen thirrja nga qielli me një ton thumbues. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“O Muhamed, lëri ata që të hanë e të kënaqen dhe le t'i mashtrojë shpresa; ata do ta marrin vesh!”**. *Ata janë si bagëtitë, që nuk dinë gjë tjetër përveç fushave dhe foragjereve dhe nuk kuptojnë gjë tjetër përveç kënaqësive materiale. Çdo gjë që ti dëshiron, nuk e tejkalon cakun e asaj që di dhe kupton.*

Ata nuk i kuptojnë të vërtetat, sepse perdet e mashtrimit, hutimit dhe siguria e rreme ua kanë vulosur zemrat.

Por kur të vijë momenti e të hapet perdja përpara syve të tyre, dhe kur ta gjejnë veten përballë vdekjes, ose kur të paraqiten në Ditën e Kiametit - Ringjalljes, atëherë atje do ta kuptojnë

¹ “Mekatijbul Resul”, vëll. 1, f. 112.

inJORancën, pakujdesinë dhe dështimin e tyre. Atëherë do ta kuptojnë se si kanë humbur gjënë më të shtrenjtë që kanë pasur.

Ajeti tjetër qartëson kufizimin e kënaqësive të kësaj bote, në mënyrë që askush të mos mendojë se ato janë të përhershme. Për këtë, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Ne nuk kemi zhdukur asnjë vend, pa i ardhur koha e caktuar”,** si dhe: **“Asnjë popull nuk mundet as ta shpejtojë, as ta ngadalësojë afatin** (e shkatërrimit të vet)”.

All'Ilahu i Lartësuar ka dashur që t'u japë kohën e mjaftueshme keqbërësve, që të kthehen tek Ai nëpërmjet sprovimit, herë me fatkeqësi, e herë me bollëkun e mirësive. Kujt nuk i bën dobi përgëzimi me të mira, i vjen paralajmërimi. E gjitha kjo ndodh për të plotësuar argumentin kundër tyre.

Është e vërtetë se Zoti i gjithësisë u jep kohë keqbërësve, por Ai nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve të tyre. Herët a vonë, secili do të marrë shpërblimin e veprave që ka punuar.

Nga dy ajetet e fundit na qartësohet filozofia e përsëritjes së ajeteve të Kur'anit, për të përkujtuar historitë e popujve të mëparshëm.

A nuk na mjaftojnë rrëfimet e popujve të mëparshëm si mësim për të rregulluar vetet tona dhe për t'u kthyer tek All'Ilahu i Lartësuar?! Si mund të jemi të qetë duke ndenjur, derisa të na bëhet si ajo që iu bë atyre që përpara nesh prej padrejtësisë? Ne e kemi për detyrë që ta vlerësojmë situatën, se përndryshe do të bëhemi mësim për ata që do të vijnë pas nesh.

Hulumtim

Pavëmendshëmria dhe shpresa e gjatë

Shpresa është një faktor i fortë shtytës në jetën e njeriut. Nëse do të largohej shpresa nga zemra e njerëzve, atëherë do të vështirësohej së tepërmi vazhdimësia e jetës dhe shumë pak njerëz do t'i përballonin vështirësitë e saj. Në një hadith të tij, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) thotë: *"Shpresa është mëshira e ymetit tim. Nëse nuk do të ishte shpresa, nëna nuk do ta ushqente të voglin e saj, e as kopshtari nuk do ta mbillte pemën e tij".*¹

Nëse shpresa do ta kalonte kufirin e saj të pranueshëm, atëherë ajo do të shndërrohej në një ndjenjë që çon në devijim dhe shkatërrim. Shembulli i shpresës është sikurse ai i ujit të shiut që zbret nga qielli, i cili simbolizon jetën e tokës, bimëve dhe kafshëve. Nëse ai e kalon masën e duhur, atëherë do të shkaktonte përmbytje dhe shkatërrim.

Shpresa vrasëse është thelbi i injorancës ndaj All'llahut të Lartësuar, është mosnjohje e së vërtetës dhe largim nga realiteti. Ajo e bën njeriun të mbyllet në vetvete apo në rrethin e tij, ku ai fillon të ushqejë iluzione të mëdha dhe largohet nga qëllimi i ekzistencës.

Duke folur në lidhje me këtë, prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: *"O njerëz! Dy gjërave u frikësohem më së tepërmi për ju. Ato janë ndjekja e epsheve dhe shpresa e gjatë. Ndjekja e*

¹ "Sefijjnetul Bihar", vëll. 1, f. 30.

epsheve ju largon nga e vërteta, ndërsa shpresa e gjatë ju bën që të harroni Botën Tjetër”.¹

Vërtet, sa shumë ka prej atyre që kanë gëzuar pasuri e pushtet, por kanë rënë në rrjetën e mashtrimit të shpresës së gjatë dhe janë shndërruar në krijesa të dobëta?! Janë shndërruar në krijesa aq të dobëta, saqë nuk kanë qenë të aftë t’i japin asgjë shoqërisë së tyre, por e kanë humbur edhe atë që i bënte dobi vetes së tyre.

Ky realitet paraqitet konkretisht në lutjen e Kumejlit, ku thuhet: “*Më burgosi shpresa ime e gjatë...*”.

Shpresa që e kalon cakun e logjikshëm, e ekspozon njeriun ndaj preokupimit, dobësimit e çrregullimit, dhe e bën atë të mendojë se kjo gjendje do ta çojë në lumturi e rehati, por ai nuk e di se ajo e çon drejt greminës së mjerimit. Në përgjithësi, jeta e këtyre njerëzve mbushet me rrëqe lotësh dhe me ankth.

¹ “Nehxhul Belaga”, fjala 42.

Ajetet 6 - 8

﴿وَقَالُوا يَا أَيُّهَا الَّذِي نُزِّلَ عَلَيْهِ الذِّكْرُ إِنَّكَ لَمَجْنُونٌ ۖ لَوْ مَا تَأْتِينَا
بِالْمَلَائِكَةِ إِن كُنْتَ مِنَ الصَّادِقِينَ ۖ مَا نُنْزِلُ الْمَلَائِكَةَ إِلَّا بِالْحَقِّ وَمَا
كَانُوا إِذَا مُنْظَرِينَ ۝﴾

“Ata (idhujtarët) thonë: ‘O ti, që të është shpallur Këshilla (Kur’ani)! Ti je vërtet i marrë!’”

“Përse nuk na sjell engjëjt, nëse ajo që thua është e vërtetë?”

“Ne i dërgojmë engjëjt vetëm me shpallje dhe dënim, e atëherë (të dënuarve) nuk u jepet afat për të pritur.”

Komentimi

Kërkesa për zbritjen e engjëjve

Këto ajete fillojnë me qartësimin e qëndrimit të verbër armiqësor dhe fanatizmin këmbëngulës ndaj Kur'anit Famëlartë dhe Pejgamberit më të nderuar (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga ana e mohuesve dhe thotë: “Ata

(idhujtarët) **thonë: 'O ti, që të është shpallur Këshilla (Kur'ani), ti je vërtet i marrë!'**"

Nëpërmjet fjalëve të tyre shfaqet haptazi kulmi i paturpësisë dhe sjellja e keqe që i ka dalluar gjatë bisedës së tyre me Pejgamberin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku një herë thonë: **"O ti!"** e herën tjetër: **"që të është shpallur Këshilla (Kur'ani)"** me një formë përçmuese e mohuese të argumenteve të All'llahut të Lartësuar. Ata përdorin elementin përforcues *"in'ne"*, që do të thotë *me të vërtetë* dhe *"lamin"* – *"përbetues"*, që të akuzojnë me çmenduri krijesën më fisnike që ka krijuar All'llahu i Lartësuar!

Po, vërtet, i sëmuri injorant kur përballlet me një njeri të mençur e të pashembullt, gjënë e parë me të cilën e akuzon është çmenduria, sepse kjo buron nga injoranca e tij, e cila nuk e përfshin mençurinë dhe të logjikshmen. Kështu, çdo gjë sipër mendjes së tij, ai e mendon si të palogjikshme. Këta persona kanë një fanatizëm të veçantë drejt çdo gjëje që është e njohur në mjedisin e tyre shoqëror, edhe nëse ajo është e devijuar, apo të çon në humbje. Për këtë, ata i sheh të përballen me çdo thirrje të re, duke e konsideruar si të palogjikshme, dhe kapen fort pas traditave dhe zakoneve të vjetra.

Ai që jeton për këtë botë, nuk i kupton domethëniet shpirtërore dhe vlerat njerëzore dhe çdo gjë e peshon me kriteret materiale. Një njeri që sakrifikon çdo gjë, madje edhe jetën, për të arritur qëllimin e tij shpirtëror, nuk konsiderohet si njeri i logjikshëm në sytë e materialistëve, sepse sipas tyre, i logjikshëm është ai që ka pasuri të bollshme, grua të mirë e të bukur, jetë të rehatshme dhe prestigj.

Kur shohin një njeri, që i refuzon të mirat e kësaj bote, duke thënë: “Betohem për All’llahun e Lartësuar, se sikur të më vendosin Diellin në krahun e djathtë dhe Hënën në krahun e majtë, në mënyrë që unë ta lë këtë çështje, unë nuk do ta lë!”. Ata do të thonë: “Me të vërtetë, ky qenka i çmendur!”

Ajo që na tërheq vëmendjen në akuzat e drejtuara Pejgamberëve të All’llahut të Madhëruar, është se ato janë kontradiktore me njëra-tjetrën. Pejgamberin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), herë e akuzojnë se është i çmendur, e herë se është magjistar, edhe pse magjistari duhet patjetër të ketë zgjuarsin dhe aftësinë. Pra, a mund të thuhet se magjistari është i çmendur?!

Ata nuk u mjaftuan që ta quanin Pejgamberin (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të çmendur, por iu vërsulën duke thënë **“Përse nuk na sjell engjëjt, nëse ajo që thua është e vërtetë?”**.

Pastaj, Krijuesi u përgjigjet duke thënë: **“Ne i dërgojmë engjëjt vetëm me shpallje dhe dënim e atëherë (të dënuarve) nuk u jepet afat për të pritur.”**.

Nëse atyre do t’u zbrisnin engjëjt, do ta shihnin të vërtetën me sytë e tyre, e pastaj nuk do të besonin, atëherë atyre do t’u zbriste ndëshkimi i All’llahut pa mëshirë.

Për fjalën e All’llahut të Lartësuar: **“Ne i dërgojmë engjëjt vetëm me shpallje dhe dënim”**, komentuesit e Kur’anit kanë mendime të ndryshme:

1- Disa komentues mendojnë se urdhri i zbritjes së engjëjve nuk ka lidhje me pretekstin që pretendohet nga disa, por është një mrekulli e All'llahut për të treguar të vërtetën dhe për ta vërtetuar atë.

Me fjalë të tjera, mrekullia nuk ndodh për t'ua mbushur mendjen të tjerëve, por është një argument i All'llahut për të përforcuar të vërtetën dhe për të shkatërruar të kotën.

Kjo e vërtetë ushqen vazhdimisht atë që e sheh dritën si dritë dhe errësirën si errësirë, nëpërmjet asaj që na ka përcjellë Pejgamberi i Islamit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me anë të Kur'anit dhe mrekullive të tjera.

2- Kuptimi i fjalës "*el hakk*" është ndëshkimi me fatkeqësinë e shkatërrimit në këtë botë. Pra, pas zbritjes së engjëjve, mohuesit janë shkatërruar përfundimisht.

Këtë kuptim e pohon fjalia "**...dhe dënim, e atëherë** (të dënuarve) **nuk u jepet afat për të pritur**".

3- Thuhet se qëllimi me fjalën "*el hakk*" në ajet, është vdekja, që do të thotë se engjëjt nuk zbresin, vetëm se për të marrë shpirtat.

Por ky kuptim është shumë i largët nga ajo çfarë thuhet në Kur'anin Famëllartë kur flitet për zbritjen e engjëjve në rrëfimin e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe të Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), si dhe për ngjarjen e Bedrit.

4- Thuhet se kuptimi me fjalën "*el hakk*" është dëshmia (e vërteta).

Kjo nënkupton se, për sa kohë që njeriu jeton në këtë botë, ai nuk është i aftë që të shohë se çfarë ka pas saj, pra nuk mund t'i shohë engjëjt që e madhërojnë dhe e falënderojnë All'llahun e Lartësuar, sepse pengesa materiale e pengon që të shohë. Vetëm pasi të kalojë në Botën Tjetër, pengesat do të shkatërrohen dhe atëherë ai do t'i shohë engjëjt.

Ky komentim ka të njëjtin problem si komentimi i tretë, sepse për shembull, populli i Lutit që ishin në mosbesim dhe devijim, i panë engjëjt e ndëshkimit në këtë botë.¹

Nëpërmjet asaj që thamë më lart, qartësohet se komentimi i parë dhe i dytë harmonizohen me kuptimin e ajetit.

Për sa i përket asaj që citohet në fundin e ajetit, ku flitet për lënien pas dore të tyre, pas përmbushjes së kërkesave për të parë mrekullitë konkrete dhe mosbesimit të tyre në to, kjo ndodh për shkak se është përmbushur argumenti kundër tyre dhe janë hequr të gjitha arsyet dhe justifikimet që ata mund të përdorin. Për pasojë, atyre u afrohet momenti i caktuar – *exheli* – dhe marrin shpërblimin që kanë merituar.

¹ Shih suren "Hud", ajeti 81.

Ajeti 9

﴿إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ﴾

“Sigurisht, ne e kemi shpallur Kur’anin dhe, sigurisht, ne do ta ruajmë atë!”

Komentimi

Ruajtja e Kur’anit nga shtrembërimi

Pasi ajetet e mëparshme trajtuan pretendimin e mohuesve dhe talljen e tyre me të Dërguarin e All’llahut (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Kur’anin, ky ajet vjen për të qetësuar e ngushëlluar zemrën e të Dërguarit të Tij si dhe zemrat e besimtarëve të singertë, nëpërmjet shtrimit të një çështjeje të rëndësishme për mesazhin, që është ruajtja e Kur’anit nga manipulimi dhe shtrembërimi. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Sigurisht, ne e kemi shpallur Kur’anin dhe, sigurisht, ne do ta ruajmë atë!”**. Pra, ndërtimi i Kur’anit është i fortë dhe diellin e ekzistencës së tij nuk mund ta mbulojë pluhuri i devijimit. Feneri i udhëzimit të tij është përherë ndriçues. Edhe nëse do të bashkoheshin diktatorët më të fuqishëm të historisë, të mbështetur nga dijetarët e së ligës dhe ushtritë më të fuqishme, ata nuk do të

mund ta shuanin kurrë dritën e Kur'anit. Ata s'do të mund ta bëjnë kurrë një gjë të tillë, sepse i Mençuri, i Plotfuqishmi, është betuar se do ta ruajë dhe do ta mbrojë atë.

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë variante të ndryshme argumentimi për ruajtjen e Kur'anit që përmendet në këtë ajet:

1- disa kanë thënë se bëhet fjalë për ruajtjen nga shtrembërimi, ndryshimi, shtesa dhe heqja;

2- disa të tjerë kanë thënë se bëhet fjalë për ruajtjen nga humbja dhe shkatërrimi deri në Ditën e Kiametit;

3- të tjerë kanë thënë se është ruajtja e tij përballë doktrinëve të devijuara dhe të humbura, që janë në kundërshtim me të.

Përderisa nuk ekziston asnjë kundërshtim ndërmjet këtyre komentimeve dhe asnjë ndërhyrje brenda konceptit të përgjithshëm të shprehjes: **“Ne do ta ruajmë atë”**, atëherë nuk është e nevojshme që t'i kufizojmë pohimet e komentuesve vetëm në një dimension, veçanërisht sepse fraza **“do ta ruajmë atë”** është cituar në trajtë absolute dhe nuk ka asgjë që ta specifikojë atë.

Duke u bazuar në ajetin e përmendur, All'Ilahu i Lartësuar ka premtuar se do ta ruajë Kur'anin në të gjitha aspektet: prej devijimit, humbjes, harresës, si dhe nga të gjitha sofizmat e përziera të armiqve dhe nga ngacmimet djallëzore.

Disa komentues nga të parët kanë thënë se kjo frazë nënkupton ruajtjen e Pejgamberit (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke cilësuar se përemri *“lehu”* – *“atë”*, në ajet i referohet atij, si dhe fjala *“dhikr”* përdoret për të në disa

ajete të tjera.¹ Gjithsesi, ky mendim bie në kundërshtim me kontekstin e ajeteve të mëparshme, ku fjala “*dhikr*” nënkupton “*Kur’anin*”. Një argument më shumë për këtë është edhe ajeti i ardhshëm që ka të njëjtin kuptim.

Një kërkim rreth pamundësisë së shtrembërimit të Kur’anit Famëlartë

Në mesin e shumicës së dijetarëve myslimanë shi’itë dhe synitë është e ditur se Kur’ani nuk ka pasur asnjë lloj ndryshimi apo shtrembërimi. Kur’ani që është në duart tona, është po i njëjti që është shpallur në zemrën e të dashurit tonë, Pejgamberit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*). Ai nuk ka as shtesë, as mangësi, qoftë edhe me një germë apo fjalë të vetme.

Këtë mendim e kanë shprehur disa prej dijetarëve shi’itë, prej të vjetërve dhe prej të rinjve, ndër të cilët përmendim:

1- Shejkh Tusijj, i njohur dhe me emrin shejkhu Taifeh (460 H), i cili ka bërë një studim mbi këtë temë në fillim të tefsirit të tij me titullin “*Tibjan*”.

2- Sherijf Murteda, i cili konsiderohet si një nga dijetarët më të mëdhenj të Imamatis të shekullit të katërt sipas hixhretit.

3- Shejkh Saduk, Muhammed bin Ali bin Babuvejh, i cili njihet si udhëheqësi i muhadithëve (dijetar hadithesh). Në sqarimin

¹ Sure “Et Talak”, ajeti 10.

e akides Imamije, ai thotë: “... ne besojmë se Kur’ani është i plotë dhe i sigurt, pa asnjë ndryshim dhe shtrembërim.”.

4- Komentuesi i shquar shejkh Tabrasijj, i cili e trajton me detaje këtë çështje në hyrje të tefsirit të tij.

5- I ndjeri shejkh Muhammed Husejn Kashiful Gita, i cili është një nga dijetarët më të mëdhenj të dekadës së fundit.

6- I ndjeri Muhakak Jezdij, i cili ka sjellë në librin e tij “El Urvetul Uthka”, çështjen e mosshtrembërimit të Kur’anit nga një grup muxhtehidësh shi’itë.

7- Si dhe dijetarë të tjerë: shejkhu Mufijid, shejkhu Behaji, Kadij Nurullah etj.

Të njëjtën linjë kanë ndjekur edhe dijetarët dhe studiuesit e Ehli Syneetit.

Dijetari i shquar Sherijf Murteda në librin “El Mesailu Et Tarabulsijat” ka thënë: “Vërtetësia e ardhjes së Kur’anit është e kthjellët si kristali. Ajo është njësoj sikurse njohja jonë për kryeqytetet e botës, për ngjarjet e rëndësishme në histori dhe për librat e shquar. A ka ndonjë që dyshon apo e mohon ekzistencën e qyteteve si: Meka, Medina apo Londra e Parisi, edhe nëse nuk i ka vizituar ato?! A ka njeri që e mohon mësymjen e mongolëve drejt Lindjes, Revolucionin Francez, apo Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore?!

Edhe nëse ka disa tendenciozë dhe paragjykses që thonë se shijat besojnë në shtrembërimin e Kur’anit, qëllimi i tyre është që të ndezin fitilin e përçarjes dhe të ngatërresës ndërmjet shijave dhe

synive. Librat e dijetarëve të mëdhenj shi'itë i kanë kundërshtuar këto të pavërteta, që nuk kanë asnjë argument logjik.

Nuk habitemi nga thënia e Fakhrudin Rraziut, i cili në komentimin e thënies së All'llahut të Lartësuar,: **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe sigurisht, Ne do ta ruajmë atë”**, ka thënë se ky është një argument që hedh poshtë thënien e shi'iave se në Kur'an ka ndodhur ndryshim, devijim, shtesë dhe mangësi. Ne e dimë që ky njeri ka qenë shumë i ndjeshëm dhe fanatik kundrejt shi'iave.

Nëse ai ka pasur si qëllim thëniet e dijetarëve të mëdhenj shi'itë dhe studiuesit e tyre, atëherë askush nga ata nuk e beson këtë gjë.

Nëse ka për qëllim ekzistencën e një thënieje të dobët rreth kësaj çështjeje në mesin e shi'iave, pa dyshim se thënie të dobëta rreth kësaj çështjeje ndodhen edhe te synitët. Askush nga të dyja palët nuk u jep rëndësi këtyre thënieve të dobëta e të pabaza.

Këtë tematikë e ka shpjeguar me qartësi dijetari i shquar shejkh Xhaferri, i njohur si Kashiful Gita, në librin e tij “Kashiful Gita”, ku thotë: “Nuk ka dyshim se Kur'ani është i ruajtur dhe i mbrojtur nga mangësia, prej një meleku të quajtur *dejjan*, siç e ka treguar qartë Kur'ani dhe konsensusi i dijetarëve në çdo kohë, dhe nuk merren për bazë gjërat e rralla”.¹

Në të vërtetë, historia islame është e mbushur me akuza e shpifje të kota, të ushqyera nga gjiri i fanatizmit të egër. Pas këtyre akuzave qëndrojnë armiqtë e Islamit, të cilët kanë për synim nxitjen

¹ Tefsiri “Alau Rrahman”, f. 35.

e urrejtjes brenda fesë së vetme. Qëllimi i tyre është që ta shohin ymetin islam të përçarë dhe të paaftë për t'u ngritur e për të kryer detyrat e tij.

Një shkrimtar i njohur nga banorët e Hixhazit - Arabisë Saudite - i fyen dhe i poshtëron shi'iat në librin e tij "Es Sirau", ku thotë: "Shi'iat janë gjithmonë armiqtë e xhamive".¹

Nëse bëjmë një statistikë për numrin e xhamive nëpër rrugë, lagje dhe tregje në qytetet e shi'ave, do të na duhej një kohë e gjatë për t'i numëruar për shkak të numrit të tyre të madh. Madje, numri i tyre është aq shumë, sa që disa shi'ia e kanë bërë problem këtë çështje dhe kanë bërë thirrje që bamirësit të ndihmojnë jetimët dhe spitalet, në vend të ndërtimit të xhamive, për shkak të numrit të mjaftueshëm të këtyre të fundit.

Argumentet që tregojnë se Kur'ani nuk është shtrembëruar

1- Argumentet që vërtetojnë se Kur'ani nuk ka pësuar shtrembërime janë të shumta.

Përpara se t'i përmendim ato, duhet të theksojmë se ai që ka supozuar shtrembërimin në Kur'an, ka dashur të tregojë se Kur'ani është i mangët.

Nga një shqyrtim i historisë së jetës së myslimanëve, vërejmë se ata e kanë përdorur Kur'anin në të gjitha sferat e jetës së tyre. Kur'ani është kodi, ligji suprem në gjykim, është kushtetuta, sistemi

¹ "Es Sirau" i autorit Abdullah Ali El Kamisi, vëll. 2, f. 23, sipas asaj që ka transmetuar prej tij dijetari El Emîni në librin "El Gadiru", vëll. 3, f. 300.

i shtetit, një libër i shenjtë qiellor dhe simbol i adhurimit. Duke pasur parasysh të gjitha këto, a është e mundur që ky libër të ketë mangësi apo shtesë?!

Historia na tregon se Kur'anit nuk e ka dalluar myslimanin: në namazin e tij, në xhami, në shtëpi, apo në fushëbetejë. Ky Libër ka qenë i pranishëm në të gjitha çështjet e myslimanëve, të vogla apo të mëdha.

Pra, pyesim sërish: A është e mundur, që këtë libër qiellor ta godasë shigjeta e shtrembërimit dhe e ndryshimit, në një kohë kur ai është i ruajtur në zemra - është mësuar përmendësh nga hafizët e Kur'anit - dhe në moralin e myslimanëve gjatë gjithë historisë?!

Siç e kemi treguar në vëllimin e parë të këtij tefsiri, mbledhja dhe tubimi i Kur'anit është bërë në kohën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*). Myslimanët e parë i kanë kushtuar një rëndësi të madhe dhe janë kujdesur për të në të gjitha aspektet: në mësimin e rregullave të tij dhe mësimin përmendësh. Kur'anit i është dhënë aq shumë rëndësi, sa që pozita e individit filloi të vlerësohej me sasinë e mësimin përmendësh të sureve të tij. Numri i hafizëve pati arritur aq shumë, sa që në një nga betejat patën rënë dëshmorë katër mijë prej tyre.¹

E tillë ka qenë gjendja edhe në kohën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), ku kanë rënë dëshmorë 70 vetë nga shokët e tij, të cilët ishin hafizë, në betejën e Bî'ru Maunetit (një zonë afër Medines).²

¹ "Muntekhab Kenzul Ummal", marrë nga "El Bejan fîj Tefsiril Kur'an", f. 262.

² "Sefijnetul Bihar", vëll. 1, f. 57.

Këta dy shembuj si dhe shumë shembuj të tjerë tregojnë se hafizët - që e mësojnë Kur'anin përmendësh - lexuesit dhe mësuesit e Kur'anit ishin të shumtë, aq sa në një betejë të vetme patën rënë dëshmorë një numër i madh prej tyre.

Kjo është e zakonshme nëse vërejmë mënyrën se si kanë punuar e janë sjellë myslimanët me Kur'anin, duke e konsideruar atë si një kod gjykues dhe si Libër të Shenjtë, me të cilin nuk ka të ngjashëm.

Kur'ani Famëlartë nuk ka qenë një libër i neglizhuar e i harruar në qoshet e shtëpive dhe xhamive të myslimanëve. Atë nuk e ka mbuluar pluhuri i harresës, aq sa t'i jepet mundësia dikujt që të shfrytëzojë rastin e të shtojë apo të heqë ndonjë gjë. Mësimi përmendësh i Kur'anit ka qenë dhe është një adhurim i madh, një synet i ndjekur, rrënjët e të cilit shtrihen herët në historinë islame.

Pasi u shfaqën shtypshkronjat, Kur'ani Famëlartë ka qenë libri që është shtypur më shumë dhe është shpërndarë në radhët e myslimanëve në të gjitha vendet. Nuk ka asnjë qytet apo vend islam që nuk ka hafizë të Kur'anit. Shembujt janë më shumë se sa thuhet, pasi në vendet islame ka shkolla specifike të leximit dhe mësimit përmendësh të Kur'anit.

Në librin e tij "Dairatul Mearife", Ferid Uixhdij thotë: "Një nga kushtet për t'u pranuar në universitetin e Ez'herit në Egjipt, është të mësuarit e Kur'anit përmendësh; pra, kandidati duhet të jetë hafiz dhe shkalla e kalueshmërisë është 20 - 40, si kufiri më i ulët.

Mësimi i Kur'anit përmendësh që në kohën kur është shfaqur Islami, është bërë një synet (traditë) i gjallë në jetën e

myslimanëve, duke ndjekur këshillat e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*). Këtu shtrojmë pyetjen: A ekziston ndonjë hapësirë për shtrembërim në Kur'an?!

2- Regjistruesit e Shpalljes kanë qenë persona, të cilëve vetë i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ua caktoi detyrën e rëndësishme të shkrimit të ajeteve të Kur'anit, pasi ato shpallëshin. Tregohet se numri i tyre ka qenë rreth 14 - 43 persona.

Ebu Abdullah Zenxhanij në librin e tij "Tarikhul Kur'an", f. 24, thotë: "Pejgamberi ka pasur regjistrues - sekretarë - që e shkruanin Revelatën, dhe ata ishin dyzet e tre persona. Më të njohurit ishin katër kalifët. Më të angazhuarit prej tyre kanë qenë Zejd bin Thabit dhe Ali bin ebuTalibi. Si është e mundur që të ketë shtrembërim një libër që ka gjithë këta shkrues?!

3- Thirrja e Imamëve, të ruajtur nga gjynahet, për të punuar e vepruar sipas Kur'anit Famëlartë - Nëse i shqyrtojmë fjalët e tyre, do të shohim se ata kanë bërë thirrje për ta lexuar dhe për ta mësuar Kur'anin, si dhe për të punuar sipas udhëzimeve të tij. Edhe ky është një argument që tregon se duart e prishura e shkatërruese nuk mundën ta preknin këtë libër qiellor.

Hytbet e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), të përcjella në "Nehxhul Belaga", janë dëshmia më e qartë për këtë pretendim. Në hytben 133 lexojmë: "*Librin e All'llahut e keni në mesin tuaj. Ai tregon dhe gjuha e tij nuk ngatërrohet. Ai është si një shtëpi, shtyllat e së cilës nuk rrënohen. Ai është si një fuqi, përkrahësit e së cilës nuk do të pësojnë kurrë disfatë.*".

Në hytben 176, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: *“Dijeni se ky Kur'an është këshilltar që nuk mashtron, është udhëheqës që nuk shpie në rrugë të shtrembër.”*.

Po në të njëjtën hytbe, ai thotë: *“Askush nuk do të ulet afër Kur'anit, e kur të çohet nga vendi, të mos jetë në fitim ose humbje; me fitim në të udhëzuarit e vet, ose me humbje në verbërinë e vet.”*.

Më tej, ai thotë: *“Me të vërtetë, All'llahu i Madhëruar nuk e ka këshilluar asnjërin në diçka që është e ngjashme me këtë Kur'an, ngase ai është një litar i fortë i All'llahut dhe një instrument i sigurtë i Tij.”*.

Në hytben 197, Imam Aliu thotë: *“Pastaj, Ai ia shpalli Librin si një dritë, flaka e të cilit nuk shuhet; si një kandil, ndriçimi i të cilit nuk mund të zhduket; si një rrugë, drejtimi i së cilës nuk shpie në prapësi; si një degëzues, argumenti i cilit nuk dobësohet; si një sqarim, themelet e të cilit nuk rrënohen.”*.

Nëse supozojmë se në këtë libër qiellor është futur dora e shtrembërimit, a është e mundur që Imamët të bëjnë thirrje për ta ndjekur atë me gjithë këtë forcë dhe të thonë se ai është rruga e drejtë e udhëzimit, mënyra e vetme që bën dallimin midis të vërtetës dhe të kotës, një dritë që nuk shuhet asnjëherë, një ndriçim i udhëzimit të pashtershëm, litari i fortë i All'llahut dhe premtimi i mbajtur?!

4- Nëse pranojmë se Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) është vula e Profetëve, se feja islame është vula e të gjitha feve hyjnore dhe se mesazhi i Kur'anit është i përherëshëm deri në Ditën e Kiametit, a mund të besohet se All'llahu i Lartësuar nuk e ruan argumentin e fesë së Tij dhe argumentin e të Dërguarit të Tij, i cili është vula e Profetëve? A

është e mundur që të bashkohet devijimi i Kur'anit me mbijetesën e Islamit gjatë mijëra viteve dhe vazhdimësia e tij deri në fund të kësaj bote?

5- Për origjinalitetin e Kur'anit dhe ruajtjen e tij nga çdo papastërti ka argumente të përcjella prej Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*).

Transmetohet nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Unë po ju lë juve dy gjëra me peshë të madhe për nga rëndësia: Nëse ju do të kapeni për këto të dyja, nuk do të humbisni kurrën e kurrës pas meje, Librin e Allahut dhe gjenezën time, Ehli Bejtin tim.”¹

A mund të jetë i vërtetë ky përshkrim ndaj një Libri, drejt të cilit zgjatet dora e shtrembërimit?!

6- Përveç kësaj, Kur'anit u ka dhënë avantazh myslimanëve, duke u shërbyer si një vijë ndarëse e standartit të sigurtë e të besueshëm, në dallimin e haditheve të sakta nga ato të devijuara (të shpikura). Shumë transmetime të cituara nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) tregojnë për vërtetësinë apo të pavërtetën e secilit hadith nëpërmjet ballafaqimit me Kur'anin. Kështu, ai hadith që është në përputhje me Kur'anin, është i saktë, ndërsa ai që bie në kundërshtim me Kur'anin, është i shpikur dhe i pavërtetë.

¹ Hadithi i “Thekalejnit” është prej haditheve të shpeshta, i transmetuar nga një grup sahabësh, si: Ebu Seid Khuderij, Zejd bin Arkam, Zejd bin Thabit, Hudhejfe bin Usejd, Xhabir bin Abdullah Ensarij, Abdullah Hantab, Abd bin Hamid, Xhubejr bin Matam, Dammere el Eslemij, Ebu Dherr Gifari, Ebu Rafiu, Ummu Seleme e të tjerë.

Nëse supozojmë se Kur'ani ka pësuar devijim apo shtrembërim (qoftë edhe në trajtë pakësimi), a mund të konsiderohet ai si një ndarës ndërmjet të vërtetës dhe të kotës, ose si një kalibër i saktë në dallimin e hadithit të saktë nga hadithi i shpikur dhe i dobët?!

Transmetimet e shtrembërimit

Ata që flasin për devijimin apo ndryshimin e Kur'anit mbështeten në transmetime, kuptimet e të cilave janë keqkuptuar, ose në transmetimet që kanë probleme në zinxhirin e tyre. Transmetimet e shtrembëruara mund të ndahen në tri kategori:

1- Transmetimet ku thuhet se Aliu urdhëroi të mblidhej Kur'ani, pas kalimit të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) nga kjo botë. Pasi e mblodhi atë, ia paraqiti një grupi prej sahabëve, prej të cilëve ishin edhe ata që u ulën në pozitën e kalifatit, por ata nuk e pranuan prej tij. Aliu tha: *"Në të vërtetë, pas kësaj ju kurrë nuk do ta shihni atë!"*.

Duke parë me vëmendje këto transmetime, arrijmë në përfundimin se Kur'ani që ka pasur Aliu, nuk ndryshonte me kopjet e tjera të Kur'anit për nga përmbajtja, përveç ndryshimit të tij në paraqitje dhe renditje në tri gjëra:

E para: ajetet dhe suret e atij Kur'ani kanë qenë të renditura sipas historikut të zbritjes;

E dyta: në të përfshihej edhe argumentimi i shkakut të zbritjes për secilin ajet dhe sure;

E treta: në të përfshihej komentimi i Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) për ajetet, duke shtuar edhe citimin e ajeteve të pavlefshme dhe të abroguara.

Kur'an i që ka mbledhur Prijësi i Besimtarëve është i njëjti Kur'an ekzistues, përveçse ai shtoi në të: komentimin, interpretimin, shkakun e zbritjes, qartësimin (i pavlefshëm ose i abroguar) dhe të ngjashme me këto. Pra, e thënë ndryshe, ai ka qenë një Kur'an me komentimin e tij origjinal.

Në librin e Sulejm bin Kajsit thuhet: "Kur Prijësi i Besimtarëve e pa distancimin e sahabëve dhe mungesën e besimit të tyre, ai qëndroi në shtëpinë e tij, iu kushtua Kur'anit dhe kur e mblodhi atë të tërën, e shkroi me dorën e tij, së bashku me komentimin e pezullimit dhe të abrogimit. Atij i dërguan lajm që të dilte nga shtëpia, por ai u përgjigj se ishte i zënë e kishte vendosur të mos e vishte rrobën e tij vetëm se për të falur namaz, derisa ta shkruante Kur'anin dhe ta tubonte atë".¹

2- Transmetimet që tregojnë "shtrembërimin shpirtëror" të Kur'anit

Siç e dimë, devijimi është tre llojesh: verbal, moral dhe praktik.

Shtrembërimi verbal është ndryshimi i fjalëve dhe i shprehjeve të Kur'anit, shtimi apo heqja e diçkaje në të (kjo gjë mohohet nga të gjithë studiuesit e Islamit).

¹ "Biharul Enuar", vëll. 92, f. 40.

Shtrejbërimi moral është komentimi i ajeteve në kundërshtim me kuptimin e tyre të saktë.

Shtrejbërimi praktik është të vepruarit në kundërshtim me atë që obligohet.

Në tefsirin e Ali Bin Ibrahim nga Ebu Dherri transmetohet se ai ka thënë: "Ka zbritur ky ajet ku Allahu i Lartësuar thotë: '**Ditën (e Kiametit) kur disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të nxihen**'. " I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Ymeti im do të paraqitet para meje Ditën e Kiametit me shtatë flamuj, një flamur i këtij ymeti përshpejtonte, dhe unë i pyes ata: 'Çfarë bëtë pas meje me Kur'anin me peshë të madhe për nga rëndësia? Ata përgjigjen: 'Të madhin e shtrejbëruam dhe e gjuajtëm pas shpine...' "¹

Është e qartë se devijimi këtu ka për qëllim shtrejbërimin moral e shpirtëror të Kur'anit dhe gjuajtjen e tij pas shpine.

3- Transmetimet e fabrikuara

Armiqtë e kësaj feje dhe të devijuarit kanë shpifur për rrugën e drejtë, kurse injorantët i kanë ndjekur ata në shpikjen e disa transmetimeve, ku goditet ndershmëria dhe shenjtëria e Kur'anit. Nga këto transmetime janë ato të Ahmed bin Muhammed bin Sejarij, numri i të cilave është 188.² Shumë nga këto transmetime i ka përmbledhur shejh Nuri në librin e tij "Faslul Kitab".

¹ Tefsiri "Burhan", komentimi i ajetit 106 të sures "Ali Imran".

² Këtë llogaritje e ka përmendur autori i librit (El Burhanul Mubin).

Sejjariu, te shumica e dijetarëve ka qenë i përfolur dhe i kontestuar. Ata kanë thënë se ai ka qenë një njeri i prishur, i shthurur në medh'heb dhe i dobët në hadith.

Sipas disave, ai ka qenë ekzagjerues, devijues, i njohur për thënien e rimishërimit dhe mashtrues. Kurse Keshijju, autori i librit "Rrixhalu Maruf" thotë se Imam Xhevadi (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka përshtatur pretendimet e Sejjarit në letrën e tij, si gënjeshtër dhe të kota.

Në mesin e këtyre transmetimeve të shpikura, e qesharake, që i mohon çdo njeri i ditur dhe i mençur, është ai që ka ardhur për shpjegimin e ajetit 3 të sures "En Nisa", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimëve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë."** Transmetimi thotë: Në mes të kushtit dhe dënimit ra një e treta e Kur'anit!!! Në komentimin e ajetit që cekëm më lart, kemi shpjeguar se kushti dhe dënimi në ajet janë të pandara dhe të lidhura ngushtë.

Duke pasur parasysh se një e treta e Kur'anit është baraz me katërmëdhjetë xhuze përafërsisht, si mundet që ky pretendues të thotë se Kur'ani nuk ka patur regjistruar të Revelatës, hafizë, që e kanë mësuar përmendësh, dhe lexues që nga koha e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*)? A mund të ndodhë kjo e të mos e vërejë askush?!

Sikur ata nuk e kanë jetuar historinë me realitetin dhe kthjelltësinë e saj! A nuk e ka vërtetuar historia, se gjëja më themelore në jetën e myslimanëve është Kur'ani? A nuk ka qenë lexuar Kur'ani në çdo kohë të ditës dhe të natës nëpër të gjitha shtëpitë dhe xhamitë e myslimanëve? Atëherë, si mund të

supozohet që të humbasë një fjalë e vetme pa e vënë re askush, e madje të thuhet se ka humbur një e treta e Kur'anit?!

Me të vërtetë, një gënjeshtër e tillë është argument i qartë për naivitetin e hartuesit të haditheve të tilla.

Shumica e pretenduesve të shtrembërimit të Kur'anit janë mbështetur në librin "Faslul Kitab", i cili u citua më lart.

Do të tregojmë qëllimin e këtij libri, duke përmendur ato që ka shkruar nxënësi i shkrimtarit të njohur, shejkh Tahrani, në vëllimin e parë të librit të tij "Mustedrekul Uesail", ku tregon se e ka dëgjuar shpesh mësuesin e tij të thotë: "Ajo çfarë gjendet në librin "Faslul Kitab" nuk përfaqëson besimin tim personal, por e kam shkruar për diskutim dhe debat. Aty unë kam treguar besimin tim për moshtrembërimin e Kur'anit, por pa e sqaruar mirë."

Muhadith Tahrani thotë: "Kjo është ajo çfarë kemi dëgjuar nga vetë shejhu ynë. Sa i përket veprës së tij, ne e kemi parë që nuk e ka vlerësuar atë që citohet në përmbajtjet e këtyre transmetimeve. Askush nuk mund t'ia dedikojë këtë shtrembërim të Kur'anit mësuesit tonë, përveç atij që nuk e njeh besimin dhe qëllimin e tij."

Së fundmi, jehuditët masonë kanë shtypur një kopje të re të Kur'anit, ku kanë ndryshuar shumë ajete kur'anore. Siç është e premtuar, dijetarët myslimanë e kanë vërejtur menjëherë këtë intrigë të pisët e të shëmtuar dhe i kanë mbledhur ato kopje. Kështu, përpjekja e këtyre keqdashësve dështoi dhe u braktis.

Këta armiq që i kishin zemrat e errëta, dështuan, sepse nëse ndryshohet qoftë dhe një pikë e vetme në Kur'an, atëherë do të ngriheshin në këmbë mbikëqyrësit komentues, hafizat dhe lexuesit

e këtij Libri madhështor. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e All'llahut me gojën e tyre, por All'llahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë.”**¹

¹ Sure “Et Teube”, ajeti 32.

Ajetet 10 - 15

﴿وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي شَيْعِ الْأَوَّلِينَ ۝ وَمَا يَأْتِيهِمْ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ۝ كَذَلِكَ نَسْلُكُهُ فِي قُلُوبِ الْمُجْرِمِينَ ۝ لَا يُؤْمِنُونَ بِهِ وَقَدْ خَلَتْ سُنَّةُ الْأَوَّلِينَ ۝ وَلَوْ فَتَحْنَا عَلَيْهِمْ بَابًا مِنَ السَّمَاءِ فَظَلُّوا فِيهِ يَعْرُجُونَ ۝ لَقَالُوا إِنَّمَا سُكَّرَتْ أَبْصَارُنَا بَلْ نَحْنُ قَوْمٌ مَسْحُورُونَ﴾^{۱۵}

“Ne u kemi çuar të Dërguar edhe para teje, grupeve të mëparshme.”

“Por ata talleshin me çdo të Dërguar që u vinte.”

“Ja, kështu ne e bëjmë mohimin të futet në zemrat e gjynahqarëve.”

“Ata nuk e besojnë atë, me gjithë shembujt e popujve të kaluar.”

“Edhe sikur ne të hapnim një derë të qiellit dhe të ngjiteshin nëpër të.”

“Ata me siguri që do të thoshin: ‘Sytë tanë kanë qenë të shushatur, madje na kanë magjepsur!’”

Komentimi

Kokëfortësia dhe fanatizmi

Këto ajete ngushëllojnë zemrën e Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) dhe zemrat e besimtarëve ndaj vështirësive që përballeshin gjatë thirrjes së tyre, duke treguar luftën e Profetëve të mëparshëm me popujt e tyre të humbur e fanatikë.

Në fillim, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ne u kemi çuar të Dërguar edhe para teje, grupeve të mëparshme.”**. Por ata, nga kokëfortësia dhe fanatizmi, arritën deri aty sa: **“Por ata talleshin me çdo të Dërguar që u vinte.”**.

Kjo tallje e përçmim ka ndodhur për disa arsye:

- ata duan që ta ulin poshtë personalitetin e Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), në mënyrë që të mos ketë ndikim në mesin e një grupi të vetëdijshëm e që kupton;

- ata përpiqen, që me tallje të mbulojnë dobësinë dhe pafuqinë e tyre përpara logjikës së fortë dhe argumenteve imponuese të të Dërguarve të All'llahut të Lartësuar (*Paqja qoftë mbi ta!*);

- ata habiten nga thirrjet revolucionare të Profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*), kundër mënyrës së jetës së tyre të prishur dhe traditave të tyre të kalbura. Injoranca dhe fanatizmi i tyre i nxit që ata të përçmojnë e të tallen.

- ata përpiqen të rrinë të hutuar në ndërgjegjen e tyre, në mënyrë që të mos zgjohen e të përqafojnë të vërtetën dhe të marrin mbi shpatulla peshën e përgjegjesisë së saj.

- kjo tallje mund të jetë për shkak të absurditetit të masës dhe standartit të tyre për shembullin dhe udhëheqësin. Sipas tyre, komandanti apo udhëheqësi duhej të ishte nga shkalla e pasur e hierarkisë. Vlerën e njeriut, ata e shihnin te rrobat e shtrenjta, mjeti luksoz, shtëpia luksoze - kështjella - dhe jeta e tij e mbushur me zbukurime. Nëse zgjohet me thirrje, një njeri i varfër që nga kjo botë nuk posedon asgjë, atëherë ai do të tallet prej tyre.

- sipas mendimit të tyre, t'i përgjigjesh thirrjes apo të pranosh mesazhin e Profetëve, do të thotë të lësh pasionet e dynjasë si dhe të mbartësh detyra të reja. Kështu, ata gjejnë strehë tek tallja për të shfajësuar kundërshtimin e tyre e për të qetësuar ndërgjegjen.

Pastaj, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Ja, kështu ne e bëjmë atë (Kur'anin) të futet në zemrat e gjynahqarëve”**, do me thënë: këto ajete kur'anore i fusim në thellësitë e zemrave dhe mendjeve të tyre.

Me qartësinë më të madhe të kumtimit, pohimit dhe sqarimit të logjikës hyjnore, si dhe me shfaqjen e mrekullive, All'Ilahu u bën vërejtje mohuesve dhe fanatikëve tallës duke u thënë: **“Ata nuk e besojnë atë”**; por kjo nuk është një risi: **“me gjithë shembujt e popujve të kaluar.”**

Gjendja e atyre që janë të zhytur në epshet e dëshirat e kësaj bote dhe që këmbëngulin fort në kokëfortësinë e tyre për të kotën, arrin deri aty, sa që ata nuk besojnë edhe sikur: **“Edhe sikur Ne të hapnim një derë të qiellit dhe të ngjiteshin nëpër të”**; e

megjithatë, **“ata me siguri që do të thoshin: ‘Sytë tanë kanë qenë të shushatur, madje na kanë magjepsur!’”**.

E habitshme që njeriu të arrijë deri në këtë gradë të ulët të kokëfortësisë dhe të fanatizmit!

Mëkatet, injoranca dhe kundërshtimi ndaj të vërtetës kanë ndikim te shpirtrat e pastër dhe te natyra e pastër njerëzore. Ato ua mbulojnë atyre shikimin e realitetit dhe i ndalojnë nga të kuptuarit e të vërtetave. Nëse njeriu nuk arrin t’i largojë këto pengesa, pa dyshim që e vërteta dhe e drejta do të ndoten në mendjen e tij, dhe ai do të mohojë çdo gjë që është e pranueshme dhe e prekshme. Nëse kjo gjendje lëshon rrënjë në zemrën e tij, atëherë ai nuk e ka të lehtë që ta çrrënjosë atë. Në këtë rast, argumentet logjike, por as argumentet konkrete më të qarta, nuk do të lënë asnjë ndikim në zemrën e tij.

Hulumtime

1- Shumësi i fjalës “*shi’iatun*” është “*shijeun*” dhe përdoret për çdo grup apo sekt që kanë një program të përbashkët.

Në librin e tij “Mufredat”, Ragib Asfehani kapitulli “*shi’iatu*” thotë: Fjala “*esh shijjau*” ka kuptimin e përhapjes, shpërndarjes dhe të fuqizimi. Thuhet: *shaá el khaberu* - u përhap lajmi, d.m.th. u përhap dhe u forcua; *shaá el kaumu* - u përhap dhe u shtua; *sheja' tu en nare bil hatabi* - e forcova atë. Kurse “*esh shi’iatu*” ka kuptimin e atyre me të cilët një njeri forcohet”.

Dijetari i shquar Tabresijj në tefsirin “Mexhmaul Bejan” thotë se rrënja e kësaj fjale është nga fjala “*meshajjeatu*”, që do të thotë *ndjekje*. Për shembull thuhet: “*shajea filan filanen fij emrihi*”, që do të thotë: *e ndoqi dhe e pasoi atë*. Nga këta janë shijat e Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ata që e kanë ndjekur dhe që e kanë vendosur Imam të tyre. Në hadithin e përcjellë nga Umu Seleme, i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) thotë: “Shi’iat e Aliut - ndjekësit e tij - do të jenë fitimtarë në Ditën e Gjykimit”.

Sido që të jetë, fjala **shijaun** do të thotë *përhapje* dhe *fuqizim*, kurse fjala **meshajeatu** ka kuptimin *ndjekje*. Secila prej të dyjave janë argument se ekziston një lloj uniteti dhe lidhjeje ideologjike dhe fetare mes “*shiatsu*” dhe “*teshejju*”.

Përdorimi i fjalës **shijeun** - **sekte** - ndaj popujve të mëparshëm, tregon se ata kanë qenë të unifikuar e bashkëpunues përballë thirrjes së Profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Nëse popujt e humbur kanë pasur këtë unifikim dhe harmoni, a nuk duhet që ndjekësit e së vërtetës të ecin në dritën e udhëzimit të saj, të unifikuar dhe bashkëpunues me njëri-tjetrin?

2- Referimi i përemrit në fjalën e All'Ilahut të Lartësuar, ku thuhet: **“Ja, kështu ne e bëjmë atë (Kur'anin) të futet”**, është prej mëshirës së All'Ilahut të Lartësuar, dhe ka kuptimin: *Ne i bëjmë keqbërësit dhe kundërshtuesit me të gjitha format, që t'i kuptojnë ajetet e Kur'anit, se ndoshta ai qëndron në zemrat e tyre. Por, mungesa e vendit të pastër dhe të përshtatshëm, bëhet shkak që ajetet të dalin nga ato zgavra të qelbura, duke i lënë përsëri si zemra të pandjeshme. Ky ngjason me shembullin e ushqimit të dobishëm në një stomak të sëmurë, i cili nuk e pranon dhe e vjell jashtë. Ky kuptim përfitohet nga fjala “suluk”, që është lënda kryesore e shprehjes “neslukuhu”.*

Duke u bazuar në këtë, përemri në fjalën “neslukuhu” i referohet fjalës “dhikër”, domethënë Kur'anit, sikurse citohet në ajetet e lartpërmendura. Gjithashtu, e njëjta gjë vlen edhe për përemrin në frazën: **“Ata nuk e besojnë atë”**, që gjithashtu i referohet Kur'anit; d.m.th. se pavarësisht kësaj, ata nuk e besojnë atë Kur'an.

Këtu vërejmë harmoninë e plotë ndërmjet dy përemrave me njëri-tjetrin, siç ndodh edhe në suren “Esh Shuara”, në ajetet 200 dhe 201.

Disa komentues kanë thënë se përemri tek fjala “neslukuhu”, që do të thotë: *“ne e bëjmë mohimin të futet”*, i referohet talljes së përmendur në ajetin e mëparshëm. Në këtë mënyrë, sipas tyre, kuptimi i ajetit është: *Ne bëjmë të mundur, që tallja dhe përçmimi të futen në zemrat tuaja, si rezultat i mëkateve dhe i kokëfortësisë.*

Gjithashtu, nga shprehja: *“ne e bëjmë mohimin të futet”* kuptojmë se përcjellësi i mesazhit dhe udhërrëfyesi e ka për detyrë që të mos mjaftohet vetëm me ofrimin e zërit në kryerjen e obligimit të tij, por ai duhet të provojë të gjitha mënyrat derisa të përçojë zërin e së vërtetës në zemra.

Pra, me fjalë të tjera, mesazhi duhet të përftohet nga të gjitha mënyrat: me të dëgjuarit, të shikuarit, me programe të ndryshme praktike, letërsi - prozë, poezi dhe tregime, - dhe me art, në mënyrë që fjala e vërtetë të jetë e qartë për zemrat që kuptojnë. Argumenti është i qartë për atë që ka bërë padrejtësi dhe ka kundërshtuar.

3- Ligji - syneti - i të parëve: ajeti i lartpërmendur na rrëfen se mënyrat e njerëzve të humbur, të cilët përpiqen që t'i përçajnë njerëzit e t'i largojnë nga miqtë e All'llahut, nuk janë të kufizuara në një kohë apo në një vend të caktuar. Këto mënyra kanë ekzistuar që në lashtësi dhe do të ekzistojnë derisa të ekzistojë lufta ndërmjet të vërtetës dhe të kotës mbi sipërfaqen e tokës. Prandaj, ne nuk duhet të dëshpërohemi nga kjo gjë e të dorëzohemi përpara problemeve dhe intrigave që i projektojnë armiqtë.

Nuk do të lejojmë që dëshpërimi të futet në zemrat tona, nuk do t'i lejojmë metodat e armiqve që të na bëjnë të humbasim besimin në vetvete, por do të kujtojmë synetin - rrugën - e të parëve tanë në Kur'an, që është një ngushëllim i mirë e një qetësim për zemrat e thirrësve të besimit.

Nëse mendojmë se përhapja e thirrjes së të vërtetës dhe ngritja e flamurit të drejtësisë e të udhëzimit, nuk do të përballen me kundërpërgjigjen e armiqve, atëherë do të bënim një gabim të madh. Detyra jonë është që të ndjekim rrugën e drejtë të

Pejgamberëve (*Paqja qoftë mbi ta!*) në përballjen e tyre ndaj armiqve të All'Ilahut dhe ta konkretizojmë në moralin dhe sjelljen tonë.

4- Komentimi i shprehjes “dhe të ngjiteshin nëpër të”: kjo pjesë kur'anore përshkruan gjendjen e këmbëngulësve në mohim. Edhe nëse atyre do t'u hapej një portë në qiell nga e cila të ngjiteshin dhe të zbrisnin, ata do të thonin: “sytë tanë janë magjepsur dhe janë penguar nga shikimi i realitetit!” (qëllimi me fjalën “*qiell*” në këtë ajet është për hapësirën e jashtme, në të cilën nuk mund të depërtohet me lehtësi).

Fjala “*dhal'lu*”, që do të thotë *kanë qëndruar*, përdoret për vazhdimin e veprimtarisë gjatë ditës. Sinonim i saj është fjala “*batu*”, që do të thotë *kanë qëndruar natën*.

Shumica e komentuesve anojnë nga ky mendim, megjithatë disa prej tyre mendojnë se përemri “*dhal'lu*”, u referohet melekëve. Në këtë rast, kuptimi i ajetit do të ishte: *në të vërtetë, edhe sikur ata t'i shikonin me sytë e tyre melekët duke u ngjitur e duke zbritur nga qielli, përsëri nuk do të besonin!*

Por, ka një mungesë harmonie të këtij mendimi me zinxhirin e ajeteve të mëparshme dhe atyre në vijim, ku flitet për idhujtarët, dhe ku përmendja e melekëve është cekur përpara gjashtë ajeteve. Ky kuptim e zvogëlon retorikën e shprehjes kur'anore, sepse Kur'ani dëshiron të thotë se idhujtarët nuk i dorëzohen të vërtetës, edhe sikur të ngjiten dhe të zbresin nga qielli disa herë në orët e ditës.

5- Kuptimi i shprehjes “Sytë tanë kanë qenë të shushatur.”. Fjala “*sukkiret*” rrjedh nga “*sekere*”, që do të thotë *mbulesë dhe perde*.

Mohuesit dhe kundërshtarët thonë: *sytë tanë janë mbuluar dhe u është vënë perde, që të mos i shohin realitetet. Edhe nëse i shikojmë vetet tona duke u ngjitur e duke zbritur nga qielli, do të gjykojmë se kjo është një imagjinatë dhe ëndërr, ashtu siç është rasti i prestigjiatorit, i cili përfiton nga shkathhtësia dhe zhërvjelltësia e dorës së tij, duke mashtruar shikimet e atyre që janë të pranishëm.*

Ata shtojnë thënien: **“madje na kanë magjepsur!”**, pavarësisht se manipulimet janë një nga llojet e magjisë, por mbase ata tregojnë diçka që është më e fortë se prestigjatura, e cila kufizohet vetëm te mashtrimi i shikimit. A nuk është magji e plotë, ajo që e mbulon të gjithë ekzistencën e njeriut dhe bashkë me të e humb edhe ndjenjën e realitetit?!

Nëse një njeriu do t'ia mbyllnim sytë, ai sërisht nuk do t'i humbiste ndjesitë e ngjitjes lart apo të zbritjes poshtë.

Kuptimi i ajetit është: *nëse idhujtarët do të ngjiteshin në skajet e qiellit, ata do të thonin: “Në të vërtetë, neve na goditi magjia”*. Pasi ta vërejnë se ky veprim nuk ndalet vetëm tek syri, atëherë ata do të thonë: *“Në të vërtetë, neve na është bërë magji!”*.

Ajetet 16 - 18

﴿وَلَقَدْ جَعَلْنَا فِي السَّمَاءِ بُرُوجًا وَزَيَّنَّاهَا لِلنَّاظِرِينَ^{١٦} وَحَفِظْنَاهَا مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ^{١٧} إِلَّا مَنْ اسْتَرَقَ السَّمْعَ فَاتَّبَعَهُ شِهَابٌ مُبِينٌ^{١٨}﴾

“Ne kemi krijuar yjësi në qiell dhe e kemi zbukuruar atë për shikuesin.”

“Ne e ruajmë atë (qiellin) nga çdo djall i mallkuar.”

“Përveç ndonjërit që dëgjon vjedhurazi e të cilin e arrin një yll i këputur me flakë të dukshme.”

Komentimi

Këto ajete tregojnë një anë të botës së krijesave dhe ndihmojnë për t’u thelluar në njohjen dhe monoteizmin e All’llahut të Lartësuar. Me to plotësohen dy hulumtime të Kur’anit dhe të profecisë, të cilat janë trajtuar në ajetet e mëparshme.

All’llahu i Lartësuar thotë: “Ne kemi krijuar yjësi në qiell”.

Fjala “buruxh” është shumësi i fjalës “burxh”, që do të thotë dukje dhe objekt i dallueshëm. Kjo fjalë përdoret për vendin që

ndërtohet në muret e qytetit, apo në muret e kalasë, ku luftëtarët mbrohen. Kjo për shkak të mundësisë së vrojtimit dhe lartësisë së veçantë që ka ai vend. Gjithashtu, fjala *“teberrexhet”* përdoret edhe për gruan e cila zbulon bukurinë e saj.

Po të shohim me vëmendje Diellin dhe Hënën, do të vërejmë se në të gjitha stinët e vitit dhe në çdo periudhë kohore, ato do të korrespondojnë me një nga figurat astronomike (figurat astronomike janë një grumbull yjesh që kanë formë të veçantë). Për këtë themi: Dielli është në yjësinë e dashit¹- për shembull – ose demit, peshores, akrepit ose shigjetarit.

Ky sistem është i përsosur dhe ekzistenca e yjësive qiellore në lëvizjen e pozicioneve të Diellit dhe Hënës brenda tyre është një nga argumentet e qarta për diturinë dhe fuqinë e Krijuesit të Madhëruar.

Ky sistem i mrekullueshëm me saktësinë e tij na zbulon ekzistencën e një qëllimi për krijimin e kësaj bote. Sa më thellë që shohim në krijesat e All'llahut, aq më shumë afrohemi me njohurinë dhe dijen e Krijuesit të Madhërishëm.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar thotë: **“dhe e kemi zbukuruar atë për shikuesin”**.²

Shihni me vëmendje qiellin në një nga netët me shumë yje! Do të vëreni një bashkësi yjesh që bashkohen në mesin e tyre në çdo skaj të qiellit, si të ishin hallka zinxhiri të sistemuara.

¹ Fjala *“hamel”* është një grup sistemesh diellore që duken në qiell, afërsisht në formën e dashit, dhe po kështu të demit, peshores e të tjera.

² Përemri *ha*, te fjala *“zejjennaha”*, i referohet *“qiellit”*, sepse është metaforë e gjinisë femërore.

Këtë panoramë të mrekullueshme, shumë e shohin si të zakonshme, ngaqë ajo përsëritet, e megjithatë kjo pamje meriton një vëmendje të veçantë.

Kur hëna shfaqet (me format e saj të ndryshme) në mesin e atyre bashkësive yjesh, ajo i shton magjisë dhe bukurisë së saj një magjepsje të re.

Përveç kësaj, hëna ka sekrete shkencore të fshehura. Vëmendja e shkencëtarëve është fokusuar tek ajo që prej mijëra vitesh e deri në kohët e sotme. Nga ky vërtetim, shkencëtarët arritën të shpiknin teleskopët, vetëm që të zbulonin sekrete të reja rreth kësaj bote që ecën vazhdimisht, pavarësisht se duket e heshtur.

Në ajetin në vazhdim, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ne e ruajmë atë (qiellin) nga çdo djall i mallkuar përveç ndonjërit që dëgjon vjedhurazi e të cilin e kap ylli i këputur me flakë të dukshme.”**.

Ky ajet është komentuar në forma të ndryshme nga komentuesit e Kur'anit, ku gjithsecili ka dhënë një variant të veçantë në kuptimin e tij.

Po i njëjti kuptim ka ardhur në ajetet 6-7 të sures “Es Saffat”, si dhe në ajetin 9 të sures “El Xhinn”.

Ndoshta disave mund t’u lindin pyetje, për të cilat nuk kanë mundur të gjejnë përgjigje. Në këtë aspekt, detyra jonë është që të paraqesim mendimet e komentuesve të mëdhenj të Kur'anit në lidhje me tematikat që shqyrtojmë. Ndër to, më të rëndësishmet janë:

1- Disa komentues të Kur'anit, prej të cilëve edhe autori i tefsirit "Dhilalul Kur'an", janë mjaftuar me një komentim përmbledhës. Ata nuk janë futur në shumë detaje dhe nuk i kanë kushtuar ndonjë rëndësi të madhe shumë çështjeve, duke i konsideruar si realitete që janë mbi fuqinë e njeriut, e që nuk mund t'i perceptojmë. Sipas tyre, ne duhet t'u japim rëndësi të veçantë vetëm ajeteve që radhisin gjurmët e jetës sonë praktike dhe që na rregullojnë sjelljet dhe orientimin kah e vërteta.

Në libra pyetet: "Çfarë është shejtani? Si mundohet ai që të vjedhë informacion? Çfarë dëgjon vjedhurazi? Të gjitha këto janë të fshehta prej të fshehtave të All'llahut të Lartësuar, te të cilat ne nuk mund të arrijmë vetëm se me anë të teksteve të shkruara. Nuk ka ndonjë dobi të futesh më thellë në çështje të tilla, sepse nuk shton ndonjë gjë në besimin tonë dhe nuk prodhon asgjë përveç preokupimit të mendjes njerëzore me atë që nuk është kompetencë e tij, duke e penguar atë edhe nga puna e tij e vërtetë në këtë jetë.¹

Kur'ani është një libër qiellor, i cili ka ardhur për ta udhëzuar njeriun në rrugën e drejtë. Ai është Libri i jetës, është libër edukativ. Nëse në të nuk do të kishte gjëra specifike që kanë lidhje me njeriun, më mirë do të ishte që të mos ishte shfaqur. Kjo është në kundërshtim me projektin dhe rrugën hyjnore, pasi çdo gjë që është në të, është mësim për ne dhe një metodë e drejtë për jetën.

Pranimi se në Kur'an ka gjëra të misterhme, është një çështje e refuzuar. A nuk është Kur'ani një libër drite dhe një libër i qartë?! A nuk ka zbritur me qëllim që njerëzit ta kuptojnë dhe të

¹ Tefsiri "Fii Dhilalil Kur'an", vëll. 5, f. 396.

udhëzohen me të?! Atëherë, pse nuk po na interesoka kuptimi i disa ajeteve të tij?!

Pra, me një fjalë, ky komentim është larg të vërtetës.

2- Një grup jo i vogël i komentuesve (sidomos ata të vjetrit) këmbëngulin në qëndrimin tek kuptimi i jashtëm i këtyre ajeteve.

Qielli është po ky qiell, flaka është flaka që ne shohim (d.m.th. janë topa të vegjël që lundrojnë në hapësirë, që digjen herë pas here nga forca tërheqëse e tokës, që shpëputen drejt saj me një shpejtësi dhe digjen si rezultat i fërkimit të tyre me ajrin që shkakton rritjen e nxehtësisë së tyre).

Shejtani është ajo krijesë rebele, që përpiket të depërtojë në thellësitë e qiellit për të mësuar lajme të asaj bote, në mënyrë që t’jua çojë ato miqve të tij të këqij në tokë, duke dëgjuar vjedhurazi. Por, ai pengohet për ta arritur qëllimin e tij, duke u goditur me këto flakë përvëluese.¹

3- Një grup prej komentuesve, si dijetari Tabatabaj në tefsirin “Mijzan” dhe Tantauj në tefsirin “El Xheuahir”, thonë se këto ajete bartin përngjasim, metaforë dhe shembuj.

Pastaj, komentuesit i kanë shpjeguar ato në disa forma:

a- Në tefsirin “Mijzan” lexojmë: “Komentuesit e Kur’anit kanë dhënë mendime të ndryshme për të kuptuar përgjimin e

¹ Këtë komentim e ka cekur Fakhru Razij në tefsirin e tij “El Kebir”, po kështu edhe Alusij në tefsirin e tij “Rruhul Meanijj”, pasi ka parashtruar problematika të ndryshme rreth kësaj tematike, duke u bazuar në shkencën e astronomisë. Shumë dijetarë u kanë dhënë përgjigje këtyre pyetjeve dhe nuk është e nevojshme që të përmendim se çfarë ka arritur sot astronomia.

shejtanëve dhe gjuajtjen e tyre me flakën përvëluese. Në të vërtetë, ekzistojnë orbita që e rrethojnë tokën, e që banojnë nga grupe engjëjsh, të cilat kanë dyer, ku nuk mund të futet askush veç tyre. Në qiellin e parë ka një grup melekësh, që në duar mbajnë flakë e që vëzhgojnë përgjuesit prej shejtanëve, duke i goditur ata me flakë.

Sot është vërtetuar se ky mendim është plotësisht i pabazë dhe i pasaktë.

Mundet - e All'llahu e di më së miri - që këto deklarata në fjalën e All'llahut të Lartësuar të jenë njësoj si shembujt e marrë, me të cilët imagjinojnë të vërtetat që janë jashtë perceptimit të shqisave. Për këtë, në ajetin 43 të sures "El Ankebut", All'llahu i Lartësuar thotë: **"Këta shembuj ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve."**

Duke u bazuar në këtë, qëllimi me qiellin ku banojnë melekët, është një botë mbretërore që ka horizontin më të lartë. Ndërsa qëllimi me afrimin e shejtanëve me qiellin, përgjimin e tyre dhe goditjen e tyre me flakë, është afrimi i tyre me botën e melaikeve, për të mësuar sekretet e krijesave dhe ngjarjet e së ardhmes si dhe gjuajtja e tyre me atë që nuk kanë fuqi prej dritës së mbretërisë".¹

b- Tantauij, në tefsirin e tij të njohur, thotë: "Me të vërtetë, dijetarëve mashtrues dhe hipokritë, të cilët i ndjekin shumica e njerëzve pa pasur asnjë meritë apo kapacitet për të informuar për mrekullitë e qiejve dhe botën superiore, All'llahu i Madhëruar ua ndalon këtë dituri dhe e vendos qiellin të mbushur me yje, me të gjitha sekretet e tyre, në zgjedhjen e atij që ka logjikë, zgjuarsin,

¹ Tefsiri "Mijzan", vëll. 17, f. 130, në komentimin e ajeteve të sures "Es Saffat".

sinqeritet dhe besim. Ai e pengon këtë kategori dijetarësh që të depërtojë në sekretet e qiellit. Çdo shejtan dëbohet nga prania hyjnore, sido që të jetë, qoftë nga njerëzit apo nga të tjerët. Ai nuk ka të drejtë që të arrijë te lartësitë e dijes. Sa më shumë që të afrohet, aq më shumë privohet prej tyre. Kështu, njerëzit mund të jetojnë me vite dhe të vdesin pa i mësuar kurrë të vërtetat. A nuk e marrin diturinë vetëm ata që e duan atë?!¹

Më tej, ai vazhdon: “Çfarë pengese ka, që këto shprehje të jenë një metaforë? Metafora është një nga llojet më të bukura të elokuencës. A nuk e vëren, se shumë njerëz rreth teje janë të burgosur në këtë tokë, se sytë e tyre nuk shohin dhe ata nuk i kuptojnë simbolet dhe mrekullitë e kësaj bote? Ata janë poshtëruar nga çdo anë, janë të dëbuar. Ata i kanë dëbuar nga ato kuptime të larta pasionet e tyre, armiqësitë e tyre, mendjemadhësia e tyre, luftërat e tyre, ambicia dhe ligësia e tyre.”²

c- Diku tjetër, ai thotë: “Mes shpirtrave të njerëzve, të cilët kalojnë në botën e *Berzakh*-ut - vend ku qëndrojnë shpirtrat ndërmjet kësaj bote dhe Botës Tjetër deri në Ditën e Kiametit - dhe shpirtrat e atyre që janë akoma me njerëzit në jetën e kësaj bote qëndron lidhja mes tyre. Nëse ka ngjashmëri dhe proporcionalitet ndërmjet tyre, atëherë është e mundur që ato të tubohen dhe të bisedohet me ta dhe të informohen për çështje aktuale dhe shumë delikate.

d- Disa të tjerë kanë thënë: “Zbulimet e fundit kanë shfaqur ekzistencën e rrezeve të forta që burojnë vazhdimisht nga hapësira e largët. Ato mund të depërtojnë në tokë nëpërmjet aparateve

¹ Tefsiri “Xheuaher Tantauj”, vëll. 8, f. 11.

² Tefsiri “Xheuaher Tantavij”, vëll. 18, f. 10.

marrëse specifike. Burimi i këtyre valëve vazhdon të jetë i panjohur, por disa shkencëtarë supozojnë se atje ekzistojnë shumë krijesa të gjalla, që jetojnë në masa qiellore të largëta, që ndoshta janë më të zhvilluara e më të përparuara se ne dhe na i dërgojnë këto valë që të na lajmërojnë për ekzistencën e tyre. Xhindet nxitojnë për t'i marrë këto lajme e për të përfituar prej tyre, por ata dëbohen me anë të këtyre rrezeve të forta, në mënyrë që të mos arrijnë të kuptojnë se çfarë u është dërguar banorëve të tokës”.¹

Këto ishin mendimet dhe thëniet e ndryshme të komentuesve të Kur'anit dhe të shkencëtarëve.

¹ “Kur'an ala merr'rriil usur”, f. 258.

Hulumtim

Në ajetet e lartpërmendura u zgjat pak shpjegimi, dhe para se të dalim me një rezultat të kërkimit, duhet të citojmë një pjesë të shënimeve:

1- Kur'ani Famëlartë e ka përmendur fjalën "*semau*", që do të thotë *qiell*, në kuptimin e të njëjtit qiell që ndonjëherë shfaqet në mendjen e njeriut, apo herë tjetër në kuptimin e lartësisë shpirtërore dhe pozitës së lartë.

Për shembull, në ajetin 40 të sures "El Araf", All'llahu i Lartësuar thotë: **"Me të vërtetë, atyre që i mohuan shenjat Tona me mendjemadhësi, nuk do t'u hapen dyert e qiellit."**

Ka mundësi që kuptimi i fjalës *qiell* këtu, të jetë një metaforë për pozitën e afrimit me All'llahun e Lartësuar, sikurse e lexojmë në ajetin 10 të sures "El Fatir", ku thuhet: **"Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë."**

Qëllimi me këtë fjalë këtu është ngritja në pozitën e afrimit hyjnor, si: nderimi, lartësimi dhe ngritja shpirtërore.

Qëllimi me fjalët "*enzele*" dhe "*nezele*" në ajetet e Kur'anit, është zbritja nga madhështia dhe vendi hyjnor për në zemrën e të Dërguarit të All'llahut të Lartësuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen tij!*).

Në ajetin 24 të sures "Ibrahim", All'llahu i Lartësuar thotë: **"Vallë, a nuk e sheh se si All'llahu e përqs fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli?"**. Rrënja e pemës së mirë, e cituar në këtë ajet, është i

Dërguari i All'llahut të Lartësuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen tij!*), dega është Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ndërsa Imamët janë degëzimet e vogla.¹

Po kështu, në një nga hadithet lexojmë: “*Veprat e jobesimtarëve nuk ngrihen në qiell*”.

Nuk ka dyshim se fjala “*qiell*” që është përdorur këtu, nuk është qielli që shohim ne.

Nga ajo çfarë treguam më lart, dalim në përfundimin se fjala “*qiell*” është përdorur me dy kuptime: material dhe shpirtëror ose real dhe metaforik.

2- Fjala “*en nuxhum*”, që do të thotë *yje*, ka gjithashtu kuptim material, që janë masat qiellore që shihen në qiell, dhe kuptim shpirtëror, që janë dijetarët që ndriçojnë rrugën e shoqërive njerëzore.

Ashtu sikurse udhëtari në shkretëtirë dhe në det udhëhiqet me anë të yjeve në netët e errëta, po kështu edhe shoqëritë njerëzore udhëhiqen me anë të dritës së dijetarëve të singertë e punëmirë.

Në një hadith të njohur, i Dërguari i All'llahut të Lartësuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen tij!*) thotë: “Shembulli i shokëve të mi në mesin tuaj, është si shembulli i yjeve. Cilindo që të merrni për ta ndjekur, do të udhëzoheni.”² Ky hadith është një tregues i qartë për këtë kuptim.

¹ Tefsiri “Burhan”, vëll. 2, f. 310.

² “Sefijnetul Bihar”, vëll. 2, f. 9,

Për fundin e ajetit: **“Është Ai që i ka krijuar yjet, për t’ju rrëfyer rrugën në errësirat e tokës dhe të detit.”**¹ në tefsirin e Ali bin Ibrahimit përmendet se Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Yjet janë familja e Muhamedit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen tij!*).”²

3- Nga disa transmetime të ndryshme që kanë ardhur në komentimin e këtyre ajeteve mësojmë se ndalimi i shejtanëve që të ngjiten në qiej dhe dëbimi i tyre duke i gjuajtur me flakë, është bërë kur ka lindur Pejgamberi Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen tij!*). Në disa transmetime të tjera thuhet se ata janë penguar qysh kur ka lindur Isai, i biri i Merjemes, por kjo ka ndodhur vetëm për një kohë të caktuar. Kur ka lindur Pejgamberi ynë (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të!*), ata janë penguar plotësisht.³

Nga këto që trajtuam mund të themi se fjala “*semau*”- “*qiell*”, është një metaforë për qiellin e të vërtetës dhe besimit. Shejtanët garojnë gjithmonë që të hyjnë në këtë qiell dhe të depërtojnë në zemrat e besimtarëve të sinqertë nëpërmjet hutimit të mbrojtësve të së vërtetës me lloj-lloj ngacmimesh.

Por, dituria dhe devotshmëria e miqve të All’llahut të Lartësuar dhe e udhëheqësve të thirrjes së të vërtetës prej Profetëve, Imamëve dhe dijetarëve, janë garantues për largimin e adhuruesve të tiranisë dhe padrejtësisë nga ky qiell.

¹ Sure “El En’am”, ajeti 97.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 750.

³ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 5; tefsiri “Kurtubij”, vëll. 5, f. 3626.

Kjo na ndihmon të kuptojmë lidhjen ndërmjet lindjes së Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen tij!*), ose lindjes së Isait (*Paqja qoftë mbi të!*), dhe dëbimit të shejtanëve nga qielli.

Gjithashtu, kjo na mundëson të kuptojmë edhe lidhjen ndërmjet ngjitjes në qiell dhe zbulimit të të fshehtave, që na garantojnë se nuk ekzistojnë lajme të posaçme ndërmjet shtresave të qiellit që ne shohim. Gjithçka ka atje nuk i tejkalon mrekullitë e krijesave që i ka formësuar Krijuesi i gjithësisë, për të cilat mund të mësohet më shumë mbi sipërfaqjen e tokës.

Ekzistenca e meteorëve është e kufizuar vetëm brenda zonës së mbulesës atmosferike. Kjo ndodh kur ato meteorë në rënie digjen në drejtim të tokës nëpërmjet fërkimit të tyre me atmosferën, ndërsa jashtë zonës së atmosferës nuk ka flakërues. Atje ka meteorë që lundrojnë në hapësirë, por ato quhen flakërues vetëm pasi të futen në zonën e atmosferës, duke u djegur dhe duke na u shfaqur para syve në formën e një vije të zjarrtë e duke i bërë njerëzit të imagjinojnë se ai është një yll që lëviz me shpejtësi.

Siç dihet, tashmë njeriu i kohës moderne ka depërtuar shumë herë në këto hapësira, madje e ka tejkaluar, duke arritur të shkelë mbi sipërfaqen e hënës (ku dihet se çatia e atmosferës shkon nga njëqind deri në dyqind kilometër gjatësi dhe se hëna është më shumë se treqind mijë kilometra larg nga toka).

Nëse qëllimi me *yllin flakërues* është vetë flaka që ne shohim, atëherë mund të themi se shkencëtarët e njerëzimit e kanë zbuluar këtë zonë dhe nuk i kanë gjetur sekretet e veçanta të supozuara.

Përmbledhje: nga faktet dhe dëshmitë e shumta që treguam më lart, na qartësohet se qëllimi me fjalën *qiell*, është qielli i së vërtetës. Shejtanët me vesvese përpiqen të gjejnë mënyra për ta zbuluar qiellin dhe për ta përgjuar, në mënyrë që të mund të mashtrojnë njerëzit, por yjet flakëruese (që janë udhëheqësit shpirtërorë nga Profetët, Imamët dhe dijetarët) i largojnë dhe i dëbojnë ata me dituri e devotshmëri.

Meqenëse Kur'ani Kerim është një oqean i pashtershëm, atëherë nuk duhet pranuar prerazi ky interpretim. Ndoshta në të ardhmen mund të sjellin një komentim tjetër të këtyre ajeteve, duke u mbështetur mbi të vërteta që ne nuk kemi arritur t'i zbulojmë deri më tani.

Ajetet 19 – 21

﴿وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ شَيْءٍ
مَوْزُونٍ ۚ وَجَعَلْنَا لَكُمْ فِيهَا مَعَايِشَ وَمَنْ لَسْتُمْ لَهُ بِرَازِقِينَ﴾

“Dhe Tokën e kemi shtrirë e nëpër të kemi shpërndarë male të patundura. Ne kemi bërë që në tokë të rritet çdo gjë në përpjesëtim.”

“E aty kemi bërë mjetet e jetesës për ju dhe për ata që nuk i mbani ju.”

“Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar.”

Komentimi

Për të plotësuar ajetet e mëparshme, Kur'ani Famëlartë sjell disa ajete që trajtojnë çështjen e krijimit dhe fenomene të madhështisë së Krijuesit në faqen e tokës. Në këto ajete përmendet toka dhe thuhet: **“Dhe Tokën e kemi shtrirë”**.

Fjala “*med*” në rrënjë do të thotë *zgjerim* dhe *shtrirje*. Mendohet se qëllimi me të është nxjerrja e një pjese të thatë të tokës

nga nënsipërfaqja e ujit, sepse sipërfaqja e tokës (siç dihet) ka qenë e mbuluar plotësisht me ujë, si rezultat i shirave të dendura. Pas shumë vitesh, uji zuri vend mbi sipërfaqen e tokës, pasi shiu u ndërpre dhe në mënyrë graduale u zbulua toka e thatë nga nënsipërfaqja e ujit. Kjo është ajo që transmetimet e quajnë “*dehoul erddi*” – “*shtrati i tokës*”.

Në vijim, All’Ilahu i Lartësuar tregon krijimin e maleve, të cilat kanë dobi të madhe, njësoj si një prej argumenteve të monoteizimit, ku thuhet: **“e nëpër të kemi shpërndarë male të patundura”**.

All’Ilahu i Lartësuar e ka përshkruar krijimin e maleve me fjalën “*ilka*” - **shpërndarë**. Ndoshta fjala “*ilka*” ka ardhur me kuptimin *krijuar*, sepse malet janë lartësi të ngritura mbi sipërfaqen e tokës, të formuara gradualisht nga të ftohtët e kores së tokës, ose nga lëndët vullkanike.

Përveç mrekullisë së krijimit si shtylla për të mbajtur të forcuar tokën dhe për ta ruajtur atë nga tërmetet, ato qëndrojnë edhe si mburojë e patundur përballë forcës së shtrëngatave të forta, madje luajnë një rol të madh në sistemin e lëvizjes së ajrit dhe përcaktimin e drejtimit të tij. Malet janë gjithashtu një epiqendër e përshtatshme për depozitimin e ujërave në formën e dëborës dhe të burimeve.

Përdorimi në këtë ajet i fjalës “*reuasijj*”, që është shumësi i fjalës “*rasijetu*”, me kuptimin *të forta e të patundura*, është një argument për atë që trajtuam më lart.

Malet janë të patundura në vetvete, si dhe një shkak i qëndrueshmërisë së kores së tokës, dhe i vendosjes së jetës njerëzore mbi të.

Pastaj ajetet flasin për faktorin jetësor në ekzistencën e jetës njerëzore dhe të kafshëve, që është bimësia: **“Ne kemi bërë që në tokë të rritet çdo gjë në përpjesëtim.”**.

Sa e bukur dhe elokumente është kjo shprehje! *“Meuzun”* është nga rrënja e fjalës *“ueznun”*¹, që tregon llogarinë precize, sistemin e mrekullueshëm, harmoninë në përpjesëtim në të gjithë bimësinë mbi sipërfaqen e tokës. Çdo pjesë e bimësisë i nënshtrohet një llogarie të përcaktuar mirë, që nuk pranon shpëputjen e lidhjes nga trangu, degët, gjethet, lulet, farërat e deri te frutat.

Mbi faqen e tokës numërohen qindra-mijëra lloje bimësh, ku gjithsecila mbart veçori të veçanta dhe të caktuara. Ato kanë shenja për t'i dalluar nga njëra-tjetra. Kjo është një portë për të njohur Krijuesin dhe Formësuesin e Madhërishtëm, ku çdo gjethë e tyre është një libër që flet për njohjen e Tij.

Disa mendojnë se qëllimi i kësaj është zbulimi i metaleve dhe i mineraleve të ndryshme në male, sepse fjala *“inbat”* në gjuhën arabe përdoret gjithashtu edhe për mineralet.

Këtë kuptim e kanë treguar edhe disa transmetime. Në transmetimin e ardhur nga Imam Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për komentimin e këtij ajeti (**Ne kemi bërë që në tokë të mbijë çdo gjë në përpjesëtim**), ai ka thënë: “All’llahu i Lartësuar nëpër male ka vendosur flori, argjend, gurë të çmuar, hekur,

¹ *El ueznu* është njohja e masës së diçkaje - “El Mufredatu” e Ragibit.

plumb, bronz, e të tjera si këto, të cilat nuk shiten vetëm se me peshore dhe të përpjesëtuara”.¹

Disa të tjerë tregojnë se fjala “inbat” ka një kuptim më të gjerë, që përfshin të gjitha krijesat që ndodhen mbi sipërfaqen e tokës, siç e tregon Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) kur i drejtohet popullit të tij: **“All’llahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët”**.²

Prandaj, nocioni “inbat” në ajet mund të përfshijë bimët, njerëzit, mineralet etj.

Meqenëse elementët dhe faktorët e jetës së njeriut nuk janë të kufizuar vetëm te bimët dhe mineralet, ajeti kur’anor në vijim tregon për të gjitha dhuntitë e tjera dhe thotë: **“E aty kemi bërë mjetet e jetesës për ju.”**

Këto mjete jetese nuk janë vetëm për njerëzit, por për të gjitha qeniet e gjalla, madje edhe për ato që janë jashtë përgjegjësisë së njerëzve. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“dhe për ata që nuk i mbani ju”**.

Po, Ne kemi dhënë mjaftueshëm për plotësimin e të gjitha nevojave të tyre!

Fjala “meajish” është shumësi i fjalës “meishetu” dhe ka kuptimin e mjeteve të domosdoshme për jetën. Këto mjete ndonjëherë arrihen me punë, e herë tjetër vijnë vetë.

Disa komentues e kanë kufizuar fjalën “meajish” me bujqësinë dhe me bimët, ose të ushqyerit dhe të pirët, por kuptimi

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 6.

² Sure “Nuh”, ajeti 17.

i saj gjuhësor është më i gjerë sesa ajo që specifikohet dhe përfshin gjithçka që lidhet me jetën dhe me mjetet e jetesës.

Për fjalën e All'Ilahut të Lartësuar, ku thuhet: **“dhe për ata që nuk i mbani ju”**, komentuesit e Kur'anit janë ndarë në dy grupe:

Sipas mendimit të grupit të parë të komentuesve, All'Ilahu i Lartësuar dëshiron që të qartësojë dhuntitë dhe mirësitë e Tij, të cilat përfshijnë njerëzimin, kafshët dhe krijesat e tjera të gjalla, e që njeriu nuk është i aftë që t'i ushqejë dhe as nuk janë në posedimin e tij.

Sipas mendimit të grupit të dytë të komentuesve, All'Ilahu i Lartësuar dëshiron që t'ia kujtojë njeriut, se Ai është Furnizuesi dhe ka garantuar që ta furnizojë me çdo gjë që ka nevojë, qoftë kjo me ndërmjetësimin e vetë njeriut apo me ndërmjetësime të tjera.

Komentimi i parë duket se është më i saktë. Këtë e përforcon hadithi i transmetuar në tefsirin e Ali Bin Ibrahimit kur trajtohet kuptimi i frazës **“dhe për ata që nuk i mbani ju”**, ku thuhet: *“Çdo lloj kafshe i kemi caktuar furnizimin e saj”*.¹

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve që janë objekt studimi përmban një përgjigje për pyetjen që sillet në mendjen e shumë njerëzve, e cila është: Përse All'Ilahu nuk i ka përgatitur mirësitë dhe furnizimet e Tij, pa pasur nevojë për përpjekje të madhe? All'Ilahu i Lartësuar i përgjigjet kësaj pyetjeje duke thënë: **“Nuk ka asnjë send që të mos gjendet te thesaret e Tij; por prej tij ne japim me masë të caktuar.”** *Fuqia Jonë nuk është e kufizuar, aq sa të frikësohemi për mbarimin e gjërave që posedojmë. Nuk ka dyshim se burimi, depozita*

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalajn”, vëll. 3, f. 6, had. 18.

dhe origjina e gjithçkaje është në duart Tona dhe Ne nuk e kemi të vështirë krijimin e çdo gjëje dhe në çfarëdo kohe qoftë, por Ne kemi caktuar që çdo gjë të jetë e nënshtruar ndaj një përllogaritjeje precize, deri edhe furnizimet që ju zbresin janë në një masë të caktuar.

Në një vend tjetër të Kur'anit lexojmë “Sikur All’Ilahu t’i shtonte mjetet e jetesës për robtë e Vet, ata do ta mbushin Tokën me mbrapshti. Por Ai u jep me masë, sa dëshiron.”¹

Me të vërtetë, lodhja dhe përpjekja në jetë i shton njeriut lëvizjen, gjallërimin dhe zellin, deri në atë shkallë sa që konsiderohet një mënyrë e shëndoshë dhe e legjitimuar për t’i vënë në punë mendjet e njerëzve dhe për të mbajtur në lëvizje trupin. Lodhja e përpjekja e largojnë dembelizmin, ndalojnë plogështinë e gjallërojnë zemrën që të lëvizë dhe të bashkëveprojë me të tjerët. E nëse furnizimet me begati do të viheshin në zgjedhjen e njeriut, e jo sipas caktimit të All’Ilahut, a do të mund ta parashikonte ndokush se si do të ishte fundi i njerëzimit?

Njerëzit nuk janë si melekët. Pasionet e tyre lozin me zemrat dhe tundimet i afrojnë pranë devijimit.

Urtësia e All’Ilahut ka dashur që njeriu të mbartë të gjitha cilësitë e mira dhe të këqija dhe të sprovohet mbi sipërfaqen e kësaj toke për atë që ai mbart, për atë që ai vepron e punon si dhe për atë që e kalon kufirin. Garimi dhe lëvizja për atë që është e lejuar, është fusha më e mirë për t’u sprovuar.

Fukarallëku dhe pasuria janë sprova që përfshihen në planin e shqyrtimit dhe të provimit. E ashtu sikurse fukarallëku dhe

¹ Sure “Esh Shura”, ajeti 27.

skamja e tërheqin njeriun drejt rënies në humnerë e në rreziqet e devijimit, po ashtu edhe pasuria në shumë situata bëhet burim i degradimit dhe i shkatërrimit.

Dy hulumtime

1- Cilat janë depozitat e All'Ilahut të Lartësuar?

Në ajetet kur'anore lexojmë se All'Ilahu i Lartësuar ka depozita. Ai Vetë në Librin e Tij thotë: **“Por All'Ilahut i takojnë thesaret e qiejve dhe të Tokës.”**. Në dorën e Tij janë të gjitha thesaret dhe depozitat. Por cilat janë thesaret e Tij?

Fjala *“khazain”* në gjuhën arabe është shumësi i fjalës *“khazanetun”*, që është vend i veçantë ku ruhet dhe grumbullohet pasuria. Ajo rrjedh nga lënda *“khazane”* dhe vjen me kuptimin e *ruajtjes së diçkaje dhe mbajtjes peng të saj*.

I pakundërshtueshëm është fakti, se ai që nuk është i aftë dhe që ka mundësi të kufizuara, për të përgatitur të gjitha ato për të cilat ka nevojë për një kohë të gjatë, fillon të grumbullojë ato që i posedon dhe t'i magazinon për një të ardhme, kur do ketë nevojë për to.

A mund të imagjinohet kjo gjë për All'Ilahun e Lartësuar? Përgjigjja është absolutisht e prerë dhe mohuese. Për këtë, disa komentues, sikurse komentuesi i shquar Tabrasij në tefsirin e tij *“Mexhmaul Bejan”* dhe Fakhri Razij në tefsirin e tij *“El Kebijr”*, e

kanë komentuar fjalën “*hazainull’llah*” me kuptimin “*makduratull’llahi*” - *burimet e pashtershme dhe të caktuara me masë nga ana e All’llahut të Lartësuar*. Kjo do të thotë se çdo gjë është grumbulluar në depozitën e fuqisë së All’llahut dhe çdo gjë që Ai e sheh të domosdoshme ose të dobishme për krijesat e Tij, e krijon me fuqinë e Tij.

Disa komentues të mëdhenj e kanë komentuar fjalën “*hazainull’llahi*”, si: “*totalin e burimeve, elementëve dhe shkaqeve të përgjithshme materiale në gjithësi...*”¹

Ky komentim, edhe nëse është i pranueshëm nga ana parimore (usulijeh), por shprehja “*indena*” – “*tek ne*” harmonizohet më shumë me komentimin e parë.

Shprehja “**thesaret e All’llahut**” dhe të ngjashmet me të nuk përshkruajnë pozitën e Zotit dhe as madhësitinë e Tij, por është përdorur për ta përafruar me të folurën e njerëzve e me gjuhën e tyre, në mënyrë që këta të fundit të kuptojnë.

Disa komentues kanë thënë se fjala “*khazainu*” është specifike për ujin dhe shiun. Por, kufizimi i nocionit “*khazainu*” me këtë gjykim të përcaktuar, është i zhveshur nga çdo argument.

¹ Tefsiri “Mijzan”, vëll. 12, f. 142.

2- Zbritja në hapësirë dhe në pozitë

Siç e kemi shpjeguar edhe më parë, zbritja nuk simbolizon gjithmonë gjendjen hapësinore (d.m.th. zbritja nga një vend për në një tjetër, lart-poshtë), por ndonjëherë simbolizon edhe zbritjen në pozitë në disa burime. Për shembull, në situatën e arritjes së një mirësie nga një person me pozitë të lartë tek ata me pozitë më të ulët sesa ai, kjo interpretohet për të si zbritje.

Kjo fjalë është përdorur në Kur'anin Famëlartë kur bëhet fjalë për burimet e mirësive të All'llahut, sido që të jenë ato, të zbritura nga qielli për në tokë, siç është shiu, apo ajo që riprodhohet në tokë, siç janë kafshët. Kjo është ajo çfarë vërejmë në ajetin 6 të sures "Ez Zumer", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ai ka krijuar për ju tetë çifte bagëtish"**. Po kështu në ajetin 25 të sures "El Hadid", All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ne e zbritëm hekurin"** etj.

Përmbyllje

Fjalët "*nuzul*" dhe "*inzal*", këtu kanë kuptimin: *ekzistencë, krijim, krijesë*. Përdorimi i këtyre shprehjeve bëhet vetëm për mirësitë e All'llahut të Lartësuar, të cilat ua ka dhuruar robve të Tij.

Ajetet 22 - 25

﴿وَأَرْسَلْنَا الرِّيَّاحَ لَوَاقِحَ فَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَسْقَيْنَاكُمُوهُ وَمَا أَنْتُمْ لَهُ بِخَازِنِينَ﴾ وَإِنَّا لَنَحْنُ نُحْيِي وَنُمِيتُ وَنَحْنُ الْوَارِثُونَ ۚ وَلَقَدْ عَلِمْنَا الْمُسْتَقْدِمِينَ مِنْكُمْ وَلَقَدْ عَلِمْنَا الْمُسْتَأْخِرِينَ ۚ وَإِنَّ رَبَّكَ هُوَ يَحْشُرُهُمْ إِنَّهُ حَكِيمٌ عَلِيمٌ﴾

“Ne i dërgojmë erërat për pllenim dhe zbresim nga qielli ujë, prej të cilit ju japim të pini e të cilin nuk mund ta depozitoni dot.”

“Në të vërtetë, vetëm Ne e japim jetën dhe e sjellim vdekjen dhe vetëm ne jemi trashëgimtarët (e gjithçkaje).”

“Vetëm Ne i dimë ata që kanë qenë para jush dhe vetëm Ne i dimë ata që do të vijnë pas jush.”

“Sigurisht që Zoti yt do t’i tubojë ata të gjithë; Ai është vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm.”

Komentimi

Roli i erërave dhe i shiut

Pasi Kur'ani Famëllartë na paraqiti në ajetet e lartpërmendura një pjesë nga të fshehtat e krijimit dhe të mirësive të All'Ilahut, si: krijimi i tokës, i maleve, i bimësisë, si dhe furnizimet e nevojshme për jetën, ajeti i parë i këtyre ajeteve na tregon për lëvizjen e erërave dhe efektet që kanë ato në zbritjen e shiut. Në të thuhet: **“Ne i dërgojmë erërat për pllenim dhe zbresim nga qielli ujë, prej të cilit ju japim të pini e të cilin nuk mund ta depozitoni dot.”**.

Fjala *“leuakih”* është shumësi i *“lakah”* dhe tregon rolin e erërave në grumbullimin e pjesëve të reve me njëra-tjetrën, për të përgatitur kështu zbritjen e shiut.

Disa dijetarë bashkëkohorë mendojnë se ky ajet tregon për pllenimin e bimëve nëpërmjet erërave dhe me këtë e argumentojnë mrekullinë shkencore të Kur'anit, duke thënë se në kohën kur është shpallur Kur'ani, shkenca nuk i kishte zbuluar këto fakte.

Duke pranuar fenomenin e pllenimit të luleve dhe rolin e erërave në këtë proces, ne nuk jemi në një mendim me atë çfarë kanë arritur dijetarët e sotëm për dy arsye:

E para: supozimi i zbritjes së shiut vjen menjëherë pas fjalës *“pllenim”*;

E dyta: prania e lidhëzës “fe” – (shkakore) ndërmjet fjalëve “*pllenim*” dhe “*zbritjes së shiut*”, tregon qartazi se pllenimin e luleve e pason zbritja e shiut.

Fraza “**e të cilin nuk mund ta depozitoni dot**”, mund të jetë treguese i depozitimit të ujit të shiut në re para se të zbresë; domethënë: *me të vërtetë, ju nuk mund t’i përvetësoni retë, të cilat janë burimi kryesor i shirave.*

Kjo frazë mund të jetë gjithashtu edhe treguese për grumbullimin dhe depozitimin e shirave pas zbritjes së tyre, që do të thotë se: *ju nuk jeni të aftë ta grumbulloni ujin e zbritur në formë shiu, në mënyrë të mjaftueshme edhe pas zbritjes, dhe se është All’llahu i Lartësuar Ai që e ruan dhe e depoziton në majat e maleve në formën e dëborës, ose e zbret atë në thellësinë e tokës, që pas kësaj të grumbullohet në puse dhe burime.*

Pastaj Kur’ani Famëlartë zhvendoset nga manifestimet e monoteizmit të All’llahut tek Ringjallja dhe thotë: “**Në të vërtetë, vetëm ne e japim jetën dhe e sjellim vdekjen dhe vetëm ne jemi trashëgimtarët** (e gjithçkaje).”. Këtu përmenden jeta dhe vdekja, të cilat konsiderohen nga prezantimet më të rëndësishme në hulumtimin e tematikës së Ringjalljes. Ekzistenca e jetës dhe e vdekjes është një argument që krijesat e kësaj bote nuk i kanë frerët e veteve të tyre dhe se trashëgimtari i vërtetë i gjithçkaje është All’llahu i Madhërueshëm.

Pastaj ajeti vazhdon e thotë: “**Vetëm Ne i dimë ata që kanë qenë para jush dhe vetëm Ne i dimë ata që do të vijnë pas jush.**”.

Domethënë: Ne jemi në dijeni të plotë dhe për ata e atë që ata punojnë, dhe çështja e llogarisë dhe e gjykimit të tyre në Ditën e Ringjalljes është shumë e lehtë për Ne.

Kështu, ajeti në vijim, ku thuhet: **“Sigurisht që Zoti yt do t’i tubojë ata të gjithë; Ai është vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshëm”**, lidhet dhe është plotësues i ajetit të mëparshëm që flet se çfarë do të ndodhë pas vdekjes. Pra, mençuria e Krijuesit ka përcaktuar që vdekja të jetë fundi për gjithçka.

Sikur jeta të ishte e kufizuar vetëm në këtë periudhë të kufizuar kohore dhe çdo gjë të mbaronte me vdekjen, atëherë procesi i krijimit do të ishte i kotë, por kjo është e palogjikshme, sepse All’llahu i Lartësuar është i pastër e pa të meta.

All’llahu i Madhëruar me Urtësinë e Tij ka dashur që kjo të jetë një periudhë përgatitore për një të ardhme të pafundme drejt absolutes, një paraprirje për Jetën e Përhershme. Pa dyshim që All’llahu është i Ditur, i di veprat e të gjithë atyre që gjenden në këtë botë, e po kështu edhe ato që janë në thellësitë e ekzistencës së njeriut. Atij nuk i fshihet asgjë.

Fakti se All’llahu i Lartësuar është i Mençuri, i Gjithëdijshmi në këto burime, është një argument i fortë për çështjen e Ringjalljes dhe të Ditës së Gjykimit.

Hulumtim

Cilët janë “ata para nesh” dhe “ata pas nesh”?

Në komentimin e ajetit: **“Vetëm ne i dimë ata që kanë qenë para jush dhe vetëm ne i dimë ata që do të vijnë pas jush”**, komentuesit kanë dhënë mendime të shumta. Tabrasijju në tefsirin e tij “Mexhmaul Bejan” citon gjashtë mendime, Kurtubijj tetë të tilla, ndërsa Fakhri Rrazij citon dhjetë mendime. Duke i vërejtur me kujdes, ne mund t’i përmbledhim të gjitha ato në një komentim të vetëm, sepse frazat “*para jush*” dhe “*pas jush*” kanë dy kuptime të gjera, që përfshijnë *ata para jush* dhe *pas jush* në kohë, e po ashtu për nga veprat e mira dhe përpjekja, madje edhe nga prania në radhët e para për faljen e namazit me xhemat dhe të tjera të ngjashme me këto. Nëse e marrim me këtë kuptim gjithëpërfshirës, atëherë ne mund t’i tubojmë të gjitha mendimet në një komentim të vetëm.

Transmetohet se në lidhje me praninë në namazin me xhemat, veçanërisht në rreshtin e parë, Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), ka thënë: “Me të vërtetë, All’llahu i Lartësuar dhe melekët bëjnë lutje për ata që janë në rreshtin e parë”. Pas këtyre fjalëve, njerëzit filluan të shpejtonin për në xhami. Në atë kohë, shtëpitë e fisit *Beni Udhrētu* kanë qenë larg xhamisë dhe ata thanë: “Ne do t’i shesim shtëpitë tona e do të blejmë shtëpi afër xhamisë, që të mund të arrijmë rreshtin e parë në namaz me xhemat”. Pastaj zbriti ky ajet dhe i bëri të kuptojnë se All’llahu i Lartësuar është i Ditur për qëllimet e tyre: *Edhe sikur të jeni në rreshtin e fundit në namaz, në të vërtetë Ai jua shkruan sevapin -*

shpërblimin - e rreshtit të parë, sipas qëllimit që ju keni dhe vendosmërisë për këtë".¹

Prandaj, kufizimi i çështjes së zbritjes së ajetit, nuk tregon për kufizimin e kuptimit të tij të gjerë.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 6, f. 334.

Ajetet 26 - 44

﴿وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ صَلْصَالٍ مِنْ حَمَإٍ مَسْنُونٍ^{٢٦} وَالْجَنَّ خَلَقْنَاهُ مِنْ قَبْلُ مِنْ نَارِ السَّمُومِ^{٢٧} وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي خَالِقٌ بَشَرًا مِنْ صَلْصَالٍ مِنْ حَمَإٍ مَسْنُونٍ^{٢٨} فَإِذَا سَوَّيْتُهُ وَنَفَخْتُ فِيهِ مِنْ رُوحِي فَقَعُوا لَهُ سَاجِدِينَ^{٢٩} فَسَجَدَ الْمَلَائِكَةُ كُلُّهُمْ أَجْمَعُونَ^{٣٠} إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَى أَنْ يَكُونَ مَعَ السَّاجِدِينَ^{٣١} قَالَ يَا إِبْلِيسُ مَا لَكَ أَلَّا تَكُونَ مَعَ السَّاجِدِينَ^{٣٢} قَالَ لَمْ أَكُنْ لِأَسْجُدَ لِبَشَرٍ خَلَقْتَهُ مِنْ صَلْصَالٍ مِنْ حَمَإٍ مَسْنُونٍ^{٣٣} قَالَ فَاخْرُجْ مِنْهَا فَإِنَّكَ رَجِيمٌ^{٣٤} وَإِنَّ عَلَيْكَ اللَّعْنَةَ إِلَى يَوْمِ الدِّينِ^{٣٥} قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمٍ يُبْعَثُونَ^{٣٦} قَالَ فَإِنَّكَ مِنَ الْمُنْظَرِينَ^{٣٧} إِلَى يَوْمِ الْوَقْتِ الْمَعْلُومِ^{٣٨} قَالَ رَبِّ بِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأُزَيِّنَنَّ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَلَأُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ^{٣٩} إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمْ الْمُخْلِصِينَ^{٤٠} قَالَ هَذَا صِرَاطٌ عَلَى مُسْتَقِيمٍ^{٤١} إِنَّ عِبَادِي لَيْسَ لَكَ عَلَيْهِمْ سُلْطَانٌ إِلَّا مَنْ اتَّبَعَكَ مِنَ الْغَاوِينَ^{٤٢} وَإِنَّ جَهَنَّمَ لَمَوْعِدُهُمْ أَجْمَعِينَ^{٤٣} لَهَا سَبْعَةُ أَبْوَابٍ لِكُلِّ بَابٍ مِنْهُمْ جُزْءٌ مَقْسُومٌ^{٤٤}﴾

“Ne e kemi krijuar njeriun prej një balte të thatë të marrë nga balta e zezë pa formë.”

“Kurse para tij kemi krijuar xhindet nga zjarri pa tym.”

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë do të krijoj një njeri prej baltës së thatë të marrë nga balta e zezë pa formë.’”

“Kur t’i jap formën dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, ju t’i përuleni atij në sexhde.”

“Të gjithë engjëjt së bashku iu përulën atij në sexhde.”

“Përveç Iblisit. Ai nuk pranoi t’u bashkohej atyre që bënë sexhde.”

“All’llahu i tha: ‘O Iblis, ç’pate ti që s’u bashkove me ata që u përulën?’”

“Iblisi tha: ‘Unë nuk i përulem një vdekatari që Ti e ke krijuar nga balta e thatë e marrë prej baltës së zezë pa formë.’”

“All’llahu tha: ‘Atëherë, dil prej Xhennetit! Ti je vërtet i mallkuar!’”

“Le të jetë mallkimi mbi ty deri në Ditën e Kiametit!”

“Iblisi tha: ‘Zoti im, më jep afat deri në Ditën kur ata do të ringjallen!’”

“Zoti tha: ‘Sigurisht që do të të jepet afat.’”

“Deri në një ditë të caktuar.”

“Iblisi tha: ‘Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t’ju zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim”

“përveç robve të Tu të sinqertë.”

“(All’Ilahu) tha: ‘Kjo është rruga Ime e drejtë.’”

“Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robtë e Mi”,

“përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.”

“Pa dyshim, Xhehennemi është vendi i premtuar për të gjithë ata.”

“Ai ka shtatë dyer e për çdo derë do të ketë një pjesë të caktuar.”

Komentimi

Krijimi i njeriut

Ajetet që janë objekt studimi qartësojnë se qëllimi kryesor për ekzistencën e çdo krijese, është në të vërtetë krijimi i njeriut.

Përpara se të hyjmë në kërkimin e detajuar rreth disa çështjeve që janë përmendur në këto ajete të bekuara, po fillojmë me një komentim të përgjithshëm.

Në fillim, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ne e kemi krijuar njeriun prej një balte të thatë, të marrë nga balta e zezë pa formë.”**. *“Salasal”* është *“balta e thatë”*, e cila nëse përplasat me diçka tjetër, lëshon një tingull. Ndërsa *“hamain mesnun”* është *“balta e zezë e dekompozuar”*.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **“kurse para tij kemi krijuar xhindet nga zjarri pa tym”**.

Fjala *“es sumum”* në gjuhë, është *“ajri i jashtëzakonshëm”*. Është quajtur *“es sumum”* sepse ai depërton në të gjitha poret e trupit të njeriut. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për lëndët vdekjeprurëse, *“es semmu”* – *“helmet”*, sepse ato depërtojnë në trupin e njeriut dhe i shkaktojnë atij vdekjen.

Kur'ani Famëlartë kthehet edhe një herë në krijimin e njeriut dhe pasqyron dialogun e All'llahut të Lartësuar me melekët përpara krijimit të njeriut, ku thotë: **“Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë do të krijoj një njeri prej baltës së thatë, të marrë nga balta e zezë pa formë. Kur t’i jap formën dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, ju t’i përuleni atij në sexhde.’”**. Ai është një shpirt fisnik, i pastër dhe i lartë, prandaj: **“atëherë ju bini atij në sexhde.”**.

Pasi u bë krijimi i njeriut me trup dhe shpirt të harmonizuar **“Të gjithë engjëjt bënë sexhde së bashku.”**.

Këtij urdhri nuk iu bind vetëm Iblisi: **“Përveç Iblisit. Ai nuk pranoi t’u bashkohej atyre që bënë sexhde.”**.

Këtu, All'llahu i Lartësuar e pyeti Iblisin: **“All'llahu i tha: ‘O Iblis, ç’pate ti që s’u bashkove me ata që u përulën?’”**.

Meqë ai ishte zhytur në detin e mendjemadhësisë së errët, i përhumbar në vetëkënaqësinë e vet dhe pasi mendjen ia mbuloi perdja e dështimit, Iblisi me krenari u përgjigj: **“Iblisi tha: ‘Unë nuk i përulem një vdekatar i që Ti e ke krijuar nga balta e thatë, e marrë prej baltës së zezë pa formë.’”**. Ku është zjarri ndriçues e ku është balta e zezë, e thatë! Një krijesë fisnike, siç jam unë, t’i bindet e t’i nënshtrohet një krijesë që është më e ulët se unë?! Çfarë ligji është ky?!

Si rezultat i mendjemadhësisë dhe vetëkënaqësisë, ai i injoroi të fshehtat e krijimit dhe i harroi mirësitë e tokës, e cila është burimi i të gjitha të mirave. Më e rëndësishmja nga të gjitha, ai e shpërfilli fisnikërinë e atij shpirti, të cilin All’llahu i Lartësuar e vendosi tek Ademi. Si rezultat i kësaj sjelljeje të devijuar, ai u bë i papërshtatshëm për të qenë në gradën e melekëve dhe mes tyre. Kështu, All’llahu e urdhëroi dhe i tha: **“All’llahu tha: ‘Atëherë, dil prej Xhennetit! Ti je vërtet i mallkuar!’”**; pra, dil nga Xhenneti, ose largohu nga qiejt, ose dil prej radhëve të melekëve.

Dije mirë, o Iblis, se mendjemadhësia jote u bë shkak i mosbesimit tënd dhe se mosbesimi yt e obligoi dëbimin tënd të përhershëm: **“Le të jetë mallkimi mbi ty deri në Ditën e Kiametit!”**!

Pasi Iblisi e gjeti veten të dëbuar nga mëshira e All’llahut, atë e kaploi mendimi se krijimi i njeriut ishte shkaku i mjerimit dhe i mallkimit të tij, kështu që iu shtua zjarri përvëlues i urrejtjes në zemrën e tij dhe vendosi të hakmerrej ndaj bijve të Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Shkaku i vërtetë i dëbimit i referohet vetë Iblisit dhe Ademi nuk ka lidhje me këtë, por mendjemadhësia, vetëkënaqësia dhe

kokëfortësia e madhe e Iblisit, nuk i dhanë mundësinë që ta kuptonte të vërtetën e mjerimit të tij. Prandaj: **“Iblisi tha: ‘Zoti im, më jep afat deri në Ditën kur ata do të ringjallen!’”**, në mënyrë që të kishte kohë të shfrynte në armiqësinë dhe inatin e tij.

All’llahu i Lartësuar e pranoi kërkesën e tij: **“Zoti tha: ‘Sigurisht që do të të jepet afat.’”**.

Por, Iblisit nuk do t’i jepet afat deri në Ditën e Ringjalljes, siç ai kërkoi dhe kishte dëshirë, por **“deri në një ditë të caktuar”**. Cila është dita e caktuar?

Disa komentues kanë thënë: “Me përfundimin e kësaj bote përfundon detyra e Iblisit për të mashtruar njerëzit, sepse pas kësaj periudhe (siç kuptohet qartë nga ky ajet kur’anor), përfundon edhe jeta e të gjitha gjallesave. Nuk mbetet gjallë asnjë krijesë e gjallë, përveç madhështisë së All’llahut të Lartësuar. Nga kjo kuptojmë dakordësinë për disa kërkesa të Iblisit”.

Disa komentues të tjerë kanë thënë se bëhet fjalë për një kohë të caktuar, të cilën nuk e di askush përveç All’llahut të Lartësuar. Sikur Ai do t’ia kishte treguar ndokujt, kjo do të shërbente si një pretekst për më shumë rebelim dhe arrogancë prej Iblisit.

Disa komentues thonë se bëhet fjalë për Ditën e Kiametit, sepse Iblisi ka dashur të jetë gjallë deri atë Ditë, në mënyrë që të ishte prej të përhershmeve në këtë botë. Dita e kohës së caktuar ka ardhur me kuptimin e Ditës së Kiametit në ajetin 50 të sures “El Uakia”, gjë që e përforcon këtë thënie.

Me sa duket, ky komentim është larg të vërtetës sepse ajetet nuk e qartësojnë se All’llahu i Lartësuar i është përgjigjur plotësisht

kërkesës së Iblisit, por deri në një kohë të caktuar. Prandaj, komentimi i parë është më afër pajtueshmërisë me thelbin dhe dukjen e ajetit dhe po kështu harmonizohet edhe me disa transmetime të ardhura nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), që flasin për këtë tematikë.¹

Iblisi e shpalosi haptazi qëllimin e tij të brendshëm: **“Iblisi tha: ‘Zoti im, për shkak se më çove në humbje’”; pra, ky njeri ka qenë shkaku që unë rashë në humbje e mjerim: “Unë do t’u zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë”, të të mirave materiale, “dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim” (unë do t’ua zbukuroj ato mirësi materiale).**

Por, Iblisi e di mirë se vesveset dhe intrigat e tij nuk do të ndikojnë në zemrat e robve të singertë të All’llahut. Ata janë të mbrojtur nga kurthi i tij, sepse forca e besimit dhe grada e singëritetit të tyre është e mjaftueshme për ta përballuar këtë rrezik dhe mund t’i heqin zinxhirët e shejtanit nga vetja e tyre. Për këtë arsye, ai bën një përjashtim në kërkesën e tij dhe thotë: **“përveç robve të Tu të singertë”**.

Pa dyshim që All’llahu i Lartësuar nuk e humb e as nuk e devijon krijesën e Tij, por përpjekja e Shejtanit që të shfajësonte humbjen dhe veten e tij, e bëri atë që këtë t’ia atribuonte All’llahut të Lartësuar. Ky qëndrim është zakoni i çdo Iblisi dhe shejtani. Së pari, ata ua faturojnë mëkatet e tyre të tjerëve, e së dyti i justifikojnë veprat e tyre të shëmtuara me një gjykim të gabuar. Por fatkeqësia është se ata do të përballen me Zotin e lavdisë dhe të krenarisë, sikur ata nuk e dinë se Atij nuk mund t’i fshihet asnjë gjë.

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 13, hadithi 45.

Fjala “*mukhlisijne*”, që do të thotë *të sinqertë*, është shumësi i fjalës “*mukhlis*”, që siç e kemi shpjeguar në komentimin e sures “Jusuf”, përdoret për besimtarin që ka arritur një gradë të lartë besimi, edukimi dhe triumfi mbi neftin - egon, duke u bërë kështu pengesë për ngacmimet e shejtanit dhe çdo ngacmimi tjetër.

Për të përçmuar shejtanin dhe për të forcuar zemrën e robve të tij besimtarë të sinqertë, që ndjekin rrugën e monoteizmit të pastër, All'llahu i Lartësuar thotë: “(All'llahu) **tha: ‘Kjo është rruga Ime e drejtë. Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robtë e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.’**”.

Që do të thotë: “O Iblis, ti nuk ke pushtet t’i humbësh njerëzit! Në të vërtetë, ata që të ndjekin ty janë të devijuarit nga rruga e drejtë dhe e atyre që i janë përgjigjur thirrjes së dëshirave dhe epsheve të tyre!”

Me fjalë të tjera, njeriu është i lirë në përzgjedhjen e tij. Iblisi dhe ushtarët e tij nuk e detyrojnë njeriun të ecë në rrugën e gabuar dhe të shthurjes, por është vetë njeriu ai që u përgjigjet thirrjes së tyre, e hap zemrën përpara tyre dhe i lejon ata që të hyjnë në të.

Shejtani dhe ushtria e tij nuk janë të aftë, sado që të intrigojnë apo të bëjnë vesvese, që të hyjnë në zemrën e një njeriu, i cili është orientuar drejt besimit të sinqertë.

Me këtë fjalë, All'llahu i Lartësuar ka dashur të largojë imagjinatën e gabuar dhe egon e mendjes së shejtanit, në mënyrë që të mos kujtojë se ai do të ketë një pushtet të madh ndaj njerëzve dhe se mund të mashtrojë kë të dojë.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar i kërcënon ata që ndjekin shejtanin dhe u thotë: “**Pa dyshim, Xhehennemi është vendi i**

premtuar për të gjithë ata.”. Atje nuk ka rrugë, së cilës mund t’i shmangesh, por të gjithë kanë për t’u gjykuar në një vend të përbashkët.

Në mbyllje të këtyre ajeteve, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ai ka shtatë dyer e për çdo derë do të ketë një pjesë të caktuar”.**

Këto janë dyert e mëkateve, për shkak të të cilave kanë për të hyrë në to. Gjithsecili ka për t’u gjykuar sipas mëkatit që ka kryer. Rast i kundërt është ai i dyerve të Xhennetit, të cilat janë për njerëzit vepërmirë e besimtarët e sinqertë.

Hulumtime

1- Mendjemadhësia dhe egoja janë shkatërruese të mëdha

Historia e Iblisit në Kur’anin Famëlartë na mëson se mendjemadhësia dhe egoja janë shkaktare për shkatërrimin dhe rënien nga pozita e respektuar dhe e lartë për në nivelin më të ulët dhe në dështim.

Siç dihet, Iblisi nuk ka qenë prej melekëve (siç e tregon ajeti 50 i sures “El Kehf”), por ai u ngrit në pedestal dhe arriti në ato grada të larta, sa të jetonte në mesin e melekëve, si rezultat i bindjes së tij të mëparshme ndaj All’llahut të Lartësuar. Madje, disa kanë

thënë se ai ka qenë mësues i melekëve. Në hytben e ardhur në “Nehxhul Belaga” mësojmë se Iblisi e ka adhuruar All’llahun e Lartësuar mijëra vjet pa pushim.

Mirëpo fanatizmi i verbër dhe adhurimi i pasionit shkatërrues, e çuan atë drejt dështimit dhe humbjes.

Egoizmi, mashtrimi, fanatizmi dhe mendjemadhësia, e bënë Iblisin që të vazhdonte në mëkate e të ecte në rrugën e armiqësisë. Ai e harroi ose bëri sikur e harroi efektin pozitiv të pendimit dhe kërkit të faljes dhe qëndroi që të merrte pjesën që i takonte nga ndëshkimi i të gjithëve, në Ditën e trembjes së madhe.

Jo vetëm Iblisi, por edhe historia na ka treguar për njerëz të sëmurë nga mashtrimi dhe mendjemadhësia. Ata shkaktuan shkatërrim në tokë, për shkak se fanatizmi dhe injoranca ua mbuloi mendimet dhe shikimin e tyre. Këta njerëz zgjodhën rrugën e padrejtësisë dhe të tiranisë, duke shkaktuar gjakderdhje e duke devijuar nga rruga e drejtë.

Vetëkënaqësia dhe mendjemadhësia janë një zjarr përvëlues. Shembulli i tyre ngjason me atë njeri që kalon një kohë për të ndërtuar dhe për ta mobiluar shtëpinë e tij, por që në pak çaste ajo mund t’i shndërrohet në një gërmadhë për shkak të një shkëndije të vogël.

A ka tregim më kuptimplotë e më elokuent sesa tregimi i Iblisit?!

Në të vërtetë, Iblisit iu përziën kuptimet e gjërave dhe nisi t’ua vendoste ato sipas imagjinatës së tij mashtruese e të kufizuar. Kështu, ai nuk e kuptoi se zjarri nuk është më i mirë se balta, dhe

se balta - toka - është burimi i të gjitha të mirave, si: i bimëve, kafshëve, elementeve të ndryshme minerale, si dhe vendi i ruajtjes së ujit. Pra, balta është burimi dhe origjina e të gjitha krijesave të gjalla, ndërsa zjarri vetëm djeg dhe në shumicën e rasteve është shkatërrues.

Prijësi i Besimtarëve e përshkruan Iblisin me këto fjalë: “Iblisi, ky armik i All’llahut, është prijësi i mospërfillësve dhe paraardhës i mendjelartëve. A nuk e keni vënë re, se si All’llahu i Lartësuar e ka ndëshkuar për arrogancën e tij dhe se si e ka poshtëruar për shkak të madhërimit të vetvetes? Ai e ka bërë të dëbuar në këtë botë dhe ka siguruar për të zjarrin e tërbuar në Botën Tjetër”.¹

Siç e treguam më lart, Iblisi ishte ai që vendosi themelet e doktrinë së arrogancës, të cilën e mohon ndërgjegjja e çdo njeriu. Ithtarët e kësaj doktrine i shfajësojnë gjynahqarët nga veprat e tyre në kundërshtim me ligjin e All’llahut. Siç e lexuam në këto ajete të Kur’anit, Iblisi u justifikua me një gënjeshtër të madhe për të shfajësuar veten dhe tha se ai kishte të drejtë që të çonte në humbje të gjithë bijtë e Ademit: **“Iblisi tha: ‘Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t’ju zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim.’”**.

¹ “Nehxhul Belaga”, fjala 129.

2- Mbi kë sundon shejtani?

Depërtimi i ngacmimeve dhe intrigave të shejtanit në zemrën e njeriut nuk ndodh papritmas apo me forcë, por ndodh me dëshirën e plotë të njeriut për t'i hapur rrugën në brendësitë e tij. Shejtani e di mirë se nuk ka asnjë mundësi për të sinqertët, të cilët i kanë pastruar vetet e tyre nga papastërtitë dhe i kanë larë zemrat e tyre nga ndryshku i idhujtarisë dhe i humbjes. Sipas përshkrimit të Kur'anit Fisnik, lidhja e shejtanit me të humburit është një lidhje varësie dhe ndjekjeje (pra, njeriu bëhet vartës dhe ndjekës), dhe jo një lidhje detyruese dhe e detyruar.

3- Dyert e Xhehennemit

Në këto ajete kur'anore mësojmë se Xhehennemi ka shtatë dyer. Numri i madh i dyerve të Xhehennemit (sikurse edhe numri i madh i dyerve të Xhenetit) nuk është për lehtësim të atyre që hyjnë në të, por është një tregues i shkaqeve të shumta që i bëjnë njerëzit të hyjnë në të. Secili prej mëkateve ka një derë të caktuar.

Në librin “Nehxhul Belaga” thuhet: *“Në të vërtetë, xhihadi është një portë prej portave të Xhenetit, të cilën All'llahu e ka hapur posaçërisht për të dashurit e Tij”*.¹

Në një hadith të njohur thuhet: *“Shpatat janë çelësat e Xhenetit”*. Këto artikulime na tregojnë qëllimin e numrit të madh të dyerve të Xhenetit dhe të Xhehennemit.

¹ “Nehxhul Belaga”, fjala 27.

Në lidhje me këtë, Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në të vërtetë, *Xhenneti ka tetë porta*”.¹ Kurse, ajetet kur'anore tregojnë se Xhehennemi ka shtatë dyer. Ky ndryshim në numër tregon se edhe pse numri i dyerve të ndëshkimit është i shumtë, mirëpo, numri i dyerve për të arritur kënaqësinë dhe mirësinë është më shumë. (Për këtë kemi folur në komentimin e ajetit 23 të sures “Err Rr'ad”).

4- Balta e thatë dhe e zezë pa formë dhe fryma (shpirti) e All'llahut të Lartësuar

Nga ajetet kur'anore mësojmë se krijimi i Ademit është arritur nga ndërthurja e dy gjërave: njëra lidhet me gradët më të larta të nderimit dhe të fisnikërisë, kurse tjetra me shkallët më të ulëta.

Nga ana materiale, njeriu është krijuar nga balta e zezë, ndërsa nga ana e tij shpirtërore dhe morale, ai është krijuar me atë që është quajtur *shpirti* i All'llahut.

Është e padiskutueshme që All'llahu i Lartësuar është i pastër e pa të meta. Ai nuk është trup dhe nuk ka shpirt. Fjala *shpirt* i është shtuar emrit të Tij, për të treguar se ai është shpirt që është vendosur në trupin e njeriut, është fisnik dhe ka një pozitë të lartë. Kjo është njësoj siç emërtohet edhe Qabja si *bejtullah* (shtëpia e All'llahut), për të treguar madhështinë dhe vlerën e saj. Apo edhe muaji i Ramazanit si *muaj i All'llahut*, për të treguar begatitë e tij.

¹ “El Khisal Shejkh Saduk”, kapitulli 8, hadithi 6.

Për këtë arsye, vërejmë se linja e ngjitjes së njeriut shkon deri në atë gradë, saqë nuk shikon tjetër pos All'llahut të Madhëruar, kurse linja e zbritjes së tij vazhdon në rënie, derisa arrin në shkallë më të ulët sesa kafshët: **“Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi.”**¹

Kjo diferencë e madhe mes dy linjave, asaj ngjitëse lart dhe asaj zbritëse poshtë, është në vetvete një argument që tregon rëndësinë e veçantë të kësaj krijese.

Sigurisht që fisnikëria e pozitës së njeriut dhe respektimi i tij bëhen sipas kësaj renditjeje të veçantë, por jo për hir të anës së tij materiale, sepse ai nuk është gjë tjetër vetëm se “një copë balte e thatë dhe e zezë”. Vlera dhe pozita e tij burojnë nga shpirti hyjnor që All'llahu ka vendosur në të. Nuk ka rrugë tjetër që njeriu ta arrijë përsosmërinë, vetëm se me ndërtimin e tij shpirtëror, duke vënë dimensionin e tij material në shërbim të rrugës së përsosmërisë.

Nga ajetet e sures “El Bekare” mësohet se suxhudi i melekëve për Ademin, ndodhi kur All'llahu vendosi në të diturinë e veçantë hyjnore.

Pyetjes se si mund të lejohet sexhdja ndaj tjetërkujt përveç All'llahut të Madhëruar, si dhe për llojin e sexhdes ndaj Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*), i jemi përgjigjur në tefsirin e ajeteve që lidhen me krijimin e Ademit në suren “El Bekare”.

¹ Sure “El Araf”, ajeti 179.

5- Kush janë “el xhánn”?

Në rrënjën e saj, fjala “el xhinnu” do të thotë *diçka e fshehur nga shqisat e njeriut*. Për shembull, thuhet “xhen'nehu lejl” ose “felema xhen'ne alejhi el lejl”, që ka kuptimin: *kur errësira ta mbulojë natën*; ose përdoret fjala “mexhnun” për atë që e ka humbur arsyen, pra që i është vënë perde mendjes e nuk sheh se është i çmendur; përdoret fjala “xhenijn” për fëmijën që është i fshehur e nuk duket në mitrën e nënës, “Xhennet” - kopshti, tokën e të cilit e kanë mbuluar pemët, “el xhinán” - zemra e fshehur në gjoksin e njeriut, si dhe “xhuneh” - mburoja që mbron njeriun nga goditjet e armikut.

Nga ajetet kur'anore mësohet se “el xhinnu” ose “el xhánn” janë krijesa me logjikë, që nuk mund të shihen apo të preken me shqisat e njeriut, të krijuara nga zjarri ose nga drita e zjarrit, pra nga fijet e pastra të flakës së zjarrit. Ibli si është prej këtij lloji.

Disa dijetarë mendojnë se “el xhinnu” janë prej një lloji shpirtrash që logjikojnë dhe që janë të zhveshur nga lënda. Është e qartë se ata nuk janë komplet të zhveshur nga ana materiale, sepse ajo që del nga lënda është lëndore, por mund të jetë një gjysmë-zhveshje prej materies, sepse ato nuk mund të perceptohen nga shqisat tona. Me fjalë të tjera, ata janë prej një lloji trupi të butë.

Nga ajetet kur'anore mësohet se xhindët janë besimtarë dhe jobesimtarë, të mirë dhe të këqinj. Në të vërtetë, ata janë të obliguar me legjislacion dhe janë përgjegjës për zbatimin e tij.

Sigurisht që shpjegimi i këtyre çështjeve dhe harmonizimi i tyre me shkencën moderne kërkon një kërkim shkencor të mirëfilltë, megjithatë këtë tematikë do ta trajtojmë më gjerësisht kur të shpjegojmë suren “El Xhinn”.

Fjala *“el xhánn”* e ardhur në këto ajete, rrjedh nga lënda *“el xhinnu”*. Por, a kanë të njëjtin kuptim këto fjalë? Disa komentues kanë thënë se fjala *“el xhánn”* është specifike për një lloj të veçantë xhindesh, por ne nuk e mendojmë kështu.

Nëse i bashkojmë me njëri-tjetrin ajetet kur'anore që flasin për këtë çështje, do të na qartësohej se të dyja kuptimet janë të njëjta. Kjo për shkak se në to, herë është vendosur fjala *“el xhinnu”* përpara fjalës *“el insan”*, që do të thotë *“njeri”*, e herë tjetër është vendosur fjala *“el xhánn”*.

Për shembull, në ajetin 88 të sure *“El Isra”*, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: ‘Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindët.’”**.

Ndërkohë, në ajetin 56 të sure *“Edh Dharijat”*, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.”**.

Përsëri në ajetet 14 dhe 15 të sure *“Er Rrahman”*, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ai e krijoi njeriun nga balta e thatë, ashtu si vorba, ndërsa xhindët i krijoi prej flakës së zjarri.”**.

Po kështu, në ajetin 39 të sure *“Er Rrahman”*, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Atë Ditë njerëzit dhe xhindët nuk do të pyeten për gjynahet e tyre.”**.

Nga këto ajete kur'anore të lartpërmenduara dhe nga ajete të tjera mësojmë qartazi se *“el xhinnu”* dhe *“el xhánn”* janë dy shprehje që kanë të njëjtin kuptim. Prandaj, fjala *“el xhinnu”* në ajetet e mëparshme ka ardhur përpara fjalës *“njeri”*, po kështu edhe fjala *“el xhánn”*.

Vlen për t'u përmendur se fjala “*el xhānn*” është cekur në Kur'anin Famëlartë me kuptimin “*gjarpër*”, siç ka ardhur në tregimin e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: “**si të ishte gjarpër**”. Megjithatë, ky trajtim është jashtë hulumimit tonë.

6- Kur'ani dhe krijimi i njeriut

Në ajetet e lartpërmendura pamë që Kur'ani Famëlartë e ka trajtuar çështjen e krijimit të njeriut në mënyrë të përmbledhur. Qëllimi kryesor i trajtimit të kësaj çështjeje është aspekti edukativ dhe moral i saj. Kjo çështje është përmendur në ajete të tjera të Kur'anit, si në suret “Es Sexhde”, “El Muminun”, “Sad” e të tjera.

Duke parë se Kur'ani nuk është libër i shkencave natyrore aq sa ç'është libër i jetës së njeriut, ku paraqiten rrugët edukative dhe bazat e përsosmërisë, nuk mund të pritët nga ky libër i shenjtë që të shqyrtojë degët e këtyre shkencave: si shkenca e evoluimit, anatomisë, embrionologjisë, botanikës etj. Megjithatë, në të ceken në mënyrë të përgjithshme një pjesë e këtyre shkencave, çka përkon edhe me kërkimin edukativ, që është dhe qëllimi i trajtimit tonë.

Pas këtij prezantimi të shkurtër, e nisim temën nëpërmjet dy kërkimeve:

a- Përsosmëria e llojit nga ana shkencore.

b- Përsosmëria e llojit sipas optikës kur'anore.

Në fillim do të shqyrtojmë pikën e parë dhe do ta studiojmë këtë çështje sipas standarteve dhe kriterëve specifike të shkencave

të natyrës, duke mos e lidhur me ajetet kur'anore dhe me hadithet profetike.

Dijetarët e shkencës së natyrës kanë hedhur dy teza mbi krijimin e gjallesave të gjalla, ku ndër to janë kafshët dhe bimët.

a- Hipoteza e zhvillimit të llojeve (e transformimit), e cila thotë: Krijesat e gjalla nuk kanë qenë në fillim ashtu siç janë sot, por kanë qenë në formën e gjallesave me një qelizë të vetme. Këto gjallesa kanë jetuar në ujërat e oqeanëve dhe janë shfaqur me një mutacion specifik nga grimcat e baltës, në thellësitë e deteve.

Pra, ato kanë qenë gjallesa pa shpirt dhe prej tyre ka lindur qeliza e parë e gjallë, si rezultat i shkaqeve dhe i kushteve specifike.

Këto gjallesa të vogla, për shkak të përmasës së vogël të tyre, nuk shihen me sy të lirë, por i kanë kaluar gradualisht fazat e përsosjes dhe janë shndërruar nga një lloj në tjetrin.

Më pas, u bë zhvendosja e tyre nga detet në shkretëtirë, më pas në hapësirë, dhe me këtë u formuan llojet e bimëve, të kafshëve ujore dhe tokësore, si dhe shpendët.

Periudha më e përsosur dhe zinxhiri i kësaj përsosjeje, është ajo e njeriut që ne shohim sot, i cili është transformuar nga gjallesa të ngjashme me majmunët, në majmunë që ngjasojnë me njeriun, pastaj ka arritur në këtë formë që është sot.

b- Hipoteza e qëndrueshmërisë së llojeve, e cila thotë se gjallesat e gjalla, që në zanafillën e tyre mbartin akoma të njëjtat forma e veçori, dhe nuk kanë ndryshuar nga një lloj në një lloj tjetër. Njëri prej tyre është njeriu, i cili ka pasur formën e tij të veçantë që në fillim të krijimit.

Secili grup i shkencëtarëve ka bërë studime të gjata për të vërtetuar doktrinën e vet, duke shkaktuar shumë polemika e divergjenca në fushat shkencore rreth kësaj çështjeje. Polemikat dhe divergjenat u shtuan, kur Lamarku, një shkencëtar i shquar francez, i specializuar në shkencat e biologjisë, që ka jetuar në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, si dhe Darvini, një shkencëtar anglez i specializuar në fushën e biologjisë, që ka jetuar në shekullin e nëntëmbëdhjetë, parashtruan tezat e tyre në çështjen e evoluimit të llojeve me argumente të reja.

Shumica e shkencëtarëve të sotëm përkrahin tezën e evoluimit apo të përsosjes së këtyre llojeve, e sidomos në forumet e shkencave natyrore.

Argumentet e atyre që thonë për përsosmërinë

Aargumentet e tyre mund t'i përmbledhim në tre grupe:

Grupi i parë: Argumentet e marra nga fosilet e skeleteve të mëdha të krijesave të gjalla, të lashta. Sipas këtij grupi, studimet e shtresave të ndryshme të tokës tregojnë se gjallesat e gjalla janë transformuar nga forma të thjeshta, në forma të tjera më të përsosura dhe më të ndërlikuara. Mbetjet fosile të gjallesave të gjalla nuk është e mundur që të shpjegohen vetëm se me hipotezën e kësaj përsosmërie.

Grupi i dytë: Një seri provash që janë grumbulluar në anatominë krahasuese.

Shkencëtarët e këtij grupi argumentojnë nëpërmjet kërkimeve të gjata e të detajuara, se kur bëjnë anatomicisht e skeleteve kockore të kafshëve të ndryshme dhe i krahasojnë ato me njëra-tjetrën, shohin se ka një ngjashmëri të madhe ndërmjet tyre, gjë që tregon se të gjitha ato kanë ardhur nga një origjinë e vetme.

Grupi i tretë: Një seri krahasimesh që janë marrë nga shkenca e embrionologjisë. Shkencëtarët e këtij grupi thonë se nëse vendosen të gjitha kafshët në gjendjen e tyre embrionale, përpara se të marrin formën e tyre të plotë, do të shihet se embrionet, përpara se të plotësohen në barkun e nënave të tyre apo në brendësinë e vezëve, janë shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin. Kjo tregon se ato kanë ardhur nga i njëjti burim dhe kanë një origjinë të vetme.

Përgjigje ndaj atyre që flasin për konstatimin e specieve

Ata që përkrahin hipotezën e konstatimit të specieve, u themi se provat e përmendura nuk kanë forcë bindjeje dhe ajo që nuk mund të mohohet, është se të tre argumentet ekzistojnë në mendje, duke supozuar një mendim për çështjen e përsosjes, por ato nuk e kanë kurrë fuqinë për të arritur në nivelin e besimit.

E thënë më qartë: Vërtetimi i hipotezës së përsosjes dhe transferimi i saj nga një obligim shkencor në një ligj shkencor definitiv, ose bëhet nëpërmjet argumentit logjik ose nëpërmjet shqisës, eksperimentit dhe testimit. Rrugë të tretë nuk ka.

Ndërsa argumentet logjik dhe filozofik, siç e dimë, nuk kanë rrugë në këto çështje. Kurse dora e eksperimentit dhe e testimit

është e shkurtër që të mbërrijë te çështjet rrënjët e së cilave janë miliona vjeçare. Me të vërtetë, ajo që perceptohet me shqisa dhe eksperimente, nuk shkon përtej të dukshmes apo mutacionit të kafshët dhe bimët.

Për shembull, ndonjëherë tek pasardhësit e deleve të zakonshme ndodh një lindje e papritur e dhenve me lesh, e cila ndryshon nga leshi i deleve të zakonshme. Ai është më i butë dhe më i mirë, e kështu nis shfaqja e një race të re.

Ose ka raste të kafshëve që u ndodh një mutacion; për shembull u ndryshon ngjyra e syve, e thonjve ose forma e lëkurës etj. Por deri tani nuk kemi parë ndonjë mutacion, që mund të çojë në një shndërrim të rëndësishëm në organet kryesore në trupin e çdo kafshe, apo të ndryshohet një specie në një specie tjetër.

Duke u bazuar në këtë, mund të imagjinohet se një lloj kafshe ndryshon në një lloj tjetër nëpërmjet akumulimit të mutacioneve trashëguese, si për shembull, të shndërrohen insektet në zogj, por kjo është vetëm një imagjinatë dhe asgjë më tepër. Ne nuk kemi parë mutacione trashëguese që kanë ndryshuar një organ thelbësor të një kafshe të veçantë, në një formë tjetër.

Argumentet e shtrura nga mbështetësit e hipotezës së transformimit nuk janë gjë tjetër veçse supozime. Këta mbështetës shprehen për hipoteza të zhvillimit dhe të transformimit të llojeve, por askush prej tyre nuk ka guxuar që t'i emërtojë ato si ligje apo të vërteta shkencore.

Teoria e përsosjes dhe besimi në Zot

Shumë njerëz mendojnë se ekziston një lloj kundërshtie ndërmjet kësaj hipoteze dhe çështjes së besimit në Zot. Mbase u jepet e drejtë pasi doktrina e Darwinizmit nxiti një luftë të ashpër ndërmjet ndjekësve të kishës dhe mbështetësve të Darwinit, derisa përplasja mes dy palëve arriti kulmin. Ndjekësit e kishës e akuzonin darvinizmin se nuk harmonizohej me besimin në Zot.

Me kalimin e kohës u vërtetua se nuk ka ndonjë kundërshtim mes këtyre dy teorive. Në të vërtetë, si e pranuan hipotezën e përsosjes, si e refuzuam atë, ne sërish do ta humbisnim argumentin, sepse në asnjërën prej tyre nuk pengohet besimi në Zot.

Nëse e pranojmë këtë hipotezë, për shkak të statusit të saj si një ligj shkencor i ngritur mbi shkak-pasojën, atëherë a konsiderohet zbulimi i dukurive natyrore, si: zbritja e shirave, gadishujt, ishujt dhe oqeanet, tërmetet dhe ngjashëm me to, një pengesë e besimit në Zot? Përgjigjja është mohuese në mënyrë definitive. Në këtë mënyrë, zbulimi i ekzistencës së një lidhjeje përsosmërie mes llojeve të gjallesave të gjalla, nuk të çon në kundërshtimin e besimit në Zot.

Këtë doktrinë e ndjekin ata njerëz që besojnë se zbulimi i shkaqeve natyrore mohon besimin në ekzistencën e Zotit. E vërteta është se zbulimi i këtyre shkaqeve, jo vetëm që nuk bie në kundërshtim me monoteizmin, por do të na japë argumente të reja nga bota e krijimit, për të vërtetuar e për të argumentuar ekzistencën e All'Ilahut të Lartësuar.

Këtu duhet të përmendim se Darvini është shfajësuar nga akuza e ateizmit - mohimit të Zotit. Në librin e tij “Origjina e llojeve”, ai shprehet kështu: “Në të vërtetë, unë e pranoj hipotezën e përsosjes së llojeve, por besoj edhe në ekzistencën e Zotit. Nuk ka dyshim se pa besimin në ekzistencën e Zotit, unë nuk mund të pranoj çështjen e përsosmërisë”.

Për Darwinin shkruhet se ka qenë një besimtar në një Zot të vetëm, pavarësisht pranimit prej tij të shkaqeve natyrore në shfaqjen e llojeve të ndryshme të gjallesave. Besimi i tij për ekzistencën e një fuqie të mbinatyrshme shtohet gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës.¹

Ai besonte se orientimi i kësaj përsosjeje të ndërlikuar dhe të çuditshme të llojit, si dhe shndërrimi i një qenieje shumë të thjeshtë, të gjallë, në të gjitha këto specie të ndryshme gjallesash, nuk realizohet ndryshe vetëm se nëpërmjet një plani të detajuar dhe të saktë.

Kështu është vërtet. Përndryshe, si është e mundur që ekzistojnë të gjitha këto lloje të mahnitshme dhe të çuditshme, nga një lëndë e vetme shumë e thjeshtë? Si është e mundur që një gjë e tillë të ndodhë pa u mbështetur në diturinë dhe fuqinë e Absolutit?!

Përfundim: Zhurma e madhe që u shkaktua për ekzistencën e antagonizmit ndërmjet doktrinë së përsosjes së species dhe besimit në Zot, nuk ka asnjë bazë dhe është e paargumentueshme (si e pranuar apo jo, hipotezën e përsosmërisë së llojeve).

¹ Mahmud Bahzad, “Darvinizmi”, f. 75-76.

Mbetet të studiohet hipoteza e zhvillimit të llojeve dhe të shihet nëse ajo bie në kundërshtim me atë që është thënë në Kur'an rreth krijimit të Ademit.

Kur'ani dhe çështja e përsosmërisë

Vlen për t'u përmendur se mbështetësit dhe kundërshtuesit e hipotezës së përsosjes së llojit - me të cilët nënkuptohen myslimanët - e kanë argumentuar qëndrimin e tyre me ajete kur'anore, të cilët kanë një lidhje të largët me qëllimin e tyre. Në ajetet pasuese do të hulumtojmë dhe do të diskutojmë më shumë rreth kësaj.

Ajeti më i rëndësishëm tek i cili mbështeten ithtarët e hipotezës, është ajeti 33 i sures "Ali Imran", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"All'llahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit (e kohës së tyre)."**

Ata thonë: Ashtu sikurse Nuhu, familja e Ibrahimit dhe familja e Imranit kanë jetuar mes popullit të tyre dhe All'llahu i Madhëruar i për zgjodhi ata, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*). Në kohën e tij (Ademit) duhet të ketë pasur njerëz me emrin "*el alemijn*", dhe All'llahu i Lartësuar e ka zgjedhur atë në mesin e tyre. Kjo tregon se Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka qenë njeriu i parë mbi sipërfaqen e Tokës, por përpara tij ka pasur njerëz të tjerë. Pastaj, atë e ka për zgjedhur në mesin e tyre me mutacion ideologjik dhe shpirtëror. Ky ka qenë shkaku i përzgjedhjes së tij.

Përveç kësaj, ata sjellin edhe ajete të tjera, por që nuk kanë lidhje në thelb me këtë çështje dhe komentimi i tyre rreth përsosmërisë është komentim sipas mendimit individual. Ka ajete të tjera kur'anore që mund të argumentojnë këto dy kuptime, ku konteksti harmonizohet me përsosmërinë e llojit, me qëndrueshmërinë e tij dhe me krijimin e pavarur të Ademit. Për këtë, e pamë të arsyeshme që të distancohemi prej diskutimit të kësaj çështjeje.

Sa i përket asaj që vërehet nga ky argumentim është fjala "*alemijne*". Nëse kjo përdoret me kuptimin e njerëzve që kanë qenë bashkëkohës të Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe se përzgjedhja ka qenë në mesin e tyre, kjo është një gjë e pranueshme. Nëse e konsiderojmë fjalën "*alemijne*" më përgjithësuese sesa bashkëkohësit e Ademit, duke përfshirë edhe jobashkëkohësit e tij, siç është transmetuar në hadithin nga i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ku thuhet: "*Në të vërtetë, bija ime Fatimeja është e para dhe më fisnikja e grave të njerëzimit, nga të parët dhe të fundit*", atëherë ky ajet nuk është argument për qëllimin e tyre. Kjo është si të thuash se All'Ilahu i Lartësuar ka përzgjedhur disa persona nga gjiri i njerëzve në çdo shekull dhe në çdo kohë dhe Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) është njëri prej tyre. Kështu që nuk është e nevojshme prania e njerëzve në kohën e Ademit, në mënyrë që të përdorej për ta emri "*alemijn*" dhe në mesin e tyre të përzgjidhej Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*), e veçanërisht kur përzgjedhja është nga ana e All'Ilahut të Lartësuar,

i Cili është i Vetmi që e di të ardhmen dhe i di të gjithë brezat e të gjitha kohërave.¹

Përsa u përket mbështetësve të qëndrueshmërisë së specieve, ata kanë zgjedhur për argument ajetet në fjalë dhe ajete të tjera të ngjashme me to, që thonë se All'llahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun nga balta

Ajo që të tërheq vëmendjen, është se në këtë shprehje herë përmendet krijimi i "*el insan*", njeriut, siç thuhet në ajetin 26 të sures "El Hixhr", All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ne e krijuam njeriun prej një balte të thatë, të marrë nga balta e zezë pa formë."** Herë tjetër në këtë shprehje përmendet krijimi i "*el beshër*", njerëzit, siç thuhet në ajetin 28 të sures "El Hixhr", All'llahu i Lartësuar thotë për veçorinë e krijimit të njeriut: **"Kur Zoti yt u tha engjëjve: 'Unë do të krijoj një njeri prej baltës së thatë të marrë nga balta e zezë pa formë.'" (Rreth rënies në sexhde të melekëve, pas krijimit të Ademit, shih ajetet: 29, 30, 31 të sures "El Hixhr").**

Në shikim të parë të ajeteve vërehet se krijimi i Ademit është bërë prej balte të thatë e të zezë, pastaj forma e tij është përsosur me fryrjen e shpirtit hyjnor në të pastaj, atij i ranë në sexhde melekët, përveç Iblisit.

Hulumtimi i ajeteve nuk tregon për ekzistencën e asnjë prej specieve të tjera që kur është krijuar Ademi nga balta, e deri në formën aktuale të fëmijëve të tij.

Edhe pse është përdorur fjala "*thumme*", që do të thotë *pastaj* (si ndajfolje), për të qartësuar distancën midis dy çështjeve, ajo nuk

¹ Sipas një mendimi tjetër thuhet se Ademi u përzgjedh nga mesi i fëmijëve të tij, pasi kaloi një periudhë jo e gjatë, e në mesin e tyre u formua një shoqëri e vogël.

tregon se kanë kaluar miliona vite apo se kanë ekzistuar mijëra lloje ndërmjet atyre intervaleve kohore.

Madje, ky mund të jetë edhe një tregues i të njëjtës fazë së krijimit të Ademit nga balta e thatë, pastaj krijimi i trupit të tij e në fund fryrja e shpirtit.

Këtë e vërejmë në përdorimin e fjalës *“thumme”*, që do të thotë *“pastaj”*, kur flitet për krijimin e njeriut në botën e embrionit dhe periudhat që vijnë më pas: **“O njerëz, nëse ju dyshoni në Ringjalljen, mendoni si ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t’jua bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë.”**¹

Ky ajet kur’anor tregon se përdorimi i fjalës *“thumme”* – *“pastaj”*, nënkupton ekzistencën e një intervali që mund të mos jetë domosdoshmërisht i gjatë, pra mund të jetë një interval i shkurtër ose i gjatë.

¹ Sure “Haxhah”, ajeti 5.

Ajetet 45 - 50

﴿إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي جَنَّاتٍ وَعُيُونٍ ۚ ادْخُلُوهَا بِسَلَامٍ آمِينَ ۚ﴾^{٤٦} وَنَزَعْنَا مَا
فِي صُدُورِهِمْ مِنْ غِلٍّ إِخْوَانًا عَلَى سُرُرٍ مُتَقَابِلِينَ ۚ لَا يَمَسُّهُمْ فِيهَا
نَصَبٌ وَمَا هُمْ مِنْهَا بِمُخْرَجِينَ ۚ^{٤٨} نَبِيُّ عِبَادِيَ أَنِّي أَنَا الْغَفُورُ الرَّحِيمُ ۚ^{٤٩}
وَأَنَّ عَذَابِي هُوَ الْعَذَابُ الْأَلِيمُ ۚ﴾

“Vërtet, punëmirët do të jenë në kopshtet e Xhennetit pranë burimeve.”

“Atyre do t’u thuhet: ‘Hyni atje me paqe dhe siguri!’”

“Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane.”

“Aty nuk do t’i mendojë lodhja e prej aty kurrë nuk do të dëbohen.”

“Lajmëroji robtë e Mi (o Muhammed) se, vërtet, Unë jam Falësi i madh, Mëshirëploti.”

“Dhe se dënimi Im është vërtet dënimi i dhembshëm!”

Komentimi

Tetë mirësitë e Xhennetit

Në ajetet e mëparshme vumë re se si All'Ilahu i Lartësuar e ka përshkruar përfundimin e çështjes së shejtanit, ndihmësve dhe ndjekësve të tij, dhe se Xhehennemi me të shtatë dyert e tij është i hapur për ta.

Ajetet që janë objekt studimi flasin për Xhennetin dhe banorët e tij dhe tregojnë se çfarë përjetojnë ata nga mirësitë e begatitë materiale e shpirtërore.

Këto ajete kanë parashtruar tetë mirësi të mëdha (materiale dhe shpirtërore), të cilat janë të barabarta me numrin e dyerve të Xhennetit.

1- Në fillim tregohet për mirësinë e rëndësishme trupore, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, punëmirët do të jenë në kopshtet e Xhennetit pranë burimeve.”**. Vërehet se ky ajet ka përdorur cilësinë **“punëmirët”** si thelbësore, dhe kjo përfshin frikën ndaj All'Ilahut të Lartësuar, devotshmërinë dhe përpikmërinë në zbatimin e rregullave hyjnore.

Përmendja e kopshteve dhe e burimeve në numrin shumë të tregon për llojet e shumta të tyre, ku secili ka shije dhe ushqim të veçantë.

2 dhe 3- Më pas, ajetet tregojnë për dy mirësi shumë të rëndësishme shpirtërore, që janë paqja dhe siguria: **“Atyre do t'u thuhet: 'Hyni atje me paqe dhe siguri!'”**.

Ajeti në vazhdim tregon për tri mirësi të tjera shpirtërore, të cilat janë:

4- All'llahu i Lartësuar thotë: “Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre”; d.m.th. që *“do t'i pastrojmë e do t'ua heqim nga zemra zilinë, urrejtjen, armiqësinë dhe tradhëtinë”*.¹

5- Pastaj, All'llahu i Lartësuar thotë: “ata do të rrinë ulur si vëllezër”; ata do t'i mbajnë lidhur lidhjet më të forta të dashurisë.

6- Përsëri All'llahu i Lartësuar thotë: “përballë njëri-tjetrit në divane.”²

Takimet e tyre do të jenë të zhveshura nga detyrimet lodhëse, që janë karakteristike për jetën e dynjasë. Aty nuk ka ndarje shtresash. Që të gjithë janë vëllezër, ulen përballë njëri-tjetrit në një rresht të vetëm dhe në një pozicion.

Sigurisht që kjo nuk e mohon ndryshimin e pozitive dhe të gradave që ata kanë arritur nga shkalla e besimit dhe e devotshmërisë në jetën e kësaj bote, por barazia për të cilën flitet, lidhet vetëm me takimet e tyre shoqërore.

7- Më pas përmendet mirësia e shtatë, ajo materiale dhe shpirtërore, ku All'llahu i Lartësuar thotë: “Aty nuk do t'i mundojë

¹ “El gil’lu” është depërtimi i fshehtë i diçkaje. Për këtë arsye, kjo fjalë përdoret për zilinë, urrejtjen dhe armiqësinë, të cilat depërtojnë fshehtas në nefsin e njeriut. Megjithatë, fjala “gil’lun” ka një kuptim të gjerë, që përfshin shumë të meta dhe karakteristika negative.

² “Es surur” është shumësi i fjalës “serirun”, që janë karriget ku banorët e Xhennetit ulen gjatë takimeve të tyre; “sururun” edhe “serirun” janë nga e njëjta lëndë.

lodhja.". Atje nuk do të ketë ditë si ditët e kësaj bote ku të kaplon lodhja dhe ke nevojë të pushosh e ku njeriu nuk gjen dot rehati dhe qetësi.

8- Ata nuk i preokupon shqetësimi i vdekjes e as i mbarimit të mirësive, sepse All'llahu i Lartësuar thotë: **"e prej aty kurrë nuk do të dëbohen."**

Kur'ani Famëlartë paraqet mirësitë e mëdha që do të kenë punëmirët në Xhennet, me atë bukuri dhe magjepsje tërheqëse, saqë i zhyt gjynahqarët në oqeanet e pafundme të dëshpërimit dhe pikëllimit dhe i detyron ata që të thonë: "Ah, sikur t'i kishim edhe ne disa nga këto të mira!" All'llahu i Lartësuar, Mëshiruesi, Mëshirëploti ua hap atyre dyert e Xhennetit. Ai u drejtohet atyre me një gjuhë të mbushur me dashuri, mëshirë dhe dhembshuri, me gjuhën e Pejgamberit të Tij, Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) dhe u thotë: **"Lajmëroji robtë e Mi (o Muhammed) se, vërtet, Unë jam Falësi i madh, Mëshirëploti."**

Në të vërtetë, fjala *"ibadij"* – *"robtë e M"*, përçon një ndjesi kënaqësie e mëshire që tërheq çdo njeri. Dhe kur ajeti mbyllet me frazën **"se, vërtet, Unë jam Falësi i madh, Mëshirëploti"**, kjo forcë tërheqëje arrin kulmin e ndikimit të saj.

Gjithashtu, karakteristikë e stilit kur'anor, është që shprehjet e rrepta të përdoren kur flitet për zemërimin dhe ndëshkimin hyjnor, që të ndalohet dhe të mos keqpërdoret mëshira hyjnore dhe që të ketë një balancë ndërmjet frikës dhe shpresës, që konsiderohet edhe si simbol i përsosmërisë dhe i edukimit. All'llahu i Lartësuar thotë: **"dhe se dënimi Im është vërtet dënimi i dhembshëm!"**.

Hulumtime

1- Kopshtet dhe burimet e Xhennetit

Kuptimi dhe përfshirja e dimensioneve të mirësive të Xhennetit, teksa jetojmë ende në këtë botë të kufizuar, konsiderohet si një gjë shumë e vështirë, madje pothuajse e pamundur, sepse mirësitë e kësaj bote në krahasim me mirësitë e Botës Tjetër janë si raporti i numrit zero me një numër shumë të madh shifror. Megjithatë, ne mund të ndiejmë disa nga rrezet e atij dimensionit me mendjen dhe shpirtin tonë.

Mirësitë e Botës Tjetër janë të shumëllojshme. Këtë të vërtetë e tregon fjala *“xhennatin”* në këto ajete dhe në ajetet e tjera kur'anore, që do të thotë *“kopshte”*, dhe po kështu edhe fjala *“ujun”*, që do të thotë *“burime”*.

Në Kur'an (në suret *“El Insan”*, *“Er Rrahman”*, *“Ed Dukhan”*, *“Muhammed”* dhe të tjera si këto) tregohet për llojet e ndryshme të këtyre burimeve. Këto çështje do t'i trajtojmë kur të komentojmë suret e lartpërmendura.

2- Mirësitë materiale dhe jomateriale

Ndryshe nga ajo që mendojnë disa, Kur'ani nuk i ka përgëzuar gjithmonë njerëzit vetëm me të mirat materiale të Xhennetit, por shpesh ka folur edhe për të mirat shpirtërore. Ajetet që po shpjegojmë janë një shembull i qartë për këtë gjë. Në to

vërejmë se gjëja e parë me të cilën përballen banorët e Xhennetit, janë mikpritja dhe përgëzimi nga melekët kur ata hyjnë në të: **“Hyni atje me paqe dhe siguri!”**.

Nga mirësitë e tjera shpirtërore që tregojnë këto ajete, është pastrimi i zemrave nga urrejtja dhe nga cilësitë negative: si zilia dhe mashtrimi, e të tjera të ngjashme me to.

Po kështu, në Xhennet hiqen barrierat e statuseve shoqërore, të cilat e trazojnë mendimin e qëndrueshëm dhe shpirtin e njeriut.

Paqja dhe siguria janë vendosur në krye të listës së mirësive të Botës Tjetër, sepse këto janë themeli i çdo mirësie tjetër.

3- Urrejtja dhe zilia janë dy armiqtë e vëllazërisë

Ajo që mund të vërehet në këto ajete, është se pasi kanë përmendur mirësinë e paqes dhe të sigurisë, e përpara se të flasin për vëllazërinë dhe harmoninë ndërmjet banorëve të Xhennetit, ato cekin çrrënjosjen e cilësive që e pengojnë vëllazërimin, siç janë: zilia, urrejtja, mashtrimi dhe tradhtia. Të gjitha këto përmbledhen në fjalën *“el gil'lu”*, e cila ka një kuptim të gjerë.

Zemra e njeriut, nëse nuk pastrohet nga këto cilësi përçmuese *“el gil'lu”*, atëherë nuk do ta përftojë mirësinë e paqes dhe të sigurisë dhe s'do të ndodhë as vëllazërimi e harmonia, por do të ketë gjithmonë përçarje, luftëra, gjakderdhje, përplasje e grindje.

4- Shpërblimi i plotë

Disa komentues të Kur'anit thonë se shpërblimi ka katër karakteristika: në të ka dobi të bollshme, ai është i shoqëruar me respekt, është i zhveshur prej çdo dhimbjeje dhe është i përhershëm e pa ndërprerje.

Ajetet që po komentojmë i kanë cekur karakteristikat e mësipërme.

Kështu, shprehja **“Vërtet, punëmirët do të jenë në kopshtet e Xhennetit pranë burimeve”**, është tregues i karakteristikës së parë.

Kurse shprehja **“Atyre do t’u thuhet: ‘Hyni atje me paqe dhe siguri!’”** është një argument i respektimit dhe i vlerësimit.

Shprehja tjetër **“Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane”** është tregues i ndalimit të çdo lloji dhimbjeje dhe shqetësimi.

Shprehja **“Aty nuk do t’i mendojë lodhja”** është tregues i mungesës së dhimbjeve trupore.

Shprehja **“e prej aty kurrë nuk do të dëbohen”** tregon për karakteristikën e fundit, që është qëndrimi i përhershëm i mirësive. Me këtë, shpërblimi bëhet i plotë në të gjitha aspektet.¹

¹ Tefsiri “Kebijr”, vëll. 19, f. 193.

5- Ejani të punojmë të gjithë së bashku, që ta bëjmë këtë botë Xhennet!

Mirësitë materiale dhe shpirtërore të përshkruara në ajetet kur'anore, janë baza e mirësive të kësaj bote. Duket sikur Kur'ani Kerim dëshiron që ne të kuptojmë se mund të kemi një Xhennet të vogël në jetën tonë të përditshme, i cili është i ngjashëm me Xhennetin e madh, nëse:

- I pastrojmë zemrat tona nga sëmundjet e zilisë dhe të armiqësisë.

- I forcojmë lidhjet vëllazërore e të harmonisë ndërmjet njerëzimit.

- Fshijmë nga jeta jonë vlerësimet dhe format e kënaqësisë së tepruar dhe përçarëse.

- Punojmë për të arritur paqen dhe sigurinë në shoqërinë tonë.

- Kuptojmë se nuk duhet të ketë shfrytëzim, skllavërim dhe racizëm klasor ndërmjet nesh. Nëse plotësohen këto kushte, atëherë njerëzimi do të jetojë Xhennetin e kësaj bote.

Ajetet 51 - 60

﴿وَنَبِّئُهُمْ عَنْ ضَيْفِ إِبْرَاهِيمَ ۖ إِذْ دَخَلُوا عَلَيْهِ فَقَالُوا سَلَامًا قَالَ إِنَّا مِنْكُمْ وَجِلُونَ ۖ قَالُوا لَا تَوْجَلْ إِنَّا نُبَشِّرُكَ بِغُلَامٍ عَلِيمٍ ۖ قَالَ أَبَشَّرْتُمُونِي عَلَى أَنْ مَسَّنِيَ الْكِبَرُ فِيمَ تَبَشِّرُونَ ۖ قَالُوا بَشِّرْنَاكَ بِالْحَقِّ فَلَا تَكُنْ مِنَ الْقَانِطِينَ ۖ قَالَ وَمَنْ يَقْنَطُ مِنْ رَحْمَةِ رَبِّهِ إِلَّا الضَّالُّونَ ۖ قَالَ فَمَا خَطْبُكُمْ أَيُّهَا الْمُرْسَلُونَ ۖ قَالُوا إِنَّا أُرْسِلْنَا إِلَى قَوْمٍ مُجْرِمِينَ ۖ إِلَّا آلَ لُوطٍ إِنَّا لَمُنَجُّوهُمْ أَجْمَعِينَ ۖ إِلَّا امْرَأَتَهُ قَدَرْنَا إِنَّهَا لَمِنَ الْغَابِرِينَ ۖ﴾

“Tregoju atyre edhe për mysafirët e Ibrahimit!”

“Ata shkuan tek ai dhe i thanë ‘Paqe!’, por ai tha: ‘Në të vërtetë, ne kemi frikë nga ju.’”

“Ata thanë: ‘Mos u frikëso, se ne po të sjellim një lajm të mirë! Ti do të kesh një djalë të ditur!’”

“Ibrahimi tha: ‘Po ma sillni këtë lajm të mirë, edhe pse më ka goditur pleqëria?! Mbi ç’bazë po ma sillni këtë lajm?’”

“Ata u përgjigjën: ‘Ne ta japim lajmin e mirë me vërtetësi, prandaj mos u bëj shpresëhumbur!’”

“Ibrahimi tha: ‘E kush mund ta humbë shpresën nga mëshira e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur?!’”

“Ai i pyeti: ‘Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?’”

“(Ata) thanë: ‘Ne jemi dërguar te një popull keqbërës (për ta shkatërruar të gjithin).’”

“Përveç familjes së Lutit. Ne do t’i shpëtojmë të gjithë ata.”

“Përveç gruas së tij; për atë, Ne kemi caktuar si dënim që të mbetet pas me të tjerët.”

Komentimi

Mysafirë të çuditshëm!

Këto ajete dhe ajetet në vijim flasin për aspektin edukativ të historisë së jetës së Profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*), rrjedhjen e ngjarjeve dhe marrëdhëniet me kundërshtarët e popujve të tyre. Këto ajete japin modele të gjalla, që duhen të merren në konsideratë nga të dyja grupet, si nga adhuruesit e singertë të All’llahut të Lartësuar, ashtu edhe nga ndjekësit dhe adhuruesit e shejtanit.

Ajetet në fjalë fillojnë me rrëfimin e mysafirëve të Ibrahimit (që janë melekët), të cilët erdhën në formën e njeriut dhe e përgëzuan atë me një djalë të begatë, duke e lajmëruar edhe për ndëshkimin e popullit të Lutit.

Në dy ajetet e para vjen urdhri i All'llahut të Lartësuar për Pejgamberin e Tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të qartësuar mëshirën e Tij të madhe për njerëzit si dhe ndëshkimin e Tij të dhembshëm. Në këtë rrëfim jepen dy modele të gjalla për mëshirën dhe ndëshkimin e All'llahut, të cilat tregojnë edhe lidhjen që kanë këto ajete.

Në fillim, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Tregoju atyre edhe për mysafirët e Ibrahimit!”**.

Fjala *“dhajfun”* në këtë ajet ka ardhur në numrin njëjës dhe do të thotë *“mysafir”*. Disa komentues të mëdhenj të Kur'anit kanë thënë se kjo fjalë mund të përdoret në numrin njëjës dhe në shumës.

Këta mysafirë ishin melekë që shkuan tek Ibrahim (i *Paqja qoftë mbi të!*), me fytyra jo të buzëqeshura. Ata e përshëndetën me *“selam”* – *“paqe”* siç thotë All'llahu i Lartësuar: **“Ata shkuan tek ai dhe i thanë ‘Paqe!’”**.

Ibrahimi u ngrit të kryente detyrën e tij e të respektonte miqtë. Përgatiti për ta ushqim dhe ua vendosi përpara, por ata nuk e prekën atë ushqim me duart e tyre. Ibrahim u habit nga qëndrimi i këtyre mysafirëve të çuditshëm dhe shprehu atë që i erdhi në mendje. Duke folur për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“por ai tha: ‘Në të vërtetë, ne kemi frikë nga ju.’”**.¹

¹ Ajetet që po komentojmë nuk e kanë përmendur detajin e moszgjatjes së duarve të tyre drejt ushqimit, por kjo gjë është cituar në ajetet 69 dhe 70 të sures “Hud”.

Ibrahimi (*Paqja qoftë mbi të!*) ndjeu frikë sepse ai e dinte se refuzimi i ushqimit ishte tregues i një qëllimi të keq, apo i një shenje armiqësie.

Por melekët nuk e lanë Ibrahimin në këtë gjendje ankthi e frike dhe i thanë: **“Ata thanë: ‘Mos u frikëso, se ne po të sjellim një lajm të mirë! Ti do të kesh një djalë të ditur!’”**.

Cili është qëllimi i pasjes së një djali të ditur e të zgjuar?

Duke ndjekur ajetet kur'anore me vëmendje, vërejmë se me fjalën “djalë i ditur” nënkuptohet Is'haku. Në suren Hud, ajeti 71, lexojmë se gruaja e Ibrahimit po qëndronte afër tij kur melekët e përgëzuan me këtë lajm të mirë. Nga kjo kuptohet se bashkëshortja e tij ishte sterile dhe e përgëzuan edhe atë: **“Gruaja e tij, që rrinte aty, qeshi kur ne i dhamë lajmin e mirë për Is'hakun.”**.

Sikurse është e ditur, Sara është nëna e Is'hakut, por Ibrahimi (*Paqja qoftë mbi të!*) ka pasur një djalë më të madh se Is'haku, i cili quhet Ismail, nga Haxhireja, robëresha me të cilën ai ka qenë i martuar.

Ibrahimi e dinte mirë se në moshën e tij ishte e pamundur të kishte fëmijë (edhe pse për All'llahun e Lartësuar nuk ka asgjë të pamundur), e për këtë ai me habi iu përgjigj atyre duke thënë: **“Ibrahimi tha: ‘Po ma sillni këtë lajm të mirë, edhe pse më ka goditur pleqëria?! Mbi ç'bazë po ma sillni këtë lajm?’”**. *A është prej jush ky lajm, apo është urdhër i All'llahut të Lartësuar? M'u përgjigjni, që të më shtohet qetësia!*

Shprehja “se mua më ka kapluar pleqëria” tregon se ai i kishte flokët të thinjur, rrudhat në fytyrë si dhe shenjat e tjera të pleqërisë.

Dikush mund të thotë se Ibrahimit i kishte ndodhur e njëjta gjë edhe kur i kishte lindur djali i parë, Ismaili, dhe ai ishte po në atë moshë të pleqërisë. Përse u habit atëherë, me përsëritjen e kësaj ngjarjeje?

Përgjigje:

Së pari: Periudha ndërmjet lindjes së Ismailit dhe Is'hakut (siç e tregojnë disa komentues) ka qenë më e madhe se dhjetë vjet, çka e bën më pak të mundur ardhjen e një fëmije në jetë.

Së dyti: Ndodhia e një situatë në kundërshtim me ligjet e natyrës, të çon drejt habitës, por nëse kjo ngjarje përsëritet, atëherë nuk ka vend për t'u çuditur se ajo do të ndodhë përsëri.

Lindja e një fëmije në këtë moshë është diçka e papritur; edhe nëse ndodh, ajo është e çuditshme dhe e habitshme.¹

Sidoqoftë, melekët nuk i lanë kohë Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) që të habitet, por thanë: **“Ata u përgjigjën: ‘Ne ta japim lajmin e mirë me vërtetësi.’. Ky është një përgëzim dhe lajm i mirë nga ana e All'llahut të Lartësuar, është një lajm i vërtetë dhe i padiskutueshëm.**

Për t'i konfirmuar çështjen dhe për t'i larguar Ibrahimit çdo mundësi dëshpërimi, melekët i thanë: **“prandaj mos u bëj shpresëhumbur!”**.

¹ Disa komentues të Kur'anit tregojnë se kur Ibrahimit i ka lindur djali i parë, Ismaili, ai ka qenë 99 vjeç, ndërsa kur i ka lindur djali i dytë, Is'haku, ka qenë 112 vjeç.

Por Ibrahimimi (*Paqja qoftë mbi të!*) i qetësoi ata, duke u thënë se dëshpërimi nuk ishte futur në zemrën e tij, sepse ai është i bindur se urdhëri i fuqisë hyjnore është i kryer në të gjitha skajet e gjithësisë, aq sa shkon deri edhe në shkeljen e normave të natyrshme dhe pa i prishur ekuilibrat. Në lidhje me këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ibrahimi tha: ‘E kush mund ta humbë shpresën nga mëshira e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur?!’”**.

Në të vërtetë, të humbur janë ata që nuk e njohin All'llahun e Lartësuar dhe fuqinë e Tij absolute. All'llahu i Lartësuar është Ai që e krijoi njeriun në formën e tij të veçantë nga grimcat e tokës dhe nga një pikë uji e pavlerë, për ta bërë atë më pas një krijesë të denjë. All'llahu është Ai, që palmën e thatë e bën të mbartë fruta. All'llahu është Ai, që e bëri zjarrin të ftohtë e paqe për Ibrahimin. A ka dyshim në fuqinë absolute të All'llahut të Lartësuar?! A është e drejtë për atë që beson dhe që e njeh mirë madhështinë e Tij, që ta humbë shpresën e mëshirës së Tij?!

Pasi e dëgjoi përgëzimin, Ibrahimimi (*Paqja qoftë mbi të!*) e kuptoi se melekët kishin zbritur për një çështje jo të mirë e se përgëzimi për të ishte vetëm një detyrë e tërthortë e tyre: **“Ai i pyeti: ‘Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?’ (Ata) thanë: ‘Ne jemi të dërguar të një populli keqbërës (për ta shkatërruar të gjithin).’”**.

Melekët e dinin se Ibrahimimi (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i ndjeshëm dhe shumë i përpiktë në çdo gjë dhe se nuk bindej me gjëra të përgjithshme, kështu që ata ia qartësuan çështjen e zbritjes së ndëshkimit mbi popullin e Lutit, të cilët ishin bërë keqbërës, përveç familjes së tij. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Përveç familjes së Lutit, Ne do t’i shpëtojmë të gjithë ata.”**

Fraza **“familjes së Lutit”** dhe forma përforcuese **“të gjithë ata”** përfshin edhe gruan e Lutit, e cila mbante anën e idhujtarëve, e ndoshta Ibrahimimi e ka ditur këtë. Prandaj, melekët shtuan duke thënë: **“përveç gruas së tij; për atë, Ne kemi caktuar si dënim që të mbetet pas me të tjerët.”**

Fraza **“Ne kemi caktuar”** në këtë ajet, tregon për detyrën që melekët janë ngarkuar nga ana e All'llahut të Lartësuar.

Tregimin e zbritjes së melekëve tek Ibrahimimi (*Paqja qoftë mbi të!*), përgëzimin e tij me Is'hakun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe bisedën e tyre me të për popullin e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*), e kemi përmendur në mënyrë të detajuar në ajetet 69-76 të sures “Hud”.

Ajetet 61 - 77

﴿فَلَمَّا جَاءَ آلَ لُوطٍ الْمُرْسَلُونَ^{٦١} قَالَ إِنَّكُمْ قَوْمٌ مُنْكَرُونَ^{٦٢} قَالُوا بَلْ جِئْنَاكَ بِمَا كَانُوا فِيهِ يَمْتَرُونَ^{٦٣} وَأَتَيْنَاكَ بِالْحَقِّ وَإِنَّا لَصَادِقُونَ^{٦٤} فَأَسْرِ بِأَهْلِكَ بِقِطْعٍ مِنَ اللَّيْلِ وَاتَّبِعْ أَدْبَارَهُمْ وَلَا يَلْتَفِتْ مِنْكُمْ أَحَدٌ وَامْضُوا حَيْثُ تُؤْمَرُونَ^{٦٥} وَقَضَيْنَا إِلَيْهِ ذَلِكَ الْأَمْرَ أَنَّ دَابِرَ هَؤُلَاءِ مَقْطُوعٌ مُصْبِحِينَ^{٦٦} وَجَاءَ أَهْلُ الْمَدِينَةِ يَسْتَبْشِرُونَ^{٦٧} قَالَ إِنَّ هَؤُلَاءِ ضَيْفِي فَلَا تَفْضَحُونِ^{٦٨} وَاتَّقُوا اللَّهَ وَلَا تُخْزُونِ^{٦٩} قَالُوا أَوْلَمْ نَنْهَكَ عَنِ الْعَالَمِينَ^{٧٠} قَالَ هَؤُلَاءِ بَنَاتِي إِنْ كُنْتُمْ فَاعِلِينَ^{٧١} لَعَمْرُكَ إِنَّهُمْ لَفِي سَكْرَتِهِمْ يَعْمَهُونَ^{٧٢} فَأَخَذْتَهُمُ الصَّيْحَةُ مُشْرِقِينَ^{٧٣} فَجَعَلْنَا عَلَيْهِمَا سَافِلَهَا وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهِمْ حِجَارَةً مِنْ سِجِّيلٍ^{٧٤} إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْمُتَوَسِّمِينَ^{٧٥} وَإِنَّهَا لِبِسَابِلٍ مُّقِيمٍ^{٧٦} إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ^{٧٧}﴾

“Dhe, kur të dërguarit erdhën te Luti.”

“Ai tha: ‘Unë nuk ju njoh ju!’”

“Ata thanë: ‘Jo, ne të kemi sjellë atë, në të cilën ata dyshojnë.’”

“Të kemi sjellë të vërtetën, prandaj të jesh i sigurt se ajo që të themi, do të bëhet.”

“Nisu me familjen tënde në një kohë të natës, shko pas tyre e askush prej jush të mos shikojë prapa, por vazhdoni në drejtimin e urdhëruar!”

“Dhe Ne ia shpallëm atij atë që do të ngjajë: që i gjithë populli i tij, deri në të mbramin, do të zhdukej në agim.”

“Banorët e qytetit erdhën tek ai gjithë gëzim.”

“Luti u tha: ‘Këta janë mysafirët e mi, andaj mos më turpëroni!’

“Kijeni frikë All’lilahun e mos më poshtëroni!”

“Ata thanë: ‘A nuk ta kemi ndaluar ne të presësh mysafirë?’”

“Ai tha: ‘Ja vajzat e mia! Nëse doni të bëni çka synoni (martohuni me to).’”

“Betohem për jetën tënde (o Muhammed), se ata ishin vërtet të përhumbur në dehjen e tyre!”

“Ata i kaploi zëri i tmerrshëm (i Xhebrailit) kur lindi Dielli.”

“Dhe ne e kthyem qytetin përmbys, duke lëshuar mbi ata shi gurësh prej dheut të pjekur.”

“Këto janë njëmend shenja bindëse për ata që i kuptojnë ato.”

“Qyteti i rrënuar është në rrugë, ku gjendet edhe tani.”

“Vërtet, në të ka shenja për besimtarët.”

Komentimi

Dënimi i keqbërësve të popullit të Lutit

Në ajetet e mëparshme mësuam për takimin e melekëve të ndëshkimit me Ibrahimin (*Paqja qoftë mbi të!*), kurse këto ajete plotësojnë ecurinë e ngjarjes, tregojnë se çfarë ndodhi qëkurse melekët u larguan nga Ibrahim (i) (*Paqja qoftë mbi të!*) e derisa u takuan me Lutin (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në fillim të këtyre ajeteve lexojmë: **“Dhe, kur të dërguarit erdhën te Luti.”**.

Luti (*Paqja qoftë mbi të!*) u kthye prej tyre dhe tha: **‘Ai tha: “Unë nuk ju njoh ju!”’**.

Komentuesit e Kur’anit thonë se ai u tha atyre ashtu për shkak të bukurisë rinore që kishin dhe për shkak se e dinte se çfarë ishte e përhapur në mesin e popullit të tij prej veprave të shëmtuara të devijimit seksual. Ata ishin mysafirët e tij dhe duhej t’i respektonte, por ambienti në të cilin jetonte Luti, ishte i infektuar dhe i papastër.

Në suren “Hud” përdoret shprehja *“siie bihim”* – **“ai u keqësua për ta”**, kur flitet për historinë e popullit të Lutit, çka do të thotë se ajo situatë ishte e vështirë për Pejgamberin e Zotit dhe se ai u brengos për ardhjen e tyre, për shkak të ditës së vështirë që i priste ata.

Por melekët nuk e lanë atë të mërzitej dhe i thanë: **“Ata thanë: ‘Jo, ne të kemi sjellë atë, për të cilën ata dyshojnë’”**; domethënë: ne kemi ardhur me një ndëshkim të dhembshëm, për

të cilin ti ua ke tërhequr vërejtjen shumë herë, por ata nuk e vranë mendjen dhe nuk e besuan.

Atij i konfirmuan të vërtetën duke i thënë: **“të kemi sjellë të vërtetën”**, d.m.th. ndëshkimin përfundimtar për popullin tënd të humbur.

Pastaj, për ta përforcuar faktin se ajo gjë do të ndodhte, i thanë: **“prandaj të jesh i sigurt se ajo që të themi, do të bëhet.”**.

Ai popull i kishte shkëputur të gjitha urat e kthimit. Për ta nuk kishte mbetur më vend për ndërmjetësim e dialog.

Melekët i thanë Lutit: “Largoje familjen tënde natën, kur populli yt të jetë duke fjetur, apo duke pirë e duke u argëtuar me epsheet e tyre”, në mënyrë që të shpëtonte grupi besimtar i popullit të tij (e ata ishin familja, përveç gruas së tij).

All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nisu me familjen tënde gjatë natës”**; ti qëndro pas tyre, në mënyrë që askush prej tyre të mos mbetet prapa dhe të jesh kujdestar dhe ruajtës i tyre. **“Shko pas tyre”**, e ata të mos shikojnë prapa se çfarë po ndodh, por të shikojnë vetëm përpara: **“E askush prej jush të mos shikojë prapa, por vazhdoni në drejtimin e urdhëruar!”** d.m.th. *do të drejtoheni për në tokën e Shamit, apo në ndonjë vend tjetër, ku njerëzit të jenë të pastër nga këto mëkate.*

Pastaj kursi i bisedës zhvendoset dhe All'llahu i Lartësuar thotë: **“Dhe ne ia shpallëm atij atë që do të ngjajë: që i gjithë populli i tij, deri në mbrëmje, do të zhdukej në agim.”**. Domethënë, deri në agim nuk do të mbesë asnjë i gjallë prej tyre.

Kur'ani e lë rrëfimin në këtë cak, për ta nisur edhe një herë në fillim dhe thotë: **“Banorët e qytetit erdhën tek ai gjithë gëzim”**; d.mth. ata menduan se gjetën një gjah të ëmbël të mysafirët e Lutit.

Fraza **“Banorët e qytetit”** tregon se ata që shkuan drejt shtëpisë së Lutit, ishin një grup i madh njerëzish. Kjo e sqaron qartë atë vepër të shëmtuar, guximin dhe paturpësinë e tyre, sidomos kur thuhet më pas shprehja **“erdhën tek ai gjithë gëzim”**, e cila tregon se sa thellë ishin zhytur në atë papastërti të ulët. Shembulli i kësaj veprë kaq të ulët nuk mund të vërehet as të kafshët, e nëse njeriu sprovohet, ai do të përpiqet që ta fshehë atë veprim, pasi kush e bën këtë vepër të shëmtuar, çon në përçmimin dhe urrejtjen nga të tjerët. Ndërsa populli i Lutit ishin të gëzuar që gjetën një pre të re, e secili përgëzonte tjetrin për pjesën që do t'i takonte.

Kur Luti dëgjoi zërat e tyre, që po pëshpëritnin për shkak të mysafirëve të tij, ai u hidhërua shumë për miqtë e tij, se deri në atë kohë nuk e dinte se ata ishin melekët e ndëshkimit. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Luti u tha: ‘Këta janë mysafirët e mi, andaj mos më turpëroni!’”**.

Domethënë, nëse ju nuk e besoni All'llahun e Lartësuar, nuk më njihni mua si të dërguar dhe nuk besoni as në shpërblim dhe as në ndëshkim, atëherë ruani të drejtën e mikpritjes dhe respektojeni atë, e cila është një traditë e njohur të çdo shoqëri njerëzore, qoftë besimtare, qoftë jobesimtare. Çfarë njerëzish jeni ju?

Pastaj, ai shtoi: **“Kijeni frikë All’llahun e mos më poshtëroni!”**¹ përpara mysafirëve të mi!

Ata, me gjithë këtë pafytyrësi ishin të vendosur në këtë devijim, dhe jo vetëm që nuk kishin turp, por nisën ta kundërshtonin Lutin dhe t’i kërkonin atij llogari, sikur të kishte bërë një krim të madh që i kishte pritur ata mysafirë. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ata thanë: ‘A nuk ta kemi ndaluar ne të presësh mysafirë?’”**. *Përse e theve urdhërin tonë?!*

Populli i Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte popull koprac dhe nuk kishin shumë dëshirë të prisnin mysafirë. Qyteti i tyre ishte pranë rrugës që kalonin karvanët. Veprimin e tyre të shpifur, ata e shfajësonin duke thënë se andej kalonin mysafirë e rrugëtarë dhe, që të mos qëndronte tek ata asnjë karvan, e ushtronin këtë praktikë të shëmtuar, gjë që me kalimin e kohës iu bë zakon.

Siç duket, Luti (*Paqja qoftë mbi të!*) kur dëgjonte se kanë ardhur njerëz të huaj në qytet, shpejtonte dhe i ftonte si mysafirë, sepse kishte frikë nga veprat e shpifura që kryente populli i tij. Kur populli e mësoi se ai e bënte këtë veprim, u hidhëruan ndaj tij dhe e ndaluan që të priste mysafirë në të ardhmen.

¹ Në këto ajete shohim se Luti kërkon nga populli i tij, që të mos e poshtëronin dhe të mos e ulnin kaq poshtë. Fjala *“el fedihatu”* nga ana gjuhësore do të thotë *zbulim i diçkaje dhe shfaqje e një të mete*. Luti donte t’u kumtonte se vepra e shëmtuar e tyre do ta poshtëronte atë para mysafirëve dhe ata do të shihnin kulmin e poshtërsisë së banorëve të Medjenit. Fjala *“khizjun”* ka kuptimin e largimit, distancimit dhe po ashtu edhe të turpfit (Luti donte t’u thoshte atyre: Mos më turpëroni para miqve të mi dhe mbani distancë e largohuni prej meje dhe atyre!).

Siç duket, fjala “*alemijn*” në këtë ajet është tregues për udhëtarët, të cilët nuk ishin banorë të atij qyteti.

Kur Luti i pa ata në këtë situatë përçmimi dhe paturpësie, me shpresën se do të reflektonin, u tha: nëse ju dëshironi të ngopni instinktet tuaja, përse ndiqni rrugën e gabuar të devijimit dhe nuk ndiqni rrugën e drejtë (martesën bashkëshortore)? **“Ai tha: ‘Ja vajzat e mia! Nëse doni të bëni çka synoni (martohuni me to).’”**.

Nuk ka dyshim se vajzat e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishin të pamjaftueshme për atë grup të madh njerëzish që kishin ardhur te shtëpia e Lutit, por Luti kishte për qëllim të argumentonte me ta dhe t’u thoshte se ishte i gatshëm deri në atë shkallë, saqë të flijonte vajzat e tij për shkak të mysafirëve, dhe për ta shpëtuar popullin e vet nga ai devijim.

Disa komentues të Kur’anit kanë thënë se fraza e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Ja vajzat e mia!”** nënkupton vajzat e të gjithë qytetit, ngaqë ai e konsideronte veten si baba shpirtëror për të gjithë. Megjithatë, komentimi i parë është më afër kuptimit të ajetit.

Nuk mund ta mohojmë se Luti (*Paqja qoftë mbi të!*) ka dashur që t’i martonte vajzat e tij me ata idhujtarë të humbur, por ai ka dashur edhe që t’u thoshte: *Ejani e besoni! Bëhuni besimtarë, që t’ju martoj me vajzat e mia!*

Por të mjerët ata! Dehja e pasionit, devijimi, mashtrimi dhe kokëfortësia ua kanë fshirë të gjitha vlerat e moraleve njerëzore dhe i kanë zbrazur ata nga ndjenjat njerëzore, të cilat do t’i bënin me turp përpara Lutit, ose do t’i bënin që të largoheshin nga shtëpia e tij. Por ata e refuzuan këtë gjë. Shumica nuk u ndikuan fare nga fjalët e Lutit dhe vazhduan në qëllimin e tyre.

All'Ilahu i Lartësuar i drejtohet Pejgamberit të Tij dhe i thotë:
“Betohem për jetën tënde (o Muhammed), se ata ishin vërtet të përhumbur në dehjen e tyre!”.

Në suren “Hud” lexuam se melekët e ndëshkimit e zbuluan çështjen e tyre dhe i thanë Lutit: *Mos ki frikë, se duart e tyre nuk të prekin ty!*

Në ajetin 37 të sures “El Kamer”, All'Ilahu i Lartësuar thotë:
“Ata i kërkuan t’ua dorëzonte mysafirët e tij. Por ne ua verbuam sytë.”.

Në disa transmetime thuhet se njëri prej mysafirëve mori një grusht me dhe’ e ua hodhi njerëzve në fytyrë, duke i verbuar ata.

Pas kësaj, fjala e All'Ilahut të Lartësuar ndaj këtij populli e arrin kulmin kur e qartëson përfundimin e tyre të keq në dy ajete të shkurtra e thotë: **“Ata i kaploi zëri i tmerrshëm (i Xhebrailit) kur lindi Dielli”**, d.m.th. një zë i fuqishëm në çastin e lindjes së diellit.

Mund të mendohet se *“sajhetu”* – **“zë i tmerrshëm”**, është vetëtimja dhe gjëmimi i madh, ose zëri i tërmetit të frikshëm. E rëndësishme është se ai ka qenë një zë i tmerrshëm që i ka hedhur të gjithë në tokë, në pavetëdiqe ose të vdekur.

Është e ditur se valët zanore, nëse e kalojnë kufirin e caktuar, bëhen shumë të frikshme, të tmerrshme, dhe ia fusin të dridhurat njeriut. Nëse kjo valë zanore shtohet, forca e saj e çon njeriun në paralizë, e ndoshta mund t’i shkaktojë edhe vdekjen. Gjithashtu, këto valë mund të shkaktojnë edhe shkatërrimin e ndërtesave.

E dënimi nuk mjaftoi me aq, por përfshi u të gjithë qytetin: **“dhe Ne e kthyem qytetin përmbys”**. Më tej vazhdon: **“duke lëshuar mbi ata shi gurësh prej dheut të pjekur”**.

Ndoshta zbritja e gurëve në formën e shiut ka pasur për qëllim të ndëshkonte ata që nuk kishin vdekur nga zëri i tmerrshëm dhe nuk kanë qenë nën rrënoja, e ndoshta për t'i shfarosur trupat e tyre nga sipërfaqja e tokës, derisa të mos mbeste asnjë shenjë nga ai popull mëkatar e kriminel.

Zbritja e këtij ndëshkimi pati tri faza: zëri i frikshëm, përmbysja e qytetit dhe shiu në formë gurësh, ndonëse secila prej tyre mjaftonte për ta shkatërruar atë popull. Ndëshkimi i tyre u shtua për shkak të shthurjes së tyre të madhe, guximit dhe vendosmërisë së tyre në kryerjen e asaj vepr e të shëmtuar, që ky të ishte një mësim për ata që kuptojnë.

Këtu, Kur'ani Famëllartë e përmbledh përfundimin dhe thotë: **“Këto janë njëmend shenja bindëse për ata që i kuptojnë ato.”**¹ Të zgjuarit janë ata që i kuptojnë këto ngjarje me zgjuarsi dhe mprehtësi.

Mos mendoni se shenjat e tyre janë zhdukur plotësisht! Ato janë të gjalla në rrugët ku kalojnë kalimtarët e karvanët e tregtisë. Për këtë, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Qyteti i rrënuar është në rrugë, ku gjendet edhe tani.”**

¹ “Muteuessem” rrjedh nga lënda “ueseme”, njësoj si “resemë”, dhe ka kuptimin *la shenjë, gjurmë*. Kjo fjalë përdoret edhe për atë që nxjerr prej një gjurme të vogël rezultate të vërteta dhe të mëdha (*muteuessemun*).

E nëse nuk e besoni, shkoni e shikoni shenjat e qyteteve të ndëshkuara që janë rrugës për në Sham! Shikoni, meditoni dhe kthehuni tek All'llahu e ndiqni rrugën e drejtë! Pendohuni dhe pastrojini shpirtat tuaj nga mëkatet dhe gjynahet!

Më pas, me anë të këtij ajeti, All'llahu u bën thirrje besimtarëve që të meditojnë për këtë tregim dhe të nxjerrin mësim: **“Vërtet, në të ka shenja për besimtarët.”**

Si mundet të mos e vlerësojë dhe të mos tronditet besimtari, kur e dëgjon lajmin e këtij realiteti?!

Në ajetet e sures “Hud” e kemi shpjeguar me detaje këtë tregim.

Aty kemi hulumtuar rreth kuptimit të fjalës “*sixhijl*” dhe rreth arsyes se përse mbi këtë popull të devijuar u hodhën gurë në formë shiu, përse u përmbys qyteti i tyre, përse u erdhi ndëshkimi në agim të ditës dhe përse u urdhërua Luti dhe familja e tij që të ecnin përpara dhe të mos shihnin prapa. Gjithashtu, po aty kemi diskutuar edhe çështjen e ndalimit të devijimit seksual në fetë qiellore dhe filozofinë e këtij ndalimi, duke shtuar edhe një studim për popullin e Lutit. Këtu do të bëjmë një kërkim për disa tregues që kanë lidhje me këtë rrëfim.

Hulumtime

1- Çfarë nënkuptohet me frazën “pasi të kalojë një pjesë e natës”?

Fjala “*el kit'u*” do të thotë *errësira e natës*. Tabrasij në tefsirin “Mexhmaul Bejan” thotë: “Fjala ‘*el kit'u*’ është shumësi i fjalës ‘*el kit'atu*’, e cila ka kuptimin: *ti ec me familjen tënde pasi të ketë kaluar pjesa më e madhe e natës dhe të ketë mbetur një pjesë e saj*”.

Por Ragib Asfehani në fjalorin e tij e konsideron fjalën “*el kit'u*” me kuptimin “*el kit'atu*” të numrit njëjës, që do të thotë “*një pjesë*”, edhe pse shumica e komentuesve kanë thënë se ajo ka kuptimin e pjesës së fundit të natës dhe në agim të ditës. Ndoshta komentimi i tyre iu referohet ajeteve të tjera, që e përcaktojnë këtë kohë në historinë e familjes së Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilën All'Ilahu i Lartësuar thotë: “**i shpëtua ata në agim**”.¹

Me fjalë të tjera, ata u larguan kur adhuresit e pasionit ishin zhytur në gjumin e thellë e të pakujdesshëm, të dehur nga pija, mashtrimi dhe pasionet. Në atë kohë, familja e Lutit mund të largohej e qetë.

Zbritja e ndëshkimit ka ndodhur në agimin e mëngjesit, afër lindjes së diellit. Ndoshta, përzgjedhja e kësaj kohe është bërë për t'i dhënë mundësinë popullit të Lutit për të reflektuar, e ajo natë ka qenë shansi i fundit i tyre.

Nga disa transmetime mësohet se disa njerëz nga populli i Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*), kur po ktheheshin për në shtëpitë e tyre,

¹ Surja “El Kamer”, ajeti 34.

u betuan se të nesërmen nuk do të linin asnjë nga familja e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) të gjallë. Për këtë zbriti ndëshkimi i All'llahut dhe ata u ndëshkuan të nesërmen në agim.¹

2- Kuptimi i fjalës së All'llahut të Lartësuar: “por vazhdoni në drejtimin e urdhëruar!”

Më lart përmendëm se melekët e këshilluan familjen e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*), që të largoheshin nga qyteti në fundin e natës për në vendin që ishte caktuar për ta, por ajetet kur'anore nuk japin detaje se si ishte ai udhëtim dhe nuk e përcaktojnë vendin ku shkuan. Në lidhje me këtë, komentuesit e Kur'anit kanë dhënë disa mendime.

Disa prej tyre kanë thënë se familja e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) u urdhëruan që të shkonin drejt Shamit, sepse ambienti atje ka qenë më i pastër.

Disa komentues të tjerë kanë thënë se melekët i patën caktuar familjes së Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) një fshat dhe u patën kërkuar që të shkonin atje.

Në tefsirin “El Mijzan” thuhet se familja e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) ka pasur një lloj udhëzimi nga All'llahu dhe një argument shkencor në ndjekjen e rrugës së tyre.

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 358, hadithi 167.

3- Lidhja ndërmjet frazës “që i kuptojnë ata” dhe fjalës “besimtarët”

Në përshkrimin e dy ajeteve, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“Këto janë njëmend shenja bindëse për ata, që i kuptojnë ato”** dhe **“kjo është vërtet treguese për besimtarët”**, vërejmë se në to flitet për historinë e popullit të Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*). Prej tyre kuptojmë se besimtar i vërtetë është ai që kupton, që është i zgjuar dhe që i shqyrton çështjet në mënyrë të detajuar.

Në transmetimin e ardhur nga Imam Bakiri, kur është pyetur për komentimin e fjalës së All’llahut **“Këto janë njëmend shenja bindëse për ata që i kuptojnë ato”**, ai ka thënë: “Bëhet fjalë për ymetin.” Pastaj, ai ka vazhduar: “I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kijeni frikë mprehtësinë e besimtarit, sepse në të vërtetë, ai shikon me dritën e All’llahut të Lartësuar.”¹

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Ata” janë prijësit.”²

Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “I Dërguari i All’llahut ka qenë i kuptueshëm. Pas tij, edhe unë e prijësit, pasardhësit e të kuptueshmëve.”³

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 23, hadithi 72.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 23, hadithi 83.

³ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 23, hadithi 84.

4- Dehja e pasionit dhe vetëkënaqësia

Dehja nga alkooli është e njohur dhe e ditur, por ekziston një dehje më e fortë sesa ajo, e kjo lloj dehjeje është dehja nga posti dhe nga pasioni. Në ajetet e lartpërmendura lexuam se si All'llahu i Lartësuar betohet për shpirtin e Pejgamberit të Tij dhe thotë: **“Betohem për jetën tënde (o Muhammed), se ata ishin vërtet të përhumbur në dehjen e tyre!”**; *për këtë arsye, ata nuk i shohin rrugët e qarta të shpëtimit, e kanë tejkaluar masën dhe e kanë refuzuar atë që Pejgamberi i tyre u ka ofruar, në mënyrë që t'i plotësojnë epshet e tyre në rrugë të drejtë e të lejuar dhe të largohen e të pastrohen nga mëkatet, papastërtitë e veprat e shëmtuara.*

Ajo që mësojmë nga qëndrimi i Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*), është se e keqja nuk luftohet vetëm duke e ndaluar atë, por duhen përgatitur edhe rrugë alternative, në mënyrë që i humburi apo i mashtruari të kalojë nga rruga e humbur për në rrugën e drejtë të shpëtimit. Prandaj, është e nevojshme që të mundësohen kushtet dhe mjedisi i shëndoshë për njerëzit, duke ngritur e zbatuar programe të vlefshme dhe efikase.

Në disa transmetime thuhet se Luti (ky Profet i madh) ka kaluar tridhjetë vjet duke thirrur popullin e tij për në rrugën e drejtë dhe duke u tërhequr atyre vërejtjen. E megjithatë, ata nuk besuan tek ai, përveç familjarëve të tij (me përjashtim të gruas së tij).¹

Sa e madhe që ishte qëndrueshmëria dhe vendosmëria e tij me të devijuarit! Nuk do të mundej askush të jetonte me atë popull,

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn” vëll. 3, f. 382, hadithi 165.

qoftë edhe për një orë! Sa e vështirë është të jetosh me një bashkëshorte të tillë!

Në ajetet 35-36 të sures “Edh Dharijat”, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ne i nxorrëm të gjithë besimtarët që ishin në atë qytet - ndonëse aty gjetëm vetëm një shtëpi myslimane.”**.

Nga këtu na qartësohet se ndëshkimi i All’llahut nuk vjen rastësisht, por përfshin vetëm ata që e meritojnë atë. Nëse në vendin për të cilin është caktuar ndëshkimi gjendet një besimtar i vetëm që i zbaton obligimet, atëherë All’llahu do ta shpëtojë atë.

Ajetet 78 - 84

﴿وَإِنْ كَانَ أَصْحَابُ الْأَيْكَةِ لَظَالِمِينَ ۝۷۸ فَانْتَقَمْنَا مِنْهُمْ وَإِنَّهُمَا لَبِإِمَامٍ مُّبِينٍ ۝۷۹ وَلَقَدْ كَذَّبَ أَصْحَابُ الْحِجْرِ الْمُرْسِلِينَ ۝۸۰ وَآتَيْنَاهُمْ آيَاتِنَا فَكَانُوا عَنْهَا مُعْرِضِينَ ۝۸۱ وَكَانُوا يَنْحِتُونَ مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا آمِنِينَ ۝۸۲ فَأَخَذْنَاهُمُ الصَّيْحَةَ مُصْبِحِينَ ۝۸۳ فَمَا أَغْنَىٰ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ۝۸۴﴾

“Por edhe banorët e Ejkes ishin keqbërës.”

“Prandaj i ndëshkuam dhe që të dy janë në rrugë të dukshme.”

“Edhe banorët e Hixhrës (fisi Themud), i quajtën të Dërguarit për gënjeshtarë.”

“Ne u patëm dhënë shenjat Tona, por ata shmangeshin prej tyre.”

“Ata gdhendnin shtëpi në shkëmbinj, duke besuar se nuk do t’i gjente asgjë.”

“Por edhe ata në agim i goditi zëri i tmerrshëm.”

“Dhe nuk patën aspak dobi nga ajo që patën ndërtuar.”

Komentimi

Përfundimi i banorëve të Ejkes dhe i banorëve të Hixhrës

Në këto ajete, Kur'ani Famëllartë flet për historitë e dy popujve të mëparshëm, që janë banorët e Ejkes dhe banorët e Hixhrës, duke plotësuar kështu diskutimin e ajeteve të mëparshme, ku flitej për popullin e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në fillim, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Por edhe banorët e Ejkes ishin keqbërës.”**¹

Pastaj, All'llahu i Lartësuar thotë: **“andaj i ndëshkuam”**; i ndëshkuam ata për padrejtësinë dhe tiraninë e tyre. Tokën e tyre dhe tokën e popullit të Lutit e kemi vënë në rrugën tuaj: **“dhe të dy janë në rrugë të dukshme”**. Shikoni se si ka qenë përfundimi i tyre! Meditoni e merrni këshillë, o ju të zgjuar që kuptoni!

Cilët ishin banorët e Ejkes?

Një grup komentuesish kanë thënë se “*ejketu*” janë pemët e ndërthurura me njëra-tjetrën, ndërsa “banorët e Ejkes” janë populli i Shuajbit (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilët kanë jetuar në një vend të begatë të mbushur me lumenj, ujë të bollshëm dhe pemë të shumta, ndërmjet Hixhazit dhe Shamit. Jeta e tyre ka qenë e pasur dhe me

¹ Fjala “in” në këtë ajet nuk është e formës kushtore, por është e formës lehtësuese. Kështu, thënia merr trajtën: “Me të vërtetë, banorët e Ejkes ishin keqbërës!”

rehati, por u goditën me vetëkënaqësi dhe pakujdesi, dhe e gjitha kjo i çoi në përcmim dhe shkatërrim në tokë.

Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) i ftoi ata në monoteizëm dhe ndoqi rrugën e vërtetë, duke ua tërhequr vërejtjen herë pas here për ndëshkimin e rëndë të veprave të tyre të këqija nëse ata do t'i vazhdonin ato.

Nga ajetet e sures "Hud" mësohet se ata nuk e përqaftuan rrugën e vërtetë dhe nuk i dëgjuan thirrësit e tyre, derisa i kaploi ndëshkimi i rëndë.

Pasi Shuajbi (*Paqja qoftë mbi të!*) i humbi pritshmëritë për ndryshimin e tyre, ata i goditi një vapë e ashpër për disa ditë me radhë dhe në ditën e fundit u shfaq një re në qiellin e hapur, nën hijen e së cilës ata u tubuan për të festuar. Në atë gjendje, një rrufe shkatërruese i goditi dhe i shkatërroi të gjithë.

Përdorimi i emërimit "**banorët e Ejkes**" në Kur'an mund të jetë një tregues për mirësitë që All'llahu i Lartësuar ua pati dhënë atyre, por ata e këmbyen falënderimin me mohim, ngritën padrejtësinë dhe tiraninë haptazi, kështu që e merituan zemërimin e All'llahut të Lartësuar, i Cili i shkatërroi me rrufe ata dhe kopshtet e tyre të begata.

Historia e banorëve të Ejkes jepet me detaje nga ajeti 176 deri në ajetin 190 të sures "Esh Shuara".

Ka mundësi që shprehja "**andaj i ndëshkuam**", mund të përfshijë popullin e Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe banorët e Ejkes së bashku, me argumentin që vjen menjëherë më pas, ku All'llahu i Lartësuar thotë: "**dhe që të dy janë në rrugë të dukshme**".

Komentuesit e Kur'anit thonë se ky ajet flet për qytetin e popullit të Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për qytetin e banorëve të Ejkes.

Fjala "*Imam*" ka kuptimin e rrugës dhe të drejtimit, sepse rrjedh nga lënda "*umme*", që do të thotë *qëllim*. Kjo për shkak se kur njeriu ecën në një rrugë, ai ecën për të arritur qëllimin e caktuar ose për të shkuar në një vend të caktuar.

Disa komentues kanë thënë se fjala "*Imamul mubijn*" është "*leuhul mahfudhi* (pllaka e ruajtur mirë)", duke marrë si argument ajetin 12 të sures "*Jasin*".

Në të vërtetë, ky mendim është i papranueshëm, sepse këtu Kur'ani Famëlartë jep një mësim për ata që duan të marrin mësim. Ekzistenca e emrit të këtyre dy qyteteve të shkruar në *Leuhul Mahfudh* nuk do të kishte ndikim te njerëzit, ndërsa ekzistenca e këtyre dy qyteteve në rrugën ku kalonin karvanet, mund të kishte një ndikim të madh tek ata.

Qëndrimi i njerëzve afër këtyre gjurmëve, kujtimi i lajmit të banorëve të tyre dhe i ndëshkimit të dhembshëm që u ka ndodhur atyre, do të ndikojë në shpirtrat e udhëtarëve, një herë në tokën e popullit të Lutit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe një herë tjetër në tokën e banorëve të Ejkes. E ato momente bëhen momente reflektimi, pasi të mësojnë apo të kujtojnë se çfarë shkatërrimi u ka ndodhur këtyre dy popujve, për shkak të veprave të shëmtuara që kanë bërë.

Banorët e Hixhrës ishin një popull mëkatar, që patën jetuar në dëfrim, në vendin e quajtur "*hixhr*". Atyre, All'Ilahu u dërgoi Pejgamberin e Tij, Salihun (*Paqja qoftë mbi të!*), që t'i udhëzonte.

Kur'ani thotë: **“Edhe banorët e Hixhrës (fisi Themud) i quajtën të Dërguarit, gënjeshtarë.”**.

Por ku ndodhet vendi ku jetuan banorët e Hixhrës?

Disa komentues të Kur'anit dhe historianë kanë thënë se ky vend ndodhet në rrugën e karvanëve ndërmjet Medinës dhe Shamit, në vendin e quajtur *Uadil Kura*, në jug të Tejmas, ku sot nuk ka pothuajse asnjë gjurmë.

Thuhet se ai ka qenë një nga qytetet tregtare në Gadishullin Arabik dhe ka pasur një rëndësi të madhe. Ptolemeu e ka përmendur këtë qytet në kujtimet e tij.

Në disa transmetime mësojmë se i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur ka udhëhequr ushtrinë kundër ushtrisë romake, në vitin e nëntë të hixhretit, ata deshën të ndalonin në këtë vend, por ai ua ndaloi dhe u tha: *“Këtu ka zbritur ndëshkimi i All'llahut të Lartësuar mbi popullin e Themudit.”*¹

Vlen të përmendet se Kur'ani Famëlartë e ka cekur çështjen e përgënjeshtimit të Pejgamberëve kur ka lajmëruar për banorët e Hixhrës (dhe po kështu për popullin e Nuhut, të Shuajbit dhe të Lutit (*Paqja qoftë mbi ta!*) në ajetet 105, 123 dhe 160 të sures “Esh Shuara”). Ajo që vihet re nga këto ajete, është se çdo popull ka pasur një Profet të vetëm, e jo më shumë.

E ndoshta, shprehja *“murseline”* – **“të Dërguar”**, në këtë ajet mund të jetë në kuptimin që Pejgamberët kanë pasur një program

¹ “A'lamul Kur'an”, i El Khazailij”, f. 292.

dhe një qëllim të vetëm. Mes tyre ka një lidhje të atillë, saqë përgënjeshtrimi i ndonjërit, është përgënjeshttrim për të gjithë ata.

Disa komentues kanë supozuar praninë e më shumë se një Pejgamberi në mesin e një ymeti dhe kanë përmendur emrin e njërit prej tyre, për shkak se ka qenë më i njohuri.

Siç duket, komentimi i parë është më i pranueshëm dhe më i saktë sesa i dyti.

Kur’ani vazhdon me rrëfimin për banorët e Hixhrës dhe thotë: **“Ne u patëm dhënë shenjat Tona, por ata shmangeshin prej tyre.”**. Shmangia që përmendet këtu ka mundësi të ketë kuptimin që ata ishin të papërgatitur për të dëgjuar ajetet dhe argumentet e për të menduar rreth tyre.

Ajeti tregon se ata kanë qenë të zellshëm dhe të saktë në çështjet e jetës së tyre: **“Ata gdhendnin shtëpi në shkëmbinj, duke besuar se nuk do t’i gjente asgjë.”**.

Gjithashtu, ajeti na tregon se zona e tyre ka qenë një zonë malore dhe ata ishin aq të zhvilluar, saqë i ndërtonin shtëpitë e tyre brenda në shkëmbinj, në mënyrë që të ishin të sigurtë nga përmbytjet, tufanet dhe tërmetet.

E habitshme puna e njeriut! Ai përgatitet për të ruajtur gjërat më të domosdoshme në jetën e tij, e cila është e sosur, dhe nuk përqendrohet për të menduar ose për t’i dhënë një rëndësi të madhe Botës Tjetër, derisa arrin në atë përfundim, që nuk e vë veten para përgjegjësisë në dëgjimin e argumenteve të All’llahut e në të menduarit mbi to!

Çfarë përfundimi mund t'i presë ata pas kundërshtimit dhe mohimit të tyre, përveçse të zbatohet mbi ta ligji i All'llahut, i cili u është premtuar?! Për këta, nuk ka gjë tjetër pos fatkeqësisë shkatërruese: **“por edhe ata në agim i goditi zëri i tmerrshëm.”**.

Zëri (*sajhatu*) ishte një zhurmë e tmerrshme e rrufesë shkatërruese, që ra mbi shtëpitë e tyre. Ajo ishte një zhurmë aq e fortë dhe e frikshme, saqë trupat e tyre i bëri të shpërndareshin nëpër tokë.

Argument për këtë që treguam, është ajeti 13 i kësaj sureje, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nëse ata shmangen, ti thuaju: ‘Ju paralajmëroj me rrufenë që goditi fiset Ad dhe Themud.’”**.

Ndëshkimin i All'llahut nuk mund ta ndalojnë as malet e mëdha dhe as shtëpitë e gdhendura, as trupat e fortë dhe as pasuria e madhe. E për këtë, në fund të këtij rrëfimi, All'llahu i Lartësuar thotë: **“dhe nuk patën aspak dobi nga ajo që patën ndërtuar”**.

Ajetet 141-158 të sures “Esh Shuara” përmbajnë shpjegime më të detajuara në lidhje me çështjen në fjalë.

Ajetet 85 - 91

﴿وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَإِنَّ السَّاعَةَ لَآتِيَةٌ فَاصْغِ الصَّفْحَ الْجَمِيلَ^{٨٥} إِنَّ رَبَّكَ هُوَ الْخَلَّاقُ الْعَلِيمُ^{٨٦} وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ سَبْعًا مِنَ الْمَثَانِي وَالْقُرْآنَ الْعَظِيمَ^{٨٧} لَا تَمَدَّنْ عَيْنَيْكَ إِلَى مَا مَتَّعْنَا بِهِ أَزْوَاجًا مِنْهُمْ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ وَخَفِضْ جَنَاحَكَ لِلْمُؤْمِنِينَ^{٨٨} وَقُلْ إِنِّي أَنَا النَّذِيرُ الْمُبِينُ^{٨٩} كَمَا أَنْزَلْنَا عَلَى الْمُقْتَسِمِينَ^{٩٠} الَّذِينَ جَعَلُوا الْقُرْآنَ عِضِينَ^{٩١}﴾

“Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe gjithçka që gjendet midis tyre vetëm me urtësi. Ora (e Kiametit) do të vijë me siguri, prandaj ti (o Muhammed) sillu me zemërgjerësi.”

“Vërtet, Zoti yt është Krijuesi Madhështor, i Gjithëdijshmi.”

“Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten dhe Kur'anin e madhërishtëm.”

“Mos i drejto sytë e tu nga kënaqësitë që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre dhe mos u hidhëro për ata! Me besimtarët, sillu butë!”

“Thuaj: ‘Në të vërtetë, unë jam vetëm paralajmërues i qartë.’”

“Siç është e vërtetë se u dërguam dënim atyre që e ndanë.”

“Dhe e bënë Kur'anin në pjesë (duke i besuar ca pjesë dhe duke i mohuar të tjerat).”

Komentimi

Pasi Kur'ani rrëfen për popujt e mëparshëm - si popullin e Lutit, Shuajbit dhe popullin e Salihut (*Paqja qoftë mbi ta!*), çështja kthehet edhe një herë te *Teuhidi* dhe te *bota e Ringjalljes*, sepse shkaku i humbjes së rrugës së vërtetë të njeriut është mospërqaftimi i doktrinë të drejtë e të vërtetë dhe mungesa e lidhjes me çështjen e fillimit (Krijimit) dhe të fundit (Ringjalljes). Në një ajet të vetëm, All'llahu i Lartësuar na tregon për këto të dyja e thotë: **“Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe gjithçka që gjendet midis tyre vetëm me urtësi.”**. Sistemi i universit është i mirëllogaritur dhe i mirëorganizuar. I tillë është edhe qëllimi i krijimit të gjithçkaje.

Ky sistem i përkryer është një argument i qartë që tregon se kjo gjithësi është krijuar nga Krijuesi, i Gjithëdijshmi dhe i Plotfuqishmi. Ai është i Vërtetë gjithashtu. Çdo gjë që është e lidhur me ekzistencën e Tij absolute, është e vërtetë, dhe çdo gjë që nuk ka lidhje me Të, është e pavërtetë, e kotë. Kjo është ajo që e specifikon *Teuhidin*. Kurse për Ringjalljen, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ora (e Kiametit) do të vijë me siguri”**; edhe nëse vonohet, pa dyshim që ai moment do të vijë.

Fragmenti i parë ka mundësi të jetë tregues dhe argumentues i fragmentit të dytë, sepse kjo botë është e vërtetë. Ditët e kësaj bote të mbushura me dhimbje e lodhje kanë një qëllim të lartë, i cili e arsyeton krijimin e kësaj ekzistence të madhe. Krijimi i qiejve, i tokës dhe çfarë ka mes tyre argumenton ekzistencën e Ditës së Kiametit dhe të Llogarisë, pasi përndryshe ato do të ishin krijuar më kot, do të ishin një lojë apo një tallje, dhe jo të vërteta. Andaj mediton!

Pas kësaj, All'Ilahu i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin e Tij (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që kokëfortësinë e popullit të tij, injorancën, fanatizmin dhe armiqësinë e tyre, t'i përballojë me dashuri e falje: **"prandaj ti (o Muhammed) sillu me zemërgjerësi!"**. Ti ke në dorë argumentin e qartë dhe nuk ke nevojë për ashpërsinë e tyre për të vërtetuar besimin e Zanafillës dhe të Ringjalljes në zemrat e njerëzve, pasi ke mendje dhe logjikë të shëndoshë. Veç kësaj, ashpërsia e ndërthurur me injorancën çojnë në një kundërpërgjigje të njëjtë, madje edhe më të ashpër se aq.

Fjala *"safh"* është fytyra e çdo gjëje, si: peisazhi i një panorame.¹ Fraza *"fe esfah"* ka kuptimin *"ktheje fytyrën tënde dhe largoje shikimin prej tyre"*.

Kthimi i fytyrës dhe distancimi nga diçka mund të tregojë mungesë interesi dhe shfaqje antipatie. Po kështu, mund të ketë edhe kuptimin e faljes dhe të tolerancës, pasi ajeti i larpërmendur ka përmendur fjalën *"xhemijlun"* pas fjalës *"safhun"*.

¹ Fijruz Abadi thotë në librin e tij *"El Kamus"*, vëll. 1, f. 242, se *"esafhu"* është ana, krahu nga mali, është shtrirja e tij poshtë; *"prej teje"* është ana jote.

Imam Ali ibn Musa Rida (*Paqja qoftë mbi të!*), në komentimin e këtij ajeti thotë: “*Bëhet fjalë për faljen dhe zemërgjerësinë pa fyerje.*”.¹

Në mënyrë të ngjashme është transmetuar edhe nga Imam Zejn Abidin.²

Ajeti në vazhdim - siç tregojnë shumica e komentuesve - ka gradën e argumentit për domosdoshmërinë e faljes dhe të zemërgjerësisë. Në lidhje me këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Zoti yt është Krijuesi Madhështor, i Gjithëdijshmi.”**.

All'llahu i Lartësuar e di më së miri se njerëzit nuk janë të njëjtë dhe të barabartë në natyrën e tyre, apo në nivelet mendore dhe shpirtërore. Ai është i Gjithëdijshëm për atë çfarë fshehin njerëzit në zemrat e tyre dhe ata duhet të trajtohen me falje dhe tolerancë, në mënyrë që të drejtohen në rrugën e drejtë gradualisht.

Disa mendojnë se urdhri i All'llahut ka qenë specifik vetëm për kohën e e Pejgamberit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur ai ka qenë në Mekë, përpara hixhretit, e se kur emigroi në Medine dhe myslimanët u fuqizuan, ai e abrogoi këtë urdhër dhe në vend të tij erdhi xhahadi.

Por ky urdhër i All'llahut ka ardhur gjithashtu edhe në suret e Medines (si në suret: “El Bekare”, “En Nur”, “Et Tegabun” dhe “El Maide”), disa prej të cilave e urdhërojnë Pejgamberin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për falje e zemërgjerësi, e disa të tjera i urdhërojnë edhe besimtarët për këtë gjë.

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 27, hadithi 95.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 27, hadithi 96.

Kjo na tregon se urdhërimi për falje është rregull i përgjithshëm dhe i përhershëm dhe ai nuk bie kurrë në kundërshtim me urdhrin për xhihad, pasi secili ka vendin e tij të veçantë.

Nëse situata e kërkon që të ketë falje dhe tolerancë, atëherë përse të mos zbatohet kjo gjë?! E nëse ka shfaqje të guximit dhe pafytyrësisë nga ana e armiqve dhe kundër tyre nuk bën dobi asgjë tjetër veç forcës, atëherë është i pashmangshëm xhihadi.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar e ngushëllon Pejgamberin e Tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë që të mos shqetësohet për ashpërsinë e armiqve të tij, edhe pse ata janë të shumtë në numër dhe kanë një potencial të madh material, sepse Ai i ka dhuruar atij një argument të fortë, të cilit nuk mund t'i dalë gjë përpara: **“Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten dhe Kur'anin e Madhërishëm.”**.

Siç dihet, fjala “*seb'atu*” është numri shtatë dhe fjala “*methanij*” është numri dy, prandaj shumica e komentuesve e kanë konsideruar fjalën **“shtatë vargje që përsëriten”** si një metaforë për suren “El Fatiha”; gjithashtu, edhe transmetimet e ardhura tregojnë për këtë kuptim.

Argument për këtë është fakti që kjo sure është e përbërë nga shtatë ajete. Prej rëndësisë dhe madhësisë që ka në përmbajtjen e saj, ajo është shpallur dy herë mbi Pejgamberin Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ose ndoshta për shkak se ajo përbëhet prej dy pjesëve (gjysma e saj është falënderim dhe lëvdatë ndaj All'llahut të Lartësuar, kurse pjesa e

dytë është lutje adhurimi)¹, ose për shkak se ajo përsëritet në çdo rekat të namazit.²

Disa komentues mendojnë se fjala “*seb'atu*” – “*shtatë*”, tregon për shtatë suret e gjata me të cilat ka filluar Kur'anin, kurse fjala “*methanij*” është metaforë për vetë Kur'anin.

Duke u bazuar në këtë mendim, fraza “**shtatë vargje që përsëriten**” nënkupton shtatë suret e rëndësishme të Kur'anit.

Këta komentues përdorin ai argument ajetin 23 të sures “Ez Zumer”, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: “**All'Ilahu ka shpallur fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten.**”.

Mirëpo, komentimi i parë duket se është më i saktë, kjo edhe për shkak se edhe transmetimet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) tregojnë se me frazën “*seb'atul methanij*” nënkuptohet surja “El Fatiha”.

Ragibi në fjalorin e tij thotë se fjala “*el methanij*” është përdorur për Kur'anin Famëlartë, sepse leximi i ajeteve të tij përsëritet. Kjo përsëritje e ruan atë nga devijimi apo nga ndryshimi. Përveç kësaj duhet thënë se argumentet e Kur'anit dhe të vërtetat e tij zbulohen ditë pas dite në një formë të re, për këtë ai duhet të përshkruhet me fjalën “*methanij*”.

¹ Në një hadith, i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të!*) thotë: “All'Ilahu i Lartësuar thotë: ‘E kam ndarë namazin mes Meje dhe robit Tim në dy pjesë: gjysma është për Mua dhe gjysma është për robin Tim’.” Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 1, f. 17.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 28-29.

Sido që të jetë, përmendja e fjalës **“Kur’anin e Madhërishëm”** pas citimit të sures “El Fatiha”, është një argument tjetër për madhështinë dhe rëndësinë që ka kjo sure e bekuar.

All’llahu i Lartësuar ia bën të qartë të Dërguarit të Tij, se ai ka një mbështetje dhe një argument të fortë (Kur’anin) dhe nuk ka asnjë forcë në botën e ekzistencës që ta luftojë atë.

Ajo është një mbështetje, e gjitha prej drite, plot mirësi, mësimë edukative e morale, një sistem jetese, një udhëzim e direktivë. Edhe vetë sureja “Fatiha” është pjesë e atij Libri. Ajo ka një përmbajtje dhe ndikim të atillë, saqë nëse robi lidhet me Zotin e tij qoftë edhe për një çast të vetëm, shpirti i tij do të rrethohej nga prania e shenjtërisë së Zotit, duke përjetuar gjendjen e respektit, paqes, shpëtimit dhe lutjes.

Pas kësaj dhurate kaq të madhe, All’llahu i Lartësuar e urdhëron Pejgamberin e Tij, Muhammedin (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për katër gjëra. Së pari i thotë: **“Mos i drejto sytë e tu nga kënaqësitë, që ne ua kemi dhënë disave prej tyre.”**

Kënaqësitë e kësaj bote nuk janë të përhershme dhe nuk janë të zhveshura nga lodhja. Ruajtja e tyre është diçka e vështirë. Prandaj, nuk duhet t’u japësh rëndësi atyre, përballë asaj çfarë të ka dhuruar All’llahu i Lartësuar: dhuratën e madhe dhe të vyer shpirtërore (që është Kur’ani).

Pastaj, All’llahu jep urdhrin e dytë: **“dhe mos u hidhëro për ata!”**; mos u hidhëro për ata, edhe pse kanë pasuri të mjaftueshme dhe të mira materiale.

Pra, urdhri i parë thekson faktin se nuk u duhet dhënë rëndësi dhe nuk duhet të orientohemi drejt të mirave materiale, ndërsa i dyti thekson se nuk duhet të ndikohemi nga humbja e tyre.

Një shembull i ngjashëm me këtë ka ardhur në ajetin 131 të sures “Ta Ha”, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre, si stoli të jetës së kësaj bote, për t’i vënë ata në provë! Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i qëndrueshëm.”**.

Urdhri i tretë ka ardhur në lidhje me domosdoshmërinë e të qenit i butë dhe modest me besimtarët: **“Me besimtarët, sillu butë!”**.

Kjo shprehje është një metaforë e bukur për modestinë, mirësjelljen, zemërgjerësinë dhe bujarinë, pasi edhe shpendët, kur duan të tregojnë e të shfaqin butësinë për zogjtë e tyre, i ngrohin, i hapin krahët e tyre dhe i marrin nën to. Kjo është forma më e lartë e dhembshurisë dhe e butësisë ndaj më të vegjëlve, e cila i mbron ata nga aksidentet dhe armiqtë dhe i ruan nga përçarja dhe copëtimi mes tyre.

Pas rrëfimit të këtyre tri urdhëresave të mësipërme, përmendja e kësaj fjalie mund të jetë një paralajmërim për mosshfaqjen e modestisë dhe mposhtjes para jobesimtarëve që janë të zhytur në kënaqësitë e kësaj bote dhe për domosdoshmërinë e shfaqjes së modestisë, dashurisë, zemërgjerësisë dhe butësisë ndaj atyre që kanë besuar, edhe pse ai mund të jetë i privuar nga pasuria e kësaj bote.

Në urdhrin e katërt thuhet: **“Thuaj: (o Muhammed) këtyre jobesimtarëve të mbuluar me mirësi e me siguri të plotë ‘Në të vërtetë, unë jam vetëm paralajmërues i qartë’.”**

Unë jua tërheq vërejtjen se do të zbresë mbi ju ndëshkimi i All’llahut të Lartësuar: “Siç është e vërtetë se u dërguam dënim atyre që e ndanë dhe e bënë Kur’anin në pjesë (duke i besuar ca pjesë dhe duke i mohuar të tjerat)”,¹ domethënë, ata që i kanë ndarë ajetet e Kur’anit në grupe e lloje të ndryshme. Ajetet prej të cilave kanë pasur dobi, ata i kanë marrë, e ato që nuk kanë qenë në përputhje me dëshirat e tyre, i kanë refuzuar.

Në vend që ta merrnin librin e All’llahut si udhëzim dhe si udhëheqës për ta, ata e përdorën si një vegël në duart e tyre dhe si një mjet për të arritur qëllimet e tyre djallëzore. Nëse gjenin një fjalë të vetme që është në dobi të tyre, ata e merrnin e kapeshin pas saj; në të kundërt, nëse gjenin një mijë fjalë që nuk u shkonin përshtat qëllimeve të tyre, ata e refuzonin Librin të tërën.

¹ Fjala “iddijn” është shumësi i “iddetun” që do të thotë ndarje në pjesë, i ndarë në pjesë.

Hulumtime

1- Kur'ani është një dhuratë e madhe e All'llahut

Në ajetet kur'anore të përmendura, All'llahu i Lartësuar e lajmëron Pejgamberin e Tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se në Kur'an ka dhunti që nuk mund të krahasohen dhe as të numërohen. *Kur'ani është kapitali më i madh i juaji, që ju të veproni me të në këtë botë. Nëse punoni me të, do ta bëni jetën tuaj të lumtur, të kënaqshme, të sigurtë dhe të paqëtë.*

Këtë të vërtetë e pohojnë dhe e pranojnë edhe jomyslimanët. Këta të fundit mendojnë se nëse myslimanët e marrin Kur'anin si themel dhe si bazë të jetës së tyre, nëse punojnë me rregullat dhe ligjet e tij dhe udhëzohen me të, atëherë ata do të kenë forcë dhe zhvillim.

Surja "El Fatiha" ka shtatë ajete që përsëriten. Ajo quhet *Vula e Librit* – "*khatimetul kitab*". E vetme, ajo përfaqëson një shkollë të plotë të jetës.

E para, ajo na tregon për Krijuesin e ekzistencës, i Cili kujdeset për të gjithë banorët e botës. Mëshira e këtij Krijuesi ka përfshirë çdo gjë. Pastaj, kjo sure tregon për gjykatën e drejtësisë së All'llahut, besimi i të cilës garanton kontrollin e imtësishëm për të gjitha sjelljet e njeriut dhe qëllimet e tij.

Pastaj surja i referohet faktit se nuk duhet mbështetur tek dikush tjetër pos All'llahut, me qëllim që të përgatitet terreni i përshtatshëm dhe i shëndoshë për të ecur në rrugën e Tij të drejtë, e cila nuk ka devijim, mangësi, as neglizhencë apo ekzagjerim.

Kjo sure është përmbledhje e të gjitha çështjeve. Nëse njeriu e ndërton qenien e tij bazuar në të, atëherë kjo sure do t'i formonte atij një personalitet me vlera të larta e të plota.

Për fat të keq, kjo dhunti hyjnore ka rënë në duart e njerëzve që nuk e njohin madhësitë dhe vlerën e saj dhe as nuk janë zhytur në thellësinë e përmbajtjes dhe kuptimit të saj. Ata janë aq injorantë dhe kanë arritur deri aty, sa i kanë braktisur ato ajete hyjnore, shpëtimtare prej qorrsoakut, humbjes dhe injorancës dhe kanë vrapuar me një frymë pas atij që e kanë mbërthyer dhe që e drejtojnë pasionet, si dhe atij që nuk ka arritur as në pragun e pjekurisë mendore, duke marrë prej tyre ligjet dhe programet edukuese, të shpikura nga injoranca e tyre e të mveshura me rrobat e diturisë e të përparimit. Këta të mjerë e shesin gjënë më të shtrenjtë me një çmim të lirë, duke u larguar kështu nga ndërtimi i Botës Tjetër.

Kjo nuk do të thotë se ne duhet të jemi kundër zhvillimit teknologjik, por nuk duhet ta kufizojmë të gjithë mundin dhe shqetësimin tonë në këtë aspekt të jetës njerëzore. Në Kur'an ne gjejmë burime të pashtershme e plot kuptime si dhe programe jetësore.

2- Lakmia është burimi i degradimit

Ka shumë njerëz që e kanë vizionin e ngushtë dhe janë të mbushur me lakmi e babëzi.

Në mënyrë të vazhdueshme, ata e krahasojnë gjendjen e tyre me atë të të tjerëve. Ata brengosen thellë nëse u mungon ndonjë gjë

dhe janë të gatshëm që ta kenë atë me çdo lloj çmimi, madje duke shitur edhe ndershmërinë e tyre.

Kjo mendësi zhvillohet në një mjedis të prapambetur dhe i zbulon ndjenjat me nyjën e përçmimit dhe me humbjen, apo me mungesën e interesimit. Ky është një ndër faktorët kryesorë të prapambetjes së njeriut në jetën e tij.

Njeriu i pavarur nuk vepron me këtë mendësi, por e përdor forcën e tij të menduarit si dhe forcën fizike për ta përsosur vetveten. Ai që ka personalitet të pavarur nuk e lidh synimin e jetës së tij vetëm me gjërat e thjeshta materiale, por i kërkon ato për të plotësuar e për të ruajtur autonominë e lirinë e tij dhe për të mos qenë i varur ndaj të tjerëve.

Në një hadith thuhet: *“Ai që e hedh shikimin e tij për të parë se çfarë kanë të tjerët, përfundon duke iu shtuar shqetësimi dhe nuk e shuan dot zemërimin e tij.”*¹

3- Modestia e udhëheqësit

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është porositur disa herë në Kur'an, që të sillet mirë me besimtarët, të jetë modest, i thjeshtë, i dashur, zemërgjerë, tolerant dhe i mëshirshëm. Këshillat dhe porositë në lidhje me këto cilësi nuk janë specifike vetëm për Pejgamberin, por

¹ Tefsiri “Es Safij”, vëll. 3, f. 121.

shërbejnë për çdo udhëheqës apo drejtues, sido që të jetë niveli i drejtimit të tij: i përgjithshëm apo i kufizuar.

Dashuria dhe lidhja e fortë e individëve me udhëheqësin e tyre është një prej parimeve efektive të suksesit të udhëheqësit. Kjo nuk mund të realizohet pa modestinë dhe dashamirësinë e tij ndaj njerëzve.

Ndërsa ashpërsia, zymtësia e fytyrës dhe jotoleranca e udhëheqësit e bëjnë atë që të shkëpusë lidhjet me individët, gjë që çon edhe në përçarje e ndasi.

Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në letrën e dërguar Muhammed ibn Ebu Bekër, i ka thënë: *“Tregohu ndaj tyre i njerëzishëm, i butë dhe fytyrëqeshur! Sillu me ta me drejtësi, në mënyrë që fisnikët të mos presin padrejtësi në favor të tyre, e as të dobët të mos e humbasin shpresën në drejtësinë tënde ndaj tyre.”*¹

4- Cilët janë ata që bënë ndarjen (e librave të mëparshëm)?

Nuk ka dyshim se udhëzimet e All’llahut i ruajnë interesat e përgjithshme dhe dobitë individuale, por disa prej tyre mund të harmonizohen me interesat tona personale e disa të tjera mund të jenë në kundërshtim me to. Nëpërmjet pranimi apo refuzimit të asaj, në të cilën na bën thirrje All’llahu i Lartësuar, dallohet besimtari i sigurt nga ai që vetëm sa e pretendon besimin. Ai që pranon çdo gjë që ka zbritur nga All’llahu i Lartësuar dhe i dorëzohet Atij, edhe nëse ajo nuk i shkon përshtat me interesat, e

¹ “Nehxhul Belaga”, fjala 27.

thotë **“çdo gjë është prej Zotit tonë”**¹ dhe nuk guxon të bëjë dallimin në ligjet e All'llahut, ai është besimtar i vërtetë.

Nga ana tjetër, ka nga ata që u rëndohet sëmundja në zemrat e tyre dhe përpiqen të përçmojnë fenë e All'llahut dhe të tallen me rregullat e Tij, për t'u shërbyer kështu interesave të tyre personale. Ata i pranojnë ato ajete që mbështesin interesat e tyre dhe i braktisin të tjerat, i ndajnë në pjesë ajetet kur'anore, madje ndonjëherë e copëtojnë edhe një ajet të vetëm. Atë që përputhet me interesat e tyre e marrin, ndërsa pjesën e mbetur të ajetit, e braktisin. Është vepra më e shëmtuar, që ne të përsërisim atë që kanë thënë popujt e mëparshëm: **“Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë.”**²

Dallimi i ndjekësve të së vërtetës nga ndjekësit e së kotës bëhet nëpërmjet dorëzimit ndaj urdhërësive dhe udhëzimeve të All'llahut, të cilat nuk përshtaten me devijimet, pasionet dhe interesat e kësaj bote. Nga këtu dallohet i sinqerti nga gënjeshtari dhe besimtari nga hipokriti.

Është e vlefshme të tregojmë se ka edhe komentime të tjera për ata që bënë ndarjen (përveç këtyre që treguam). Imam Kutubij në tefsirin e tij ka përmendur shtatë mendime për kuptimin e kësaj fjale, por shumica e tyre nuk kanë argument.

Njëri nga mendimet lidhet me ngjarjen kur një grup drejtuesish të idhujtarëve në ditët e Haxhit po qëndronin në rrugët kryesore dhe në çdo cep të Mekës. Secili nisi ta përçmonte dhe ta tallte të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin*

¹ Sure “Ali Imran”, ajeti 7.

² Sure “En Nisa”, ajeti 15.

mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Kur'anin, në mënyrë që njerëzit të largoheshin prej tij.

Disa thanë: “Ai është i çmendur (*mexhnunun*), sepse ajo që thotë nuk është e kuptueshme.”.

Disa të tjerë thanë: “Ai është magjistar (*sâhir*) dhe Kur'ani i tij është një lloj magjie.”.

Disa thanë: “Ai është poet (*shâirun*) dhe ajetet janë poezi.”.

Disa të tjerë thanë: “Ai është fallxhor (*kâhin*), sepse lajmet e fshehta të Kur'anit janë një lloj falli.”.

Këta lloj njerëzish u quajtën “të ndarë”, sepse i ndanë rrugët dhe rrugicat e Mekës si dhe vendkalimet e saj sipas një plani të detajuar dhe të llogaritur mirë.

Ky komentim dhe ajo çfarë përmendëm më lart mund të përfshihen në kuptimin e përgjithshëm të ajetit në fjalë.

Ajetet 92 - 99

﴿فَوَرَبِّكَ لَنَسَأَلَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ٩٢ عَمَّا كَانُوا يَعْمَلُونَ ٩٣ فَاصْدَعْ بِمَا تُؤْمَرُ
وَأَعْرِضْ عَنِ الْمُشْرِكِينَ ٩٤ إِنَّا كَفَيْنَاكَ الْمُسْتَهْزِئِينَ ٩٥ الَّذِينَ يَجْعَلُونَ مَعَ
اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ٩٦ وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّكَ يَضِيقُ صَدْرُكَ بِمَا
يَقُولُونَ ٩٧ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَكُنْ مِنَ السَّاجِدِينَ ٩٨ وَاعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّى
يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ ٩٩﴾

“Ashtu është e vërtetë, për Zotin tënd, se ne do t’i pyesim ata të gjithë.”

“Për gjithçka që kanë bërë.”

“Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar dhe largohu nga idhujtarët.”

“Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin.”

“E të cilët, përveç All’llahut, adhurojnë edhe zot tjetër. Do ta marrin vesh mirë ata.”

“Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre.”

“Prandaj, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur!”

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja.”

Komentimi

Prediko haptazi atë që të është urdhëruar!

Në ajetet e fundit të sures “El Hixhr”, Kur’ani bën të qartë të ardhmen e atyre që bëjnë ndarje e që janë përmendur në ajetet e mëparshme. All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ashtu është e vërtetë, për Zotin tënd, se ne do t’i pyesim ata të gjithë, për gjithçka që kanë bërë!”**.

Në të vërtetë, Ai që është në dijeni të së dukshmes dhe së fshehtës, të Cilit nuk mund t’i fshihet as edhe një grimcë sado e vogël në thellësinë e tokës dhe as në thellësinë e qiejve, nuk pyet për të zbuluar një çështje të fshehtë (All’llahu i Lartësuar është i pastër nga kjo e metë!). E pyetura bëhet për t’ia kumtuar atij që pyetet se sa i keq është veprimi i tij; ose mund të jetë si një lloj ndëshkimi shpirtëror, sepse përgjigja do të jetë për çështjet e këqija, të shoqëruara me fajësim dhe qortim.

Fraza: **“për gjithçka që kanë bërë!”** tregon se të pyeturit do të jetë për të gjitha llojet e punëve të njeriut pa përjashtim. Ky është një mësim domethënës që na ndërgjegjëson që të mos i neglizhojmë punët tona.

Ndërsa ajo çfarë kanë thënë disa komentues të Kur’anit mbi specifikën e të pyeturit për monoteizmin dhe besimin tek Profetët, apo lidhjes së saj me atë çfarë adhurojnë idhujtarët, është një mendim pa asnjë argument.

Disa mund të kenë dyshime nëse ajeti i lartpërmendur është një konfirmim i faktit që All'llahu i Lartësuar ka për t'i pyetur robtë e Tij, siç e lexojmë në ajetin 39 të sures "Er Rrahman": **"Atë ditë njerëzit dhe xhindet nuk do të pyeten për gjynahet e tyre."**

Kësaj pyetjeje i jemi përgjigjur edhe më parë dhe përmbledhja e saj është: në Ditën e Kiametit ka periudha në të cilat njerëzit pyeten, e ka të tjera kur ata nuk pyeten. Kjo për shkak se çështjet do të jenë aq të qarta, sa nuk do të ketë nevojë për pyetje, ose nuk do të jetë pyetje me gojë. Kjo është ajo çfarë mësojmë nga ajeti 65 i sures "Jasin", ku thuhet se do të kyçen gojët e do të fillojnë të pyeten gjymtyrët e trupit, madje edhe lëkura.¹

Pastaj, All'llahu i Lartësuar e urdhëron të dërguarin e Tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **"Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar!"**; d.m.th: *mos ki frikë nga zhurma e idhujtarëve dhe e keqbërësve, mos u dobëso, mos bëj mbrapa dhe as mos hesht, por prediko mesazhin tënd haptazi, pa hezitim!*

Më pas, All'llahu i Lartësuar thotë: **"dhe largohu nga idhujtarët"**; *mos ua vër veshin se çfarë thonë dhe largohu nga ata!*

Fjala "fesda" rrjedh nga lënda "sede", që në gjuhë do të thotë ndarje ose çarje në mënyrë të prerë; gjithashtu, për dhimbjen e fortë të kokës thuhet "sudaun".

Këtu, kjo fjalë ka kuptimin e *shfaqjes, lajmërimit dhe të përhapjes*.

¹ Për sqarime të mëtejshme, shih komentimin e ajetit 8 të sures "El Araf".

*Largimi nga idhuhtarët këtu ka kuptimin e neglizhimit, të lënies pas dore ose shmangies nga përplasja dhe luftimi me ta. Kjo për shkak se në atë kohë, myslimanët nuk kishin arritur akoma standartin e përballjes me armiqtë. Pastaj, All'llahu i Lartësuar e qetëson Pejgamberin e Tij (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për t'ia forcuar zemrën e tij dhe i thotë: **“Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin.”***

Ardhja e foljes në këtë ajet në kohën e shkuar, edhe pse qëllimi është për të ardhmen, tregon për mbrojtjen e sigurtë të All'llahut, që do të thotë: *Ne do të të mbrojmë ty nga e keqja e atyre që tallen.*

Komentuesit e Kur'anit kanë përmendur një transmetim që flet për gjashtë grupe (ose më pak), të cilët janë tallur me Pejgamberin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Sa herë që ai donte të predikonte haptazi, një grup prej tyre ngriheshin për ta tallur e për t'i përçarë njerëzit rreth tij. Por All'llahu i Lartësuar e sprovoi secilin prej tyre me një lloj sprove, derisa ata u larguan nga i Dërguari i All'llahut (në disa tefsire përmenden me detaje llojet e sprovave të tyre).

Më pas përshkruhen edhe ata që vazhdojnë e tallen, me këto fjalë: **“e të cilët, përveç All'llahut, adhurojnë edhe zot tjetër. Do ta marrin vesh mirë ata!”**.

Duket sikur Kur'ani dëshiron të thotë: *Me të vërtetë, mendimet dhe veprat e këtyre personave janë vetë një lojë dhe një tallje. Ata adhurojnë atë që vetë e gdhendin me duart e tyre prej guri dhe prej druri,*

e injoranca i ka shtyrë që t'i bëjnë All'llahut shokë ata që i kanë bërë me duart e veta; e përsëri, ata tallen me ty!

Për ta qetësuar edhe më shumë zemrën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), All'llahu i Lartësuar vazhdon e thotë: **“Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre”**; shpirti yt i dëlirë dhe zemra jote e pastër nuk mund t'i përballojnë ato fjalë fyese dhe përçmuese, ato fjalë mohimi e idhujtarie, e për këtë, zemra jote ngushtohet.

Por ti mos u shqetëso për fjalët e këqija që ata thonë, por vepro siç thotë All'llahu i Lartësuar: **“Prandaj, lartësoje Zotin tënd, duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur!”**.

Lavdërimi dhe lartësimi i All'llahut e largojnë efektin e fjalëve të këqija të njerëzve nga zemrat e të dashurve të All'llahut të Lartësuar. Ato japin myzhde, forcë, dritë dhe pastërti, forcojnë lidhjen me All'llahun e Lartësuar, shtojnë dëshirën për të duruar dhe për të qenë më i qëndrueshëm përballë armiqve të All'llahut.

Në një transmetim nga ibn Abbasi lexojmë se kur të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e shqetësonte diçka, ai falte namaz.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar i jep Pejgamberit të Tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhrin e fundit dhe thotë: **“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”**.

Komentuesit thonë se fjala *“jekijn”* në këtë ajet, është *vdekja*. Është quajtur *“jekijn”* për shkak se është e pashmangshme. Ndoshta

njeriu mund të dyshojë në çdo gjë, përveç se te vdekja, pasi askush nuk mund të dyshojë për të.

Është quajtur “*jekijn*” edhe sepse perdet hiqen nga sytë e njeriut kur i vjen vdekja dhe qartësohen të vërtetat përpara tij.

Në ajetet 46 dhe 47 të sures “El Muddeththir”, në gjuhën e banorëve të Xhehennemit lexojmë: “**dhe mohonim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja.**”.

Nga këtu qartësohet gabimi që kanë transmetuar një pjesë e sufistëve, të cilët kanë thënë se ky ajet është argument që të lihen adhurimet. Sipas tyre, njeriu duhet ta adhurojë All’llahun derisa të arrijë gradën e lartë të besimit, e kur ta ketë arritur këtë të fundit, pas saj nuk ka nevojë që të kryejë adhurimet.

Ne themi:

Së pari: fjala “*jekijn*” në këtë ajet ka kuptimin *vdekje*, duke pasur si argument ajetet e tjera kur’anore që e tregojnë këtë gjë. Vdekja i ndodh si myslimanit, si idhujtarit, në mënyrë të barabartë.

Së dyti: ky ajet i drejtohet Pejgamberit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe grada e lartë e besimit për Pejgamberin është e padiskutueshme. A guxon kush të pretendojë e të thotë, se i Dërguari i All’llahut nuk i ka arritur gradat e larta të besimit, derisa t’i drejtohet me ajetin e lartpërmendur?!

Së treti: është e vërtetë e padiskutueshme se Pejgamberi (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e ka ndërprerë asnjëherë adhurimin deri në momentet e fundit të jetës së tij. Kështu ka qenë gjendja edhe për prijësin e besimtarëve,

Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ai ra dëshmor duke qenë afër mihrabit.

Hulumtime

1- Fillimi i predikimit të Islamit haptazi

Nga disa transmetime mësohet se dy ajetet: **“Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar dhe largohu nga idhujtarët! Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që të tallin”**, kanë zbritur në Mekë, pasi i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte kaluar tre vjet duke bërë thirrje e duke predikuar fshehurazi mesazhin e tij dhe pasi i kishin besuar vetëm një numër i paktë njerëzish. E para që ka besuar nga gratë ka qenë Hatixhja (*Paqja qoftë mbi të!*), kurse nga burrat, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

Thirrja në monoteizëm të sinqertë (Teuhid), e cila u shoqërua me shkatërrimin e sistemit të idhujtarisë dhe adhurimit të idhujve në atë mjedis, në të vërtetë ka qenë një vepër e çuditshme dhe e frikshme. Tallja e idhujtarëve dhe përçmimi i tyre ka qenë i njohur tek All'llahu i Lartësuar përpara se ata të vepronin, e për këtë, Ai ka dashur që të forconte zemrën e Pejgamberit të Tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në mënyrë që të mos kishte frikë nga talljet e mohuesve dhe ta predikonte

mesazhin e All'llahut tek paria e tyre e t'u hapte një luftë logjike atyre.¹

2- Ndikimi shpirtëror në përkujtimin e All'llahut të Lartësuar

Jeta e njeriut ka qenë dhe vazhdon të jetë e mbushur me probleme. Sa më lart në grada që të ngrihet njeriu, aq më shumë i shtohen problemet. Nga këtu kuptojmë edhe vështirësinë e problemeve dhe të shqetësimeve që ka përballuar i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në rrugën e përcjelljes së mesazhit të tij të madh.

Ilaçi hyjnor për t'i tejkaluar vështirësitë është përpjekja për të arritur forcën nga burimi i saj i vërtetë, me ëmbëlsinë e zemërgjerësinë e shpirtit. All'llahu e urdhëron të Dërguarin e Tij për madhërim, përkujtim, lutje dhe sexhde, për shkak të ndikimit të thellë që ka adhurimi në forcimin e shpirtit të njeriut, besimit dhe dëshirës së tij.

Nga transmetimet e ndryshme të ardhura nga Imamët, mësojmë se kur ata u sprovuan me vështirësi, iu drejtuan All'llahut të Lartësuar me adhurim, përkujtim e lutje, në mënyrë që të merrnin forcë nga Ndihmësi i vërtetë.

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 32, hadithi 126.

3- Adhurimi dhe përsosmëria

Sikurse është e ditur, njeriu e ka filluar jetën e tij nga mosekzistenca dhe vazhdon ende drejt absolute e nuk do ta ndërpresë përpjekjen për përsosje.

Adhurimi konsiderohet si një shkollë e lartë e edukimit, sepse ai e zgjon logjikën e njeriut, e drejton mendjen e tij drejt përsosmërisë, i pastron pluhurin e mëkateve dhe të pakujdesisë nga zemra dhe shpirti i tij, rrit e zhvillon tek ai cilësitë e larta njerëzore, i forcon besimin dhe e bën atë të vetëdijshëm për përgjegjësitë.

Njeriu realist nuk mund të bëjë pa këtë shkollë të lartë e të bukur. Ata që thonë se kur njeriu e arrin një gradë të caktuar, ai nuk ka më nevojë për ibadet, ose e konsiderojnë procesin e përsosjes së njeriut si të kufizuar e që përfundon në një cak, ose nuk e kanë perceptuar saktë kuptimin e adhurimit.

Në lidhje me këtë, dijetari i shquar Tabatabajj në tefsirin e tij “Mijzan” thotë: Çdo lloj gjallese ka kulmin e përsosmërisë së saj. Po kështu, edhe njeriu ka kulmin e përsosmërisë. Njeriu është qenie sociale. Individët e një shoqërie kanë nevojë për rregulla dhe ligje dhe këto rregulla dhe ligje duhet të respektohen e të punohet me to.

Me fjalë të tjera, nëse shoqëria njerëzore është e drejtë, atëherë ajo ua mundëson individëve të saj që të arrijnë qëllimin e tyre përfundimtar, që është përsosmëria; e nëse ajo shoqëri degjenerohet e shkatërrohet, individët e saj bëhen të prapambetur dhe nuk e arrijnë përsosmërinë.

Rregullat dhe ligjet, sido që të jenë, shoqërore apo të adhurimit, nuk janë të ndikueshme dhe të dobishme vetëm nëse merren nëpërmjet profecisë dhe shpalljes qiellore, e jo nga burime njerëzore. Ne e dimë se këto rregulla adhurimi përbëjnë një pjesë të mirë të kësaj përsosmërie individuale dhe shoqërore. Nga kjo na qartësohet se obligimi i All'llahut e shoqëron njeriun për sa kohë që ai jeton në këtë botë. Moskryerja e këtij obligimi e çon individin dhe shoqërinë drejt shkatërrimit. Veprat e mira dhe adhurimet janë burim i cilësive psikologjike e mendore të virtytshme. Nëse këto vepra zbatohen mjaftueshëm dhe nëse cilësitë e mira forcohen në shpirtin e njeriut, atëherë ato do të jenë një burim i ri për më shumë vepra të mira si dhe për bindje dhe ibadete më të mira.¹

Përktheu: Agim Reçaj

¹ Tefsiri "Mijzan", vëll. 12, f. 210.

Sure “En Nahl”

**Sure “En Nahl” është surja e 16-të e rënditur në Kur'anin Kerim,
e cila ka 128 ajete dhe ka zbritur në Mekë.**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Përmbajtja e sures

Shumica e interpretuesve të Kur'anit janë shprehur se një pjesë e ajeteve të kësaj sureje janë zbritur në Mekë dhe pjesa tjetër në Medine, por disa të tjerë janë shprehur se të gjitha ajetet e kësaj sureje janë zbritur në Mekë. Por, duke marrë parasysh karakterin e sureve të zbritura në Mekë dhe të atyre të zbritura në Medine, bëhet e qartë se mendimi i parë është shumë më i drejtë. Këtë e përforcon përmbajtja e ajetit 41 të kësaj sureje: **“Ata që emigruan për hir të All'Ilahut...”**, si dhe përmbajtja e ajetit 110 të kësaj sureje: **“Pastaj Zoti yt, atyre që emigruan pasi u torturuan dhe më pas ata luftuan e qëndruan...”**. Siç shihet, ajeti i nderuar trajton njëherësh me qartësi çështjen e emigrimit dhe të luftës në rrugën e All'Ilahut. Gjithashtu, bëhet e qartë se të dyja ajetet përputhen me ngjarjet që ndodhën pas emigrimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) prej Mekës në Medine.

Kur marrim parasysh emigrimin për të cilin flet ajeti 41, kuptohet qartë se bëhet fjalë për emigrimin e parë të myslimanëve, kur një grup myslimanësh emigruan prej Mekës në Abisini nën kryesinë e Xha'fer bin Ebù Tàlibit (*Paqja qoftë mbi të!*). Përjashtohet mundësia që të jetë fjala për emigrimin e për luftën në rrugën e All'Ilahut, për të cilat flet ajeti 110, pasi emigrimi në këtë ajete të nderuar përputhet plotësisht vetëm me emigrimin e Profetit (*Paqja*

dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për në Medine.

Duhet theksuar se ajeti 126 i kësaj sureje: **“Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar...”**, ka zbritur në luftën e Uhudit, që ndodhi pas emigrimit të dytë dhe ky fakt është i njohur ndër interpretuesit e Kur'anit.

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se dyzet ajetet e para të kësaj sureje kanë zbritur në Mekë dhe pjesa tjetër e ajeteve në Medine; interpretues të tjerë janë shprehur se të gjitha ajetet e kësaj sureje janë zbritur në Mekë, përveç ajeteve që kanë lidhje me luftën e Uhudit (tri ajetet e fundit).

Vërtetohet me siguri se ajetet e kësaj sureje janë zbritur në Mekë dhe në Medine, por nuk është e mundur të specifikohen me përpikëri se cilat ajete kanë zbritur në Mekë dhe cilat në Medine, me përjashtim të ajeteve të lartpërmendura.

Sido që të jetë, duke vështruar në këtë sure, për ne bëhet e qartë se edhe studimet mbi ajetet e sures “En Nahl” herë trajtojnë ato çështje që trajtojnë vetë ajetet e zbritura në Mekë, siç është çështja e Njësimit të All'llahut (*All'llahu është Zoti Një e i Vetëm*), Ringjallja, luftimi i politeizmit (vënies shok All'llahut - shirk) dhe i adhurimit të idhujve, herë tjetër trajtojnë çështje që trajtojnë ajetet e zbritura në Medine, siç janë dispozitat shoqërore dhe çështjet e luftës në rrugën e All'llahut apo çështja e emigrimit.

Përmbajtja e sures, e parë me kujdesin më të madh, na mundëson të njihemi me çështjet vijuese:

1- Përmendja e mirësive të All'llahut dhe shpjegimi i atyre mirësive në mënyrë të hollësishme, përbën një motiv shtytës që çdo njeri të falënderojë me ndjenja të gjalla, me qëllim afrimin e njeriut pranë Krijuesit e Dhuruesit të këtyre mirësive.

Prej mirësive të përmendura në këtë sure janë mirësia e shiut, drita e diellit, llojet e bimëve, frutave e lëndëve të tjera ushqyese, kafshët shtëpiake, prej të cilave njeriu përfiton shërbime dhe dobi, si dhe kërkimi për plotësimin e mjeteve të jetesës. Madje në këto ajete mësojmë edhe për mirësinë që gëzon njeriu prej fëmijëve e prej gruas, si dhe llojet e shumta të të mirave që gëzon njeriu në këtë jetë. Pikërisht për këtë arsye disa interpretues e kanë emërtuar këtë sure "Suretu En Niami" - surja e mirësive.

Sure "En Nahl" është e njohur edhe për theksimin e përfitimeve që i vijnë njeriut prej bletës, për të cilën në këtë sure tregohet me fjalë shumë të shkurtra, por kuptimplota, pasi bleta këtu përmendet në tërësinë e mirësive të shumta të All'llahut, duke u specifikuar si burim ushqimi shumë i rëndësishëm prej ushqimeve të njeriut. Jeta e këtij insekti konsiderohet shprehëse e Njësimit të All'llahut.

2- Flet për argumentet që vërtetojnë Njësimin e madhështinë e të gjitha gjërave që ka krijuar Krijuesi, Ringjalljen dhe paralajmëron idhujtarët e kriminelët.

3- Trajton dispozita islame të ndryshme, si urdhrin për drejtësi e për bamirësi e mirësjellje, emigrimin, luftën në rrugën e All'llahut, ndalimin e mëkateve të mëdha e të punëve të urreyera, padrejtësinë, tiraninë dhe mosmbajtjen e besës, përveç thirrjes për të falënderuar All'llahun e Lartësuar për mirësitë e mëdha; më pas

në disa ajete theksohet se Ibrahim (Paqja e All'llahut qofshin mbi të!) ishte monoteist dhe prej falënderuesve.

4- Flet për sajemat e idhujtarëve, krahas përmendjes së shembujve të gjallë.

5- Së fundi, paralajmëron njerëzimin që të ruhet prej cytjeve të shejtanit.

Mirësia e sures

Në lidhje me mirësinë e sures "En Nahl" transmetohet se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Kush e lexon atë (suren "En Nahl"), All'llahu nuk i kërkon atij llogari për mirësitë e kësaj bote që Ai i ka dhënë atij".¹

Ajetet që trajtojnë shumë prej mirësive të All'llahut duhen lexuar me kujdes, duke menduar e duke reflektuar me vendosmëri për të punuar e për të ecur në përputhje të plotë me udhëzimin e All'llahut dhe për të falënderuar Mirësidhënësin. Ky falënderim dhe reflektim duhet të jetë rrugë që njeriu të përdorë çdo mirësi ashtu siç e ka detyrë ta përdorë atë, as të mos e mbajë dorën të mbyllur, as të mos shpërdorë dhe vazhdimisht të gjendet në radhën e falënderuesve. Nëse njeriu vepron kështu, si është e mundur që ai nesër të vihet para llogaridhënies?

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjàn", vëll. 6, f. 347.

Ajetet 1 - 2

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

﴿أَتَى أَمْرُ اللَّهِ فَلَا تَسْتَعْجِلُوهُ سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ يُنَزِّلُ
الْمَلَائِكَةَ بِالرُّوحِ مِنْ أَمْرِهِ عَلَى مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ أَنْ أَنْذِرُوا أَنَّهُ لَا
إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاتَّقُونِ﴾

Bismil'lahir Rrahmanir Rrahim

“Erdhi (u afrua) urdhri i All'llahut (Kiameti), prandaj mos kërkoni që ai të vijë sa më shpejt. I pastër e pa asnjë të metë është vetëm madhëria e Tij në krahasim me ato që ata i vënë Atij për shok.”

“Me urdhrin e Tij i zbret engjëjt tek ai që dëshiron prej robërve të Vet, që ata të paralajmërojnë se s’ka të adhuruar tjetër përveç Meje, prandaj të keni frikë prej Meje.”

Komentimi

Erdhi urdhri i All'llahut:

“Erdhi (u afrua) urdhri i All'llahut (Kiameti)”:

Më sipër përmendëm se një pjesë e mirë e ajeteve të fillimit të sures janë zbritur në Mekë gjatë kohës kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte në një konflikt të ashpër me politeistët – ata që i vënë shok All'llahut (mushrikët) - dhe me adhuruesit e idhujve (idhujtarët). Nuk kalonte një ditë që armiqtë e mesazhit të mos sajonin një kundërvënie të re përballë thirrjes së bekuar islame, sepse kjo thirrje kishte qëllim ndërtimin e bazave të lirisë, madje ndërtimin e të gjithë jetës nga e para.

Prej tërësisë së përballjeve të tyre është edhe fjala që ata i thoshin Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur ai i kërcënonte e i paralajmëronte ata me dënimin e All'llahut: “Kur kjo qenka e vërteta, atëherë përse nuk na vjen ndëshkimi e dënimi tani?!”

Përveç kësaj, ata shtonin: “Edhe sikur ndëshkimi të vijë, ne do të strehohemi tek idhujt që ata të ndërmjetësojnë për ne tek All'llahu që Ai të na e heqë dënimin. Përse nuk ndodh kjo, a nuk janë idhujt ndërmjetësues?!”

Ajeti i parë i sures i zhvlerëson këto iluzione me fjalën e të Lartit:

“Erdhi (u afrua) urdhri i All'llahut (Kiameti), prandaj mos kërkonë që ai të vijë sa më shpejt” dhe nëse ju besoni se idhujt

ndërmjetësojnë tek All'llahu për ju, me të vërtetë keni gabuar rëndë: **"I pastër e pa asnjë të metë është madhëria e Tij në krahasim me ato që ata i vënë Atij për shok"**.

Këtu fjala **"urdhri i All'llahut"** do të thotë urdhri i All'llahut për dënimin e politeistëve, kurse qëllimi me foljen *"erdhi"* është se dënimi do të ndodhë patjetër në të ardhmen, pavarësisht se folja është në kohën e shkuar, por është në përshtatje të plotë dhe me shumë shembuj të tjerë të retorikës së Kur'anit. Disa interpretues e shpjegojnë fjalën **"urdhri i All'llahut"** me vetë dënimin dhe jo me urdhrin për ardhjen e dënimit.

Interpretues të tjerë kanë thënë se qëllimi me fjalën **"urdhri i All'llahut"** është Dita e Gjykimit.

Mendojmë se komenti që përmendëm, është më i afërt se komentet e tjera, gjithsesi vetëm All'llahu e di më mirë.

Meqenëse drejtësia e All'llahut domosdoshmërisht e ka kushtëzuar dënimin vetëm pas ardhjes së një shpjegimi të mjaftueshëm e argumentimi të plotë, i Plotpushtetshmi shton: **"Me urdhrin e Tij ia zbret engjëjt atij që Ai dëshiron prej robërve të Vet: paralajmëroni se s'ka të adhuruar tjetër përveç Meje"**. Në bazë të këtij njoftimi vjen edhe paralajmërimi e tërheqja e vëmendjes: **"prandaj të keni frikë prej Meje"**.

Për sa i përket qëllimit me fjalën *"err'rruhu"* – *shpirt* – në këtë ajet, interpretuesit e Kur'anit kanë thënë shumë fjalë, por kuptimi më i plotë më këtë fjalë këtu është revelata, Kur'ani dhe profetësia, që janë burimi i jetës morale për mbarë njerëzimin.

Disa interpretues e kanë ndarë revelatën prej Kur'ânit e prej profetësisë, duke vënë në konsideratë se kemi të bëjmë me tri interpretime të pavarura të fjalës “shpirt”, që janë burimi i jetës morale për njerëzimin.

Disa interpretues e kanë ndarë revelatën prej Kur'ânit e profetësisë dhe për këtë ndarje ata kanë marrë parasysh se këtu kemi tri interpretime të pavarura të kësaj fjale, por që të gjitha rezultojnë në një të vërtetë të vetme.

Në të gjitha gjendjet, fjala “err’rrùhu” – *shpirt* – në këtë vend ka anën e saj morale dhe thekson se gjithçka që është shkak për ringjalljen e zemrave, për edukimin e shpirtave dhe për udhëzimin e mendjeve në rrugën e drejtë, ashtu siç e lexojmë në ajetin 24 të sures “El Enfâl”: **“O ju që keni besuar, përgjigjuni thirrjes së All’l-lahut dhe të Dërguarit, kur ai (i Dërguari) u bën thirrje për në atë që u jep jetë”**; gjithashtu edhe në ajetin 15 të sures “El Gàfir”: **“...Ai me urdhrin e Vet ia sjell shpirtin (Shpalljen) atij që do prej robërve të Vet...”**; si dhe në ajetin 52 të sures “Esh’shùrà”: **“Po kështu me urdhrin Tonë Ne të shpallëm ty edhe shpirtin (Kur’ânin); ti nuk ke ditur as ç’është Libri (Kur’âni) e as ç’është besimi (ijmàni)”**.

Shihet qartë se fjala “err’rrùhu” – *shpirti* – në ajetet e mësipërme është simbol tregues për “Kur’ânin”, “Revelatën” dhe “punën e profetësisë”.

Fjala “err’rrùhu” – *shpirti* – ka ardhur edhe më kuptime të tjera në disa vende në Kur’ânin Famëlartë, por duke marrë parasysh shembujt që ne përmendëm, konkludojmë se qëllimi me fjalën “err’rrùhu” – *shpirti* – në ajetin që kemi në studim, është Kur’âni dhe përmbajtja e revelatës.

Duhet theksuar se shprehja e ajetit të mësipërm: **“atij që Ai dëshiron prej robërve të Vet”**, nuk do të thotë se në udhëzimin për në rrugën e drejtë të revelatës e të profetësisë, nuk ka përgjegjësi, sepse nuk ka as ndarje e as kontradiktë në mes vullnetit e vendimit të All’llahut, ashtu siç folëm për këtë çështje kur trajtuam ajetin 124 të sures “El En’àm”: **“All’llahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Tij”**.

Paralajmërimi mund të jetë prej urdhrave të parë të ardhur prej All’llahut drejtuar të gjithë Profetëve (*Paqja dhe bekimet i All’llahut qofshin mbi ta dhe mbi familjet e tyre!*) dhe argumenti për këto është fjala “en endhirù”-“*paralajmëroni*”, sepse natyra e fjalës “*paralajmërim*” lë të kuptohet se pas paralajmërimit vjen tërheqja e vëmendjes, vjen një ngritje dhe një lëvizje.

Është e vërtetë që njeriu kërkon dobinë dhe mbrohet prej dëmtimit, por praktika ka nxjerrë në dukje se stimulimi i interesit ka efekt shumë të madh tek ai që ka arritur të zotërojë bazat e kushtet për të pranuar udhëzimin për në rrugën e drejtë. Kurse atyre që u kanë mbyllur sytë kënaqësitë e kësaj bote, u sjell dobi vetëm kërcënimi e përbetimi, prandaj në fillimet e thirrjes profetike ishte e domosdoshme përdorimi i metodës së paralajmërimit të ashpër.

Ajetet 3 - 8

﴿خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ تَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ﴾ ٣ خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ نُطْفَةٍ فَإِذَا هُوَ خَصِيمٌ مُبِينٌ، وَالْأَنْعَامَ خَلَقَهَا لَكُمْ فِيهَا دِفْءٌ وَمَنَافِعُ وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ. وَلَكُمْ فِيهَا جَمَالٌ حِينَ تُرِيحُونَ وَحِينَ تَسْرَحُونَ. وَتَحْمِلُ أَثْقَالَكُمْ إِلَىٰ بَلَدٍ لَّمْ تَكُونُوا بِالْغِيَةِ إِلَّا بِشِقِّ الْأَنْفُسِ إِنَّ رَبَّكُمْ لَرءُوفٌ رَّحِيمٌ ٦ وَالْخَيْلَ وَالْبِغَالَ وَالْحَمِيرَ لِتَرْكَبُوهَا وَزِينَةً وَيَخْلُقُ مَا لَا تَعْلَمُونَ﴾ ٨

“Ai i krijoi qiejt dhe tokën me urtësinë më të përpiktë; Ai është i lartësuar e pa asnjë të metë nga ato që ata (idhujtarët) i vënë Atij për shok.”

“Ai e Krijoi njeriun nga një pikë (uji) dhe ai (njeriu) del kundërshtar i hapur.”

“Edhe kafshët Ai i krijoi për ju që ju prej kafshëve të mbroheni e të keni edhe dobi të tjera dhe që ju të hani prej kafshëve.”

“Në ato (kafshët) ju shikoni hijeshi në mbrëmje kur i ktheni (nga kullota) dhe në mëngjes kur i lëshoni (në kullotë).”

“Ato (kafshët) mbartin barrët tuaja për në vendin ku doni të arrini, që ju vetë do të arrinit me shumë vështirësi. Me të vërtetë, Zoti juaj është i Dhembshuri i dashur dhe Mëshirëploti.”

“Edhe kuajt, mushkat e gomarët (Ai i krijoi) për ju që të hipni mbi ata dhe si stoli. Ai krijon (për hipje) edhe atë çka ju (akoma) nuk e dini.”

Komentimi

Kafsha, kjo krijesë dhënëse

Pamë se ajetet e para flisnin për hedhjen poshtë të politeizmit (shirkut), ndërsa këto ajete vijnë për të çrrënjosur plotësisht politeizmin dhe për të orientuar njeriun drejt Krijuesit të tij me anë të dy rrugëve:

1) rruga e argumenteve logjike nëpërmjet kuptimit e përpjekjes për të përvetësuar sistemin e habitshëm që është te krijesat;

2) rruga e ndjenjave, duke shpjeguar mirësitë shumë të mëdha që All’llahu ka bërë për njeriun, mbase kështu do të lindë te njeriu ndjenja e falënderimit për këto mirësi. Nëpërmjet falënderimit, njeriu afrohet te Mirësidhënësi, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe është krejtësisht i pastër nga të metat.

All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ai i krijoi qiejt dhe tokën me urtësinë më të përpiktë”.**

Bëhet e qartë e vërteta e padiskutueshme e krijimit të qiejve dhe të tokës me atë sistem të përkryer e me ato krijesa të sistemuara dhe qëllimi i krijimit të krijesave së bashku me dobitë që vijnë prej tyre.

Më pas ajeti vijon: **“Ai është i lartësuar e pa asnjë të metë nga ato që ata (idhujtarët) i vënë Atij për shok”**.

A kanë mundësi idhujt të bëjnë atë çfarë ka bërë All'llahu?!

Madje a kanë mundësi idhujt të krijojnë qoftë edhe një mushkonjë të vogël apo një grimcë toke?!

Atëherë si i bëjnë idhujt shokë e ortakë All'llahut, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe është krejtësisht i pastër nga mangësitë!

Qesharake dhe për të qarë në gjendjen e politeistëve është fakti se ata në të vërtetë e konsiderojnë All'llahun Krijuesin e ditur e të fuqishëm të këtij sistemi të përsosur e të mahnitshëm, megjithëkëtë u bëjnë sexhde (i përulen me krye në tokë) idhujve!

Pasi theksohet krijimi i qiejve e i tokës dhe i të fshehtave të krijesave të panumërta që janë në qiej e në tokë, Kur'ani Famëlartë prek edhe disa hollësi të krijimit të njeriut e të formimit të tij dhe thotë: **“Ai e Krijoi njeriun nga një pikë (uji) dhe ai (njeriu) del kundërshtar i hapur”**.

Fjala **“pikë uji”** në tekstin origjinal (në arabishte) të Kur'anit Famëlartë ka ardhur me fjalën *“en'nutfeh”*, në kuptimin e ujit të paktë ose e ujit shumë të pastër dhe, dihet që fjala *“nutfeh”* përdoret për pikat e ujit që bëhet shkak për formimin e njeriut pas fekondimit.

E vërteta e shprehjes ka si qëllim të bëjë të qartë fuqinë e All'Ilahut të Plotpushtetshëm, i Cili krijon njeriun, prej një pike të këtij uji kaq të ulët, krijon këtë krijesë të mahnitshme, së bashku me vlerat që ai mbart, duke shtuar edhe nderimin e respektin e veçantë që gëzon njeriu tek All'Ilahu ndërmjet të gjitha krijesave.

Është kështu kur ne marrim në konsideratë fjalën “*khasijmun*” - *kundërshtar i hapur* – në kuptimin e mbrojtësit dhe aftësinë e të shprehurit që ai ka në vetvete, ashtu siç na njofton për këtë edhe ajeti 105 i sures “En Nisà”: “**mos u bëj mbrojtës për tradhtarët** (armiqtë e hapur)”, ashtu siç janë shprehur për këtë kuptim një grup interpretuesish të Kur'anit Famëlartë.

Të tjerë interpretues e kanë shpjeguar këtë fjalë në një formë tjetër, e cila në mënyrë të përmbledhur konkludon: me fuqinë e plotë të All'Ilahut, njeriu u krijua prej një pike uji të ulët, por kjo krijesë nuk falënderon dhe në shumë raste mban një qëndrim polemizues e kundërshtues para Krijuesit të tij. Këta interpretues, këtë shpjegim e kanë bazuar në ajetin 77 të sures “Jàsijn” dhe e sjellin këtë ajet si vërtetues për shpjegimin e dhënë prej tyre.

Siç shihet, interpretimi i parë është shumë më i qartë e më i drejtë se interpretimi i dytë, sepse ajetet që janë para këtij ajeti shpjegojnë madhësinë dhe fuqinë e pakufizuar e të pakushtëzuar të All'Ilahut. Madhështia e All'Ilahut në këto ajete del fare e qartë, kur Ai krijon këtë qenie shumë të nderuar, megjithëse u krijua prej një lënde, e cila nga ana e jashtme duket kaq e parëndësishme.

Në tefsirin “Nüruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 39 të autorit Ali bin Ibrahim thuhet: “Ai e krijoi atë (njeriun) nga një pikë prej ujit të

qelbur, megjithëkëtë ai del një armik i hapur (me një gjuhë shumë elokuyente)".¹

Më pas, Kur'ani Famëllartë thekson mirësinë e madhe të krijimit të kafshëve, si dhe dobitë e shumta që ka njeriu prej kafshëve, përfshirë edhe veshjen që siguron prej tyre dhe thotë: **"Edhe kafshët Ai i krijoi për ju, që nëpërmjet tyre të mbroheni, të keni dobi të tjera, si dhe të hani prej tyre"**.

Krijimi i kafshëve tregon diturinë e gjithanshme dhe fuqinë e Filluesit të Plotpushtetshëm, pasi kafshët kanë shumë dobi për njeriun, megjithëse ajeti thekson vetëm tri prej tyre:

E para: fjala *"dif'un"*, *mbrojtje*, përfshin çdo gjë me të cilën njeriu mbulon trupin e tij, duke përfutur prej leshit e prej lëkurëve të kafshëve, me të cilat ai përgatit veshje, këpucë, enë e mbulesa.

E dyta: fjala *"menàfiu"*, *dobi*, thekson qumështin dhe nënproduktet e qumështit.

E treta: fjala *"minhà teakulùn"*, *prej atyre hani*, do të thotë: hani mishin.

Në rreshtimin e dobive janë vënë më përpara veshjet, mbulesat e banesat dhe pastaj dobitë e tjera, çka tregon rëndësinë dhe domosdoshmërinë që ato kanë për jetën e njeriut.

Gjithashtu konstatohet se në radhë të parë ka ardhur fjala *"dif'un"*, *mbrojtje*, e më pas fjala *"menàfiu"*, *dobi*. Ka ardhur kështu sepse mjetet me të cilat njeriu spraps dëmin, kanë përparësi ndaj dobive të tjera që ai përfiton prej kafshëve.

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 39, hadithi 8.

Disa prej atyre që kundërshtojnë ngrënien e mishit kanë mundësi të konkludojnë nga ana e jashtme e këtij ajeti e të thonë se Krijuesi i Madhërishëm nuk e ka konsideruar çështjen e ngrënies së mishit dobi. Pikërisht për këtë, edhe ne mendojmë se fjala “*minhà teakulùne*”, prej atyre hani, ka ardhur pas fjalës “*menàfiu*”, dobi. Nga ky rreshtim, më e pakta që mund të konkludohet, është fakti se ajeti i nderuar thekson me përparësi rëndësinë shumë të madhe të qumështit ndaj mishit.

Ajeti i nderuar nuk mjaftohet vetëm të përmendja e mirësive materiale, por thekson edhe dobitë shpirtërore e morale, kur thotë: “**Në ato (kafshët) ju shikoni hijeshi në mbrëmje kur i ktheni (nga kullota) dhe në mëngjes kur i lëshoni (në kullotë)**”.

Rrënja e foljes “*turijhùne*” – që t’i qetësoni – është në kuptimin e kthimit të kafshëve pas përdimit të diellit në vendin ku ato pushojnë; kurse rrënja e foljes “*tusrihune*” - i lëshoni – është në kuptimin e daljes së kafshëve në mëngjes për në kullotë.

Kur’ani Famëlartë me fjalën “*xhemàl*” – stoli – shpreh lëvizjen në grup të kafshëve shtëpiake kur ato nxitojnë për në kullotën e tyre dhe kur kthehen në vendin ku pushojnë, sepse pikërisht në këto kohë, kafshët kanë atë hijeshi të veçantë që e lumturon njeriun, njëkohësisht shpreh edhe të vërtetën e ngulitur në thellësi të shoqërisë për mbarështimin e kafshëve shtëpiake.

Lëvizja e kafshëve, përveç hijeshisë që shkakton, i jep siguri shoqërisë se gjërat e domosdoshme për jetën ecin përpara syve tuaj, prandaj gëzohu për këtë mirësi e merr prej asaj aq sa ke nevojë dhe nuk është e nevojshme që plotësimi i nevojave jetike të jetë i lidhur me këtë ose me atë faktor, ndryshe do të dobësohesh. Me këtë

shpjegim duket sikur kjo mirësi të flet ty drejtpërdrejtë dhe të thotë: “me ndërmjetësinë time (mirësia që vjen prej kafshëve), personalisht je i siguruar dhe të mjafton”.

Stoli - “*xhemâl*” - është edhe kënaqësia personale, është hijeshia e prodhimit dhe e garantimit të kërkesave të mbarë popullatës. Thënë me fjalë më të qarta, është ndjenja e kënaqësisë që sjell pavarësia ekonomike dhe prerja e çdo varësie prej tjetrit.

Të vërtetën e sigurisë shpirtërore që i jep lëvizja e kafshëve njeriut, më shumë se kushdo tjetër e ndiejnë banorët e fshatrave. Janë pikërisht ata që e shijojnë këtë siguri shpirtërore, kur shikojnë se nuk kanë nevojë të jenë të varur prej të tjerëve; veç kësaj, kjo siguri tregon edhe plotësimin e njëres prej detyrave më të rëndësishme shoqërore.

Është kuptimplotë fakti që ajeti i mësipërm fillon duke përmendur kthimin e kafshëve në vendin ku do të pushojnë (në stallë, në stan), kur vështruesi në këtë kohë shikon gjinjtë e kafshëve të fryra prej qumështit e barqet e tyre të mbushura. Ai shikon se fytyrat e kafshëve tani që kthehen mbartin shenja të një kënaqësie që ato nuk e kishin në mëngjes kur nxitonin për në kullotë, kurse tani kthehen pa nxitim e shikojnë me qetësi drejt vendit ku do të pushojnë. Pikërisht, kjo pamje të mjafton si njeri për t’u ndier i sigurt për plotësimin e nevojave jetike, veçanërisht kur shikon gjinjtë e bagëtive.

Më pas, i Larti në ajetin vijues thekson edhe njërin prej dobive shumë të rëndësishme që ka njeriu prej kafshëve dhe thotë: **“Ato (kafshët) mbartin barrët tuaja për në vendin ku doni të arrini, që ju vetë do t’i arrinit me shumë vështirësi”**. Kjo mirësi e

madhe është njëra prej dukurive të mëshirës e të dhembshurisë së të Plotpushtetshmit, i Cili i ka bërë kafshët të përulura ndaj njeriut, megjithëse ato zotërojnë kaq fuqi e forcë, prandaj i Larti njofton: **“me të vërtetë Zoti juaj është i Dhembshuri i dashur dhe Mëshirëploti”**.

Fjalën e ajetit *“shik’k” - me shumë vështirësi* – disa interpretues të Kur’anit Famëlartë e kanë mbartur në kuptimin e prerjes, rraskapitjes. Do të thotë se ju o njerëz nuk do të kishit mundësi të transportoni këto barra të rënda e t’i çoni aty ku keni qëllim, veçse duke humbur gjysmën e fuqive tuaja.

Duket se interpretimi i parë është më i pranueshëm se interpretimi i dytë.

Kafshët i japin njeriut veshjet që e mbrojnë prej të nxehtit e prej të ftohtit, i japin qumësht e mish që ai të ushqehet. Gjithashtu, ata lënë në shpirtin e njeriut ndjenja shpirtërore të mira dhe, së fundi, mbajnë mbi kurriz edhe barrët që duan njerëzit të transportojnë nga njëri vend në një vend tjetër.

Pavarësisht nga përparimi i arritur në fushën e qytetarisë e të përgatitjes së mjeteve moderne të transportit, vazhdojnë të jenë të shumta rrugët ku transporti bëhet vetëm me kafshë.

Më pas, ajeti flet për një lloj tjetër kafshësh, prej të cilit njeriu ka dobi në lëvizjet e që bën dhe thotë: **“Edhe kuajt, mushkat e gomarët (Ai i krijoi) për ju që të hipni mbi ata dhe si stoli”**.

Fjala e ajetit *“zijneten” - stoli* – këtu nuk është një fjalë më tepër ose një fjalë që shpreh vlerën e stolisë në kuptimin e saj të

vërtetë; jo, kjo fjalë shpreh efektin e madh dhe shumë të dukshëm që kanë kafshët shtëpiake në jetën shoqërore.

Për të shpjeguar më qartë e në mënyrë më të kuptueshme dobinë që kanë njerëzit prej kafshëve, le të marrim si shembull një person që përshkon me këmbë një rrugë të gjatë nëpër shkretëtirë. Si do të arrijë ky njeri në vendin ku ka qëllim të arrijë? Ai do të arrijë atje i lodhur e i rraskapitur, aq sa s' do ketë fuqi të kryejë asnjë punë.

Por, kur për të udhëtuar përdor një mjet të rehatshëm e të shpejtë, në këtë gjendje ai do të arrijë shumë shpejt aty ku dëshiron, do të fitojë kohë, nuk do të lodhet dhe do të ruajë fuqinë për të kryer punët e veta. Pas gjithë kësaj, a nuk është kjo një stoli?!

Në fundin e ajetit theksohet fakti se njeriu do të arrijë të ketë edhe mjete të tjera transporti përveç kafshëve dhe për këtë i Larti thotë: **“Ai krijon (për hipje) edhe atë çka ju (akoma) nuk e dini”**, do të thotë mjete hipjeje dhe mjete transporti.

Disa interpretues të mëparshëm të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se kjo pjesë e ajetit tregon për kafshët që do të krijohen në të ardhmen, të cilat njeriu do t'i përdorë në lëvizjet që bën nga njëri vend në një tjetër.

Në tefsirin “El Meràgij” dhe në tefsirin “Fij Dhillàlil Kur'an” thuhet se këtë frazë të Kur'anit e kuptojmë me shumë lehtësi, sepse jetojmë në kohën e automobilave e të mjeteve të tjera të shpejta të transportit.

Kur ajeti shprehet me fjalën *“krijon”*, kjo nuk do të thotë se njeriu me shpikjet e reja që do të realizojë është krijuesi i atyre mjeteve, pasi lëndët e para të domosdoshme për këto shpikje janë

të krijuara dhe gjenden në duart tona. Por do të thotë se njeriut nuk i mbetet gjë tjetër përveçse të përdorë gjithçka që All'Ilahu i ka dhuruar atij, përfshirë edhe fuqinë e kapacitetin për të bërë shpikje të reja. Pra, të asaj fuqie që All'Ilahu ka depozituar te njeriu për të përgatitur këto materiale, për t'u dhënë atyre formën e duhur dhe për t'i montuar ato në atë mënyrë që na japin një send prej të cilit të përfitojmë.

Rëndësia e madhe e bujqësisë dhe e blegtorisë

Pavarësisht nga përhapja e mjeteve prodhuese në të gjitha fushat e jetës, ashtu siç është arritur në ditën e sotme, prodhimet bujqësore dhe mbarështimi i kafshëve, nga pikëpamja e rëndësisë mbeten në krye të listës së prodhimeve të domosdoshme për jetën e njeriut, sepse janë burimi i ushqimit dhe pa to s'ka as jetë.

Është fakt se mbulimi i nevojave të individit me prodhime bujqësore e blegtorale, konsiderohet një prej kolonave kryesore që sigurojnë pavarësinë ekonomike e politike të një vendi.

Pikërisht për këtë, ne vërejmë se të gjithë popujt e botës punojnë shumë që bujqësia dhe mbarështimi i kafshëve shtëpiake të arrijë në nivele të atilla që prej bujqësisë e blegtorisë së përparuar të përfitojë edhe zhvillimi teknik i arritur.

Nevoja për këto prodhime bazë të këtyre dy sektorëve të ekonomisë është kaq e rëndësishme, sa ka bërë që edhe një superfuqi si Rusia të shtrijë dorën e të bëjë disa lëshime politike ndaj shteteve që janë kundërshtarë të saj në rrafshin politik e

doktrinar, për shkak të nevojës së ngutshme që ka për këto prodhime!

Mësimet islame i japin një rëndësi shumë të madhe prodhimit blegtoral dhe bujqësisë, duke e nxitur këtë proces dhënës të mirash materiale të domosdoshme.

Ne pamë si e paraqitnin ajetet e mësipërme me fjalë të bukura lëvizjen e bagëtisë e dobisë e mëdha që vijnë prej tyre, ashtu siç pamë edhe stimulimin për mbarështimin e bagëtive.

Me lejen e All'llahut, në ajetet që do të vijnë më poshtë do të flitet edhe për rëndësinë e madhe të bujqësisë e të frutikulturës.

Prej burimeve të ndryshme, këtu do të sjellim disa transmetime që kanë të bëjnë me subjektin e studimit tonë dhe do të shikojmë se këto transmetime, rëndësinë e madhe të blegtorisë e të bujqësisë e shprehin me frazat më të bukura. Ja se si na njoftojnë këto transmetime:

1- Prej Ebù Xha'ferit (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë hallës së tij: "Ç'të pengon që të mos marrësh në shtëpinë tënde një begati?"

Ajo i tha: "O i Dërguar i All'llahut, ç'është kjo begati?"

Ai i tha: “Një bagëti që ta mjelësh, sepse ai që ka në shtëpinë e tij një bagëti mali, ose një lopë të egër, ose një dele, ose një lopë, të gjitha këto janë begati”.¹

2- Transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në lidhje me bagëtitë e imta ka thënë: “Sa pasuri e mirë që është delja!”.²

3- Në tefsirin “Nûruth Thekalejn”, në vijim të komentimit të ajeteve që kemi në studim, transmetohet se Prijësi i Besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Gjëja më e mirë që merr burri në shtëpinë e tij për familjen e vet është delja, kush ka një dele në shtëpinë e tij, në atë shtëpi vijnë engjëjt dy herë për çdo ditë”.

Nuk duhet të merret si shkujdesje fakti që shumë prej shtëpive të qyteteve nuk janë të përshtatshme për mbarëshkrimin e bagëtive, pasi qëllimi bazë në këto transmetime është që të theksohet rëndësia e prodhimit të vazhdueshëm të produkteve për të cilat kanë nevojë njerëzit. Prandaj, edhe ti mendo!

4- Për ne është e mjaftueshme fjala që ka thënë Prijësi i Besimtarëve Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me rëndësinë e bujqësisë: “Kush gjen ujë e tokë dhe mbetet i varfër, atë e largon All'Ilahu (prej mëshirës së Tij)”.³

Vetëkuptohet që ky transmetim flet për individin dhe njëherësh për mbarë popullin. Populli që edhe pse i ka të gjitha

¹ “Bihàrul Enuàr”, vëll. 64, f. 130; dhija në këtë transmetim është përmendur në shtesë të deles dhe lopës. Bëhet fjalë për lopën e egër, për bagëtitë e malit dhe për delen femër.

² “Bihàrul Enuàr”, vëll. 61, f. 129.

³ “Bihàrul Enuàr”, vëll. 97, f. 65.

kushtet e mjaftueshme për zhvillimin e bujqësisë, shtrin dorën të kërkojë ndihmë të tjerët, pa diskutim që ai është i larguar prej mëshirës së All'llahut.

5- Transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Keni detyrë të mbarështoni bagëtinë e të mbillni tokën, sepse që të dyja vijnë me të mira dhe janë ushqim i mirë”.¹

6- Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Tek All'llahu s'ka ndonjë punë më të dashur se bujqësia”.²

7- Së fundi, le të lexojmë transmetimin e ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), në të cilin ai ka thënë: “Fermëret janë thesaret e njerëzve, ata mbjellin të mirën që ka nxjerrë All'llahu i Plotpushtetshëm dhe Ditën e Gjykimit ata do të kenë vendin më të mirë, pozitën më të afërt dhe do të thirren me emrin begatuesit”.³

¹ “Bihàrul Enuàr”, vëll. 17, f. 41

² “Bihàrul Enuàr”, vëll. 17, f. 41.

³ “Vesàilush Shijah”, vëll. 13, f. 194.

Ajetet 9 - 13

﴿وَعَلَى اللَّهِ قَصْدُ السَّبِيلِ وَمِنْهَا جَائِرٌ وَلَوْ شَاءَ لَهَدَاكُمْ أَجْمَعِينَ ۚ هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً لَكُمْ مِنْهُ شَرَابٌ وَمِنْهُ شَجَرٌ فِيهِ تُسِيمُونَ ۚ يُنْبِتُ لَكُمْ بِهِ الزَّرْعَ وَالزَّيْتُونَ وَالنَّخِيلَ وَالْأَعْنَابَ وَمِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ۝ وَسَخَّرَ لَكُمْ الَّيْلَ وَالنَّهَارَ وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٌ بِأَمْرِهِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ۝ وَمَا ذَرَأَ لَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِقَوْمٍ يَذَّكَّرُونَ ۝﴾

“Udhëzimi në rrugën e drejtë i takon All’llahut, ka edhe rrugë të shtrembër; sikur Ai të dëshironte, të gjithë do t’i kishte udhëzuar në rrugën e drejtë.”

“Ai për ju e lëshon ujin nga qielli, që ju të pini prej atij uji dhe po prej atij uji të keni bimësi që të kullotni (bagëtinë).”

“Falë tij (shiut) mbijnë për të mirën tuaj të mbjellat, ullalet, ullalet, hurmat e hardhitë dhe të gjitha frutat; në këto (mirësi) ka argumente për ata që mendojnë.”

“Për ju, Ai nënshtroi (vuri në dispozicionin tuaj) natën, ditën, diellin e hënën; edhe yjet janë të nënshtuara me urdhrin e Tij;

në të vërtetë, në të gjitha këto ka argumente për ata që logjikojnë.”

“Edhe në llojet e ndryshme që Ai krijoi në tokë (bagëti, bimë, pemë, minerale etj.), ka argumente për ata që dinë të kujtohen.”

Komentimi

Çdo gjë është në shërbim të njeriut

Pasi u përmendën mirësitë e ndryshme në ajetet e mësipërme, këto ajete e vënë theksin mbi mirësi të tjera. Në radhë të parë flasin për mirësitë e larta morale, kur theksojnë: **“Udhëzimi në rrugën e drejtë i takon All’Ilahut”**, do të thotë se vetëm i Plotpushtetshmi udhëzon në rrugën e shpëtimit dhe vetëm Ai është Ruajtësi i kësaj rruge prej çdo lloj devijimi, rrugë të cilën Ai e ka vënë që të jetë në dorën e njeriut.

Në tekstin e Kur’anit, udhëzimi në rrugën e drejtë ka ardhur me fjalën *“kasdus’sebijli”* në kuptimin rrugë e drejtë, në të cilën s’ka as shkarje në rrugën e humbjes, as devijim e reformim. Por, cila anë e rrugës së drejtë është qëllimi këtu: ana e formimit apo ana ligjore?

Në lidhje me këtë çështje, interpretuesit e Kur’anit Famëlartë kanë mendime të ndryshme, megjithëse s’ka asgjë që e ndalon trajtimin e të dyja anëve së bashku.

Sqarim: All'llahu e ka pajisur njeriun me fuqi të shumëllojshme dhe i ka dhënë atij fuqi e mundësi të ndryshme që e ndihmojnë në rrugën e tij drejt plotësimit, domethënë në realizimin e qëllimit për të cilin u krijua.

Edhe te krijesat e tjera janë depozituar fuqi e instinkte që i çojnë ato drejt qëllimit që kanë, por njeriu dallon mbi krijesat e tjera sepse është i pajisur me lirinë e zgjedhjes e me vullnetin për të arritur atë çka ai dëshiron të arrijë. Pikërisht, për këtë arsye s'ka analogji në boshtin vertikal të plotësimit e të njeriut në krahasim me gjallesat e tjera.

All'llahu i ka dhuruar njeriut mendjen, kapacitete të shumta e të gjitha forcat me të cilat ai është formuar. Janë këto forca që e ndihmojnë njeriun të ecë në rrugën e drejtë.

Gjithashtu, All'llahu për njeriun ka dërguar Profetët dhe Revelatën qiellore, i ka dhënë atij mësimet e mjaftueshme dhe ligjet e domosdoshme për të ecur në përputhje me ligjin e All'llahut dhe për të mos shkuar në rrugët e devijuara e të gabuara.

Vetë metoda e bukur e Kur'anit e ka bërë udhëzimin e njeriut në rrugën e drejtë të përmendur më sipër në ajetin që kemi në studim, obligim mbi vetë të Plotfuqishmin, kur Ai thotë "*alell'illâhi*" - *detyrim mbi All'llahun* - duke shtuar se këtë frazë e gjejmë në shumë ajete të Kur'anit, si për shembull në ajetin 12 të sures "El Lejl": "*in'ne alejnel hudâ*" - *udhëzimi në rrugën e drejtë është detyrë mbi Ne*. Sikur të vështrojmë në qëllimin e kuptimit të frazës së ajetit "*kasdus'sebijli*" - *udhëzimi në rrugën e drejtë* - do të thotë ato forca që All'llahu ka depozituar në njeriun prej formimit të tij në rrugën e drejtë e në rrugën e ligjshmërisë. Pikërisht për këtë, ne arrijmë

madhështinë e kësaj mirësie dhe të gjitha virtytet që janë në këtë mirësi të madhe. Më pas, Filluesi i Lartësuar e paralajmëron njeriun se ka edhe shumë rrugë të devijuara dhe thotë: *“ue minhà xhàirun”* - ka edhe rrugë të shtrembër.

Mirësia e vullnetit dhe liria e zgjedhjes te njeriu është prej faktorëve plotësues më të rëndësishëm te njeriu. Këtë ajeti e thekson me një fjali fare të shkurtër: **“Sikur Ai të dëshironte, të gjithë do t’i kishte udhëzuar në rrugën e drejtë”** dhe ata nuk do të kishin mundësi tjetër, përveçse të realizojnë qëllimin e All’llahut.

Por i Larti nuk vepron kështu, sepse udhëzimi i imponuar për në rrugën e drejtë, nuk mund të lartësohet së bashku me njeriun në shkallët e plotësimit e të krenarisë. Prandaj, All’llahu i ka dhënë njeriut lirinë që ai të zgjedhë vetë rrugën mbi të cilën ai dëshiron të ecë, për të arritur në lartësitë më mëdha të plotësimit që ka mundësi të arrijë.

Gjithashtu, ajeti thekson edhe një të vërtetë tjetër: rruga e gabuar dhe rruga e shtrembër që zgjedhin disa për veten, nuk do të thotë që dikush të ketë iluzione se All’llahu i Plotpushtetshëm është mposhtur para këtyre personave, në të kundërt, vullneti e urtësia e Tij kërkojnë që njeriu të jetë i lirë të zgjedhë rrugën që dëshiron të ndjekë.

Ajeti vijues rikthehet në anën lëndore që lind te njerëzit ndjenjën e falënderimit për Mirësidhënësin dhe që ndez në zemrat e tyre dritën e dashurisë për All’llahun, duke u bërë atyre thirrje që të afrohen sa më shumë tek All’llahu, sepse vetëm kështu do ta njohin edhe më mirë Mirësidhënësin e vërtetë. Për këtë ajeti thotë: **“Ai për ju e lëshon ujin nga qielli”**, uji që është shkak i jetës, është

burim jete, është i pastër nga të gjitha papastërtitë. Ajeti vijon: **“dhe prej atij uji keni ujin që pini”**; ajeti vazhdon të përmendë mirësinë e madhe të ujit dhe thotë: **“dhe po prej atij uji të keni bimësi që të kullotni** (bagëtinë)”.

Togfalëshi foljor *“të keni bimësi”*, në tekstin e Kur’anit ka ardhur me foljen *“tesijmùne”* në kuptimin se kafshët, siç dihet, përfitojnë prej bimësisë e prej gjetheve të pemëve; kurse fjala e tekstit të Kur’anit *“esh’shexheru”* - *pemë* - nga ana gjuhësore ka një kuptim shumë më të gjerë dhe përfshin pemët e të gjitha bimët.

Pa dyshim që edhe shiu nuk është më pak i rëndësishëm, pasi prej ujit të shiut, njeriu merr ujin e pijshëm dhe vadit me të bimët. Përveç kësaj, ka edhe dobi të tjera, si: shiu pastron tokën e ajrin, prej tij krijohet lagështia e duhur për të mbajtur të butë lëkurën e trupit të njeriut dhe pastërtia që fiton ajri prej shiut, bën që njeriu të marrë frymë qetësisht. Gjithashtu, njeriu e mjedisi kanë përfitime të tjera prej shiut, të cilat përmenden në ajetin e nderuar dhe që nuk janë më pak të rëndësishme.

I Larti e plotëson fjalën e Tij dhe thotë: **“Falë tij (shiut) mbijnë për të mirën tuaj të mbjellat, ullinjtë, hurmat e hardhitë dhe të gjitha frutat”**.

Pa dyshim që krijimi i këtyre frutave të ndryshme dhe i të gjitha prodhimeve bujqësore që ekzistojnë është një argument për ata që vështrojnë, ashtu si thotë vetë ajeti i nderuar: **“në këto (mirësi) ka argumente për ata që mendojnë”**.

Fjala e ajetit *“ez’zer’a”* - *të mbjellat* - përfshin të gjitha bimët që kultivohen për të siguruar bukën, kurse fjala e ajetit *“uez’zejtùne”*

- *edhe ullinjë* – dihet që është emri i përveçëm për bimën që jep frutën shumë dobiprurëse të ullirit.

Është fakt se disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se me fjalën "*ez'zejtùn*" - *ulliri* - qëllimi është vetëm për drurin e ullirit, kurse fjala e arabishtes "*zejtuneh*" është në kuptimin e frutës së ullirit. Mirëpo, në ajetin 53 të sures "En Nùr", fjala "*zejtuneh*" është thënë për vetë pemën e ullirit.

Në vijim edhe fjala "*en'nakhijl*" - *hurma e Arabisë* – përdoret për njëjësin dhe për shumësin e kësaj fjale; kurse fjala e ajetit "*el aënàb*", është shumësi i fjalës *rrush*.

Këtu na lind pyetja: përse Kur'ani ka parapëlqyer të përmendë vetëm këto lloje frutash dhe s'ka përmendur frutat e tjera, përse është kufizuar të përmendë vetëm ullirin, hurmën e rrushin? Me lejen e All'Ilahut, shpjegim më të qartë për këtë pyetje do të lexojmë në studimet rreth interpretimit të këtij ajeti.

Më pas, mirësitë që ekzistojnë dhe që janë vënë në shërbim të njeriut, ajeti i nderuar i thekson me fjalën e Tij të shenjtë: **"Për ju Ai nënshtroi (vuri në dispozicionin tuaj) natën, ditën, diellin e hënën; edhe yjet janë të nënshtruara me urdhrin e Tij; në të vërtetë, në të gjitha këto ka argumente për ata që logjikojnë"**. Të gjitha këto mirësi tregojnë madhështinë e fuqinë e All'Ilahut të Lartësuar dhe madhështinë e gjithçkaje që Ai ka krijuar.

Në lidhje me kuptimin konkret të vënies në dispozicion të njeriut të të gjitha krijesave, ne thamë gjatë interpretimit të sures "Ibràhim" dhe të sures "Err Rrad", se të gjitha ato janë në dobi të njeriut. Kjo realizohet prej natyrës së këtyre mirësive e nëpërmjet

punës që kryen njeriu me anë të këtyre gjërave, krahas mundësisë që ka për të përfituar prej tyre.

Dielli, hëna, nata, dita, yjet, të gjitha kanë një lloj efekti të veçantë në jetën e njeriut dhe që janë shprehur aq bukur në frazën: (vënia e sendeve në dispozicion të njeriut bëhet me urdhër të All'Ilahut), duke shtuar se me këtë vënie në dispozicion, në këndvështrimin e Islamit e të Kur'anit, del në shesh respekti e nderimi i veçantë për njeriun si person. Përveç kësaj, dhënia e kësaj fuqie e bën njeriun të aftë të meritojë gradën që i është dhënë, që ai të jetë mëkëmbës i All'Ilahut në tokë; njëkohësisht kjo i kujton njeriut që ai të mos jetë i shkujdesur ndaj mirësive të mëdha që All'Ilahu i ka dhënë. Në të vërtetë, të gjitha këto mirësi janë një motiv shtytës për ndjenjat e njeriut që ai ta falënderojë All'Ilahun e Lartësuar nëpërmjet gjërave që ai i prek e i shikon me sytë e tij. Falë këtij falënderimi, njeriu afrohet më shumë te Krijuesi i tij dhe shpreson të arrijë vendin më të nderuar në Botën e Ardhsme.

Për të gjitha këto, në fund të ajetit të nderuar, All'Ilahu thotë: **“në të vërtetë në të gjitha këto ka argumente për ata që logjikojnë”**.

Referohu në interpretimin tonë tek ajetet 32 dhe 33 të sures “Ibrâhim”, që të marrësh më shumë njoftim në lidhje me sekretet e vënies së gjërave në dispozicion të njeriut, që u përmend më sipër.

Përveç asaj që u tha më lart, theksojmë se fjala e ajetit: **“Edhe në llojet e ndryshme që Ai krijoi në tokë”**, domethënë krijesat që Ai i ka vënë në dispozicionin tuaj o njerëz, kurse me fjalën **“llojet e ndryshme”**, përfshihen të gjitha sendet e gjërat prej të cilave njeriu përfiton, si shtroje e mbuloje, rroba, ushqime, gra të ndershme, mjete që sigurojnë jetesë të mirë, deri edhe metalet e thesaret e

tokës, si dhe të gjitha mirësitë e tjera dhe, në të gjitha këto: **“në këto ka argumente për ata që dinë të kujtohen”**.

Hulumtime

1- Mirësitë materiale dhe morale

Ajetet e mësipërme janë në vetvete një burim studimi, pasi ato i përmendin mirësitë materiale dhe morale në mënyrë të lidhur e të pandashme nga njëra-tjera. Megjithëkëtë, mënyra dhe elokuenca e shprehjes është ndryshe kur përmenden mirësitë materiale dhe ndryshe kur përmenden mirësitë morale. Në lidhje me mirësitë materiale nuk gjejmë që në Kur'anin Famëlartë të thuhet: (Furnizimi juaj me ushqim është detyrë e All'Ilahut), kurse në lidhje me udhëzimin në rrugën e drejtë, All'Ilahu thotë: **“Udhëzimi në rrugën e drejtë i takon All'Ilahut”**. Pra, All'Ilahu u jep ju o njerëz çdo gjë për të cilën keni nevojë, nga ana e krijimit dhe nga ana ligjore, që të ecni të ekuilibruar në rrugën e caktuar prej Tij!

Kur Kur'ani flet për krijimin e pemëve e të frutave ose për vënien e diellit e hënës në dispozicion të njeriut, thotë se i Plotpushtetshmi i ka vënë ato në dispozicion të njeriut në vazhden e qëllimit moral: **“në këto ka argumente për ata që dinë të kujtohen”**. Frazja e ajetit ka ardhur në këtë formë sepse siç dihet, metoda e shtrimit kur'anor të fakteve në bashkëbisedim e drejtpërdrejtë me njerëzit, nuk ka vetëm një dimension.

2- Përse ulliri, hurma e rrushi dhe jo frutat e tjera:

Në pamjen e parë, ajeti që kemi në studim na mundëson të fiksojmë në mendje se përmendja e ullirit, e hurmës dhe e rrushit në ajetin e nderuar të Kur'anit Famëllartë tregon se këto fruta gjendeshin në zonën ku është zbritur Kur'ani. Por në këndvështrimin e anës globale të mesazhit kur'anor, krahas besimit se mesazhi kur'anor është i qëndrueshëm, konstatohet edhe orientimi për të shikuar në thellësi të shprehjes, atëherë për ne bëhet e qartë sa i gabuar ishte përfytyrimi ynë i parë.

Dijetarët e specializuar në fushën e ushqimeve (prej atyre që kanë shpenzuar vite të shumta në studimet e tyre në lidhje me dobitë e veçantitë e ushqimeve), kanë thënë se nga ana ushqimore, shumë pak fruta i sjellin trupit të njeriut dobi të atij niveli që i sjellin tri frutat e lartpërmendura në ajetin e nderuar.

Këta dijetarë thonë: “Vaji i ullirit ka vlera shumë të larta për të siguruar kaloritë e nevojshme në trupin e njeriut dhe pikërisht për këtë arsye konsiderohet prej ushqimeve që e forcojnë trupin, prandaj të gjithë ata që duan të ruajnë shëndetin e tyre, kanë detyrë të vazhdojnë të marrin këtë eliksir të çmuar”.

Vaji i ullirit është shumë i përshtatshëm për mëlçinë e njeriut, ka shumë efekt në largimin e anomalive të veshkave dhe mban të buta kanalet urinare dhe ato të mëlçisë.

Për të gjitha këto, në transmetimet islame gjejmë shumë fjalë lavdëruese për vajin e ullirit. Në një njoftim të transmetuar prej Ali bin Mûsà Err Rridà (*Paqja qoftë mbi të!*) ai ka thënë për të: “Sa ushqim i mirë është vaji i ullirit, është i shijshëm, heq gëllezën,

qartëson ngjyrën e lëkurës, forcon nervat, largon sëmundjet kronike dhe shuan zemërimin”.¹

Përveç kësaj, vetë Kur’ani Famëlartë e ka cilësuar pemën e ullirit me fjalën *“Esh’shexheretul mubàrekeh”* - pema e uruar.

Edhe në lidhje me frutën e hurmës, transmetimet islame vërtetojnë dy cilësi tepër të rëndësishme të saj: cilësinë shëruese dhe atë ushqyese. Madje këto cilësi të hurmës i kanë vërtetuar edhe shkencëtarët, të cilët në frutën e hurmës kanë bërë të qartë praninë e kalciumit, këtij elementi kryesor për ndërtimin dhe forcimin e kockave. Gjithashtu, hurma përmban edhe fosfor, i cili konsiderohet prej elementeve bazë në formimin e trurit, duke shtuar se fruta e hurmës ndalon dobësimin e nervave dhe heq lodhjen, si dhe luan rol në mprehtësinë e shikimit.

Hurma përmban edhe potas, element shumë i rëndësishëm në ndërtimin e qelizave të trupit, mungesa e këtij elementi shkakton ulcerën e stomakut.

Në mesin e specialistëve të shkencës së ushqimeve është bërë e njohur se fruta e hurmës luan rol për mosprekjen e njeriut nga sëmundja e kancerit.

Statistikat tregojnë qartë se rajonet ku hurma përdoret me shumicë janë rajonet me më pak të prekur prej kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse. Këtu duhet kërkuar edhe shkaku pse banorët e shkretëtirës, të cilët kanë mungesa në ushqime dhe hurmën si ushqim bazë, preken shumë pak nga sëmundja e kancerit.

¹ “El Bihâr”, vëll. 66, f. 183.

Shkencëtarët kanë zbuluar se fruta e hurmës përmban edhe magnez.

Edhe sheqeri që gjendet te hurma është prej llojit më të mirë, madje nuk shkakton probleme shëndetësore as te personat që vuajnë nga sëmundja e sheqerit (diabetikët).

Deri tani, shkencëtarët kanë zbuluar te fruta e hurmës dhjetë lëndë jetësore dhe pesë lloje vitaminash, çka e bën atë një burim ushqimi me vlera shumë të larta.¹

Edhe në transmetimet e ardhura theksohet në veçanti rëndësia e madhe e hurmës si lëndë ushqyese. Transmetohet se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Haje frutën e hurmës, sepse në atë ka shërim prej sëmundjeve”.

Gjithashtu transmetohet se ushqimi që merrte më shumë Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte buka dhe hurma.

Në një transmetim tjetër, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në atë shtëpi që s’ka hurma, njerëzit e saj janë të uritur”.²

Në suren “Merjem” mësojmë se All’Ilahu i Lartësuar e ushqeui Merjemen kur ajo lindi Isanë (*Paqja qoftë mbi të!*) me hurma të buta, çka tregon se hurma është ushqimi më i mirë për gruan lehonë. Gjithashtu, këtë fakt e vërtetojnë edhe transmetimet e ardhura në lidhje me interpretimin e këtij ajeti dhe që vërtetojnë se

¹ “Ev’velu xhàmiatin ue àkharu nebij’jin”, vëll. 7. Ky vëllim shpjegon kryesisht veçoritë ushqyese, shëndetësore dhe mjekuese të hurmës e të rrushit. Aty mund të merret informacion për rëndësinë e madhe të këtyre dy frutave.

² “Sefijnetul Bihâr”, vëll. 1, f. 124.

hurma është ushqimi më i mirë për gruan që sapo ka lindur fëmijën.¹

Shkencëtarët e fushës së ushqimeve kanë theksuar rëndësinë e madhe të rrushit dhe dobitë e shumta që ka si lëndë ushqyese, aq sa ne mund të themi se rrushi është një farmaci natyrale e kompletuar.

Përveç kësaj, veçoritë e rrushit janë të ngjashme me veçoritë e qumështit të nënës, domethënë se edhe rrushi është një ushqim i kompletuar. Madje, dobia që vjen nga ngrënia e rrushit, është disa fish më e madhe se dobia që vjen nga ngrënia e mishit: rrushi është lëndë ushqyese me kalori të larta, rezistent kundër helmeve dhe ka një efekt të pakundërshtueshëm në pastrimin e gjakut, përmban elemente profilaktike ndaj reumatizmit e sëmundjes së kyçeve të këmbës; shton gjakun, pastron stomakun e zorrët, rrit aktivitetin dhe heq lodhjen, forcon nervat dhe përmban vitamina të ndryshe të domosdoshme për forcimin e organizmit.

Përveç faktit që rrushi është ushqyes shumë i rëndësishëm, ai ka fuqi të madhe për të luftuar mikrobet në një shkallë mjaft të ndjeshme. Pikërisht për këtë është konsideruar prej ushqimeve të rëndësishme që luftojnë sëmundjen e kancerit dhe si ilaç profilaktik kundër kësaj sëmundjeje.²

Transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Ushqimi juaj më i mirë është buka dhe fruta juaj më e mirë është rrushi".³

¹ "Sefijnetul Bihâr", vëll. 1, f. 124.

² "Ev' velu xhâmiatin ue âkharu nebij'jin", vëll. 7.

³ "El Islâmu tabijbun bilâ devâin" – Islami është mjek pa barna.

Nëse do të përmendnim gjithçka që kanë thënë shkencëtarët e fushës së ushqimeve në lidhje me veçoritë e këtyre tri frutave dhe nëse do të bashkonim edhe transmetimet e ardhura në lidhje me lëndët që përmbajnë këto tri fruta, me siguri që do të dalim prej natyrës së interpretimit të Kur'anit. Por qëllimi ynë me këtë zgjatje ishte vetëm që të shpjegojmë sa më qartë shkakun e mirëfilltë shkencor në përmendjen e këtyre tri frutave në ajetin e nderuar që kemi në studim. Ka të ngjarë që dobitë e shumta që përmend ajeti, nuk ishin të njohura për njerëzit në kohën kur është zbritur ky ajet.

3- Të menduarit, të logjikuarit dhe të kujtuarit

Në ajetet objekt studimi pamë se Kur'ani pasi përmend tri lloje të mirësive të All'llahut, u bën thirrje njerëzve të mendojnë për mirësinë e llojit të parë dhe thotë: **“Në të vërtetë, në të gjitha këto ka argumente për ata që mendojnë”**. Për mirësinë e llojit të dytë, ajeti thotë: **“për ata që logjikojnë”** dhe për mirësinë e llojit të tretë thotë: **“për ata që kujtohen”** - nga këto mirësi kujtohen të falënderojnë All'llahun.

Ndryshimi në shprehjet e Kur'anit nuk është për efekt artistik, pasi metoda e Kur'anit është të theksojë çdo mirësi me një cilësim të veçantë.

Qëllimi me këtë mënyrë paraqitjeje mund të jetë se mirësitë e All'llahut që gjenden në tokë janë aq të qarta e aq të shumta, sa është e pamundur të përmenden të gjitha.

Për sa u përket të lashtave, ullirit, hurmës, rrushit dhe frutave është i domosdoshëm përqendrimi e mendimi mbi këto

mirësi, që të mësohen veçoritë ushqyese e shëruese të tyre. Pikërisht në rëndësinë e këtyre mirësive për njeriun duhet parë edhe qëllimi që folja kalimtare *"jetefek'kerùn"*, *mendohen*, në ajetin e nderuar ka ardhur në mënyrën që në gjuhën arabetregon përqendrim të mendimit në këto mirësi.

Kurse çështja e vënies së diellit, hënës, natës e ditës në dispozicion të njeriut ka nevojë për një mendim më të përqendruar e më të thellë se në rastin e parë, prandaj është shprehur me foljen *"jeakilùn"* - *logjikojnë*.

Në të gjitha rastet, Kur'ani Famëlartë gjithmonë u flet në vetën e dytë dijetarëve, mendimtarëve dhe të mençurve, pavarësisht se mjedisi ku është zbritur Kur'ani ishte i rrethuar nga injoranca më e madhe që mund të mendohet, por pikërisht këtu për ne del në dukje madhështia e Kur'anit me qartësinë më të madhe.

Kur'ani Famëlartë me përmbajtjen e tij është një goditje fatale për njerëzit me horizont të ngushtë, që refuzuan të gjitha fetë dhe parapëlqyen të mbeten në fetë mitike, fe të ndërtuara mbi themelet e mitologjisë. Mbi këto themele, ata ngritën ndërtesën e konsideratave të tyre të lëkundshme, derisa arritën të deklarojnë se feja zhvlerëson mendjen e diturinë dhe se besimi në All'llahun e Gjithëpushtetshëm është prodhim i injorancës dhe i pafuqisë së njeriut!

Të këtilla thirrje Hyjnore si ato që u përmendëm më sipër, gjejmë në të gjitha suret e Kur'anit Famëlartë dhe janë këto thirrje që na flasin me qartësi të plotë se feja e vërtetë është rezultat i ardhur prej të logjikuarit dhe nuk është as pjellë e fantazisë së sëmure dhe as ka ardhur prej errësirës së injorancës.

Mesazhi islam vazhdimisht u drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm dijetarëve e njerëzve të mençur dhe jo injorantëve, mbartësve të miteve e legjendave të rreme apo pseudointelektualëve.

Ajetet 14 - 18

﴿وَهُوَ الَّذِي سَخَّرَ الْبَحْرَ لِتَأْكُلُوا مِنْهُ لَحْمًا طَرِيًّا وَتَسْتَخْرِجُوا مِنْهُ حِلْيَةً تَلْبَسُونَهَا وَتَرَى الْفُلْكَ مَوَاجِرَ فِيهِ وَلِتَبْتَغُوا مِنْ فَضْلِهِ وَلِعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ﴾^{١٤} وَأَلْقَى فِي الْأَرْضِ رَوَاسِيَ أَنْ تَمِيدَ بِكُمْ وَأَنْهَارًا وَسُبُلًا لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ^{١٥} وَعَلَامَاتٍ وَبِالنَّجْمِ هُمْ يَهْتَدُونَ^{١٦} أَفَمَنْ يَخْلُقُ كَمَنْ لَا يَخْلُقُ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ^{١٧} وَإِنْ تَعُدُّوا نِعْمَةَ اللَّهِ لَا تُحْصُوهَا إِنَّ اللَّهَ لَغَفُورٌ رَحِيمٌ^{١٨}﴾

“Ai e nënshtroi detin që prej tij të hani mish të freskët dhe prej tij nxirrni stoli që ju i mbani (vishni); në det shikon anijet (të lundrojnë) që ju të arrini begatitë e Tij dhe kështu të falënderoni (All’Ilahun).”

“Në tokë Ai vuri male që ajo të mos lëkundet me ju, (vuri) edhe lumenj e rrugë që ju të orientoheni.”

“(Vuri) Edhe shenja të tjera (për orientim ditën), ndërsa (natën), ata orientohen me anën e yjeve.”

“Ai që krijon është si ai që nuk krijon, a nuk po meditoni?”

“Nëse do të (përpiqeshit) numëroni mirësitë e All’llahut, nuk do të arrinit t’i numëroni dot; me të vërtetë vetëm All’llahu është shumë Falës e Mëshirëplotë.”

Komentimi

Mirësia e maleve, e deteve dhe e yjeve

Këto ajete shpjegojnë një pjesë tjetër prej mirësive të përcaktuara me të cilat All’llahu e ka privilegjuar njeriun. Kur’ani Famëlartë fillon me përmendjen e deteve, këtij burimi thelbësor për jetën dhe thotë: **“Ai e nënshtroi detin”**.

Dihet se detet zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së globit, gjithashtu se uji është baza e jetës, prandaj detet konsiderohen burim shumë i rëndësishëm për vazhdimësinë e jetës së njerëzve dhe të të gjitha qenieve të gjalla që gjenden në të gjitha anët e globit.

Sa mirësi e madhe është që detet janë vënë në shërbim të njeriut!

Më pas, Filluesi (i krijimit të të gjitha sendeve), të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s’ka nevojë për asnjë send, thekson tri lloje prej mirësive të deteve dhe thotë: **“që prej tij të hani mish të freskët”**. All’llahu i Lartësuar ka bërë që në dete të ketë mish prej të cilit të hajë njeriu pa derdhur as mundin më të vogël për mbarështimin tij, pasi ai mish është mirësi e dhënë prej fuqisë së All’llahut. Madje, i

Larti këtë mish e përshkruar me cilësinë *"të freskët"*, nëse do të marrim parasysh se mishrat jo të freskëta në atë kohë ishin me bollëk dhe janë me bollëk edhe në ditët e sotme, thuhet janë në mënyrë të barabartë. Prandaj, ne e kuptojmë fare mirë rëndësinë e madhe të kësaj mirësie të All'Ilahut; gjithashtu, ajeti thekson edhe rëndësinë e madhe të mishrave të freskëta.

Krahas zhvillimit e përparimit që ka arritur jeta e njerëzve në fushën e qytetërimit në të gjitha fushat e jetës, deti vazhdon të mbetet njëri prej burimeve kryesore për ushqimin e njeriut, pasi çdo vit aty gjuhen mijëra e mijëra tonelatë peshk i freskët, të cilin All'Ilahu i Lartësuar, nga kujdesi i madh që ka për njeriun, e ka vënë në dispozicion të njeriut.

Nuk është rastësi kur shikojmë se vëmendja e shkencëtarëve bashkëkohës është orientuar te detet për të përballuar kërcënimin që i vjen njerëzimit prej rrezikut të mungesës së lëndëve ushqyese në të ardhmen, për shkak të shtimit të madh të popullatës. Prandaj, shkencëtarët shpresojnë që falë mirësisë së deteve të plotësojnë një pjesë të ndjeshme të kësaj mangësie me anë të mbarështimit të llojeve të shumta të peshqve.

Nga ana tjetër, shkencëtarët kanë vënë disa rregulla e kufij për të ndaluar ndotjen e ujërave të deteve, me qëllim që të mos asgjësohen kafshët e detit. Të gjitha këto na e bëjnë më të qartë rëndësinë e çështjeve shkencore të shtruuara si detyrë për njerëzimin, të theksuara në ajetin e nderuar që përpara katërmbëdhjetë shekujsh.

Gjithashtu prej dobive që ka njeriu prej deteve janë edhe stolitë që nxjerr prej fundit të detit, të cilat ajeti i thekson me fjalën: **“dhe prej tij nxirrni stoli që ju i mbani”**.

Ndjenja për të bukurën është prej gjërave me të cilat është krijuar njeriu dhe një shtytës për ndjenjat ndaj të gjitha llojeve e formave të artit original që gjenden te njeriu.

S’ka dyshim se ky dimension që i është dhënë njeriut, luan një rol tepër të rëndësishëm në jetën njerëzore dhe është detyrë të punohet që ky dimension te njeriu të ngopet në rrugën e drejtë e të shëndoshë, larg çdo lloj ekstravagance, shkujdesjeje e keqpërdorimi.

S’ka asnjë dallim në rezultatin mes atij që është zhytur në adhurimin e së bukurës e të rehatisë dhe mes atij që i anashkalon këto dhe jeton në gjendje amullie. I pari ka praktikuar ekstravagancën si motiv për të konsumuar kapitalin e tij dhe është bërë shkak për vendosjen e ndarjeve klasore që shoqërojnë këtë gjendje, e cila nga ana e saj vret të gjitha gjërat që s’kanë lidhje me moralin; kurse i dyti ka praktikuar neglizhencën në të gjitha drejtmet, mirëpo kjo gjendje bëhet një motiv për të qëndruar në gjendje amullie. Gjithsesi, si i pari, ashtu edhe i dyti kanë bërë një punë që nuk duhet ta bëjë askush që ka qoftë edhe një pikë të vetme të shëndoshë prej dimensioneve të ndjenjës për të bukurën.

Pikërisht për këtë, Islami e porosit kaq shumë stolisjen e arsyeshme e jashtë çdo lloj teprimi, si për shembull veshja e rrobave të mira, parfumimi, përdorimi i gurëve të çmuar etj.

Më pas, ajeti i nderuar i Kur’anit Famëlartë trajton dobinë e tretë të deteve: lëvizjen e anijeve mbi sipërfaqen e ujërave të deteve

si mjete shumë të rëndësishme për të transportuar njeriun dhe të gjitha gjërat për të cilat ai ka nevojë dhe thotë: **“në det shikon anijet (të lundrojnë)”**. Sa gjëra të bukura shikojnë ata që kanë hipur në anije kur ajo lëviz mbi sipërfaqen e ujërave të deteve e të oqeanëve.

All'llahu i Lartësuar ua ka dhënë këtë mirësi të madhe që ju të përfitoni në punët e tregtisë dhe ajeti i nderuar vazhdon: **“që ju të arrini begatitë e Tij”**.¹

Pas përmendjes së këtyre mirësive, të cilat e obligojnë njeriun e mençur të falënderojë Dhuruesin e këtyre mirësive, në fundin e ajetit thuhet: **“dhe kështu të falënderoni (All'llahun)”**.

Fjala *“el fulku”* do të thotë *anija*, në ajetin e nderuar në gjuhën e arabetregon numrin njëjës dhe shumës të kësaj fjale.

Kurse fjala *“meuàkhire”* është shumësi i fjalës *“màkhireh”* në kuptimin e çarjes së ujit djathtas e majtas. Gjithashtu, kjo fjalë në këtë formë ka kuptimin uturimës së fortë të erës, duke pasur parasysh që anija e çan ujin me pjesën e saj të përparme, në gjuhën arabethirret edhe me emerin *“el màkhiru”* ose *“el màkhireh”*, hundëse.

Pyetje: Kush i ka dhënë materialet me të cilat punohen anijet me cilësinë që të qëndrojnë mbi sipërfaqen e ujit?

¹ Frazja *“ue litebtægù min fadlihi”* fillon me lidhësen *“ue”* - edhe - e cila duke qenë përpara fjalës, sipas rregullave të gjuhës arabishte, i jep përparësi fjalës që është përpara lidhëses. Në ajetin që kemi në studim, rëndësia e asaj fjale është përcaktuar me qartësinë më të madhe. Duke u folur njerëzve në vetën e dytë u thotë që ju të përfitoni prej vetë detit dhe të përfitoni edhe prej mirësive të tij.

Anija me ngarkesën që mban është shumë më e rëndë se uji. A do të kishin mundësi të qëndronim mbi sipërfaqen e ujërave, nëse uji nuk do të kishte këtë forcë shtytëse?

Kush i lëviz erërat mbi sipërfaqen e detit?

Edhe më tepër, kush i dha avullit fuqinë për të vënë në lëvizje anijen në udhëtimin e saj mbi sipërfaqen e ujit?

A nuk janë të gjitha këto prej mirësive të All'llahut të Lartësuar?

Ajo që e nxjerr në dukje më shumë mirësinë e deteve është fakti se detet janë rrugë shumë më të gjëra se rrugët tokësore, shumë më pak të kushtueshme dhe shumë më të volitshme për lëvizjen e mjeteve transportuese të mëdha. Të gjitha këto mirësi që ka njeriu prej deteve konstatohen me lehtësi kur vështrojmë anijet e mëdha që janë përdorur e përdoren, si dhe ngarkesat e përmasave të mëdha që mbartin ato.

Në vijim, në ajetin e nderuar, pas paraqitjes së dobive të deteve, flitet për malet: **“Në tokë Ai vuri male që ajo të mos lëkundet me ju”**.¹

Në të vërtetë, malet janë të lidhura me rrënjët e tyre, nga të cilat ato ngrihen lart dhe jo vetëm që e bëjnë tokën të qëndrueshme, por janë një pengesë shumë e madhe ndaj dridhjeve të forta që shkaktohen në tokë prej trysnisë së gazeve që gjenden në brendësi të tokës. Shkenca ka shpjeguar se gazet që tentojnë të dalin në

¹ Nga këndvështrimi se njerëzit nuk duan që toka të lëkundet nën këmbët e tyre.

sipërfaqen e tokës, janë një kërcënim real dhe janë këto gaze që shkaktojnë tërmetet.

Duhet theksuar edhe veçoria e maleve në shtimin e fuqisë së kores së tokës me rezistencën e duhur kundrejt forcës tërheqëse të hënës (forcë që manifestohet në dukurinë e baticë-zbaticës). Përsëri janë malet ato që e pakësojnë efektin e kësaj force tërheqëse.

Parë nga një anë e tretë, malet janë një barrierë shumë e fortë ndaj furisë së madhe të erërave; përveç kësaj mirësie, ato orientojnë edhe lëvizjen e erërave. Nëse nuk do të ishin malet, sipërfaqja e tokës do të ishte vazhdimisht e ekspozuar ndaj stuhive të fuqishme.

Më pas, Kur'ani Famëllartë flet drejtpërdrejt për mirësinë e lumenjve, si dhe për lidhjet mes maleve e lumenjve, në atë mënyrë që malet konsiderohen depozitat bazë të ujërave dhe thotë: **“edhe lumenj”**.¹

Kjo çështje me të vërtetë tërheq vëmendjen, pasi në luginat e lumenjve gjejmë rrugë nëpër të cilat njeriu kalon gjatë lëvizjeve të tij nga njëri vend në një vend tjetër nëpër të gjitha vargmalet e botës dhe, falë luginave të lumenjve, vetëm pak krahina janë të ndara nga njëra-tjetra.

Në vijim, ajeti i nderuar thotë **“edhe shenja të tjera”**. Nga kjo fjalë e ajetit del qartë se rrugët pa shenja dhe karakteristika dalluese nuk i mundësojnë njeriut të arrijë qëllimin e tij. Falë atyre

¹ Ky ajet konsiderohet prej mrekullive të Kur'anit Famëllartë, pasi kjo dukuri shkencore është përmendur që në kohën kur njeriu nuk kishte arritur ende në fazën e zbulimeve të këtilla. Për më shumë shpjegime referohu në librin tonë “Kur'ani dhe Profeti i fundit”, kapitulli “Mrekullitë shkencore të Kur'anit”.

njeriu orientohet drejt për në rrugën ku ka qëllim të arrijë dhe, pikërisht për këtë shkak, ajeti e përmend edhe mirësinë e madhe të shenjave.

Shenja të këtilla janë forma e maleve, e luginave, vendkalimet, lartësitë, ultësirat, ngjyra e tokës dhe e maleve, madje edhe natyra e lëvizjes së ajrit.

Për të mësuar rëndësinë e madhe që ka mungesa e këtyre shenjave, është e mjaftueshme të hedhim një shikim në gjendjen e shkretëtirave të mëdha, të cilat në disa rajone të botës kanë një karakteristikë të përbashkët: procesi i kalimit nëpër shkretëtira është i vështirë, madje shumë i vështirë, krahas rrezikut tepër të madh që ka udhëtimi nëpër shkretëtirë. Sa udhëtarë kanë hyrë në shkretëtirë dhe nuk janë kthyer më!

Nëse e gjithë sipërfaqja e tokës do të ishte shkretëtirë, nëse të gjitha malet do të kishin të njëjtën formë e madhësi, nëse fushat do të kishin vetëm një ngjyrë dhe nëse të gjitha luginat do të ishin plotësisht të ngjashme, a do të ishte e lehtë për njeriun të ecte nëpër të gjitha këto?!

Në gjendjen kur nuk është e mundur që këto shenja të dallohen për shkak të errësirës së natës, për atë që udhëton në tokë e në det, All'Ilahu i Lartësuar ka bërë shenja edhe në qiell, shenja të cilat në këtë gjendje kompensojnë mungesën e shenjave në tokës dhe ajeti thotë: **“ndërsa (natën), ata orientohen me anën e yjeve”**.

Nga vetë natyra e gjendjes, kjo është njëra prej tërësisë së dobive të yjeve, madje edhe nëse nuk do të kishte dobi tjetër përveç kësaj, veçanërisht kur marrim parasysh kohën e zbritjes së Kur'anit, pa dyshim që edhe kjo do të ishte e mjaftueshme. Kjo për arsye se

jemi në kohën kur nuk ishte shpikur ende as astrolabi, nuk njiheshin as koordinatat që të ndihmonin anijet në udhëtimet që bënin në përputhje me hartat që u përgatitën për këtë qëllim. Atëherë lundrimet pezulloheshin kur qielli ishte i mbuluar me re të dendura, pasi kushdo që do të guxonte të udhëtonte në këto kushte atmosferike, me siguri që do të përballej me rrezikun e vdekjes.

Siç dihet, yjet që ne na duken se lëvizin në qiell, në të vërtetë janë pesë planetët dhe që në gjuhën e zakonshme quhen yje lëvizëse. Në të vërtetë janë më shumë se pesë, por syri e ka të pamundur t'i dallojë me lehtësi, përveçse me ndihmën e mjeteve speciale për këtë punë. Kurse, yjet e tjera e ruajnë pozicionin e tyre në kupën e qiellit, sikur të ishin perla të lidhura me penj mbi një copë kumashi të zezë, e cila duket sikur tërhiqet nga njëra anë, prandaj na duket sikur lëviz e gjitha njëherësh.

Me fjalë të tjera, lëvizja e yjeve është kolektive, kurse lëvizja e planetëve është lëvizje individuale. Prandaj, distancat mes planetëve dhe yjeve stabël ndryshojnë vazhdimisht.

Përveç kësaj, yjet stabël mes tyre kanë forma të përcaktuara, që njihen me emrin (figura astronomike), të cilat kanë efekt shumë të madh në njohjen e katër anëve të horizontit (veri, jug, lindje, perëndim).

Pasi përmend të gjitha këto mirësi të mëdha dhe këtë dashamirësi të fshehur të All'llahut, Kur'ani Famëlartë i bën thirrje ndërgjegjes së njeriut të gjykojë në lidhje me këto mirësi dhe thotë: **“Ai që krijon nuk është si ai që nuk krijon, a nuk po mediton?”**.

Ashtu siç jemi mësuar prej Kur'anit dhe rrugës së tij edukative me synime gjurmëlënëse, Kur'ani e shtron problemin e

argumentimit në formë pyetjeje dhe përgjigjen e saj e lë në ndërgjegjen e gjallë njerëzore. Kjo mënyrë e shtrimit të çështjeve në formë pyetjeje, në të vërtetë stimulon lëvizjen e brendshme të ndjenjave në thellësi të shpirtit, që te njeriu të vihet në lëvizje dashuria e tij e thellë ndaj Krijuesit të tij.

Në realitetin shpirtëror të njeriut, vendimtar është fakti se mësimi dhe edukimi i shëndoshë kërkojnë përpjekjen në shkallën më të lartë, që të mundësohet pranimi i asaj që i jepet e i mësohet njeriut vetëm nëpërmjet vetëbindjes dhe në atë mënyrë që te njeriu të formohet bindja se ajo që i jepet atij, në të vërtetën e saj është një zgjim që buron nga brendësia e tij dhe jo si detyrim mbi njeriun nga jashtë. Sepse kështu njeriu e pranon atë me të gjithë ekzistencën e tij, është i kujdesshëm ndaj këtij mësimi e ndaj kësaj edukate dhe e mbron atë.

E gjejmë të domosdoshme t'i rikthehemi asaj që thamë më lart se politeistët (mushrikët), të cilët adhuronin me krye në tokë (u bënë sexhde) idhujve, besonin se krijuesi është All'Ilahu i Lartësuar, prandaj Kur'ani Famëlartë shtron pyetjen: cili ka më shumë të drejtë të adhurohet: Krijuesi i të gjitha sendeve apo i krijuari?

Në fundin e ajetit, Filluesi i të gjitha sendeve, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka asnjë mangësi, e mbyll ciklin e mirësive të All'Ilahut që u përmendën me fjalën e Tij dhe thotë: **"Nëse do të (përpiqeshit) numëroni mirësitë e All'Ilahut, nuk do të arrinit t'i numëroni dot."**

Me këtë fjalë, ajeti u thotë njerëzve: në të vërtetë, ju jeni të mbuluar kokë e këmbë në mirësitë e All'Ilahut, në çdo njeri ngjiten

lart e zbresin poshtë mijëra e mijëra mirësi, por për çdo mirësi është detyrim të falënderohet.

Çdo minutë jetë që kalojmë, jemi borxhlinj ndaj veprimtarisë së miliona qenieve të gjalla brenda trupit tonë, si dhe ndaj miliona qenieve të gjalla e jo të gjalla jashtë trupit tonë, pa të cilat nuk do të kishim mundësi të jetonim asnjë çast.

Por mjegulla e shkujdesjes është kaq e dendur, sa na pengon të shikojmë mirësitë e shumta që kemi prej këtyre gjallesave e jogjallesave, të cilat për çdo hap që shkenca hedh përpara, për ne bëhen më të qarta përmasat e mëdha dhe horizontet e reja që hapen para nesh për të njohur mirësitë e All'llahut gjithnjë e më mirë. Duke qenë të vetëdijshëm se gjithçka që ne arrijmë të kuptojmë në këtë fushë, është fare pak në krahasim me mirësitë që Filluesi i gjithçkaje ka caktuar për ne, prandaj s'ka e s'mund të ketë ndonjë kufi të caktuar që të numërohen të gjitha mirësitë që Ai ka dhënë për ne?!

Pikërisht këtu vihem përpara një pyetjeje, e cila vetvetiu kërkon përgjigje: Si ta kryejmë të drejtën e falënderimit që i takon All'llahut? A nuk jemi edhe ne së bashku me grupin e mohuesve?

Por fjala e të Lartit: **“me të vërtetë, vetëm All'llahu është shumë Falës e Mëshirëplotë”**, është përgjigja më e mirë për këtë pyetje.

Patjetër, vetëm Ai, i Gjithëpushtetshmi është më i mëshirshmi e më dashamirësi, që nuk na ndëshkon pse për shkak të pamundësisë sonë nuk e kryejmë të plotë detyrën që kemi për ta falënderuar All'llahun e Lartësuar për mirësitë e panumërta që Ai na ka dhënë.

Neve na mjafton dashamirësia e të Lartit, që Ai na llogarit prej falënderuesve, kur ne i kërkojmë Atij ndjesë dhe pohojmë para Tij pamundësinë e pafuqinë tonë që nuk e plotësojmë dot detyrën për ta bërë falënderimin të plotë.

Megjithëkëtë, kjo pamundësi e jona nuk na ndalon që të numërojmë mirësitë e All'Ilahut me aq sa kemi mundësi, sepse kjo punë na shton njohjen e All'Ilahut, marrim dijeni për botën e krijesave, për horizontet e pamasa të Njësimit (All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm). Në të njëjtën kohë, në thellësi të zemrave ndiejmë ngrohtësinë e dashurisë ndaj të Gjithëpushtetshmit dhe falë kësaj dashurie vihen në lëvizje të gjitha ndjenjat tona për domosdoshmërinë e plotësimit të detyrës për të falënderuar Mirësidhënësin e Lartësuar, ashtu siç duhet falënderuar vetëm Ai.

Pikërisht për këtë arsye shikojmë se Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*) në fjalët, në lutjet e në meditimet e tyre kanë theksuar mirësitë e All'Ilahut dhe kanë numëruar disa anë të tyre. Numërimin e këtyre mirësive ata e kanë bërë vetëm e vetëm për të adhuruar All'Ilahun, për të mbajtur në mendje mirësitë e Tij dhe për të mësuar edhe të tjerët.

(Çështjen e falënderimit për mirësitë dhe për pamundësinë e njeriut për të numëruar të gjitha mirësitë e All'Ilahut, e kemi trajtuar gjatë studimit mbi ajetin 34 të sures "Ibrâhim".)

Hulumtime

Rruga, shenja, drejtuesi

Ajetet e mësipërme bënin fjalë për rrugët tokësore si një prej mirësive të All'Ilahut. Në këtë kuadër, Kur'ani Famëlartë i konsideron rrugët si mjetet më të rëndësishme që kanë mundur lidhjet mes njerëzve në udhën e qytetërimit njerëzor.

Edhe kur hartohen planet urbanistike, patjetër që duhet të përshkruhen vijat e rrugëve të përshtatshme në vendin ku do të bëhen ndërtimet, ndryshe në atë vend nuk mund të bëhet asnjë ndërtim.

Por, shpjegimi i Kur'anit nuk mund të reduktohet vetëm në këtë anë, pasi ne kemi mundur të themi se fjala *rrugë* e ajetit përfshin edhe anën e jetës morale të njerëzimit, sepse arritja në një qëllim të shenjtë kërkon patjetër edhe ecjen në rrugën e drejtë që të çon në atë qëllim.

Kurse rëndësia e ekzistencës së shenjave për dallimin e rrugëve në morinë e rrjetit të rrugëve, duke shtuar edhe rrugën kryesore, bëhet e mundur vetëm falë ekzistencës së atyre sendeve që ajeti i përmend me emrin *shenja*.

Duhet theksuar se ajetet e Kur'anit i kanë emërtuar besimtarët me fjalën "*muteves'simine*", "**me shenja dalluese**"; është e qartë se ky emërtim ka ardhur për të theksuar domosdoshmërinë e përqendrimit të vëmendjes në ato shenja.

Që të bëhet i mundur dallimi i së drejtës prej së gabuarës, patjetër që duhet të njihen shkollat juridike (medh'hebet), rrugët

dhe thirrjet e ndryshme, madje duhet të njihen edhe personat. Padyshim që kjo njohje bëhet e mundur vetëm falë ekzistencës së shenjave.

Për sa i përket çështjes së ekzistencës së drejtuesit, nuk është e nevojshme të bëhet ndonjë sqarim apo shpjegim, sepse qartësuesi nuk qartësohet.

Fjala e ajetit *“en’nexhmu”* **“ylli”** është interpretuar me të Dërguarin e All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kurse fjala *“el alàmât”*, **“shenja”**, në shumë transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) është interpretuar me Imamët, kurse në disa transmetime të tjera, fjalët *mirësi* dhe *shenja*, të dyja janë interpretuar me Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*). Në vijim përmendim disa prej këtyre transmetimeve:

1- Në tefsirin e Ali bin Ibrahimit, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: “Ylli është i Dërguari i All’llahut, kurse shenjat janë Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*)”.¹ Një transmetim i ngjashëm ka ardhur edhe prej Imamit Ali bin Mùsà Riza (*Paqja qoftë mbi të!*).

2- Prej Imam Bäkirit (*Paqja qoftë mbi të!*), në interpretimin e ajetit të mësipërm transmetohet se ai ka thënë: “Ne jemi yjet”.²

3- Prej Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe*

¹ Tefsiri “Nüruth Thekalejn”, vëll. 3. f. 45.

² Burimi i mësipërm.

mbi familjen e tij!) i ka thënë Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ti je ylli i beni (fisit) Hashimi”.¹

4- Në një transmetim tjetër tregohet se i ka thënë Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ti je njëra prej shenjave”.²

Të gjitha këto transmetime tregojnë për interpretimin e anës morale të këtyre ajeteve.

¹ Burimi i mësipërm.

²Burimi i mësipërm.

Ajetet 19 - 23

﴿وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُسِرُّونَ وَمَا تُعْلِنُونَ^{١٩} وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَا يَخْلُقُونَ شَيْئًا وَهُمْ يُخْلَقُونَ^{٢٠} أَمْوَاتٌ غَيْرُ أَحْيَاءٍ وَمَا يَشْعُرُونَ أَيَّانَ يُبْعَثُونَ^{٢١} إِنْ هِيَ إِلَّا إِلَهٌ وَاحِدٌ فَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ قُلُوبُهُمْ مُنْكَرَةٌ وَهُمْ مُسْتَكْبِرُونَ^{٢٢} لَا جَرَمَ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا يُسِرُّونَ وَمَا يُعْلِنُونَ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْتَكْبِرِينَ^{٢٣}﴾

“All’Ilahu e di atë që ju e fshihni dhe atë që e shfaqni sheshit.”

“Idhujt që ata adhurojnë dhe nuk adhurojnë All’Ilahun, nuk krijojnë asnjë send dhe vetë ato janë të krijuar.”

“Janë të vdekur e jo të gjallë, ata (idhujt) nuk e dinë kur ata (adhuruesit e idhujve) do të ringjallen.”

“Zoti juaj është Një Zot i Vetëm dhe ata që nuk besojnë në Botën Tjetër, zemrat e tyre janë mohuese (mohojnë Njësimin) dhe ata janë mendjemëdhenj.”

“Me të vërtetë All’Ilahu e di atë çka ata e fshehin dhe atë çka ata e shfaqin sheshit, Ai nuk i do mendjemëdhenjtë.”

Komentimi

Zota që nuk ndiejnë

Ajetet e mëparshme përmendën dy prej cilësive Hyjnore, të cilat nuk gjenden as tek idhujt e as te sendet e tjera që njerëzit adhurojnë, në vend që të adhurojnë All'llahun. Këto dy cilësi ishin krijimi i sendeve dhe dhënia e mirësive, ndërse ajeti i parë i grupit të ajeteve që kemi në studim thekson edhe një cilësi të tretë të të Adhuruarit të vërtetë që është dituria. Për këtë cilësi, ajeti thotë: **“All'llahu e di atë që ju fshihni dhe atë që e shfaqni hapur”**.

Atëherë përse adhuronit idhujt që nuk janë krijuesit tuaj, që nuk kanë dhënë për ju asnjë mirësi dhe nuk kanë asnjë dijeni për punët që i bëni hapur, pa folur për ato që i bëni në fshehtësi?!

Vallë a është me vlerë adhurimi që i bëhet një sendi, i cili nuk zotëron cilësitë e të Adhuruarit të vërtetë?!

Në vijim të këtij ajeti, Kur'ani Famëlartë e vazhdon çështjen e krijimit nga një horizont edhe më i gjerë dhe thotë: **“Idhujt që ata adhurojnë në vend që të adhurojnë All'llahun, ata nuk krijojnë asnjë send dhe ata janë të krijuar”**.

Nga studimi që kemi bërë deri tani kemi parë se idhujt nuk kanë asnjë atribut për të qenë të adhuruar, sepse ata nuk janë krijues, madje ata janë të krijuar, pra kanë nevojë që dikush “t'i punojë” që ata të jenë trup. Atëherë si është e mundur që njeriu të mbështetet te këta idhuj për të plotësuar nevojat që ka?! A nuk është ky budallallëku më i madh?

Megjithëkëtë, Kur'ani tregon edhe një karakteristikë tjetër të idhujve dhe thotë: **“Janë të vdekur dhe jo të gjallë”**.

Nëse do të nisemi edhe nga vlerësimi më i vogël, a nuk duhet që i adhuruari të jetë patjetër i gjallë dhe të ketë dijeni për nevojat e adhuruesve të tij?

Atëherë vetvetiu rezulton që cilësia e të qenët gjallë është vetëm tek i Adhuruari i vërtetë, cilësi që idhujt nuk e kanë.

Më pas, në lidhje me adhuruesit e idhujve Kur'ani shton: **“Ata (idhujt) nuk e dinë kur ata (adhuruesit e idhujve) do të ringjallen”**.

Nëse shpërblimi e dënimi do të ishte në dorën e idhujve, më e pakta që duhej të dinin ata është koha kur do të ringjallen adhuruesit e tyre, me gjithë këtë padituri që kanë idhujt në lidhje me Ringjalljen e dhënien llogari, si ka mundësi që ata të jenë të përshtatshëm për t'i adhuruar?!

Kjo është cilësia e pestë që patjetër gjendet vetëm në të Adhuruarin e vërtetë, All'Ilahun e Lartësuar dhe që idhujt nuk e kanë.¹

¹ Në komentimin e ajetit **“ata (idhujt) nuk e dinë kur ata (adhuruesit e idhujve) do të ringjallen”**, disa interpretues të Kur'anit mendojnë se qëllimi në këtë ajet nuk është ajo që u shpjegua në tekstin e këtij interpretimi, por thonë se qëllimi këtu është që idhujt nuk e dinë as vetë se kur do të ndodhë Dita e Gjykimit dhe, për këtë, ata kanë sjellë si argument fjalën e të Lartit në ajetin 98, të sures “El Enbijà”: **“Ju dhe ata që adhuronin dhe nuk adhuronin Allahun, do të jeni lëndë djegëse e Xhehennemit”**; por, është e qartë se kjo nuk është në harmoni me ajetin para dhe pas këtij ajeti. Prandaj, fjala më e saktë mbetet ajo që ne thamë më sipër.

Në shumë raste kemi thënë se koncepti “idhull” dhe “adhurimi i idhujve” në logjikën e Kur'anit Famëlartë është shumë më i gjerë sesa kufizohet me zotat e punuar prej guri, druri ose metali, pasi idhull është çdo gjë tjetër që ekziston dhe që njerëzit e marrin si vendstrehim për veten e tyre, duke iu kundërvënë All'llahut të Gjithëpushtetshëm, madje në dorën e këtyre idhujve, njerëzit lënë edhe të ardhmen e tyre, megjithëse ai është një idhull, qoftë ky i adhuruar dhe njeri.

Është e qartë se në ajetet e mësipërme përfshihen edhe ata që e adhurojnë All'llahun e Lartësuar vetëm me gjuhët e tyre, kurse në realitet ia kanë dorëzuar jetën e vet një të adhuruari të pafuqishëm. Mbase ata e kanë ndjekur këtë idhull për shkak se besojnë se shpëtuesi për ata nuk është All'llahu i Lartësuar, por është ky idhull. Vetëkuptohet që kjo vjen tek ata sepse e kanë humbur orientimin e pavarësisë së besimtarit të vërtetë.

Të këtillë njerëz besojnë se superfuqitë botërore mund të jenë strehë në jetën e tyre edhe pse ata e mohojnë All'llahun e Lartësuar dhe prej atyre do të ndëshkohen në zjarrin e Xhehennemit. Të këtillë njerëz edhe nga ana praktike, realisht janë adhurues të idhujve dhe prej atyre që i bëjnë shok All'llahut të Lartësuar. Këtyre njerëzve duhet t'u parashtrojmë në formë pyetjesh argumentet vijuese:

A kanë krijuar këta të adhuruar ndonjë gjë për ju?

A janë ata burim i mirësive?

A kanë dijeni ata për punët tuaja të dukshme e të padukshme?

A e dinë ata se kur do të Ringjalleni?

A është në dorën e idhujve shpërblimi e dënimi?

Nëse përgjigjja është negative, atëherë përse adhuroni idhujt dhe nuk adhuroni All'llahun e Lartësuar?!

Pas këtyre përfundimeve të qarta nga jeta e gjallë në lidhje me pafuqinë e idhujve, Kur'ani Famëlartë përmend përfundimin e vetëm logjik dhe thotë: **“Zoti juaj është Një Zot i Vetëm”**.

Meqenëse marrëdhënia ndërmjet fillimit dhe Ringjalljes është e lidhur në mënyrë të ndërthur, aq sa është e pamundur të ndahen nga njëra-tjetra, Kur'ani Famëlartë shton menjëherë: **“dhe ata që nuk besojnë në Botën Tjetër, zemrat e tyre janë mohuese (mohojnë Njësimin) dhe ata janë mendjemëdhenj”**.

Argumentet në lidhje me Njësimin (besimi se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm) dhe në Ringjalljen, janë të lexueshme për cilindo që ka si qëllim të dijë të vërtetën dhe që e kërkon atë, sepse shkaku i mospranimi të së vërtetës dhe mohimi i saj kanë të bëjnë me mendjemadhësinë dhe me mosdorëzimin para së vërtetës. Kështu që mohimi bëhet sundues në qenien e mohuesve, sidomos pasi ata arrijnë të mohojnë edhe të vërtetat që arrihen me anë të shqisave, edhe pse këto të vërteta tek ata janë me shumicë. Pikërisht në këtë cak, tek ata nuk sjellë më dobi as fjala e vërtetë, as argumenti i vërtetuar për qëndrueshmërinë e tij dhe as logjika e shëndoshë.

Argumentet jetësore që u përmendën në ajetet e mësipërme dhe që tregonin se idhujt nuk meritojnë të adhurohen, janë të mjaftueshme për çdo njeri me mendje të udhëzuar në rrugën e

drejtë, megjithëkëtë gjejmë shumë njerëz që nuk e pranojnë këtë të vërtetë, pavarësisht se ajo është plotësisht e qartë!

Ajeti tregon qartë se All'llahu i Lartësuar e njeh si të panjohurën, ashtu dhe të njohurën dhe thotë: **“Me të vërtetë, All'llahu e di, si atë çka fshehin, ashtu edhe atë çka e shfaqin hapur”**.

Ajeti i nderuar me qartësinë e tij të madhe, është një kërcënim për mohuesit dhe për armiqtë e së vërtetës dhe i njofton ata hapur se All'llahu i Lartësuar nuk është i shkuajdesur ndaj punëve të tyre, qoftë kur i bëjnë hapur, qoftë kur i bëjnë në fshehtësi dhe u thotë në mënyrë të prerë se çdo njeri do të dënohet për ato që ka bërë me dorën e tij.

Duke qenë se mohuesit janë mendjemëdhenj, All'llahu i Lartësuar na njofton: **“Ai nuk i do mendjemëdhenjtë”**, mirëpo mendjemadhësia kundër së vërtetës është njëra prej shenjave të injorancës ndaj madhësisë së All'llahut të Lartësuar.

(Fjala e ajetit “lâ xhereme”, siç shihet përbëhet prej dy fjalëve, prej fjalës “lâ” dhe prej fjalës “xhereme”. Zakonisht, kjo fjalë përdoret në kuptimin e një pune të përfunduar, ndërsa herë tjetër përdoret në kuptimin e këputjes së frutave prej pemës dhe, kur para fjalës “xhereme” është fjala “lâ”, ka kuptimin se asgjë nuk ka mundësi ta ndajë këtë objekt dhe ta ndalojë atë prej vërtetimit. Prej kësaj fjale përfitohen kuptimet: “në mënyrë të prerë”, “patjetër”, ndërsa herë tjetër, ajo përdoret për “betim”.

Hulumtime

Cilët janë mendjemëdhenjtë?

Fjala “mendjemadhësi” është përmendur në shumë ajete të Kur’anit Famëlartë, duke u konsideruar si njëra prej veseve të ulëta të mohuesve, si dhe për të theksuar arrogancën që shfaqin mohuesit kur kundërshtojnë të pranojnë të vërtetën.

Fjalën “mendjemadhësi” e hasim edhe në ajetin 7 të sures “Nuh”: **“Sa herë që unë u bëja thirrje që Ti t’ua falje atyre mëkatet, ata zinin veshët me gishta, mbulonin kokat me rrobat e tyre dhe vazhdonin rrugën me një mendjemadhësi të fortë”.**

Edhe në ajetin 5 të sures “El Munàfikùn” e hasim fjalën “mendjemadhësi”: **“Kur atyre u thuhet ejani tek i Dërguari i All’liahut që ai të kërkojë për ju faljen e mëkateve, ata tundnin kokat dhe i sheh të kthejnë shpinën me mendjemadhësi.”.**

Gjithashtu, për mendjemadhin flet edhe ajeti 8 i sures “El Xhàthijeh”: **“I dëgjon ajetet e All’liahut që i lexohen atij, por si mendjemadh që është, vazhdon sikur nuk i ka dëgjuar.”.**

Forma më e keqe e mendjemadhësisë është kur njeriu qëndron para së vërtetës dhe e refuzon atë, sepse mendjemadhësia i mbyll mendjemadhit të gjitha udhët e udhëzimit në rrugën e drejtë dhe e lë atë të gremiset në humnerat e mëkateve e të rrëzohet në udhën e humbjes.

Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka cilësuar shejtanin “i pari i mendjemëdhenjve”¹, sepse shejtani është ai që bëri hapin e parë në udhën e kundërshtimit të së vërtetës dhe mosdorëzimit ndaj fjalës së All’llahut, që thotë se Ademi është më i plotësuar sesa shejtani.

Studimin tonë e përfundojmë me një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Ai që arrin të mendojë se është më i mirë se tjetri, patjetër që është njëri prej mendjemëdhenjve”. Përcjellësi tregon se i ka thënë Imamit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Domethënë, ai ka përparësi ndaj tjetrit ngaqë ka qëndruar larg mëkateve të mëdha?” Ai më tha: “Eh sa larg që është, shpresohet që ai e ka falur për atë që ka menduar e ka thënë, ndërsa ti vetë je duke dhënë llogari. A nuk e ke lexuar ngjarjen me magjistarët e Mùsàit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)”².

(Kur magjistratët qëndruan një ditë ballë për ballë me Mùsàin (*Paqja qoftë mbi të!*) për të kënaqur egon e Faraonit dhe lakminë e tij të madhe për të triumfuar mbi Mùsàin, sapo e kuptuan të vërtetën, e përqafulan menjëherë dhe nuk u frikësuan prej kërcënimit të Faraonit, vazhduan ta refuzonin kërkesën e tij dhe nuk u dorëzuan para tiranit dhe, rezultati që se All’llahu i fali ata dhe i futi nën mëshirën e Tij).

¹ “Nehxhul Belàgah”, ligjërata “El Kàsia”.

² Tefsiri “Nùruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 48 dhe vëll. 56, cituar prej librit “Reudatul Kàfij”.

Ajetet 24 - 29

﴿وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ مَآذَا أَنْزَلَ رَبُّكُمْ قَالُوا أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ﴾، لِيَحْمِلُوا أَوْزَارَهُمْ كَامِلَةً يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَمِنْ أَوْزَارِ الَّذِينَ يُضِلُّونَهُمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ أَلَا سَاءَ مَا يَزِرُونَ، قَدْ مَكَرَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَأَتَى اللَّهَ بُنْيَانُهُمْ مِنَ الْقَوَاعِدِ فَخَرَّ عَلَيْهِمُ السَّقْفُ مِنْ فَوْقِهِمْ وَأَتَاهُمُ الْعَذَابُ مِنْ حَيْثُ لَا يَشْعُرُونَ، ثُمَّ يَوْمَ الْقِيَامَةِ يُخْزِيهِمْ وَيَقُولُ أَيْنَ شُرَكَائِيَ الَّذِينَ كُنْتُمْ تُشَاقُّونَ فِيهِمْ قَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ إِنَّ الْخِزْيَ الْيَوْمَ وَالسُّوءَ عَلَى الْكَافِرِينَ، الَّذِينَ تَتَوَفَّاهُمُ الْمَلَائِكَةُ ظَالِمِي أَنْفُسِهِمْ فَأَلْقَوْا السَّلَامَ مَا كُنَّا نَعْمَلُ مِنْ سُوءٍ بَلَى إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ، فَادْخُلُوا أَبْوَابَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا فَلَئْسَ مَثْوًى الْمُتَكَبِّرِينَ﴾

“Kur atyre (mohuesve) u thuhet: Ç’është ajo që shpalli Zoti juaj? Ata thonë: ‘Mite të popujve të hershëm.’”

“Për të mbajtur Ditën e Gjykimit, mëkatet e veta dhe një pjesë prej mëkateve të atyre që i mashtruan dhe i çuan në rrugën e humbjes pa asnjë arsye.”

“Sa e keqe është barra me të cilën ata do të ngarkohen. Edhe ata që ishin para tyre thurën intriga, por All’llahu e rrënoi nga

themeli ndërtesën e tyre (intrigat), ndërsa kulmi u shemb mbi ata, u erdhi dënimi andej nga nuk e menduan.”

“Pastaj, Ditën e Gjykimit, Ai i turpëron dhe u thotë: Ku janë ata që m’i bënit Mua shokë dhe për hir të cilëve ju e lodhnit veten aq shumë! Ata që zotëronin dituri do të thonë: Me të vërtetë sot turpi dhe e keqja i përfshiu jobesimtarët.”

“Kur engjëjt ua marrin shpirtin atyre që ishin mizorë ndaj vetes së tyre, ata dorëzohen (në çastin e vdekjes duke thënë) nuk kemi bërë ndonjë të keqe; patjetër që All’llahu i di më mirë punët që keni bërë.”

“Prandaj hyni në dyert e Xhehennemit, ku do të jeni përgjithmonë; sa vend i keq është vendi i mendjemëdhenjve.”

Shkaku i zbritjes

Në tefsirin “Mexhmaul Bejjàn” tregohet se këto ajete kanë zbritur për gjashtëmbëdhjetë burra, të cilët në ditët e Haxhit u dilnin njerëzve në rrugë dhe në çdo të përpjetë ishin katër prej tyre, që përpiqeshin të largonin njerëzit prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur njerëzit i pyesnin ata se çfarë i ka zbritur të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ata i përgjigjeshin: mite e besëtytni prej atyre të hershmëve.

Komentimi

Mbajtja e barrës së të tjerëve

Ajetet e mësipërme flisin për inatin e për mendjemadhësinë e politeistëve (mushrikëve) para së vërtetës, si dhe për përpjekjen e tyre të nxituar për t'i bërë bisht përgjegjësisë dhe për të mos u dorëzuar para së vërtetës.

Në këto ajete flitet për logjikën superiore të mendjemëdhënjeve, për të cilët Kur'ani njofton: **“Kur atyre (mohuesve) u thuhet: Ç’është ajo që shpalli Zoti juaj? Ata thonë: Mite të popujve të hershëm”**. Me këto fjalë, ata thoshin se ajo që zbret nuk është Revelatë Hyjnore, por është nga gënjeshttrat e të hershmëve.

Me këto fjalë, ata kishin dy qëllime:

1) t'i bënin të tjerët të besonin se niveli i mendimit e i diturisë që ata zotërojnë është më i lartë se ajo që zbret prej All'llahut!

2) ajo që shpallte Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk është gjë tjetër përveçse mite e legjenda të të hershmëve të formuluar me fraza të këndshme që duken të lustruara për njerëzit e zakonshëm. Më pas shtonin se kjo nuk ishte diçka e re dhe Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sipas shpifjeve të tyre, nuk bënte gjë tjetër veçse përsëriste mitet e legjendat e të përparshmëve.

Në tekstin e Kur'anit fjala *“el esàtijnr”* - mite, legjenda - përmendet për tregimet e historitë me përralla të mbushura me gënjeshttra. Fjala *“el esàtijnr”* përmendet në Kur'anin Famëlartë nëntë

herë, e shqiptuar prej gjuhëve të mohuesve kundër Profetëve për të justifikuar kundërshtimin që ata i bënin thirrjes së All'Ilahut të Lartësuar.

Në të gjitha vendet ku përmendet kjo fjalë është përmendur së bashku me fjalën *"el ev'velijne"* - të hershmëve -, për të theksuar se këto mite e legjenda nuk ishin diçka e re dhe se me kalimin e kohës edhe këto që i zbrisnin Muhammedit do të mbeteshin si të gjitha përrallat e mitet! Me thëniet e tyre, mohuesit kishin arritur deri aty sa e tepronin në të gjitha fjalët që thoshin, ashtu siç njoftohet në ajetin 31 të sures "El Enfâl": **"Kemi dëgjuar (të këtilla fjalë), sikur të donim edhe ne do të thoshim diçka të ngjashme me to"**.

Konstatohet se edhe mendjemëdhenjtë e ditëve tona bëjnë kundër fesë të njëjtat akuza me qëllim që t'i largohen së vërtetës, si dhe për të futur të tjerët në rrugën e humbjes, madje kokëtrashësia tek ata ka arritur deri aty sa ta konsiderojnë fenë si diçka që ka lindur prej injorancës së njerëzve dhe se pikëpamjet e fesë, sipas këtyre mohuesve, nuk janë gjë tjetër veçse legjenda e mite. Të gjitha këto i kanë shkruar nëpër librat e sociologjisë me formulim shkencor.

Sikur të depërtojmë në thellësi të mendimit të këtyre mohuesve, me siguri do të gjejmë se fetë e sajuara dhe sektet mitologjike nuk kanë luftuar kurrë; në të kundërt, ata janë vetë themelues e përhapës të këtyre kulteve të mbushura me mite e legjenda boshe, pasi, në të vërtetë, ata kanë luftuar e luftojnë vetëm fenë e vërtetë, fenë që nxit mendimin njerëzor, që thyen prangat e kolonializmit dhe i pret rrugën revizionistëve që të mos deformojnë seriozitetin e fjalës së drejtë.

Thirrjen e fesë për morale të larta ata nuk e gjejnë në harmoni me temperamentin e tyre, sepse moralet e fesë janë në kundërshtim me pasionet dhe me dëshirat e tyre të paligjshme.

Për të gjitha këto, ata e shohin thirrjen e fesë së vërtetë një pengesë përpara asaj që ata aspirojnë të arrijnë. Ata përdorin mënyra të shumta për ta poshtëruar në sytë e të tjerëve këtë fe me vlera kaq të larta, me qëllim që të kenë mundësi për të punuar ashtu siç kanë dëshirë.

Është për të ardhur keq kur shikon se injorantët i paraqitin mitet e mendimet e gabuara të veshura me petkun e fesë, pasi ky veprim është një faktor ndihmues në guximin që ata njerëz kanë për ta njollosur fenë dhe i shtyn ata të akuzojnë si përcjellëse të miteve dhe legendave. Në këtë gjendje del detyrë e domosdoshme për të gjithë besimtarët e ndërgjegjshëm të qëndrojnë fuqishëm para të gjitha këtyre mashtrimeve për ta bërë të paefektshme këtë armë në dorën e armiqve të tyre. Është detyrë e besimtarëve që këtë të vërtetë ta përmendin në të gjitha vendet dhe të thonë me zë të lartë se asgjë nuk i lidh mitet e legendat me fenë e vërtetë. Gjithashtu thirrësi i ndërgjegjshëm nuk duhet të vërë mitet e legendat në dispozicion të armiqve të fesë në luftën tonë kundër atyre dhe anasjellas, sepse procesi i harmonizimit të mësimave Hyjnore me logjikën, është aq i fortë dhe i qartë saqë nuk lë asnjë shteg nga ku mund të hidhen të këtilla fjalë krejtësisht të pabazuara e mashtruese.

Ajeti tjetër i zbulon edhe më qartë punët e tyre dhe thotë: **“Për të mbajtur Ditën e Gjykimit mëkatet e veta dhe një pjesë prej mëkateve të atyre që i mashtruan e i çuan ata në rrugën e**

humbjes pa asnjë arsye. Sa e keqe është barra me të cilën ata do të ngarkohen”.

Në të vërtetë, fjalët e tyre të gabuara kanë efekt negativ, pasi me këto fjalë ata kanë futur në rrugën e humbjes shumë e shumë të tjerë, prandaj për ta do të jetë zi e më zi kur do të mbajnë edhe barrën e atyre mijëra njerëzve që u mashtroan prej fjalëve të tyre, pa harruar se fjalët e gabuara të këtyre armiqve do të grumbullohen edhe në brezat që do të vijnë pas tyre, dhe kështu fjalët e tyre mashtruese do të jenë një burim për çuarjen e këtyre brezave në rrugën e humbjes dhe, e gjitha kjo shton pa pushim peshën e barrës që do të mbajnë.

Folja *“lijahmilû”* - për të mbajtur - në tekstin e Kur'anit ka ardhur në mënyrën urdhërore, veta e tretë, me qëllim që të shpjegohet më qartë rezultati përfundimtar i punëve të këtyre njerëzve që punojnë për të futur të tjerët në rrugën e humbjes. Në të vërtetë, kjo mënyrë shprehjeje i ngjan rastit kur i thua një personi:

“Meqë ti e bërë këtë punë të paligjshme, të mbetet të përballosh edhe pasojat e punës që bërë dhe të shijosh të hidhurën e punës sate të keqe. (Disa interpretues janë shprehur se mënyra urdhërore e kësaj foljeje në vetën e tretë, përdoret për të shprehur më qartë rezultatin).

Kurse fjala *“el uzâr”* - barrët - është në kuptimin e peshës së rëndë, gjithashtu kjo fjalë në Kur'an ka ardhur edhe në kuptimin e fajit e të mbajtjes së përgjegjësisë, prandaj edhe ministrit (në arabisht *“vezir”*), i thuhet *“vezir”*, për shkak të përgjegjësisë që mban.

Këtu na del përpara pyetja se pse Kur'ani thotë: **“Mbajnë prej mëkateve të atyre që i çuan në rrugën e humbjes”** dhe nuk thotë: “Të gjitha barrat e tyre”. Në një kohë kur transmetimet theksojnë qartë: “Kush sajon një rrugë të keqe, ai mban mbi vete barrën e rrugës së keqe që sajoi dhe barrën e atyre që punuan deri Ditën e Kiametit sipas asaj rruge”.

Disa interpretues të Kur'anit i janë përgjigjur kësaj pyetjeje me faktin se mbi ata që punojnë për t'i çuar njerëzit në rrugën e humbjes rëndojnë dy lloje mëkatesh, njëri lloj është se ata ndjekin krerët e udhës së humbjes, dhe lloji i dytë është për shkak të punës së tyre të keqe. Barra që mbajnë krerët e udhëheqësit e tyre, është prej mëkatit të llojit të parë dhe nuk ka të bëjë me llojin e dytë.

Interpretues të tjerë të Kur'anit kanë thënë se lidhësja “*min*” - prej - në këtë fjali nuk tregon pjesë, por ka ardhur për të shpjeguar sa më qartë se mëkatet e ndjekësve rëndojnë mbi shpatullat e të ndjekurve.

Fjalët e shkruara në disa libra tefsiresh në lidhje me këtë ajet, janë më afër për t'u pranuar në krahasimin me fjalët që thuhet në disa libra të tjerë tefsiresh, në të cilët thuhet: “Ndjekësit e atyre që janë në rrugën e humbjes janë në dy gjendje”.

Ndodh që janë ndjekës të devijuesve (atyre që deformojnë fenë me qëllim), megjithëse e dinë mirë se cilët janë ata. Nga historia mësojmë se ka shumë raste nga kjo kategori ndjekësish, ku shkak i mëkatit nga njëra anë është urdhri i udhëheqësit dhe, nga ana tjetër, shkak është vendosmëria e ndjekësve për të vepruar sipas mësimave e këshillave të udhëheqësit. Për rrjedhojë një pjesë e përgjegjësisë së mëkateve të ndjekësve bie mbi shpatullat e

drejtuesve që orientojnë në rrugën e gabuar dhe, patjetër nuk do të pakësohet asgjë prej peshës së barrës që mbartin vetë ndjekësit.

Herë tjetër ndodh që ndjekja të jetë rezultat i shkujdesjes dhe rënies së ndjekësve në kurthet e cytjeve të atyre që punojnë për të devijuar të vërtetat e fesë, domethënë, ata që bëhen ndjekës në mënyrë të pandërgjegjshme dhe pa e kuptuar të vërtetën e punës. Ky fakt konstatohet në masën e njerëzve të zakonshëm në shumë shoqëri njerëzore, në të cilat futja në rrugën e humbjes ndodh edhe në emër të afrimit tek All'llahu i Lartësuar. Në këtë gjendje e gjithë barra e mëkateve të ndjekësve rëndon mbi drejtuesit që i futën ndjekësit në rrugën e humbjes dhe për këta të fundit nuk ka asnjë barrë nëse kanë punuar me ngulm për të gjetur të vërtetën e punës.

Padyshim që grupi i parë që ecën në rrugën e humbjes, duke e ditur se si është ajo rrugë, nuk i lehtësohet asgjë prej mëkateve; në të kundërt, atyre u shtohen barrët e mëkateve, ashtu siç u shtohen drejtuesve të tyre.

Këtu duhet theksuar se togfjalëshi i tekstit të Kur'anit "*bigajri ilmin*" - *pa asnjë arsye* - nuk është argument për të justifikuar shkujdesjen e përhershme të atyre që janë mashtruar dhe kanë hyrë në rrugën e humbjes. Kjo fjalë në asnjë gjendje nuk shpreh shkarkimin e përgjegjësisë prej këtyre ndjekësve të painformuar për gjendjen e drejtuesve të rrugës së keqe, madje kjo fjalë e ajetit thekson se rënia e masës së njerëzve të thjeshtë në rrugën e humbjes ndodh më me shpejtësi se rënia e dijetarëve të tyre në kurthet e atyre që punojnë për të futur njerëzit në udhën e humbjes.

Për të gjitha këto shikojmë se Kur'ani Famëlartë në shumë ajete të tjera nuk i justifikon këta ndjekës, madje i ngarkon ata edhe

me një pjesë të përgjegjësisë së krerëve të rrugës së humbjes, ashtu siç thuhet qartë në ajetet 47 dhe 48 të sures “Gafir”: **“Duke qenë në zjarr, ata grinden me njëri-tjetrin, të pafuqishmit u thonë të mëdhenjve: ‘Ne ishim ndjekësit tuaj (në botën e tokës), a mund të na e hiqni një pjesë të dënimit në zjarr?’ Ata që kishin qenë paraia thonë: ‘Ne të gjithë jemi brenda në zjarr; All’llahu vendosi në mënyrë të prerë në mes të njerëzve.’”**.

Në vijim, ajeti pasardhës i grupit të ajeteve që kemi në studim thekson se akuza për të cilësuar Revelatën Hyjnore si mite të të hershmëve nuk është diçka e re dhe për këtë i Larti thotë: **“Edhe ata që ishin para tyre thurën intriga, por All’llahu e rrënoi ndërtesën e tyre (intrigat) nga themeli dhe kulmi u shemb mbi ata, atyre u erdhi dënimi andej nga nuk e menduan.”**.

Në lidhje me komentimin e këtij ajeti, disa interpretues të Kur’anit kanë shkuar deri te historia e tiranit Nemrud që urdhëroi hedhjen në zjarr të hazretit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe urdhëroi të ndërtohej kulla e lartë me anën e së cilës do të luftohej Zoti i qiejve! Interpretues të tjerë të Kur’anit e kanë komentuar ajetin me historinë e mbretit tiran të Asirisë së lashtë, Bahtansarit, porse e vërteta për të cilën flet ajeti i nderuar përfshin të gjitha komplotet e intrigat e mendjemëdhenjve dhe të krerëve të atyre që punojnë për të futur njerëzit në rrugën e humbjes.

Por bukuria e çështjes që shpreh kjo frazë e Kur’anit Famëlartë, qëndron në faktin se ajeti i nderuar thekson: **“All’llahu i gjithëpushtetshëm jo vetëm që e shkatërron godinën e mendjemëdhenjve duke filluar nga maja e saj, por ai e shkatërron atë nga themelet që ajo të bjerë mbi vetë mendjemëdhenjtë”**.

Shembja e kolonave dhe rrëzimi i çatisë për të cilat na flet ajeti i nderuar mund të jetë një hamendësim për shembjen e ndërtesave të tyre si pasojë e faktorëve natyrorë, tërmete e rrufe dhe nën ato gërmadha të asgjësohen edhe vetë mendjemëdhenjtë; por fjala “shembje” e ajetit të nderuar mund të jetë një njoftim për shkatërrimin e shoqërive dhe të partive të mendjemëdhenjve me urdhrin e All'llahut të Gjithëpushtetshëm, madje nuk kanë asnjë ndalesë që fjala “shembje” e ajetit të përfshijë njëherësh shkatërrimin fizik të ndërtesave e të shoqërive të mendjemëdhenjve.

Kur'ani Famëlartë me stilin e tij të lartë të fjalës tërheq vëmendjen se në ajet pas fjalës “*es'sakfu*” - *kulmi, çatia* - vjen fjala “*min feukihim*” - *mbi ta, sipër atyre*. Zakonisht, kulmi i çatisë është në majën më të lartë të ndërtesës, atëherë si qëndron puna që është përmendur edhe fjala “*min feukihim*” - *mbi ata, sipër tyre*? Ka mundësi që kjo pjesë e fjalisë të jetë për të përforcuar më shumë kuptimin e fjalës para saj, gjithashtu ka mundësi që të jetë për të shpjeguar se rrëzimi i çatisë së mendjemëdhenjve do të ndodhë kur ata të jenë nën çatinë, dhe kështu do të asgjësohen së bashku me ndërtesën e tyre, pasi ka mundësi që rrëzimi i ndërtesës, mund të ndodhë edhe kur të zotët e shtëpisë të jenë brenda, edhe kur ata ndodhen jashtë saj.

Historia e kohës së vjetër dhe e kohës së re na sjell shembuj shumë të qartë të dënimit Hyjnor, pasi dihet që tiranët e despotët kanë jetuar dhe i kanë përjetuar kënaqësitë e kësaj bote nën mbrojtjen e kështjellave të ndryshme, duke shtuar edhe planet që ata thurnin që kjo gjendje të vazhdonte edhe për pasardhësit e tyre, prandaj ata bënë gjithçka për të siguruar vijimësinë e fuqisë së pushtetit të tyre. Tregimet e historisë na njoftojnë se dënimi Hyjnor i zuri edhe këta tiranë dhe para këtij dënimi, ata nuk patën asnjë

mundësi që të përfitonin prej fuqisë që kishin, por vetëm panë se si kështjellat e ngritura me aq mund e kujdes prej tyre, shembeshin mbi kokat e tyre dhe nuk mbeti më asnjë shenjë që të tregonte fuqinë e tiranëve mendjemëdhenj.

Dënimi i atyre tiranëve e despotëve në jetën e kësaj bote, nuk do të thotë se ata e kanë marrë të plotë dënimin, pasi plotësimi i dënimit për ata do të jetë Ditën e Madhe të Gjykimit, ashtu siç na njofton ajeti i nderuar: **“Pastaj, Ditën e Gjykimit, Ai i turpëron ata.”**.

All’Ilahu i Lartësuar do t’i pyesë: **“dhe i thotë: Ku janë ato që ju m’i bënit Mua shokë dhe për hir të cilëve ju e lodhnit veten aq shumë?”**, domethënë, për të cilët polemizonit e armiqësoheshit aq shumë, por ata nuk kanë mundësi të përgjigjen dhe ajeti na njofton: **“Ata që zotëronin dituri do të thonë: Me të vërtetë sot turpi dhe e keqja i përfshiu jobesimtarët.”**.

Nga fjalët e këtij ajeti mësojmë se ata që do të flasin Ditën e Gjykimit do të jenë pikërisht dijetarët, dhe patjetër që në procedurën hyjnore nuk mund të thuhet fjalë të gabuara.

Nëse do të shikojmë në disa transmetime të ardhura prej Ehli Bejt (Paqja qoftë mbi ta!) do të mësojmë se dijetarët në atë procedurë janë Imamët e ruajtur prej mëkateve, sepse ata janë më të mirët e më të plotësuarit dhe kanë besueshmërinë më të madhe për këtë.¹

Le të rikujtojmë se qëllimi me pyetjen e me përgjigjen Ditën e Gjykimit, nuk është zbulimi i ndonjë të fshehte, por është njëri prej llojeve të ndëshkimeve shpirtërore, dhe patjetër për të vënë në

¹ Referoju tefsirit “Nûruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 50-71.

vend të drejtën e besimtarëve, të cilët janë njollosur e janë sharë rëndë në jetën e kësaj bote prej politeistëve (mushrikëve) mendjemëdhenj.

Fundi i ajetit e përshkruan gjendjen e mohuesve me këto fjalë: **“Kur engjëjt i marrin shpirtin atyre që ishin mizorë ndaj vetes së tyre.”**

Do të ndodhë kështu, sepse padrejtësia në të vërtetën e saj është padrejtësi kundër vetes para se të jetë padrejtësi ndaj të tjerëve; veç kësaj, padrejtësia asgjëson autoritetin qenësor të njeriut, gjithashtu asgjëson edhe paprekshmërinë e cilësive morale që janë në brendësi të njeriut.

Këtu duhet shtuar se kur padrejtësia merr përmasa të mëdha në çdo shoqëri, patjetër që rezultati i natyrshëm i kësaj padrejtësie do të bjerë mbi ata që bënë padrejtësi, madje do t'i përfshijë ata sapo padrejtësia të bëhet.

Në lidhje me momentin kur vjen ora e vdekjes, prej syve të njeriut hiqet perdja e shkujdesjes dhe për këtë ajeti i nderuar njofton: **“ata dorëzohen** (në çastin e vdekjes duke thënë) **nuk kemi bërë ndonjë të keqe”**.

Përse e mohojnë punën e tyre të keqe? A nuk ishin ata që gënjenin aq shumë sa gënjeshtro u bë një cilësi e përhershme? Apo me këtë fjalë ata duan të thonë: në të vërtetë ne e dimë të keqen e punëve tona, por gabuam, ne kurrë nuk kemi pasur qëllime të liga?

Këtu mund të flitet për qëllimin e të dyja anëve që u thanë.

Ndërkaq, atyre u vjen përgjigjja menjëherë: Me të vërtetë ju gënjeni, keni bërë shumë mëkate, ashtu siç njofton ajeti i nderuar:

“patjetër që All’llahu i di më mirë punët që keni bërë”, Ai i di edhe qëllimet tuaja.

Sepse atë Ditë nuk është vendi as për të mohuar e as për të justifikuar dhe ajeti njofton: **“Prandaj hyni në dyert e Xhehennemit, ku do të jeni përgjithmonë; sa vend i keq është vendi i mendjemëdhenjve.”**.

Dy Hulumtime

1- Ka vetëm dy rrugë: e mirë ose e keqe

Kryerja e çdo pune padyshim që kërkon përgatitje të shumta, prandaj të gjitha rrugët e rregullat vepruese në një shoqëri, të mira ose të këqija qofshin, siç mund të jetë përgatitja e tokës, ose veprime sociale që e ndihmojnë udhëheqësin, qoftë kur ai është i udhëzuar në rrugën e drejtë, qoftë kur është në rrugën e humbjes, ai punon që ato rrugë e rregulla të veprojnë me efektshmëri, qoftë edhe në disa raste kur udhëheqësi merr rolin e orientuesve dhe rregullvënësve për të gjithë punonjësit.

Për këtë arsye, në të tilla rrugë nuk është e mundur të ndahet roli i rregullvënësve prej punonjësve, prandaj ata janë ortakë në punën e mirë, kur kanë vënë një ligj apo kanë dhënë një orientim të mirë, në një kohë kur për punonjësit kanë vënë ligje e rregulla të këqija.

Kur'ani Famëllartë dhe hadithet e nderuara e trajtojnë me kujdesin më të madh si çështjen e vënësve të një rruge të drejtë dhe nxjerrjen e një ligji të mirë, ashtu edhe çështjen e atyre që nxjerrin një ligj të padrejtë.

Nga ajetet e mësipërme mësuam se mendjemëdhenjtë që punojnë për të futur të tjerët në rrugën e humbjes, përveç barrës së tyre do të mbajnë edhe barrën e atyre që ata i orientuan të punojnë në rrugën e humbjes.

Kjo çështje ka një rëndësi të madhe, aq sa Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Orientuesi për punë të mirë, është si ai që e bën punën e mirë".¹

Në komentimin e këtij ajeti transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Cilido që bën thirrje për udhëzim në rrugën e drejtë, atë ndiqe dhe ai njeri ka shpërblimet e atyre që ndjekin udhëzimin e tij, pa i pakësuar ndjekësve asgjë prej shpërblimit. Cilido që bën thirrje për të hyrë në rrugën e humbjes, atë kundërshtojë, sepse ai do të mbajë aq barra sa janë ata që e kanë ndjekur këtë thirrës të rrugës së humbjes, pa pakësuar asgjë nga barra që do të mbajnë ata që e ndjekin".²

Gjithashtu transmetohet se Imam Bàkiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Kush vendos një rrugë veprimi të drejtë, atë ndiqe dhe ai ka shpërblimin e të gjithë atyre që punojnë me atë rrugë, pa i pakësuar asgjë nga shpërblimi atyre që e bëjnë punën e mirë ndërsa, ai që vendos një rrugë veprimi të keqe, atë kundërshtojë, mbi atë

¹ "Uesàilush Shijah", vëll. 11, f. 436.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 6, f. 356, fundi i ajetit që kemi në studim.

do të rëndojë edhe barra e atyre që punuan me rrugën e tij të keqe, pa i pakësuar asgjë nga barra për punën e keqe që bënë duke vepruar sipas kësaj rruge të keqe”.¹

Ka edhe transmetime të tjera që kanë të njëjtën përmbajtje të transmetuara prej Imamëve të pastër, transmetime, të cilat shejhu El Àmilij i ka mbledhur në vëllimin e njëmbëdhjetë të librit të tij “El Uesàil”, pjesa: “Urdhërimi për punë të mirë dhe ndalimi i punës së keqe”, kapitulli i gjashtëmbëdhjetë.

Në “Sahihun” e Muslimit transmetohet një hadith prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përcjellë prej Mundhir bin Xheririt, i cili tregon se ai vetë ka dëgjuar babanë e tij të thotë: “Një mesditë ishin tek i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndërkaq vijnë disa njerëz këmbëzbathur e të zhveshur, ishin vjelës frutash, ose punues gunash, ose kalitës shpatash. I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u mavijos në fytyrë kur pa se sa të varfër ishin ata njerëz, hyri brenda dhe urdhëroi Bilalin të thërriste ezanin, fali namaz dhe pastaj filloi të lexojë disa ajete të Kur’ànit Famëlartë: **“O njerëz, kijeni frikë Zotin tuaj që u ka krijuar prej një njeriu të vetëm”** (surja “En Nisà”, ajeti nr. 1); **“All’llahu është vëzhgues mbi ju”**, (surja “En Nisà”, ajeti nr. 1); **“Kijeni frikë All’llahun dhe njeriu le të shikojë se çka përgatitur për nesër...”** (surja “El Hashr”, ajeti 18), pastaj e përsëriti frazën: **“Kijeni frikë All’llahun”** dhe vazhdoi: “Burri le të japë sadaka një dinar, një dirhem, rrobën e tij, një “saë” (masë e barabartë afërsisht me 3,5 kg) prej grurit të tij, një “saë”, prej hurmave të tij” derisa sa tha: “një gjysmë hurme”.

¹ “Uesàilush Shijah”, vëll. 11, f. 437.

Përcjellësi i hadihit vazhdon: “menjëherë një burrë prej ensareve erdhi me një thes që mezi po e mbante, pastaj njerëzit vinin njëri pas tjetrit, derisa pamë që u bënë dy grumbuj me ushqime e rroba, ndërkaq fytyra e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) filloi të shkëlqejë si hëna e re”. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Kush hap një rrugë veprimi të mirë, ai ka shpërblimin për atë rrugë veprimi, si dhe shpërblimin e atyre që ndjekin rrugën e tij, por pa i pakësuar atyre asgjë prej shpërblimit që i takon. Ndërsa kush hap në Islam një rrugë veprimi të keqe, ai do të mbajë barrën e kësaj rruge të keqe, si dhe barrën e atyre që pas tij do të punojnë sipas asaj rruge të keqe, por pa i pakësuar atyre asgjë nga barra për punën e keqe”.¹

Pyetje: Si do t'i përgjigjemi pyetjes se si duhet t'i harmonizojmë këto transmetime që janë e kundërta e asaj që thuhet në ajetin 164 të sures “El En'àm”: **“askush nuk do të mbajë barrën e tjetrit?”**.

Përgjigje: përgjigjja bëhet e qartë me anë të konstatimit se ata nuk mbajnë përgjegjësi për mëkatet e të tjerëve, por vetëm për mëkatet e tyre, por ata ngaqë janë pjesëmarrës në mëkatet e të tjerëve, do të kenë pjesën e tyre në mëkatet e përbashkëta, domethënë se edhe mëkatet jo të drejtpërdrejta, konsiderohen si mëkate që i kanë kryer ata vetë.

¹ “Sahihu i Muslimit”, vëll. 2, f. 704, kapitulli “Nxitja për të dhënë sadaka qoftë edhe një gjysmë hurme”.

2- Dorëzimi pas kalimit të kohës

Të paktë janë ata që mohojnë të vërtetën pasi e kanë parë atë në periudhën e dëshmisë, domethënë në kohën e agonisë, prandaj ne shohin se mëkatarët e mizorët e shfaqin besimin menjëherë pasi prej syve të tyre hiqet ajo perdja e shkujdesjes dhe mendjemadhësia, atëherë, kur syri pas vdekjes do të shohë jetën e pritjes në varr, ashtu siç e treguan qartë ajetet e mësipërme me fjalën e vetë mohuesve kur thonë: **“ata dorëzohen** (në çastin e vdekjes)“.

Qëllimi i fundit në këtë punë është se të gjithë do të dorëzohen, porse fjalët e tyre do të jenë të ndryshme, një pjesë prej tyre do të shfaqësohen për punët e tyre të këqija duke thënë: **“nuk kemi bërë ndonjë të keqe”**; domethënë se aq shumë kanë gënjer, sa gënjeshtër është përzier me mishin e me gjakun e tyre dhe të gjithë punën e kanë mbuluar plotësisht me gënjeshtër, megjithëse e dinë mirë se gënjeshtër nuk sjellë asnjë dobi në këtë vend, ku të gjitha punët dëshmohen, megjithëkëtë, edhe këtu ata vazhdojnë të gënjejnë!

Disa ajete të Kur'anit Famëlartë njoftojnë se do të ketë prej atyre që do të gënjejnë edhe në Ditën e Gjykimit, ashtu siç thotë ajeti 23 i sures “El En’àm”: **“betohemi në All’llahun, Zotin tonë, ne nuk ishim politeistë** (mushrikë)!“.

Një pjesë tjetër prej atyre do të pendohen dhe do të kërkojnë të rikthehen në jetën e tokës për të përmirësuar punën e tyre, ashtu siç shpjegohet qartë në ajetin 12 të sures “Es Sexhdeh”.

Një pjesë tjetër do të mjaftohet të shfaqë besimin, pra veprojnë ashtu si veproi edhe Faraoni, siç tregohet në ajetin 9 të sures “Jûnes”.

Pavarësisht nga fjalët që ata do të thonë, asnjëra prej tyre nuk do të pranohet, sepse ato janë fjalë të thëna jo në kohën kur duheshin thënë, por kur koha ka përfunduar, sepse nuk ka asnjë vlerë ai besim që shfaqet në gjendje nevojë të ngutshme.

Ajetet 30 - 32

﴿وَقِيلَ لِلَّذِينَ اتَّقَوْا مَاذَا أَنْزَلَ رَبُّكُمْ قَالُوا خَيْرًا لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةٌ وَلَدَارُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ وَلَنِعْمَ دَارُ الْمُتَّقِينَ ٣٠ جَنَّاتٌ عَدْنٍ يَدْخُلُونَهَا يُجْرَى مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ لَهُمْ فِيهَا مَا يَشَاءُونَ كَذَلِكَ يَجْزِي اللَّهُ الْمُتَّقِينَ ٣١ الَّذِينَ تَتَوَفَّاهُمُ الْمَلَائِكَةُ طَيِّبِينَ يَقُولُونَ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ ادْخُلُوا الْجَنَّةَ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ٣٢﴾

“Atyre që kishin frikë All’lahun (dënimin e All’llahut) u thuhet: ‘Ç’është ajo që shpalli Zoti juaj?’ Ata thanë: ‘Shpalli çdo të mirë; ata që bënë punë të mira edhe në këtë jetë shpërblimin e kanë të mirë, por shpërblimi i tyre në Botën Tjetër është shumë më i mirë, eh, sa vend i mirë ashtë ai i të devotshmëve.”

“Është Xhenneti i Adnit, ku ata do të hyjnë, nëpër të rrjedhin lumenj dhe aty kanë gjithçka që dëshirojnë; kështu i shpërblen All’llahu të devotshmit.”

“Të cilët duke qenë të pastër, engjëjt ua marrin shpirtin me fjalë të mira duke u thënë: Eselàmun alejkum (paqe e shpëtim për ju), gjetët shpërblimin, hyni në Xhennet për punët që bëtë.”

Komentimi

Përfundimi i të devotshmëve dhe i punëmirëve

Në ajetet e mësipërme lexuam fjalët e politeistëve rreth Kur'anit dhe përfundimin e punës së tyre, ndërsa tani së bashku me besimtarët do të hyjmë në besimin e tyre dhe në përfundimin që ata do të kenë. Për këtë Kur'ani Famëlartë thotë: **“Atyre që kishin frikë All'Ilahun (dënimin e All'Ilahut) u thuhet: Ç'është ajo që shpalli Zoti juaj? Ata thanë: Shpalli çdo të mire.”**

Në tefsirin e Kurtubij'jit tregohet se një burrë prej banorëve të shkretëtirës vinte në Mekë gjatë ditëve të Haxhit dhe pyeste politeistët (mushrikët) për Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ata i përgjigjeshin: “Ai është magjisttar, ose vjershëtar, ose falltar, ose i çmendur dhe, kur ai pyeste besimtarët ata i thoshin: “All'Ilahu i ka zbritur të mirën dhe udhëzimin në rrugën e drejtë”.

Nuk ka më të bukur sesa shprehja “të mirën” dhe, duke qenë se është shprehje e pakushtëzuar, ajo përfshin të gjitha të mirat: ligjin e mirë, lumturinë, mirëqenien, përparimin material e moral, të mirën në këtë botë e në Botën Tjetër, të mirën për njeriun si individ dhe si shoqëri, të mirën në edukim e në arsimim, në politikë e në ekonomi, sigurinë dhe lirinë; thënë më shkurt, fjala “të mirën” përfshin të mirën në të gjitha kuptimet, madje vetë ndërtimi i fjalës në arabe “khajren” tregon se kjo fjalë ka kuptim gjithëpërfshirës.

Vetë ajetet e Kur'anit Famëlartë e përshkruajnë Kur'anin e nderuar me cilësi të shumta, si: dritë, shërim, udhëzim në rrugën e drejtë, ndarës – në kuptimin që ndanë të vërtetën nga e gabuara – i

vërtetë, këshillë dhe me cilësi të tjera të ngjashme si këto që u thanë, porse në ajetin që kemi në studim, cilësia ka ardhur me fjalën “*kharjen*” - të mirën - fjalë, e cila në vetvete shpreh një kuptim përgjithësues e gjithëpërfshirës për të gjitha kuptimet e veçanta.

Dallimi është shumë i qartë në cilësimin e Kur'anit prej politeistëve dhe besimtarëve; besimtarët thanë “të mirën”, domethënë, All'Ilahu zbriti të mirën. Me këtë përgjigje del hapur besimi i tyre se Kur'ani është Revelatë Hyjnore.

Nga ana tjetër shikojmë se kur u thuhet politeistëve (mushrikëve) se ç'është ajo që shpalli Zoti juaj? Ata thanë: “*esâtijrul ev'velijne*” - mite të të hershmëve. Kjo përgjigje e politeistëve mohon qartë se Kur'ani nuk është Revelatë Hyjnore.

Gjithashtu ajeti që kemi në studim e shpreh shumë qartë rezultatin përfundimtar të besimit që shfaqën besimtarët me përgjigjen e tyre, ndërsa ajetet e mësipërme e bënë të qartë përfundimin e politeistëve për fjalët që thanë: dënim në këtë botë e në Botën Tjetër, dënim material e dënim moral të dyfishuar, kurse: **“ata që bënë punë të mira edhe në këtë jetë shpërblimin e kanë të mire.”**

Fjala “*shpërblim*”, në tekstin e Kur'anit është thënë me fjalën “*haseneten*”, të mirë, të bukur, ashtu siç përfshin edhe fjala “*khajren*” të gjitha llojet e të mirave e të gjitha mirësitë në jetën e kësaj bote dhe, ajeti shton: **“por shpërblimi i tyre në Botën Tjetër është shumë më i mirë, eh, sa vend i mirë është ai i të devotshmëve.”**

Fraza **“eh, sa vend i mirë është ai i të devotshmëve”**, vjen e shoqëruar me fjalën gjithëpërfshirëse “*khajrun*” “të mirën”, sepse shpërblimi do të jetë sipas vlerësimit të punës në sasi dhe në cilësi.

Nga sa thamë del shumë qartë se ajeti *“lil’ledhijne ahsenù...”* **“ata që bënë punë të mira...”** deri në fundin e ajetit, shpreh fjalët e All’llahut të Gjithëpushtetshëm dhe ky kuptim përforcohet kur vihet përballë ajeteve të mësipërme.

Disa interpretues të Kur’anit kanë thënë se kjo fjalë në vetvete shpreh dy mundësi:

- 1) ajo është fjalë e All’llahut;
- 2) është vazhdim i fjalës së të devotshmëve.

Ajeti vijues e përshkruan në mënyrë përgjithësuese vendin e të devotshmëve në Botën Tjetër me fjalën e Kur’anit Famëlartë: **“Është Xhenneti i Adnit, ku ata do të hyjnë; nëpër të rrjedhin lumenj dhe aty kanë gjithçka që dëshirojnë.”**.

Vallë a mund të ketë përshkrim më të zgjeruar dhe më gjithëpërfshirës se ky përshkrim për të shpjeguar mirësitë e Xhennetit?

Gjerësia e shprehjes së ajetit bëhet edhe më e qartë kur shikojmë në ajetin 71 të sures *“Ez’zukuruf”*: **“aty do të kenë gjithçka që u dëshiron shpirti dhe u kënaqen sytë”**. Siç shihet, në këtë ajet është theksuar fjala **“gjithçka që u dëshiron shpirti”**, në një kohë kur në ajetin që kemi në studim, dëshira është shprehur në mënyrë gjithëpërfshirëse me fjalën: **“gjithçka që dëshirojnë”**.

Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë kanë arritur në përfundimin se ardhja e shprehjes **“dhe aty kanë”** përpara shprehjes **“gjithçka që dëshirojnë”**, njofton një vend të caktuar, domethënë se njeriu ka mundësi të arrijë çdo gjë që dëshiron vetëm në Xhennet dhe jo në këtë botë.

Më sipër kemi thënë se ajetet që kemi në studim shpjegojnë qartë mënyrën e jetës e të vdekjes së të devotshmëve dhe, duke bërë krahasimin me atë që thuhet në ajetet e mëparshme në lidhje me politeistët e mendjemëdhenjtë, kur engjëjt i marrin atyre shpirtin, ne pamë se vdekja për ata është vetëm fillimi i një etape të re dënimi e vuajtjesh dhe më pas atyre do t'u thuhet: **“hyni në dyert e Xhehennemit”**.

Kurse të devotshmëve: **“të cilët duke qenë të pastër, engjëjt ua marrin shpirtin me fjalë të mira”**, sepse ata janë krejtësisht të pastër prej ndotjes së vënies shok All'llahut në adhurim (shirk), ata janë të pastër edhe nga njollat e padrejtësisë e mendjemadhësisë dhe plotësisht të pastër nga mëkatet, atyre, engjëjt u thonë: **“selàmun alejkum”** - *paqe e shpëtim për ju* - paqja është simboli i sigurisë e i shpëtimit.

Pastaj të devotshmëve u thuhet: **“hyni në Xhennet për punët që bëtë”**.

Vdekja e të devotshmëve ka ardhur me foljen **“tetevef'fâhum”** **“ua marrin shpirtin”**. Në brendi të saj, kjo folje ka butësinë dhe thekson se vdekja nuk do të thotë zhdukje, ose përfundim i çdo gjëje, pasi vdekja është një fazë kalimtare për në një botë tjetër.

Në tefsirin **“El-Mijzàn”** tregohet se në këtë ajet gjenden tri çështje:

1- Pastërtia e besimtarëve prej së ligës së vënies shok All'llahut në adhurim.

2- Fjala **“paqe e shpëtim për ju”** që engjëjt u thonë besimtarëve, është me siguri fjalë për ata.

3- **“hyni në Xhennet për punët që bëtë”**, është orientim për ata që të nisen drejt Xhennetit.

Të tria këto dhunti përmenden edhe në ajetin 82 të sures “El-En’àm”: **“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e përzier me besime të kota, për ata do të ketë siguri dhe janë të udhëzuar në rrugën e drejtë.”**.

Ajetet 33 - 37

﴿هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا أَنْ تَأْتِيَهُمُ الْمَلَائِكَةُ أَوْ يَأْتِيَ أَمْرُ رَبِّكَ كَذَلِكَ فَعَلَ
الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَمَا ظَلَمَهُمُ اللَّهُ وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ^{٣٣}
فَأَصَابَهُمْ سَيِّئَاتُ مَا عَمِلُوا وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ^{٣٤} وَقَالَ
الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا عَبَدْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ نَحْنُ وَلَا آبَاؤُنَا
وَلَا حَرَمْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ كَذَلِكَ فَعَلَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَهَلْ
عَلَى الرُّسُلِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ^{٣٥} وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنْ اعْبُدُوا
اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ فَمِنْهُمْ مَنْ هَدَى اللَّهُ وَمِنْهُمْ مَنْ حَقَّتْ عَلَيْهِ
الضَّلَالَةُ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكَذِّبِينَ^{٣٦}
إِنْ تَحْرِصْ عَلَى هُدَاهُمْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ يُضِلُّ وَمَا لَهُمْ مِنْ
نَاصِرِينَ^{٣٧}﴾

“A mos presin ata (idhujtarët) diçka tjetër përveçse që t’u vijnë engjëjt (t’i marrin shpirtin), ose t’u vijë urdhri (dënimi) i Zotit tënd; ashtu punonin edhe ata që ishin para tyre; All’Ilahu atyre nuk i bëri padrejtësi, por ishin ata që i bënë padrejtësi vetvetes.”

“Prandaj ata i goditi dënimi i të këqijave që bënë dhe i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin.”

“Ata që i bënë shok All’llahut, thanë: sikur të kishte dashur All’llahu, as ne e as prindërit tanë nuk do të adhuronin asgjë tjetër përveç Tij dhe nuk do të ndalonin (nuk do të bënë haram) asnjë send (përveç ndalesave) të Tij; kështu vepruan edhe ata që ishin para tyre. Vallë, mos kanë të Dërguarit ndonjë detyrim tjetër përveçse të kumtojnë (mesazhin) qartë?”

“Në çdo popull, Ne çuam të Dërguar që t’u thonë: adhuroni vetëm All’llahun dhe largoni (mos adhuroni) djajtë; prej atyre pati nga ata që All’llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë, pati edhe nga ata që e merituan të jenë në rrugën e humbjes; udhëtoni nëpër botë dhe shihni si është fundi i përgënjeshtresve.”

“Nëse ti (o Muhammed) përpiqesh t’i udhëzosh ata në rrugën e drejtë (dije se), All’llahu nuk e udhëzon atë që shkon vetë në rrugën e humbjes dhe për ata nuk ka ndihmues.”

Komentimi

Kumtimi qartë i mesazhit, misioni i Profetëve

Kur'ani Famëlartë paraqet para nesh edhe një herë tjetër realitetin e mendimeve të politeistëve (mushrikëve) mendjemëdhenj dhe me një gjuhë përbetimi e kërcënimi tregon se ç'është ajo që ata presin dhe thotë: **“A mos presin ata (idhujtarët) diçka tjetër përveçse që t'u vijnë engjëjt (t'i marrin shpirtin)”**, domethënë engjëjt e vdekjes, që është çasti kur për ata mbyllen portat e pendimit (teubes), domethënë se për ata nuk ka më rrugë për kthim, sepse njëherësh janë mbyllur edhe regjistrat e punëve!

Mos vallë ata presin që t'i vijë urdhri i All'llahut për dënimin e tyre? Ajeti vijon: **“ose t'u vijë urdhri (dënimi) i Zotit tënd”**, domethënë me ardhjen e urdhrit, portat e pendimit mbyllen përfundimisht dhe që nga ky çast nuk ka më rrugë për përmirësim.

Çfarë mendimi i drejton ata dhe çfarë mllefi e kokëfortësie i sundon?!

Fjala e ajetit *“el melàiketu”* - engjëjt - përfshin të gjithë engjëjt, por këtu bëhet fjalë vetëm për engjëjt e ngarkuar me marrjen e shpirtrave. Ky ajet i nderuar është në harmoni të plotë me ajetet paraardhëse që gjithashtu flisnin për engjëjt.

Pjesa e ajetit: **“ose t'u vijë urdhri (dënimi) i Zotit tënd”**, patjetër që mund të komentohet në shumë kuptime, porse kuptimi me më shumë peshë është se fjala *“urdhri”* tregon ardhjen e dënimit, sepse me këtë kuptim, kjo fjalë ka ardhur edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë.

Të dyja frazat e këtij ajeti në tërësi kanë kuptimin e qortimit për mendjemëdhenjtë, të cilët nuk i zgjuan prej gjumit të shkujdesjes as mësimet e All'llahut dhe as këshillat e Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*), prandaj ajeti i nderuar u thotë atyre drejtpërdrejt se vdekja dhe dënimi hyjnor shumë shpejt do t'i ndërgjegjësojë për këtë, porse atëherë ky ndërgjegjësim nuk do të sjellë asnjë dobi.

Më pas, ajeti shpjegon se ata nuk janë të parët që për shkak të punëve që kanë bërë ndodhen në këtë gjendje dhe kanë këto vese, ashtu siç njofton ajeti i nderuar: **“ashtu punonin edhe ata që ishin para tyre; All'llahu nuk u bëri padrejtësi, por ishin ata që i bënë padrejtësi vetvetes.”**.

Shumë shpejt, ata do të gjejnë rezultatin e punëve që bënë me duart e veta.

Ajeti i nderuar thekson edhe një herë se padrejtësia, despotizmi dhe e keqja në fund të fundit kthehen kundër vetë të padrejtë, despotit e të keqit, sepse puna e keqe lë gjurmë të këqija në shpirtin e në psikologjinë e keqbërësit, atij i nxihet zemra dhe humb sigurinë e qetësinë.

Përfundimin e punës së tyre i Larti e përmend me fjalën e Tij: **“Prandaj ata i goditi dënimi i të këqijave që bënë dhe i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin.”**.

Fraza e Kur'anit *“hàka bihim”*, është në kuptimin *“i goditi ata”*, porse disa interpretues të Kur'anit Famëlartë, si Kurtubij'i dhe Ferijdi Vexhdiji, kur kanë interpretuar këtë ajet kanë thënë se kjo frazë ka kuptimin *“i rrethoi ata”*.

Megjithëkëtë është e mundur që të dyja kuptimet të bashkohen, dhe atëherë interpretimi do të jetë: *“mbi ata zbriti dënimi dhe ai i ka rrethuar”*.

Në të gjitha gjendjet, fraza e ajetit: **“Prandaj ata i goditi dënimi i të këqijave që bënë”**, thekson edhe një herë faktin se punët e këqija kthehen kundër keqbërësit në mënyrë të barabartë, qoftë në këtë botë, qoftë në Botën e Ardhshme. Punët që ai ka bërë do t'i shikojë të trupëzuara në forma të ndryshme dhe do t'i shkaktojnë dhimbje e tortura, kështu që në dënimin e tij nuk ka asgjë tjetër përveç punëve që ai ka bërë.

Ajeti pasardhës e vë theksin mbi njëren prej fjalëve boshe të politeistëve dhe thotë: **“Ata që i vunë shok All'llahut thanë: Sikur të kishte dashur All'llahu, as ne e as prindërit tanë nuk do të adhuronin asgjë tjetër përveç Tij dhe nuk do të ndalonin** (nuk do të bënë haram) **asnjë send** (përveç ndalesave) **të Tij.”**.

Fjala e politeistëve **“dhe nuk do të ndalonin”**, tregon se politeistët në kohën e injorancës para Islamit e kishin shpallur të ndaluar (haram) mishin e disa lloje kafshësh, por i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua kundërshtoi fuqishëm.

Politeistët (mushrikët) pretendonin se gjithçka që ata kishin bërë, që nga adhurimi kushtuar idhujve deri te lejimi e moslejimi i sendeve ishte në përputhje me kënaqësinë e All'llahut të Lartësuar dhe me lejen e Tij!

Mundet që kjo fjalë e politeistëve zbulon ekzistencën e doktrinë së fatalizmit në morinë e besëtytnive të tjera që ata besonin. Me këtë pohim, ata donin të thoshin se çdo veprim që

bënin, ishte i paracaktuar në mënyrë të prerë që ata ta bënin pikërisht atë veprim, ashtu siç thonë e veprojnë shumë prej politeistëve.

Fjala e tyre mbase shpreh edhe diçka tjetër: “Ata nuk thoshin se veprimi i tyre ishte i diktuar të bëhej patjetër prej tyre, domethënë, që ata ishin të detyruar, por me këtë fjalë ata protestonin kundër All’llahut të Gjithëfuqishëm dhe del sikur donin të thoshin: ‘Kur punët tona nuk e kënaqnin All’llahun e Lartësuar, përse Ai nuk dërgoi te ne Profetë që të na udhëzonin në rrugën e drejtë dhe të mos bënim punët që bëmë?’ Veç kësaj shtonin se heshtja e All’llahut e mosndalimi nga ana e Tij i punëve që bënin, është një argument që tregon se Ai ishte i kënaqur me punët tona”.

Kjo mundësi e fjalës së politeistëve është në harmoni me fjalët e fundit të ajetit dhe të ajeteve që vijnë më pas.

Pikërisht për këtë arsye i Larti thotë drejtpërdrejt: **“kështu vepruan edhe ata që ishin para tyre. Vallë mos kanë të Dërguarit ndonjë detyrim tjetër përveçse të kumtojnë (mesazhin) qartë?”**.

Kjo fjalë e të Lartit në radhë të parë shpjegon qartë se pretendimit të pavlerë dhe të gabuar të politeistëve se All’llahu i Lartësuar heshti për punët tona, ju i përgjigjeni: “Në të vërtetë All’llahu ka dërguar te ju Profetë, të cilët kanë bërë thirrje që të besonin në All’llahun, Zotin Një e të Vetëm (Teuhid) dhe të mohoni idhujtarinë”.

Në radhë të dytë: All’llahu i Lartësuar në asnjë mënyrë nuk udhëzon në rrugën e drejtë me detyrim, por Ai bën që ju të shikoni rrugën e drejtë dhe në të vërtetë kështu ka ndodhur.

Fraza e ajetit **“kështu vepruan edhe ata që ishin para tyre”**, është për të qetësuar zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ai të mos hidhërohej, njëkohësisht që zemra e tij të forcohej kur përballej me punët që kurdisnin idhujtarët dhe thotë se All'llahu gjithmonë është me atë dhe është Ai që e ndihmon të Dërguarin e Tij.

Pasi shpjegon se detyra e Profetëve është kumtimi qartë i mesazhit, ajeti vijues e thekson në mënyrë shumë të përmbledhur edhe thirrjen e Profetëve të përparshëm: **“Në çdo popull, Ne çuam të Dërguar.”**.

Rrënja e fjalës së ajetit *“ymetin”* - popull - në gjuhën arabe është fjala *“el-um’mu”* - nënë - në kuptimin e çdo sendi që në brendësi të tij përmban një send tjetër. Nisur nga fakti se fjala *“ymetin”* thuhet edhe për një grup njerëzish, ose edhe për një komunitet të lidhur në unitet të përcaktuar nga pikëpamja e kohës ose vendit, mendimit, ose qëllimit.

Ky kuptim i kësaj fjale përforcohet edhe më shumë gjatë studimit të atyre ajeteve të Kur’anit Famëlartë ku gjendet kjo fjalë. Në Kur’ânin Famëlartë kjo fjalë është përmendur 64 herë.

Kur’ani Famëlartë e bën të qartë brendinë e thirrjes së Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) me fjalën: **“adhuroni vetëm All'llahun dhe largohuni (mos adhuroni) djallin”**.

Baza e thirrjes së të gjithë Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) dhe hapi i parë në lëvizjen e tyre është pikërisht thirrja në Njësimin e All'llahut (*besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm*), si dhe lufta kundër *“tægùtit”* - djallit - domethënë kundër adhurimit të djallit dhe adhurimit të idhujve, sepse baza e Njësimit të All'llahut

bëhet sunduese vetëm kur dëbohen idhujt nga mesi i shoqërive njerëzore, ndryshe nuk mund të ndërmerret asnjë program përmirësues.

Siç kemi shpjeguar edhe më sipër fjala “*tàgùt*” është forma më e lartë e fjalës “*tugjàn*” - *despotizëm*, domethënë tejkalim i kufirit, veprim i tepruar dëmsjellës. Gjithashtu fjala “*tàgùt*” thuhet për çdo send që është shkak për tejkalimin e caktut logjik të veprimit, prandaj fjala “*tàgùt*” këtu ka ardhur për të treguar djallin, idhullin, sundimtarin despotin, mendjemadhin dhe çdo orientim që çon në rrugën e gabuar.

Fjala “*tàgùt*” - *djall, idhull, despot e mendjemadh* - në Kur'an ka ardhur në numrin njëjës, por herë të tjera ka ardhur edhe në numrin shumës me fjalën “*tàvàgijt*” - *djajtë, idhujt, despotët, mendjemëdhenjtë*. Me fjalë të tjetra, të gjitha llojet e orientuesve që çojnë në rrugën e gabuar, në rrugën që kundërshton të vërtetën.

Le të shikojmë se si ishin rezultatet që arriti thirrja e Profetëve (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi ta!*) në rrugën e besimit në Njësimin e All'Ilahut. Për këtë, Kur'ani Famëlartë njofton: **“por prej atyre pati nga ata që All'Ilahu i udhëzoi në rrugën e drejtë, pati edhe nga ata që e merituan të jenë në rrugën e humbjes.”**

Pikërisht këtu ngrihen zërat e atyre që besojnë në fatalizmin, domethënë se veprimi njerëzor është i detyruar, madje për të përforcuar doktrinën e tyre, ata mbështeten pikërisht në këtë ajet të Kur'anit!

Shpesh është përsëritur se ajetet e Kur'anit që flasin për udhëzimin në rrugën e drejtë dhe për rrugën e humbjes, janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, prandaj tek ato nuk mbetet më asnjë

dyschim se tregojnë detyrimin; në të kundërt, këto ajete shpjegojnë qartë se njeriu e për zgjedh vetë drejtimin e rrugës për vënien në zbatim të vullnetit të tij dhe është krejtësisht i lirë që në sjelljet e tij të ndjekë rrugën që dëshiron.

Në caktimin Hyjnor, udhëzimi në rrugën e drejtë patjetër që bëhet vetëm pasi janë të gjitha premiset paraprake të udhëzimit hyjnor për në rrugën e drejtë, gjithashtu edhe hyrja në rrugën e humbjes bëhet vetëm kur janë të gjitha premiset paraprake të udhëzimit Hyjnor për në rrugën e drejtë, porse ato nuk kanë zënë vend në mendimet e në veprimet e njeriut dhe, kjo e vërtetë theksohet shpesh në ajetet e Kur'ânit Famëlartë.

All'Ilahu i Lartësuar (siç tregojnë qartë ajetet e Kur'ânit Famëlartë) nuk udhëzon në rrugën e drejtë as mohuesit, as ata që e tejkalojnë masën logjike të veprimit, as gënjeshtarët, ndërsa ata që luftojnë në rrugën e All'Ilahut dhe i janë përgjigjur thirrjes së Profetëve (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi ta!*) janë të përfshirë në mëshirën e të Plotpushtetshmit, pikërisht këta njerëz udhëzon Ai në rrugën e Tij të drejtë, Ai e bën mbarë që të ecin në rrugën e plotësimit, ndërsa ata të grupit të parë (mohuesit, shpërdoruesit, tiranët, mendjemëdhenjtë, gënjeshtarët etj.), i lë nën kujdestarinë e vetes së tyre, prandaj ata e pësojnë prej rezultateve të punëve të këqija që kanë kryer.

Meqenëse veçantitë dhe efektet e punëve, të mira e të këqija, janë prej All'Ilahut të Gjithëpushtetshëm, mundësohet që rezultatet e atyre punëve t'i bashkohen All'Ilahut të Lartësuar, dhe kështu udhëzimi në rrugën e drejtë dhe shkarja në rrugën e humbjes janë përsëri prej All'Ilahut të Lartësuar.

Që në fillim, urtësia e All'llahut kërkon që udhëzimi në rrugën e drejtë të jetë ligjor dhe është ligjëruar me dërgimin e Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*), të cilët i kanë bërë thirrje njerëzve të besojnë në Njësimin (*All'llahu është Zoti Një e i Vetëm*), gjithashtu ata i kanë bërë thirrje njerëzve të kundërshtojnë adhurimin e idhujve (shirkun). Ata vazhdimisht i kanë bërë njerëzit të ecin në udhën e besimit të vërtetë, me të cilin është krijuar njeriu. Ai që tregon edukatën e mirë, duke iu përgjigjur thirrjes së Profetëve, individ ose grup, ka merituar butësinë e mëshirën e All'llahut dhe ka arritur udhëzimin në rrugën e drejtë, rrugën e besimit me të cilin ai është krijuar.

Po, kjo është rruga e All'llahut dhe jo ashtu siç kanë thënë përkrahësit e shkollës së fatalizmit. All'llahu u bën thirrje njerëzve me anë të Profetëve dhe vetëm pasi kjo thirrje e Profetëve ka arritur të njerëzit, Ai krijon besimin ose mosbesimin në zemrën e individëve. Në këtë çështje vetëkuptohet që nuk ka vend për pyetje dhe logjikisht shkak për këtë nuk mund t'i kërkohej në asnjë mënyrë All'llahut të Gjithëpushtetshëm.

Sa e pështrirë është ajo që ata thonë në adresë të All'llahut të Lartësuar, pasi fjala e tyre nuk përputhet as me mendjen, as me ndjenjat dhe as me çdo rregull logjik!

Nga ajeti që kemi në studim vëmë re se ndryshe flet për udhëzimin në rrugën e drejtë dhe ndryshe flet për shkarjen në rrugën e humbjes. Në lidhje me çështjen e udhëzimit në rrugën e drejtë, ajeti thotë: **“prej atyre pati nga ata që All'llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë”**, ndërsa për kategorinë e dytë nuk thotë se All'llahu i çoi ata në rrugën e humbjes, pasi rruga e humbjes kishte bërë vend në brendësi të tyre, ishte e ngjitur mbi ata, ashtu siç thotë

ajeti i nderuar: **“pati edhe nga ata që e merituan të jenë në rrugën e humbjes”**.

Kjo ndryshueshmëri në shprehje ka mundësi të theksojë atë që thuhet në disa ajete të tjera që janë në harmoni me atë që tregohet në disa transmetime që trajtojnë çështjen e udhëzimit në rrugën e drejtë dhe çështjen e shkarjes në rrugën e humbjes dhe, rezultati në lidhje me këtë çështje do të ishte:

“Pjesa më e madhe e udhëzimit të njeriut në rrugën e drejtë ka lidhje me premisat që All’llahu i Lartësuar ka krijuar për këtë qëllim. I Larti i ka dhënë njeriut mendjen, e ka krijuar me natyrshmërinë që të besojë në Njësimin (*All’llahu është Zoti Një e i Vetëm*), ka dërguar Profetët, ka bërë që argumentet ligjore dhe argumentet e krijimit të jenë të qarta dhe, të gjitha këto për njeriun janë të mjaftueshme që ai të marrë vendimin e tij në liri të plotë për të arritur qëllimin që i ka vënë vetes”.

Për sa i përket çështjes së shkarjes në rrugën e humbjes, kjo çështje u takon atyre që shkanë në rrugën e humbjes, sepse ata shkuan në kundërshtim me argumentet ligjore e me argumentet e krijimit me të cilat All’llahu i Lartësuar i ka krijuar. Por, këtë natyrë të pastër me të cilën janë krijuar, ata e mbuluan me një perde të errët, mbyllën ligjet e krijimit të pastër dhe hodhën pas shpine argumentet ligjore dhe argumentet e krijimit; ata mbyllën sytë e veshët që të mos shihnin e të mos dëgjonin thirrjen e Profetëve (*Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!*), përfundimisht ata nga fillimi në fund ishin në rrugën e humbjes. Por, a nuk është e gjitha kjo prej vetë atyre?

Ajeti 79 i sures “En Nisà” e thekson qartë kuptimin e mësipërm: **“Çdo e mirë që të vjen është prej All’llahut dhe çdo e keqe që të ndodh e ke prej vetes sate.”**.

Në librin “Usùl Kàfij”¹, transmetohet se Imami Ali bin Mùsà Err’rridà (*Paqja qoftë mbi të!*) në përgjigje të pyetjes së njërit prej shokëve të tij rreth çështjes së fatalizmit dhe përzgjedhjes tha: “Shkruaj, me emrin e All’llahut, Mëshirëmadhit, Mëshirëplotit, Ali bin Hysejni ka thënë: All’llahu i Gjithëpushtetshëm thotë: ‘O bir i Àdemit (o njeri), me dëshirën Time, ti je ai që je, me fuqinë Time kreve detyrimet që Unë kam urdhëruar, me mirësinë Time qëndrove fuqishëm dhe nuk më kundërshtove, Unë të bëra të dëgjosh e të shikosh, çdo e mirë të vjen është prej All’llahut dhe çdo pësim që të godet, atë e ke prej vetes sate, por ja që ty të vjen mirë të thuash se të mirat i ke prej vetes tënde, kurse pësimet që të godasin të vijnë prej Meje”.

Në fundin e ajetit që kemi në studim, vjen edhe urdhri i përgjithshëm për të zgjuar prej gjumit të shkujdesjes ata që kanë shkarë në rrugën e humbjes, si dhe për të forcuar shpirtërisht të udhëzuarit në rrugën e drejtë: **“udhëtoni nëpër botë dhe shihni si është fundi i përgënjeshtresve”**.

Ky ajeti i Kur’ànit është argument që flet qartë e shkoqur për lirinë e vullnetit të njeriut. Nëse udhëzimi në rrugën e drejtë dhe shkarja në rrugën e humbjes do të ishin të paracaktuara, nuk do të kishte kuptim që ajeti të ftonte njerëzit për të udhëtuar nëpër tokë e për të shikuar si e patën përfundimin përgënjeshtresit e përparshëm, madje urdhri për të udhëtuar nëpër tokë me qëllim

¹ “Usùlul Kàfij”, vëll. 1, f. 159, kapitulli “El xhebru uel kaderu”, vëll. 12.

për të parë, e përforcon çështjen e përzgjedhjes prej vetë njeriut dhe caktimin e së ardhmes me dëshirën e tij, gjithashtu tregon se njeriu në përzgjedhjen e tij nuk është aspak i detyruar.

Në lidhje me çështjen e ecjes nëpër tokë për të parë e për të menduar rreth përfundimit të punëve për të cilat flet Kur’ani Famëlartë, janë bërë studime të shumta që kanë sjellë një informacion të bollshëm dhe, e përsërisim se këtë çështje e kemi trajtuar me hollësi gjatë interpretimit të ajetit 137 të sures “Àli Imràn”.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që është objekt studimi, thekson edhe më shumë qetësimin e zemrës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke i shpjeguar qartë se deri ku ka arritur gjendja e atyre që kanë shkarë në rrugën e humbjes:

“Nëse ti (o Muhammed) përpiqesh t’i udhëzosh ata në rrugën e drejtë (dije se) All’llahu nuk e udhëzon atë që shkon vetë në rrugën e humbjes dhe për ata nuk ka ndihmues.”.

Fjala e ajetit “*tahris*” - *nëse ti përpiqesh* - në gjuhën arabe nënkupton kërkimin e një sendi me seriozitet edhe pse mundohesh shumë.

Është e mahnitshme që ajeti nuk përfshin të gjithë ata që kanë devijuar nga rruga e vërtetë, sepse gjithëpërfshirja është në kundërshtim me misionin e Profetit që është udhëzimi në rrugën e drejtë dhe kumtimi i mesazhit. Historia sjell fakte të shumta në lidhje me efektin e madh që ka udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë. Sa shumë janë ata që kanë shpëtuar prej llumit të rrugës së

humbjes dhe janë bërë përkrahësit më të sinqertë të së vërtetës, madje janë bërë prej atyre që bëjnë thirrje për të vërtetën.

Nisur nga ky shpjegim, bëhet e qartë se fraza e mësipërme e ajetit bën fjalë vetëm për një grup të caktuar prej atyre që kanë shkarë në rrugën e humbjes, të cilët vetëm nga mllëfi e kokëfortësia kanë rënë në shkallët më të ulëta në rrugën e kundërshtimit të së vërtetës dhe rezultati është: janë të mbuluar prej mendjemadhësisë, vetëpëlqimit, shkujdesjes ndaj mëkateve dhe kështu përpara një njeriu të këtillë janë mbyllur dyert e udhëzimit në rrugën e drejtë. Njerëzve të kësaj kategorie nuk i sjellin asnjë dobi përpjekjet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ai bën për t'i udhëzuar ata në rrugën e drejtë, edhe sikur puna për udhëzimin e tyre të vazhdojë për një kohë mjaft të gjatë, sepse ata padyshim që kanë devijuar nga e vërteta për shkak të punëve të tyre të liga, të cilat i kanë çuar deri në atë shkallë sa janë bërë prej atyre që kurrë nuk e pranojnë udhëzimin në rrugën e drejtë.

Është e natyrshme që për të këtillë njerëz të mos ketë ndihmues, sepse ndihmuesi e ofron ndihmën e bashkëpunimin e tij vetëm në një mjedis të përshtatshëm ku vlen të jepet ndihma.

Kjo frazë e ajetit është argument për mohimin e fatalizmit, sepse munda e përpjekja e ndihmuesit, në të vërtetë sjell dobi vetëm nëse në brendësi të të ndihmuarit ka një lëvizje drejt përmirësimit për në rrugën e drejtë. Vetëm atëherë ai derdh mund e punë, e ndihmon atë dhe e merr në dorë udhëzimin e tij për në rrugën e drejtë, prandaj edhe ti mendohu e mundohu të kuptosh.

Mbase përdorimi i fjalës “ndihmues”, “nàsirijne” në tekstin e Kur’anit ka ardhur në numrin shumë për të theksuar se besimtarët janë e kundërta e të devijuarve në rrugën e humbjes, sepse besimtarët kanë më shumë sesa një ndihmues. Ndhmues i besimtarëve është All’llahu i Gjithëpushtetshëm, janë Profetët (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi ta dhe mbi familjen e tyre!*) janë njerëzit e mirë të All’llahut (*ibàdu-ll’llàhi-s’sàlihijne*), janë edhe engjëjt e mëshirës.

Këtë ndihmë, Kur’ani Famëlartë e thekson fare qartë edhe në ajetin 51 të sures “Gàfir”: **“Ne patjetër do të ndihmojmë të Dërguarit Tanë e besimtarët në jetën e kësaj bote edhe Ditën e paraqitjes së dëshmive.”**.

Përsëri Kur’ani Famëlartë e thekson këtë ndihmë edhe në ajetin 30 të sures “Fus’silet”: **“Pa dyshim se ata që thanë All’llahu është Zoti ynë dhe ishin të palëkundshëm (në këtë besim), atyre u vijnë engjëjt (në prapësinë e vdekjes e i thonë) mos u frikësoni, mos u hidhëroni, përgëzohuni me Xhennetin që u është premtuar.”**.

Dy Hulmtime

1- Ç'është kumtimi i qartë?

Në ajetet që kemi në studim pamë se misioni kryesor i Profetëve ishte kumtimi i qartë i mesazhit: **“vallë mos kanë të Dërguarit ndonjë detyrim tjetër përveçse të kumtojnë (mesazhin) qartë?”**.

Kjo do të thotë se thirrja për udhëzimin në rrugën e drejtë patjetër duhet bërë hapur, megjithëse në disa raste, kushtet kanë qenë të atilla kur prej Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) është kërkuar që thirrja e tyre të bëhej në fshehtësi, por kjo kërkesë ka qenë vetëm për një kohë të kufizuar, sepse mënyra e bërjes së thirrjes në fshehtësi në kohën e Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) nuk dëgjohej prej gjithë shoqërisë dhe në atë gjendje nuk e kishte efektin e kërkuar.

Prandaj thirrja duhet bërë hapur e në mënyrë sa më të përsosur, me fjalë sa më të kuptueshme, me fjalë të prera dhe e shoqëruar me planifikim e me sistem. Kjo rrugë e thirrjes është kusht themelor që thirrja të jetë e suksesshme në mesin e shoqërisë.

Kur lexojmë historinë e të gjithë Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) do të shikojmë se ata e kanë bërë thirrjen hapur dhe duke e shpjeguar me qartësinë më të madhe, pavarësisht se ndihmësit që kishin prej popullit të tyre ishin një pakicë.

Kjo është rruga për të gjithë Profetët që bënë thirrje për në rrugën e vërtetë, ata kurrë nuk e veshën thirrjen e tyre me hipokrizi dhe kurrë nuk i bënë komplimente as të gabuarës e as atyre që kanë

mbështetur të gabuarën, në të kundërt, ata mbajtën të gjitha pasojat që patën për shkak të kësaj thirrjeje të qartë e të përcaktuar deri në imtësi.

2- Për çdo popull një të dërguar?

Fjala e Gjithëpushtetshmit: **“Në çdo popull, Ne çuam të dërguar”**, na vë përpara pyetjes: sikur për çdo popull të kishte një të Dërguar, atëherë Profetët do të shfaqeshin në të gjitha trevat e botës, porse historia nuk na e tregon një gjë të këtillë, atëherë si është orientimi?!

Përgjigjja bëhet e qartë kur do të mendojmë se qëllimi me dërgimin e Profetëve është arritja e thirrjes së All’llahut në veshët e të gjithë popujve. Për shembull, kur Profeti ynë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u dërgua në qytetin e Mekës, në qytetet e tjera të zonës së Hixhazit nuk kishte profet, por emisarët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkonin nëpër qytetet e vendeve të tjera dhe bashkë me ata, në ato vende arrinte edhe zëri i të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Thirrja e tij arrinte në veshët e të gjithëve, duke shtuar edhe letrat e mesazhet e shumta që ai i dërgoi shteteve të tjera, si Iranit, Bizantin, Abisinisë etj. Kjo ishte rruga me të cilën ai e kumtoi mesazhin Hyjnor.

Edhe sot, ne e dëgjojmë thirrjen e Profetit tonë (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pavarësisht nga periudha e gjatë historike që na ndanë, por kjo u bë e mundur falë dijetarëve emisarë, të cilët gjatë shekujve e përhapen mesazhin

që ai kumtoi. Prandaj, fjala e ajetit nuk ka qëllim vetëm thjesht kuptimin që për çdo popull ka një Profet.

Ajetet 38 - 40

﴿وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَا يَبْعَثُ اللَّهُ مَنْ يَمُوتُ بَلَى وَعْدًا عَلَيْهِ حَقًّا وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ^{٣٨} لِيُبَيِّنَ لَهُمُ الَّذِي يُخْتَلِفُونَ فِيهِ وَلِيَعْلَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّهُمْ كَانُوا كَاذِبِينَ^{٣٩} إِنَّمَا قَوْلُنَا لِشَيْءٍ إِذَا أَرَدْنَاهُ أَنْ نَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ^{٤٠}﴾

“Ata bënë një betim të fortë se All’llahu nuk do të ringjallë atë që vdes; patjetër, (Ringjallja) është premtimi i Tij i prerë, porse shumica e njerëzve nuk dinë.”

“(i ringjall të vdekurit) për t’u sqaruar atyre çështjen për të cilën ata kishin mosmarrëveshje dhe për t’u bërë të njohur atyre që nuk besuan se ata janë gënjeshtarë.”

“Kur Ne dëshirojmë një send, Ne vetëm i themi atij bëhu dhe ai menjëherë bëhet.”

Shkakun e zbritjes

Në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit 38 të kësaj sureje, interpretuesit e Kur'anit Famëllartë tregojnë se njëri prej myslimanëve i kishte dhënë borxh një politeisti (mushriku), mirëpo ky i fundit nuk po ia shlyente borxhin që i kishte marrë. Nga kjo mosshlyerje e borxhit, myslimani u zemërua aq sa u betua në Ditën e Gjykimit dhe tha: “Ajo që unë shpresoj për atë pas vdekjes, të jetë ai kështu siç jam unë tani”. Politeisti i tha: “Ti pretendon se do të ringjallesh pas vdekjes, ndërkaq u betua në All'llahun duke thënë: “All'llahu nuk do të ringjallë atë që ka vdekur dhe All'llahu i Lartësuar zbriti ajetin në fjalë”.¹

Komentimi

Ringjallja është fundi i mosmarrëveshjeve

Ajetet e mësipërme në kuadrin e trajtimit të Njësimit të All'llahut dhe mesazhit të Profetëve të Tij, prekën vetëm njërën anë të problemit të Ringjalljes.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh thotë: **“Ata bënë një betim të fortë se All'llahu nuk do të ringjallë atë që vdes.”.**

¹ Tefsiri “Mexhmeul Bejan”, vëll. 6, f. 360; Tefsiri “El Kurtubij”; Tefsiri “Ruhul Xhinan”, fundi i ajetit në fjalë.

Ky mohim i pabazuar në asnjë argument që ata e filluan me një betim të fortë e shumë të qartë, tregon vetëm injorancën e tyre dhe për këtë Kur'ani i përgjigjet atyre me fjalën e tij: **“patjetër, (Ringjallja) është premtimi i Tij, porse shumica e njerëzve nuk dinë”**.

Fjalët *“belà” - patjetër, “vaëden” - premtim dhe “hak’kan” - e vërtetë e padiskutueshme* - të përmendura në këtë ajet të Kur'anit Famëlartë, theksojnë qartë se Ringjallja do të bëhet patjetër.

Në përgjithësi, përplasia me dikë që mohon të vërtetën duhet të jetë në masën e mohimit të tij, madje duhet të jetë më i fuqishëm, me qëllim që efekti i keq shpirtëror i mohimit të asgjësohet me një kundërshtim të prerë. Gjithashtu është detyrë të bëhet e qartë se mohimi i së vërtetës është injorancë dhe duhet kundërshtuar derisa efekti i mohimit të zhduket plotësisht, ashtu siç thuhet në ajetin e nderuar: **“por shumica e njerëzve nuk dinë”**.

Më pas, Kur'ani Famëlartë trajton njërin prej qëllimeve të Ringjalljes dhe fuqinë e madhe të All'Ilahut për të bërë Ringjalljen; Kur'ani Famëlartë hedh poshtë dyshimin e atij që thotë se nuk do të ketë Ringjallje pas vdekjes, ose thotë që Ringjallja është diçka e kotë.

Për këtë ajeti thotë: **“(i ringjallë të vdekurit) për t'i sqaruar atyre çështjen për të cilën kishin mosmarrëveshje dhe për t'ua bërë të njohur atyre që nuk besuan se ata janë gënjeshtarë”**, domethënë, për të hedhur poshtë mohimin e tyre se All'Ilahu nuk do të ringjallë atë që vdes!

Bota e ekspozimit të dëshmvive, bota e ngritjes së perdes, bota e zbulimit të asaj që ata e kishin mbuluar, është bota e daljes së të

vërtetave sheshit, ashtu siç thuhet në ajetin 22 të sures “Kâf’’: **“Ti ishe i shkujdesur ndaj kësaj (Dite), prandaj Ne e hoqëm perden prej teje dhe shikimi yt sot është i mprehtë”**, si dhe në ajetin 9 të sures “Et Tàrik’’: **“Ditën kur do të gjurmohen të fshehtat”**; gjithashtu edhe në ajetin 48 të sures “Ibràhim’’: **“ata të gjithë dalin sheshit para All’lilaut, i cili është Një, Mposhtësi i çdo sendi.”**.

Në Ditën e zbulimit të sekreteve nuk kanë më kuptim kundërshtimet doktrinare edhe pse do të ndodhë që disa mendjemëdhenj që kanë valëvitur flamurin e mohimit, Ditën e Kiametit me qëllim që të justifikojnë veten e tyre do të thonë gënjeshtër në disa vendqëndrime, por edhe kjo mundësi mund të jetë vetëm një përjashtim kalimtar.

Gënjeshtër e mohuesve në atë Ditë, deri në njëfarë mase është e ngjashme me mohimin e krimit nga ana e kriminelit në fillimin e gjykimit, porse shumë shpejt ai do të përulet para së vërtetës kur të ekspozohen kundër tij provat materiale të mbledhura prej krimit të tij dhe ato prova nuk pranojnë në asnjë rast që dikush tjetër të dënohet në vend të kriminelit; kështu do të ndodhë edhe me nxjerrjen e të vërtetave, por kjo nxjerrje e të vërtetave do të jetë shumë më e qartë se dalja në shesh e së vërtetës në gjykatën e kësaj bote.

Megjithëse objektivat e jetës pas vdekjes - Bota e Ahiretit - janë të shumta, si për shembull, plotësimi i njeriut, zbatimi i drejtësisë së All’lilaut, trupëzimi i qëllimit të jetës në këtë botë, vërshimi i butësisë së All’lilaut dhe të tjera qëllime të ngjashme; të gjitha këto qëllime, Kur’ani Famëlartë i ka përmendur në ajete të ndryshme të sureve të Kur’anit. Ajete ynë si objekt studimi thekson edhe një objekt tjetër përveç objektivave të lartpërmendur,

ngritjen e kundërshtimeve dhe kthimin e të gjithë njerëzve në Njësimin e All'Ilahut (Teuhid), në besimin se *All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm*.

Ne besojmë se baza e Njësimit është më e rëndësishmja prej bazave që rregullojnë botën, ajo është bazë gjithëpërfshirëse. Kjo bazë vërteton ekzistencën, cilësitë dhe punët e All'Ilahut të Gjithëpushtetshëm, vërteton botën e krijesave dhe ligjet që e rregullojnë këtë botë dhe vërteton se në fund të fundit, çdo gjë detyrimisht do të kthehet në këtë bazë.

Ne besojmë se të gjitha problemet nga të cilat vuan njerëzimi në të gjithë globin, do të marrin fund, sepse ato janë probleme të lindura prej kontradiktash, të cilat nga ana e tyre kanë prodhuar luftërat e përplasjet. Ne besojmë se të gjitha këto do të marrin fund falë ndërtimit të një qeverie unike nën udhëheqjen e Imamit Mehdi (*All'Ilahu e shpejtoftë shfaqjen e tij të uruar*), sepse në fund të fundit është detyrë të largohet e të hiqet çdo gjë që kundërshton frymën e ekzistencës, frymën e Njësimit (Teuhidit).

Për sa i përket ndryshueshmërisë së doktrinës, ajo kurrë nuk do të ngrihet plotësisht prej kësaj bote, për shkak se ekziston bota e mbulimeve dhe e perdeve që do të marrin fund vetëm Ditën e madhe të Gjykimit, kur të vijë koha e daljes në shesh e të gjitha të vërtetave.

Kthimi në unitet dhe marrja fund e kontradiktave doktrinare është prej dimensioneve të Ringjalljes dhe për këtë flet qartë edhe ajeti objekt i studimit tonë.

Në ajete të shumta të Kur'anit Famëlartë përsëritet se All'Ilahu i Gjithëpushtetshëm Ditën e Gjykimit do të gjykojë

çështjet që kanë njerëzit në mes tyre, do të gjykojë të gjitha punët rreth të cilave ata kishin kundërshtime me njëri-tjetrin.

Në ajetin vijues, Kur'ani Famëlartë e thekson të vërtetën e Ringjalljes për cilindo që e mendon të pamundur rikthimin e njeriut edhe një herë në jetë pasi ka vdekur: **“Kur Ne dëshirojmë një send, Ne vetëm i themi atij bëhu dhe ai menjëherë bëhet.”**.

Para kësaj fuqie kaq të plotë, a mund të mbetet më dyshim ose ndonjë ngurrim në lidhje me fuqinë e të Lartit, të Gjithëpushtetshmit për të ringjallur të vdekurit?!

Patjetër që nuk është nevoja të shpjegohet që fjala “*bëhu*”, është përmendur vetëm si domosdoshmëri e shprehjes me fjalë, sepse nuk ka nevojë të dalë urdhri i All'llahut “*bëhu*”, pasi vetëm vullneti i të Gjithëfuqishmit është i mjaftueshëm të bëhet gjithçka që Ai ka qëllim.

Nëse do të sillnim një shembull të vogël dhe natyrisht të cunguar nga jeta jonë – sepse shembulli më i lartë i takon vetëm All'llahut – do të shikojmë se kemi mundësi që në mendjen tonë të formojmë figurën e një sendi, vetëm se ashtu na shkoi në mendje, apo se ashtu që vullneti ynë. Patjetër që nuk kemi asnjë problem të përfytyrojmë pamjen e një mali të lartë, ose detin e dallgëzuar, ose një kopsht të mbushur me lulet e me pemët më të mira. Për këtë përfytyrim nuk kemi nevojë të shqiptojmë ndonjë fjalë që në mendjen tonë të formohet figura e sendit që dëshirojmë, pasi vullneti ynë për të përfytyruar atë që duam bën që figura e atij sendi menjëherë shfaqet në mendjen tonë.

Le të shikojmë bashkërisht transmetimin e ardhur prej Imamit Ali bin Mūsà Rridà (*Paqja qoftë mbi të!*), ku do të lexojmë se

Safvàn bin Jahjà i ka thënë Imamit: “Më flit për vullnetin e All’llahut të Lartësuar dhe për vullnetin e njerëzve”. Ai tha: “Vullneti i të krijuarit (njeriut) është dituria e tij si dhe të gjitha punët që ai bën pasi ka shfaqur vullnetin e tij, pa harruar se vullnetin e njeriut e bën vetëm All’llahu, i Gjithëfuqishmi; kurse All’llahu për konkretizimin e vullnetit të Tij nuk ka nevojë as të hajë, as të interesohet, as nuk mendohet, pasi të gjitha këto cilësi u përkasin njerëzve dhe janë krejtësisht të pamundura të jenë cilësi të All’llahut të Lartësuar. Por, kur Ai shfaq vullnetin e Tij që një send të bëhet, ai send bëhet menjëherë. Urdhri i All’llahut “*bëhu*” është pa fjalë, pa u shqiptuar me gjuhë, pa u menduar dhe pa “**Si?**”, ashtu siç është Vetë i Larti, pa “**Si?**”.¹

¹ “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 109, kreu “El Iradetu”, hadithi 3.

Ajetet 41 – 42

﴿وَالَّذِينَ هَاجَرُوا فِي اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مَا ظَلَمُوا لَنُبَوِّتَنَّهُمْ فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً
وَلَأَجْرُ الْآخِرَةِ أَكْبَرُ لَوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ، الَّذِينَ صَبَرُوا وَعَلَى رَبِّهِمْ
يَتَوَكَّلُونَ﴾

“Atyre që emigruan për hir të All’Ilahut pasi u dhunuan, do t’u mundësojmë një vendbanim të mirë në këtë botë, por shpërblimi në botën tjetër është më i madh, sikur njerëzit të dinin (për këtë shpërblim).”

“Janë ata që bënë durim dhe u mbështetën vetëm në Zotin e tyre.”

Shkaku i zbritjes

Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë kanë theksuar se ajeti 41 i sures “En Nahl” ka zbritur për myslimanët që u torturuan në Mekë, si Suhajbi, Am’mari, Bilali, Khab’babi etj., të cilët All’Ilahu i Lartësuar i stabilizoi në Medine. Interpretuesit kanë përmendur se Suhajbi u ka thënë banorëve (idhujtarë) të Mekës: “Unë jam i moshuar, nëse do të qëndroj me ju nuk do të keni asnjë dobi prej meje, por edhe nëse jam kundër jush, nuk do të shkaktoj asnjë dëm,

prandaj merreni pasurinë time, por më lini të shkoj". Suhajbi u dha atyre të gjithë pasurinë e tij dhe emigroi për tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Njëri prej atyre i tha: "Ku e ke fitimin e shitjes o Suhajb?".

Transmetohet se njëri prej kalifëve, kur i jepte ndonjërit prej emigrantëve (muhàxhirëve) ndonjë gjë të mirë, i thoshte: "Merre, kjo është ajo që të ka premtuar All'llahu në këtë botë, kurse ajo që Ai do të japë më vonë, është ku e ku më e mirë", pastaj i lexonte këtë ajet.¹

Komentimi

Shpërblimi i emigrantëve

Shpesh kemi thënë se Kur'ani Famëlartë përdor metodën e krahasimit si metodën më të rëndësishme për edukimin dhe orientimin, si dhe për gjithçka që është qëllim të ekspozohet për njerëzit. Prandaj, Kur'ani shtron së bashku me çështjen edhe diçka tjetër që i qëndron kundrejt çështjes së shtruar. Padyshim që kjo bëhet me qëllim që të specifikohen dallimet dhe që njerëzit të përvetësojnë kuptimin e asaj që u shtrua në mënyrë sa më të qartë.

Në ajetet e mësipërme pamë bisedën me politeistët (mushrikët) dhe me mohuesit e Ditës së Gjykimit, kurse në ajetet që kemi në studim, biseda kalon tek emigrantët e sinqertë. Në këtë

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 6, f. 361, fundi i ajetit që kemi në studim.

grup ajetesh, krahasimi mes dy grupeve bëhet me qëllim që të shpjegohet sa më qartë karakteri i të dyja grupeve (besimtarëve dhe mohuesve).

Në lidhje me besimtarët, Kur'ani thotë: **“Atyre që emigruan për hir të All'lahut pasi u dhunuan, do t'u mundësojmë një vendbanim të mirë në këtë botë, por shpërblimi në Botën Tjetër është më i madh, sikur njerëzit të dinin (për këtë shpërblim).”**.

Në ajetin vijues, emigrantët përshkruhen besimtarë të mirë me dy cilësi, ashtu siç njofton ajeti: **“Janë ata që bënë durim dhe u mbështetën vetëm në Zotin e tyre.”**.

Hulumtime

1- Siç dihet, myslimanët kanë emigruar dy herë: emigrimi i parë ishte relativisht i kufizuar (kur një grup myslimanësh të kryesuar prej Xhafer bin Ebù Tàlibit emigruan në Abisini) dhe i dyti, emigrimi i përgjithshëm për te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëhet fjalë për emigrimin e myslimanëve prej Mekës në Medine.

Siç u theksua edhe në shkakun e zbritjes, ajeti i parë bën fjalë për emigrimin e dytë.

Edhe më parë e kemi trajtuar rëndësinë e emigrimit në jetën e myslimanëve, në të kaluarën dhe në kohën e sotme, si dhe vijimin e emigrimit në çdo shekull e në çdo kohë; të gjitha këto i kemi

trajtuar hollësisht gjatë komentimit të ajetit 100 të sures “En Nisà” dhe të ajetit 75 të sures “El Enfàl”.

Sido që të jetë, emigrantët (muhàxhirinët) kanë një pozitë shumë të lartë në Islam. Vetë Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pas tij myslimanët, janë interesuar shumë për emigrantët, sepse kanë qenë pikërisht ata që e vunë jetën e tyre dhe të gjithë pasurinë që kishin në dispozicion të thirrjes së uruar islame, madje ka pasur prej atyre që e kanë vënë jetën e tyre në rrezik, të tjerë kanë lënë të gjithë pasurinë që kishin (si Suhajbi) dhe e konsideruan veten e tyre fitues në këtë transaksion të bekuar.

Nëse nuk do të ishin këto sakrifica të emigrantëve, mjedisi i korruptuar në Mekë dhe arbitrariteti i djajve që sundonin në Mekë, kurrë nuk do të kishte lejuar që të dilte jashtë saj zëri i Islamit. Ky zë më pas do të arrinte te të gjithë njerëzit; djajtë e Mekës do të bënin çmos që të mos dëgjohej, të mbetej i fshehur dhe të varrosej përgjithmonë në zemrat e besimtarëve. Ishin emigrantët ata që me transformimin e tyre të studiuar e të ndërgjegjshëm, me emigrimin e tyre të uruar, jo vetëm që çliruan Mekën, por e çuan zërin e Islamit në të gjitha trevat e botës. Në këtë mënyrë, emigrimi u bë një rrugë islame që do të vijojë përgjatë gjithë historisë, kudo që do të përballlet me kushte si ato të Mekës para emigrimit (hixhretit).

2- Faza e ajetit: **“Ata që emigruan për hir të All’llahut”**, pa u përmendur fraza: “në rrugën e All’llahut”, thekson sinqeritetin në shkallën më të lartë që i karakterizonte emigrantët e parë, të cilët emigruan për hir të All’llahut; në rrugën e Tij, në kërkim të kënaqësisë së Tij, emigruan për të ruajtur fenë e All’llahut dhe për

të mbrojtur këtë fe; jo që të shpëtonin prej vrasjes apo që të kërkonin fitime të tjera materiale.

3- Fraza vijuese e ajetit: **“pasi u dhunuan”**, shpjegon qartë moslargimin nga fusha e betejës menjëherë, pasi patjetër që duhet bërë durim dhe të mbahet aq barrë e aq përgjegjësi sa është e mundur të mbahet.

Por, kur durimi ndaj dhunës së armikut bëhet motiv për të shtuar guximin e trimërinë e armikut, patjetër që do të vijë edhe dobësimi i besimtarëve. Pikërisht në këtë cak, emigrimi bëhet detyrë, me qëllimin për të fituar fuqinë e domosdoshme dhe për t'u përgatitur në pritje të ballafaqimit të pashmangshëm dhe për të vazhduar luftën në rrugën e All'llahut në të gjitha nivelet në pozita më të favorshme për besimtarët, derisa gjendja të përfundojë me fitoren e mbështetësve të së vërtetës në rrafshin ushtarak, shkencor e në fushën e kumtimit të mesazhit Islam.

4- Fjala e të Lartit: **“atyre do t'u mundësojmë një vendbanim të mirë në këtë botë”**, tregon se ata që emigruan për hir të All'llahut, edhe pse në fillim humbën mundësitë materiale të domosdoshme për ballafaqimin me politeistët, më vonë do të ishin triumfues edhe nga ana materiale.

Atëherë, përse besimtari vazhdon të mbajë mbi kurrizin e tij goditjet e njëpasnjëshme të armikut dhe të poshtërohet prej këtyre goditjeve?! Përse nuk emigron dhe me trimërinë që e karakterizon të luftojë në rrugën e All'llahut, duke u nisur prej ndonjë pozicioni të ri dhe të marrë prej armikut të drejtën e uzurpuar me dhunë?!

Kjo çështje është trajtuar shumë qartë në ajetin 100 të sures “En Nisà”: **“Kush emigron në rrugën e All’llahut, gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë.”**

5- Shkaku i zgjedhjes së dy cilësive për emigrantët (muhàxhirinët), “durimi” dhe “mbështetja vetëm tek All’llahu”, për të përshkruar emigrantët në rrugën e All’llahut, është shumë i qartë: emigranti përballet me kushte shumë të vështira dhe të mundimshme, që në radhë të parë kanë nevojë për qëndrueshmëri e durim për të përballuar të hidhurën e tyre, që më pas të mbështeten vetëm në All’llahun e Lartësuar e të Gjithëpushtetshëm. Nëse njeriu gjatë tronditjeve nervore dhe gjendjeve tepër të rënduara humb sigurinë dhe mbështetjen morale, atëherë durimi, vazhdimi në rrugën e drejtë dhe qëndrueshmëria e tij do të ishin krejtësisht të pamundura.

Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë janë shprehur se përzgjedhja e cilësisë së “durimit” në këtë ajet, ka ardhur për faktin se fillimi i ecjes në rrugën e emigrimit për hir të All’llahut, në radhë të parë ka nevojë për rezistencë dhe qëndrueshmëri para dëshirave të unit njerëzor, kurse përzgjedhja e cilësisë së mbështetjes vetëm tek All’llahu, ka ardhur për shkak se përfundimi i ecjes, do të thotë mënjanim i plotë prej çdo gjëje, përveç All’llahut të Lartësuar dhe forcimi i lidhjes vetëm me Atë.

Bazuar mbi këtë shpjegim, cilësia e parë, durimi, është për fillimin e rrugës së emigrimit dhe cilësia e dytë, mbështetja vetëm tek All’llahu, është për fundin e kësaj rruge.

Sido që të jetë, s’ka rrugë për të bërë emigrimin e jashtëm, pa bërë më parë emigrimin e brendshëm; kjo do të thotë se për të

realizuar emigrimin në rrugën e All'llahut, në radhë të parë njeriu ka detyrë të shkëpusë marrëdhëniet e tij të brendshme të interesave materiale dhe të synojë ecjen në drejtim të virtyteve morale, pasi vetëm kështu ka mundësi të lërë vendin e mohuesve, qoftë edhe duke lënë në dorën e tyre gjithçka që ka në zotërim, dhe më pas të kalojë në vendin e besimtarëve.

Ajetet 43 - 44

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ إِلَّا رِجَالًا نُوحِي إِلَيْهِمْ فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ^٣، بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ^٤﴾

“Ne edhe para teje kemi dërguar vetëm burra, të cilëve u dhamë Revelatën dhe, ju (o idhujtarë) pyetni dijetarët (e Teuràtit e të Inxhilit) nëse nuk dini.”

“(i kishim dërguar ata) me argumente e me libra të shenjtë dhe ty të zbritëm Kur’ànin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, duke shpresuar se ata do ta studiojnë (Kur’ànin).”

Komentimi

Pyetni nëse nuk dini:

Në dy ajetet e mëparshme, Kur’ani Famëlartë në vijim të bisedës në lidhje me politeistët (mushrikët) shpalos gjendjen e emigrantëve (muhaxhirëve) dhe tani rikthehet të shpjegojë çështjet e kaluara që kanë lidhje me bazat e fesë. Këtë e bën nëpërmjet

përgjigjes për njërin prej problemeve të njohura, rreth të cilit politeistët stisnin gënjeshtër dhe thoshin: “Përse All’llahu nuk ka zbritur engjëll për të kumtuar mesazhin e Tij?” Ose thoshin: “Përse All’llahu nuk e ka pajisur Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me një fuqi të jashtëzakonshme që të na detyrojë të heqim dorë prej punëve tona!?”

All’llahu, i Gjithëpushtetshmi, i drejtohet Profetit dhe njëkohësisht u përgjigjet atyre me fjalën e Tij: **“Ne edhe para teje kemi dërguar vetëm burra, të cilëve u dhamë Revelatën.”**

Po, Profetët e All’llahut (*Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!*) të gjithë janë njerëz; si të tillë kanë instinkte e ndjenja njerëzore, ndiejnë dhimbje dhe kanë nevoja si të gjithë.

Ndërsa engjëjt nuk kanë mundësi t’i kuptojnë mirë këto punë, nuk kanë mundësi të kenë dijeni siç duhet për gjërat që lëvizin në thellësi të njeriut.

Më sipër shpjeguam se misioni i Profetëve (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi ta dhe mbi familjet e tyre!*) është kumtimi i mesazhit qiellor, i Revelatës Hyjnore dhe çuarja e thirrjes së All’llahut te njerëzit, si dhe puna me ngulm e me mjete natyrore për të realizuar objektivat e Revelatës dhe jo me anë të përdorimit të forcave të jashtëzakonshme të All’llahut. Megjithëse edhe këto janë rrugë të natyrshme për të detyruar njerëzit të pranojnë thirrjen e të heqin dorë prej besëtytnive; por Profetët (*Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!*) nuk kërkuan kurrë të kenë në dispozicion fuqi të jashtëzakonshme apo të përdorin dhunë për të mbështetur thirrjen e tyre; jo, ata vetëm kumtuan mesazhin dhe këshilluan; ata ishin të

vetëdijshëm se mënyrat e përmendura, nuk linin më vend që njeriu të ndihej krenar për besimin dhe për plotësimin e tij të gjithanshëm.

Për të përforcuar këtë të vërtetë, Kur'ani shton: **“dhe, ju (o idhujtarë) pyetni dijetarët (e Teuràtit e të Inxhijlit) nëse nuk dini”**.

Fjala e Kur'anit *“edh'dhikri”* - është në kuptimin *dituri, informacion*, kurse fjala *“ehledh dhikri”* - *dijetarët* - ka një kuptim më gjithëpërfshirës. Në këtë shprehje përfshihen të gjithë dijetarët e specialistët e të gjitha fushave. Disa autorë tefsiresh, frazën *“ehledh'dhikri”* e kanë interpretuar me kuptimin: dijetarët e ithtarëve të librave të mëparshëm (jehuditë e të krishterë). Por, ky interpretim në asnjë rast nuk do të thotë që kjo frazë të kufizohet në një kuptim shabllon, prandaj në të vërtetë nuk do të thotë asgjë më shumë se zbatim i një titulli të përgjithshëm vetëm në njërin prej konfirmimeve të tij. Për sa i përket pyetjes së politeistëve nëse Profetët dhe të Dërguarit e mëparshëm dhe mbajtësit e mesazheve e të detyrave Hyjnore, ishin njerëz, përse duhet që për këtë pyetje të shkojmë të kërkojmë përgjigje te dijetarët e librave të mëparshëm, jehuditë e të krishterë.

Kjo ndodh për faktin e njohur: pavarësisht nga mospërputhja e plotë që ekziston mes dijetarëve jehuditë e atyre të krishterë nga njëra anë dhe politeistëve nga ana tjetër, ata kanë të përbashkët kundërshtimin e Islamit. Për këtë arsye, dijetarët e ithtarëve të librave të mëparshëm janë një burim shumë i mirë informacioni për politeistët, të cilët në kuadrin e stisjes së gënjeshtreve e kanë të domosdoshme të njihen me gjendjen e Profetëve të përparshëm.

Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'ânit thotë se fjala “*edh'dhikr*” ka dy kuptime: *i pari*, ruajtje në mendje dhe *i dyti*, vetëkujtim dhe sjellja e një sendi në zemër. Pikërisht për këtë arsye thuhet se fjala “*edh'dhikr*”, *kujtesë*, është dy herë kujtesë: me zemër dhe me fjalë; gjithashtu kemi parë se me fjalën “*edh'dhikr*” thirret edhe Kur'âni, për shkak se i shtron të vërtetat dhe i zbulon ato.

Ajeti vijues thotë: “(i kishim dërguar ata) **me argumente e me libra të shenjtë**”.¹

Fjala “*el bej'jinàti*” - “*argumente*”, është shumësi i fjalës *argument* dhe është në kuptimin e *argumenteve të qarta*, por këtu mundet që të jetë për mrekullitë e argumentet që vërtetënin mesazhet që kanë kumtuar Profetët e përparshëm (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) dhe të thirrjeve që ata kanë bërë.

Kurse fjala “*ez zuburi*”, është shumësi i fjalës “*zebûr*” dhe do të thotë *libër*.

¹ Interpretuesit e Kur'ânit kanë dhënë disa alternativa që kanë lidhje me foljen së cilës i referohet fraza “*bilbej'jinàti uez'zuburi*”. Disa kanë thënë se kjo frazë ka lidhje me foljen “*ata nuk dinë*” dhe, ashtu siç thamë më sipër, ky kuptim është në harmoni me kuptimin e jashtëm të ajeteve të Kur'ânit, krahas vërejtjes se folja “*nuk dinë*”, është folje kalimtare. Interpretues të tjerë kanë thënë: “Fraza ‘*bilbej'jinàti uez'zuburi*’ ka lidhje me frazën vlerësuese “*Ne dërguam*”, sepse në origjinë kjo frazë është “*Ne i dërguam ata me argumente dhe me libra*”. Të tjerë interpretues janë shprehur se fraza e ajetit “*bilbej'jinàti uez'zuburi*”, ka lidhje me fjalinë foljore të ajetit paraardhës “*dhe nuk kemi dërguar*”; të tjerë kanë thënë: “Ajo frazë ka lidhje me fjalët e ajetit ‘*Ne u shpallëm atyre*’”. Shihet qartë se në të gjitha opinionet e shtruar, disa prej atyre e vënë kuptimin e ajetit brenda kufijve të përcaktuar, por në tërësi, nuk ka ndonjë dallim të madh mes këtyre opinionëve.

Argumentet e qarta (elbej'jinàt) janë argumente që vërtetojnë profetësinë, kurse librat (ez'zubur) tregojnë librat në të cilat janë të mbledhura mësimet e Profetëve.

Më pas, Kur'ani Famëlartë i drejton fjalën Profetit tonë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“edhe ty të zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, duke shpresuar se ata do të studiojnë (Kur'anin)”**, domethënë që t'u shpjegojnë njerëzve përgjegjësitë që ata mbajnë ndaj argumenteve të Zotit të tyre, ndaj të Vërtetit.

Prandaj (o Muhammed) edhe thirrja që t'i bën e mesazhi që ti mban, nuk janë të reja. Ne u kemi zbritur libra edhe të Dërguarve që kanë jetuar përpara teje që ata t'i mësonin njerëzve obligimet e ligjit të fesë, kurse ty të kemi zbritur Kur'anin që të shpjegosh qartë mësimet e kuptimet e tij, që me Kur'anin të zgjosh mendimin njerëzor dhe që njerëzit të ecin në rrugën e të Vërtetit, pasi më parë janë ndërgjegjësuar në lidhje me përgjegjësitë që kanë marrë mbi shpatullat e tyre për të hyrë në rrugën e plotësimit. Por, ky ndërgjegjësim i njerëzve në asnjë rast nuk do të thotë se do të vijë me rrugën imponimit e të forcës.

Hulumtime

Cilët janë dijetarët (*ehlu dh'dhikri*)?

Transmetimet e shumta të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë përmendur se “*ehludh'dhikri*” janë Imamët e ruajtur prej mëkateve. Prej këtyre transmetimeve përmendim:

- transmetohet prej Imamit Ali bin Mùsà Rridà (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili në përgjigjen që ka dhënë për kuptimin e këtij ajeti ka thënë: “ne jemi ‘*ehludh'dhikri*’ – dijetarët - dhe ne jemi përgjegjësit”;¹

- transmetohet prej Imam Bäkirit (*Paqja qoftë mbi të!*) se në komentin e ajetit tonë që është objekt studimi, ai ka thënë: “‘*edh'dhikru*’ është Kur’ani dhe familja e të Dërguarit, kurse ‘*ehlu dh'dhikri*’, janë përgjegjësit”.²

Në transmetime të tjera thuhet: “‘*edh'dhikru*’ - dituria - është Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kurse ‘*ehlu dhikr*’ - dijetarët - janë Ehli Bejt³ (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ka edhe shumë transmetime të tjera që kanë të njëjtin kuptim.

Në librat e tefsirit e në librat e tjerë të Ehli Syneetit ka transmetime në të cilat fjala “*ehludh'dhikr*” kanë gjithashtu të njëjtin kuptim dhe, prej këtyre transmetimeve përmendim:

- në tefsiret “El Ithnà Ashrij” - “Dymbëdhjetët” - transmetohet prej Ibni Ab'bàsit se në interpretimin e këtij ajeti ai ka thënë: “Është Muhammedi, Aliu, Fàtimeja, Hasani dhe Hyseni

¹ Tefsiri “Nüruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 55-56.

² Burimi i mësipërm.

³ Burimi i mësipërm.

(*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi ta!*) – ata janë ‘ehludh’dhikri’ – dijetarët – janë të mençurit dhe ata që dinë të shpjegojnë”.¹

Kjo nuk ndodh për herë të parë në tefsiret e në transmetimet e ardhura në lidhje me ajetet e Kur’ànit, që shpjegohen vetëm nga njëra anë e konfirmimit të tyre, pa e kushtëzuar kuptimin e përgjithshëm të ajetit.

Gjithashtu thamë se fjala “edh’dhikr” ka kuptimin e të gjitha llojeve të diturive, ka edhe kuptimin e njohjes dhe të informacionit, kurse “ehludh’dhikri” janë dijetarët e fushave të ndryshme dhe, duke pasur parasysh në konsideratë se Kur’ani është modeli më i kompletuar dhe më i shquar i diturisë e i njohjes, fjala “edh’dhikr”, është përdorur edhe si emër i përveçëm për Kur’ànin. Gjithashtu, kjo fjalë është përdorur si emër i përveçëm edhe për personin e nderuar të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse në të vërtetë ai është konfirmimi më i qartë i fjalës “edh’dhikr”, dituri. Me këtë emër thirren edhe Imamët e ruajtur prej mëkateve (*Paqja qoftë mbi ta!*) duke qenë se ata janë njerëzit e shtëpisë së profetësisë dhe trashëgimtarët e diturisë së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

¹ “Inkàkul Hak’k” vëll. 3, f. 428. Qëllimi me tefsirin “El Ithnà Ashrij” është për interpretimet e bëra prej: Ebù Jüsufit, Ibni Haxherit, Mukàtil bin Sulejmànit, Vekij bin Xherràhit, Jüsuf bin Mùsà, Katàdeh, Harb Et’tàij, Esedij, Muxhàhidit, Mukàtil bin Hajànit, Ebù Sàlihut dhe Muhammed bin Mùsà Esh’shijràzij. Transmetohet edhe një hadith prej Xhàbir El Xhafeijit në lidhje me interpretimin e ajetit që është objekt i studimit tonë në librin e Eth’thalebij’jit, i cili tregon se kur zbriti ky ajet, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Ne jemi ‘ehludh’dhikr” - dijetarët. Referoju burimit të mësipërm.

tij!). Gjithashtu, Imamët e ruajtur prej mëkateve janë pohim i plotë i fjalës “ehludh’dhikri” - dijetarët.

Ky shpjegim nuk është në kundërshtim me kuptimin e përgjithshëm të ajetit, as me burimin e shkakut të zbritjes, që siç e pamë ishin dijetarët e ithtarëve të librave të mëparshëm. Të gjitha këto bënë që dijetarët tonë të fushës së ligjit të fesë (fik’hut) dhe të bazave të kësaj diturie në studimet e tyre të kenë objekt të hulumtimit dhe të ndjekjes fjalën e dijetarëve. Ata shprehen për domosdoshmërinë e ndjekjes së dijetarëve për cilindo që s’ka arritur gradën e nxjerrjes së dispozitave ligjore. Për të arritur në këtë konkluzion, dijetarët janë mbështetur pikërisht në këtë ajet të Kur’anit Famëlartë.

Mund të shtrohet pyetja në lidhje me atë çfarë thuhet në transmetimin e ardhur prej Imami Ali bin Mùsà Err’Rridà në librin “Ujùnu akhbàurr’Rridà” (*Paqja qoftë mbi të!*) se në kuvendin e Mëmùniti (njëri prej kalifëve të dinastisë abaside), në lidhje me komentimin e ajetit që kemi në studim, dijetarët thanë: “Me këtë është qëllimi për jehudinjtë e të krishterët”, por Imami Err’Rrida (Riza) (*Paqja qoftë mbi të!*) u hodh menjëherë dhe tha: “Subhànell’Ilàh (*vetëm All’llahu është i dëlirë nga të metat e mangësitë*), a lejohet të thuhet kjo fjalë, ata na bëjnë thirrje të pranojmë fenë e tyre dhe na thonë se feja e tyre është më e mirë se Islami”. Pastaj ai tha: “Dhikri – dituria - është i Dërguari i All’llahut dhe ne jemi ehludh’dhukri – dijetarët”.

Përgjigjen për pyetjen e shtruar do ta përmbledhim me këto fjalë: Imami i nderuar e tha këtë fjalë për cilindo që beson se interpretimi i këtij ajeti është i kufizuar, në kuptimin se pikë referimi që duhen të pyeten janë dijetarët e ithtarët e librave të

mëparshëm në çdo shekull e në çdo kohë. Por, pa dyshim që një besim i këtillë është në kundërshtim të hapur me realitetin, sepse qëllimi nuk është referimi te dijetarët e ithtarëve të librave të mëparshëm në të gjitha kohët e në të gjitha ditët, pasi për çdo pozicion ka një fjalë të caktuar dhe, në kohën e Imamit Ali bin Mûsà Err'Rridà (*Paqja qoftë mbi të!*) patjetër që pikë referimi për t'u pyetur ishin dijetarët e Islamit, madje dijetarët më në zë.

Me fjalë të tjera, misioni që i kishin vënë vetes politeistët (mushrikët) në fillimet e Islamit me pyetjet që bënin rreth Profetëve të kaluar, nëse ata ishin njerëz. Për pyetjet e tyre patjetër që pikë referimi janë dijetarët e ithtarëve të librave të përparshme dhe jo Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por kjo nuk do të thotë se të gjithë njerëzit e çdo kohe e të çdo vendi duhet t'u referohen vetëm dijetarëve të ithtarëve të librave të mëparshëm, por është detyrë që t'u referohen dijetarëve të të gjitha kohërave.

Në të gjitha gjendjet, ajeti i nderuar është shpjegues i qartë i një baze islame, prandaj mbetet detyrim që me këtë kuptim ai të merret në të gjitha fushat e jetës materiale dhe morale. Përveç kësaj, ajeti e përforcon te myslimanët domosdoshmërinë e të pyeturit për çështjet që ata s'kanë dijeni, cilido qoftë prej myslimanëve dhe jo të fusin veten në ngatërresa për gjëra rreth të cilave s'kanë fare dijeni.

Bazuar mbi këtë, del qartë se Kur'ani Famëlartë as nuk e kufizon, as nuk e ndalon "çështjen e specializimit" në lidhje me çështjet fetare. Përkundrazi, Kur'ani udhëzon të pyetet për të gjitha temat e për të gjitha dituritë e ndryshme, prandaj është detyrë që në mesin e myslimanëve të ketë dijetarë të të gjitha fushave të dijes,

në mënyrë që njerëzit të kenë mundësi t'u drejtohen atyre për gjërat që nuk i dinë.

Këtu duhet tërhequr vëmendja në lidhje me domosdoshmërinë e referimit tek ai dijetar, dituria e të cilit është afirmuar e qëndrueshme dhe e vendos atë në vendin që me të vërtetë i takon, duke shtuar se tek ai nuk mund të mendohet se mungon elementi i sinqeritetit dhe i përkushtimit në fushën e diturisë që ai zotëron, ndryshe nuk do të ishte me vend të pyetet një mjek specialist, por që nuk është i sinqertë në punën e tij.

Këtu qëndron edhe rëndësia e vënies së kushtit të drejtësisë në çështjet e ndjekjes së fjalës së dijetarit. Pra që dijetari të cilit i referohen njerëzit, jo vetëm që është dijetar i mirëfilltë, por patjetër është edhe njeri i drejtë, i pastër, i devotshëm dhe patjetër njohës i mirë i çështjeve islame.

Ajetet 45 - 47

﴿أَفَأَمِنَ الَّذِينَ مَكَرُوا السَّيِّئَاتِ أَنْ يَخْسِفَ اللَّهُ بِهِمُ الْأَرْضَ أَوْ يَأْتِيَهُمُ
الْعَذَابُ مِنْ حَيْثُ لَا يَشْعُرُونَ، أَوْ يَأْخُذَهُمْ فِي تَقَلُّبِهِمْ فَمَا هُمْ
بِمُعْجِزِينَ، أَوْ يَأْخُذَهُمْ عَلَى تَخَوُّفٍ فَإِنَّ رَبَّكُمْ لَرَءُوفٌ رَحِيمٌ﴾^{٤٧}

“Mos vallë ata që kurdisën kurthe janë të sigurt se All’llahu nuk do t’i fundosë nën tokë, ose që dënimi nuk do t’u vijë atyre andej kah ata nuk e mendojnë?”

“Ose Ai do t’i dënojë kur ata janë në udhëtimet e tyre dhe ata nuk i shpëtojnë dot dënimit.”

“Ose dënimi do t’i zërë ata duke qenë në panik prej frikës; porse Zoti juaj është i Buti, i Gjithëmëshirshmi.”

Komentimi

Për çdo faj, një dënim

Në shumë studime kur'anore ka lidhje mes mjeteve të nxjerrjes së argumenteve (mjete deduktive) dhe mes çështjeve të ekzistencës, që lënë shumë mbresa në shpirtrat e dëgjuesve. Ajetet e mësipërme janë një model i kësaj metode.

Ajetet e mëparshme ishin shprehje e një studimi logjik të pretendimeve të politeistëve në lidhje profetësinë dhe Ringjalljen, ndërsa ajetet që kemi në studim, kërcënojnë hapur arrogantët, despotët dhe mëkatarët.

Ajeti e fillon bisedën duke thënë: **“Mos vallë janë të sigurt ata që kurdisën kurthe”**, ata që thurën intriga të shumta për të shuar dritën e vërtetë të besimit: **“se All'Ilahu nuk do t'i fundosë nën tokë?”**.

A mos vallë nuk ka mundësi që pas bëmës së tyre të urryer të mos ndodhë një tërmet aq i fuqishëm, sa të çahet korja e tokës dhe t'i përpijë ata me gjithçka që zotërojnë, ashtu siç ka ndodhur disa herë me kombet e mëparshme?!

Fraza e ajetit *“mekerûs'sej'jiati”* - **“kurdisën kurthe”**, do të thotë ata kurdisën intriga e plane për të arritur qëllimet e tyre të liga. Ashtu siç vepronin politeistët (mushrikët) për të shuar dritën e Kur'anit, apo orvatja e tyre për të vrarë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe të gjitha llojet e torturave që praktikuan mbi besimtarët e përkushtuar në besimin islam.

Kurse folja “jekhsifu” – “fundos”, rrjedh prej foljes rrënjë “khasefe” në kuptimin e fshehjes, madje kjo fjalë përdoret edhe për fshehjen e dritës së hënës nën hijen e tokës (eklipsi i hënës). Gjithashtu, fjala “khasefe” përdoret edhe për pusin pa ujë, në kuptimin që uji i atij pusi u shterua. Nisur nga këto përdorime të kësaj fjale, gjithnjë në kuptimin e fshehjes, në ajetin që është objekt studimi, kjo fjalë ka ardhur në kuptimin e fundosjes së njerëzve dhe shtëpive në çarjen e tokës të shkaktuar prej tërmetit.

Më pas, ajeti shton: **“ose që dënimi nuk do t’u vijë atyre andej kah ata nuk e mendojnë. Ose Ai (All’llahu) do t’i dënojë kur ata janë në udhëtimet e tyre”**, domethënë në kohën kur ata shkojnë e kur vijnë, gjatë lëvizjeve të tyre në kërkim të fitimit të parave e të grumbullimit të pasurive dhe ajeti njofton: **“dhe ata nuk i shpëtojnë dot dënimit”**.

Siç kemi thënë më sipër, fjala e ajetit “bi mu’xhizijne”, është në kuptimin e asgjësimit të fuqisë së palës tjetër, kurse këtu është në kuptimin: ata s’kanë mundësi as të ikin prej dënimit dhe as të bëjnë rezistencë kundër tij.

Ose dënimi i All’llahut nuk do të bjerë mbi ata në kohën kur janë krejtësisht të shkujdesur, por do të bjerë gradualisht dhe i shoqëruar me paralajmërim të përsëritur: **“Ose dënimi do t’i zërë ata duke qenë në panik prej frikës.”**

Për shembull, sot goditet nga një pësim fqinji i tyre, nesër goditet nga ndonjë pësim një i afërmi i tyre, një ditë tjetër shkatërrohen disa prej pasurive të tyre dhe përfundimi, atyre u vijnë paralajmërimet dhe pësimet u futen në mendje njëra pas tjetrës. Për ta do të ishte gjëja më e mirë zgjimi (prej gjumit të

shkujdesjes), ndryshe do të goditen prej dënimit të All'llahut dhe do të shkatërrohen fare.

Dënimi gradual në këto gjendje vjen për shkak se ekziston mundësia që ky grup njerëzish të udhëzohet në rrugën e drejtë dhe All'llahu i Gjithëpushtetshëm nuk dëshiron që t'i trajtojë këta njerëz si të tjerët, sepse në vijim ajeti thotë: **“por Zoti juaj është i Buti, i Gjithëmëshirshmi”**.

Në ajetet që janë objekt studimi bie në sy përmendja e katër llojeve prej dënimit Hyjnor:

a- fundosja nën tokë;

b- dënimi i befasishëm, domethënë, dënimi i vjen njeriut në një kohë kur ai është krejtësisht i shkujdesur ndaj këtij dënimi;

c- dënimi u vjen njerëzve kur janë të përkushtuar për të mbledhur pasuri dhe për këtë ndërmarrin udhëtime të shumta;

d- mundimi e dënimi gradual.

Myslimani beson se lloji i dënimit është në përputhje me llojin e mëkatit të kryer, edhe pse këto dënime në ajetin që kemi objekt studimi kanë ardhur të gjitha së bashku dhe janë për ata që: **“ata që kurdisën kurthe”**. Këto ajete në të vërtetë na njoftojnë se punët e All'llahut nuk mund të jenë veçse me urtësi e me drejtësi.

Në kuadrin e studimit tonë nuk kemi gjetur ndonjë opinion të interpretuesve të Kur'anit në lidhje me këtë çështje, por duket se dënimi i llojit të parë është i veçantë për komplotistët e sërës së arrogantëve mendjemëdhenj si Kàrùni, të cilin All'llahu e fundosi nën tokë dhe së bashku me të fundosi edhe shtëpinë e pasurinë e

tij, duke e bërë shembull për njerëzit, megjithëse ai kishte fuqi të madhe e pasuri të shumta.

Kurse dënimi i lloji të dytë është i veçantë për komplotistët që ishin të zhytur në shijimin e kënaqësive të jetës dhe plotësimit të të gjitha dëshirave e interesave; këtyre u vjen dënimi Hyjnor aq papritur, sa nuk e kuptojnë nga u erdhi.

Lloji i tretë i dënimit është i veçantë për adhuruesit e të mirave materiale të kësaj bote, të cilët natë e ditë ishin të shqetësuar të shtonin pasuritë e tyre vazhdimisht, pavarësisht nga mjetet që përdornin për ta realizuar këtë. Madje, në rrugën e grumbullimit të pasurive ata nuk ngurronin të kryenin edhe krime e vepra të kundërligjshme, pasi shihnin vetëm e vetëm që të plotësonin ambiciet e tyre! Këta njerëz, All'llahu i Lartësuar i dënoi pikërisht kur ata ishin në këtë gjendje.¹

Lloji i katërt i dënimit është i veçantë për ata që në despotizmin e tyre e në rrugën e thurjes së kurtheve, si dhe në kryerjen e mëkateve, nuk kishin arritur ende në atë shkallë ku nuk mund të ktheheshin më prej rrugës së punëve të liga që bënin. Pikërisht, këta njerëz All'llahu i Lartësuar i dënon me frikësim ose i paralajmëron se mbi disa anë të tyre do të bjerë një ndëshkim i dhimbshëm. Por, nëse ata zgjohen prej gjumit të shkujdesjes dhe ndërgjegjësohen, le ta dinë se kjo është ajo që kërkohet prej tyre,

¹ Nga ana gjuhësore fjala "*et'tekal'lub*" e ajetit është fjalë e pakushtëzuar, në kuptimin vajtje-ardhje. Kurse në ajetin tonë që është objekt studimi, ashtu siç janë shprehur pjesa më e madhe e interpretuesve të Kur'anit Famëlartë dhe siç theksojnë edhe transmetimet e ardhura që shpjegojnë kuptimin e këtij ajeti, fjala vajtje-ardhje tregon rrugën e tyre të tregtisë në kërkim të pasurive. Prandaj mendohu!

ndryshe dënimi do të bjerë edhe mbi ata dhe do t'i shkatërrojë krejtësisht.

Është e qartë se përmendja e dy cilësive të All'llahut, butësia e mëshira gjithëpërfshirëse e Tij, ka lidhje me llojin e katërt, me ata që kurdisnin kurthe për punë të këqija, por që nuk i kishin prerë të gjitha lidhjet e tyre me All'llahun dhe nuk i kishin shkatërruar të gjitha urat e rikthimit.

Ajetet 48 – 50

﴿أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى مَا خَلَقَ اللَّهُ مِنْ شَيْءٍ يَتَفَيَّأُ ظِلَالُهُ عَنِ الْيَمِينِ
وَالشَّمَائِلِ سُجَّدًا لِلَّهِ وَهُمْ دَاخِرُونَ^٨؛ وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا
فِي الْأَرْضِ مِنْ دَابَّةٍ وَالْمَلَائِكَةُ وَهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ^٩؛ يَخَافُونَ رَبَّهُمْ مِنْ
فَوْقِهِمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ^{١٠}﴾

“A nuk e shohin ata se çdo send që ka krijuar All’llahu, e sjell hijen e vet djathtas e majtas duke iu përlur (duke i bërë sexhde) All’llahut dhe duke qenë respektues e i përlur.”

“Vetëm All’llahut i bëjnë sexhde, çka është në qiej e çka është në tokë, edhe engjëjt, ata nuk bëjnë kryelartësi.”

“Ata e kanë frikë Zotin e tyre që është sipër tyre dhe bëjnë vetëm punën që urdhërohen.”

Komentimi

Të gjitha krijesat i bëjnë sexhde vetëm All'llahut të Gjithëpushtetshëm:

Këto ajete i rikthehen çështjes së Njësimit (Teuhidit) dhe fillojnë me: **“A nuk e shohin ata se çdo send që ka krijuar All'llahu, e sjell hijen e vet djathtas e majtas duke iu përlurur (duke i bërë sexhde) All'llahut dhe duke qenë respektues e i përlurur.”.**

Pra, a nuk e shohin politeistët (mushrikët) si lëviz majtas e djathtas hija e krijesave të All'llahut për të shprehur përlurjen e tyre me krye në tokë (sexhde) vetëm për të madhëruar të Gjithëpushtetshmin?!

Disa kanë thënë se arabët për hijen e mëngjesit përdorin fjalën *“edh'dhil'lu”*, kurse për hijen e pasdites përdorin fjalën *“el fej'u”*. Nëse do të vështrojmë në origjinën e kuptimit të kësaj fjale do të gjejmë se me fjalën *“el fej'u”* emërtohen disa pasuri, pasuria që fitohet dhe plaçka e luftës. Gjithashtu do të gjejmë se kjo fjalë thekson një të vërtetë shumë domethënëse: të gjitha pasuritë më të parapëlqyera të kësaj bote do të zhduken dhe do të jenë si hija e pasdites.

Nga krahasimi i fjalës *hije* dhe *lëvizjen e hijes nga e djathta në të majtë*, që në ajetin tonë përmendet me fjalën arabe *“el'fej'u”*, rezulton se kjo fjalë ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin të gjitha llojet e hijeve.

Nëse në kohën e lindjes së diellit, njeriu qëndron i kthyer në drejtim të jugut, do të shohë lindjen e diskut të diellit nga e majta e horizontit të lindjes. Për rrjedhojë, të gjitha hijet e trupave do të jenë nga e djathta e tij, domethënë do të jenë nga ana perëndimore e horizontit. Kjo gjendje e hijeve do të vazhdojë kështu derisa ato i afrohen anës së djathtë, por kjo ndodh në kohën e mesditës. Pikërisht në këtë kohë hijet kthehen nga ana e kundërt, pra nga ana e majtë dhe do të vazhdojnë të jenë në këtë anë deri në kohën e perëndimit të diellit, kohë në të cilën hijet bëhen të gjata e të shtrira në drejtim të lindjes dhe më pas, me perëndimin e diellit s'ka më hije.

Filluesi i të gjitha krijesave e i çdo gjëje, me lëvizjen e hijeve të trupave nga e djathta në të majtë, shpalos një dukuri shumë të madhe: Ai e cilëson lëvizjen e hijeve të trupave *sexhde e përrulje* që bëjnë të gjithë trupat për të madhëruar të Gjithëfuqishmin.

Efekti i hijeve në jetën tonë

Pa dyshim, hija që lëshon çdo trup ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë, megjithëse ky fakt shumë njerëzve mund të mos ua tërheqë vëmendjen, por Kur'ani Famëlartë e thekson këtë çështje me qëllim që njerëzit t'i kushtojnë dukurisë "hije" vëmendjen e duhur.

Prej hijeve, që s'janë gjë tjetër veçse mungesa e dritës, kemi dobi të shumta:

1- Ashtu siç kanë rrezet e diellit një rol kryesor në jetën tonë, po kështu edhe hijet kanë rol jo më pak të vogël, sepse bëjnë të

mundur procesin e rregullimit të nxehtësisë së madhe të rrezeve të diellit.

Lëvizja e alternuar e hijeve e ruan nxehtësinë e diellit në një kufi të balancuar dhe të efektshëm; pa hijet menjëherë do të digjej çdo send prej nxehtësisë së diellit, e cila ruan një gradë nxehtësie të qëndrueshme për një kohë të gjatë.

2- Ndeshemi me një çështje tjetër shumë të rëndësishme, në kundërshtim me përfytyrimin e shumicës së njerëzve dhe që konsiston në faktin se drita nuk është shkak i vetëm që bën të shikojmë sendet, por patjetër duhet që drita e hija të jenë së bashku që të realizohet shikimi në mënyrë natyrale.

Me fjalë të tjera, nëse drita do të rrethonte një trup të çfarëdoshëm, domethënë mbi të vazhdimisht të binin rreze drite dhe të mos kishte as hije të plotë e as gjysmë hije, në këtë gjendje nuk do të ishte i mundur shikimi i këtij trupi të zhytur në dritë.

Kjo do të thotë se ashtu siç nuk është e mundur shikimi i sendeve në errësirë të plotë, po kështu është e pamundur që sendet të shikohen nën dritën e plotë. Shikimi i sendeve bëhet i mundur për shkak të ekzistencës së dritës dhe errësirës (dukuria dritëhije).

Bazuar mbi këtë shpjegim rezulton se hijet kanë një ndikim shumë të madh në shikimin, në specifikimin, në njohjen dhe në dallimin e sendeve prej njëri-tjetrit. Mendo!

Në ajetin që është objekt studimi vërejmë edhe një konstatim tjetër shumë domethënës: përmendja e fjalës *djathtas*, "*jemijn*", në numrin njëjës, kurse fjala *majtas* ka ardhur në numrin shumës: "*esh'shemàil*".

Ndryshueshmëria në shprehje ka mundësi të jetë për shkak se hija në mëngjes bie në anën e djathtë të atij që qëndron i kthyer në drejtim të jugut, pastaj lëviz vazhdimisht në drejtin të anës së majtë, derisa në kohën e perëndimit të diellit fshihet përfundimisht në horizontin e lindjes.¹

Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë kanë shprehur edhe një variant tjetër për komentimin e fjalës *djathtas* në këtë ajet, e cila në fakt ka ardhur në numrin njëjës, por ka mundësi që në disa gjendje fjala *djathtas*, "*jemijn*", në numrin njëjës, mund të vij me qëllim kuptimi në numrin shumës. Ajeti që po studiojmë në të vërtetë tregon për numrin shumës të fjalës *djathtas*.²

Në ajetin e mëparshëm u përmend sexhdeja e hijeve, në kuptimin më të gjerë të fjalës, kurse në ajetin vijues, sexhdeja është përmendur për të gjitha sendet që ekzistojnë, lëndore e jolëndore, në çdo vend të gjithësisë. Ajeti thotë: **"Vetëm All'llahut i bën sexhde çka është në qiej e çka është në tokë, edhe engjëjt, ata nuk bëjnë kryelartësi"**, pra engjëjt janë të nënshtruar plotësisht ndaj All'llahut e ndaj urdhrave të Tij.

E vërteta e sexhdes është kulmi i përruljes, i nënshtrimit, i kryeultësisë dhe i adhurimit, përfshirë shtatë gjymtyrët me të cilat plotësohet sexhdeja. E gjitha kjo është vetëm një konfirmim i këtij kuptimi të përgjithshëm të fjalës *sexhde*, por kurrë nuk mund të reduktohet vetëm në këtë konfirmim.

Meqenëse të gjitha krijesat e botës lëndore e jolëndore janë të nënshtruara ndaj ligjeve universale të botës së ekzistencës, botë

¹ Tefsiri i Kurtubij'jit, fundi i ajetit objekt studimi.

² Tefsiri "Rùhul Xhinàn", vëll. 7, f. 110.

që e vuri në lëvizje vullneti hyjnor, të gjitha krijesat janë në pozicion në sexhde për të madhëruar të Gjithëpushtetshmin. Prandaj, asnjë krijesë nuk duhet të devijojë jashtë linjës së këtyre ligjeve, sepse të gjitha krijesat janë dukuri të madhështisë, diturisë e fuqisë së Filluesit, të Gjithëfuqishmit. Është kjo dukuri e madhështisë së Krijuesit që tregon se i Gjithëfuqishmi s'ka nevojë për asgjë. Rezultati: të gjitha krijesat janë argument që vërtetojnë ekzistencën e të Lartit.

Fjala e ajetit "*dàb'betin*" është në kuptimin e qenieve të gjalla dhe ajeti përmend sexhden e tyre në qiej e në tokë. Kjo do të thotë se ajeti na njofton për ekzistencën e qenieve të gjalla edhe në trupa të tjerë qiellorë, përveç atyre që gjenden në tokë.

Disa interpretues të Kur'anit Famëlartë janë shprehur se fraza e ajetit "*min dàb'betin*" - *qenie e gjallë* - është kusht për fjalën "*mà fil erdi*" - *ç'ka në tokë* - do të thotë se bëhet fjalë vetëm për qeniet e gjalla që gjenden në tokë.

Por ky opsion duket larg asaj që thuhet në ajetin 29 të sures "*Esh'shùrà*": **"Prej argumenteve të Tij është krijimi i qiejve e i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja (në qiej e në tokë)."**

Është e vërtetë që sexhdeja, si shenja më e lartë e përluljes dhe e nënshtrimit ndaj All'Ilahut, cilësi me të cilat është formuar çdo qenie e gjallë, nuk reduktohet vetëm tek ato. Duhet të specifikojmë theksimin në gjithçka që mbart kjo e vërtetë prej sekreteve të madhështisë së krijimit, atëherë do të shikojmë se është më shumë se kaq.

Meqenëse ajeti përfshin njeriun besimtar e të mençur, engjëjt dhe kafshët e tjera, padyshim që fjala *sexhde* është përmendur në një

kuptim përgjithësues, që përfshin sexhden fakultative dhe sexhden e saktësuar në ligjin e fesë. Gjithashtu, kuptimi i kësaj fjale përfshin edhe nënshtrimin me të cilin janë formuar krijesat, që është sexhdeja e imponuar.

Në ajetin që është objekt studimi, engjëjt theksohen të ndarë nga krijesat e tjera, sepse fjala “*dàb’betin*” e ajetit thuhet vetëm për qeniet e gjalla me trup lëndor, kurse fjala “*el melàiketi*” e ajetit tregon lëvizje, prani e mosprani. Pra, fjala “*el melàiketi*” nuk është në kuptimin e qenieve me trup lëndor që të përfshihet në kuptimin e fjalës “*dàb’betin*”, gjallesa të tokës.

Transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në një hadith ka thënë: “Në qiellin e shtatë ka engjëj që janë në sexhde për madhërimin e All’llahut të Lartësuar qysh ditën që janë krijuar dhe do të qëndrojnë në sexhde deri Ditën e Kiametit, duke u dridhur të tulatur nga frika prej All’llahut të Lartësuar. Çdo pikë prej lotëve të tyre bëhet engjëll dhe Ditën e Kiametit, ata do të grenë kokat prej sexhdes duke thënë: ‘Nuk të adhuruam ashtu siç është e drejtë të bëhet adhurimi për madhërinë Tënde’”.

Për sa i përket frazës së ajetit “**ata nuk janë kryelartë**”, tregon njërin prej cilësive të engjëjve. Te ta nuk ekziston asnjë lloj mendjemadhësie, veçanërisht kur janë në sexhde. Engjëjt nuk shfaqin kurrë mendjemadhësi e mosbindje ndaj All’llahut të Gjithëpushtetshëm dhe nuk i kundërshtojnë kurrë urdhrat e Tij.

Edhe në ajetin 6 të sures “*Et’tahrijm*”, ku përshkruhet një grup engjëjsh, thuhet: “**ata nuk e kundërshtojnë All’llahun për gjithçka që Ai i urdhëron dhe bëjnë vetëm punën për të cilën janë urdhëruar.**”.

Prej këtij ajeti mësojmë fare qartë se duke e theksuar mohimin e mendjemadhësisë, engjëjt dallohen për dy gjëra:

a) për ndjenjën e përgjegjësisë dhe bindjes së plotë ndaj urdhrave Hyjnorë pa asnjë kundërshtim dhe, ky është cilësimi i gjendjes shpirtërore të atyre që nuk janë mendjemëdhenj;

b) për zbatimin e urdhrave të Alla'llahut ashtu siç duhet dhe për punë në përputhje me ligjet e përgatitura për këtë bindje absolute dhe, kjo është pasqyrim i pikës së mësipërme dhe realizimi konkret i saj.

Pa dyshim që fraza e ajetit "*min feukihim*" - "*sipër tyre*", nuk është për të treguar lartësinë që kuptojmë falë ndjenjave në raport me vendin ku ndodhemi, por qëllimi me fjalën "*sipër tyre*" është lartësia e pozitës, sepse All'Ilahu i lartësuar si pozitë është sipër të gjitha sendeve.

Këtë çështje e lexojmë edhe në ajetin 61 të sures "El En'âm": **"Vetëm Ai është Mbizotëruesi ndaj robërve të Vet"**; gjithashtu çështjen e kuptimit të fjalës "*feuka*" - "*sipër*" e lexojmë edhe në ajetin 127 të sures "El A'râf": **"dhe Ne jemi Mbizotërues mbi ata"**. Faraoni e tha këtë fjalë kur donte të vinte në dukje fuqinë e tij!

Ajetet 51 - 55

﴿وَقَالَ اللَّهُ لَا تَتَّخِذُوا إِلَهَيْنِ اثْنَيْنِ إِنَّمَا هُوَ إِلَهٌ وَاحِدٌ فَإِيَّايَ فَارْهَبُونِ۝ وَلَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَهُ الدِّينُ وَاصِبًا أَفَغَيْرَ اللَّهِ تَتَّقُونَ۝ وَمَا بِكُمْ مِنْ نِعْمَةٍ فَمِنَ اللَّهِ ثُمَّ إِذَا مَسَّكُمُ الضُّرُّ فَإِلَيْهِ تَجْأَرُونَ۝ ثُمَّ إِذَا كُشِفَ الضُّرُّ عَنْكُمْ إِذَا فَرِيقٌ مِنْكُمْ بِرَبِّهِمْ يُشْرِكُونَ۝ لِيَكْفُرُوا بِمَا آتَيْنَاهُمْ فَتَمَتَّعُوا فَسَوْفَ تَعْلَمُونَ۝﴾

"All'Ilahu tha: 'Mos adharoni dy zota, sepse Ai është Një Zot i Vetëm dhe bëni kujdes, vetëm Mua të më keni frikë.'"

"E Tij është çka në qiej e në tokë dhe vetëm Atij i takon të adhurohet vazhdimisht; mos vallë keni frikë prej ndonjë tjetri dhe jo prej All'Ilahut?"

"Çdo të mirë që keni, ajo është prej All'Ilahut, pastaj kur goditeni nga e keqja, ju te Ai e ngrini zërin (Atij i luteni)."

"Më pas, kur Ai e largon dënimin prej jush, një grup prej jush i vënë shok Zotit të tyre."

"(duke i vënë shok Zotit të tyre) ata le të bëhen bukëshkalë për të mirat që Ne u dhamë atyre, por kënaquni (përkohësisht) dhe më vonë do ta mësoni (përfundimin)."

Komentimi

Vetëm një fe e vërtetë dhe vetëm Një i Adhuruar:

Në vijim të studimit rreth - Teuhidit - Njësimit (*All'llahu është Zoti Një e i Vetëm*), ky grup ajetesh trajton hedhjen poshtë të idhujtarisë dhe tregon për njohjen e All'llahut nëpërmjet rrugës së krijimit të njerëzve, ashtu siç u shpjegua edhe në ajetet e përparshme, me qëllim që e vërteta të bëhet sa më e qartë nëpërmjet krahasimit mes çështjeve. Ajeti fillon: **“All'llahu tha: ‘Mos adhuroni dy zota, sepse Ai është Një Zot i Vetëm dhe bëni kujdes, vetëm Mua të më keni frikë’”**.

Vënia e fjalës *“ij’jâje” - bëni kujdes* – ka për qëllim reduktimin e kuptimit të urdhrit **“Mua të më keni frikë”** vetëm në një vend, ashtu si ka ardhur kjo fjalë edhe në suren e parë të Kur'anit: *“Ij’jâke na’budu”* **“Vetëm Ty të adhurojmë”**, do të thotë se është detyrë të frikësoheni vetëm prej dënimit Tim dhe jo të ndonjë tjetri.

Këtu bie në sy se ajeti e vë theksin mbi mohimin e ekzistencës së dy të adhuruarve, në një kohë kur politeistët (mushrikët) adhuronin shumë idhuj.

Ka mundësi që ky theksim të tregojë vetëm njërën prej pikave të mëposhtme ose edhe të gjitha:

1- Ajeti mohon adhurimin e dy zotave; mendo se çdo të thuhet për adhurimin e më shumë zotave?!

Me fjalë të tjera, ajeti shpjegon kufirin më të afërt për të theksuar ndalimin e prerë të adhurimit të shumë zotave, sado qoftë numri i zotave të parapëlqyer, pasi fjala *disa* do të thotë më shumë se një, prandaj ishte e domosdoshme të theksohej fjala dy.

2- Çdo send tjetër që adhurohet, në vend që të adhurohet vetëm All'llahu, është shumësi i futur në njëshin dhe ajeti thotë: mos i adhuroni ato së bashku me All'llahun, mos adhuroni as dy zota (të vërtetin e të pavërtetin).

3- Arabët e kohës së injorancës para Islamit kishin të zgjedhur dy të adhuruar:

a- Krijuesin e botës, domethënë All'llahun e Gjithëfuqishëm, dhe i besonin Atij.

b- idhujt, të cilët ata i konsideronin ndërmjetës mes tyre dhe All'llahut, gjithashtu ata i konsideronin burim të së mirës, begatisë dhe mirësive.

4- Ka mundësi që ajeti të jetë një dritare për të hedhur poshtë doktrinën e dualistëve (thànevitë) që pretendonin ekzistencën e zotit të së mirës dhe zotit të së keqes. Këtë logjikë kaq pa kuptim e krejtësisht të gabuar, ata e kishin zgjedhur me dashjen e vet, megjithëkëtë adhuruesit e idhujve e tejkaluan edhe këtë logjikë, pasi ata adhuronin *disa* zota!

Interpretuesi i dëgjuar i Kur'anit Famëlartë, dijetari poliedrik Et'tabersij, në komentimin e këtij ajeti ka cituar një shprehje shumë domethënëse, të marrë prej fjalës së *disa* të urtëve: "Zoti yt të ka ndaluar të adhurosh dy zota dhe ti adhurove vetëm një zot, adhurove veten tënde e dëshirat tuaja, adhurove karakterin

e qëllimin tënd, adhurove edhe njerëzit, qysh mund të jesh ti 'muveh'hid' (monoteist), adhurues i një Zoti të Vetëm".

Në vijim, në kuadrin e tri ajeteve që janë objekt studimi, Kur'ani sqaron argumentet e Njësimit në adhurim me katër shpjegime dhe në fillim thotë: **"E Atij është ç'ka në qiej e në tokë"**. Atëherë, a duhet t'i bëhet sexhde idhujve që nuk zotërojnë asnjë send apo vetëm Atij që zotëron ç'ka në qiej e në tokë?

Ajeti vijon të shpjegojë: **"dhe vetëm Atij i takon të adhurohet vazhdimisht"**.

Kur'ani duke vërtetuar se bota e ekzistencës është vetëm prej All'llahut dhe se Ai është Bërësi i të gjitha ligjeve të ekzistencës që Ai krijoi, vërteton se edhe legjislacionet janë vënë prej Tij. Prandaj, s'mund të ketë bindje e përlulje për asnjë tjetër përveç bindjes e përluljes para All'llahut të Lartësuar.

Fjala e ajetit *"väsiben"*, rrjedh prej fjalës *"el vusùb"* - *vazhdimësi* – por disa e kanë shpjeguar këtë fjalë me kuptimin e sinqeritetit. Mirëpo është e natyrshme se e pasinqerta nuk mund të jetë e vazhdueshme, kurse ata që e kanë marrë në konsideratë fjalën e ajetit *"ed'dijnu"* - *adhurimi* – në kuptimin e *bindjes*, fjalën *"väsiben"* e kanë komentuar në kuptimin e detyrës, domethënë se është detyrë të adhurohet vetëm All'llahu.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë se dikush e ka pyetur atë në lidhje me fjalën e All'llahut të Lartësuar **"dhe vetëm Atij i takon të adhurohet vazhdimisht"**, ai i tha: "detyrë".¹

¹ Tefsiri "El Burhàn", vëll. 3, f. 373.

Është e qartë se këto kuptime janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin.

Në fundin e ajetit ka ardhur pyetja: **“mos vallë keni frikë prej ndonjë tjetri dhe jo prej All’llahut?”**.

A mundet që idhujt të ndalojnë prej jush pësimet që nuk doni të bien mbi ju ose të shtojnë për ju ndonjë mirësi? Megjithëkëtë, ju keni frikë prej idhujve dhe vazhdoni të jini aq të përkushtuar në adhurimin e tyre?!

Në një kohë kur: **“Çdo të mirë që keni, është prej All’llahut.”**.

Ky ajet përmban edhe shpjegimin e tretë në lidhje me domosdoshmërinë për të adhuruar vetëm All’llahun, Zotin Një e të Vetëm. Pasi adhurimi që u bëhet idhujve, pavarësisht se bëhet në falënderim të një mirësie, në të vërtetë nuk është mirësi, sepse të gjithë, pa asnjë përjashtim jetojnë falë mirësive të All’llahut të Lartësuar, prandaj është detyrë të adhurohet vetëm All’llahu dhe askush tjetër përveç Atij.

Përveç kësaj: **“pastaj kur goditeni nga e keqja, ju tek Ai e ngrini zërin (Atij i luteni)”**.

Kur adhurimi juaj për idhujt qenka për të sprapsur dëmin dhe për të zgjidhur problemet, dijeni mirë se sprapsja e dëmit e zgjidhja e problemeve vijnë vetëm prej All’llahut dhe jo prej ndonjë tjetri. Madje, këtë fakt ju e shihni vetë në praktikën tuaj. Sa herë që dëmtoheni, te cili shkoni të qaheni me zë të lartë? Lini të gjitha sendet dhe drejtoheni vetëm te All’llahu.

Ky është shpjegimi i katërt rreth çështjes së Teuhidit – All'llahu është Zoti Një e i Vetëm – prandaj është detyrë që vetëm Ai të adhurohet.

Folja “*texh'erùne*”- “**e ngrini zërin**”, ka për rrënjë fjalën “*el xhuàr*”, në kuptimin e zërit të kafshëve e të bishave, kur ulërijnë për shkak të dhimbjes që ndiejnë. Më pas kjo fjalë është për të përdoruar të gjitha “ahet e ohet” e pavullnetshme që dalin prej njeriut si pasojë e ndonjë gjendjeje shumë të rënduar ose nga dhimbjet.

Ardhja e kësaj fjale me këtë kuptim tregon gjendjen tuaj të vështirë, kur pësimet mbi ju vijnë njëri mbi tjetrin dhe nga kjo sprovë kaq e rëndë, krejtësisht në mënyrë të pavetëdijshme, ju e ngrini zërin sa më lart për të kërkuar ndihmë. Në këtë gjendje, mos vallë ju i drejtoheni tjetër kujt, përveç të Gjithëfuqishmit të Lartësuar?! Atëherë, përse në jetën tuaj të zakonshme nuk shkoni të ngrini zërin tek idhujt as kur përballeni me probleme fare të thjeshta?!

Po, vetëm All'llahu i Plotpushtetshëm e dëgjon thirrjen tuaj në të gjitha gjendjet, vetëm Ai u ndihmon dhe e largon prej jush pësimin që u ka zënë, megjithëkëtë: **“Më pas, kur Ai e largon dënimin prej jush, një grup prej jush i vë shok Zotit të tyre”**, duke u rikthyer në adhurimin e idhujve!

Në të vërtetë, në këtë ajet Kur'ani Famëlartë thekson krijimin e të gjithë njerëzve me besimin në Zotin Një e të Vetëm, por perdja e shkujdesjes, mendjemadhësia, injoranca, fanatizmi dhe besëtytnitë, në jetën e përditshme e mbulojnë besimin e pastër me të cilin është krijuar njeriu.

Në raste furtunash të fuqishme dhe pësimesh të rënda, kjo perde largohet vetvetiu dhe menjëherë rishfaqet e fuqishme si shkreptimë drita e pastër e besimit në Zotin Një e të Vetëm (Teuhid), besim me të cilin është krijuar njeriu. Ndodh kështu, sepse njerëzit në gjendje të tilla të rënduara të mendojnë se te kush duhet të drejtohen. Ata menjëherë fillojnë e i luten All'Ilahut me sinqeritet me të gjithë qenien e tyre dhe, në këtë gjendje, Ai i heq shtresat e sprovës së rëndë që ra mbi ata për shkak të asaj perdeje që kishte veshur zemrat e tyre. Sqarojmë se fraza e ajetit **“Ai e largon dënimin”**, do të thotë: Ai i heq shtresat e pësimit.

Por, sapo stuhia qetësohet e pësimeet largohen dhe ju riktheheni në bregun e sigurisë, përsëri me zakonin e shkujdesjes e mendjemadhësisë sërish riktheheni në adhurimin e idhujve, duke e shfaqur sheshit shirkun tuaj (vënien shok All'Ilahut)!

Në fundin e ajetit të këtyre ajeteve, pas zbardhjes së të vërtetës me argumente logjike, vjen edhe kërcënimi: **“(duke i vënë shok Zotit të tyre) ata le të bëhen bukëshkalë për të mirat që Ne u dhamë atyre, por kënaquni (përkohësisht) dhe më vonë do ta mësoni (përfundimin)”**.

Kjo mënyrë edukimi është e ngjashme me rastin kur njeriu lëviz prej pozicionit të orientuar të këshillave për të ndjekur direktivat e ndonjërit që ka devijuar prej rrugës së drejtë. Është e kuptueshme se shtrimi i së vërtetës për këtë njeri me argumente logjike, nuk i sjell asnjë dobi. Prandaj, ajeti e ndërpret bisedën me këtë person me butësi dhe i vë përballë kërcënimin, me qëllim se kështu edhe ky njeri do të ndërgjegjësohet, prandaj edhe atij i thuhet ashtu siç të thamë edhe ty: **“Bëj si të duash, por shpejt ose vonë, patjetër do të shohësh rezultatin e punës sate”**.

Mënyra urdhërore e foljes, në vetën e tretë shumës **“ata le të bëhen bukëshkalë”**, si dhe të foljes tjetër në urdhërore **“kënaquni”**, në këtë ajet të nderuar, tregon kërcënimin. Ndërsa, ardhja e foljes së parë në vetën e tretë dhe e foljes së dytë në vetën e dytë, supozon që ata herën e parë nuk janë të pranishëm, prandaj u thotë: *“Shkoni e tregohuni bukëshkalë ndaj këtyre mirësive”*. Kur vjen radha e kërcënimit, ajeti u thotë bukëshkalëve: *“Kënaquni me këto mirësi të pakta të kësaj bote, pasi shumë shpejt do vija dita, sepse pikërisht në atë ditë ju do të kuptoni gabimin tuaj të madh dhe atëherë do të shihni edhe përfundimin e punëve tuaja”*.

Edhe ajeti 30 i sures **“Ibràhim”** ka qëllim të ngjashëm me ajetin që kemi objekt studimi: **“thua: kënaquni, e ardhmja juaj është te zjarri”**.¹

¹ Një grup interpretuesish të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se folja *“lijekfurù”* **“le të bëhen bukëshkalë”**, është rezultati i idhujtarisë dhe i mohimit, për të cilat flitet në ajetin para këtij ajeti dhe kuptimi është: ata pasi shpëtuan prej dëmit, e lanë rrugën e Njësimit dhe vazhduan në rrugën e idhujtarisë, kështu u bënë bukëshkalë ndaj mirësive të Allahut, madje i mohuan fare të gjitha mirësitë.

Ajetet 56 - 60

﴿وَيَجْعَلُونَ لِمَا لَا يَعْلَمُونَ نَصِيبًا مِّمَّا رَزَقْنَاهُمْ تَاللَّهِ لَتُسْأَلُنَّ عَمَّا
 كُنْتُمْ تَفْتَرُونَ^{٥٦} وَيَجْعَلُونَ لِلَّهِ الْبَنَاتِ سُبْحَانَهُ وَلَهُمْ مَا يَشْتَهُونَ^{٥٧}
 وَإِذَا بُشِّرَ أَحَدُهُم بِالْأُنْثَىٰ ظَلَّ وَجْهُهُ مُسْوَدًّا وَهُوَ كَظِيمٌ^{٥٨} يَتَوَارَىٰ مِنَ
 الْقَوْمِ مِنْ سُوءِ مَا بُشِّرَ بِهِ أَيُمْسِكُهُ عَلَىٰ هُونٍ أَمْ يَدُسُّهُ فِي التُّرَابِ أَلَّا
 سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ^{٥٩} لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ مَثَلُ السَّوْءِ وَلِلَّهِ الْمَثَلُ
 الْأَعْلَىٰ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ^{٦٠}﴾

“Nga ajo që Ne i furnizuam, një pjesë prej saj ata e ndajnë për ato (zotat e tyre) që nuk kuptojnë asgjë; betohem në All’llahun, patjetër do të përgjigjeni për ato që trilluat.”

“Ata i përshkruajnë All’llahut vajza (thonë All’llahu ka vajza); Ai është plotësisht i dëlirë nga kjo (shpifje e idhujtarëve), ndërsa vetes së tyre i përshkruajnë ata që dëshirojnë (djem).”

“Kur ndonjëri prej tyre përgëzohet me (lindjen) vajzë, i nxihet fytyra dhe mbushet me mllef.”

“U fshihet njerëzve për shkak të keqes me të cilën u përgëzua (lindjen e vajzës e konsideron turp të madh dhe jo dhuratë prej All’llahut) dhe (mendon) ta mbajë atë ashtu i poshtëruar, apo ta mbulojë (gjallë) në tokë; sa i keq është gjykimi i tyre.”

“Shembulli i keq u takon atyre që nuk besojnë në Botën Tjetër, ndërsa All’lلاهut i takon shembulli më i lartë, Ai është Fuqiploti, i Urti.”

Komentimi

Koha kur lindja e vajzës konsiderohej turp

Ajetet e mësipërme shpalosën studimet në lidhje me hedhjen poshtë të idhujtarisë dhe adhurimin e idhujve. Ajetet e këtij grupi trajtojnë një pjesë prej sajësave të politeistëve dhe disa forma të adhurimeve të tyre të këqija, duke shtuar kështu një argument tjetër për pavlefshmërinë e politeizmit dhe adhurimit të idhujve. Këto ajete theksojnë tri lloje sajësash e zakonesh që kishin idhujtarët:

Në radhë të parë, ajeti thotë: **“Nga ajo që Ne i furnizuar, një pjesë prej saj ata e ndajnë për ato (zotat e tyre) që nuk kuptojnë asgjë”**.¹

¹ Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë gjatë komentimit të fjalës së ajetit “*mà là jaëlemùne*”, **ata që nuk kuptojnë**, kanë përmendur dy opinione në lidhje me faktin se kujt i adresohet përemri “ata”:

opinion i parë: pjesëza mohuese e foljes **ata që nuk kuptojnë** u adresohet politeistëve, pasi ishin adhuruesit e idhujve ata që ndanin pjesë për idhujt, megjithëse vetë nuk dinin nëse kishin ndonjë të mirë apo të keqe prej tyre. Ky ishte edhe komenti që ne parapëlqyem;

opinion i dytë: përemri u adresohet idhujve, domethënë që idhujtarët u ndanin pjesë idhujve, megjithëse idhujt nuk kuptojnë, s’kanë mendje e as nuk dinë! Në komentin e dytë del sheshit një lloj kontradikte mes shprehjeve të ajetit,

Pjesa që ata ndanin ishin deve dhe kafshë të tjera shtëpiake, përveç prodhimeve bujqësore, ashtu siç njoftohet edhe në ajetin 136 të sures “El En’àm”: **“Nga ajo që Ai krijoi prej të lashtave e prej kafshëve shtëpiake, idhujtarët një pjesë e ndanë për All’llahun dhe sipas mendimit të tyre thanë: ‘Kjo është për All’llahun dhe kjo është për idhujt tanë’. Ajo që ishte për idhujt, nuk shkonte tek All’llahu, kurse ajo që ishte për All’llahun shkonte tek idhujt e tyre. Sa gjykim i shëmtuar ky gjykim i tyre!”**.

Në vijim të ajetit, Kur’ani shton: **“betohem në All’llahun, patjetër do të përgjigjeni për ato që trilluat”**.

Pas marrjes në pyetje do të vijë pohimi, prej të cilit s’ka mundësi të shpëtojë askush dhe më pas vjen dënimi i bazuar mbi të. Duhet theksuar se për shkak të punëve pa asnjë dobi që ata bënë, dënimi në këtë botë do të jetë material, por do të ketë edhe një dënim në Botën e Ardhshme, sepse mendimi juaj o idhujtarë për All’llahun ishte shumë i keq! Gjithashtu ju do të dënoheni edhe për shkak se adhuronit edhe dikë tjetër përveç All’llahut!

Sajesa e dytë e politeistëve ishte: **“Ata i përshkruajnë All’llahut vajza** (thonë All’llahu ka vajza); **Ai është plotësisht i dëlirë nga kjo** (shpifje e idhujtarëve)”; është i dëlirë prej trupëzimit që ata i bëjnë All’llahut, si dhe prej këtij përshkrimi të idhujtarëve. Kurse për vete përshkruajnë: **“ndërsa vetes së tyre i përshkruajnë**

për faktin se pjesëza mohuese “mâ” - nuk - zakonisht përdoret për qeniet pa inteligjencë, kurse folja “ja’lemùne” - kuptojnë - zakonisht përdoret për qeniet me inteligjencë.

Në komentin e parë, pjesëza mohuese “mâ” - nuk - shkon kundër idhujve dhe folja “ja’lemùne” - kuptojnë - shkon kundër adhuresve të idhujve.

ata që dëshirojnë (djem)". Domethënë për veten e tyre nuk e pranojnë atë çfarë përshkruan për All'Ilahun **"ndërsa vetes së tyre i përshkruajnë ata që dëshirojnë (djem)"**, sepse në mendësinë tyre vajzat janë shkak për turp dhe për të keqen!

Për të plotësuar këtë temë, ajeti vijues thekson edhe zakonin e tretë të keq të idhujtarëve: **"Kur ndonjëri prej tyre përgëzohet me (lindjen) vajzë, i nxihet fytyra dhe mbushet me mllef"**.

Por çështja për ata nuk përfundon deri në këtë cak: **"U fshihet njerëzve për shkak të së keqes me të cilën u përgëzua (lindjen e vajzës e konsideron turp të madh dhe jo dhuratë prej All'Ilahut)"**.

Turpërimi për shkak të lindjes së vajzës nuk merr fund këtu, pasi ai është i zhytur në një mendim të thellë: **"dhe (mendon) ta mbajë atë ashtu i poshtëruar, apo ta mbulojë (gjallë) në tokë"**.

Në fundin e ajetit, Filluesi i të gjitha krijesave e hedh poshtë këtë gjykim mizor e shumë të keq të politeistëve me fjalën e Tij: **"Sa i keq është gjykimi i tyre!"**.

Së fundi, i Larti thekson edhe shkakun e vërtetë për të gjitha këto punë të liga: mosbesimi në Botën e Ardhshme: **"Shembulli i keq u takon atyre që nuk besojnë në Botën Tjetër, ndërsa All'Ilahut i takon shembulli më i lartë, Ai është Fuqploti, i Urti."**

Sa më shumë të afrohet njeriu pranë të Gjithëfuqishmit, të Urtit, aq më shumë pasqyrohen në shpirtin e tij cilësitë e Tij të larta, si dituria, fuqia e urtësia dhe aq më shumë largohen prej tij besëtytnitë, sajесat e rreme dhe punët e këqija.

Sa më shumë të largohet njeriu prej të Lartit, me të njëjtën masë zhytet në errësirat e injorancës, të pafuqisë, poshtërimit dhe punëve të këqija.

Shkaku kryesor për çdo devijim, për çdo të keqe e për çdo besëtytni është shkujdesja e njeriut për të përmendur All'llahun, shkujdesja ndaj gjykatës së Tij të drejtë në Botën e Ardhshme; kurse përmendja e All'llahut (dhikri) dhe e Botës së Ardhshme janë shtytësi original i ndjenjës së përgjegjësisë për të luftuar injorancën e besëtytnitë, është faktor kapaciteti, është force e dituri.

Hulumtime

1- Përse idhujtarët i konsideronin engjëjt vajza të All'llahut?

Në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë kemi lexuar se politeistët (mushrikët) thoshin se engjëjt janë vajzat e All'llahut të Gjithëfuqishëm ose se ata i konsideronin engjëjt femra, pa thënë se janë vajza të All'llahut.

Ashtu siç thuhet në ajetin 19 të sures "Ez Zukhruf": **"Edhe engjëjt që janë adhurues të Mëshirëmadhit, ata i quajnë femra"**; si dhe në ajetin 40 të sures "El Isrâ": **"A mos u dalloi Zoti juaj me djem dhe për vete zgjodhi engjëjt që ju i mendoni femra?"**.

Këto besime mund të jenë mbetje prej besëtytnive të popujve të hershëm dhe arritën deri tek arabët e kohës së injorancës para

Islamit ose ka të ngjarë që ky përfytyrim të jetë formuar ndër ta për shkak se engjëjt janë të mbuluar (të padukshëm) për njerëzit. Mirëpo, mbulesa më të shumtën e herëve është karakteristikë për gratë. Pikërisht për këtë arsye, edhe dielli në gjuhën arabe në mënyrë alegorike është në gjininë femërore, kurse hëna, gjithashtu në mënyrë alegorike, është në gjininë mashkullore. Kjo duke pasur parasysh se disku i diellit nuk i mundëson vrojtuesit të shikojë gjatë në të, sepse dielli e mbulon veten me dritën e tij, kurse disku i hënës është fare i dukshëm për syrin dhe i lejon vrojtuesit të shikojë në të, pavarësisht se sa zgjat koha e vrojtimit.

Një hamendje tjetër për emërtimin e engjëjve femra ka të bëjë me xhentilesën e engjëjve dhe dihet se femrat kanë më shumë xhentilesë se meshkujt.

Sido që të jetë, emërtimi i engjëjve femra prej politeistëve pa dyshim që është prej atyre infiltrimeve të besëtytnive të hershme të kalcifikuara në imagjinatën e në fantazinë e njerëzimit, derisa kanë arritur të zënë vend edhe në kokat e disa bashkëkohësve tanë. Duhet theksuar se këto besëtytni nuk janë karakteristikë vetëm te një popull dhe jo te një popull tjetër. Madje, këto besëtytni i konstatojmë edhe në letërsinë e një numri gjuhësh të botës: për shembull, shikojmë që kur shkrimtari do të përshkruajë bukurinë e një femre e cilëson atë me engjëjt. Ndodh kështu sepse artisti duke marrë engjëjt si etalon të bukurisë, i paraqet ata në formën e femrës, megjithëse engjëjt s'kanë trup që të na mundësojë t'i përshkruajmë ata të gjinisë mashkullore ose të gjinisë femërore.

2- Përse u përhap zakoni për varrosjen gjallë e vajzave në kohën e injorancës para Islamit?

Varrosja gjallë e njeriut në vetvete është një veprim makabër, sepse vepruesi që kryen këtë krim të mynxyrshëm, shtyp në brendësi të vetes dashurinë e mëshirën deri në atë gradë sa arrin të vrasë një njeri të pafajshëm, i cili mund të jetë edhe më i afërm se vetja!

Më i keq është fakti se politeisti (mushriku) ndihej krenar për këtë veprim të tij të urryer!!

Ku qëndron krenaria në vrasjen e një njeriu të pafuqishëm që s'ka fuqi të mbrojë veten? Përveç kësaj, si është e mundur që njeriu arrin deri aty sa të varrosë të gjallë një pjesë të zemrës së tij?!

Ky veprim nuk ishte urdhër Hyjnor. Çdo njeri, sado barbar që të jetë, nuk do të kryente këtë krim të përbindshëm pa ekzistuar për këtë lloj krimi premisa shoqërore-ekonomike me ndikim të thellë dhe shumë mbresëlënëse, që e bënë të domosdoshme kryerjen e një veprimi të këtillë.

Historianët thonë se ky veprim i keq ka filluar pas një luftime që ndodhi në mes dy tribuve arabe të asaj kohe, kur triumfuesi i mori robëresha gratë, vajzat e të mundurit, por pasi kaloi njëfarë kohe, u arrit paqja. Të mundurit kërkuan kthimin e njerëzve të tyre të marrë rob lufte, mirëpo disa prej këtyre femrave të marra robëresha ishin martuar me burrat e tribusë triumfuese. Ato parapëlqyen të qëndronin me burrat e tyre dhe refuzuan të ktheheshin në tribu. Ky veprim e vështirësoi shumë gjendjen e prindërve të tyre, të cilët për shkak të moskthimit të grave e të vajzave të tyre, u bënë objekt qortimesh e sharjesh. Puna arriti deri

aty sa disa prej burrave të kësaj tribuje u betuan të vrisnin çdo vajzë që do të lindë, me qëllim që ajo në të ardhmen të mos binte robëreshë në dorën e armiqve!

Vërehet qartë se ky krim i shëmtuar kryhej nën shtysën e zakonit për të mbrojtur nderin, si dhe të nxitjes mashtruese të familjes. Rezultati ishte lindja e zakonit më të keq që mund të mendohet: varrosja gjallë e vajzave, zakon që u përhap ndër të gjithë politeistët, derisa me kalimin e viteve, në kohën e injorancës para Islamit u bë rrugë veprimi. Ligësinë e atij veprimi të shëmtuar, Kur'ani Famëllartë e kundërshton fuqishëm me fjalën e tij: **“dhe kur të pyetet ajo vajza e varrosur gjallë. Për çfarë mëkati u vra?”**.¹

Shkak tjetër i lindjes së këtij zakoni makabër e të shëmtuar mund të jetë roli natyror prodhues i fëmijëve meshkuj dhe tendenca natyrale konsumatore e femrave, si dhe roli i dy gjinive në jetën shoqërore dhe ekonomike. Në mendësinë e politeistëve, fëmija mashkull ishte një furnizim i rëndësishëm që u sillte atyre dobi në lufte, në inkursionet e vazhdueshme që organizonin për të mësuar afrimin e armikut dhe gjendjen e tij. Gjithashtu, djemtë u duheshin atyre për ruajtjen e bagëtive dhe për të tjera punë të ngjashme dobisjellëse, në një kohë që vajzat nuk i bëjnë dot këto punë.

Nga ana tjetër, luftërat e konfliktet në mes tribuve shkaktonin shumë të vrarë burra e djem, çka çoi në prishjen e ekuilibrit shoqëror në raportin femra-meshkuj dhe, gjendja arriti deri aty sa lindja e një fëmije mashkull u bë një eveniment i veçantë gëzimi dhe e bënte burrin të mburrej ndër njerëzit e tij kur atij i lindte një fëmijë mashkull. Por, burri ndihej shumë keq dhe kishte

¹ Sure “Et Tekuir”, ajetet 8-9.

dhimbje të madhe shpirtërore kur i lindi vajzë dhe, ashtu siç thonë disa historianë, në kohën e injorancës para Islamit, puna kishte arritur deri aty sa kur gruas i afrohej koha e lindjes, burri i asaj gruaje largohej që të mos gjendej në shtëpi nëse gruaja e tij lindi vajzë!

Por kur burrin e njoftonin se gruaja e tij lindi djalë, ai menjëherë kthehej në shtëpinë e tij fytyrëqeshur e i mbushur me gëzim, ndërsa kur e njoftonin se i lindi vajzë, për burrin ishte mjerim mbi mjerim dhe ai mbushej me zemërim e hidhërim.¹

Tregimet për varrosjen gjallë të vajzave janë të mbushura me ngjarje të dhimbshme: transmetohet se një burrë erdhi tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe deklaroi para Tij se kishte pranuar Islamit; më pas ai erdhi përsëri te Profeti dhe i tha: "Unë kam kryer një mëkat shumë të madh, a mund të më pranohet mua teubeja?" I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i lexoi ajetin: "**All'llahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëploti**". Burri përsëri i tha: "O i Dërguar i All'llahut, mëkati im është shumë i madh". Ai i tha: "I mjeri ti, por sado i madh qoftë mëkati yt, falja e All'llahut është më e madhe se ai". Pas kësaj fjale, burri filloi të tregojë: "Në kohën e injorancës para Islamit unë ndërmora një udhëtim të largët, lashë gruan shtatzënë dhe kur u ktheva në shtëpi pas katër vjetësh, përveç gruas pashë edhe një vajzë të vogël. E pyeta gruan: "E kujt është kjo vajzë?" Gruaja u përgjigj: "Është e fqinjit tonë". Mendova se vajza do të largohej prej shtëpisë sime pas një ore, por nuk u largua; atëherë e pyes gruan përsëri: "Më thuaj të vërtetën, e kujt është kjo vajzë? Gruaja më tha:

¹ Tefsiri "El Kebijr", vëll. 20, f. 55

“A të kujtohet se unë isha shtatzënë kur ti u nise për udhëtim, ajo është vajza jote”. Atë natë fjeta si mbi gjemba, më zinte gjumi dhe zgjohesha dhe kështu vazhdova deri sa u gdhi. U ngrita nga shtrati dhe vajta të shtrati i vajzës sime, e zgjova, e nxora jashtë dhe i thashë të më shoqëronte deri te muri i hurmave. Vajza më ndoqi derisa u afruam pranë murit dhe aty fillova të hap një grope; vajza më ndihmonte edhe në hapjen e gropës. Pasi e përfundova hapjen e gropës e futa vajzën në mesin e gropës – ndërkaq lotët filluan të rrjedhin prej syve të të Dërguarit të All’llahut - pastaj vazhdoi burri, vura dorën e majtë mbi supin e vajzës dhe më dorën e djathtë fillova të hedh dheun mbi të; vajza thërriste me të madhe, mbrohej me duar e me këmbë dhe thoshte: “Baba, ç’po bën me mua?!” Gjatë kohës që unë hidhja dheun mbi vajzën, mjekra ime u ndot me pluhur dhe vajza, ashtu siç ishte në atë gjendje e ngriti dorën dhe më pastroi mjekrën prej pluhurit, ndërsa unë vazhdova të hedh dheun mbi vajzën, derisa e varrosa plotësisht.

I Dërguari i All’llahut duke fshirë lotët i tha: “Nëse mëshira e All’llahut nuk do të ishte më e madhe se zemërimi i Tij, me siguri që All’llahu do ta përshpejtonte dënimin tënd”.¹

Një ndodhi e këtillë e ngjashme transmetohet edhe për Kajs bin Àsimin, i cili në kohën e injorancës para Islamit ishte njëri prej krerëve të tribusë “Benij Temijm”. Edhe ai e kishte pranuar Islamin në prani të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Një ditë, ai vjen tek i Dërguari All’llahut dhe i thotë: “Baballarët tanë i varrosnin gjallë vajzat e tyre, kështu që edhe unë kam varrosur gjallë dymbëdhjetë vajza. Kur gruaja ime lindi vajzën e trembëdhjetë e mbajta fshehur dhe hapa fjalë se

¹ “El Kur’ānu juvākibu d’dehr” vëll. 2, f. 314.

fëmija kishte vdekur gjatë lindjes, ndërkaq gruaja e çoi vajzën te disa të tjerë, por kur pas një kohë mësova për këtë veprim të gruas, mora vajzën dhe e çova në një vend të largët. Aty e varrosa të gjallë, pa u prekur fare nga të qarat e të lebetiturat e vajzës”.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u ndie shumë keq prej asaj që i tregoi Kajsi dhe duke i rrjedhur lotët prej syve tha: “Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet”. Menjëherë u kthye në drejtim të Kajsit duke i thënë: “Ti e paske një ditë të keqe”. Ndërkaq Kajsi e pyeti: “Ç’ të bëj për të shlyer mëkatin tim?” Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: “Jepu lirinë aq robërve sa vajza ke varrosur gjallë”.¹

Gjithashtu transmetohet se Saësaë bin Nàxhijeh, gjyshi i poetit të njohur Ferzedek, ishte burrë i nderuar dhe thuhet se në kohën e injorancës para Islamit ka luftuar shumë kundër zakoneve të këqija. Kështu, ai ka blerë 360 vajza prej prindërve të tyre me qëllim që t’i shpëtonte prej vrasjes makabre, madje një ditë një burri që desh të vriste vajzën e tij i dha kafshën e shalimit dhe dy deve.

Një herë, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha atij: “Ke bërë shumë mirë dhe shpërblimin e ke tek All'llahu”.

Poeti Ferzedek, duke u krenuar me gjyshin e tij, tha:

Prej nesh është ai që ndaloi varrosjen gjallë të vajzave.

¹ “El Xhàhili’jetu uel Islamu”, f. 632.

Ai i dha jetë vajzës dhe nuk la ta varrosnin gjallë.¹

Tani le të shikojmë se si Islami i eliminoi këto tragjedi makabre, të shëmtuara e shumë të dhimbshme, se si i dha gruas një pozitë të nderuar të atillë që ajo nuk e kishte pasur gjatë shekujve.

Roli i Islamit në riaftësimin e gruas

Shpërfillja për gruan nuk ishte karakteristikë vetëm e arabëve të kohës së injorancës para Islamit, madje gruaja nuk gëzonte as shkallën më të ulët të respektit e të vlerësimit në shumicën e kombeve të qytetëruara të asaj kohe. Në shumicën e rasteve, ajo trajtohej si mall tregtie dhe jo si njeri i respektuar, por arabët e kohës së injorancës para Islamit e manifestonin nënvleftësimin e gruas në format më të këqija e në mënyrat më barbare sesa popujt e tjerë. Madje, ata nuk i fusnin vajzat as në trungun e familjes, ashtu siç e lexojmë në një vjershë të njohur të kohës së injorancës para Islamit, ku thuhet:

Bijtë tanë janë bij të baballarëve e të vajzave tona.

Bijtë e atyre grave janë bij të burrave të largët.

Arabët e kohës së injorancës para Islamit nuk i njihnin femrës të drejtën e trashëgimisë, ata nuk kishin kufizim në numrin e grave që merrnin dhe procedura e martesës ose e divorcit tek ata ishte më e thjeshtë sesa pirja e një gote ujë.

¹ "Kàmûsu Rrixhâl", vëll. 5, f. 125

Që në ditët e para të tij, Islami luftoi ashpër në të gjitha drejtimet e dimensionet që kishte marrë poshtërimi dhe nëpërkëmbja e femrës. Në mënyrë të veçantë luftoi zakonet e tyre shumë të keq, konsiderimin turp i madh kur në familje lindte një femër. Madje, Islami i dha kaq shumë rëndësi lindjes së vajzës sa në shumë transmetime theksohet fuqishëm se vajza është njëra prej portave të mëshirës së All'llahut për atë familje.

Sa shumë e ka respektuar Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) Fatime Zehranë (*Paqja qoftë mbi të!*), aq sa njerëzit çuditeshin me këtë veprim të tij. Ndonëse Ai gëzonte pozitën më të lartë, i puthte dorën Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) kur kthehej prej udhëtimit, para se të shkonte në shtëpi, shkonte në shtëpinë e saj dhe kur nisej për udhëtim, shtëpia e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte shtëpia e fundit ku shkonte për të thënë lamtumirë.

Kur u njoftua për lindjen e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*), pa se fytyrat e shokëve të tij u kontraktuan dhe ai menjëherë tha: “Ç’është kështu me ju? Ajo është borzilok që unë do t’i marr erë, atë ma dha All’llahu i Plotpushtetshëm!”¹

Në një hadith tjetër, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Po, fëmija, janë vajzat, ato janë të dashura, furnizuese, shoqëruese dhe erëkëndshme”.²

Në një hadith tjetër thuhet: “Kush hyn të treg, blen një send të mirë dhe e çon atë te njerëzit e familjes së tij, është si ai që mban sadakanë mbi shpinë për ta çuar te nevojtarët. Prandaj, le të fillojë

¹ “Uesàilu Shijah”, vëll. 15, f. 102.

² Burimi i mësipërm, f. 100.

me vajzat para djemve, sepse ai që gëzon vajzën e tij është sikur i ka dhënë lirinë një robi prej bijve të Ismailit”.¹

Respekti që Islami ligjëroi për gruan, në të vërtetë i ktheu gruas personalitetin e saj të humbur në mesin e pengesave të kohës së injorancës para Islamit. Islami e çliroi gruan prej zakoneve të shëmtuara dhe i dha fund kohës kur gruaja përbuzej.

Pa dyshim që thellësia e kësaj teme kërkon një shkoqitje të hollësishme, por me lejen e All'llahut do të rikthehemi të flasim rreth kësaj çështjeje gjatë komentit të ajeteve përkatëse. Megjithëkëtë, ajo që lëvrin në shpirtin tonë na detyron të mos heshtim kur në shoqërinë tonë islame shikojmë shumë prej gjurmëve të dukurive të kohës së injorancës para Islamit. Madje edhe në ditët e sotme konstatojmë se shumë familje gëzohen kur lind një fëmijë mashkull dhe ndihen shumë keq e shtrembërojnë fytyrën kur fëmija i lindur është vajzë! Ose më e pakta, anojnë më shumë kah djali sesa te vajza!

Pa dyshim që edhe kushtet e veçanta ekonomike e shoqërore, vazhdojnë të ndikojnë në gjendjen e gruas në shoqëritë tona, vazhdojnë të jenë shkak për ekzistencën e zakoneve e të qëndrimeve të gabuara të femrës. Prandaj, besimtarët e sinqertë duhet patjetër të luftojnë këtë lloj mendësie derisa të shkulin krejtësisht rrënjët e saj socialo-ekonomike. Islami nuk pranon që ndjekësit e tij edhe pas 14 shekujsh të kthehen në mendësitë e kohës së injorancës para Islamit, sepse në vetvete një mendësi e këtillë është një lloj injorance.

Në asnjë rast nuk duhet të na mposhtin iluzionet e përhapura kur ne shikojmë nga larg se gruaja në botën

¹ “Mekàrimul Akhlàk”, f. 54.

perëndimore ka arritur qëllimet e saj dhe gëzon respektin e lirinë që është për të pasur zili! Në të vërtetë, jeta konkrete në Perëndim tregon pa dyshimin më të vogël se gruaja atje është e shpërfillur, është bërë lodër dhe mjet i lirë për të ngopur epshet ose për të reklamuar mallrat e prodhimet e ndryshme.¹

¹ Është rastësi e bukur që ky studim u shkrua me datën 20 të muajit Xhemàduth Thànij, të vitit 1401H, datë që përkon me datëlindjen e Fatime Zehrasë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ajetet 61 - 64

﴿وَلَوْ يُؤَاخِذُ اللَّهُ النَّاسَ بِظُلْمِهِمْ مَا تَرَكَ عَلَيْهَا مِنْ دَابَّةٍ وَلَكِنْ يُؤَخِّرُهُمْ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ لَا يَسْتَأْذِرُونَ سَاعَةً وَلَا يَسْتَقْدِمُونَ^{٦١} وَيَجْعَلُونَ لِلَّهِ مَا يَكْرَهُونَ وَتَصِفُ أَلْسِنَتُهُمُ الْكَذِبَ أَنَّ لَهُمُ الْحُسْنَىٰ لَا جَرَمَ أَنَّ لَهُمُ النَّارَ وَأَنَّهُمْ مُّفْرَطُونَ^{٦٢} تَاللَّهِ لَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ أُمَمٍ مِنْ قَبْلِكَ فَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَالَهُمْ فَهُمْ وَليِهِمُ الْيَوْمَ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ^{٦٣} وَمَا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ إِلَّا لِتُبَيِّنَ لَهُمُ الَّذِي اخْتَلَفُوا فِيهِ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ^{٦٤}﴾

“Nëse All’llahu do t’i dënonte njerëzit për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi të (tokë) asnjë gjallesë, por Ai i lë ata për më vonë deri në afatin e caktuar dhe, kur të vijë afati i tyre, ata nuk kanë mundësi as ta vonojnë e as ta shpejtojnë atë qoftë edhe një moment.”

“Ato (vajzat) që i urrejnë për vete, ia veshin All’llahut, gjuhët e tyre lakojnë rrenën se atyre u takon më e mira (Xhenneti); pa dyshim që atyre u takon zjarri dhe ata janë të parët në të.”

“Pasha All’llahun, edhe para teje Ne kemi çuar të Dërguar ndër popujt, por djalli ua zbukuroi punët e tyre (të këqija), ai (djalli) sot është miku i tyre dhe ata kanë një dënim të dhimbshëm.”

“Librin (Kur’ânin) nuk ta kemi zbritur për ndonjë gjë tjetër përveçse që t’u shpjegosh atyre ato për të cilat ata u përçanë, si dhe (ta zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë.”

Komentimi

Mëshira e All’llahut është më e gjerë se zemërimi i Tij

Ajetet e mëparshme bënë fjalë për krimet e shëmtuara e makabre të idhujtarëve, përfshirë edhe varrosjen gjallë të vajzave. Kundrejt një gjendjeje të këtillë në mendjen e disave mund të lindë pyetja: përse All’llahu nuk dënon shpejt fajtorët për punët e këqija që kanë bërë dhe për mizorinë e tyre të kobshme?!

Ajeti 61 i sures që kemi në studim, i përgjigjet kësaj pyetjeje me fjalët: **“Nëse All’llahu do t’i dënonte njerëzit për shkak të mizorisë së tyre, nuk do të linte mbi të (tokë) asnjë gjallesë”**.¹

Fjala e ajetit *“dàb’betin”* - *kafshë* – tregon të gjitha qeniet e gjalla. Gjithashtu ka mundësi që me këtë fjalë këtu të jetë qëllimi vetëm për njeriu, për shkak se është afër me fjalën *“bidhulmihim”* - **“të mizorisë së tyre”**.

¹ Parafjala *“mbi të”* i referohet tokës edhe pse në ajetet e mëparshme nuk ka ardhur për të shpjeguar qartë punën, por shembujt e ngjashëm me këtë shprehje, janë të shumtë në gjuhën arabe.

Do të thotë: nëse All'llahu do t'i dënonte njerëzit për padrejtësitë e mizoritë që bëjnë, nuk do të kishte mbetur njeri mbi faqen e dheut.

Gjithashtu ka mundësi që qëllimi me këtë fjalë të jenë të gjitha qeniet e gjalla, pasi e dimë se të gjitha këto qenie u krijuan për të qenë në shërbim të njeriut, ashtu siç thuhet në ajetin 29 të sures "El Bekareh": **"Ai, i Cili krijoi për ju gjithçka që ka në tokë"**. Por, njeriu arrin deri aty sa mohon shkakun e ekzistencës së qenieve të tjera të gjalla, madje ndërpret edhe shkaqet e riprodhimit e qenie të tjera të gjalla.

Këtu na lind një pyetje e dytë: nëse shikojmë kuptimin gjithëpërfshirës të ajetit, rezultati i fundit do të jetë që në tokë nuk gjendet njeri që të mos jetë mizor. Kjo do të thotë se çdo njeri është mizor sipas fuqisë e mundësisë që ka dhe, nëse All'llahu do të lëshonte dënim të menjëhershëm e të shpejtë, përsëri në këtë gjendje nuk do të mbetej asnjë njeri mbi sipërfaqen e tokës. Pa dyshim që diku ka edhe ndonjë që nuk e miraton këtë kuptim, pasi Profetët (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) si dhe Imamët e ruajtur prej mëkateve, janë jashtë kuptimit përgjithësues të këtij ajeti. Madje, në çdo kohë e në çdo vend ka njerëz, punët e mira të cilëve janë më shumë se punët e tyre të këqija. Gjithashtu gjenden edhe njerëz të mirë e të sinqertë, njerëz që luftojnë për lartësimin e fjalës së All'llahut dhe për ruajtjen e fesë së Tij dhe, të gjithë këta nuk e meritojnë kurrë dënimin asgjësues.

Përgjigje: nisur nga pyetja del qartë se ajeti shpjegon një dispozitë cilësuese dhe jo një dispozitë të përgjithshme që i përfshin të gjithë. Shembuj të ngjashëm me këtë kuptim janë të shumtë në letërsinë arabe.

Prej argumenteve që vërtetojnë këtë shpjegim është edhe ajeti 32 i sures: “Fàtir”, ku thuhet: **“Pastaj Ne u lamë trashëgim Librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur. Prej atyre ka që i bëjnë padrejtësi vetvetes, ka që janë mesatarë, ka edhe prej atyre që me ndihmën e All’llahut, janë të parët në punë të mira; ja, kjo është mirësia e madhe”**.

Vërejmë se ajeti trajton tri kategori njerëzish: mizor e i padrejtë, bërës i mëkateve të vogla dhe ata që janë të parët në punë të mira. Është e dukshme se qëllimi në ajetin që është objekt i studimit tonë, është kategoria e parë dhe jo dy kategoritë e tjera. Pavarësisht nga kjo, s’ka asgjë që na habit, kur themi se ajeti në të njëjtën kohë është edhe gjithëpërfshirës, sepse kategoria e parë përbën shumicën në shoqërinë njerëzore.

Nga sa u përmend bëhet e qartë se ajeti nuk e mohon që Profetët janë të ruajtur prej mëkateve. Kush beson në të kundërtën e kësaj, në të vërtetë është i shkujdesur ndaj shembujve të ngjashëm të shprehjes dhe nuk kthen kokën të shikojë se ç’thonë ajetet e tjera të Kur’anit në lidhje me këtë veçanti.

Ajeti i nderuar vazhdon: **“por Ai i lë ata për më vonë deri në afatin e caktuar dhe, kur të vijë afati i tyre, ata nuk kanë mundësi as ta vonojnë e as ta shpejtojnë atë qoftë edhe një moment”**, patjetër që vdekja do t’u vijë atyre pikërisht në çastin e caktuar.

Hulumtime

Ç'është afati i caktuar?

Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë kanë dhënë shpjegime të shumta në lidhje me qëllimin e frazës së ajetit "*exhelin musem'men*" - *afat i caktuar* – por nga konstatimi i të gjitha ajeteve të Kur'anit, ndër të cilat ajeti 2 i sures "El En'am" dhe ajeti 34 i sures "El Arâf", del qartë se qëllimi me këtë frazë është koha e ardhjes së vdekjes. Pra, All'Ilahu i Gjithëpushtetshëm i lë njerëzit deri në fundin e jetës së tyre të caktuar për ata, me qëllim që edhe ky vonim të jetë një argument kundër vetë mizorëve e mëkatarëve. Pasi ndodh që njeriu heq dorë prej mizorisë dhe kthehet në rrugën e drejtë, kështu që edhe ai ka mundësi të korrigjojë e të përmirësojë veten, duke shpresuar që kjo futje e tij e vonuar në rrugën e drejtë të bëhet shkak që ai të kthehet të Krijuesi i tij dhe të hyjë në rrugën e drejtësisë.

Urdhri për vdekjen del sapo të mbarojë koha e dhënë për të jetuar, pastaj që në çastet e para pas vdekjes, fillon edhe dënimi i tyre.

Për më shumë shpjegime rreth çështjes së "*afatit të caktuar*" referojuni fundit të ajetit 2 të sures "El En'am", gjithashtu edhe fundit të ajetit 34 të sures "El Arâf".

Kur'ani Famëlartë i rikthehet hedhjes poshtë e refuzimit të sajësave të politeistëve dhe besëtytnive të tyre të kohës së injorancës para Islamit, hedhjes poshtë të urrejtjes së tyre për lindjen e fëmijës femër, si dhe kundërshtimit të besimit të tyre të gabuar kur thoshin se engjëjt janë femra. Ajeti njofton: "**Ato (vajzat) që i urrejnë për vete, ia veshin All'Ilahut**".

Vërtet që kjo është kontradiktë shumë e çuditshme, ashtu siç ka ardhur edhe në ajetin 22 të sures “En Nexhm”: **“atëherë, ajo është një ndarje e padrejtë”**. Nëse engjëjt do të ishin vajzat e All’llahut të Gjithëpushtetshëm, në një kohë ku Ai është krejtësisht i pastër nga kjo shpifje dhe, meqenëse engjëjt sipas mendjes së tyre janë vajza të All’llahut, del që lindja e tyre është gjë shumë e mirë, atëherë përse ju o politeistë e urreni lindjen e vajzës?! Nëse kjo do të ishte punë e keqe, atëherë përse thoni që engjëjt janë vajzat e All’llahut?!

Krahas të gjitha këtyre shpifjeve pa asnjë bazë, përsëri politeistët pretendojnë: **“gjuhët e tyre lakojnë gënjeshtren se atyre u takon më e mira (Xhenneti)”**.

Prej çfarë pune e presin ata të mirën e shpërblimit?! A mos e presin me varrosjen gjallë të vajzave të tyre?! Apo me shpifjet e tyre të ulëta që ia veshin All’llahut?!

Fjala e ajetit “*el husnà*” - *më e mira* - ka ardhur në gjininë femërore dhe këtu është në kuptimin: shpërblimi më i mirë ose përfundimet më të mira. Megjithëse, ata si mendjemëdhenj e shpifës pa dyshim që ishin plotësisht në rrugën e humbjes, pretendonin për veten e tyre më të mirën, edhe pse vazhdonin të kryenin krimet më të shëmtuara!

Pyetje: Si i thoshin arabët e kohës së injorancës para Islamit këto fjale, kur ata nuk besonin në Ringjallje?

Përgjigje: Ata nuk e mohanin Ringjalljen në mënyrë absolute; në të vërtetë mohanin vetëm ringjalljen trupore, pasi me ringjallje ata kuptonin çështjen e kthimit të njeriut në jetën materiale edhe një herë tjetër.

Megjithëkëtë, nëse e marrim fjalinë e tyre si kushtore, domethënë: nëse me të vërtetë ka Ringjallje, kjo për ne do të jetë në një botë me shpërblimin më të mirë! Ky ishte edhe përfytyrimi i shumë tiranëve e i atyre që devijonin nga rruga e drejtë, të cilët pavarësisht sa larg All'llahut ishin, përsëri e konsideronin veten njerëzit më të afërm të All'llahu, megjithëse kur deklararin pretendime kaq të pathemelta, dukeshin sikur talleshin.

Disa interpretues të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se fjala *"el husnà"* - *më e mira* – këtu ka kuptimin e mirësisë së lindjeve të fëmijëve meshkuj, sepse lindjen e vajzës ata e konsideronin të keqe e shkak për të keqen, kurse lindjen e djemve mbarësi e gjë shumë të mirë.

Interpretimi i parë rezulton të jetë më i drejtë, prandaj Kur'ani pa asnjë presje në mes fjalëve e vazhdon: **"pa dyshim që atyre u takon zjarri"**. Domethënë, ata nuk janë humbës vetëm për shkak të përfundimit të punës së tyre, por atyre pa dyshim që u takon zjarri, ku: **"ata janë të parët në të"**, pra, janë prej të parëve që do të hyjnë në zjarr.

Mbase disa prej nesh kur dëgjojnë tregimet për arabët e kohës së injorancës para Islamit dhe për zakonin e tyre të urreyer për varrosjen gjallë të vajzave mund të habiten dhe të pyesin: si mund të besojmë që njeriu të varrosë të gjallë pjesën e zemrës së tij?!

Ajeti vijues i përgjigjet hakisë së këtyre njerëzve dhe thotë: **"Pasha All'llahun, edhe para teje Ne kemi çuar të Dërguar ndër popujt, por djalli ua zbukuroi punët e tyre (të këqija)"**.

Po, djalli ka cytje të shumta me të cilat edhe punët më të këqija e më të kobshme i zbukuron në sytë e disave, madje i

zbukuron deri në atë shkallë sa ata ndihen krenarë që i bëjnë ato punë, ashtu siç e konsideronin varrosjen gjallë të vajzave nder, krenari dhe ruajtje të dinjitetit të tribusë! Madje me disa njerëz të asaj kohe, që ishin në shkallët më të ulëta të injorancës, puna arrinte deri aty sa e kishin për krenari të deklaronin: “Sot me duart e mia varrosa të gjallë vajzën time, që nesër ajo të mos bjerë robëreshë në dorë të armikut!”.

Derisa djalli arrinte që edhe punën më të keqe, siç ishte varrosja gjallë e vajzave, ta paraqiste në sytë e disave si punë të bukur e të mirë, vetëkuptohet si do të ishte gjendja e tyre në lidhje me punët e tjera të këqija.

Edhe në ditët e sotme shikojmë se shumë prej punëve të njerëzve mbajnë vulën e djallit: ka njerëz që i përshkruajnë vjedhjet e krimet e tyre me fraza të sheqerosura që të duken të pranueshme apo kur nën mbulesën e fjalëve të bukura fshehin të vërtetën e krimeve që kanë kryer.

Në vijim, Kur’ani Famëllartë njofton se edhe politeistët e ditëve tona janë në të njëjtën rrugë me politeistët që jetuan para tyre, prej atyre që djalli ua zbukuronte punët e liga me fjalët e tij të bukura që pëshpëriste në vesh. Për këtë, Kur’ani thotë: **“ai (djalli) sot është miku i tyre”** dhe atyre u duket se përfitojnë prej asaj që ai u jep si gjë të mirë, por për këtë vijon ajeti: **“dhe ata kanë një dënim të dhimbshëm”**.

Interpretuesit e Kur’anit Famëllartë kanë dhënë shpjegime të shumta në lidhje me frazën e Kur’anit, **“ai (djalli) sot është miku i tyre”**. Por, ne mendojmë se shpjegimi më i qartë është ai që thamë më sipër, domethënë: kjo është një shenjë që tregon se politeistët e

kohës së injorancës para Islamit, në të vërtetë janë në gjendjen e popujve të mëparshëm që devijuan prej rrugës së drejtë; djalli është në pararojë të rrugës së tyre dhe orientues i tyre, ashtu siç ishte orientues edhe për popujt e përparshëm.¹

Gjithashtu qëllimi me frazën **“ai (djalli) sot është miku i tyre”** mund të jetë që të tregojë se edhe në ditët tona vazhdojnë të ekzistojnë mbetje prej popujve të kaluar që devijuan prej rrugës së drejtë, por ata edhe sot vazhdojnë të ecin në këtë rrugë të devijuar, sepse djalli, ashtu siç thamë më sipër, është miku i tyre.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që kemi objekt studimi trajton dërgimin e Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) gjithashtu thekson të vërtetën që nëse popujt e kombet do të ndiqnin Profetët dhe do të kishin hequr dorë prej pasioneve e dëshirave të tyre personale, ndër ata nuk do të kishte mbetur asnjë gjurmë besëtytnie e devijimi dhe patjetër që do të ishin shuar kontradiktat për punët e tyre, ashtu siç njofton ajeti: **“Librin (Kur'anin) nuk ta kemi zbritur për ndonjë gjë tjetër, përveçse që t'u shpjegosh atyre ato për të cilat ata u përçanë, si dhe (ta zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë.”**.

Dalja e cytjeve dhe e ngacmimeve të djallit prej zemrave të tyre, heqja e perdes prej shpirtit të prirur për punë të këqija që mbulonte të vërtetat dhe dalja e të vërtetave sheshit me dritën e

¹ Është e qartë se ky interpretim përmban ekzistencën e një kundërshtimi në lidhje me përemrin (i tyre) në të dyja frazat e ajetit: **“punët e tyre”** dhe **“miku i tyre”**. Përemri i parë u referohet popujve të mëparshëm, kurse përemri i dytë u referohet idhujtarëve të kohës së fillimeve të Islamit. Megjithatë është e mundur zgjidhja e këtij problemi duke lexuar fjalinë: **“ata ndjekin popujt e kaluar”**; (Medito!).

fortë vezulluese që rrezatojnë ato, demaskimi i veprave penale e i krimeve të ndryshme të kamufluara nën ornamentet zbukuruese të fjalëve, fshirja e çdo gjurme prej kundërshtimeve të lindura prej pasioneve, si dhe asgjësimi i së keqes, të gjitha këto do të arrihen vetëm me përhapjen e dritës së mëshirës e udhëzimit në rrugën e drejtë, duke i përfshirë të gjithë njerëzit në të gjitha vendet.

Ajetet 65 – 67

﴿وَاللَّهُ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِقَوْمٍ يَسْمَعُونَ ٦٥ وَإِنَّ لَكُمْ فِي الْأَنْعَامِ لَعِبْرَةً نُسْقِيكُمْ مِمَّا فِي بُطُونِهِ مِنْ بَيْنِ فَرْثٍ وَدَمٍ لَبَنًا خَالِصًا سَائِغًا لِلشَّارِبِينَ ٦٦ وَمِنْ ثَمَرَاتِ النَّخِيلِ وَالْأَعْنَابِ تَتَّخِذُونَ مِنْهُ سَكَرًا وَرِزْقًا حَسَنًا إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ٦٧﴾

“All’lillahu lëshon prej qielli ujë (shi) dhe me të ngjall tokën pas vdekjes së saj; në këtë gjendet një argument i fuqishëm për ata që dëgjojnë me vëmendje (kuptojnë).”

“Edhe te kafshët ju keni mësim dhe prej asaj që ato kanë në barqet e tyre në mes ushqimit e gjakut, Ne u japim të pini qumësht të pastër e të shijshëm për ata që e pinë.”

“Edhe prej frutave të hurmës e të rrushit ju nxirrni pije dhe ushqim të mirë; s’ka dyshim që edhe në këtë ka fakte (për fuqinë e All’lilaut) për njerëzit që mendojnë.”

Komentimi

Ujërat, frutat dhe kafshët shtëpiake

Përsëri Kur'ani Famëlartë merr në studim mirësitë e mëdha e të shumta që ka dhënë All'llahu, duke vënë theksin në çështjen e Njësimi (All'llahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe në çështjen e njohjes së All'llahut, si dhe në çështjen e Ringjalljes, me synimin për të vënë në lëvizje te njerëzit ndjenjën e falënderimit që ata të afrohen tek i Gjithëfuqishmi. Nëpërmjet këtij orientimi të All'llahut bëhet e qartë lidhja mes këtyre ajeteve dhe të atyre të mëparshmeve.

Ajeti i fundit prej grupit të ajeteve të mëparshme trajtoi çështjen e zbritjes së Kur'anit dhe çështjen e jetës e të shpirtit të njeriut. Në të njëjtën linjë vjen edhe ajeti i parë i grupit të ajeteve që janë objekt i studimit tonë, ku flitet për rënien e shirave dhe dobinë që kanë ato në gjallërimin e trupit të njeriut dhe thotë: **“All'llahu lëshon prej qielli ujë (shi) dhe me të ngjall tokën pas vdekjes së saj; në këtë gjendet një argument i fuqishëm për ata që dëgjojnë me vëmendje (kuptojnë).”**.

Shumë ajete të Kur'anit Famëlartë e trajtojnë çështjen e gjallërimit të tokës me rënien e shirave prej qiellit. Sa e sa toka të thata ose të vdekura Ne i gjallëruam. Tokat e djegura prej thatësisrës u bënë të atilla që njeriu nuk përfitonte dot më prej tyre, madje për shkak të thatësisrës tokat kishin arritur deri në atë gradë sa njeriu të mendonte se ato ishin pa bimësi, nuk besonte që ato në të ardhmen do të ishin prodhuese. Por, për shkak të rënies së shirave herë pas here dhe të rrezeve të diellit që bien mbi ato toka, ajo që dukej si e vdekur, do të lëvizë kur mbi atë të fillojë të lëvizë përsëri jeta e

gjallë. Në damarët e asaj toke me fillimin e lëvizjeve të gjakut “shi” do të rikthehet jeta; ajo tokë do të mbushet me gjallëri e aktivitet, kur mbi të të mbijnë lloje të shumta lulësh e bimësh. Më pas, do të sulen nga të gjitha anët e kësaj toke insekte, shpendë e lloje të tjera kafshësh. Kështu, mbi sipërfaqen e kësaj toke, rrota e jetës fillon të rrotullohet përsëri.

Me pak fjalë, njeriu mbetet i habitur para shndërrimit të tokës së vdekur në një skenë të re për jetën dhe vërtet që kjo është prej çudive më të mëdha të krijimit.

Por kjo është vetëm njëra prej dukurive të fuqisë e të madhësisë së Krijuesit të Gjithëpushtetshëm, në të njëjtën kohë është një argument i padiskutueshëm që vërteton mundësinë e Ringjalljes dhe tregon qartë se të vdekurit do të riveshin rrobën e jetës së re. Gjithashtu tregon se e gjitha kjo është e nënshtruar ndaj fuqisë së Atij që nuk i mungon asgjë dhe që s’ka nevojë për asgjë.

Në të vërtetë edhe mirësia e madhe e shirave (njeriu s’ka asnjë kontribut në formimin e shiut), ka një argument tjetër që vërteton fuqinë e madhësitë të Krijuesit të Lartësuar.

Kur’ani Famëlartë pasi përmend mirësinë e madhe të ujit (uji konsiderohet hapi i parë në rrugën e jetës), thekson edhe mirësinë e ekzistencës së kafshëve shtëpiake, veçanërisht qumështin që marrin njerëzit prej kafshëve si lëndë ushqyese me dobi të shumta dhe thotë: **“Edhe në kafshët ju keni mësim”**.

Mësim e çfarë mësimi, por përveç kësaj ajeti shpjegon: **“dhe prej asaj që ato kanë në barqet e tyre në mes ushqimit e gjakut, Ne u japim të pini qumësht të pastër e të shijshëm për ata që e pine.”**.

Fjala e ajetit “*ferthin*” është në kuptimin e *ushqimit të tretur në stomak*. Sapo ky ushqim arrin në zorrë, e furnizon trupin me lëndën e tij jetësore, ndërsa pjesën e tepërt e nxjerr jashtë; ushqimi që tretet në brendësi të stomakut në gjuhën arabe quhet “*ferth*” - *ushqim* - kurse pjesa e ushqimit që nxirret jashtë quhet “*reuth*” - *jashtëqitje*.

Gjithashtu ne dimë se muret e stomakut thithin vetëm një sasi të paktë prej lëndëve ushqyese - vetëm disa lëndë sheqerore - ndërkaq pjesa më e madhe e ushqimit kalon prej stomakut në zorrë, ku gjaku thith prej ushqimit aq lëndë ushqyese sa ka nevojë.

Gjithashtu ne dimë se qumështi rrjedh prej disa gjëndrave të veçanta që janë brenda gjinjve të femrave, por lënda bazë e qumështit merret prej gjakut dhe gjëndrave yndyrore.

Qumështi, kjo lëndë me ngjyrë të bardhë të theksuar, ka fuqi të larta ushqyese, megjithëse prodhohet prej ushqimeve të përziera me teprica prej gjakut.

Fakti më i çuditshëm me qumështin është se ky prodhim kaq i pastër e ka origjinën prej sendeve të ndotura!

Pas kësaj bisede në lidhje me kafshët shtëpiake dhe qumështit që marrin njerëzit prej kafshëve, Kur’ani Famëlartë përmend edhe mirësitë që kanë njerëzit prej bimëve dhe thotë: **“Edhe prej frutave të hurmës e të rrushit ju nxirrni pije dhe ushqim të mirë; s’ka dyshim që edhe në këtë ka fakte (për fuqinë e All’llahut) për njerëzit që mendojnë.”**

Fjala e ajetit “*sekeren*” - “*pije*” ka disa kuptime, por këtu është në kuptimin e pijeve dehëse, madje duhet theksuar se ky është edhe kuptimi më i përhapur i kësaj fjale.

Por ajo që nuk pranon as dyshimin më të vogël, është fakti se Kur'ani Famëlartë në këtë ajet nuk e lejon kurrë prodhimin e pijeve dehëse prej hurmave e prej rrushit. Gjithashtu duhet ditur që përmendja e pijeve dehëse këtu ka ardhur që të jetë përballë fjalës tjetër të ajetit *“rizkan hasenen”* - **“ushqim i mirë”**, si shenjë e vogël që tregon ndalimin kategorik të verës e të pijeve të tjera dehëse. Bazuar mbi këtë të vërtetë nuk është e nevojshme të thuhet se ky ajet ka zbritur më përpara se vera të ndalohej (të bëhej haram), ose të thuhet që ajeti e lejon verën (e bën hallall), në një kohë kur e vërteta e shprehjes kur'anore tregon pikërisht ndalimin e verës në formë të prerë. Gjithashtu, ajeti me siguri që ishte shenjë e qartë dhe bënte paralajmërimin e parë për ndalimin kategorik të verës (bërjen e verës haram).

Në të vërtetë, kjo shprehje duket si një fjali – në kllapa – kundërshtuese brenda këtij ajeti kur'anor.

Hulumtime

1- Si formohet qumështi?

Kur'ani Famëllartë në këtë ajet dhe të mëparshmet njofton se qumështi del prej ushqimesh të tretura në brendësi të stomakut dhe prej gjakut.

Këtë fakt e ka vërtetuar edhe shkenca e fiziologjisë, e cila shpjegon se kur brenda në stomak kryhet tretja e ushqimit, i cili bëhet i gatshëm për t'u thithur, ai përhapet gjerësisht brenda stomakut dhe zorrëve përpara miliona damarëve të hollë si qime, të cilat thithin prej këtij ushqimi elementet dobisjellëse të duhura për ta çuar këtë lëng në damarët e gjirit.

Kur gruaja shtatzënë ushqehet, lëngu i formuar prej ushqimit kalon në gjakun që rrjedh nëpër damarë dhe vazhdon qarkullimin së bashku me gjakun, derisa më në fund arrin në damarët që janë afër damarëve të fetusit. Me qëllim që ky me anë të kësaj rruge të ushqehet gjatë gjithë kohës që është në barkun e nënës dhe, pasi fëmija të lindë, rruga e ushqimit të tij kalon nëpërmjet gjirit. Në një periudhë të caktuar të jetës së fëmijës, gjaku i nënës nuk mund të arrijë te gjaku i fëmijës, prandaj bëhet e nevojshme që ushqimi të pastrohet e të ndryshojë në mënyrë që të përshtatet me gjendjen e re të fëmijës. Pikërisht në këtë kohë fillon të formohet qumështi prej ushqimit e prej gjakut: ushqimi që merr nëna, shndërrohet në ushqim të tretur e të gatshëm për t'u përzier me gjakun e saj që të formohet qumështi.

Në të vërtetë, qumështi është një produkt në mes ushqimit e gjakut, nuk është as gjak i mirëfilltë e as ushqim i tretur, por qëndron më lart se i dyti dhe më poshtë se i pari!

Dihet që gjiri i femrës përfiton prej aminoacideve të depozituara në trup vetëm për të prodhuar lëndët proteinike që mundësojnë prodhimin e qumështit.

Gjithashtu, qumështi ka edhe përbërës të tjerë që nuk gjenden në gjak, por që i prodhojnë disa gjëndra të veçanta, të cilat gjenden në gjirin e femrës (kakazuinë).

Përbërësit e tjerë të qumështit, si vitaminat, kripa e fosfati, vijnë nga depërtimi i drejtpërdrejtë i plazmës në gjak dhe hyjnë në përbërjen e qumështit pa pësuar asnjë ndryshim.

Për sa i përket sheqerit që gjendet në qumësht (laktoza), ai merret prej sheqerit që gjendet në gjak, vetëm pasi më parë gjëndrat e gjirit e kanë përpunuar këtë sheqer dhe vetëm pasi në të kanë ndodhur ndryshimet e domosdoshme dhe, falë këtyre ndryshimeve, ky sheqer shndërrohet në një lloj të ri.

Dihet se prodhimi i qumështit bëhet me anë të thithjes së lëndëve ushqimore nëpërmjet gjakut dhe nëpërmjet lidhjes së drejtpërdrejtë të gjakut me gjëndrat e gjirit. Pavarësisht nga kjo, te qumështi nuk konstatojmë as erën e ushqimeve, as ngjyrën e gjakut, por shikojmë se qumështi fillon të rrjedhë prej gjirit me ngjyrë dhe me erë karakteristike.

Është e rëndësishme të citojmë fjalët e shkencëtarëve specialistë, të cilët janë shprehur se për prodhimin e një litër qumështi, është e nevojshme që në gjirin e saj të kalojnë 500 litra

gjak, pasi vetëm kështu gjiri ka mundësi të thithë lëndët e nevojshme për prodhimin e kësaj sasi qumështit, ashtu siç është e nevojshme që edhe për prodhimin e një litri gjak, duhet të kalojnë nëpër zorrë sasi të shumta lëndësh ushqimore. Me këtë shpjegim, për ne bëhet i qartë plotësisht edhe kuptimi i frazës së ajetit: **“në mes ushqimit e gjakut”**.¹

2- Lëndët ushqyese më të rëndësishme të qumështit

Qumështi përmban lëndë të ndryshme ushqyese, të cilat së bashku formojnë në grup lëndësh ushqyese të kompletuara.

Ai përmban edhe elemente metale e metaloide, si sodium, potas, kalium, magnez, bakër, sasi të pakta hekuri, fosfor, klor etj.

Gjithashtu qumështi përmban oksigjen dhe acid karbonik, ndërsa lëndët sheqerore gjenden në sasi të mjaftueshme në formën e laktozës.

Në qumësht gjenden edhe vitaminat B, B₁, P dhe D.

Shkenca moderne ka vërtetuar se qumështi i një kafshe të ushqyer mirë përmban të gjitha llojet e vitaminave, prandaj pa asnjë diskutim qumështi konsiderohet ushqim i kompletuar, por në këtë studim të reduktuar e kemi të pamundur të japim hollësi të mëtejshme.

¹ Pjesa është shkëputur prej librit tim “El Kijmijâu l hajevej’jetu ue’t’ib’bij’jetu” – “Kimia biologjike dhe mjekësore” – si dhe prej fillimit të librit “Ev’velu xhàmiatin ue àkharu nebij’jin”, vëll. 6, f. 71-77

Patjetër që për vlerat e mëdha të qumështit si lëndë ushqyese flet edhe hadithi i transmetuar prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Vendin e ushqimit e të pijes nuk e zë asgjë tjetër përveç qumështit”.

Gjithashtu në transmetime të tjera lexojmë se qumështi rrit te njeriu aftësinë e të menduarit, përmirëson shikimin, përmirëson kujtesën dhe fuqizon zemrën e shpinën (është bërë e njohur se këto efekte kanë lidhje të ngushtë me lëndët jetësore të qumështit).¹

3- Qumështi, ushqim i pastër dhe lehtësisht i tretshëm

Ajetet e mësipërme theksuan dy veçanti shumë të rëndësishme të qumështit: është ushqim i pastër, i shijshëm dhe lehtësisht i tretshëm. Dihet se qumështi ka vlera të larta ushqyese dhe është i dobishëm, pavarësisht nga vëllimi i tij i paktë. Cilësia e parë e përmendur në fjalën e ajetit tonë: “*khàlisan*” – *i pastër* - do të thotë se qumështi s’ka lëndë të tepërta të shtuara dhe në të njëjtën kohë është lehtësisht i tretshëm, pra i përshtatshëm për njerëzit e të gjitha moshave, nga fëmijëria deri në pleqëri. Pikërisht për këtë arsye, të sëmuret e kanë qumështin ushqim më të përshtatshëm, dobisjellës dhe të pranueshëm, sidomos për efektin e madh që ka për zhvillimin e kockave, prandaj në raste frakturash të kockave dhe të gjendjeve të ngjashme këshillohet të pihet shumë qumësht.

Në tërësinë e kuptimeve të fjalës “*khalisan*” - *i pastër* – është edhe kuptimi *lidhje*. Mbase disa janë bazuar pikërisht te ky kuptim

¹ Për më shumë hollësi lexo librin “Ev’velu xhàmiatin ue àkharu nebi’j’in” vëll.6

kur thonë që fjala e ajetit “*khalisan*” tregon për efektin e qumështit të pastër në ndërtimin e në lidhjen e kockave.

Do të vërejmë se ky kuptim theksohet qartë edhe në dispozitat e ligjit të fesë islame, që flasin për ushqimin e fëmijës me gjirin e nënës.

Fukahatë (juristët e ligjit të fesë islame) kanë shpjeguar edhe lidhjen e ngushtë që formohet në mes fëmijës e në mes gruas që e ushqen atë me qumështin e gjirit të saj. Falë këtij qumështi, fëmijës i forcohen kockat dhe mishi, prandaj është e ndaluar që gjidhënësja të jetë grua për këtë fëmijë. Gjithashtu, juristët e ligjit të fesë kanë shpjeguar se gjidhënësja konsiderohet nënë për fëmijën që ajo mëkoi me qumështin e saj.

Gjithashtu fukahatë kanë thënë se 15 gëlltitje qumësht gjiri të njëpasnjëshme ose gjidhënia gjatë një ditë nate pa ndërprerje, përsëri e konsideron gjidhënesen nënë për fëmijën.

Nëse do të bashkojmë të dyja thëniet, a nuk do të rezultonte se ushqimi me qumësht gjiri gjatë një ditë nate ka efekt në forcimin e kockave e të mishit të fëmijës?!

Të tërheq vëmendjen fakti që rregullat islame e kanë theksuar kaq shumë rëndësinë e qumështit për njeriun menjëherë pas lindjes, madje në disa libra të fik’hut islam thuhet se jeta e fëmijës është peng i qumështit. Për këtë arsye, ata e kanë ngritur në shkallën e obligimit (farz) ushqimin e fëmijës me qumështin e lehonës.

Patjetër që edhe ajeti 7 i sures “El Kasas” që flet rreth Hazretit Musa (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ka lidhje me këtë

çështje dhe thotë: **“Nënën e Musait Ne e inspiruam që t’i japë atij
gji dhe kur të kesh frikë për të (për jetën e tij), atëherë hidhe atë
në lumë.”.**

Ajetet 68 – 69

﴿وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنِ اتَّخِذِي مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا وَمِنَ الشَّجَرِ
وَمِمَّا يَعْرِشُونَ ٦٨ ثُمَّ كُلِي مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ فَاسْلُكِي سُبُلَ رَبِّكِ ذُلًّا
يَخْرُجُ مِنْ بُطُونِهَا شَرَابٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ فِيهِ شِفَاءٌ لِلنَّاسِ إِنَّ فِي ذَلِكَ
لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ﴾ ٦٩

**“Zoti yt i tha bletës: ndërto shtëpi në malet, në drunjtë dhe në
çatitë (kosheret) që ata (njerëzit) ndërtojnë.”**

**“Pastaj ha prej të gjitha (llojeve) frutave dhe përshko të gjitha
rrugët e caktuara prej Zotit tënd; prej barqeve të tyre (bletëve) del
një pije me ngjyra të ndryshme, në të cilën ka shërim (ilac) për
njerëzit; edhe në këtë ka një argument për ata që mendojnë.”**

Komentimi

“Zoti yt i tha bletës!”. Në këto dy ajete të Kur'anit, mënyra e bisedës për paraqitjen e mirësive të ndryshme të All'Ilahut dhe për shpjegimin e sekreteve të krijimit kalon në bisedën rreth bletës e prodhimit që del prej saj (mjalti). Gjithashtu, ajeti që është objekt studimi flet edhe për simbolikën e inspirimit të fshehtë hyjnor drejtuar bletës: **“ndërto shtëpi në malet, në drunjtë dhe në çatitë (kosheret) që ata (njerëzit) ndërtojnë”**.

Ky ajet i nderuar përmban disa shprehje, te të cilat do të përqendrohemi për të dhënë më shumë hollësi.

1- Ç'është inspirimi?

Fjala e ajetit *“vahju”* siç thotë edhe Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit (mufredat el fàdhul Kur'an) është në kuptimin e theksimit të shpejtë dhe pastaj njoftimin në fshehtësi.

Fjala *“el vahju”* e Kur'anit Famëlartë ka ardhur për të treguar në mënyrë simbolike disa sende, të cilat kanë kuptimet e mëposhtme:

- inspirimi profetik (revelata profetike, shpallja profetike), në këtë kuptim kjo fjalë ka ardhur në shumë ajete të Kur'anit, si për shembull në ajetin 51 të sures “Esh Shurà”: **“Nuk ka asnjë njeri që t'i ketë folur All'Ilahu përveçse me anë të inspirimi.”**

Prej kuptimeve të fjalës *“vahjun”* në kuptimin e inspirimit, qoftë edhe kur personi që inspirohet i është tërhequr vëmendja më

parë, siç është rasti me nënën e hazretit Mùsà (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*): **“Nënën e Musait Ne e inspriuam që t’i japë atij gjë dhe kur të kesh frikë për të (për jetën e tij), atëherë hidhe atë në lumë”**; ose pa tërheqje vëmendjeje, siç është inspirimi instiktiv, ashtu siç e pamë me bletën. Pikërisht ky është inspirimi për të cilin bëhet fjalë në këtë ajet.

Dihet që inspirimi në këtë drejtim, pra inspirimi instiktiv me motiv të brendshëm, është instinkti që All’llahu me urtësinë e Tij e ka depozituar te qeniet e gjalla.

Herë tjetër fjala *“vahjun”* është në kuptimin e theksimit të një sendi, ashtu siç ka ardhur në rastin e tregimit të Zekerijàs në ajetin 11 të sures “Merjem”: **“dhe atyre u bëri shenjë: adhuroni All’llahun mëngjes e mbrëmje.”**.

Gjithashtu, kjo fjalë ka edhe kuptimin e dërgimit të fjalëve në fshehtësi, ashtu siç thuhet në ajetin 112 të sures “El En’àm”: **“me fjalë të zbukuruara e në fshehtësi ata nxitën njeri-tjetrin me mashtrime”**.

2- A është i veçantë inspirimi instiktiv vetëm për bletët?

Dihet se ekzistenca e instinkteve (inspirimi instiktiv) nuk reduktohet vetëm për bletën, por përfshin të gjitha kafshët. Atëherë, përse në këtë ajet përmendet veçanërisht bleta?

Përgjigjja për këtë pyetje do të bëhet e qartë nëpërmjet parathënies vijuese: studimet e hollësishme që kanë kryer shkencëtarët mbi veçoritë e jetës së bletëve, kanë vërtetuar se te ky insekt i mahnitshëm janë shumë të zhvilluara rregulla të habitshme

qytetërimi e të jetës kolektive të ngjashme në shumë drejtime me qytetërimin e njeriut dhe me jetën e tij kolektive.

Në ditët e sotme, shkencëtarët kanë arritur të zbulojnë shumë prej sekreteve të këtij insekti. Falë këtyre studimeve, ata kanë arritur në bindjen e plotë se Krijuesi është Një e i Vetëm dhe se është detyrim që të nënshtrohen ndaj fuqisë së të Gjithëfuqishmit, të Lartit.

Kur'ani Famëlartë e thekson këtë fakt jo të zakonshëm me fjalën e tij *"elvalhu"* - *inspirim* - për të bërë të qartë se jeta e bletës nuk mund të matet me jetën e njeriut. Me këtë fjalë, Kur'ani Famëlartë ka qëllim të nxisë njerëzit që ata të thellohen në botën e sekreteve të këtij insekti të çuditshëm dhe nëpërmjet këtij studimi të thelluar të njihen me madhësinë e me fuqinë e Krijuesit të bletës. Por, ka mundësi që kjo fjalë simbolike ka ardhur në këtë ajet veçanërisht për bletën, në raport me atë çka u tha në ajetet e mësipërme.

3- Detyra e parë në jetën e bletëve

Detyra e parë me të cilën urdhërohen bletët në këtë ajet është ndërtimi i shtëpisë. Mbase kjo është njëra prej shenjave që tregon se ndërtimi i banesës së përshtatshme është kushti i parë për jetesën dhe më pas vijnë aktivitetet e tjera. Ose ka gjasa që kjo fjalë tregon punët e hollësishme e fortësinë e shtëpisë së bletëve, duke theksuar se ndërtimi i hojeve të bletës me dyllë dhe në formë gjashtëkëndëshi të rregullt, është praktikuar qysh prej miliona vitesh në shumë

vende. Madje, ndërtimi i shtëpisë së bletës mund të jetë punë edhe më e habitshme se prodhimi i mjaltit.¹

Si e vënë bletët këtë lëndë të veçantë prej dylli? Si i ndëtojnë ato hojet gjashtëkëndëshe me këtë formë gjeometrike të përkryer? Forma dhe dimensionet e shtëpisë së bletëve janë të llogaritura me imtësi, këndet e hojeve janë plotësisht të barabarta dhe me karakteristika që përjashtojnë çdo mundësi që ato të jenë më të mëdha ose më të vogla.

Urtësia e All'llahut ka shfaqur vullnetin që shtëpia e bletëve të ketë formën më të mirë, të jetë e përzgjedhur dhe me karakteristika të përkryera. Vetëm All'llahu, Krijuesi i të gjitha sendeve është i dëlirë nga mangësitë e nga nevojat.

4- Ku është vendi i bletëve?

Ajeti i nderuar e ka përcaktuar vendin për ndërtimin e banesës së bletëve nëpër male, mes shkëmbinjve e qafave të përshtatshme, ose në mes degëve të drunjve, madje edhe në shtëpitë (kosheret) që i ndërton vetë njeriu për bletët.

Prej shprehjes së ajetit kuptohet se shtëpitë e bletëve duhet të ndërtohen në një vend të ngritur të malit ose të pemës, ose në kosheret e punuara posaçërisht me qëllim që bletët të përfitojnë në mënyrën sa më të mirë.

¹ Deri tani njihen 4 500 lloje bletësh të egra, por është shumë e habitshme se të gjitha këto lloje kanë të përbashkët emigrimin, ndërtimin e hojeve, vendin dhe thithjen e nektarit të luleve. Referoju librit "Ev'velu xhâmiatin ue âkharu nebij'jin", vëll. 5, f. 55.

Në ajetin vijues, Kur'ani Famëlartë flet për detyrën e dytë të bletëve: **“Pastaj ha prej të gjitha (llojeve) frutave dhe përshko të gjitha rrugët e caktuara prej Zotit tend.”**.

Në tekstin arabisht, fjala e ajetit *“dhulelen”* - të caktuara - ka ardhur në numrin shumë në kuptimin: dorëzim dhe veprim sipas inspirimit.

Rrugët cilësohen me fjalën të nënshtruara - të caktuara - sepse janë të përcaktuara me imtësi për të qenë të nënshtrura e drejtuese për bletët gjatë lëvizjeve që ato bëjnë. Për realizimin e lëvizjeve të bletëve do të flasim në vijim.

Së fundi, Kur'ani Famëlartë bën të njohur edhe detyrën e fundit të bletëve, si dhe të detyrave të saj të mëparshme: **“prej barqeve të tyre (bletëve) del një pije me ngjyra të ndryshme, në të cilën ka shërim (ilac) për njerëzit; edhe në këtë ka një argument për ata që mendojnë”**. Me karakteristikat e jetës së saj dhe me ushqimin që ajo i jep njeriut, që në të njëjtën kohë është edhe shërues, patjetër që bleta është një argument që tregon fuqinë e madhe të Krijuesit të Lartësuar.

Hulumtime

Në këtë ajet gjenden një sërë studimesh të tjera shumë të vlefshme:

1- Përbërësit e mjaltit

Bleta thith disa lëndë sheqerore të veçanta që gjenden në pjalmoren (vendi ku formohet (poleni) i luleve. Specialistët e bletëve thonë se puna e bletës nuk reduktohet vetëm në marrjen e lëndës sheqerore, pasi kjo detyrë kapërcehet disa herë për të përfituar prej disa pjesëve të tjera të luleve, ashtu siç qëndron edhe puna me frutat, të cilën Kur’ani Famëlartë e thekson me fjalën e tij: **“prej të gjitha (llojeve) frutave”**.

Këtu do të citojmë atë që ka thënë shkencëtari i fushës së mjedisit Meterlink, që Kur’ani Famëlartë e ka shprehur në një formë edhe më të qartë. Ja se ç’thotë shkencëtari i lartpërmendur: “Nëse do të zhduken të gjitha llojet e bletëve të buta e të egra, do të zhdukeshin njëqindmijë lloje bimësh, frutash e lulesh, do të zhdukej edhe qytetërimi ynë, për shkak të rolit që luajnë bletët në transportimin e farës mashkullore të fekondimit në ato femërore. Këtë veprim të bletës disa shkencëtarë e kanë vlerësuar shumë më të rëndësishëm sesa prodhimi i mjaltit”.

Në të vërtetë, ushqimi që merr bleta prej llojeve të frutave, realizohet falë fuqisë dhe jo të punës dhe, pikërisht për këtë bleta jep ndihmesën e saj në formimin e mjaltit. Këtë të vërtetë, Kur’ani Famëlartë e shpreh me fjalën: **“prej të gjitha (llojeve) frutave”**.

2- Udhët e nënshtruara

Shkencëtarët e specializuar në studimin e jetës së bletëve kanë arritur në konkluzionet vijuese: çdo mëngjes del prej kosheres një grup bletësh për të mësuar vendet ku gjenden lulet dhe i përcaktojnë ato, pastaj grupi kthehet në koshere për të njoftuar bletët e tjera për vendet ku gjenden lulet, gjithashtu i njoftojnë edhe për drejtimin që duhet të marrin për të arritur te lulet, si dhe distancën lule-koshere.

Disa herë bleta përdor shenja të veçanta për të përcaktuar rrugët që i çojnë te lulet, madje ato specifikojnë natyrën e aromave që shpërndajnë lulet gjatë rrugës që ato ndjekin; ose bletët përdorin shenja të tjera të ngjashme dhe e gjitha kjo bëhet që bletët të mos humbin rrugën vajtje-ardhje.

Mbase fraza e ajetit: **“përrshko të gjitha rrugët e caktuara të Zotit tënd”**, thekson pikërisht këtë lëvizje të bletëve.

3- Ku fabrikohet mjalti?

Mbase edhe në ditët tona mund të gjendet dikush që mendon se nektarin e thithur prej luleve, bleta e mbledh në gojën e saj dhe pastaj e depoziton në hoje. Por, ky mendim është në kundërshtim me atë çka bën bleta në të vërtetë. Ajo e mbledh polenin e luleve në disa gropëza të veçanta brenda trupit të saj, të përqendruara në zonën e poshtme të barkut. Këto gropëza në vetvete janë si laboratorë kimikë të specializuar në proceset e

shndërrimit e të përpunimit të nektarit të luleve, derisa arrijnë në fabrikimin e mjaltit, të cilin bleta në saje të daljes e të mbledhjes së këtij nektari, e çon atë të përpunuar në hojet e kosheres.

Është e çuditshme që surja “En Nahl” – “Bleta” – është sure e zbritur në Mekë, e cila siç dihet shtrihet në një zonë të thatë, ku s’ka fare bletë, për shkak të mungesës së bimësisë e të luleve për të cilat ajo ka nevojë. Megjithëkëtë, Kur’ani Famëlartë flet për imtësi të jetës së bletës, madje tregon edhe hollësi të punës së saj (prodhimin e mjaltit): **“prej barqeve të tyre (bletëve) del një pije me ngjyra të ndryshme”**.

4- Ngjyrat e ndryshme të mjaltit

Ngjyra e mjaltit ndryshon sipas ngjyrës së luleve prej të cilave bleta ka marrë nektarin: disa herë ka ngjyrë kafeje të errët, herë tjetër është me ngjyrë të verdhë, herë tjetër është me ngjyrë argjendi, herë tjetër s’ka ndonjë ngjyrë të përcaktuar, herë tjetër duket transparent, herë tjetër ka ngjyrë floriri ose ngjyrën e hurmës, ose ka raste që sikur anon kah e zeza.

Patjetër që në këtë ndryshueshmëri të ngjyrave të mjaltit ka një urtësi me rëndësi shumë të madhe, madje kohët e fundit është zbuluar se ngjyra e ushqimit ka një efekt të rëndësishëm në vënie në lëvizje të dëshirës së njeriut për atë lloj ushqimi.

Kjo e vërtetë nuk ishte e panjohur as për të mëparshmit, të cilët bënë kujdes të madh që ngjyra e ushqimit të binte në sy. Për këtë arsye i shtonin ushqimit edhe disa lëndë të tjera, si për

shembull erëza të ndryshme, me qëllim që të arrinin atë shije e ngjyrë që dëshironin.

Në lidhje me çështjen e ngjyrës së ushqimit ka studime të detajuara në librat e kulinarisë, prandaj nuk është e nevojshme të flasim gjerë e gjatë për të, pasi edhe mund të dalim jashtë fushës së interpretimit të Kur'anit Famëllartë.

5- Mjalti, shërues sëmundjesh

Dihet që bimët e lulet kanë veti kurative të efektshme për shumë sëmundje dhe, pavarësisht se dimë kaq shumë gjëra, ne nuk njohim ende shumë prej dobive të tyre. Gjithsesi në temën tonë është e rëndësishme të citojmë konkluzionin ku kanë arritur shkencëtarët nëpërmjet eksperimenteve që kanë bërë, me anë të të cilave kanë vërtetuar se bleta zotëron një mjeshtri të rrallë në fabrikimin e mjaltit. Me bletën nuk shkon dëm asgjë nga e veçanta që përmbajnë bimët e lulet, pasi të gjitha këto veçanti ajo i transporton dhe i vendos te mjalti.

Shkencëtarët kanë shpallur shumë prej cilësive të mjaltit dhe dobive që përmban mjalti për shëndetin e njeriut, si profilaktike, kurative dhe fuqizuese. Disa nga vetitë e mjaltit janë:

- thithet shumë shpejt prej gjakut, prandaj është ushqim fuqizues dhe me efekt shumë të madh në formimin e gjakut;
- parandalon fryrjen e stomakun;
- hidraton;

- është ilaç kundër pagjumësisë (me kusht që të mos tejkalohet sasia, pasi marrja e një sasive të shumtë mjalti pakëson gjumin);

- ka efekt të rëndësishëm për çlodhjen dhe kontraktimin e muskujve;

- fuqizon sistemin nervor të fëmijëve (kur nëna nuk është ushqyer me mjaltë gjatë shtatzënisë);

- largon sasinë e kalciumit në gjak;

- është i dobishëm në fuqizimin e aparatit tretës (veçanërisht të atyre që vuajnë nga fryrja e barkut);

- duke qenë lehtësisht i djegshëm, është veprues i shpejtë dhe shumë i mirë në dhënien e fuqisë;

- fuqizon zemrën, ndihmon në mjekimin e sëmundjeve të mushkërive, është shumë i dobishëm në raste diarreje, sepse vret mikrobet;

- konsiderohet prej faktorëve shumë të rëndësishëm për mjekimin e ulcerës së stomakut dhe duodenit;

- është shumë i dobishëm për mjekimin e reumatizmës dhe shëron dhimbjet nervore;

- është shumë i dobishëm për largimin e kollës, si dhe element shumë i rëndësishëm për pastrimin e zërit.

Si përfundim, vetitë kurative të mjaltit janë më shumë nga sa mund të thuhet në këtë përmbledhje të shkurtër.

Gjithashtu, mjalti hyn edhe në industrinë e përgatitjes së medikamenteve zbutëse të lëkurës, si të kremrave për zbukurim. Ai ndikon edhe në zgjatjen e jetës; përdoret për mjekimin e plagëve në gojë, në gjuhë e në sy; për qetësimin e dhimbjeve të muskujve të shkaktuara nga lodhja e madhe, si dhe për të mjekuar çarjet e lëkurës dhe për raste të tjera të ngjashme.

Mjalti përmban lëndë e vitaminave të shumta, si A, B, C, D, K, E, madje disa besojnë se mjalti përmban edhe vitaminë (PB); lëndë minerale, si: hekur, fosfor, potas, jod, magnez, plumb, bakër, sulfur, nikel, sodium etj.

Prej mjaltit përfitohen nënproduktet: dyllë, acid laktik, acid formik, acid citrik, acid tatarik dhe vajra aromatike.

Pra, mjalti është ilaç për shëndetin e për bukurinë e njeriut.

Edhe transmetimet islame flasin për vetitë e veçanta kurative të mjaltit. Kanë ardhur shumë transmetime prej prijësit të besimtarëve Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe prej Imamëve ((*Paqja qoftë mbi ta!*) të ruajtur prej mëkateve. Që të gjithë kanë thënë: “Asgjë nuk i shëron njerëzit si mjalti”.¹

Në një transmetim tjetër thuhet: “Kurrë nuk shërohet njeriu ashtu siç shërohet duke pirë mjaltë”.²

Gjithashtu transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ai që pi

¹ “Vesailush Shijah”, vëll. 17, f. 73-75.

² Burimi i mësipërm.

mjaltë një herë në çdo muaj duke pasur qëllim atë çka thuhet në Kur'an, ai është shëruar prej shtatëdhjetë e shtatë sëmundjesh.¹

Ka edhe hadithe të tjera që flasin për rëndësinë e mjaltit në mjekimin e dhimbjeve të barkut.

Vlen të theksohet se për çdo dispozitë të përgjithshme dhe për çdo rregull ka edhe përjashtime. Pikërisht për këtë arsye ndalohet përdorimi i mjaltit në disa raste.

6- “Për njerëzit”

Në studimet e specialistëve të bletëve të tërheq vëmendjen fakti se ata kanë thënë: është e mjaftueshme thithja e dy ose e tre luleve për të shuar urinë e bletës. Por zakonisht brenda një ore, bleta kalon mbi 205 lule dhe për këtë ajo përshkon disa kilometra. Ndonëse jeta e bletës është shumë e shkurtër, ajo prodhon sasi jo të pakta mjalti. Mund edhe të mos besohet sa shumë mjaltë prodhon bleta në krahasim me jetën e saj të shkurtër, por ajo arrin të prodhojë këtë sasi mjalti vetëm falë punës së vazhdueshme e të palodhur që kryen.

Gjithë ky mundim e kjo punë këmbëngulëse në të vërtetë nuk është që bleta të mbushë barkun e saj, por të “fabrikojë” mjaltin, ashtu siç e shpreh Kur’ani Famëlartë me fjalën: “*lin'nàsi*” - *për njerëzit*.

¹ “Sefijnetul Bihàri”, vëll. 2, f. 190

7- Konstatime të rëndësishme për mjaltin

Shkenca moderne ka vërtetuar se mjalti është lëndë ushqyese që mbetet gjithmonë e freskët, nuk prishet dhe ruan të gjitha përbërësit e vitaminat, sado kohë të qëndrojë pa u konsumuar, sepse siç thamë, është prej ushqimeve që nuk prishet.

Shkakun e kësaj vetie të rrallë të mjaltit, shkencëtarët ia atribuojnë pranisë së potasiumit, i cili nuk i lejon mikrobet të jenë vepruese të mjaltit. Patjetër duhet shtuar edhe prania në mjaltë e disa lëndëve rezistente ndaj thartimit e prishjes, si për shembull acidi formik, plus faktit që vetë mjalti është ndalues e vrasës i mikrobeve, madje egjiptianët e hershëm për këtë shkak e kanë përdorur mjaltin edhe në procesin e mumifikimit.

Shkencëtarët thonë se mjalti nuk duhet ruajtur në enë metalike.

Në këtë drejtim, Kur'ani Famëljartë thotë: **“ndërto shtëpi në malet, në drunjtë dhe në çatitë që ata (njerëzit) ndërtojnë”**, pra shtëpia e bletëve duhet të jenë vetëm në mes pemëve dhe gërxeve.

Një tjetër konstatim me rëndësi janë edhe përfitimet që arrihen prej cilësive mjekuese të mjaltit. Për këtë arsye, mjalti nuk duhet vënë në zjarr që të gatuhet, madje disa besojnë se fjala e Kur'anit *“sheràbun” - pije* – thekson pikërisht për këtë çështje, pasi mjalti është prej llojit të pijeve dhe nuk është gjellë që gatuhet në nxehtësinë e zjarrit.

Edhe një konstatim tjetër: pavarësisht se pickimi i bletës shkakton dhimbje, por edhe ka gjithashtu efekt kurativ. Megjithatë, bleta me karakterin e saj të butë nuk pickon asnjë njeri pa shkak,

madje janë njerëzit ata që e shtyjnë atë të pickojë, qoftë kur e dimë, qoftë kur nuk e dimë që po e ngacmojmë.

Prej shkaqeve që e detyrojnë bletën të pickojë njeriun, është fakti që bleta nuk i duron erërat e këqija. Kur njeriu i afrohet kosheres për të vjelë prodhimin e bletës, ajo e pickon vetëm nëse dora e tij është e ndotur; kur në rrobën e tij ka ndonjë erë të keqe; kur njeriu nuk e ka të larë dorën që e kalon nëpër hoje, atëherë atë do ta pickojë bleta e hojes tjetër, sepse ai çoi tek ajo erën e një hoje të huaj për atë!

Megjithëse pickimi bëhet për qëllim vetëmbrojtjeje, për bletën pickimi është vetëvrasje, pasi duke pickuar me thumbin, në të vërtetë ajo ka shkruar edhe vdekjen e saj!

Shkencëtarët specialistë kanë vënë një program të përcaktuar për trajtimin e sëmundjeve të reumatizmës, malaries dhe të dhimbjeve nervore me anë të pickimit të bletëve, megjithëse këto shkaktajnë dhimbje të forta, madje në disa raste janë shumë të rrezikshme.

Njeriu mban një pickim ose disa pickime të bletës, por nëse pëson 200-300 pickime, mund të kalojë në gjendje helmimi dhe mund të ketë trazime në zemër. Nëse numri i pickimeve të bletëve arrin në 500, shumë shpejt helmi i marrë nga ato do të çojë në paralizimin e aparatit të frymëmarrjes dhe mbase deri në vdekje.

8- Çuditë e jetës së bletëve

Të mëparshmit njihnin shumë pak gjëra rreth jetës së bletëve, kurse në ditët tona, si rezultat i studimeve të gjera që kanë kryer shkencëtarët, është bërë e qartë se blea bën një jetë të organizuar shumë mirë, duke filluar dhe me ndarjen punëve, me caktimin e përgjegjësive dhe zbatimin e një programi pune shumë të detajuar.

“Qyteti” i bletëve është prej qyteteve më të pastra, më të sistemuara; në qytetin e bletëve (koshere) ka punë për të gjitha bletët. Ai është e kundërta e qytetit të njerëzve: aty s’ka as papunësi e as varfëri, të gjithë bëjnë një jetë të bukur, çdo bletë u nënshtrohet rregullave të qytetit, aty nuk sheh asnjë kundërvajtje e asnjë shkelje të “rregullave ligjore”. Gjithashtu, në qytetin e bletëve nuk ka asnjë punë të lënë mangët, përjashtoj ndonjë rast të rrallë. Kur kjo mangësi në punë ndodh, dihet se ka ardhur për shkak se njëra prej bletëve ka shkuar në ndonjë lule me erë të keqe dhe ka thithur nektarin e saj. Për këtë arsye, kjo bletë i nënshtrohet një kontrolli të fortë në hyrje të “qytetit”, pastaj “gjykohej” në një gjykatë tepër strikte: dënohet me vdekje, ashtu siç njihen edhe ndër njerëzit gjykatat që trajtojnë dënimet për krime të rënda.

Shkencëtari belg në fushën e mjedisit Meterlink, i cili ka kryer studime të shumta rreth jetës së bletëve dhe të sistemit të mahnitshëm që sundon në qytetin e bletëve, shprehet: “Është fakt që mbretëresha e bletëve, e cila në të vërtetë është nëna e bletëve të kosheres, nuk jeton në qytetin e saj të veçantë, ashtu siç mund të përfytyrohet prej pushtetit të saj dhe të urdhrave që ajo jep. Në të kundërt, mbretëresha e bletëve, ashtu si çdo bletë tjetër e këtij qyteti, u bindet rregullave e sistemit sundues të qytetit. Por ne nuk

dimë sesi janë vënë këto rregulla e ky sistem, prandaj presim që ndonjë ditë të kuptojmë edhe këtë çështje; ndërkaq ne njohim Vënësin e këtyre rregullave, të Cilin përkohësisht do ta quajmë ‘shpirti i zgjoit’!

Mbretëresha i bindet ‘shpirtit të zgjoit’ ashtu si të gjithë bletët e tjera të kosheres.

Ne nuk e dimë ku gjendet ky ‘shpirt i zgjoit’, gjithashtu nuk dimë në cilin pjesëtar të kosheres ka hyrë ky shpirt. Megjithëkëtë, ne dimë se nuk është i ngjashëm me instinktet e shpendëve, gjithashtu dimë se nuk është zakon apo vullnet i verbër që sundon specien bletë. Në të vërtetë, ‘shpirti i zgjoit’ është ai që cakton detyrat e çdo pjesëtari të kosheres në përputhje me përgatitjen që ka secili pjesëtar dhe që drejton në një punë të caktuar çdo pjesëtar.

‘Shpirti i zgjoit’ urdhëron bletën inxhinierë, bletën ndërtuese dhe bletën punëtore të ndërtojnë shtëpitë. Të gjithë këta pjesëtarë të qytetit, në një ditë të caktuar dhe në një orë të caktuar, urdhërohen të emigrojnë prej këtij qyteti dhe të drejtohen drejt ngjarjeve e vështirësive të panjohura në gjetje të një banese e të një strehe të re!

Në të vërtetë, ne nuk dimë se në cilin kuvend konsultativ janë shtruar ligjet e qytetit të bletëve të vëna prej ‘shpirtit të zgjoit’, i cili ka marrë edhe vendimin për zbatimin e atyre ligjeve, gjithashtu nuk dimë kush i nxjerr urdhrat për lëvizjet që do të bëhen në një ditë të caktuar.

Po, në zgjua ka premisa të emigrimit në bindje të Zotit, në dorën e të Cilit gjendet e ardhmja e bletëve”.¹

¹ Përmbledhje prej librit: “En Nahlu” – “Bleta” – e autorit Meterlink.

Shkencëtari i lartpërmendur e vuri theksin në kuptimin e kësaj çështjeje, pasi në mendjen e tij qëndronin të varura mbetjet e ardhura prej fundërrinave të materializmit!

Në të vërtetë, ne e kuptojmë me lehtësi prej nga erdhën këto ligje e këto programe. Ne e dimë cili është Urdhëruesi i këtyre ligjeve e programeve. Të gjitha këto i dimë ngaqë kemi kërkuar udhëzimin në rrugën e drejtë me dritën e Kur'anit.

Sa bukur e shpreh Kur'ani këtë dituri: **“Zoti yt i tha bletës”**.

A mund të ketë shprehje më të gjerë, më gjithëpërfshirëse e më absolute se kjo?!

Me aq sa thamë për bletën, në të vërtetë kemi përmendur fare pak gjëra, sepse programi i interpretimit (tefsirit) të Kur'anit nuk na e lejon të vazhdojmë më gjatë rreth kësaj çështjeje.¹

Mendojmë se është e mjaftueshme edhe kaq sa thamë për atë që mendon dhe ecën në rrugën e njohjes së madhësisë së All'Ilahut të Lartësuar, ashtu siç thotë ajeti i nderuar: **“edhe në këtë ka një argument për ata që mendojnë”**.

¹ Në studimin tonë për bletën dhe veçoritë e mjalit, jemi bazuar në disa libra, prej të cilave: “Ev'velu xhàiatin ue àkharu nebij'jin”, “En'nahlu”, autori Meterlink dhe në librin “Axhàibu àlemul hajejànàti”.

Ajetet 70 - 72

﴿وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ ثُمَّ يَتَوَفَّاكُمْ وَمِنْكُمْ مَنْ يُرَدُّ إِلَى أَرْدَلِ الْعُمْرِ لِكَيْ لَا يَعْلَمَ بَعْدَ عِلْمٍ شَيْئًا إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ قَدِيرٌ^{٧٠} وَاللَّهُ فَضَّلَ بَعْضَكُمْ عَلَى بَعْضٍ فِي الرِّزْقِ فَمَا الَّذِينَ فُضِّلُوا بِرَادِّي رِزْقِهِمْ عَلَى مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَهُمْ فِيهِ سَوَاءٌ أَفَبِنِعْمَةِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ^{٧١} وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَزْوَاجِكُمْ بَنِينَ وَحَفَدَةً وَرَزَقَكُمْ مِنَ الطَّيِّبَاتِ أَفِالْبَاطِلِ يُؤْمِنُونَ وَبِنِعْمَتِ اللَّهِ هُمْ يَكْفُرُونَ^{٧٢}﴾

“All’lillahu u krijoi, pastaj Ai ua merr shpirtin; prej jush ka që arrin në jetën më të vjetër, derisa nuk din asgjë nga ato që ka ditur; All’lillahu është i Gjithëdituri i Gjithëfuqishmi.”

“All’lillahu favorizoi disa prej jush mbi disa të tjerë në furnizim; atyre që u është dhënë favorizimi (në furnizim), ata nuk janë furnizues të atyre që i kanë në posedim (robërve); ata (të gjithë) në të janë të barabartë (furnizuesi kryesor është All’lillahu); a mos duan të mohojnë mirësinë e All’lillaut?”

“All’lillahu krijoi për ju bashkëshorte prej vetes suaj dhe prej bashkëshorteve tuaja. Ai bëri për ju fëmijë e nipa dhe u furnizoi

me (ushqime) të mira; qysh besojnë ata në të gabuarën dhe të mirat e All'Ilahut i mohojnë."

Komentimi

Shkaku i diferencimit në furnizim

Ajetet e mësipërme vërtetuan një pjesë prej mirësive Hyjnore të vëna në botën bimore dhe atë shtazore si argumente që ndihen me anë të shqisave për njohjen e All'Ilahut të Gjithëfuqishëm. Ndërsa ajetet që kemi si objekt studimi e çojnë çështjen e vërtetimit të Krijuesit të lartësuar me një mënyrë tjetër: me anë të rrugës së përmendjes së mirësive që janë jashtë për zgjedhjes së njeriut, e cila zbulon me pak hollësi ekzistencën e të Gjithëfuqishmit, Mirësisbërësit. Ajeti njofton: **"All'Ilahu u krijoi, pastaj Ai ua merr shpirtin."**

Edhe mosha e jetës suaj nuk është me për zgjedhjen tuaj, ka prej jush që vdesin në moshën e rinisë, të tjerë vdesin në moshën të pjekur, por ka edhe prej atyre që **"prej jush ka që arrin në moshën më të vjetër"**.¹

¹ Rrënja e fjalës së Kur'anit *"erdheli"* - më të vjetër, është *"redhele"*, në kuptimin: *e urryer, e padëshiruar*. Por, qëllimi me frazën e ajetit *"erdhelil umuri"* **"në jetën më të vjetër"** janë vitet shumë të përparuara të jetës të njeriut, moshë në të cilën shfaqen pafuqia e harresa, aq sa njeriu s'ka mundësi të sigurojë deri as nevojat e tij të dorës së parë. Për këtë arsye, Kur'ani Famëlartë e ka përmendur këtë moshë me togfjalëshin *"erdhelil umuri"*. Disa interpretues të Kur'anit kanë theksuar se kjo moshë fillon në moshën 75 vjeç, të tjerë 90 vjeç, të tjerë 95 vjeç, por në të vërtetë

Si rezultat i kësaj moshe: **“derisa nuk di asgjë nga ato që ka ditur”**.¹

Në këtë moshë, njeriu do të jetë ashtu siç ishte në moshën e foshnjërisë, i shkujdesur dhe në gjendje harrimi e moskuptimi të sendeve. Po, kështu është sepse: **“All’llahu është i Gjithëdituri i Gjithëfuqishmi.”**. Pra, të gjitha fuqitë janë në dorën e Tij dhe Ai i jep ata në përputhje me urtësinë e me interesin, gjithashtu edhe dënimi i Tij, patjetër do të jetë vetëm kur bëhet e domosdoshme.

Në ajetet vijuese, Kur’ani Famëlartë shpjegon se çështja e furnizimit me ushqim nuk është në dorën e njeriut, por: **“All’llahu favorizoi disa prej jush mbi disa të tjerë në furnizim.”**. Megjithëkëtë, të pasurit nuk e kanë gatishmërinë që prej këtij furnizimi t’u japin edhe robve që ata kanë në zotërim, ose që t’i bëjnë edhe ata pjesëtarë në këtë furnizim, sepse kanë frikë se mos bëhen të barabartë me robtë: **“ata (të gjithë) në të janë të barabartë (furnizuesi kryesor është All’llahu)”**.

Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë janë shprehur se ajeti i nderuar mund të theksojë disa punë të politeistëve, që i bënin për shkak të idiotizmit të tyre. Ata ndanin pjesë prej mishit të kafshëve të tyre dhe prej prodhimeve bujqësore që ata merrnin prej tokës për

kjo moshë nuk përcaktohet me vitet e jetës, pasi ajo ndryshon nga një individ te një tjetër.

¹ Me frazën e ajetit **“derisa nuk di asgjë nga ato që ka ditur”**, qëllimi mund të jetë se kjo gjendje bëhet e mundur në saje të viteve shumë të përparuara të jetës së njeriut. Kuptimi i frazës do të ishte: truri i njeriut dhe nervat e tij si rezultat i viteve të shumta e kanë humbur fuqinë e përqendrimit e të mbajtjes mend. Për rrjedhojë, njeriun e sundon harrimi e shkujdesja e plotë; gjithashtu, fraza mund të ketë kuptimin e sëmundjes, domethënë Allahu i Lartësuar e çon njeriun deri në këtë moshë, derisa ai të preket prej sklerozës. Kështu, njerëzit do të kuptojnë se në të vërtetë nuk zotërojnë asgjë prej vetes.

zotat e tyre idhuj që i kishin punuar me duart e veta, megjithëse gurët e drurët e gdhendur s'kishin asnjë efekt në jetën e tyre. Në atë kohë ishte shumë më mirë që ata të kthenin kokën te shërbëtorët e te robtë që kishin në zotërim dhe t'u jepnin atyre ndonjë shpërblim për shërbimet që u bënë ata natën e ditën!

A është drejtësi favorizimi në furnizim?

Pyetje: Këtu ballafaqohemi me një pyetje që shtrohet spontanisht: ekzistenca e mosbarazisë dhe e ndryshimeve në furnizimin në mes njerëzve, a është në harmoni me drejtësinë e All'llahut të Lartësuar dhe me barazinë në mes krijesave të Tij, drejtësi që duhet të jetë sunduese në sistemin e shoqërisë njerëzore?

Përgjigje: Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, më parë le të shikojmë dy vërejtjet vijuese:

1- Diferencimi që ekziston në mes njerëzve nga ana e të ardhurave materiale ka lidhje me diferencimin që vjen për shkak të përgatitjes dhe të mundësive që kanë njerëzit për të punuar, por që patjetër ndryshon nga një individ te një tjetër.

Ndryshueshmëria në përgatitjen fizike e shpirtërore sjell detyrimisht edhe ndryshim në sasinë e në cilësinë e efikasitetit ekonomik të individëve, çka çon në shtimin e të ardhurave për disa dhe në pakësimin e të ardhurave për disa të tjerë.

Padyshim që disa ngjarje lënë gjurmë në pasurimin e disa njerëzve, por nuk mund ta mbështesim studimin mbi këto, pasi ato në të vërtetë nuk janë më shumë se një përjashtim, ndërsa rregulla në shumicën e rasteve është ndryshueshmëria që ekziston në sasinë

e në cilësinë e punëve. (Vetëkuptohet që studimi ynë trajton shoqërinë e shëndoshë që është larg padrejtësisë e shfrytëzimit. Ne nuk kemi qëllim shoqëritë e devijuara, të cilat i kanë lënë më një anë ligjet e krijimit e të sistemit njerëzor dhe kanë rrëshqitur në rrugën e padrejtësisë e të shfrytëzimit).

Habitemi kur vërejmë se disa të humbur e pa asnjë përgatitje kanë një furnizim të madh. Por, kur zhvishemi prej gjykimit arbitrar të bazuar në dukuritë dhe depërtojmë në thellësi të veçorive dalluese fizike, shpirtërore dhe morale të disa individëve, do të gjejmë se ata disponojnë disa forca, të cilat i kanë çuar ata aty ku janë. (E përsërisim se studimi ynë bëhet në kuadrin e një shoqërie të shëndoshë, në të cilën s'ka shfrytëzim).

Në të gjitha gjendjet, ndryshueshmëria në mes të të ardhurave të individëve buron prej ndryshueshmërisë në përgatitje, e cila është prej dhuntive dhe prej mirësive Hyjnore, edhe pse disa prej këtyre mundësive janë të fituara, ndërsa pjesa tjetër jo. Pra rezulton se ekzistenca e ndryshueshmërisë në furnizimin e njerëzve nuk mund të mohohet nga ana ekonomike, madje plotësohet edhe brenda shoqërive të shëndosha. Me përjashtim të rasteve kur supozojmë se ekziston një grup individësh unikë nga ana e formës, ngjyrës e përgatitjes! Kur ne nuk e supozojmë këtë, ky është fillimi i problemeve dhe i vuajtjeve të rënda!

2- Nëse do të vërejmë trupin e njeriut, të gjithsecilit, ose një pemë apo një buqetë lulesh, a do të gjejmë barazi në mes të pjesëve të çdonjërës prej tyre?

Vallë forca, rezistenca e përgatitja e rrënjëve të pemës është e barabartë me fuqinë, rezistencën dhe elegancën e gjetheve të trëndafilut? A nuk është e ndryshme kocka e këmbës së njeriut prej rrjetës së syve të tij?

A është e drejtë që të gjitha këto t'i konsiderojmë një send i vetëm?!

Nëse heqim dorë prej parullave të rreme e të zbraza prej çdo kuptimi dhe supozojmë barazinë në mes njerëzve në të gjitha drejtimit, menjëherë do të mbushnim tokën me pesë miliard individë që kanë të njëjtën formë, të njëjtën shije e të njëjtin mendim, madje edhe të bashkuar në të gjitha sendet si një paketë cigaresh, a do të mundemi të garantojmë se jeta e këtyre do të jetë e mirë? Përgjigjja patjetër që do të jetë jo, të gjithë do të digjeshin në zjarrin e përngjasimit të tejskajshëm dhe në monotoninë e depresionit e të melankolisë, të gjithë do të lëviznin vetën në njërin drejtim, të gjithë do të synonin të njëjtin send, do të dëshironin të njëjtin ushqim dhe do të kishin dëshirë të bënë vetëm të njëjtën punë!

Vetëkuptohet se një jetë e tillë do të ndërpritej shumë shpejt dhe prej saj nuk do të mbetej asgjë; por edhe nëse supozojmë për këtë jetë vazhdimësinë, ajo do të jetë një jetë e mundimshme, e lodhshme, monotone, në të cilën do të humbë çdo shpirt i gjallë, ose thënë me një shprehje përgjithësuese, kjo shoqëri nuk mund të përjashtohet prej vdekjes në masë.

Bazuar mbi këto që u thanë, vetë urtësia e ekzistencës së ndryshueshmërisë në përgatitje e kërkon këtë ndryshueshmëri, të cilën e imponon ruajtja e sistemit shoqëror dhe që ndryshueshmëria në përgatitje të jetë shtytëse për edukimin e për rritjen e përgatitjeve

të ndryshme në të gjithë individët. Parullat e rreme s'kanë mundësi të qëndrojnë përballë kësaj të vërtete, pasi këtë të vërtetë e imponon gjithmonë realiteti objektiv.

Me këtë fjalë nuk duhet të kuptohet se ne duam një shoqëri klasore ose një regjim shfrytëzues e kolonialist, jo, kurrë e asnjëherë! Në të vërtetë, me kundërshtitë kemi qëllim ndryshueshmërinë natyrale në mes individëve (jo ndryshueshmërinë artificiale); nuk kemi qëllim shoqëritë ku njëri kafshon tjetrin, ose një shoqëri që është bërë një gur rrëshqitës në rrugën e përparimit të individëve, që bën thirrje për të tejkaluar masën në të gjitha veprimet dhe për të shkelur të drejtat.

Në të vërtetë, kontradikta klasore (këtu fjala klasa është kuptimi terminologjik i ekzistencës së një klase shfrytëzuese dhe të një klase të shfrytëzuar), sistem që kurrë e asnjëherë nuk është në harmoni me sistemin e krijimit, por të një sistemi që është në përputhje me rregullin e krijimit, sistem, i cili qëndron pikërisht në ndryshueshmërinë, në përgatitjet e në punën që bëhet; patjetër që dallimi në mes këtyre dy gjërave është aq i madh sa është dallimi në mes qiellit e tokës. (Mendo.)

Thënë ndryshe, ndryshueshmëria në përgatitjet duhet të jetë në shërbim të rrugës së ndërtimit, ashtu siç është ndryshueshmëria natyrale mes gjymtyrëve në vetë trupin e njeriut, ose mes pjesëve të lules. Këto krahas ndryshueshmërisë, në të vërtetë nuk janë në konkurrencë me njëra-tjetrën, por disa pjesë ndihmojnë të tjerat për të kryer të gjithë punën në mënyrën më të plotë.

Pra, kërkohet që ekzistenca e ndryshueshmërisë në përgatitjet dhe në të ardhurat ditore të individëve të mos jetë nxitëse për keqpërfitim dhe për formimin e një shoqërie klasore.¹

Pikërisht për të gjitha këto, në fundin e ajetit që kemi objekt studimi, Kur'ani Famëllartë thotë: **“a mos duan të mohojnë mirësinë e All'Ilahut”**.

Kjo frazë e ajetit thekson se ndryshueshmëria në gjendjen e saj natyrale (jo në gjendjen e padrejtësisë së sajuar) është prej mirësive Hyjnore, që All'Ilahu me mirësinë e Tij e ka vënë për të ruajtur sistemin e shoqërisë njerëzore.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi fillon me emrin e lartë **“All'Ilah”**, ashtu si edhe dy ajetet para këtij ajeti, për të na folur për mirësitë Hyjnore dhe krijimin e fuqisë njerëzore. Gjithashtu, për të na folur për furnizimet e mira, në plotësim të tri formave të mirësive të përmendura në fundin e të tri ajeteve, në të cilat studimi filloi me sistemin e jetës e të vdekjes, pastaj vijoi me furnizimet dhe përgatitjet, duke zbuluar një sistem të integruar (shumëllojshmërinë e jetës), për të përfunduar me ajetin e fundit të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, në të cilin shikojmë rregullin e shtimit të njerëzimit dhe të furnizimeve të mira. Ajeti thotë: **“All'Ilahu krijoi për ju bashkëshorte prej vetes suaj”**, që ato të jenë qetësi për trupat e për shpirtrat tuaj dhe shkak për vijimësinë e njerëzimit.

¹ Çështjen e filozofisë së ndryshueshmërisë në përgatitje dhe të përfitimeve që vijnë prej saj, e kemi trajtuar në mënyrë të hollësishme gjatë interpretimit të fundit të ajetit 32 të sures “En Nisà”. (Lexoje!)

Për këtë qëllim, ajeti thotë menjëherë: **“dhe prej bashkëshorteve tua, Ai bëri për ju fëmijë e nipa”**.

Fjala e ajetit *“hafedeten”* në origjinë është në kuptimin e njeriut që punon me shpejtësi e aktivitet pa pritur mendime e shpërblim. Ndërsa në këtë ajet, shumica e interpretuesve të Kur’anit Famëlartë janë shprehur se qëllimi me këtë fjalë është për fëmijët e fëmijëve; të tjerë interpretues kanë thënë se kjo fjalë përdoret veçanërisht për fëmijët femra dhe jo për fëmijët meshkuj.

Një pjesë tjetër e interpretuesve të Kur’anit Famëlartë besojnë se fjala e ajetit *“benijne”* përdoret për fëmijët e vegjël, kurse fjala *“hafedeten”* thuhet për fëmijët e rritur, të cilët kanë mundësi të ndihmojnë baballarët e tyre.

Interpretues të tjerë kanë thënë se kjo fjalë nënkupton çdo ndihmues, qofshin fëmijët e prindërve apo ndihmues të tjerë.¹

Duket që kuptimi i parë (fëmijët e fëmijëve) është më afër se kuptimet e tjera që u thanë, pavarësisht nga çfarë u tha në lidhje me gjerësinë e shtrirjes së kuptimit të fjalës *“hafedeten”* në origjinën e saj.

Pavarësisht nga gjendja, fuqia njerëzore ekziston te bijtë, te nipat e te gratë. Për njeriun këta janë prej mirësive të mëdha Hyjnore, me të cilat e ka pajisur Ai që ka Emrin më të Lartë, pasi

¹ Në këtë gjendje, sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe, fjala *“hafedeten”* - nipa - nuk duhet të ketë lidhje me fjalën *“benijne”* - fëmijë - por me fjalën *“ezvaxhen”* - bashkëshorte. Por kjo lidhje është në kundërshtim të hapur me lidhjen që bën ajeti mes kësaj fjale dhe fjalës *“benijne”*. (Mendohu!)

falë këtyre mirësive njeriu ndihmohet materialisht e moralisht në jetën e tij në këtë botë.

Në vijim ajeti vazhdon: **“dhe u furnizoi me (ushqime) të mira”**.

Edhe fjala e ajetit *“et’taj’jibàti”* - **“të mira”**, këtu ka kuptime të gjera, në mënyrë që përfshin të gjitha furnizimet e pastra dhe është e barabartë si me furnizimet materiale, ashtu edhe me ato morale, individuale ose shoqërore.

Pas kësaj paraqitje kur'anore të shenjave të fuqisë e të madhësisë së All'llahut sëbashku me mirësitë e shumta që All'llahu i Lartësuar ka derdhur mbi njerëzimin, jo pak njerëz falënderojnë e adhurojnë shtatoret e gdhendura prej tyre dhe lënë rrugën që i çon ata në adhurimin e madhësisë së të Vërtetit. Ajeti vijon: **“qysh besojnë ata në të gabuarën dhe të mirat e All'llahut i mohojnë?”**.

Sa i çuditshëm që është ky devijim i mbrapshtë i politeistëve! Në ç'gjendje ranë ata që të shkojnë te idhujt? Çudi e madhe me politeistët dhe mjerim i madh ngaqë i ka rrethuar shkujdesja e harresa për të falënderuar për këto mirësi vetëm All'llahun e Lartësuar. Është kjo shkujdesje e harresë që i çon ata deri aty sa të falënderojnë e të adhurojnë idhujt, megjithëse politeistët e dinë mirë që prej idhujve s'kanë ndonjë dëm e as ndonjë dobi!!!

Dy hulumtime

1- Shkaqet e furnizimit

Pavarësisht nga ato që u përmendën në lidhje me ndryshueshmërinë nga ana e përgatitjes dhe nga ana e dhuntive që u janë dhënë njerëzve, duhet theksuar se baza e suksesit qëndron në punën, në vazhdimin dhe në kryerjen e saj me seriozitet: sa më shumë punë, aq më shumë sukses në jetë, por edhe kundërta është plotësisht e vërtetë.

Pikërisht për këtë, Kur'ani Famëllartë ka bërë lidhjen mes asaj që arrin njeriu dhe punës së tij. Me qartësinë më të madhe thotë: **“Njeriut nuk i takon asgjë tjetër përveç asaj që ka punuar.”**. (sure “En Nexhm”, ajeti 39.)

Prej punëve që kanë ndikim të rëndësishëm në çështjen e arritjes së furnizimit, është zbatimi i parimeve të devotshmërisë, besnikërisë, bindjes ndaj ligjeve hyjnore, zbatimi i bazave të drejtësisë, ashtu siç theksohet në ajetin 96 të sures “El Aràf”: **“Sikur banorët e këtyre vendeve të kishin besuar dhe të ishin të ruajtur (prej mëkateve) Ne do të hapnim për ata begati prej qiellit e prej tokës.”**.

Gjithashtu edhe ajetet 2 dhe 3 të sures “Et Talàk” flasin për efektin e shpenzimit në shtimin e furnizimit: **“Dhe kush punon sipas dispozitave të All'Ilahut, Ai bën për atë një rrugëdalje dhe e furnizon atë andej nga ai nuk e llogarit.”**.

Edhe ajeti 17 i sures “Et Tegàbun” flet për efektin e shpenzimit në shtimin e furnizimit: **“Nëse i huazoni All’llahut (shpenzoni për hir të All’llahut) diçka të mirë, Ai ua shumëfishon atë.”**.

Nuk është e nevojshme të përmendim se humbja e një njeriu ose e një grupi njerëzish, patjetër që dëmton gjithë shoqërinë, prandaj ruajtja e individëve dhe ndihma që u jepet atyre rikthehet me dobi për të gjithë njerëzit (pa përmendur anët humanitare e shpirtërore të kësaj dhënieje).

Pra, kur ekonomia e shoqërisë ndërtohet mbi bazën e ruajtjes prej mëkateve, mbi bazën e përmirësimit, e ndihmës së ndërsjellë dhe e shpenzimit për hir të All’llahut, rezultati është se do të jetë një shoqëri e fuqishme dhe ballëlartë. Por, kur ekonomia ndërtohet mbi bazën e shfrytëzimit, e despotizmit, e padrejtësisë, e dhunës dhe e moskujdesit për njerëzit, patjetër që një shoqëri e këtillë do të jetë ekonomikisht e prapambetur, ku lidhjet e jetës shoqërore do të zhduken dalë-ngadalë.

Kjo është edhe arsyeja pse hadithet e transmetimet i kushtojnë një rëndësi të veçantë punës në kërkim të furnizimit të shoqëruar me ruajtjen prej mëkateve. Transmetohet prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) se ai ka thënë: “Mos përtoni në kërkim të mjeteve të jetesës suaj, pasi prindërit tanë punuan me ngulm në kërkim të mjeteve të jetesës!”¹

¹ “El Uesàil”, vëll. 12, f. 38.

Gjithashtu prej tij transmetohet se ai ka thënë: “Ai që punon për të ushqyer njerëzit që ka në ngarkim, është si ai që lufton në rrugën e All’llahut!”¹

Madje Imami i kishte urdhëruar njerëzit e tij të thoshin “All’llahu Ekber” kur dilnin në kërkim të furnizimit.² Gjithashtu, ai i këshillonte njerëzit se atyre që nuk u pranohet lutja, janë pikërisht ata që e kanë lënë punën në kërkim të furnizimit, megjithëse i kanë mundësitë për të punuar, por në vend që dalin për punë, futen në ndonjë qoshe të shtëpive të tyre dhe aty i luten All’llahut të sigurojë furnizim edhe për ata!

Pyetje: Mund të lindë një pyetje e shkaktuar prej ajeteve të Kur’anit e prej transmetimeve që theksojnë se furnizimi është në dorën e All’llahut, por ata flasin edhe për garancinë që ka puna në furnizimin. Si mund të shpjegohet kjo pyetje?!

Përgjigje: Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje do të kujtojmë dy vërejtjet e mëposhtme:

1- Përqendrimi dhe verifikimi në burimet islame shpjegon qartë se ajetet dhe transmetimet të cilat, qoftë për këtë çështje, qoftë për çështje të tjera tregojnë për një rezultat të nxjerrë pas një shikimi të thjeshtë e të sipërfaqshëm. Në të vërtetë, ato e trajtojnë këtë çështje në atë mënyrë që përfshin të gjitha anët e saj; çdo ajet ose transmetim në të vërtetë trajton vetëm një aspekt të përcaktuar dhe atij që nuk i ndjek këto ajete e transmetime në tërësinë e tyre, i krijohet iluzioni se në to ka kontradiktë.

¹ Burimi i mësipërm, f. 43.

² Burimi i mësipërm, f. 50.

Aty ku njerëzit punojnë me pasion e me kujdes për këtë botë dhe me qëllim që të zbukurojnë jetën materiale, bëjnë çdo punë të urryer për të arritur qëllimin që kanë, prandaj ajetet dhe transmetimet shpjegojnë qartë banalitetin e kësaj bote dhe parëndësinë e pasurisë.

Kur njerëzit lënë punën në kërkim të furnizimit me argumentin e përkohshmërisë, ajetet dhe transmetimet e ardhura u shpjegojnë atyre me qartësi të plotë rëndësinë e madhe dhe domosdoshmërinë e punës në kërkim të furnizimit.

Komandant i suksesshëm dhe udhërrëfyes i drejtë është ai që ka fuqi të ndalojë në shoqërinë e tij dy gjendje: tejkalimin e masës dhe punën e mangët në kryerjen e detyrave.

Qëllimi i ajeteve dhe i transmetimeve që theksojnë se furnizimi është në dorën e All'llahut, në asnjë rast nuk do të thotë që ne të mbyllim portat e kujdesit për të punuar, ose të kërkojmë plotësimin e dëshirave jashtë mundësive, ose të stimulojmë dashuri të madhe për këtë botë apo të nxisim punë pa rregulla ligjore. Nga ana tjetër, ajetet e transmetimet nuk kanë qëllim të shuajnë shkëndijën e jetës e të aktivitetit në punë për të arritur një jetesë të ndershme e të pavarur.

Me këtë bëhet i qartë interpretimi i ajeteve dhe i transmetimeve që tregojnë se: “nëse ju nuk i kërkonit shumë prej furnizimeve, atëherë ato do t’ju kërkojnë juve”.

2- Nga ana e besimit, të gjitha sendet janë të varura tek All'llahu i Lartësuar. Çdo monoteist (muveh'hid) i vërtetë beson se burimi dhe origjina e çdo sendi është prej Fuqiploetit, është prej Atij që nuk i mungon asgjë e që s'ka nevojë për asnjë send dhe përsërit

atë që thuhet në ajetin 26 të sures “Àli Imrà”: **“Në dorën Tënde është e mira, me të vërtetë Ti ke mundësi për çdo gjë.”**.

Në të njëjtën kohë nuk duhet të rrëmbehemi nga shkujdesja dhe të themi se çdo gjë vjen vetëm prej punës, aktivitetit, mendimit e nismës krijuese të njeriut, pasi në të vërtetë çdo gjë është vetëm prej All’Ilahut të Lartësuar.

Le të supozojnë se për një çast të vetëm se u ndalua dashamirësia e All’Ilahut ndaj njeriut, shumë shpejt prej emrit njeri nuk do të mbetej asgjë.

Njeriu që beson në Zotin Një e të Vetëm edhe kur hipën mbi një mjet thotë: “I plotpushtetshëm është vetëm Ai që e vuri këtë në dispozicionin tonë”.

Kur ai arrin ndonjëherë prej mirësive, thotë: “Çdo mirësi që e kemi, është vetëm prej Teje”.¹

Kur njeriu bën hapa përpara në rrugën e përmirësimit, ashtu siç është edhe rruga e Profetëve në kumtimin e Mesazhit me të cilin ata erdhën për të udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë, ajeti thotë: **“Vetëm tek Ai jam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam drejtuar.”**. (sure “Hùd”, ajeti 88.)

Përveç kësaj, të gjitha sa janë thënë mund të përmbliidhen në atë që puna e mirë pa teprime e pa u lënë mangët është baza për fitimin e furnizimit dhe, çdo rrugë që e çon furnizimin te njeriu pa punë, në të vërtetë ai furnizim është dytësor, është degëzim, nuk është furnizim kryesor. Mbase, kjo çështje e ka shtyrë Prijësin e Besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) të përmendë kërkimin e furnizimit dhe ta paraqesë këtë furnizim me fjalët e tij të shkurtra:

¹ Prej lutjeve që këndohen në përfundim të namazit të pasdites, ashtu siç thuhet në librin e lutjeve (duàve).

“O njeri, furnizimi është dy llojesh: furnizim të cilin e kërkon njeriu dhe furnizim që e kërkon njeriun”.¹

2- Dashamirësia ndaj të tjerëve

Ajetet e Kur'anit Famëlartë e theksojnë shumë koprracinë e atyre njerëzve që nuk ndjekin sjelljen dhe edukatën e Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) dhe të Imamëve të ruajtur prej mëkateve. Gjithashtu, edhe transmetimet e ardhura në interpretimin e këtyre ajeteve flasin qartë për barazinë dhe për dashamirësinë. Prej këtyre transmetimeve përmendnin komentim e bërë prej Ali bin Ibrahimit në fundin e ajetit: “Burrit nuk i lejohet të ndajë për vete ndonjë gjë që hahet dhe të mos i japë prej asaj njerëzve të familjes që ka në ngarkim”.²

Gjithashtu transmetohet prej Ebù Dherr'rrit se ai ka dëgjuar të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të thotë në lidhje me robërit: “Ata janë vëllezërit tuaj, prandaj vishini me rrobat që vishni ju vetë dhe jepuni të hanë prej atyre gjërave që hani edhe ju”. Pas kësaj fjale nuk shikohej ndonjë rob që të mos kishte veshjen e poshtme e të sipërme si të pronarit të tij pa asnjë ndryshim.³

Në disa transmetime dhe ajeti që kemi objekt studimi thuhet **“ata (të gjithë) në të janë të barabartë”**, dhe prej tyre mësojmë se Islami urdhëron përkujdesjen e dashamirësinë si program morali

¹ “Nehxhul Belàgah”, Fjalët e shkurtra, fjala nr. 279.

² Tefsiri “Nùruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 147.

³ Burimi i mësipërm, f. 148.

në mesin e pjesëtarëve të familjes me sa është mundësia, si dhe për ata që janë nën kujdestarinë e tyre dhe të mos i njohin vetes së tyre ndonjë privilegj mbi ata.

Ajetet 73 – 74

﴿وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَمْلِكُ لَهُمْ رِزْقًا مِنَ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ شَيْئًا وَلَا يَسْتَطِيعُونَ^{v3} فَلَا تَضْرِبُوا لِلَّهِ الْأَمْثَالَ إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ
وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ^{v4}﴾

“Ata nuk adhurojnë All’llahun, por adhurojnë ato që s’kanë fuqi të sjellin për ata asnjë furnizim prej qiejve e prej tokës dhe as që kanë mundësi.”

“Mos sillni shembuj për All’llahun, All’llahu i di të gjitha dhe ju nuk dini.”

Komentimi

Mos i bëni All’llahut të ngjashëm

Këto dy ajete vijojnë studimin e çështjes së Njësimit të All’llahut, ashtu siç bënë edhe ajetet e mëparshme, duke theksuar edhe çështjen e idhujtarisë (shirkut). Me një gjuhë të ashpër, të mbushur më qortim, ajeti thotë: **“Ata nuk adhurojnë All’llahun, por adhurojnë ato që s’kanë fuqi të sjellin për ata asnjë furnizim prej qiejve e prej tokës.”**

Jo vetëm që s'kanë fuqi, por **"dhe as që kanë mundësi"** të krijojnë ndonjë send.

Ky është një sinjalizim që u bëhet politeistëve, të cilëve u thuhet qartë: "Për ju s'ka asnjë shpresë prej adhurimit që u bëni idhujve, sepse ata as nuk sjellin ndonjë dëm mbi ju e as nuk sjellin ndonjë dobi për ju. Gjithashtu, idhujt s'kanë asnjë efekt mbi të ardhmen tuaj". Le të marrim për shembull furnizimin me të cilin lëviz rrota e jetës, që është e barabartë si me furnizimin që vjen prej qiellit (si pikat e shiut, rrezet e diellit etj...), ashtu edhe me atë që nxirret prej tokës. Në të vërtetë, ky furnizim është jashtë përzgjedhjes së idhujve, sepse ata janë trupa që s'kanë asnjë vlerë dhe nuk zotërojnë vullnet. Për më tepër, idhujt s'janë gjë tjetër veçse mite të krijuara prej fanatizmit të inorancës.

Togfjalëshi foljor *"ue là jestetij'ùne"* - **"dhe as që kanë mundësi"**, është shkak për foljen *"là jemliku"* - **"dhe as që kanë fuqi"**, do të thotë se idhujt nuk zotërojnë asgjë prej furnizimeve, sepse ata s'kanë as mundësi për të sjellë furnizim për adhuruesit e tyre. Atëherë si është e mundur që ata të krijojnë?!

Në vijim, si rezultat i asaj që u shpjegua në ajetin e mësipërm, ajeti pasardhës thotë: **"Mos sillni shembuj për All'Ilahun"**, sepse **"All'Ilahu i di të gjitha dhe ju nuk dini"**.

Disa interpretues të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se fraza e ajetit **"All'Ilahu i di të gjitha dhe ju nuk dini"**, thekson logjikën e politeistëve të kohës së inorancës para Islamit (megjithëse edhe koha e sotme nuk është pa politeistë të ngjashëm me ata të mëparshmit), që thoshin se ne i adhurojmë idhujt ngaqë s'kemi aftësinë të adhurojmë All'Ilahun ose ne i adhurojmë idhujt që ato të

na afrojnë tek All'Ilahu! Në logjikën e atyre politeistëve, All'Ilahu ishte si një mbret i madh tek i cili nuk afroheshin dot as ministrat e tij të veçantë, prandaj njerëzit e thjeshtë u afroheshin atyre që rrinin përqark mbretit, që të arrinin të ishin në shërbim të All'Ilahut!

Ky devijim i tejskajshëm në orientim e në mendim që herë-herë mund të konkretizohet në mënyrën e shembujve të deformuar, në të vërtetë është prej rreziqeve të atilla që mbulon të gjitha devijimet ideologjike.

Pikërisht për këtë arsye, Kur'ani Famëllartë u përgjigjet politeistëve duke u thënë: **“Mos sillni shembuj për All'Ilahun”**, sepse shembujt që sillni janë prej mendjeve tuaja të kufizuara dhe prej sendeve që ekzistojnë, prandaj janë plot me të meta e mangësi.

Sikur ju të kishit dijeni për madhësitë dhe ekzistencën e të Lartit, për mëshirën e për dashamirësinë e Tij, patjetër që do të mësonit se Ai është afër jush, madje është më afër se vetja juaj. Nëse me të vërtetë do ta mësonit këtë, ju kurrë nuk do të kërkonit të keni ndërmjetës mes jush e të Gjithëpushtetshmit.

All'Ilahu u bën thirrje njerëzve t'i luten vetëm Atij sheshit e në vetmi, pasi Ai në çdo kohë i ka të hapura portat e pranimit të lutjes. Prandaj, në asnjë rast nuk duhet ta krahasoni Atë me një tiran mendjemadh, tek i cili askush s'ka mundësi të arrijë dhe të futet në pallatin e tij, përveç disa të besuarve të veçantë. Ajeti urdhëron: **“Mos sillni shembuj për All'Ilahun”**.

Në studimet tona të mësipërme, kur trajtuam cilësitë e larta të All'Ilahut, kemi theksuar se rrëshqitja në përngjasimin e All'Ilahut me shembuj, konsiderohet prej shkarjeve më të rrezikshme në rrugën e njohjes së cilësive të larta të All'Ilahut. Për

këtë arsye nuk duhet që cilësitë e të Gjithëpushtetshmit të maten me metrin e cilësive të njerëzve, sepse Filluesi i të gjitha sendeve, madhështia e Tij u shenjtëroftë, ekziston në mënyrë absolute, kurse të gjitha qeniet e tjera janë të kufizuara e të kushtëzuara, ndër të cilat edhe njeriu. Prandaj, si është e mundur që Absoluti të krahasohet me të kufizuarin?! Ajeti urdhëron: **“Mos sillni shembuj për All’llahun”**.

Kur ne detyrohemi të krahasojmë qenien e Tij të Shenjtë me dritën ose me diçka të ngjashme me të, patjetër që e dimë mirë se ky krahasim është tepër i mangët në të gjitha gjendjet. Gjithashtu e dimë mirë se ky krahasim vërteton vetëm njërën anë të ndonjë cilësie të Tij dhe nuk vërteton anët e tjera. (Prandaj mendo!)

Meqenëse shumica e njerëzve janë të shkujdesur ndaj kësaj të vërtete, shumë të tjerë bien në luginën e krahasimit të gabuar e të matjes së papranueshme dhe kështu vetëlargohen prej të vërtetës së Njësimi (Teuhidit - All’llahu është Zoti Një e i Vetëm). Shpeshherë shikojmë se Kur’ani Famëlartë e vë theksin mbi këtë çështje; herë shprehet ashtu siç ka ardhur në ajetin 4 të sures “El Ikhlàs”, ose siç është quajtur “sureja e Teuhidit”: **“Asgjë nuk është i ngjashëm me Atë”**; herë tjetër, Kur’ani shprehet në lidhje me krahasimin ashtu siç ka ardhur në ajetin 11 të sures “Esh Shùrà”: **“asnjë send nuk është si Ai”**, ose mossjelljen e shembujve për All’llahun e shpreh ashtu siç ka ardhur në ajetin tonë të cilin e kemi objekt studimi: **“Mos sillni shembuj për All’llahun”**.

Mbase edhe fraza: **“All’llahu i di të gjitha dhe ju nuk dini”**, thekson se shumica e njerëzve janë krejtësisht të shkujdesur ndaj cilësive të larta të All’llahut.

Ajetet 75 - 77

﴿ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا عَبْدًا مَمْلُوكًا لَا يَقْدِرُ عَلَى شَيْءٍ وَمَنْ رَزَقْنَاهُ مِنَّا
رِزْقًا حَسَنًا فَهُوَ يُنْفِقُ مِنْهُ سِرًّا وَجَهْرًا هَلْ يَسْتَوُونَ الْحَمْدُ لِلَّهِ بَلْ
أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ۝ وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا رَجُلَيْنِ أَحَدُهُمَا أَبْكَمُ لَا
يَقْدِرُ عَلَى شَيْءٍ وَهُوَ كَلٌّ عَلَى مَوْلَاهُ أَيْنَمَا يُوَجِّههُ لَا يَأْتِ بِخَيْرٍ هَلْ
يَسْتَوِي هُوَ وَمَنْ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَهُوَ عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ۝ وَلِلَّهِ غَيْبُ
السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا أَمْرُ السَّاعَةِ إِلَّا كَلَمْحِ الْبَصَرِ أَوْ هُوَ أَقْرَبُ إِنَّ
اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝﴾

“All’lillahu sjell shembull një rob që është pronë e një tjetri dhe që s’ka në dorë asgjë, si dhe atë që Ne e kemi furnizuar me një furnizim të mirë dhe ai jep prej atij (furnizimi) fshehtas e sheshit, a janë të barabartë ata të dy? Falënderimi i takon vetëm All’lilahun, por shumica e tyre nuk e dinë.”

“All’lillahu sjell shembull dy burra, njëri prej atyre të dyve është memec dhe s’ka fuqi për asgjë, madje është barrë për kujdestarin e tij, i cili ngado që ta drejtojë, ai nuk sjell ndonjë dobi; a është ai i barabartë me atë që udhëzon për drejtësi dhe është vetë në rrugën e drejtë?”

“Vetëm All’llahut i takon (ka dijeni) e fshehta e qiejve dhe e tokës; puna e orës (së fundit) është (e shpejtë) sa të hedhësh një shikim, ose edhe më afër; All’llahu është i Gjithëfuqishëm për çdo send.”

Komentimi

Dy shembuj, për besimtarin dhe për mohuesin:

Ajetet e mësipërme bënë fjalë për besimin, mohimin, besimtarët, mohuesit dhe politeistët (mushrikët), ndërsa ajetet që janë objekt i studimit tonë flasin për gjendjen e të dyja grupeve (besimtarëve e mohuesve), duke sjellë dy shembuj të gjallë e të qartë.

Shembulli i parë i krahason politeistët me një rob që s’ka fuqi të bëjë asnjë shërbim për pronarin e tij, kurse për besimtarët sjell shembull një njeri të pasur, prej mundësive të të cilit përfitojnë të gjithë: **“All’llahu sjell shembull një rob që është pronë e një tjetri dhe që s’ka në dorë asgjë”**.

Robi s’ka fuqi të bëjë asgjë, sepse ai është i tëri në dorën e pronarit të tij dhe është në gjendje kufizimi në çdo send; ai s’ka fuqi ligjore, sepse e drejta për të vepruar me pasurinë e tij (nëse ka pasuri) - çdo send që ka lidhje me robin, vetë robi dhe të gjitha sa mund të ketë robi - të gjitha janë në dorën e pronarit të tij. Me fjalë tjetra ai është rob, është pronë për një të krijuar dhe kjo nuk do të thotë asgjë më shumë se robëri dhe kufizim në çdo send.

Përkundrejt këtij është vënë njeriu besimtar që ka disa lloje cilësish, si dhe një furnizim të mirë: **“si dhe atë që Ne e kemi furnizuar me një furnizim të mirë”**. Njeriu i lirë, për mundësitë e mëdha që ai ka **“dhe ai jep prej atij (furnizimi) fshehtas e sheshit”**, prandaj mendoni: **“a janë të barabartë ata të dy”**.

Në asnjë mënyrë jo! Atëherë **“Falënderimi i takon vetëm All'llahut”**, i Cili e krijon robin e Vet njeri të lirë, të fuqishëm dhe që shpenzon, kurse idhujt formojnë ndër adhuruesit e vet robër të pafuqishëm dhe me mundësi të kufizuara: **“por shumica e tyre nuk e dinë”**.¹

Pastaj, All'llahu sjell një shembull tjetër për adhuruesit e idhujve dhe për besimtarët e vërtetë: adhuruesin e idhujve e krahason me një memec, i cili s'ka fuqi të bëjë asgjë, kurse besimtarin e sinqertë e krahason me një njeri të lirë, i cili jo vetëm që urdhëron drejtësi, por edhe vetë është në rrugën e drejtë: **“All'llahu sjell shembull dy burra, njëri prej atyre të dyve është memec dhe s'ka fuqi për asgjë, madje është barrë për kujdestarin e tij”**² prandaj: **“i cili ngado që ta drejtojë, ai nuk sjell ndonjë dobi”**.

¹ Shembulli i përmendur është një model i shëmbëllimit për besimtarin dhe për mohuesin (sipas dritës së komentit tonë), megjithëse një grup interpretuesish të Kur'anit Famëlartë janë shprehur se robi që është në pronësi shpreh idhujt, kurse besimtari i lirë dhe që shpenzon, është shenjë treguese për Allahun e Lartësuar (neve na duket se ky interpretim është shumë larg realitetit të fjalës së ajetit).

² Ràgipi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit thotë se fjala e ajetit *“ebkemu”* - memec – është i linduri memec, prandaj çdo memec është lindur i tillë, por jo çdo i lindur që belbëzon është memec. Kur thuhet se ai nuk flet dot, kjo fjalë thuhet kur ai është bërë i pafuqishëm të flasë për shkak të dobësisë mendore, për rrjedhojë është bërë memec.

Bazuar mbi këtë shpjegim të ajetit, ai ka katër cilësi negative:

a- është memec (nuk flet, nuk dëgjon që kur ka lindur);

b- s'ka fuqi të bëjë asgjë;

c- është barrë për kujdestarin e tij;

d- ngado që ai e drejton, ai nuk sjell asnjë të mirë.

Cilësitë negative të përmendura flasin qartë jo vetëm për lidhjen sëmundje -i sëmurë, por ato përshkruajnë edhe figurën e një njeriu qind për qind negativ, në atë mënyrë që nga ekzistenca e tij nuk vjen asnjë e mirë apo begati. Akoma më tepër, ai është barrë jo vetëm për familjen e tij, por edhe për të gjithë shoqërinë.

Prandaj: **“a është ai i barabartë me atë që udhëzon për drejtësi dhe është vetë në rrugën e drejtë”**.

Ky burrë në shembullin e ajetit është njeri që vazhdimisht bën thirrje për drejtësi dhe vetë ecën në rrugën e drejtë. Këto dy cilësi janë vetëm çelësi për cilësitë e tjera pozitive. Mbartësi i këtyre dy cilësive: gjuha e tij flet, logjika e tij është urtësi, ka vullnet të fuqishëm, është trim e i sjellshëm, sepse e ka të pamundur të përfytyrojë atë që bën thirrje për drejtësi të jetë memec, i çmendur e i pafuqishëm, njeri që s'ka mundësi të jetë në rrugën e drejtë, njeri të mangët, të pafuqishëm dhe mendjelehtë. Në të kundërt, thirrësi për drejtësi patjetër duhet të jetë i mençur, i zgjuar, i vëmendshëm, i urtë e i qëndrueshëm.

Dallimi në mes këtyre dy burrave del fare qartë: është shumë i gjerë ndërmjet anëve të dy mendimeve të ndryshme. Nga njëra anë qëndrojnë adhuruesit e idhujve dhe nga ana tjetër qëndrojnë

adhuruesit e All'llahut të Lartësuar, prandaj edhe dallimi edukativ e doktrinar mes dy grupeve është fare i qartë.

Ne pamë edhe lidhjen që bën Kur'ani Famëlartë në studimet e tij në mes Njësimit (Teuhidit) me luftimin e idhujtarisë, Ringjalljen dhe gjykatën e madhe të Ditës së Kiametit. Në këto lidhje shikojmë të trajtohet përgjigjja ndaj paradokseve të politeistëve për Ringjalljen dhe u thotë atyre: **“Vetëm All'llahut i takon (ka dijeni) e fshehta e qiejve dhe e tokës.”**.

Duket sikur ajeti i jep përgjigje paradoksit që nuk u hiqej nga mendjet e nga gjuhët atyre që mohonin Ringjalljen trupore dhe thoshin: “Kur ne të vdesim dhe trupat tanë të bëhen një me grimcat e dheut, cili është ai që ka fuqi të mbledhë këto grimca?! Edhe sikur të supozojmë se këto grimca u mbloodhën dhe ne u rikthyem në jetë, cili është ai që do të ketë dijeni për punët tona, të cilat i ka mbuluar harresa dhe që ne të japim llogari për ato punë?”

Me pak fjalë, ajeti i jep përgjigje pyetjes së mohuesve në të gjitha aspektet dhe u thotë qartë se All'llahu i Lartësuar **“di të fshehtën e qiejve e të tokës”**, se Ai është i pranishëm në çdo kohë e në çdo vend dhe i Larti e di se si është çdo send. Por të këtilla shprehje që paraqesin gjendje të njerëzve, janë të përshtatshme vetëm për ekzistencën tonë të cunguar dhe jo për dikë tjetër.

Në vijim ajeti shton: **“puna e orës (së fundit) është (e shpejtë) sa të hedhësh një shikim, ose edhe më afër”**.¹

¹ Fjala e ajetit *“lemlh”* është në kuptimin e vezullimit të shkrepitjes dhe më pas ka ardhur në kuptimin e shikimit të shpejtë. Gjithashtu duhet tërhequr vëmendja se lidhësja *“ose”*, këtu ka ardhur në kuptimin e parafjalës *“por”*.

Kjo frazë e ajetit të Kur'ânit i jep përgjigje një paradoksi tjetër që shtronin mohuesit e Ringjalljes kur thoshin: “Cili ka fuqi të Ringjallë dhe që mund të realizojë këtë punë kaq të vështirë?!

Kur'âni Famëlartë u përgjigjet atyre: “Puna e Ringjalljes për ju duket shumë e vështirë sepse ju vetë jeni të pafuqishëm, kurse për Zotëruesin e fuqisë absolute, puna e Ringjalljes është prej punëve shumë të thjeshta e të shpejta, madje edhe më e shpejtë nga sa ju mund ta përfytyroni, pasi ajo punë është: **‘sa të hedhësh një shikim’**, ashtu si bëni ju”.

Pasi e krahasoi shpejtësinë e ndodhjes së Kiametit me hedhjen e një shikimi, ajeti thotë: **“ose edhe më afër”**. Kjo do të thotë: krahasimi me hedhjen e shikimit ka ardhur për shkak se fraza e Kur'ânit nuk mund të imitohet, si dhe për shkak të rregullave të gjuhës arabe, pasi në të vërtetë Kiameti do të ndodhë më shpejt, madje aq shpejt sa nuk mund të ketë bazë, as të konstatohet në kohë. Patjetër që ky përshkrim është vetëm për të afruar në mendjet tuaja konceptin e shpejtësisë me të cilën do të ndodhë Kiameti, pasi hedhja e shikimit, në logjikën tuaj është koha më e shkurtër.

Sido që të jetë, të dyja shprehjet janë shenjë e gjallë për fuqinë absolute të All'Ilahut të Lartësuar në lidhje me çështjet e Ringjalljes e të ndodhjes së Kiametit. Për këtë, Filluesi i të gjitha sendeve thotë në fundin e ajetit: **“All'Ilahu është i Gjithëfuqishëm për çdo send”**.

Hulumtime

1- Njeriu ndërmjet lirisë dhe robërisë

Çështja e Njësimit (Teuhidit) dhe e politeizmit (shirkut) nuk është thjesht çështje doktrinare apo mendësie, ashtu siç pandehin disa. Në të vërtetë, çështja e Njësimit ka gjurmë të rëndësishme në të gjitha fushat e jetës, gjurmët e këtij besimi patjetër i shikon të fiksuara në të gjitha kthesat e anët e jetës. Kur Njësimi (*besimi i plotë se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm*) hyn në zemër, ky besim e gjallëron zemrën dhe mbjell në të elementet e udhëzimit në rrugën e drejtë, elementet e plotësimit, sepse Njësimi zgjeron horizontin e shikimit e të mendimit të njeriut në atë mënyrë që e bën atë të lidhur me Absolutin.

Kurse politeizmi (shirku) është plotësisht e kundërta. Politeizmi e bën njeriun të jetojë në qerthullin e një jete të kufizuar; qenien e tij e përplasin sa andej-këndej ato idhujt prej guri ose prej druri, ose prirjet dhe pasionet e dobëta e të pafuqishme të idhujve njerëzorë. Për rrjedhojë, mendimi, konceptet, fuqia dhe puna e njeriut mbyllet në rrethin e atyre dimensioneve të ngushta e kontradiktore.

Këtë fakt, ajetet e Kur'anit e kanë përshkruar me imtësi dhe e kanë mbledhur në një shembull të kapshëm për mendjet, kur thonë: në të vërtetë, politeisti (adhuruesi i idhujve) është memec, praktika e tij tregon mosorientim të mendimit të tij dhe se ai e ka humbur logjikën e shëndoshë. Adhurimi i idhujve i ka lidhur atij të gjitha mundësitë dhe e lë atë të zbrazur deri në atë shkallë, sa që ai

s'ka fuqi të bëjë asgjë, i ka hequr atij lirinë pasi ai e dorëzoi veten rob në dorën e miteve dhe iluzioneve.

Për shkak të këtyre cilësive të ulëta, ai bëhet barrë mbi shoqërinë, sepse e poshtëroi nderin e dinjitetin e saj që në çastin kur la drejtimin e jetës së tij në dorën e idhujve e kolonialistëve.

Politeisti bëhet gjithmonë ndjekës i të tjerëve dhe, derisa nuk është çliruar prej lakut të adhurimit të idhujve, nuk do të shijojë kurrë lirinë e pavarësinë e vërtetë, përveçse kur të orientohet në besimin e plotë e të sinqertë se All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid).

Si rezultat i koncepteve të tij doktrinare të gabuara, adhuruesi i idhujve gjithmonë do të ecë në rrugën e humbjes dhe kurrë nuk do të gjejë të mirën ngado që të drejtohet: **“i cili ngado që ta drejtojë, ai nuk sjell ndonjë dobi”**.

Sa distancë të madhe ka mes këtij ndjekësi e adhuruesi të miteve, me horizont të ngushtë, rob i miteve e i pafuqishëm dhe njeriut të lirë e trim, i cili jo vetëm që ndjek rrugën e drejtësisë, por u bën thirrje të gjithë njerëzve për drejtësi?!

Individi që zotëron mendim logjik dhe që është në harmoni me sistemin e besimit në All'Ilahun, Zotin Një e të Vetëm, me këtë sistem sundues në të gjitha krijesat, është gjithmonë në rrugën e drejtë. Është kjo ecje e tij në këtë rrugë që do ta çojë atë sa më shpejt e sa më afër synimit që i ka vënë vetes, pa i konsumuar furnizimet e trupit të tij në rrugën e humbjes e të rrugës së devijuar.

Me pak fjalë, Njësimi (Teuhidi) dhe adhurimi i idhujve (shirku) nuk janë vetëm punë besimi, po është një sistem i plotë për

të gjithë jetën, është një program i gjerë që përfshin mendimin, moralin dhe ndjenjat e njeriut. Gjithashtu trajton edhe jetën individuale, shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore të njeriut.

Sikur të bëjmë një krahasim në mes arabëve idhujtarë të kohës së injorancës para Islamit dhe myslimanëve në fillimet e Islamit, patjetër do të gjemë një dallim shumë të qartë në mes dy grupeve.

Ata që ishin në injorancë, të copëzuar mes tyre e të degraduar, nuk njihnin gjë tjetër përveç një mjedisi të kufizuar e të mbushur me varfëri e degjenerim, u bënë që të gjithë një unitet, u bënë dituri e kapacitet, aq sa edhe bota e qytetëruar e asaj kohe ra nën ndikimin e fuqisë së tyre. Të gjitha këto për shkak se ata ndryshuan drejtimin e rrugës së jetës së tyre, hoqën dorë prej adhurimit të idhujve dhe kaluan në rrugën e adhurimit të All'llahut, Zotit Një e të Vetëm.

2- Roli i drejtësisë dhe i rrugës së drejtë në jetën e njeriut

Të tërheq vëmendjen fakti se ajetet që janë objekt studimi, ndër të gjitha cilësitë e atyre që besojnë se vetëm All'llahu është Zoti Një e i Vetëm, e vënë theksin te cilësitë që ata shfaqin për të bërë thirrje për drejtësi dhe për të ecur në rrugën e drejtë. Me këto dy cilësi shpjegohet qartë rëndësia e madhe që kanë ata për ndërtimin e një shoqërie njerëzore të lumtur. Gjithashtu tregojnë se kjo shoqëri mund të ndërtohet nëpërmjet adaptimit e përvetësimit të një

programi të vërtetë e të saktë, larg çdo devijimi, djathtas ose majtas (as lindor, as perëndimor). Më pas vjen thirrja për të vënë në zbatim këtë program të ndërtuar mbi bazat e drejtësisë; gjithashtu duhet që ky program të mos jetë vetëm për një kohë, sapo të përfundojë ajo periudhë kohe, por patjetër duhet të jetë ashtu siç thotë Kur’ani Famëlartë: **“udhëzon për drejtësi”**. (Folja udhëzon është në kohën e tashme dhe, sipas rregullave të gramatikës së gjuhës arabe tregon vazhdimësi). Pra, thirrja për të udhëzuar në rrugën e drejtë është program i vazhdueshëm e i përhershëm.

3-Transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit

Transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) në lidhje me interpretimin e këtyre ajeteve përmendin se “ai që urdhëron për drejtësi, është prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe imamët e Ehli Bejtit (*paqja qoftë mbi ta!*).”¹

Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë kanë thënë se fraza e ajetit: **“atë që udhëzon për drejtësi”**, ka zbritur në lidhje me Hamzan ose me Osman bin Ma’ûnin, ose me Am’màrin.

Kurse fjala “*ebkemu*” - **“memec”**, sipas mendimit të këtyre interpretuesve ka zbritur në lidhje me Ubej bin Makhlefin ose në lidhje me Ebû Xhehlin; ose në lidhje me të ngjashëm me ata të dy.

Të gjitha këto janë anë për të shpjeguar çështje të rëndësishme dhe të qarta të ajetit, por në asnjë rast ky shpjegim nuk mund të jetë shkak për të reduktuar kuptimin e ajetit vetëm në këtë shpjegim. Interpretimet që janë bërë në lidhje me këto ajete të

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 70, hadithi 161.

Kur'anit, dëshmojnë se këto ajete janë studiuar e janë shpjeguar mbi bazën e bërjes së qartë të dallimit në mes adhuruesve të idhujve e besimtarëve dhe jo mes idhujve e All'llahut të Gjithëpushtetshëm.

Ajetet 78 - 83

﴿وَاللَّهُ أَخْرَجَكُمْ مِنْ بُطُونِ أُمَّهَاتِكُمْ لَا تَعْلَمُونَ شَيْئًا وَجَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ وَالْأَفْئِدَةَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ﴾^{٧٨} أَلَمْ يَرَوْا إِلَى الطَّيْرِ مُسَخَّرَاتٍ فِي جَوِّ السَّمَاءِ مَا يُمَسِّكُهُنَّ إِلَّا اللَّهُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ^{٧٩} وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُم مِّنْ بُيُوتِكُمْ سَكَنًا وَجَعَلَ لَكُم مِّنْ جُلُودِ الْأَنْعَامِ بُيُوتًا تَسْتَخِفُّونَهَا يَوْمَ ظَعْنِكُمْ وَيَوْمَ إِقَامَتِكُمْ وَمِنْ أَصْوَابِهَا وَأَوْبَارِهَا وَأَشْعَارِهَا أَثَاثًا وَمَتَاعًا إِلَى حِينٍ^{٨٠} وَاللَّهُ جَعَلَ لَكُم مِّمَّا خَلَقَ ظِلَالًا وَجَعَلَ لَكُم مِّنَ الْجِبَالِ أَكْنَانًا وَجَعَلَ لَكُم سَرَابِيلَ تَقِيكُمُ الْحَرَّ وَسَرَابِيلَ تَقِيكُمُ بَأْسَكُمْ كَذَلِكَ يُتِمُّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تُسْلِمُونَ^{٨١} فَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا عَلَيْكَ الْبَلَاغُ الْمُبِينُ^{٨٢} يَعْرِفُونَ نِعْمَتَ اللَّهِ ثُمَّ يُنْكِرُونَهَا وَأَكْثَرُهُمُ الْكَافِرُونَ^{٨٣} ﴿

“All’l-lahu u nxori prej barqeve të nënave tua ja dhe ju nuk dinit asgjë; Ai ju pajisi me dëgjim, me shikim e me zemër, që ju të falënderoni.”

“A nuk i shohin ata shpendët në hapësirën e qiellit, ata nuk i mban askush përveç All’llahut; edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë.”

“All’llahu bëri për ju prej shtëpive tuaja vendbanim të qetë. Edhe prej lëkurëve të kafshëve, Ai mundësoi për ju të keni banesa të lehta për t’u mbartur kur udhëtoni dhe kur vendoseni. Ndërsa prej leshit, prej qimeve dhe prej leshit të ashpër të kafshëve, (Ai bëri për ju) rroba e shtroje që ju i shfrytëzoni për një kohë.”

“All’llahu nga ajo që Ai krijoi, bëri për ju hije dhe në male për ju bëri vendstrehime. Ai bëri për ju edhe rroba që u mbrojnë prej të nxehtit, bëri edhe rroba që ju mbrojnë në luftë. Kështu i plotëson All’llahu mirësitë e Tij për ju, që ju të pranoni Islamin.”

“Nëse ata kthejnë shpinën, atëherë detyra jote është kumtimi i qartë.”

“Ata i njohin mirësitë e All’llahut, pastaj i mohojnë ato dhe shumica e tyre janë mohues.”

Komentimi

Llojet e mirësive materiale e morale

Kur'ani Famëlartë i kthehet edhe një herë ekspozimit të një grupi tjetër prej mirësive të All'llahut si mësim për Njësimin (Teuhidin) dhe për njohjen e All'llahut. Mirësia e parë që theksojnë këto ajete të uruara është dituria dhe mjetet për ta arritur atë: **“All'llahu u nxori prej barqeve të nënave tuaja dhe ju nuk dinit asgjë”**.

Është e natyrshme që në atë mjedis të kufizuar e të errët ju nuk dinit asgjë, por kur u transferuat në këtë botë, nuk ishte urtësi që ju të vazhdonit në gjendje paditurie. Për këtë shkak, Filluesi i të gjitha krijesave u pajisi me mjetet që mundësojnë për ju të kuptoni çdo gjë. Për këtë ajeti vazhdon: **“Ai ju pajisi me dëgjim, me shikim e me zemër”**, me qëllim që në thellësitë tuaja të vihet në lëvizje ndjenja e falënderimit nëpërmjet kuptimit nga ana juaj të këtyre mirësive të mëdha të All'llahut. Ajeti përfundon: **“që ju të falënderoni”**.

Hulumtime

Këtu do të shtrojmë hulumtimet vijuese.

1- Kur fillon të kuptojë njeriu

Ajeti deklaron hapur se kur lind njeriu, ai nuk kupton asgjë prej sendeve që e rrethojnë. Gjithçka që ai arrin të kuptojë, ndodh vetëm pas lindjes me ndërmjetësinë e shqisave që All'llahu i ka dhënë njeriut.

Këtu ballafaqohemi me problemin vijues: në të vërtetë, njeriu është i pajisur me një grup diturish, si besimi në All'llahun, Zoti Një e i Vetëm (Teuhid), duke shtuar edhe disa dituri të vetëkuptueshme, si për shembull (pamundësia për të qenë bashkë dy të kundërta, e gjitha është më e madhe se pjesa, mirësia e drejtësisë, e keqja e padrejtësisë etj.). Të gjitha këto dituri janë të depozituara në zemrat tona dhe lindin së bashku me ne. Atëherë, si duhet ta kuptojmë fjalën e Kur'anit se në kohën kur njeriu del prej mjedisit të fetusit, nuk ka dituri për asnjë send?

Vallë a kemi pasur dituri për ekzistencën tonë (është një dituri jo e fituar) apo e fitojmë atë me anë të dëgjimit, shikimit dhe zemrës?

Përgjigje: për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje themi: dituritë spontane dhe të domosdoshme, si dhe dituritë e natyrshme, nuk ishin vepruese në njeriun në kohën e lindjes së tij, por ato gjendeshin në formë të përgatitur dhe ekzistonin së bashku me fuqinë.

Me fjalë të tjera, në të vërtetë kur lindim, jemi në një gjendje shkujdesi të plotë ndaj të gjitha sendeve, madje edhe ndaj vetes. Gjatë kohës që vazhdojmë të jemi në gjendjen e fetusit, çështja e të kuptuarit të të vërtetave gjendet te ne në formën e fuqisë së mundshme dhe jo të punës. Pas lindjes, sytë tanë e arrijnë fuqinë e shikimit gradualisht, veshëve u vjen fuqia e dëgjimit dhe mendjes sonë i vjen fuqia e të kuptuarit, e sintezës dhe e analizës. Kështu i gëzojmë këto tri mirësi Hyjnore, me ndërmjetësinë e të cilave kemi mundësi të kuptojmë shumë prej përfytyrimeve që i depozitojmë në mendje dhe prej përfytyrimeve formojmë koncepte të plota. Më pas arrijmë te të vërtetat logjike me anë të rrugës së përgjithësimit e të deduksionit.

Fuqia e mendjes sonë arrin të kuptojë veten (duke e konsideruar dituri jo të fituar) dhe më pas dituritë e depozituara te ne çlirohen si fuqi për t'u bërë dituri reale. Pas kësaj prej diturive spontane e prej diturive të domosdoshme ne bëjmë përpjekje për të arritur në shkencat teorike dhe jospontane.

Bazuar mbi këtë që u tha, përgjithësimi dhe tërësia janë ato për të cilat flet ajeti (që ne nuk dimë asgjë në kohën kur lindim) dhe, për këtë s'ka as përjashtim, as veçanti.

2- Mirësia e mjeteve të njohjes

Pa dyshim që është i pamundur përvetësimi e futja e botës së jashtme në qenien tonë dhe, ajo që arrihet në mendjen tonë konkretisht është figura e një sendi të botës së jashtme, të cilën ne e marrim me anë të mjeteve të përcaktuara për këtë qëllim. Pra,

njohja jonë me botën e jashtme realizohet vetëm falë aparateve të caktuara, si ai i dëgjimit dhe ai i shikimit.

Këto aparate marrin dhe depozitojnë në mendjen tonë çdo gjë që kapin jashtë. Me anë të të menduarit kryhet procesi i ndarjes në pjesë dhe procesi i analizës.

Pikërisht për këtë, ajeti e shpjegon qartë çështjen e mosdijes absolute të njeriut në kohën e lindjes dhe thotë: **“Ai u pajisi me dëgjim, me shikim e me zemër”**, që ju të arrini të kuptoni të vërtetat e ekzistencës.

Në ajetin tonë që është objekt studimi vërejmë se dëgjimi është vënë përpara shikimit, megjithëse sytë kryejnë një punë shumë më të madhe se veshët. Mbase kjo ka ardhur kështu për faktin se pas lindjes, veshi e fillon punën e tij përpara syrit. Dihet që syri gjatë kohës së shtatzënisë është në një errësirë të plotë. Si rezultat i forcës së rrezeve të dritës që bien mbi syrin pas lindjes, ai e ka të pamundur të fillojë funksionin e tij menjëherë për shkak të ndjeshmërisë së madhe. Prandaj, syri përshtatet të përballojë dritën në mënyrë graduale, derisa arrin në gjendjen e tij normale. Ne shikojmë se fëmija në ditët e para të lindjes i mban sytë mbyllur, kurse për veshin mendohet se ka më shumë fuqi për të dëgjuar, pak ose shumë. Madje edhe kur ishte në barkun e nënës, veshi është mësuar të dëgjojë rrahjet e zemrës së nënës!

Përveç kësaj duhet shtuar se njeriu shikon me syrin e tij vetëm sendet që preken, në një kohë që veshi konsiderohet mjet për edukim e për mësim në të gjitha gjendjet. Nëpërmjet dëgjimit të fjalëve, njeriu arrin të njohë të gjitha të vërtetat në mënyrë të barabartë, qoftë kur ato janë prej sendeve që preken, qoftë kur janë

jashtë sferës së tyre, kurse syri nuk e ka këtë fushë të gjerë. Është e vërtetë se njeriu ka mundësi të arrijë diturinë edhe me anë të leximit, por jo të gjithë njerëzit dinë të lexojnë, kurse fjalët i dëgjojnë të gjithë njerëzit normalë.

Shkakun e ardhjes së fjalës *dëgjim* në numrin njëjës dhe i fjalës *shikim* në numrin shumës në ajetin tonë e kemi shpjeguar gjatë interpretimit të ajetit 7 të sures “El Bekare”.

Është edhe një konstatim tjetër që duhet përmendur dhe ka të bëjë me fjalën e ajetit *zemrat*. Në tekstin e ajetit kjo fjalë ka ardhur me fjalën “*el fuàd*”, në kuptimin e zemrës e të mendjes. Prej mendjes lind gjendja e inteligjencës ose thënë ndryshe gjendja e interpretimit, e analizës dhe e shpikjeve.

Ragibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur’ànit thotë se fjala “*el fuàd*” është në kuptimin e zemrës, kur kjo merret në konsideratë në kuptimin e inteligjencës. Është aksiomë e njohur se inteligjenca te njeriun arrihet pasi është fituar një eksperiencë e mjaftueshme.

Sido që të jetë, edhe pse mjetet e njohjes nuk mund të kufizohen vetëm në këto tri aparate, në të vërtetë ato janë prej aparateve më të përkryera. Sepse njeriu e arrin diturinë ose me anë të rrugës së eksperimentimit, ose me anë të rrugës së nxjerrjes së konkluzioneve logjike, pa vënë në përdorim mendjen e zemrën, që siç thamë është në kuptimin e inteligjencës.

3- Që ju të falënderoni

Mirësia e aparateve me të cilët arrihet dituria, konsiderohet mirësia më e madhe që All'llahu i ka dhuruar njeriut. Megjithëkëtë, roli i syrit e i veshit nuk reduktohet vetëm në shikimin e fakteve të All'llahut mbi krijesat e Tij ose në dëgjimin e bisedave për Profetët e All'llahut e për njerëzit e Tij të mirë (eulijatë). Sepse të gjitha këto ti i kupton vetëm falë analizës e deduksionit, madje çdo hap drejt përparimit është i lidhur ngushtësisht me këto aparate.

Dhënia e këtyre aparateve në të vërtetë është një falënderim për Dhuruesin, sepse nëpërmjet tyre Ai mundëson të arrihet dituria e njohja, me të cilat dallohet njeriu prej gjallesave të tjera.

S'ka dyshim se njeriu e ka të pamundur ta falënderojë Krijuesin ashtu siç është detyrë të bëhet falënderimi kushtuar vetëm Atij. Prandaj, njeriut nuk i mbetet gjë tjetër veçse të kërkojë ndjesë për këtë pamundësi nga ana e tij.

Ajeti vijues shpjegon sekretet e madhështisë së All'llahut të Gjithëfuqishëm në lidhje me ontologjinë dhe thotë: **“A nuk i shohin ata shpendët në hapësirën e qiellit”**.

Fjala e ajetit *“xhev’vi” - hapësirë* – është në kuptimin e ajrit, ashtu siç e përmend Ragibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, është ajo pjesë e ajrit larg tokës, ashtu siç thuhet në tefsirin “Mexhmeul Bej’jàn”, në tefsirin “El Mizàn” dhe në tefsirin e “El Àlusi’j’it”.

Meqenëse të gjithë trupat i nënshtrohen ligjit të tërheqjes universale, patjetër që edhe shpendët natyrshëm tërhiqen në drejtim të tokës. Kur’ani Famëlartë e ka përshkruar lëvizjen e

shpendëve në hapësirën e qiellit me fjalën “*musekh'haràtin*”, *vënie në dispozicion*. Domethënë që Filluesi i të gjitha krijesave, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka nevojë për asgjë, në flatrat e shpendëve ka vendosur një fuqi, gjithashtu edhe në ajrin ka krijuar një karakteristikë. Janë këto dy mirësi që u mundësojnë shpendëve të fluturojnë në hapësirën e qiellit, pavarësisht nga ligji i tërheqjes universale.

Ajeti thotë: **“ato nuk i mban askush përveç All'lahut”**.

Është e vërtetë që te shpendët gjenden edhe shumë gjëra të tjera që u japin atyre mundësi të fluturojnë, si për shembull flatrat, fuqia e muskujve, forma e ndërtimit të skeletit, duke shtuar edhe karakteristikat e përshtatshme të ajrit. Por cili është Krijuesi i kësaj forme dhe i këtyre karakteristikave?

Cili e vendosi këtë sistem kaq të hollësishëm?

Vallë është natyra e verbër apo është Ai që ka dijeni për të gjitha karakteristikat e shpendëve dhe dituria e Tij absolute përfshin të gjitha këto punë?

Pa dyshim që ne jo vetëm që i vërejmë të gjitha këto, por jemi plotësisht të bindur se janë prej veprave të All'lahut të Lartësuar dhe se burimi i ekzistencës së shpendëve është vetëm prej të Lartit. Shembuj shprehjesh të këtilla në lidhje me shkaqet e pasojat që i adresohen vetëm All'lahut të Gjithëfuqishëm, janë të shumtë në Kur'anin Famëlartë.

Në fund të ajetit vjen edhe fjala e të Lartit: **“edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë”**. Pra, ata i shikojnë këto punë me sytë e tyre, i dëgjojnë me veshët e tyre, njerëzit mendojnë rreth gjërave

që panë e dëgjuan dhe me të gjitha këto, atyre u forcohet e u rrënjohet gjithnjë e më shumë besimi te Krijuesi.

4- Sekretet e fluturimit të shpendëve në qiell

Ne nuk e vlerësojmë rëndësinë e madhe të shumë prej çudirave të ekzistencës, ngaqë jemi mësuar t'i shikojmë shpesh dhe nuk shqetësohemi për imtësitë shkencore. Ky zakon i yni është bërë si një perde që e mbulon këtë këshillë. Nëse ndonjë prej nesh do të kishte mundësi ta hiqte këtë perde prej mendjes, me siguri që te gjërat rreth tij do të shikojë çudi të shumta.

E njëjta gjë ndodh edhe me fluturimin e shpendëve në qiell: lëvizja e një trupi të rëndë dhe pa ndonjë vështirësi në kundërshtim me ligjin e tërheqjes universale, apo ngritja lart e shpendit me shpejtësi derisa humb prej syve tanë brenda pak çasteve, të gjitha këto janë thirrje për të menduar dhe për studim.

Po të vërejmë me kujdes ndërtimin e trupit të shpendit fluturues, do të gjejmë atë lidhje të hollë e të ndërsjellë mes të gjitha cilësive e gjendjeve që e ndihmojnë shpendin të fluturojë: forma e aerodinamike e trupit pakëson rezistencën e ajrit mbi trupin e shpendit deri në kufirin e mundshëm më të madh, puplat e tij janë të lehta dhe bosh nga brenda, gjoksi i shtrirë i mundëson atij të qëndrojë “hipur” mbi valët e ajrit, natyra e veçantë e flatrave i jep fuqinë ngritëse¹ dhe e ndihmon atë të ngrihet lart. Gjithashtu, edhe

¹ “Fuqia ngritëse” është term i fizikës moderne dhe përdoret në fushën e aviacionit. Ky term në thelb do të thotë: kur trupi ka dy faqe të shtrira me formë të ndryshme nga njëra-tjetra (si krahët e aeroplanit që anën e poshtme e kanë të sheshtë dhe anën e sipërme e kanë me kurriz). Kur aeroplani lëviz vertikalisht,

natyra e veçantë e bishtit të shpendit fluturues dhe mundësia që bishti të lëvizë në të gjitha drejtimet e ndihmon shpendin të ndryshojë drejtimin e fluturimit me shpejtësi djathtas, majtas, lart dhe poshtë (si bishti i aeroplanit). Ky koordinim që ekziston ndërmjet shikimit dhe shqisave të tjera, tregon se të gjitha pjesët e trupit të shpendit marrin pjesë së bashku në procesin e fluturimit dhe të gjitha i japin shpendit fluturues mundësi të fluturojë me shpejtësi.

Përveç këtij fakti kemi edhe rrugën e riprodhimit të shpendit (bërja e vezëve), rritja e të vegjëlve jashtë trupit të nënës, fakt që i heq shpendit gjendjen e barrës, e cila pa dyshim që do ta pengonte në procesin e fluturimit, si dhe të tjera fakte që konsiderohen prej faktorëve që ndikojnë fizikisht në procesin e fluturimit.

Të gjitha këto që u përmendën, zbulojnë ekzistencën e një diturie dhe të një fuqie tepër të lartë, të një Krijuesi e të një Organizuesi konstruktiv në lëvizjen e këtyre qenieve të gjalla dhe, ashtu siç thotë Kur'ani: **“edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë”**.

Çuditë e shpendëve fluturues janë më të shumta nga sa mund të shkruhen në një libër apo në disa libra. Le të marrim për shembull shpendët shtegtarë dhe çuditë që i rrethojnë udhëtimet e

menjëherë lind një fuqi e veçantë që e ngre atë në lartësi. Kjo fuqi lind prej presionit të ajrit mbi pjesën e poshtme të krahëve, që është e sheshtë. Në pjesën e poshtme të fletës, ky presion është më i madh se në pjesën e sipërme të saj, sepse sipërfaqja e poshtme është më e vogël, kurse faqja e sipërme është më e gjerë si sipërfaqe. Pikërisht mbi këtë dukuri mbështetet lëvizja e aeroplanëve. Kur ne e përqendrojmë shikimin në flatrat e shpendëve, menjëherë do të vërejmë këtë dukuri shumë qartë. Prandaj, mendo! Në përgjithësi duhet thënë: ndërtimi i aeroplanëve nuk është gjë tjetër veçse një kopjim nga anë të ndryshme i trupit të shpendëve fluturues!

gjata të tyre. Jeta e këtyre shpendëve është ndërtuar mbi bazën e kalimit nëpër anët e ndryshme të banueshme, duke përshkuar distanca shumë të gjata, si për shembull ajo ndërmjet Polit të Veriut e Polit të Jugut. Është e qartë se jeta e këtyre shpendëve mbështet edhe në aftësinë që kanë ata për t'u orientuar me saktësi gjatë udhëtimeve. Në udhëtimet që ndërmarrin, këto shpendë bazohen mbi disa shenja dalluese që u mundësojnë të kapërcejnë male, lujna e dete. Gjithashtu, fluturimin e tyre nuk e pengon as përkeqësimi i motit, as errësira e thellë e natës, gjendje në të cilat edhe vetë njeriu pavarësisht nga pajisjet e mjetet që ka në dispozicion, përsëri e ka të vështirë të orientohet.

Është me të vërtetë e habitshme ajo që ndodh me këta shpendë shtegtarë: gjatë shtegtimin ndodh që ata flenë lart në qiell duke fluturuar! Udhëtimet e tyre vazhdojnë disa javë pa ndaluar as natën, as ditën dhe gjatë kësaj kohe ata nuk ushqehen fare! Vetëkuptohet që kanë marrë ushqim të mjaftueshëm para fillimit të udhëtimit (në sajë të inspirimit të brendshëm). Ky ushqim shndërrohet në formë dhjami dhe depozitohet në anësitë e trupit të këtyre shpendëve!

Ndër sekretet e shumta që ekzistojnë në lidhje me konstruktin e shpendëve fluturues është edhe çerdhja që shpendi përgatit, mënyra e rritjes së të vegjëlve, mënyra si i mbron të vegjlit prej armiqve, mënyra e sigurimit të ushqimit të domosdoshëm, bashkëpunimi ndërmjet njëri-tjetrit, madje edhe bashkëpunimi me shpendë të tjerë jo prej species së tyre etj. Të gjitha këto që ne përmendëm, në të vërtetë janë një tregim i gjatë.

Po, është ashtu siç thuhet në ajetin e nderuar: **“edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë”**.

5- Lidhja ndërmjet ajeteve të Kur'ânit

Pa dyshim që këtu kemi një lidhje ndërmjet ajetit të mësipërm që flet për mënyrën e fluturimit të shpendëve me ajetet e mëparshme që flisnin për mirësitë e All'Ilahut të Gjithëfuqishëm në botën e krijesave, apo për dimensionet e madhështisë e të fuqisë së të Gjithëpushtetshmit. Gjithashtu, nuk përjashtohet fakti që përmendja e fluturimit të shpendëve ka ardhur pas përmendjes së mjeteve të njohjes. Ky fakt në vetvete është një shenjë me kuptim të gjerë që rezulton prej krahasimit që ajeti bën për fluturimin e këtyre shpendëve në botën e shqisave me fluturimin e mendimeve në botën e sendeve që s'kanë shqisa. Por secili fluturon në hapësirën e tij të veçantë falë mjeteve që ai ka.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në hutben e tij të quajtur "Shakshakij'jeh" thotë: "Prej meje rrokulliset rrjedha, por tek unë nuk ngjitet lart shpendi".

Gjithashtu edhe te fjalët e tij të shkurtra, kur shpjegon mirësitë e komandantit trim Malik Eshter thotë: "Atë nuk e zë as thundra e kalit dhe mbi të nuk ka efekt as shpendi fluturues".¹

Në këtë sure janë përmendur pesëdhjetë mirësi, që bëjnë thirrje për njohjen e All'Ilahut të Lartësuar. Të gjitha këto mirësi nxisin për të falënderuar vetëm Atë, prandaj disa interpretues e kanë emërtuar këtë sure "suretun Niami" – "surja e Mirësive".

¹ "Nehxhul Belàga", Fjalët e shkurtra, fjala nr. 443.

Ajetet vijojnë të theksojnë mirësitë e All'llahut derisa arrijmë në ajetin e tretë të grupit të ajeteve që kemi objekt studimi, që thotë: **“All'llahu bëri për ju prej shtëpive tuaja vendbanim të qetë”**.

Është plotësisht e vërtetë që mirësia e banesës është prej mirësive më të rëndësishme dhe pa të, nuk do të ishte e mundur që e mira të gëzohej me ndonjë gjë tjetër.

Fjala e tekstit të Kur'anit *“bujûtikum”* - **“shtëpive tuaja”**, në origjinën e vetë fjalës ka kuptimin e qëndrimit natën dhe fjala *“bejtun”* është përdorur për dhomën ose për shtëpinë, prej të cilave përfitohet qetësimi natën.

Këtu duhet të tërheqim vëmendjen me vërejtjen vijuese: Kur'ani Famëlartë nuk ka thënë *“All'llahu shtëpitë tuaja i bëri qetësim për ju”*, por më parë ka përmendur parafjalën *prej*, çka nuk tregon përgjithësim, por vetëm disa. Në fillim i Larti ka thënë: *“min bujûtikum”* - **“prej shtëpive tuaja”**. Patjetër që kjo është prej hollësive të fjalës së plotë të All'llahut në shprehje, pasi shtëpia ose edhe dhoma ka edhe anekse, si depo, banjë etj.

Pasi përmend shtëpitë e qëndrueshme, Kur'ani Famëlartë kalon në përmendjen e shtëpive të transportueshme dhe thotë: **“edhe prej lëkurëve të kafshëve Ai mundësoi për ju të keni banesa”**.¹

¹ Në kohën tonë, punimi i tendave prej lëkurë kafshësh është i paktë, por ajeti i nderuar ka qëllim të vërë në dukje edhe mirësinë e kësaj banese që në atë kohë ishte prej llojit më të parapëlqyer të banesave. Madje ajeti i nderuar e ka veçuar këtë mirësi, duke mos i përmendur mirësitë e tjera. Ka mundësi që tendën prej lëkure kafshësh e përmend në mënyrë të veçantë për cilësitë që ka kjo lloj kësaj banese si banesa më e sigurt ndaj stuhive të shkretëtirës përvëluese të zonës së Hixhazit të Arabisë.

Tenda prej lëkure kafshësh është shumë e thjeshtë në përdorim dhe shumë e lehtë për t'u transportuar: **“të lehta për t'u mbartur kur udhëtoni”**, si dhe kur: **“dhe kur vendoseni”**.

Përveç kësaj, Ai për ju ka bërë që: **“ndërsa prej leshit e prej qimeve të tyre dhe prej leshit të ashpër të kafshëve, (Ai bëri për ju) rroba e shtroje që ju i shfrytëzoni për një kohë.”**.

Dihet se leshi e qimet që veshin trupin e kafshës, te disa prej tyre është i ashpër, si për shembull te dhitë, te të tjera më pak i ashpër. Ky është leshi që ne njohim zakonisht, por ka edhe kafshë me fije më pak të butë se leshi i zakonshëm, që në Kur'an ka ardhur me fjalën *“eubâr”*. Është interesante që ndryshueshmëria në natyrën e leshit, i butë, i ashpër dhe më pak i ashpër, çon edhe në shumëllojshmërinë e sendeve që përfitohen prej tij. Me një lloj leshi prodhohen tendat, prej një lloji tjetër prodhohen veshje dhe prej llojit të tretë prodhohen të tjera sende të nevojshme për jetesën e njeriut.

Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë në lidhje me kuptimin e dy fjalëve të fundit të ajetit, *“ethàthen”* dhe *“metà'an”* kanë përmendur shumë kuptime. Disa prej atyre kanë thënë se fjala *“ethàthen”* është në kuptimin e sendeve të shtëpisë.

Kurse për fjalën *“metà'an”* kanë thënë se kjo fjalë përdoret për çdo send prej të cilit njeriu përfiton. (Të dyja termat theksojnë të njëjtin kuptim, por nga dy anë të ndryshme).

Krahas vërejtjes në lidhje me ato që u thanë, përdorimi i të dyja termave njëra pas tjetrës, (*“ethàthen”* dhe *“metà'an”*) ka mundësi të theksojë kuptimin: ju keni mundësi të përgatitni prej tri

llojeve të leshit që u përmendën, mjete shtëpie të shumta dhe gëzohuni që i keni ato gjëra që bëni prej këtyre materialeve.

Interpretues të tjerë, ndër ata edhe Fakhru Ràzij, kanë thënë se fjala *“ethàthen”* është në kuptimin e mbulesave e të veshjeve, kurse *“metà'an”* është në kuptimin e shtrojave, por për këtë interpretim s'kanë përmendur asnjë argument.

Ndërsa El-Àlusi'ji në tefsirin e tij *“Rùhul Bejàn”* ka shpjeguar se fjala *“ethàthen”* tregon sendet që ka shtëpia, kurse *“metà'an”* tregon mjetet që përdoren për tregtinë.

Neve na duket se ajo që thamë në fillim është më afër se të gjitha kuptimet e tjera të këtyre dy fjalëve. Edhe për frazën: **“për një kohë”** janë përmendur shumë kuptime, por duket fare qartë se qëllimi me këtë fjalë është: përfitoni prej këtyre mjeteve e prej këtyre gjërave në këtë botë derisa të mbarojë jeta. Siç shihet, edhe kjo është një shenjë që tregon se jeta në këtë botë nuk është e përhershme, gjithashtu edhe sendet e gjithçka tjetër në këtë botë, kanë një afat kohe të kufizuar.

6- Hijet, banesat, mbulesat

Kur'ani Famëlartë thekson edhe një mirësi tjetër: **“All'Ilahu nga ajo që krijoi bëri për ju hije dhe në male për ju, Ai bëri vendstrehime.”**.

Fjala e ajetit *“eknànen”* është në kuptimin e mjeteve për mbulesë e të mjeteve ruajtëse dhe këtu thuhet për shpellat, për zgavrat e maleve dhe për vetë malet.

Nëse do të shikojmë fjalën “*dhilàlen*” - *hijet* - në ajetin që po studiojmë, do të vërejmë se kjo fjalë përfshin të gjitha hijet, si ato të pemëve, të zgavrave, të maleve apo të diçkaje tjetër, duke e konsideruar atë si njërën prej mirësive hyjnore (në të vërtetë, kështu është). Njeriu ashtu siç ka nevojë për dritë në jetën e tij, po ashtu në shumë raste ka nevojë edhe për hije, sepse nëse drita do të ishte e vazhdueshme, jeta do të ishte e pamundur. Rolin e hijes së globit tokësor (e quajtur natë) mbi jetën tonë e konstatojmë fare mirë me shqisat tona. I domosdoshëm është edhe roli i hijeve të tjera gjatë ditës në vende e në gjendje të ndryshme.

Duket se përmendja e mirësive “*hije*” - “*dhilàl*” dhe “*zgavrave të maleve*” - “*eknàn*”, pas përmendjes së mirësive “*banesa*” - “*sekenen*” dhe “*tenda*” - “*khijàm*” në ajetin e mëparshëm, kanë ardhur për të treguar se grupet e njerëzve nuk dalin jashtë njëres prej tri gjendjeve: njëri grup jeton nëpër qytete e nëpër fshatra, ku përfitojnë prej ndërtimit të shtëpive për të banuar në ato, një grup tjetër bën jetën nomade, pra udhëton ose zhvendoset së bashku me tendat, kurse grupi i tretë janë ata që udhëtojnë dhe s’kanë me vete mjete për banesë. Megjithëkëtë, Filluesi i çdo gjëje, as këtë grup nuk e ka lënë të jetojë pa mbrojtje, por Ai ka urdhëruar që në rrugën e tyre të ketë hije e zgavra ku ata të mbrohen.

Mbase banorët e qyteteve nuk arrijnë ta kuptojnë rëndësinë e madhe të zgavrave të maleve, kurse ata që përshkojnë shkretëtirat, udhëtarët, barinjtë dhe të gjithë ata që janë të privuar prej mirësisë së banesave të qëndrueshme ose të transportueshme (përkohësisht, ose përgjithmonë), të gjithë ata që vazhdimisht ndodhen nën goditjen e nxehtësisë përvëluese të stinës së verës ose gjenden nën acarin e stinës së dimrit të ashpër e dinë mirë rëndësinë e atyre zgavrave në male. Këto zgavra për ata janë vendstrehime të

freskëta në stinën e verës dhe të ngrohta në stinën e dimrit dhe, nga kjo pikëpamje, në disa raste janë shpëtuese prej vdekjes së shpejtë, për njeriun dhe për kafshën.

Pasi përmend mirësinë e hijeve natyrale dhe artificiale, Kur'ani Famëlartë kalon në përmendjen e veshjeve të njeriut dhe thotë: **“Ai bëri për ju edhe rroba që u mbrojnë prej të nxehtit”**; pastaj përmend veshjet e tjera që njerëzit përdorin për të mbrojtur trupat e tyre në luftë: **“bëri edhe rroba që u mbrojnë në luftë”**.

Fjala *veshje* në ajetin tonë ka ardhur me fjalën “*seràbijle*”, në kuptimin e çdo lloji veshjeje (ashtu siç thotë Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit). Këtë shpjegim të tij e kanë mbështetur shumica e interpretuesve të Kur'anit, megjithëse ka prej tyre që kanë thënë se fjala “*seràbijle*” ka kuptimin e rrobës dhe të mbulesës së trupit të njeriut, por më i përhapur është kuptimi i parë.

Siç dihet, dobia e veshjeve nuk mund të reduktohet vetëm në ruajtjen e njeriut prej të nxehtit ose prej të ftohtit, pasi njeriu vishet me rroba për të qenë i respektuar dhe për të ruajtur trupin e tij prej rreziqeve që e rrethojnë. Nëse njeriu do të ishte i zhveshur, pa rroba në trup, patjetër që do të ishte shumë i ekspozuar ndaj plagëve dhe të ngjashmet me plagët. Gjithashtu, nga fakti që Kur'ani Famëlartë i përmend rrobat në mënyrë të specifikuar, kuptohet qartë edhe rëndësia e veçantë e tyre. Gjithashtu edhe përmendja e të nxehtit në mënyrë të veçantë në ajetin tonë që është objekt studimit tonë është plotësisht në përshtatje me gjuhën arabe në rastin e përmendjes së dy të kundërtave në mënyrë të shkurtër. Pra, pa e përmendur të kundërtën e dytë, pasi e kundërta e dytë kuptohet qartë për shkak të krahasimit me të kundërtën e parë, ose ka mundësi që është përmendur vetëm të nxehtë për shkak se për

njerëzit e zonës ku ka zbritur Kur’ani, ruajtja prej të nxehtit ishte e një rëndësie të veçantë.

Ka edhe një mundësi tjetër dhe që ka lidhje me rrezikun e njohur të goditjes prej diellit, ose thënë ndryshe; rezistenca e njeriut ndaj nxehtësisë së madhe të rrezeve të diellit, arrin deri në njëfarë kufiri, është më e vogël se rezistenca e tij ndaj të ftohtit.

Në fund, ajeti i nderuar u kujton njerëzve: **“kështu i plotëson All’llahu mirësitë e Tij për ju, që ju të pranoni Islamin”,** domethënë t’i bindeni urdhrit të Tij.

Është më se e natyrshme që njeriu të mendojë në lidhje me Krijuesin e mirësive, veçanërisht kur atij i tërhiqet vëmendja për mirësitë e shumta që e rrethojnë, atëherë ndërgjegjja e tij zgjohet dhe orientohet kah Mirësidhënësi. Falë këtyre mirësive, të shtojë njohuritë e tij rreth Mirësidhënësit të Gjithëfuqishëm, por kjo ndodh vetëm kur njeriu zotëron edhe shkallën më të vogël për të falënderuar për të mirën.

Megjithëkëtë, disa interpretues të Kur’anit Famëlartë e kanë reduktuar kuptimin e fjalës së ajetit “mirësi” vetëm në disa të tilla, si: mirësia e krijimit, plotësimi i mendjes, ose mirësia që ne besojmë se All’llahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhidi), ose mirësia e ekzistencës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*). Gjithsesi, kuptimi i fjalës së ajetit “niëmetun” – mirësi -, është shumë më i gjerë se kaq, pasi kjo fjalë e ajetit përfshin të gjitha mirësitë, (ato që u përmendën dhe ato që s’janë përmendur) dhe, për sa i përket përmendjes së vetëm disa mirësive, në të vërtetë ato dalin në dritë falë vërtetimit nëpërmjet interpretimit të qartë.

Pas përmendjes së këtyre mirësive të mëdha, i Gjithëfuqishmi thotë: “Edhe sikur ata të kthejnë shpinën dhe nuk i nënshtrohen së vërtetës, ti (o Muhammed) as mos u hidhëro e as mos u shqetëso, sepse detyra jote është vetëm t’u kumtosh atyre mesazhin qartë”: **“Nëse ata kthejnë shpinën, atëherë detyra jote është kumtimi i qartë.”**.

Pavarësisht se kumtuesi zotëron një logjikë të shëndoshë dhe të mbështetur mbi argumente të vërteta që të bëjnë për vete, fjalët e tij s’kanë asnjë efekt mbi bashkëbiseduesin nëse ai nuk është i gatshëm të dëgjojë e të pranojë fjalën e kumtuesit. Thënë ndryshe, zgjedhja e vendit dhe e kohës ku duhet bërë kumtimi dhe kur është kusht për arritjen e efektit.

Pra, nëse ty nuk të besojnë ata që e kanë zemrën të verbër, si dhe ata që dallohen për fanatizëm e për kokëfortësi, kjo nuk është diçka e re. Prandaj, ti ke detyrë vetëm të kumtosh mesazhin me zë të lartë, me gjuhë të bukur e të qartë dhe të mos lësh asgjë mangët në çështjen e kumtimit të tij. Vetëkuptohet se qëllimi me këtë frazë të Kur’anit është dashamirësia dhe qetësimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*).

Në plotësim të bisedës, Kur’ani Famëlartë shton fjalën e tij: **“Ata i njohin mirësitë e All’llahut, pastaj i mohojnë ato.”**.

Veprimi i tyre mohues nuk është për shkak se ata nuk kanë dijeni për mirësitë hyjnore, por për shkak të injorancës dhe të cilësive të tyre të këqija. Janë pikërisht këto që i ndalojnë ata të besojnë, si: fanatizmi i verbër, këmbëngulja për të qenë armiq të së vërtetës, dhënia përparësi e përfitimeve të tyre materiale mbi të

gjitha gjërat e tjera dhe ndotja në llumin e epsheve, duke shtuar këtu edhe sëmundjen e mendjemadhësisë e të krekosjes.

Mbase edhe fraza e fundit e ajetit **“dhe shumica e tyre janë mohues”**, tregon për shkaqet që u përmendën.

Fjala e ajetit *“ue ektheruhum”* ka tërhequr vëmendjen dhe interesimin e madh të interpretuesve të Kur’anit, të cilët kanë studiuar shkaqet e ardhjes së kësaj fjale. Ata kanë arritur të gjejnë shkaqe të shumta, secili sipas këndvështrimit nga e ka bërë atë studim, por ajo që ne thamë duket se është më afër kuptimit të saktë nga të gjithë kuptimet që ata kanë përmendur. Me pak fjalë, shumica e mohuesve janë prej fanatikëve dhe kokëngjeshurve, kurse ata që kanë mohuar për shkak të injorancës së tyre apo të shkujdesjes, janë pakicë në krahasim me të parët.

Në Kur’anin Famëlartë ndeshen fraza të shumta, ku fjala mohim është përdorur për llojin e mohimit të ardhur prej mendjemadhësisë dhe kokëfortësisë. Ka edhe fraza të tjera ku kjo fjalë është përdorur për mendjemadhësinë e djallit, ashtu siç thuhet në ajetin 34 të sures “El Bekareh”: **“ai kundërshtoi, tregoi mendjemadhësi dhe u bë mohues”**.

Interpretues të tjerë janë shprehur se fjala e ajetit *“ue ektheruhum”* ka qëllim njerëzit për të cilët janë plotësuar argumentet kundrejt një pakice për të cilët nuk janë plotësuar ende argumentet. Ka mundësi që ky kuptim të kthehet në kuptimin e parë.

7- Fjalët e interpretuesve të Kur'anit

Nga ajo që lexojmë në fjalët e shumë interpretuesve të Kur'anit Famëlartë në lidhje me frazën e ajetit të fundit të këtij grupi ajetesh që janë objekt i studimit tonë, **“mirësitë e All'llahut”**, në shumicën e rasteve kjo fjalë është interpretuar si argument dhe kriter, edhe pse në dimensionet e saj përfshin të gjitha mirësitë materiale e morale. Madje edhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) konsiderohet njëra prej argumenteve të gjalla të mirësive të All'llahut të Gjithëfuqishëm.

Në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) theksohet se qëllimi me fjalën **“mirësitë e All'llahut”** është ekzistenca e Imamëve të ruajtur prej mëkateve.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ai ka thënë: “Pasha All'llahun, ne jemi mirësia e All'llahut që Ai ka bërë për robërit e Tij dhe me ne fiton ai që do të fitojë”.¹

8- Konflikti i së vërtetës me të gabuarën

Disa interpretues të Kur'anit kanë qëndruar në ndajfoljen “*thum'me*” - **“pastaj”** të ajetit që kemi objekt studimi: **“Ata i njohin mirësitë e All'llahut, pastaj i mohojnë ato.”**. Zakonisht kjo ndajfolje përdoret si lidhëse ndërmjet dy punëve që kanë diferencë kohore. Pra ka një ndarje mes diturisë së tyre për mirësitë e All'llahut dhe mes mohimit të tyre për këto mirësi. Pikërisht për këtë disa interpretues të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se qëllimi

¹ Tefsiri “Nüruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 164.

me këtë shprehje është që të bëhet e qartë ajo që duhet bërë e qartë kundër atyre që nuk pranojnë se All'Ilahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhidin), megjithëse ata kishin dijeni për mirësitë e All'Ilahut. Pra, ishte detyrim nga ana e tyre që të ishin të nënshtruar ndaj këtij pohimi të tyre, por ata vazhduan të ecin në rrugën e gabuar, prandaj Kur'ani Famëllartë e përjashton punën e tyre duke e shprehur me ndajfoljen *"thum'me"* - pastaj.

Ne themi se kjo ndajfolje, këtu tregon edhe një kuptim të fshehtë, i cili në thelb do të thotë se kur thirrja e të Vërtetit depërton në brendësi të shpirtit të njerëzve nëpërmjet rrugës së saj origjinale me logjikë të shëndoshë, patjetër që ajo do të ndeshet me elemente negative dhe me mohimin që gjendet aty. Kjo i fut ata në një polemikë e konflikt të brendshëm, i cili vazhdon për aq kohë sa është edhe fuqia e pafuqia e këtyre elementeve. Nëse elementet e ndalimit e të mohimit janë më të fuqishme, ato e mundin atë pas njëfarë kohe. Këtë gjendje Kur'ani Famëllartë e shpreh me ndajfoljen *"thum'me"* - pastaj.

Ajetet 64 dhe 65 të sures "El Enbijà" paraqesin bisedën e hazretit Ibràhim (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!), pasi shkatërroi të gjithë idhujt e politeistëve, me përjashtim të idhullit që ata e mbanin si më të madhin. Në fillim, fjala e Ibrahimit i bëri ata të mendohen thellë, madje arritën edhe të qortojnë veten dhe gati sa nuk u futën në rrugën e drejtë. Por ekzistenca e mbetjeve të elementeve negative në shpirtrat e tyre (fanatizmi, mendjemadhësia, kokëfortësia) bënë që peshorja e logjikës së tyre të anojë kah refuzimi i thirrjes për të vërtetën dhe u kthyen përsëri në atë që ishin më parë (në adhurimin e idhujve). Pikërisht duke përshkruar këtë gjendje të atyre, Kur'ani Famëllartë edhe këtu ka përdorur fjalën *"thum'me"* - pastaj. Ajeti thotë: **"Ata i thirrën mendjes dhe thanë: 'Vërtet ju jeni të**

gabuarit'. Pastaj ndërruan mendje për këtë që kishin në kokat e tyre dhe thanë: ti e dije që ata (idhujt) nuk flasin".

Me këto shpjegime, kuptimi i fjalës "*el kâfirûne*" - *mohuesit* - pas ndajfoljes "*thum'me*" - *pastaj* - bëhet edhe më i qartë.

Ajetet 84 - 89

﴿وَيَوْمَ نَبْعَثُ مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ شَهِيدًا ثُمَّ لَا يُؤْذَنُ لِلَّذِينَ كَفَرُوا وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ﴾^{٨٤} وَإِذَا رَأَى الَّذِينَ ظَلَمُوا الْعَذَابَ فَلَا يُخَفَّفُ عَنْهُمْ وَلَا هُمْ يُنْظَرُونَ^{٨٥} وَإِذَا رَأَى الَّذِينَ أَشْرَكُوا شُرَكَاءَهُمْ قَالُوا رَبَّنَا هَؤُلَاءِ شُرَكَائُنَا الَّذِينَ كُنَّا نَدْعُو مِنْ دُونِكَ فَأَلْقُوا إِلَيْهِمُ الْقَوْلَ إِنَّكُمْ لَكَاذِبُونَ^{٨٦} وَأَلْقُوا إِلَى اللَّهِ يَوْمَئِذٍ السَّلَامَ وَضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ^{٨٧} الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ زِدْنَاهُمْ عَذَابًا فَوْقَ الْعَذَابِ بِمَا كَانُوا يُفْسِدُونَ^{٨٨} وَيَوْمَ نَبْعَثُ فِي كُلِّ أُمَّةٍ شَهِيدًا عَلَيْهِمْ مِنْ أَنْفُسِهِمْ وَجِئْنَا بِكَ شَهِيدًا عَلَى هَؤُلَاءِ وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تِبْيَانًا لِكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَى لِلْمُسْلِمِينَ^{٨٩}﴾

“Ditën kur Ne për secilin popull do të sjellim dëshmitarin, ata që nuk besuan nuk lejohen (të justifikohen) e as nuk u kërkohet (justifikim).”

“Kur mizorët do të shohin dënimin, atyre (dënimi) as nuk u lehtësohet e as nuk u shtyhet për më vonë.”

“Kur adhuruesit e idhujve të shikojnë idhujt (zotat e tyre) do të thonë: o Zoti ynë, këta janë idhujt që ne adhuronim dhe nuk të adhuriam Ty! Ato (idhujt) i përgjigjen: ju jeni gënjeshtarë.”

“Atë ditë ata (adhuruesit e idhujve) i dorëzohen All’llahut dhe ajo që ata kishin trilluar u asgjësohet.”

“Atyre që nuk besuan dhe penguan (të tjerët) nga rruga e All’llahut, mbi ata Ne shtojmë dënim mbi dënim për shkak të ngatërresave që bënin.”

“Atë ditë kur Ne për çdo popull do të sjellim prej mesit të tyre dëshmitar kundër tyre edhe ty do të sjellim dëshmitar kundër tyre; Ne ty të zbritëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe përgëzim për myslimanët.”

Komentimi

Kur përpara mizorëve do të mbyllen portat

Kur’ani Famëlartë pasi shpalosi në ajetet e mësipërme mohimin e kundërshtarëve të së vërtetës, të cilët si rezultat i mohimit ishin edhe mosmirënjohës ndaj mirësive të All’llahut, në këtë grup ajetesh që janë objekt studimi trajton njërën anë të dënimit të ashpër të All’llahut që i pret njerëzit e këtillë në Botën Tjetër. Trajtimi i dënimit ka ardhur me qëllim që i shkujdesuri të zgjohet prej gjumit të shkujdesjes dhe mbase të hedhë sytë e të shikojë qëndrimet e veta të devijuara nga rruga e drejtë, para se të

jetë vonë për këtë. Në fillim, ajeti thotë: **“Ditën kur Ne për secilin popull do të sjellim dëshmitarin.”**.

A do të jetë e nevojshme të sillet dëshmitari krahas diturisë absolute të All’llahut?

Gjatë leximit të ajetit, ka mundësi që kjo pyetje të kalojë në mendjen e lexuesit dhe përgjigjja për këtë pyetje bëhet e qartë nëpërmjet shkoqitjes së vërejtjes vijuese: në punët që kanë qëllim anën shpirtërore, në shumicën e rasteve njeriu bëhet i vetëdijshëm kur vihet përballë dëshmitarëve dhe mbikëqyrësve të urdhëruar nga ana e All’llahut të Lartësuar që të qëndrojnë gjithmonë vazhdimisht pranë njeriut. Në të vërtetë, prania e dëshmitarëve të këtillë bën që ai të shtojë kërkimin e llogarisë ndaj vetvetes dhe, më e pakta, ai do të mendojë sa i turpëruar do të jetë ditën kur do të ballafaqohet me punët që ka bërë.

Në lidhje me këtë gjykatë, ajeti thotë: **“ata që nuk besuan nuk lejohen** (të justifikohen)”.

A është e mundur që All’llahu të mos u japë leje mohuesve të mbrojnë veten?

Po, nuk do t’i lejojë, sepse në atë Ditë të madhe nuk do të jetë nevoja të flasë gjuha, sepse gjymtyrët e njeriut, këmba, veshi, syri, si edhe lëkura, madje edhe toka mbi të cilën njeriu nuk është nënshtruar apo ka kundërshtuar, të gjithë këta do të dëshmojnë kundër tij. Ky kuptim mund të nxirret dhe prej ajeteve të tjera të Kur’anit Famëlartë, si për shembull prej ajetit 65 të sures “Jâsin” dhe prej ajetit 36 të sures “El Murselât”.

Edhe më shumë, ata nuk do të lejohen as të flasin, ashtu siç vijon ajeti: **“e as nuk u kërkohet (justifikim)”**.¹

Sepse Bota Tjetër është vendi i ballafaqimit të rezultatit të punëve dhe nuk është as ditë pune, as ditë përmirësimi. Në atë Ditë, njerëzit janë si frutat e këputura që u ka mbaruar koha e rritjes.

Ajeti në vazhdim shpjegon gjendjen e mizorëve, pasi për ata ka përfunduar dhënia e llogarisë dhe tashmë kanë hyrë në vendin e dënimit. Si është mundur që ata herë kërkojnë lehtësimin e dënimit të ashpër dhe herë tjetër kërkojnë të lihen për më vonë, domethënë kërkojnë shtyrjen e dënimit. Ajeti i jep përgjigje kërkesës së tyre: **“Kur mizorët do të shohin dënimin, atyre (dënimi) as nuk u lehtësohet e as nuk u shtyhet për më vonë.”**.

Të dy ajetet theksuan katër faza të gjendjes së kriminelëve (ashtu siç i vëmë re katër faza të ngjashme të kriminelëve në jetën e kësaj bote):

faza e parë: kriminelin përpiqet të kamuflohet e të përgënjeshtrojë, me qëllim që të nxjerrë veten të pafajshëm dhe, nëse nuk e arrin qëllimin e tij, atëherë ai kalon në fazën vijuese;

¹ Rrënja e foljes “*justa'tebùne*” e këtij ajeti të Kur'anit është fjala “*istit'àb*”, origjina së cilës është emri foljor “*it'àb*”, që do të thotë: bisedë me fjalor të ashpër shoqëruar me qortim. Kuptimi i rrënjës së foljes është kështu: fajtori kërkon të dënohet personi prej të cilit ai ka për të marrë të drejtën. Fajtori e bën një kërkesë të këtillë me qëllim që ajo të jetë shkak për uljen e zemërimit e tij. Dihet se ai i bën këto lëvizje me qëllim që të arrijë mirëkuptimin me të. Disa kanë thënë se folja “*justa'tebùne*” është në kuptimin e arritjes së marrëveshjes, në një kohë që këtu s'ka vend për të, për shkak se është detyrim që personi të cilit i takon të marrë të drejtën, patjetër duhet të mbetet i kënaqur.

faza e dytë: i shkon prapa atij që ka për të marrë të drejtën prej tij për të marrë vesh zemërimin e tij, me qëllim që të arrijë të kuptohet me të, por kur as ky qëndrim nga ana e tij nuk i sjell ndonjë dobi, atëherë ai kalon në fazën e tretë;

faza e tretë: kërkon lehtësimin e dënimit dhe thotë: “Më dëno, por më lehtëso ndëshkimin!”. Nëse ai nuk i përgjigjet kërkesës së kriminelit sepse dhimbja e tij është shumë e fortë për shkak të fajit të kriminelit, atëherë ky bën kërkesën e fundit;

faza e katërt: kërkon t’i jepet kohë e të vonohet dënimi i tij dhe kjo është përpjekja e tij e fundit për të shpëtuar prej dënimit.

Por Kur’ani Famëlartë i përgjigjet kërkesës së kriminelëve se ata nuk do të kenë as leje të mbrojnë vetveten, as nuk është e mundur që të arrijnë kënaqësinë e të Gjithëfuqishmit. Dënimi atyre as nuk do t’u lehtësohet, as nuk do t’u shtyhet për më vonë, sepse punët e tyre janë aq të këqija dhe mëkatet e tyre janë aq të rënda, sa i kanë mbyllur të gjitha portat e pranimit të kërkesës.

Në ajetin vijues biseda vazhdon rreth përfundimit të punëve të politeistëve. Kur ata do të jenë në Xhehennem së bashku me të adhuruarit prej tyre, idhujt prej guri e idhujt njerëz që ata adhuronin në këtë botë. Ajeti i nderuar vijon duke përshkruar gjendjen e tyre: **“Kur adhuruesit e idhujve të shikojnë idhujt (zotat e tyre) do të thonë: ‘O Zoti ynë, këta janë idhujt që ne adhuronim dhe nuk të adhuruam Ty!’”**. Këta janë të adhuruarit që na cytnin të përlyheshim në baltovinat e punës së keqe, këta janë edhe ortakë me ne në krimin që bëmë, prandaj hiqe dënimin prej nesh dhe hidhe mbi ata!”

Në këtë çast, të adhuruarit idhuj (me lejen e All'Ilahut) fillojnë të flasin: **“Ata (idhujt) u përgjigjen: ju jeni gënjeshtarë”**, ne kurrë nuk kemi qenë ortakë me All'Ilahun dhe pavarësisht nga cytjet tona, ne nuk duhet të dënohemi për disa prej fajeve tuaja.

Këtu duhet të bëhen disa vërejtje:

1- Fjala *“shurekàehum”* - ortakët e tyre - është në kuptimin ortakë të All'Ilahut – për të treguar se idhujt në të vërtetën e tyre nuk ishin ortakë të All'Ilahut të Lartësuar, por ishin adhuruesit e idhujve e politeistët ata që u atribuuan atyre këtë cilësi, duke gënjyer sipas fantazisë së tyre. Prandaj, ata duhet t'i bëjnë idhujt ortakë të vetes dhe jo të thonë se idhujt janë ortakë me All'Ilahun e Lartësuar.

Këtë të vërtetë e përforcon edhe ajo që vumë re më sipër se idhujtarët ndanin për idhujt prej kafshëve të tyre e prej prodhimeve bujqësore që merrnin dhe i bënin idhujt ortakë të vetes në këto mirësi.

2- Prej ajetit mësohet se në “sallën” e gjyqit, Ditën e Gjykimit të përgjithshëm nuk do të jenë vetëm idhujt prej guri e prej druri, por edhe njerëzit që u adhuruan, si Faraoni e Nemrudi.

Kjo e vërtetë përforcohet nga fjalët e ajetit 98 të sures “El Enbijà”: **“Ju dhe ata që adhuruat e nuk adhuruat All'Ilahun, do të jeni lënda djegëse e Xhehennemit.”**.

3- Ajeti zbulon me vete fjalën e adhuruesve të idhujve se ata i adhuronin këta kur pohojnë para All'Ilahut të Lartësuar: **“këta janë idhujt që ne adhuronim dhe nuk të adhuruam Ty”**. Në këtë kontekst, kjo fjalë e idhujtarëve përmban të vërtetën e asaj që ata

pohojnë, prandaj është pa kuptim që idhujtarët të përgënjeshtrohen prej idhujve të tyre.

Por ka mundësi që përgënjeshtrimi nga ana e idhujve të jetë në kuptimin që atyre nuk u përshtatet të adhurohen dhe të mos adhurohet All'Ilahu, ose ngaqë idhujtarët shtojnë edhe një fjali tjetër në kuptimin se të adhuruarit na shtynë e na cytën ne që ne të adhurojmë idhujt. Atëherë përgënjeshtrimi i idhujtarëve nga ana e idhujve tregon se idhujt në të vërtetë nuk zotërojnë ndonjë fuqi as për të cytur, as për të inspiruar.

4- Ka mundësi edhe ardhja e frazës: **“Ata (idhujt) u përgjigjen”**, është në kuptimin: ata u thanë atyre, për shkak se idhujt s’kanë fuqi të flasin vetë. Prandaj, fjala e tyre është një shprehje e ardhur prej All’Ilahut e vënë në fjalën e idhujve, domethënë se All’Ilahu i Gjithëfuqishëm është Ai që e hedh këtë frazë tek idhujt dhe ata e hedhin këtë frazë në drejtim të adhuruesve të tyre (mushrikëve).

Ajeti vijues shpjegon qartë se të gjithë, pasi kanë thënë gjithçka që kishin dhe pasi kanë dëgjuar edhe përgjigjet për fjalët e tyre, kalojnë në një gjendje tjetër: **“Atë ditë ata** (adhuruesit e idhujve) **i dorëzohen All’Ilahut”**,¹ të bindur ndaj All’Ilahut, të nënshtruar ndaj madhështisë së të Gjithëfuqishmit, sepse arroganca e fanatizmi i tyre të ardhura prej injorancës u asgjësuan sapo ata

¹ Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë, si autori i tefsirit “El Mizàn”, kanë thënë se dorëzimi (pranimi i së vërtetës) është vetëm prej adhuruesve të idhujve dhe jo prej idhujve. Veç kësaj, këtë thënie e përforcojnë edhe vetë fjalët e fundit të ajetit.

panë të vërtetën, para së cilës s'ka rrugë tjetër përveç vërtetimit të saj dhe nënshtrimit para saj.

Gjatë kësaj kohe kur çdo gjë bëhet e qartë dhe e dukshme si drita e diellit, idhujtarëve u asgjësohet ajo që kishin trilluar: **“ajo që ata kishin trilluar u asgjësohet”**, domethënë asgjësohet gënjeshtra që ata kishin stisur për ekzistencën e ortakëve për All'llahun. Gjithashtu bëhet pa asnjë vlerë edhe pretendimi i tyre se idhujt do të ndërmjetësonin tek All'llahu për ata. Ata do të shikojnë se idhujt jo vetëm që s'kanë fuqi të bëjnë asnjë punë, por janë bashkë me ta në zjarrin e Xhehennemit.

Me këto ajete, biseda u shtjellua rreth devijimit të idhujtarëve në rrugën e humbjes dhe rënien e tyre në shkallët më të ulëta të idhujtarisë, pa pasur mundësi t'u bëjnë thirrje të tjerëve për ndihmë për t'i shpëtuar ose për t'i lehtësuar dënimin në gjendjen ku janë. Më pas, Kur'ani Famëlartë kalon te trajtimi i çështjes së mohuesve, të cilët nuk u mjaftuan vetëm me mohimin, por harxhuan edhe pikën e fundit të mundit të tyre për të futur edhe të tjerët në rrugën e humbjes: **“Atyre që nuk besuan dhe penguan (të tjerët) nga rruga e All'llahut, mbi ata Ne shtojmë dënim mbi dënim për shkak të ngatërresave që bënin.”**.

Patjetër që idhujtarët duke adhuruar idhujt janë ortakë në krimin e të tjerëve, duke shtuar edhe punët që ata bënë vetë. Në të vërtetë ishin punët e tyre të këqija ato që shkaktonin përhapjen e ngatërresave e të shkatërrimeve mbi tokë, si dhe puna e madhe që ata bënin për të çuar në rrugën e humbjes krijesat e All'llahut dhe për t'i larguar ata prej rrugës së Tij të drejtë.

Nisur nga logjika e shoqërisë islame, shpesh kemi perifrastuar hadithin e nderuar që thotë se ai që hap një rrugë veprimi (të mirë ose të keqe) është pjesëmarrës e ortak në shpërblimin ose në dënimin me ata që veprojnë sipas asaj rruge. Ja edhe fjalët e hadithit të lartpërmendur, të cilat e shpjegojnë këtë fakt me qartësinë më të madhe: “Kush vë një rrugë veprimi të drejtë dhe e ndjek atë, ka shpërblimin e të gjithë atyre që veprojnë sipas kësaj rruge, pa u pakësuar atyre asgjë prej shpërblimit. Kush vë një rrugë veprimi të padrejtë dhe e ndjek atë, ka edhe mëkatin e të gjithë atyre që veprojnë sipas kësaj rruge, pa u pakësuar atyre asgjë prej mëkatit”.

Në të gjitha gjendjet, ajetet e Kur’anit dhe hadithet e nderuara bëjnë të qartë përgjegjësinë e krerëve dhe të orientuesve para All’liahut dhe para njerëzve.

Ajeti i nderuar trajton gjithashtu edhe praninë e dëshmitarit në të gjithë popujt (kjo çështje u përmend në ajetin e parë të grupit të ajeteve që po diskutojmë), por Kur’ani Famëllartë, për ta bërë këtë çështje akoma më të qartë thotë: **“Atë Ditë kur Ne për çdo popull do të sjellim prej mesit të tyre dëshmitar kundër tyre”**.

Prania e këtyre dëshmitarëve, veçanërisht prej personave të përzgjedhur për këtë mision prej mesit të vetë popujve, nuk është në kundërshtim me diturinë e All’liahut të Lartësuar, dituri me të cilën Ai ka rrethuar të gjitha sendet, por sjellja e dëshmitarit është për të treguar se punët e njerëzve vëzhgohen e kontrollohen, si dhe për t’i tërhequr vëmendjen njerëzve një herë e mirë se ata vazhdimisht janë të mbikëqyrur.

Patjetër që dispozita e ajetit përfshin edhe shoqërinë islame, si dhe Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në kuadrin e theksimit të kësaj çështjeje, Kur'ani famëlartë thotë: **“edhe ty do të të sjellim dëshmitar kundër tyre”**.

Thuhet se me fjalën e ajetit *“hàulài”* - atyre – është qëllimi për myslimanët që jetuan në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili gjatë asaj kohe ishte mbikëqyrës, shikues e dëshmues për punët e tyre. Është e natyrshme që pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të vijë një person tjetër, i cili do të ndjekë rrugën e tij dhe do të jetë dëshmues për popullin mysliman (ky dëshmues është prej mesit të myslimanëve), i cili patjetër duhet të jetë i ruajtur prej mëkateve, pasi vetëm kështu ka mundësi të dëshmojë të drejtën e të vërtetën.

Pikërisht për këtë, disa interpretues të Kur'anit Famëlartë (prej dijetarëve të Imamive dhe prej Ehli Syneetit) janë bazuar mbi këtë ajet dhe e kanë marrë si argument për të vërtetuar praninë e një dëshmuesi të drejtë në çdo kohë. Gjithashtu, ata e kanë konsideruar praninë e një Imami të ruajtur prej mëkateve si domosdoshmëri në të gjitha kohët. Kjo logjikë është në përputhje me shkollën juridike (medh'hebin) të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Ka mundësi që për këtë shkak edhe Fakhru Ràziu në tefsirin e tij, kur ballafaqohet me këtë problem orientues, ka thënë: “Nga kjo arrihet se asnjëra prej kohëve nuk ka qenë pa një dëshmues që të dëshmojë për njerëzit dhe kundër njerëzve, por ky dëshmues patjetër duhet të jetë i ruajtur prej gabimeve, ndryshe do të lindte nevoja për një dëshmues tjetër. Kjo do të thotë që vargu i gjetjes së

dëshmuesit të vërtetë të zgjatet në pafundësi, çka është krejtësisht gabim, sepse vërtetohet se patjetër në çdo kohë duhet të ketë njerëz fjala e të cilëve është argument, prandaj kjo kërkon që i gjithë ymeti mysliman (ixhmài ummeh) të jetë argument”.¹

Nëse Fakhru Ràziu do të kishte kapërcyer pak kufijtë e tij doktrinarë, nuk do të kishte rënë kurrë në këtë kontradiktë, sepse Kur’ani thotë: **“Atë Ditë kur Ne për çdo popull do të sjellim prej mesit të tyre dëshmitar kundër tyre”**; vetëkuptohet që tërësia e ymetit nuk mund të jetë dëshmuar për çdo individ prej individëve të ymetit.

Ashtu siç kemi thënë në tefsirin tonë gjatë komentimit të ajetit 41 të sures “En Nisà”, janë edhe dy mundësi të tjera në lidhje me komentimin e fjalës “hàulài” - ata - të ajetit tonë që është objekt studimi.

E para: fjala “hàulài” - ata - tregon dëshmuesit e popujve të kaluar, Profetët (Paqja e All’llahut qoftë mbi ta!) dhe të porositurit. Por edhe Profeti ynë (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) do të jetë dëshmuar mbi këtë ymet (ymetin e tij) dhe për Profetët e mëparshëm.

E dyta: qëllimi me dëshmuar këtu është dëshmuar konkret, pra ekzistenca e një personi i cili është shembull dhe peshore e dallimit të së vërtetës prej së gabuarës.

(Për më shumë shpjegime, lexo fundin e ajetit 41 të sures “En Nisa”).

¹ Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 3. f. 98.

Meqenëse dëshmuesi është degë e një programi të plotë e të përgjithshëm për të gjithë njerëzit, dëshmuesi duhet të ketë cilësitë që e bëjnë atë pohues të argumentit kundër tyre. Pra, ky dëshmues është i saktë e i prerë në dëshminë e tij, si dhe në kuptimin e shikuesit e të vëzhguesit. Prandaj, Kur'ani Famëllartë pas asaj që u tha në ajetet e mësipërme, i drejtohet Profetit: **“Ne të zbritëm Librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe përgëzim për myslimanët.”**.

Dy Hulumtime

1- Kur'ani është sqarues për çdo send

Më e rëndësishmja prej çështjeve që trajtuan ajetet e uruara të këtij grupi ajetesh rezultoi se Kur'ani Famëllartë është sqarues për çdo send.

Në tekstin e ajetit të nderuar fjala *sqarim*¹ ka ardhur me fjalën *“tibjànen”*, por që mund të lexohet edhe *“tebjànen”* në kuptimin e rrënjës së foljes. Nga ky fakt mund të arrihet qartë në përfundimin se Kur'ani është sqarues për çdo send, duke marrë në konsideratë diapazonin e gjerë të togfjalëshit *çdo send* dhe duke vënë parasysh

¹ El Àlûsij'ji në tefsirin “Rûhul Meànij” ka cituar prej disa gjuhëtarëve se te të gjitha rrënjët e foljeve që janë në masën *“tif'âl”*, germa *“t”* e kësaj fjale lexohet me zanoren *“e”*. Pra, lexohet *“tef'âl”*, përveç fjalës *“tibjàn”* - *sqarim* - dhe të fjalës *“tilkàe”* - *kah* - por disa prej letrarëve i konsiderojnë këto dy fjalë rrënjë foljeje dhe disa të tjerë i konsiderojnë emër i rrënjës së foljes.

shënimin se Kur'ani për njeriun është libër edukimi e udhëzimi në rrugën e drejtë dhe se Kur'ani ka zbritur që të arrijë tek individit dhe te shoqëria – në të gjitha rrafshet materiale e morale – deri në gjendjen e plotësimit e të përparimit. Nga ky sqarim bëhet e qartë nga togfjalëshi i ajetit *“kul’li shej’in”* - *çdo send* - do të thotë të gjitha punët e duhura për të arritur në rrugën e plotësimit. Kur'ani nuk është enciklopedi diturish të mëdha, megjithëse përmban edhe imtësi prej shkencave të matematikës, gjeografisë, kimisë, fizikës etj. Jo, Kur'ani është thirrje në rrugën e vërtetë, me të cilën arrihet ndërtimi i njeriut, prandaj me thirrjen e Tij u drejtohet të gjithë njerëzve që ata të arrijnë dituritë për të cilat kanë nevojë. Kur'ani e heq mbulesën prej shumë pjesëve të ndjeshme në përgjigjet e ndryshme shkencore në brendësi të studimeve që trajtojnë çështjen e Teuhidit (besimit se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm), si dhe studimet që trajtojnë çështjet e edukimit. Megjithëse, ky zbulim nuk është qëllimi i mirëfilltë, pasi qëllimi i mirëfilltë i Kur'anit është orientimi i njerëzve drejt besimit se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm (Teuhid), edukimi me mësimet Hyjnore dhe se vetëm ky besim e ky edukim e çon njeriun në brigjet e lumturisë së vërtetë, nëpërmjet arritjes së fitimit të kënaqësisë së të Gjithëpushtetshmit.

Kur'ani Famëlartë herë thekson edhe hollësi të punëve e të çështjeve, ashtu siç ka ardhur në disa ajete kur shpjegohen dispozitat për bërjen me shkrim të kontratave tregtare e të dokumenteve të kreditimit. Madje në ajetin më të gjatë të ajeteve të Kur'anit, pikërisht në ajetin 282 të sures *“El Bekare”*, vetëm për dy

çështjet e lartpërmendura janë përmendur tetëmbëdhjetë dispozita.¹

Herë tjetër, Kur'ani Famëllartë i ekspozon çështjet jetësore të njeriut në format e tyre përgjithësuese, ashtu siç ka ardhur në ajetin 90 të sures "En Nahl": **"All'llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë ndaj të varfërve dhe ndalon imoralitetin, punët e urryera dhe dhunën."**

Gjithashtu, Kur'ani trajton me imtësi çështjen e mbajtjes së besës për premtimin e dhënë, ashtu siç ka ardhur në ajetin 34 të sures "El Isrâ": **"me të vërtetë premtimi ka përgjegjësi"**. Madje, koncepti i mbajtjes së besës në Kur'an shtrihet edhe te kontratat, ashtu siç ka ardhur në ajetin 1 të sures "El Mâide": **"mbani besën për kontratat"**. Edhe domosdoshmëria e kryerjes së detyrimit të luftës në rrugën e All'llahut (xhihâdi – lufta për mbrojtjen e Islamit dhe e lartësisimit të fjalës së All'llahut) është trajtuar në ajetin 78 të sures "El Haxh": **"Luftoni me një luftë të denjë për hir të All'llahut"**. Kur'ani trajton edhe konceptin e drejtësisë, ashtu siç ka ardhur në ajetin 25 të sures "El Hadid": **"që njerëzit t'i përmbahen së drejtës"**. Në Kur'an është trajtuar edhe koncepti i përgjithësisimit të kujdesit për rregullin në të gjitha punët, ashtu siç ka ardhur në ajete 7, 8, 9 të sures "Err Rrahmân": **"Edhe qiellin Ai e ngriti dhe Ai vuri drejtësinë. Që të mos e kaloni kufirin në drejtësi. Mbani drejtësi në peshim dhe mos peshoni mangët."** Në Kur'an është trajtuar edhe koncepti i ndalimit të bërjes së ngatërresave e shkatërtimeve mbi tokë, ashtu siç ka ardhur në ajetin 85 të sures "El A'râf": **"dhe mos bëni ngatërresa e shkatërtime në tokë pas**

¹ Këtë koment lexojë në fundin e ajetit 282 të sures "El Bekare".

përmirësimit të saj", duke shtuar edhe thirrjen për rregullim, për të menduar dhe për të logjikuar, ashtu siç ka ardhur në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë. Shembuj të këtillë prej direktivave përgjithësuese ka shumë në Kur'an dhe këta shembuj kanë ardhur që të jenë fanarë ndriçues në të gjitha fushat e mendimit e të jetës së njeriut. Të gjithë këta shembuj e direktiva në formë urdhri argumentojnë se nuk pranohet as ngurrimi, as dyshimi që Kur'ani Famëlartë është sqarues për çdo send.

I Larti e Filluesi i të gjitha sendeve nuk ka anashkaluar as çështjet dytësore të këtyre urdhrave përgjithësues, por edhe për ato ka përcaktuar çështje që mund të trajtohen me imtësi, ashtu siç e shpjegon këtë çështje për ne ajeti 7 i sures "El Hashr": **"atë që ua jep i Dërguari merreni dhe nga ajo që ai u ndalon lëreni"**.

Njeriu sa më shumë të notojë në oqeanin e Kur'anit Famëlartë dhe sa më shumë të depërtojë në thellësitë e tij, nga ku nxjerr programe e direktiva që e çojnë atë drejt lumturisë, aq më e qartë bëhet për njeriun madhështia e këtij Libri qiellor dhe cilësia e tij gjithëpërfshirëse.

Kushdo që kërkon ligje të tjera dhe e lë Kur'anin, në të vërtetë ai nuk e ka njohur Atë, prandaj kërkon prej një tjetri atë që e ka pranë vetes.

Duke shtuar edhe specifikimin që i bën ajeti i nderuar çështjes së origjinalitetit e të pavarësisë së mësimave islame në të gjitha punët, myslimanët kanë marrë përsipër vazhdimisht përgjegjësinë e studimit e të mësimit në Kur'anin Famëlartë, që të arrijnë të nxjerrin prej Tij gjithçka për të cilën kanë nevojë.

Transmetimet e shumta theksojnë çështjen e kuptimeve gjithëpërfshirëse të Kur'anit në kuadrin e çështjeve që shtrun ky ajet, si dhe ajetet e tjera të ngjashme.

Prej transmetimeve kemi edhe transmetimin e ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “All’llahu i Gjithëfuqishëm me Kur’anin ka zbritur sqarim për çdo send; pasha All’llahun, i Larti s’ka lënë pa sqaruar asnjë send për të cilin kanë nevojë robërit e Tij dhe askush s’ka mundësi të thotë: ‘Sikur kjo të ishte zbritur në Kur’an, sepse All’llahu edhe atë gjë e ka zbritur në Kur’an’”.¹

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Bäkirit (*Paqja qoftë mbi të!*), ai ka thënë: “All’llahu i Gjithëfuqishëm s’ka lënë asnjë send për të cilën ka nevojë ymeti që të mos e ketë zbritur në Kur’an, që të mos ia ketë shpjeguar qartë atë send të Dërguarit të Tij (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Ai për çdo send ka vënë një kufi, për çdo send Ai ka bërë edhe një argument; për atë që e tejkalon këtë kufi, Ai ka bërë edhe masën e dënimit për çdo lloj shkelje”.²

Transmetimet e nderuara që theksojnë këtë çështje, nuk i kuptojnë të gjithë njerëzit drejtpërdrejt prej fjalëve të Kur'anit. Disa fjalë të Kur'anit i kuptojnë në thellësinë e tyre vetëm dijetarët, kurse disa të tjera i kuptojnë të gjithë njerëzit, në një kohë që ana e brendshme e Kur'anit është si një det, të cilit nuk i arrihet fundi. Gjithashtu, në Kur'an ka prej çështjeve e prej diturive, të cilat nuk i kupton askush përveç Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Prej transmetimeve që trajtojnë cilësinë

¹ Tefsiri “Nüruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 74 dhe f. 176.

² Burimi i mësipërm, f. 177.

gjithëpërfshirëse të Kur'anit përmendim transmetimin e ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: "S'ka ndonjë punë për të cilën dy vetë kanë mendime të ndryshme, që ajo fjalë të mos ketë një bazë në Librin e All'llahut të Gjithëfuqishëm, por atë nuk e arrijnë dot mendjet e burrave".¹

Moskuptimin e kësaj pjese të diturive kur'anore prej masës së njerëzve, ne kemi mundësi ta shëmbëllojmë me atë që quhet bota e jositimenteve, e cila nuk pengon lëvizjen nën dritën e botës së sentimenteve. Prandaj, Kur'ani në shumë ajete urdhëron që me dritën e jashtme të kësaj pjese të Kur'anit, të përfitohet prej këtyre diturive.

2- Katër fazat e udhëzimit në rrugën e drejtë

Për të shpjeguar qëllimin e zbritjes së Kur'anit, ajeti i mësipërm ka përmendur katër shprehje që kanë lidhje njëra me tjetrën sipas radhës:

- a- sqarues për çdo send;
- b- udhëzues në rrugën e drejtë;
- c- mëshirë;
- d- përgëzim për myslimanët.

Po të vërejmë me kujdes, patjetër do të gjejmë fare të qartë lidhjen logjike ndërmjet këtyre shprehjeve. Secila prej katër shprehjeve simbolizon një fazë të përcaktuar: faza e parë e

¹ Burimi i mësipërm, f. 75 dhe f. 180.

udhëzimit në rrugën e drejtë, patjetër që kërkon sqarim dhe mësim; pas kësaj vjen faza e udhëzimit, pas udhëzimit në rrugën e drejtë vjen puna që e bën detyrim mëshirën dhe, në fund kemi përgëzimin me shpërblimin e All'llahut për atë që bën punë të mirë, si dhe përgëzimin për shpërblimin e All'llahut për të gjithë ata që ecin në rrugën e të Vërtetit.

Ajeti 90

﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ
الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُم لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ﴾

“All’lillahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë ndaj të afërmve dhe ndalon imoralitetin, punët e urryera dhe dhunën. Ai u këshillon që ju të merrni mësim.”

Komentimi

Programi shoqëror më i plotë

Në ajetet e mësipërme u theksua që Kur’ani është sqarues për çdo send. Në këtë ajet të nderuar paraqitet një program me direktiva islame në lidhje me çështjet sociale, humane dhe morale. Ajeti i nderuar përmban gjashtë baza të rëndësishme. Tri bazat e para janë të karakterit pozitiv dhe All’lillahu urdhëron të punohet me ato, kurse tri bazat e tjera janë veprime negative, prandaj All’lillahu e ndalon njeriun të bëjë veprime të tilla.

Në fillim, ajeti i nderuar thotë: **“All’lillahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë ndaj të afërmve”**.

A është e mundur të përfytyrohet program më i gjerë e më gjithëpërfshirës se drejtësia?!

Drejtësia është ligji rreth të cilit rrotullohen të gjitha sistemet e ekzistencës, madje edhe qiejt e toka kanë bazë drejtësinë (me drejtësi qëndrojnë qiejt dhe toka).¹

Edhe shoqëria njerëzore, kjo pjesëz e tërësisë së madhe të kësaj ekzistence, nuk është jashtë ligjit të drejtësisë. As që mund të përfytyrohet një shoqëri që ka fatin të përmendë paqen e shpëtimit dhe të mos i ketë kriteret e jetës së saj mbi bazat e drejtësisë në të gjitha fushat.

Kuptimi real e konkret i drejtësisë do të thotë kryerja e vënja e çdo pune në vendin e duhur, kurse devijimi, teprimi, lënia mangët, tejkalimi i masës dhe sulmi mbi të drejtat e të tjerëve, nuk janë gjë tjetër përveçse veprime të kundërta me bazën e drejtësisë.

Njeriu konsiderohet i shëndetshëm kur të gjitha gjymtyrët e trupit të tij punojnë në mënyrë normale (pa asnjë shtesë e pa asnjë pakësim). Kur njeriu sëmuret, ne dallojmë tek ai shenjat e pafuqisë dhe të dobësisë menjëherë sapo njëra prej gjymtyrëve të tij të mos punojë në mënyrë normale. Pra ajo gjymtyrë nuk e kryen të plotë funksionin që i është ngarkuar.

Shoqëria njerëzore mund të krahasohet me trupin e njeriut: kur ndodh që njeriu sëmuret ose pëson ndonjë aksident, tek ai prishet sistemi i drejtësisë së trupit të tij.

¹ "Auàlil Leàlij", vëll. 4, f. 102.

Fuqia, madhështia dhe efekti i thellë që ka drejtësia në të gjitha kohët, në kohë të zakonshme e të jashtëzakonshme, në procesin e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë nuk mund të llogaritet. Por drejtësia nuk është elementi i vetëm që e kryen këtë detyrë të rëndësishme, prandaj urdhri për bamirësi ka ardhur menjëherë pas urdhrit për drejtësi, pa asnjë ndarje në kohë.

Thënë më qartë: në jetën e njerëzimit mund të ndodhin gjendje tepër të ndjeshme, në të cilat është e pamundur që problemet të zgjidhen me anë të kërimit të ndihmës vetëm me bazë të drejtësisë, pasi nevoja e kërkon të ndikohet e të ndërhyhet në gjendjen e krijuar, kërkon falje e sakrifica, porse të gjitha këto mund të realizohen vetëm në saje të bamirësisë.

Le të marrim një shembull: një armik i pabesë ka sulmuar një shoqëri, ose ka rënë një tërmet, ose lumenjtë kanë dalë prej shtratit dhe kanë shkaktuar përmytje, ose në disa zona të vendit kanë ndodhur rrebeshe. A është e mundur që këto gjendje të trajtohen duke ndarë në mënyrë të drejtë të gjitha kapacitetet e fondet nëpërmjet zbatimit të ligjeve të zakonshme?! Në këto rrethana patjetër u duhet dhënë përparësi sakrificës dhe stimulimit të kujtdo që ka mundësi financiare, trupore e mendore të japë ndihmesën e tij për të përballuar rrezikun dhe për të eliminuar atë. Përndryshe, rruga përpara armikut është e shtruar që ai të asgjësojë të gjithë shoqërinë ose katastrofat natyrore të shkatërrojnë prona të shumta e të vrasin një numër të madh njerëzish.

Të dyja këto baza, drejtësia dhe bamirësia, janë sunduese edhe në trupin e njeriut në formë natyrore. Në gjendje normale, të gjitha gjymtyrët e trupit të njeriut bashkëveprojnë në mënyrë të ndërsjellë dhe çdo gjymtyrë e trupit kryen funksionin përkatës,

duke kërkuar edhe ndihmën e gjymtyrëve të tjera. Kjo është baza e drejtësisë.

Kur njëra prej gjymtyrëve plagoset ose nuk e kryen dot funksionin e saj, gjymtyrët e tjera jo vetëm që nuk e harrojnë kurrë gjymtyrën që ka humbur fuqinë për të kryer punën e saj, por vazhdojnë furnizimin e saj me ushqim dhe e mbështesin atë. Kjo është baza e bamirësisë.

E njëjta gjë ndodh edhe në shoqëri. Në një shoqëri të shëndoshë patjetër duhet të jenë sunduese këto dy baza, pra drejtësia dhe bamirësia.

Në transmetimet dhe në fjalët e interpretuesve të Kur'anit janë dhënë shpjegime të ndryshme në lidhje me dallimin mes drejtësisë dhe bamirësisë, shumica e të cilave theksojnë atë që thamë më sipër.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Drejtësia është marrja e të drejtës në mënyrë të barabartë, kurse bamirësia është dashamirësi"*,¹ ashtu siç e theksuam më sipër në komentin tonë.

Disa të tjerë kanë thënë se drejtësia është Teuhidi – besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm - kurse bamirësia është kryerja e obligimeve.

Duke u mbështetur në këtë interpretim, rezulton se drejtësia tregon besimin dhe bamirësia tregon punën.

¹ "Nehxhul Belàga", Fjalët e shkurtra, fjala nr. 231.

Të tjerë kanë thënë se drejtësia është harmonizimi mes së jashtmes e së brendshmes, kurse bamirësia tregon se e brendshmja e njeriut është më e mirë se e jashtmjja e tij.

Të tjerë kanë thënë: drejtësia ka lidhje me punët praktike, kurse bamirësia ka lidhje me punët e fesë.

Siç thamë më sipër, disa prej këtyre interpretimeve rreth këtyre dy fjalëve përputhen plotësisht me interpretimin që i bëmë më sipër fjalëve drejtësi dhe bamirësi. Meqenëse këto interpretime nuk janë në kundërshtim me njëri-tjetrin mund të bashkohen me njëri-tjetrin.

Për sa i përket çështjes së frazës së ajetit: **“ndihmë të afërmeve”**, kjo hyn në kuadrin e çështjes së bamirësisë, pasi bamirësia përfshin të gjithë shoqërinë. Ndërsa urdhri për të ndihmuar të afërmit, veçon një grup të vogël prej shoqërisë së madhe, pavarësisht se në ajet ka ardhur fjala *të afërmit*. Duke pasur parasysh se shoqëria e madhe përbëhet prej grupesh, çdo gjë që arrihet te këto grupe, patjetër që ka një koordinim më të shumtë. Efekti i asaj që u arrit në njërin prej grupeve shumë shpejt do të duket në të gjithë shoqërinë. Në këtë gjendje, çështja konsiderohet pjesëtim i drejtë për funksionet e për përgjegjësitë ndërmjet njerëzve, sepse kjo kërkon që çdo grup në radhë të parë të ndihmojë të afërmit e vet, duke pasur parasysh që ndihma të përfshijë të gjithë të pafuqishmit e nevojtarët, të cilët duhet të rrethohen me kujdesin e me interesimin e të afërmeve të tyre që kanë mundësi të ndihmojnë.

Gjithashtu në disa hadithe gjejmë se qëllimi me frazën e ajetit: **“ndihmë të afërmeve”**, qëllimi është për Ehli Bejtin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për

pasardhësit e tij, për Imamët e ruajtur prej mëkateve. Gjithashtu, në transmetime e në hadithe thuhet se qëllimi me këtë frazë të ajetit është plotësimi i detyrimit për të dhënë një të pestën e fitimit. Gjithsesi, qëllimi i shtrirjes së kuptimit të ajetit nuk mund të kufizohet, pasi fjala *të afërmit* është vetëm njëri prej faktorëve që përfshihet në gjerësinë e kuptimit të këtij ajeti, çka tregon se kjo fjalë kurrë nuk ndalon që urdhri i ardhur për ndihmë në këtë ajet të ketë kuptim gjithëpërfshirës.

Nëse do të marrim në konsideratë se kuptimi i fjalës *“dhil kurbà”* - *të afërmit* - reduktohet vetëm te të afërmit, të afërmit e familjes ose të afërmit e fisit, ose të afërm prej anëve të tjera, vetëkuptohet që ajeti ka një kuptim shumë më të gjerë nga ai që ne zakonisht i japim kësaj fjale, sepse ajo përfshin edhe komshiun, miqtë e të ngjashëm me këta, megjithëse me këtë fjalë, zakonisht njihen të afërmit e fisit.

Ndihma për grupe të vogla të afërmish është e bazuar në ndjenjën e dashamirësisë ndaj tyre, në të njëjtën kohë kjo ndihmë është një garanci më shumë që ndihma të shtrihet edhe te të tjerët.

Pasi përmendi në këtë ajet tri bazat pozitive, Kur'ani Famëlartë troket në tri bazat negative që qëndrojnë përballë tyre dhe thotë: **“dhe ndalon imoralitetin, punët e urryera dhe dhunën”**.

Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë kanë folur shumë rreth tri fjalëve *“el fahshàì”*, *“el munkeri”* dhe *“el bag'jì”*, **“imoraliteti”**, **“punët e urryera”**, **“dhuna”**. Duke marrë parasysh kuptimin fjalorik të këtyre tri fjalëve dhe veçantitë që ato shprehin ndaj njëra-tjetrës, bëhet e qartë se fjala *“el fahshàì”* - imoraliteti - tregon për

mëkatet që kryhen në fshehtësi, fjala *“el munkeri”* - punët e urryera – tregon për mëkatet që kryhen sheshit, ndërsa fjala *“el bag’ji”* - dhuna – tregon çdo tejkallim të masës mbi të drejtën e njeriut, padrejtësinë ndaj të tjerëve dhe lartësimin mbi të tjerët.

Disa prej interpretuesve të Kur’anit Famëlartë¹ kanë thënë: burimi i devijimeve morale janë tri forca: forca e epshit, ajo e zemërimit dhe forca djallëzore e iluzioneve.

Forca e epshit nxit te njeriu dëshirën për të plotësuar kënaqësitë e epshit dhe zhytjen në imoralitet; forca e zemërimit e shtyn atë të bëjë punë të urryera, të fyejë të gjithë njerëzit dhe t’u shkaktojë atyre sa më shumë mundim, kurse forca djallëzore e iluzioneve, lind tek ai dëshirën për të qenë mbi të gjithë njerëzit, më lart se të tjerët, lind te njeriu dashurinë për të qenë i parë, të jetë mbi të gjithë dhe të sulmojë të drejtat e të tjerëve.

Filluesi e Krijuesi i të gjitha sendeve, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s’ka nevojë për asgjë, thekson në tre termat e lartpërmendur tiraninë e instinkteve njerëzore, prandaj bën thirrje për të ecur vetëm në rrugën e të Vërtetit, në rrugën e udhëzimit të drejtë. Këtë thirrje e bën me anë të një shpjegimi të veçantë e gjithëpërfshirës për çdo devijim moral.

Në fundin e ajetit të nderuar vjen edhe ritheksimi i rëndësisë së madhe së këtyre gjashtë bazave: **“Ai u këshillon që ju të merrni mësim”**.

¹ Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 20, f. 104.

Ajetet më gjithëpërfshirëse të së mirës e të së keqes

Përmbajtja e këtij ajeti të nderuar është aq ndikuese, sa shumë njerëz për shkak të kuptimeve që përfshihen aty kanë përqaftuar Islamin, pasi në këtë ajet pamë një argument për punën e tyre. Ja për shembull Osman bin Madh'uni, njëri prej shokëve të ngushtë (sahabëve) të të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tregon: “Unë u bëra mysliman ngaqë kisha turp prej të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për shkak të argumenteve të Islamit që ai më vinte përpara. Megjithëkëtë, Islami nuk kishte zënë vend në zemrën time. Një ditë isha pranë tij kur ai ishte duke u menduar, ndërkaq e nguli shikimin në drejtim të qiellit sikur po e pyeste për ndonjë gjë. Kur ai e mori përgjigjen top sekret, unë e pyeta për këtë gjendje të tij dhe ai më tha: ‘Po, ndërsa isha duke biseduar me ty, unë pashë Xhibrilin në ajër dhe ai më erdhi me ajetin: **All'llahu urdhëron drejtësi, bamirësi...**’” dhe e lexoi ajetin për mua deri në fund. Pikërisht në këtë çast Islami hyri në zemrën time, ndërkaq shkova te xhaxhai i tij Ebù Tàlibi, të cilën e njoftova për sa më ngjau dhe ai tha: “O bij të fiseve kurejshë, ndiqeni Muhammedin – (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ai t’ju orientojë në rrugën e drejtë, sepse ai urdhëron të ndiqni vetëm moralet më të nderuara. Më pas shkova te Velid bin El Mugireh, të cilit i lexova ajetin e mësipërm dhe ai tha: ‘Nëse këtë e ka thënë Muhammedi, ka thënë fjalën më të mirë, nëse këtë fjalë e ka thënë Zoti i tij, nuk mund të thuhet fjalë më e mirë’”.¹

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 10, f. 380, fundi i ajetit objekt studimi.

Në një hadith tjetër lexojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se këtë ajet ia ka lexuar Velid bin El Mugireh, i cili i tha: “O djali i vëllait tim¹, përsërite dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e përsëriti. Pastaj, Velidi tha: ‘Në të vërtetë në këtë fjalë ka ëmbëlsi, me të vërtetë mbi këtë fjalë ka bukuri, pjesa e sipërme e kësaj fjale është frutdhënëse, pjesa e poshtme e saj është bollëk, kjo nuk është fjalë njerëzish’”.²

Transmetohet prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Devotshmëria është e mbledhur në fjalën e të Lartit: ‘**All'llahu urdhëron drejtësi, bamirësi**’”.³

Prej këtyre haditheve dhe prej haditheve të tjera mësojmë se ky ajet konsiderohet kushtetutë pune e përgjithshme islame dhe përfaqëson nenet e ligji themelor të Islamit në çdo kohë. Gjithashtu, prej Imam Bäkirit (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai e lexonte këtë ajet të nderuar para përfundimit të hutbes së ditës së Xhuma (këshilla e veçantë për ditën e Premte). Pas hutbes thoshte: “O Zoti im, na bëj prej atyre që marrin mësim dhe mësimi u sjell dobi!”⁴ dhe vetëm pastaj ai zbriste prej minberit.

Zbatimi konsekuent i tri bazave: drejtësi, bamirësi dhe ndihmë të afërmve, si dhe lufta kundër tri devijimeve në rrafsh botëror është garantues që në botë të sundojë e mira, që bota të jetë e qetë prej çdo turbullire dhe të mos ekzistojë e keqja, shkatërrimi e ngatërresa. Transmetohet prej Ibni Mes'ûdit – shok i ngushtë e i

¹ Këtë fjalë e ka thënë sepse ai ishte xhaxhai i Ebû Xhehlit dhe të dy janë kurejshë.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 10, f. 381, fundi i ajetit objekt studimi.

³ Tefsiri “Nûruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 78-196.

⁴ “Usûlul Kâfij”, citim prej tefsirit “Nûruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 77-192.

mirënjohur i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Në Librin e All'llahut, ky është ajeti më gjithëpërfshirës i së mirës e i së keqes”, ashtu siç e përmendëm më sipër.

Përmbajtja e këtij ajeti të nderuar na sjell në mendje hadithin e transmetuar prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në të cilin ai ka thënë: “Dy kategori prej ymetit tim, kur këto dy kategori janë përmirësuar, ymeti im përmirësohet dhe kur ato dy kategori kanë ngatërresa, ngatërrohet e prishet ymeti im”. Atij i thanë: “O i Dërguar i All'llahut, cilat janë këta dy kategori?” Ai tha: “Fukahatë dhe sundimtarët”.

Dijetari i haditheve El Kumm'ij, në librin “Sefijnetul Bihâr” ka përmendur një hadith, të cilin e ka cituar të përcjellë prej të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në të cilin ai ka thënë: “Tri kategorive do t’u flasë zjarri Ditën e Gjykimit: sundimtarit, lexuesit të Kur’ânit dhe të pasurit. Sundimtarit do t’i thotë: ‘Ty që All’llahu të dhuroi pushtet, por ti nuk vure drejtësi dhe e gëlltite atë siç gëlltit zogu farën e susamit!’. I thotë lexuesit të Kur’ânit: ‘Ti që dukeshë i zbukuruar për njerëzit dhe i kundërviheshë All’llahut me mëkate’, e përpin dhe këtë!. I thotë të pasurit: ‘Ty All’llahu të dhuroi pasuri të shumta dhe kur i mjeruari të kërkonte borxh, ti nuk i dhe atij asgjë, ngaqë ishte koprrac’ dhe e përpin edhe atë!’”.

Çështjen e drejtësisë duke e konsideruar njërën prej kolonave të Islamit, ne e kemi trajtuar gjatë komentimit të ajetit 8 të sures “El Mâide”.

Ajetet 91 - 94

﴿وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا
وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ عَلَيْكُمْ كَفِيلًا إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ﴾^{٩١} وَلَا
تَكُونُوا كَالَّذِي نَقَضَتْ غَزْلَهَا مِنْ بَعْدِ قُوَّةٍ أَنْكَاثًا تَتَّخِذُونَ
أَيْمَانَكُمْ دَخَلًا بَيْنَكُمْ أَنْ تَكُونَ أُمَّةٌ هِيَ أَرْبَى مِنْ أُمَّةٍ إِنَّمَا
يَبْلُوكُمُ اللَّهُ بِهِ وَلِيُبَيِّنَ لَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ^{٩٢}
وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ يُضِلُّ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي
مَنْ يَشَاءُ وَلِتُسْأَلُنَّ عَمَّا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ^{٩٣} وَلَا تَتَّخِذُوا أَيْمَانَكُمْ
دَخَلًا بَيْنَكُمْ فَتَزِلَّ قَدَمٌ بَعْدَ ثُبُوتِهَا وَتَذُوقُوا السُّوءَ بِمَا صَدَدْتُمْ عَنْ
سَبِيلِ اللَّهِ وَلَكُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ^{٩٤}﴾

“Mbajeni besën që i keni dhënë All’lilahu dhe mos i shkelni betimet tuaja, të cilat më parë i keni vërtetuar dhe mbi veten tuaj keni bërë garant All’lilahun; me të vërtetë All’lilahu i din punët që ju bëni.”

“Mos u bëni si ajo (gruaja) që e prish fillin që ka tjerre e dredhur fort dhe t’i përdorni betimet tuja për mashtrime në mes jush, për shkak se njëri popull është më i madh se tjetri; me këtë All’lilahu

u sprovon dhe Ditën e Gjykimit, Ai patjetër do të sqarojë punët rreth të cilave ju kishit kundërshtime.”

“Sikur të dëshironte All’llahu, do t’ju bënte në një fe të vetme, porse Ai çon në rrugën e humbjes atë që dëshiron dhe udhëzon në rrugën e drejtë atë që dëshiron; patjetër ju do të përgjigjeni për punët që keni bërë.”

“Mos i përdorni betimet tuaja për mashtrim në mes jush e të rrëshqisni pasi i keni vërtetuar ato dhe të shijoni të keqen (e dredhisë) ngaqë penguat (të tjerët) nga rruga e All’llahut, pasi (për këtë shkak) do të pësoni një dënim shumë të rëndë.”

Shkaku i zbritjes

Interpretuesi i dëgjuar i Kur’anit Famëlartë, Et Tabresij, në tefsirin “Mexhmaul Bejân”, thotë se shkaku i zbritjes së ajetit të parë të këtij grupi ajetesh janë ata që i dhanë besën Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se e kishin pranuar Islamin (ka mundësi që disa prej atyre nuk e mbajtën besën që dhanë për shkak të numrit të vogël të myslimanëve dhe numrit të madh të idhujtarëve). Në këtë ajet i Gjithëfuqishmi u flet atyre drejtpërdrejtë dhe u thotë të mos u shtyjë që të thyeni besën e dhënë numri i paktë i myslimanëve dhe numri i madh i idhujtarëve.

Komentimi

Mbajtja e besës së dhënë është argument që vërteton besimin

Pasi paraqiti në ajetet e kaluara disa prej bazave kryesore të Islamit (drejtësinë, bamirësinë e të ngjashme me këto të dyja), në këto ajete Kur’ani Famëlartë bën fjalë për një pjesë tjetër prej mësimëve të rëndësishme të Islamit (mbajtja e besës së dhënë dhe mosshkelja e betimeve).

Për të gjitha këto, Kur’ani Famëlartë vazhdon fjalën e tij: **“por Ai çon në rrugën e humbjes atë që dëshiron dhe udhëzon në rrugën e drejtë atë që dëshiron”**.

Megjithëse as udhëzimi Hyjnor në rrugën e drejtë, as çuarja në rrugën e humbjes, nuk e heq përgjegjësinë prej jush, pasi ajo do të rëndojnë mbi ju që në hapat tuja të parë, ashtu si ka ardhur në njoftimin e All’llahut: **“patjetër ju do të përgjigjeni për punët që keni bërë”**.

Kjo frazë tregon se hedhja e punëve të njerëzve mbi ata që i kanë bërë ato punë, përforcon faktin se vetë njerëzit do të mbajnë përgjegjësinë për to. Gjithashtu, kjo frazë konsiderohet prej elementeve të qarta krahasuese në komentin e dy fjalëve Hyjnore: udhëzim në rrugën e drejtë (hidàjet) dhe çuarje në rrugën e humbjes (idlàl). Kjo frazë tregon se asnjëra prej këtyre dy fjalëve që tregojnë dy gjendje të kundërta, kurrë s’kanë në brendinë e tyre gjurmë të imponimit.

Këtë çështje e kemi trajtuar edhe më parë. (Referojuni komentit të ajetit 26 të sures “El Bekare”).

Duke e vënë theksin mbi çështjen e mbajtjes së fjalës për marrëveshjen e lidhur dhe mbajtjen e betimeve (duke e konsideruar këtë prej elementeve shumë të rëndësishme në qëndrueshmërinë e shoqërisë), Kur’ani Famëlartë thotë: **“Mos i përdorni betimet tuaja për mashtrim në mes jush”**. Domethënë: mos i përdorni betimet tuaja si mjete për të mashtruar dhe për hipokrizi, sepse në të dyja këto veprime ka rreziqe shumë të mëdha:

rreziku i parë: “e të rrëshqisni pasi i keni vërtetuar ato”. Në të vërtetë, ai që firmos një marrëveshje ose artikulon një betim me qëllim që të mos i qëndrojë as marrëveshjes, as betimit, shumë shpejt nuk do të jetë më i besueshëm te njerëzit. Ata as nuk do të bazohen në besën e dhënë prej tij, as nuk do të besojnë në betimin e tij. Një njeri i tillë përngjan me atë që vë këmbën mbi një tokë që i duket e fortë e kompakte, kurse në realitet ajo është një rrëshqitë, për rrjedhojë do të jetë shkak për rrëshqitjen e për rrëzimin e tij;

rreziku i dytë: “dhe të shijoni të keqen (e dredhisë) ngaqë penguat (të tjerët) nga rruga e All’liahut”, në këtë botë dhe në Tjetrën: “do të pësoni një dënim shumë të rëndë”.

Prej efekteve negative të thyerjes së marrëveshjes së lidhur dhe mosmbajtjen e betimeve është mendimi i keq që do të formojnë njerëzit për fenë e vërtetë dhe largimin prej saj, prishja e radhëve (unitetit) në mes myslimanëve dhe humbja e besimit, deri në atë shkallë sa njerëzit nuk do të kenë dëshirë për Islamin. Nëse do të lidhin me ju ndonjë marrëveshje, nuk do ta ndiejnë veten të detyruar ta respektojnë atë. Kjo gjendje pa dyshim që çon në të

këqija e në ngatërresa të shumta, si dhe në daljen sheshit të një gjendje prapambetjeje në jetën e kësaj bote.

Pa dyshim që prishja e marrëveshjeve dhe mosmbajtja e betimeve do të jetë shkak për dënimin e për ndëshkimin e All'Ilahut në Botën Tjetër.

Dy Hulumtime

1- Filozofia e respektimit të marrëveshjes

Dihet se besimi i ndërsjellë mes individëve të shoqërisë përbën kolonën më të rëndësishme të kompaktësisë së shoqërisë. Besa e ndërsjellë mes njerëzve është prej kolonave të formimit të shoqërisë, në daljen e saj prej gjendjes së individualistëve dhe dhënien e saj cilësinë e kolektivit. Në origjinë, besimi i ndërsjellë konsiderohet mbështetësi më i fuqishëm për kryerjen e aktiviteteve shoqërore dhe e bashkëpunimit të ndërsjellë në një rrafsh edhe më të gjerë.

Besa e dhënë e sanksionuar në marrëveshje, si dhe betimi janë prej përforcuesve të kësaj lidhjeje e të këtij besimi. Kur përfytyrojmë një shoqëri në të cilin thyerja e besës së dhënë është sunduese, kjo do të thotë mungesë besimi në formë të përgjithshme në atë shoqëri. Gjithashtu, do të thotë se kjo shoqëri shumë shpejt do të shndërrohet në një shoqëri individësh të shpërndarë, në një shoqëri në të cilën ka humbur lidhja e ndërsjellë, fuqia dhe efikasiteti shoqëror.

Për të gjitha këto, ne shohim se ajetet e Kur'anit dhe hadithet e nderuara i kushtojnë një rëndësi të madhe çështjes së respektimit të marrëveshjeve të lidhura, mbajtjes së besës dhe zbatimit të betimeve. Prandaj, prishja e marrëveshjeve, thyerja e besës së dhënë dhe moszbatimi i betimeve konsiderohen prej mëkateve të mëdha.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka theksuar rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje në kohën e Islamit dhe në kohën e injorancës para Islamit. Ai e ka konsideruar prej çështjeve më të rëndësishme, ashtu siç del qartë në fjalën që i tha Màlik ibn Eshterit në kohën kur po i jepte detyrën: “S’ka ndonjë obligim më të madh me të cilin All’llahu i ka ngarkuar njerëzit sesa detyrimi që ata të jenë së bashku, megjithëse pasionet e mendimet e tyre nuk janë të bashkuara; gjithashtu edhe obligimi për respektimin e zbatimin e marrëveshjeve me jomyslimanët, si detyrim për palët në marrëveshje, për shkak të pësimeve që kanë ardhur prej pasojave të tradhtisë e të pabesisë”.¹

Në dispozitat e luftërave islame gjejmë se dhënia e sigurisë qoftë edhe nga ana e një individi të vetëm prej ushtrisë së myslimanëve një personi armik ose një reparti prej reparteve të armikut, e bën detyrim që siguria e dhënë të respektohet prej të gjithë myslimanëve!

Historianët dhe interpretuesit e Kur'anit kanë thënë se nga tërësia e punëve që i kanë bërë shumë njerëz në fillimet e Islamit të përqafojnë këtë fe të madhe Hyjnore, ka qenë pikërisht përkushtimi i vendosur i myslimanëve për të zbatuar marrëveshjet e

¹ “Nehxhul Belàga”, mesazhi nr. 53.

dokumentet e ndryshme, si dhe kujdesi i tyre për mbajtjen e betimeve që ata bënin.

Rëndësia e madhe që ka respektimi i marrëveshjeve dhe mbajtja e betimeve del e qartë edhe në fjalën që tha Selman Farisiu: “Ky ymet do të shkatërrohet nga mosrespektimi i marrëveshjeve të tij”.¹

Kjo do të thotë se respektimi i marrëveshjeve e i dokumenteve sjell fuqi, mirësi e përparim, kurse mosrespektimi dhe prishja e tyre sjell pafuqi, pamundësi e shkatërrim.

Në historinë islame lexojmë se kur myslimanët triumfuan mbi ushtrinë e sasanidëve gjatë kohës së kalifit të dytë, zunë rob edhe Hermazànin, komandantin e ushtrisë së persianëve, të cilin e sollën tek Omeri, i cili i tha Hermazanit: “Çfarë argumenti dhe justifikimi ke për thyerjen e marrëveshjes nga ana jote herë pas here?

Ai tha: “Kisha frikë se do të më vrisje para se të njoftoj”.

Omeri i tha: “Për këtë mos ki frikë”; ai kërkoi ujë për të pirë dhe i sollën ujë në një enë të madhe.

Ai tha: “Do të vdes nga etja, pasi s’kam mundësi të pi me një enë si kjo!” I sollën një enë tjetër, të cilën ai e pëlqeu.

Përsëri tha: “Kam frikë se do të vritem duke pirë ujë”.

Omeri i tha: “Mos ki frikë derisa të pish ujë” dhe i përmbys gotën.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 6 f. 686, fundi i ajetit objekt studimi.

Omeri urdhëroi: “Mbusheni gotën përsëri dhe mos i bëni bashkë për atë vrasjen dhe etjen”.

Ai tha: “Unë nuk kisha nevojë për ujë, në të vërtetë me ujin desha të marr sigurinë për jetën time”.

Omeri i tha: “Unë do të të vras”.

Ai tha: “Ti më dhe siguri”.

Omeri i tha: “Gënjen!”.

Enesi tha: “Ai tha të vërtetën o Prijës i Besimtarëve, ti e sigurove atë”.

Omeri tha: “O Enes, unë të siguroj vrasësin e Muxhze’eh bin Theur dhe të Beràë bin Màlik! Pasha All’llahun, patjetër të më gjesh një rrugëdalje, ndryshe do të të dënoj ty!”.

Enesi i tha: “I the: ‘Mos ki frikë derisa të më njoftosh dhe mos ki frikë derisa të pish ujë’”.

Të njëjtat fjalë thanë edhe ata që u ndodhën aty.

Atëherë Omeri i afrohet Hermazànit dhe i thotë: “Më mashtrove, pasha All’llahun, unë nuk mashtroj deri sa ti të pranosh Islamin” dhe ai u bë mysliman.¹

¹ “El Kàmilu fit’tàrijkh”, vëll. 2, f. 594.

Çfarë nuk pranohet në prishjen e marrëveshjeve

E keqja e madhe e prishjes së marrëveshjeve qëndron në faktin se askush nuk ka gatishmërinë të mbajë me çiltërsi përgjegjësinë, me përjashtim të disa njerëzve të rrallë, pasi prishësi i marrëveshjes për të justifikuar punën e tij nuk lë justifikim pa sjellë, pavarësisht se ai mund të jetë shumë i dobët për të justifikuar veprimin e tij. Ajetet e mësipërme përmendën edhe një model për këtë, kur njoftuan se disa myslimanë u përpoqën të justifikoheshin me argumente të pafuqishme, si për shembull numri i madh i armiqve dhe numri i vogël i besimtarëve, për të justifikuar thyerjen e marrëveshjes që kishin me All'llahun dhe me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Qëndrimet e tyre ishin të lëkundshme, në një kohë kur shumica numerike në të vërtetë nuk përbën forcën e vërtetë. Në historinë njerëzore njihet edhe fitorja e pakicës besimtare mbi shumicën jobesimtare, edhe nëse supozojmë që armiku arrin të disponojë forca e fuqi, përsëri as ky nuk është justifikim i pranueshëm për prishjen e marrëveshjes. Nëse do të shikojmë me imtësi në realitetin e kësaj çështjeje, patjetër do të konstatojmë se ky lloj justifikimi në të vërtetë është një lloj idhujtarie e injorance ndaj All'llahut të Gjithëfuqishëm.

Në kohën e sotme, kjo çështje është konkretizuar në një formë tjetër.

Një pjesë e shteteve të vogla islame, në të vërtetë kanë hequr dorë prej detyrës së tyre për të ndihmuar besimtarët për shkak të frikës prej supershteteve kolonialiste. Me fjalë të tjera, në llogaritë e tyre i japin përparësi fuqisë së dobët njerëzore kundrejt fuqisë absolute të All'llahut. Ata nuk shkojnë të strehohen tek All'llahu, kanë frike prej një tjetri dhe jo prej All'llahut. Por me qëndrime të

këttilla kanë prishur marrëveshjen me Krijuesin e tyre dhe, kuptohet qartë se të gjitha këto lloje qëndrimesh s'janë as më shumë, as më pak se sa mbeturina të idhujtarisë dhe adhurimit të idhujve.

Ajetet 95 - 97

﴿وَلَا تَشْتَرُوا بِعَهْدِ اللَّهِ ثَمَنًا قَلِيلًا إِنَّمَا عِنْدَ اللَّهِ هُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ﴾^{٩٥} مَا عِنْدَكُمْ يَنْفَدُ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ بَاقٍ وَلَنَجْزِيَنَّ الَّذِينَ صَبَرُوا أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ^{٩٦} مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّن ذَكَرٍ أَوْ أَنَّىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيَاةً طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ^{٩٧}﴾

“Mos e shitni besën e dhënë All’l-lahut për një vlerë të paktë; ajo që do të keni tek All’l-lahu është shumë më e mirë për ju, nëse ju e dini.”

“Ajo që keni ju, është e përkohshme, kurse ajo që është tek All’l-lahu është e përjetshme; Ne do të shpërblejmë ata që duruan me më të mirën e saj që ata punuan.”

“Ai që bën punë të mirë, mashkull ose femër, dhe është besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë e Tjetrën) do t’i japim edhe shpërblimin më të mirë për punët që kanë bërë.”

Shkaku i zbritjes

Interpretuesi i dëgjuar i Kur'anit, dijetari i madh Et Tabresij, ka cituar prej Ibni Ab'bàsit fjalën e tij: "Një burrë prej Hadremeuti i quajtur Ijdàn El Eshreu tha: 'O i Dërguar i All'llahut, Imrul Kajs El Kendij e kam komshi në tokat e mia, ai shkëputi një pjesë prej tyre dhe kështu ato toka nuk i kam më; njerëzit e dinë që unë them të vërtetën, por ai tek ata është më i nderuar se unë'. I Dërguari i All'llahut pyeti Imrul Kajsin për këtë çështje, i cili tha: 'Nuk e di se ç' thotë, prandaj për çështjen e tij duhet të betohet'. Ijdàni tha: 'Ai është mëkatar dhe nuk e ka për gjë të betohet'; por ai i tha: 'Nëse nuk ke dëshmitarë, atëherë prano betimin e tij' dhe kur ai u ngrit të betohej, unë po e shikoja atë me qëllim që ta ndihmoja. Ndërkaq zbriti ajeti: **'Mos e shitni besën e dhënë All'llahut'** dhe, kur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i lexoi të dyja ajetet, Imrul Kajsi tha: 'Ajo që kam, do të zhduket dhe ky thotë të vërtetën, unë i kam marrë tokë këtij, por nuk e di sa i kam marrë, prandaj ky le të marrë prej tokës time sa të dëshirojë ose të marrë aq tokë sa pretendon se unë i kam marrë së bashku me frutat që unë kam ngrënë prej frutave të tokës që i mora këtij!'. Ndërkaq zbriti edhe ajeti vijues: **'ai që bën një punë të mirë...'**."

Komentimi

Çmimi i jetës së mirë

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh thekson të keqen e thyerjes së marrëveshjeve herë pas here, gjithashtu bën të qartë edhe të keqen e sjelljes së argumenteve të dobëta për të justifikuar prishjen e marrëveshjeve. Ajetet e mësipërme trajtuan justifikimin e frikës prej shumicës së armiqve, ndërsa ky ajet trajton justifikimet me natyrë të interesit personal (interesat materiale), të cilat kanë efekte negative mbi jetën e njeriut.

Për këtë, ajeti thotë: **“Mos e shitni besën e dhënë All’llahut për një vlerë të paktë.”**

Domethënë se çmimit të mbajtjes së besës së dhënë All’llahut nuk mund t’i afrohet asnjë çmim. Edhe nëse ju keni në dorë të gjitha pasuritë e botës, përsëri as kjo pasuri, si vlerë nuk mund të jetë e barabartë qoftë edhe vetëm për një çast me mbajtjen e besës së dhënë All’llahut.

Për të argumentuar këtë çështje, ajeti i nderuar shton: **“ajo që do të keni tek All’llahu është shumë më e mirë për ju, nëse ju e dini”**.

Kur’ani Famëlartë në ajetin vijues shpjegon qartë shkakun e kësaj përparësie me fjalën e tij: **“Ajo që keni ju, është e përkohshme, kurse ajo që është tek All’llahu është e përjetshme”**, sepse të mirat materiale, edhe nëse nga ana e jashtme duken shumë, në të vërtetë janë si flluska sapuni mbi sipërfaqen e ujit. Në një kohë që dënimi e shpërblimi i Zotit buron prej vetë Qenies absolute të

All'Ilahut, Qenies më të pastër, Qenies më të lartë, Qenies më të mirë se të gjitha qeniet e sendet.

Në vijim Kur'ani shton: **“Ne do të shpërblejmë ata që duruan”** – veçanërisht për qëndrueshmërinë e tyre në mbajtjen e besës dhe të betimeve - **“me më të mirën e saj që ata punuan”**.

Fjala e Kur'anit *“biahseni”* - *më të mirën* – është një argument që tregon se punët e tyre të mira nuk janë të gjitha në një shkallë të vetme. Domethënë se disa punë të tyre janë të mira dhe disa të tjera janë më të mira, por All'Ilahu i Lartësuar i shpërblen të gjitha punët e mira me më të mirën e asaj që ata punuan. Ja, kjo është pika më e lartë e dashamirësisë dhe e mëshirës Hyjnore. Këtë fakt le ta ilustrojmë me një shembull të ngjashëm nga jeta jonë: një shitës ekspozon lloje mallrash me cilësi të ndryshme, një pjesë e tyre janë të llojit të mirë, një pjesë nuk janë prej llojit të mirë, ka edhe mallra që nga ana e cilësisë nuk janë as të mira, as të këqija, por që blerësi i merr të gjitha me çmimin e llojit të mallit të mirë!

Edhe fraza e ajetit thotë: **“Ne do të shpërblejmë ata që duruan...”**, nuk mund të mos tregojë se durimi e qëndrueshmëria gjatë ecjes në rrugën e bindjes, veçanërisht ruajtja e besës për marrëveshjen e bërë dhe për mbajtjen e betimeve, janë prej punëve më të mira të njeriut.

Prej Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: *“Durimi ndaj besimit është si koka ndaj trupit, s'ka të mirë në trupin pa kokë dhe s'ka besim kur së bashku me atë nuk është durimi”*.¹

¹ “Nehxhul Belàga”, Fjalët e shkurtra, nr. 82.

Më pas Kur'ani Famëlartë shpjegon - në formën e një ligji universal – se njeriu për punët e mira që kryen të shoqëruara me besimin (imàn), patjetër që shpërblimin më të mirë do ta ketë në këtë botë e në Tjetrën, ashtu siç njofton ajeti: **“Ai që bën punë të mirë, mashkull ose femër, dhe është besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë e në Tjetrën), do t’i japim edhe shpërblimin më të mirë për punët që kanë bërë.”**.

Bazuar mbi këtë ajet, kriteri matës i punës së mirë është: punët e mira janë ato që dalin prej besimit, pa asnjë kusht nga ana e moshës, e gjinisë, e pozitës shoqërore ose të ngjashme me këto.

Edhe fraza e ajetit **“jetë të mirë”** në këtë botë është rezultati natyral për punën e mirë që ka buruar prej besimit. Pra, shoqëria njerëzore do të bëjë një jetë të qetë e të sigurt, të mbushur me mirëqenie, paqe, dashuri e bashkëpunim të ndërsjellë, jetë të mirë në të gjitha kuptimet. Për rrjedhojë, ajo do të jetojë e sigurt prej vuajtjeve e dhimbjeve të shkaktuara nga mendjemadhësia, padrejtësia, tirania, adhurimi i pasioneve dhe egoizmi, sëmundje që e kanë mbuluar botën me errësi.

Ashtu siç u tha më sipër në komentimin e kësaj fraze, All’llahu i Lartësuar do t’i shpërblejë ata me më të mirën e asaj që ata punuan.

Hulumtime

1- Burimet e përjetësisë

Nga natyra e saj lëndore, jeta në këtë botë do të asgjësohet dhe do të shkatërrohet me gjithçka që gjendet në të: ndërtesat më të forta, qeveritë më jetëgjata, njerëzit më të fuqishëm. Të gjitha këto në fundin e punës së tyre do të bëhen të pafuqishëm e do të asgjësohen, me fjalë të tjera, çdo send pa asnjë përjashtim është i ekspozuar të shkatërrohet.

Nëse qeniet do të kishin mundësi të gjenin për veten e tyre një lloj lidhjeje me të Gjithëfuqishmin i dëlirë nga mangësitë, të punonin për veten e tyre dhe në rrugën e tyre, do të kishin cilësinë e përjetësisë, sepse vetëm Qenia e pastër e Zotit është e përhershme dhe çdo gjë që del prej kësaj arrin cilësinë e përjetësisë.

Punët e mira janë të përhershme, dëshmitarët që i vërtetojnë ato janë: Profetët, dijetarët, të singertët dhe ata që luftojnë në rrugën e All'llahut. Të gjithë këta do të përmenden përgjithmonë në kujtesën e historisë.

Pikërisht për të gjithë këta, ajetet e mësipërme na kujtojnë dhe na bëjnë thirrje që të shpëtojmë prej zhdukjes e asgjësimit pjesët thelbësore të ekzistencës sonë dhe t'i depozitojmë ata në arkën mbi të cilën nuk zgjatet dora e kohës, ku nuk i asgjësojnë as netët, as ditët.

Prandaj ejani të derdhim të gjitha kapacitetet në rrugën e All'llahut dhe në shërbim të krijesave të All'llahut, ejani të fitojmë kënaqësinë e të Gjithëfuqishmit dhe të bëhemi prej vërtetuesve të

frazës së ajetit: “**tek All’llahu**”, që ajo të jetë e qëndrueshme, sipas kërkesës së ajetit: “**ajo që është tek All’llahu, është e përjetshme**”.

Transmetohet prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Kur njeriu vdes (në tekst: biri i Ademit) puna e tij ndërpritet, përveçse në tri: një sadaka vijuese, një dituri prej së cilën përfitohet dhe një djalë i mirë i cili lutet për atë”.¹

Prej Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: “Sa e madhe është distanca ndërmjet dy punëve: një punë, kënaqësia për të cilën kalon dhe mbeten pasojat e saj, si dhe një punë, ushqimi i së cilës shkon dhe pritet shpërblimi për atë punë”.²

2- Barazia mes burrit dhe gruas

Pa dyshim që mes burrit e gruas ka dallime e ndryshime fizike e shpirtërore. Janë këto dallime që i bëjnë ata të ndryshëm nga njëri-tjetri në detyrat e tyre dhe në punët shoqërore që kryejnë. Por natyra e ndryshimeve ekzistuese mes burrit e gruas nuk pasqyrohet në personalitetin njerëzor, prandaj s’ka asnjë ndryshim mes pozitës së burrit e asaj të gruas tek All’llahu i Lartësuar. Nga kjo anë që të dy janë të barabartë, prandaj si për burrin, ashtu edhe për gruan ka një matës të vetëm, i cili është: besimi, puna e mirë, devotshmëria dhe mundësia e barabartë si për burrin, edhe për gruan.

¹ “El Irshad” i Ed Dejlemij’jit.

² “Nehxhul Belàga”, Fjalët e shkurtra, nr. 121.

Ajetet e mësipërme e shpjegojnë këtë të vërtetë për ne me qartësi të plotë dhe mbyllin gojët dyshuese në të kaluarën e në të tanishmen në lidhje me natyrën njerëzore të gruas. Gjithashtu i përgjigjen fuqishëm të gjithë atyre që i japin gruas një pozitë më të ulët nga ana njerëzore në raport me burrin. Ajetet e Kur'anit kanë shpallur sheshit logjikën e Islamit në lidhje me këtë çështje shoqërore shumë të rëndësishme dhe na thonë: “Në të vërtetë, Islami është e kundërta e mendjeshkurtërve që thonë se feja e grave nuk është në të njëjtën masë me fenë e burrave”.

Mirëpo kushdo që bën punë të mirë dhe është besimtar, qoftë burrë apo grua, për atë do të ketë një jetë të mirë. Punëmiri do të arrijë shpërblimin e All'llahut pa asnjë dallim e pa asnjë përparësi mes dy gjinive, përveçse kur njëri ka përparësi mbi tjetrin nga ana e besimit dhe e punës së mirë.

3- Rrënjët e punës së mirë vaditen prej besimit

Puna e mirë është një term me kuptim të gjerë, që përfshin në brendinë e vet të gjitha punët pozitive, të dobishme e konstruktive në të gjitha rrafshet e jetës shkencore, kulturore, ekonomike, politike, ushtarake etj.

Gjithashtu, puna e mirë përfshin shpikjen për të cilin shkencëtari ka derdhur mundin e tij gjatë shumë viteve, me qëllim që t'i shërbejë njerëzimit; përfshin luftën e dëshmorit, i cili e ka vënë shpirtin e tij në pëllëmbën e dorës së vet dhe ka dalë të luftojë aty ku zhvillohet beteja ndërmjet së vërtetës e së gabuarës. Në këtë betejë, ai derdh gjakun e tij të shtrenjtë në rrugën e All'llahut. Termi *punë e mirë* përfshin edhe dhimbjet që përballon nëna besimtare

gjatë lindjes së fëmijës, pa përmendur përballimin e vështirësive që i dalin asaj për edukimin e për rritjen e fëmijëve të saj. Puna e mirë përfshin edhe vuajtjet e dijetarëve për hartimin e librave të tyre shumë të çmuar.

Puna e mirë përfshin edhe punët më të mëdha, si mbajtja e mesazhit të profetësisë; përfshin edhe punët më të vogla, siç është heqja e një guri të vogël prej rrugës mbi të cilën ecin këmbësorët. Po, të gjitha sa u përmendën hyjnë në konceptin e punës së mirë.

Në këtë gjendje përballemi me pyetjen: “Përse puna e mirë është kushtëzuar me besimin, në një kohë kur është e mundur që puna e mirë të kryhet edhe pa këtë kusht? A ka fusha të veprimtarisë njerëzore dëshmi që na e tregojnë këtë?”

Përgjigjja konsiston në sqarimin e një çështjeje të vetme, që është motivi i besimit. Nëse ky motiv nuk arrihet, në shumicën e rasteve punët do të jetë të ndotura (kjo rregull e përgjithshme mund të ketë disa përjashtime të shpërndara këtu e atje), ndërsa kur rrënjët e pemës së punës së mirë vaditen prej ujit të “Teuhidit” (besimit se All’llahu është Zoti Një e i Vetëm), vetëm rrallëherë kjo punë mund të preket prej sëmundjeve të këtilla, si: pëlqimi i vetes, hipokrizia, arroganca, ndërrimi i mendjes, përmendja e së mirës etj. Prandaj, gjejmë se Kur’ani Famëlartë në shumicën e rasteve e ka përmendur punën e mirë së bashku me besimin, patjetër për shkak të lidhjes që ekziston realisht ndërmjet punës së mirë dhe besimit.

Këtë çështje po e bëjmë edhe më të qartë me shembullin vijues: nëse supozojmë se dy persona kanë qëllim të ndërtojnë një spital, njëri prej tyre e ndërmerr këtë nismë nisur nga motivi hyjnor për t’u shërbyer njerëzve, kurse qëllimi i të dytit është që ai të duket

me punën e mirë, falë së cilës të bëhet person i dëgjuar dhe të gëzojë një pozitë shoqërore të nderuar.

Në shikimin e parë dhe me një mendim sipërfaqësor, kemi mundësi të themi: spitali do të ndërtohet dhe shumë shpejt njerëzit do të përfitojnë prej punës së atyre dy vetëve në mënyrë të barabartë. Në këtë gjendje është plotësisht e vërtetë se njëri prej atyre të dyve do të arrijë shpërblimin e All'llahut, kurse tjetri nuk do të arrijë këtë shpërblim, megjithëse në punën e secilit prej tyre s'ka asnjë ndryshim.

Ashtu siç thamë, ky konkluzion ishte rezultat i një shikimi sipërfaqësor mbi këtë çështje. Por, nëse do të thellohemi do të vërejmë patjetër se ata të dy ndryshojnë nga shumë anë. Për shembull, personi i parë për ndërtimin e spitalit do të zgjedhë një vend që të jetë sa më afër shtresave të varfra e të privuara, mbase vendi që ai do të zgjedhë për ndërtimin e spitalit do të jetë në ndonjë lagje të panjohur, kurse personi i dytë do të synojë të zgjedhë një zonë sa më të dëgjuar, edhe pse ajo zonë mund të mos ketë fare nevojë për një spital më shumë ose nevoja për atë spital në atë zonë do të jetë fare e vogël.

Personi i parë mundohet të zgjedhë materialet e ndërtimit dhe ka parasysh që ato materiale të shërbejnë për një të ardhme të largët, që themeli i ndërtesës të qëndrojë për shumë vite. Personi i dytë do të përpiqet që ndërtimi të mbarojë brenda një kohe sa më të shkurtër, që ai të shpejtojë hapjen e spitalit, bën shumë zhurmë dhe e reklamon këtë spital, me synimin që të arrijë qëllimin e tij. Personi i parë kujdeset që edhe punimet e brendshme të spitalit të jenë më cilësore, në një kohë që personi i dytë interesohet vetëm për pamjen e jashtme të spitalit, që ai të duket sa më luksoz. Edhe kur

të vijë puna për përzgjedhjen e personelit mjekësor që do të punojnë në këtë spital, mjekë, infermierë e të gjithë personelin e duhur për funksionimin e spitalit, përsëri do të vërejmë një ndryshim shumë të madh mes atyre dy personave: ndryshimi i qëllimit e lë efektin e vet në të gjitha fazat e punimeve, pra, puna do të marrë ngjyrën e qëllimit.

4- Cila është jeta e mirë?

Interpretuesit e Kur'anit në lidhje me kuptimin e frazës së ajetit *jetë e mirë*, kanë dhënë disa komente: disa e kanë komentuar me kuptimin e furnizimit hallall; të tjerë e kanë komentuar me kuptimin e kënaqësisë me atë që ka; të tjerë e komentuar me kuptimin e furnizimit të përditshëm; të tjerë e kanë komentuar me kuptimin e adhurimit krahas furnizimit hallall.

Disa të tjerë e kanë komentuar me kuptimin e përshtatshmërisë në bindje të urdhrave të All'llahut. Kanë dhënë edhe komentime të tjera të ngjashme.

Mendojmë se nuk është e nevojshme të kujtojmë se kuptimi i togfjalëshit *jetë e mirë* është shumë më i gjerë nga kuptimet që u përmendën, pasi i bashkon të gjitha ato. Në *jetën e mirë* s'ka ndotje, s'ka padrejtësi, tradhti, armiqësi, poshtërim, asnjë lloj dhimbjeje e asnjë brengë; në *jetën e mirë* është gjithçka që e bën jetën e njeriut si uji i kulluar që del prej burimit pa asnjë papastërti.

Duke theksuar konstatimin e ajetit në lidhje me shpërblimin Hyjnor në përputhje me punët më të mira, arrijmë të kujtojmë se

jeta e mirë ka lidhje me këtë botë, kurse shpërblimi me *më të mirën* ka lidhje me Botën Tjetër.

Kur Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me fjalën e të Lartit: **“Ne do t’i japim atij një jetë të mirë”**, ai tha: “Kjo është kënaqësia me atë që njeriu ka”.¹

S’ka dyshim që ky komentim nuk nënkupton reduktimin e kuptimit të *jetës së mirë* me kënaqësinë, pasi shpjegimi edhe vetëm me njërin prej vërtetuesve të saj, është shumë i qartë. Nëse njeriut do t’i jepet e gjithë bota dhe të hiqet prej tij kënaqësia me atë që ka, në këtë gjendje patjetër që ai do të jetojë gjithmonë në mundim, në dhimbje e në pikëllim dhe do ta pasqyrojë këtë. Kur njeriu zotëron cilësinë e kënaqësisë me atë që ka, heq dorë nga kujdesi i tepruar për më shumë dhe në zemrën e tij nuk lëvrin asnjëra formë e ambicies, patjetër që ai do të jetojë gjithmonë i kënaqur.

Në disa transmetime të tjera është shpjeguar komenti i togfjalëshit *jetë e mirë* në kuptimin e kënaqësisë me betimin e All’llahut. Ky kuptim është në një horizont të afërt me kënaqësinë e njeriut me atë që ka.

Duhet që këtyre kuptimeve të mos u japim kurrë cilësinë e mpikjes, pasi në të vërtetë qëllimi konkret i shpjegimit të kënaqësisë së njeriut me aq sa ka, është eliminimi i kujdesit të tepërt dhe heqja prej shpirtit të njeriut e dëshirës për të ndjekur pasionet. Këto cilësi konsiderohen prej faktorëve që nxisin armiqësitë, shfrytëzimin, luftërat, gjakderdhjen, punë që shkaktojnë poshtërim e robëri.

¹ “Nehxhul Belàga”, Fjalët e shkurtra, nr. 229.

Ajetet 98 – 100

﴿فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ۝ إِنَّهُ لَيْسَ لَهُ سُلْطَانٌ عَلَى الَّذِينَ آمَنُوا وَعَلَى رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ۝ إِنَّمَا سُلْطَانُهُ عَلَى الَّذِينَ يَتَوَلَّوْنَهُ وَالَّذِينَ هُمْ بِهِ مُشْرِكُونَ ۝﴾

“Kur të lexosh Kur’ânin, kërko mbrojtjen e All’liahut prej djallit të mallkuar (thuj: Eùdhu bil’làhi mineshe shejtànirr rrexhijm).”

“Në të vërtetë, ai (djalli) s’ka asnjë fuqi kundër atyre që besuan dhe që janë mbështetur në Zotin e tyre.”

“Ai (djalli) ka fuqi vetëm mbi ata që e ndihmojnë atë dhe që për shkak të tij u bënë idhujtarë.”

Komentimi

Ja kështu lexoje Kur’ânin

Ne nuk na del nga mendja ajo që ka ardhur në disa ajete të Kur’ânit, se “Kur’âni është sqarues për çdo send”. Më pas në Kur’ân plotësohet studimi për një pjesë shumë të rëndësishme të urdhrave Hyjnorë.

Ajetet që janë objekt studimi shpjegojnë përfitimin prej Kur'anit, si dhe mënyrën e leximit të Tij, sepse edhe përmbajtja aq e dendur e Kur'anit, nuk është e mjaftueshme për të na udhëzuar në rrugën e drejtë. Për këtë arsye, për udhëzimin në rrugën e drejtë kërkohet që prej nënvetëdijes sonë duhet të hiqet e të asgjësohet patjetër ajo perde që rrethon kujtesën dhe shpirtin tonë, pasi vetëm kështu kemi mundësi të arrijmë të futemi në kuptimet kaq të pasura të Kur'anit Famëlartë.

Pikërisht për këtë, Kur'ani thotë: **“Kur të lexosh Kur'anin, kërko mbrojtjen e All'llahut prej djallit të mallkuar** (thuj: Eùdhu bil'lahi mineshejtànirr rrexhijm)“.

Me kërkimin e mbrojtjes nuk është qëllimi që ne të mjaftohemi vetëm të lakojmë fjalën: **“Kërkoj mbrojtjen e All'llahut!”**, pasi kërkimi i mbrojtjes patjetër duhet të jetë parathënie për të realizuar krijimin e gjendjes shpirtërore të kërkuar, gjendjen e orientimit tek All'llahu i Lartësuar, ndarjen e plotë prej pasioneve të shpirtit dhe largimin e inatit, punë të cilat e pengojnë kuptimin e saktë të njeriut. Prandaj duhet kërkohet largim prej fanatizmave, arrogancës, dashurisë për veten dhe vënien e saj mbi çdo gjë tjetër. Dashuria për veten ushtron presion mbi njeriun, që ai të vërë në dispozicion të realizimit të dëshirave të tij të devijuara të gjitha sendet, deri edhe fjalën e All'llahut të Lartësuar.

Nëse njeriu nuk e realizon shkëputjen e plotë prej gjërave që u përmendën më sipër, ai e ka të pamundur të kuptojë të vërtetat kur'anore. Mbase arrin deri aty sa me anë të interpretimit të Kur'anit sipas opinionit e bën atë mjet për të justifikuar mendimet e dëshirat e tij të ndotura me llumin e idhujtarisë. Ajeti vijues vjen

që të jetë argument për atë që erdhi në ajetin para: **“Në të vërtetë ai (djalli) s’ka asnjë fuqi kundër atyre që besuan dhe që janë mbështetur në Zotin e tyre”**. Sepse: **“Ai (djalli) ka fuqi vetëm mbi ata që e ndihmojnë atë dhe që për shkak të tij u bënë idhujtarë”**, sepse ata vënë në konsideratë bindjen ndaj djallit dhe jo bindjen ndaj urdhrit të All’l’lahut!

Hulumtime

1- Ndaluesit e njohjes

Edhe pse e vërteta është aq e dukshme dhe aq e qartë, ajo mund të konstatohet vetëm falë një syri vëzhgues. Me fjalë të tjera, për njohjen e së vërtetës duhen dy kushte:

kushti i parë: qartësia e së vërtetës;

kushti i dytë: ekzistenca e një mjeti për të shikuar tek e vërteta dhe për ta kuptuar atë.

A mundet i verbri të shikojë diskun e diellit, qoftë edhe vetëm për një ditë, duke vazhduar të jetë i verbër? A mund të dëgjojë shurdhi tingujt e kësaj bote të bukur? Kështu qëndron puna edhe me atë person që e ka humbur aftësinë e vëzhgimit dhe atë të dëgjimit. Në të vërtetë, një person i tillë është i privuar prej shikimit të madhështisë së të Vërtetit, si dhe prej dëgjimit të argumenteve të Tij të mrekullueshme.

Përse e humb njeriu fuqinë e njohjes?!

Sepse në të vërtetë ai u ka bërë vend te vetja tezave të hershme të gabuara, ka lejuar që pasionet e shpirtit dhe fanatizmat e verbra e të tejskajshme të jenë mbizotëruese në çorientimin e tij. Për rrjedhojë, ai ka rënë rob i kënaqësive fizike e i arrogancës, ka përlyer kthjelltësinë e zemrës e pastërtinë e shpirtit të tij me punë që e ndalojnë njeriun të kuptojë të vërtetat.

Në një hadith të nderuar thuhet: “Sikur djajtë të mos silleshin rreth zemrave të bijve të Ademit (njerëzve), me siguri që ne do të shihnim mbretëritë e qiejve”.

Kushti i parë që duhet realizuar prej atij që i ka hyrë rrugës së të Vërtetit, është edukimi i shpirtit dhe përvetësimi i devotshmërisë, sepse pa këtë kusht thelbësor, njeriu bie në errësirën e iluzioneve dhe e humb rrugën e drejtë.

Këtë të vërtetë, Kur'ani Famëlartë e thekson me fjalët: **“udhëzues për të devotshmit”**. (Sure “El Bekare” ajeti 2).

Sa njerëz i kanë kërkuar ajetet e Kur'anit me fanatizëm, me inat e me tezat e mëparshme (individuale ose shoqërore). Ata e kanë marrë Kur'anin ashtu siç kanë dashur dhe jo ashtu siç është qëllimi i Kur'anit. Rezultati: ata janë thelluar në rrugën e humbjes, në vend që Kur'ani për ta të ishte udhëzues në rrugën e drejtë. (Është e natyrshme që Kur'ani me argumentet e me të vërtetat e tij të pastra, nuk mund të jetë mjet për të çuar në rrugën e humbjes, por janë pasionet e mllefë që i kanë tërhequr ata zvarrë në rrugën e humbjes). Edhe dy ajetet 124 dhe 125 të sures “Et Teube” e shpjegojnë për ne këtë gjendje me qartësinë më të plotë: **“...atyre që i besuan** (asaj që zbriti) **i shton besimin dhe ata gëzohen për**

atë. Kurse, atyre që kanë sëmundje në zemrat e tyre, ajo (që zbriti), u shton ndyrësi mbi ndyrësinë e tyre dhe ata vdesin mohues”.

Qëllimi i ajetit është që të mos mjaftohemi vetëm duke e thënë frazën **“eùdhu bil’làhi mineshe shejtànirr rrexhijm”**, por patjetër duhet që këtë fjalë ta bëjmë mendim, sepse mendimi ka edhe një gjendje të brendshme. Kur e këndojmë ajetin **“eùdhu bil’làhi mineshe shejtànirr rrexhijm”**, i kërkojmë All’llahut të na mbrojë që cytjet e ngacmimet e djallit të mos bien mbi ne dhe që ai të mos hyjë mes nesh e mes fjalës së All’llahut të Gjithëfuqishëm.

2- Përse të kërkohet mbrojtje “prej djallit të mallkuar”

Origjina e fjalës së tekstit të ajetit **“err’rrexhiymi”** - **“i mallkuar”**, është **“rexhm”**, në kuptimin **“i përzënë”**, që në origjinë ka kuptimin ekzekutim me guajtje me gurë, por që më pas u përdor në kuptimin i përzënë (i përzënë prej mëshirës së All’llahut, domethënë i mallkuar).

Vëmë re se ndër të gjitha cilësitë e këqija të djallit, ajeti ka përmendur vetëm cilësinë e përzënies së tij dhe, kjo është për të na kujtuar mendjemadhësinë e tij kur kundërshtoi urdhrin All’llahut për t’iu përlur (për t’i bërë sexhde) Ademit. Është kjo mendjemadhësi që u fut si perde mes tij e kuptimit të të vërtetave, derisa atij iu rrit mendja aq shumë sa të besojë se ka përparësi ndaj Ademit, kur i tha All’llahut: **“unë jam më i vlefshëm se ai, mua më krijoje prej zjarrit dhe atë e krijoje prej baltës”**. (sure “El A’râf”, ajeti 12)

Ky mllef e kjo arrogancë qenë shkaku që ai ngriti krye kundër urdhrit të All'llahut të Gjithëfuqishëm, çka e çoi në mohim dhe pastaj në përzhënien e tij prej Xhennetit.

Kur'ani Famëlartë duke përdorur fjalën *“err'rrxhijm”* - i përzhënë, i mallkuar - ka qëllim të na bëjë të kuptojmë domosdoshmërinë për të qenë të rezervuar dhe për të bërë kujdes që të mos biem në gjendje mendjemadhësie, arrogance e fanatizmi kur lexojmë ajetet e Librit të All'llahut, të Urtit. Pra, të mos biem ashtu siç ra djalli më parë në batakun e mohimit, por prej ajeteve të Librit të All'llahut të Gjithëfuqishëm të kuptojmë të vërtetat kur'anore.

3- Ndërmjet ngjyrave të së vërtetës dhe të së gabuarës

Ajetet e mësipërme i ndajnë njerëzit në dy kategori: njëra kategori është nën sundimin e djallit dhe kategoria tjetër është jashtë sundimit të tij. Gjithashtu, ajetet sqarojnë edhe nga dy cilësi për secilën prej këtyre dy kategorive.

Jashtë pushtetit të djallit janë besimtarët të cilët mbështeten vetëm tek All'llahu i Lartësuar, domethënë ata që nga ana e besimit janë rob të All'llahut dhe nga ana praktike bëjnë një jetë të pavarur prej të gjitha sendeve. Ata nuk mbështeten as te njerëzit, as te dëshirat e as te fanatizmat.

Për sa u përket atyre që kanë rënë nën pushtetin e djallit, ai është drejtuesi i tyre, të cilin ata *“jetevel'leunehù”* - e ndihmojnë – dhe janë ortakë me të, sepse punët e tyre tregojnë se ata ndjekin djallin

e urdhrat e tij. Nga kjo pikëpamje, kjo varësi e tyre i çon ata deri aty sa t'i vënë shok e ortak All'llahut të Gjithëfuqishëm.

Këtu duhet të theksojmë se edhe prej atyre që punojnë për të qenë prej kategorisë së parë, ka që shkojnë e bien në batakun e kategorisë së dytë, për shkak se janë larguar prej edukuesve shpirtërorë, ose ngaqë kanë rënë në një mjedis të shprishur, apo për ndonjë shkak tjetër që i çon në këtë batak.

Në të gjitha gjendjet, ajeti thekson të vërtetën: pushteti i djallit nuk është pushtet që i imponohet njeriut, madje pushteti i tij s'ka as mundësi të ndikojë te njeriu, pa e shtruar ky vetë rrugën për të hyrë djalli në shpirtin e tij dhe pa i dhënë atij leje për të kaluar nëpër portat e zemrës së tij.

4- Rregullat e leximit të Kur'ânit

Çdo send ka nevojë për një program të caktuar, madje prej kësaj rregulle nuk përjashtohet as Libri më i madh, Kur'âni Famëlartë. Prandaj, vetë Kur'âni Famëlartë ka përmendur disa rregulla e kushte kur njeriu lexon fjalën e All'llahut, me qëllim që ai të përfitojë prej argumenteve të këtij libri të papërsëritshëm:

a- Në fillim i Larti thotë: **“Atë e prekin vetëm të pastrit”** (sure “El Vâkia”, ajeti 79). Kjo shprehje e ajetit tregon pastërtinë e jashtme, pra prekja e Librit të Kur'ânit është e kushtëzuar me pastrimin e përgjithshëm (guslin), ose me pastrimin e pjesshëm (abdesin) për cilindo që e prek këtë Libër të nderuar. Gjithashtu, ajeti tregon se arritja e kuptimit të përmbajtjes së ajeteve të Kur'ânit bëhet e mundur vetëm nëpërmjet pastrimit të vetes prej veseve

poshtëruese, sepse ato e ndalojnë shikimin e bukurisë të së vërtetës dhe bëhen si një perde e errët ndërmjet njeriut dhe të vërtetave kur'anore.

b- Është detyrim të kërkohet mbrojtja e All'llahut prej djallit të mallkuar para se të fillohet leximi i ajeteve të All'llahut, ashtu siç thotë ajeti: **“Kur të lexosh Kur'anin kërko mbrojtjen e All'llahut prej djallit të mallkuar”**.

Transmetohet se kur është pyetur për rrugën e përdorimit të kësaj fraze, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Thuaj: ‘Kërkoj mbrojtjen e Gjithëdëgjuesit, të Gjithëditurit prej djallit të mallkuar!’”. Në një transmetim tjetër tregohet se kur ai mori të lexonte suren “El Fàtiha”, tha: *“Kërkoj mbrojtjen e All'llahut, Gjithëdëgjuesit, të Gjithëditurit prej djallit të mallkuar dhe kërkoj mbrojtjen e All'llahut që ai të mos më afrohet!”*.

Ashtu siç thamë, vetëm shqiptimi me fjalë i kërimit të mbrojtjes nga ana e All'llahut, nuk është i mjaftueshëm për asgjë. Kërkimi i mbrojtjes duhet të depërtojë në thellësitë e shpirtit në atë mënyrë që njeriu kur lexon Kur'an të jetë i ndarë krejtësisht prej vullnetit të djallit dhe të afrohet sa më pranë cilësive hyjnore, duke hequr prej mendimit të tij të gjithë ndaluesit që e pengojnë atë të kuptojë fjalën e të Vërtetit, sepse vetëm kështu ai ka mundësi të shohë bukurinë e së vërtetës me qartësi të plotë.

Kërkimi i mbrojtjes së All'llahut prej djallit është detyrim të bëhet para se të fillohet leximi i Kur'anit, gjithashtu kërkimi i ndihmës së All'llahut duhet të jetë i pandërprerë gjatë leximit dhe deri në fund të tij, edhe pse gjatë leximit nuk e shqiptojmë me fjalë kërkimin e ndihmës prej All'llahut të Lartësuar.

c- Lexuesi e ka detyrim të mendojë e të meditojë mbi fjalët e Kur'anit që lexon (tertijl), ashtu siç urdhëron ajeti: **“dhe Kur'anin lexoje me vëmendje”** (sure “El Muzem'mil”, ajeti 4).

Në lidhje me interpretimin e këtij ajeti tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur'ani nuk lexohet me të thirrura e me lëvizje të shumta! Kur'ani lexohet duke menduar mbi ato që lexon dhe, kur të lexosh ajete në të cilat përmendet zjarri (Xhehennemi), ndaloje leximin dhe kërkoji All'llahut të të mbrojë prej zjarrit!”¹

ç- Kur'ani urdhëron që Libri i All'llahut të lexohet me vëmendje, duke menduar mbi atë që lexon, ashtu siç urdhërohet në ajetin 82 të sures “En Nisa”: **“A nuk po e lexojnë ata Kur'anin me vëmendje?”**.

Ebù Abdurrahman Es Selemij ka thënë: “Sahabët që na afroheshin, na flisnin se kur merrnin prej të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhjetë ajete, ata nuk merrnin dhjetëshen tjetër të ajeteve derisa të mësonin se ç'dituri kishte te të parat dhe të punonin me to.”

Në një hadith të transmetuar prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ai ka thënë: “Analizojeni Kur'anin dhe merrni gjërat e tij të rralla!”²

Transmetohet prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) se ai ka thënë: “All'llahu i Lartësuar është bërë i dukshëm për njerëzit me fjalët e Tij, por njerëzit nuk e shikojnë”³; megjithëkëtë, ata që e kanë

¹ “Bihàrul Enuàr”, vëll. 89, f. 106

² Burimi i mësipërm.

³ “Bihàrul Enuàr”, vëll. 92, f. 107.

ndërgjegjen të gjallë, si dhe dijetarët besimtarë, kanë mundësi të shohin bukurinë e Tij të shfaqur në fjalën e Tij të lartësuar.

d- Ata që dëgjojnë të këndohet Kur'an, kanë detyrim të dëgjojnë me vëmendje dhe të mendojnë mbi atë që dëgjojnë, ashtu siç urdhëron ajeti 204 i sures "El A'râf": **"kur lexohet Kur'ani, dëgjojeni atë me vëmendje dhe heshtni, kështu ju do të mëshiroheni"**.

Hadithe të tjera stimulojnë leximin e Kur'anit me zë të bukur, pasi kështu kuptimet e tij lënë gjurmë në ndjenjat tona; por, vendi nuk na lejon që këtë çështje ta trajtojmë në mënyrë të hollësishme.¹

¹ Për më shumë informacion, referoju librit "Bihàrul Enuàr" vëll. 9, f. 190 e në vijim.

Ajetet 101 - 105

﴿وَإِذَا بَدَّلْنَا آيَةً مَكَانَ آيَةٍ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُنَزِّلُ قَالُوا إِنَّمَا أَنْتَ مُفْتَرٍ
بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ^{١٠١} قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ
لِيُثَبِّتَ الَّذِينَ آمَنُوا وَهُدًى وَبُشْرَى لِلْمُسْلِمِينَ^{١٠٢} وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّهُمْ
يَقُولُونَ إِنَّمَا يُعَلِّمُهُ بَشَرٌ لِّسَانُ الَّذِي يُلْحِدُونَ إِلَيْهِ أَعْجَمِي وَهَذَا
لِّسَانُ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ^{١٠٣} إِنَّ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ لَا يَهْدِيهِمُ اللَّهُ
وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ^{١٠٤} إِنَّمَا يَفْتَرِي الْكَذِبَ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ
وَأُولَئِكَ هُمُ الْكَاذِبُونَ^{١٠٥}﴾

“Kur një ajet e zëvendësojmë me një ajet tjetër, All’Ilahu e di më mirë atë çka zbriti, dhe, ata thanë: ‘Ti (o Muhammed) je vetëm trillues’; jo, por shumica e tyre nuk dinë.”

“Thuaj: ‘Atë (Kur’anin) e solli shpirti i shenjtë prej Zotit tënd plot vërtetësi, për të përforcuar më shumë ata që besuan dhe për të qenë udhërrëfyes e përgjzues për myslimanët.”

“Ne e dimë shumë mirë se ata thonë: ‘Atë (Muhammedin) e mëson një njeri, mirëpo gjuha e atij që ata anojnë (supozojnë) nuk është arabe (është e paqartë), kurse kjo (gjuha e Kur’anit) është gjuhë arabe e qartë.”

“S’ka dyshim se ata që nuk i besojnë ajetet (argumentet) e All’lلاهut, ata nuk i udhëzon All’lلاhu në rrugën e drejtë dhe kanë një dënim të dhimbshëm.”

“Gënjeshtren e trillojnë vetëm ata që nuk u besojnë argumenteve (ajeteve) të All’lلاهut dhe ata janë gënjeshtarët.”

Shkaku i zbritjes

Ibni Abbàsi tregon: “Ata (idhujtarët) thoshin: ‘Muhammedi po tallet me shokët e vet, sot i urdhëron për një punë, nesër i urdhëron për një tjetër; patjetër që ai është gënjeshtar, i urdhëron ata me ato që thotë prej vetes’”.

Komentimi

Shpifja

Ajetet e mësipërme trajtuan mënyrën e përfitimit prej Kur'anit Famëlartë, ndërsa ajetet që kemi objekt studimi trokasin mbi anë të tjera prej çështjeve që kanë lidhje me Kur'anin dhe fillojnë me disa dyshime që qëndronin pezull në mendjet e politeistëve rreth ajeteve të bekuara të Kur'anit. Ajeti thotë: **“Kur një ajet e zëvendësojmë me një ajet tjetër, All'lahu e di më mirë atë çka zbriti”**. Ky ndryshim e ky zëvendësim i nënshtrohet vendimit të All'lahut, i Cili është më i dituri për atë çka zbriti dhe si e zbriti. Por, politeistët për shkak të injorancës së tyre thoshin: **“dhe, ata thanë: ‘ti (o Muhammed) je vetëm trillues; jo, por shumica e tyre nuk dinë’”**.

E vërteta është se politeistët nuk kishin arritur ende të kuptonin misionin e Kur'anit dhe mesazhin që Ai sillte. Në përfytyrimet e në mendjet e tyre nuk kishte hyrë ende fakti se Kur'ani në fushën e ndërtimit të shoqërisë njerëzore është risi dhe se atë e përshkon përparimi, liria dhe morali i lartë; por shumica e atyre nuk e dinë këtë.

Vetëkuptohet që në këtë gjendje, patjetër duhet ndërruar receta e medikamentit Hyjnor për të shpëtuar këta të sëmurë. Për këtë arsye, ndryshimi e zëvendësimi duhet bërë gradualisht, krahas asaj që ata përvetësojnë; për atë që u jep sot, ai u flet atyre nesër, kështu derisa receta të plotësohet e gjitha.

Shkujdesja e plotë e politeistëve ndaj këtyre të vërtetave dhe vetëlargimi i tyre prej kushteve të zbritjes së Kur'anit i shtynin ata

të besonin se në brendinë e fjalëve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka kontradiktë ose shpifje për All'llahun e Lartësuar: ata duhej të dinin se anulimi i dispozitave është pjesë prej urdhrave e prej argumenteve të Kur'anit. Gjithashtu duhej të dinin se edhe këto ndryshime janë të sistemuara në formën e programit edukues të hollësishëm dhe se nuk është e mundur të arrihet në qëllimin e fundit, që është arritja e plotësimit, përveçse me atë.

Anulimi i dispozitave në një shoqëri e cila përjeton një gjendje tranzicioni ndërmjet dy etapave kohore, konsiderohet prej domosdoshmërive shkencore dhe reale, pasi ndryshimi dhe kalimi i njerëzve prej një etape në një tjetër, nuk plotësohet me një shtysë të vetme, por patjetër duhet të kalojnë disa periudha të hollësishme tranzicioni.

A është i mundur shërimi i një të sëmuri kronik brenda një dite?

Ose a është e mundur që një narkoman, i cili ka marrë drogë për vite me radhë, të shërohet brenda një dite të vetme? A nuk është mjekimi i shkallëzuar metoda më e mirë për trajtimin mjekësor të këtij narkomani?

Pasi këto pyetje të marrin përgjigje, ne nuk na mbetet të themi gjë tjetër, përveçse anulimi i dispozitave në etapat tranzitore është një program i përkohshëm.

(Çështjen e anulimit e kemi trajtuar gjatë komentimit të ajetit 36 të sures "El Bekare", prandaj referoju këtij studimi.)

Ajeti vijues vazhdon të trajtojë të njëjtën temë, për të theksuar urdhrin që merr Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajeti thotë: **“Thua: ‘Atë, (Kur’ànin) e solli shpirti i shenjtë prej Zotit tënd plot vërtetësi”**.

“Shpirti i shenjtë”, “Rrùhul Kudusì”, është korrieri besnik i Revelatës Hyjnore, Xhebràili besnik, nëpërmjet të cilit ajetet e Kur’ànit me urdhrin e All’llahut të Gjithëfuqishëm i zbrisnin (i shpalleshin) Profetit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qofshin ajete anuluese ose të anuluar.

Çdo ajet i Kur’ànit është i vërtetë, qëllimi i tyre është i njëjtë dhe konsiston në orientimin e njeriut në kuadrin e edukimit të tij Hyjnor. Veç kësaj, janë kushtet përbërëse të njeriut ato që e bëjnë të domosdoshme ekzistencën e dispozitave anuluese e të anuluar në procesin e edukimit.

Për të gjitha këto, në plotësim të ajetit të nderuar ka ardhur fraza: **“për të përforcuar më shumë ata që besuan dhe për të qenë udhërrëfyes e përgëzues për myslimanët”**.

Autori i tefsirit “El Mizàn” thotë: “Përkufizimi i Kur’ànit: përforcues për besimtarët me udhëzimin në rrugën e drejtë dhe përgëzues për myslimanët, në të vërtetë tregon dallimin ndërmjet imànit e Islamit (besimit dhe fesë); imani - besimi ka të bëjë vetëm me zemrën, domethënë që besimi (imàni) është përforcimi i njeriut me dituri e me nënshtrim, kurse Islami, feja, shfaqet në anën e jashtme të punës e të veprës që kryen njeriu dhe njëkohësisht ajo shfaqet në periudhat e lëvizjeve të gjymtyrëve të trupit. Udhëzimi në rrugën e drejtë është pjesë e edukimit islam të njeriut, është

detyrim për të punuar, por është edhe përgëzim, sepse qëllimi më i lartë është Xhenneti dhe lumturia.

Sido që të jetë, për të forcuar frymën e besimit dhe për të ecur në rrugën e udhëzimit e të përgëzimit, patjetër që lind nevoja për të pasur një program të shkurtër dhe të përkohshëm, një program gradual që zë vendin e programit përfundimtar e të qëndrueshëm. Ky është edhe shkaku i ekzistencës së ajeteve anuluese dhe të anuluar në tërësinë e ajeteve kur'anore.

Pasi asgjësoi dyshimet e politeistëve, Kur'ani Famëlartë troket në një dyshim tjetër, ose më saktë, përmend një shpifje tjetër që bënin kundërshtarët e Profetit të mëshirës (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajeti thotë: **“Ne e dimë shumë mirë se ata thonë: ‘Atë (Muhammedin) e mëson një njeri”**.

Interpretuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme në lidhje me emrin e personit për të cilin politeistët pretendonin se ai mësonte Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Prej Ibni Abbàsit transmetohet se personi për të cilin aludonin politeistët ishte një burrë që quhej Bel'am, i cili në Mekë punonte shpata, ishte i krishterë me origjinë bizantine.

Disa kanë thënë se ai ishte një djalë bizantin që jetonte në tribunë Benij Hadram dhe quhej Jaish, ose Àish, kishte pranuar Islamin dhe ishte bërë prej shokëve (sahabëve) të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Të tjerë kanë thënë: “Mësues të tij ishin dy djem të krishterë, njëri quhej Jasâr dhe tjetri Xheber. Që të dy kishin një libër në gjuhën e tyre, të cilin ia këndonin atij herë pas here me zë të lartë.

Të tjerë hamendësuan se mësuesi është Selman Farisiu, por ai është bashkuar me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Medine dhe po aty ka pranuar Islamin në praninë e tij. Këto shpifje, politeistët i lakonin me gjuhët e tyre në Mekë, duke shtuar se pjesa më e madhe e ajeteve të sures “En Nahl” kanë zbritur në Mekë dhe jo në Medine.

Pavarësisht nga fjalët e tyre, Kur’ani Famëlartë u përgjigjet atyre fuqishëm dhe asgjëson të gjitha shpifjet që bënin politeistët dhe thotë: **“mirëpo gjuha e atij që ata anojnë¹ (supozojnë) nuk është arabishte² (është e paqartë), kurse kjo (gjuha e Kur’anit), është gjuhë arabe e qartë”**.

Nëse me shpifjet e tyre politeistët kishin qëllim se mësuesi që i mësonte Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) fjalët e Kur’anit, ishte një person joarab, vetëkuptohet se ai s’kishte si të dinte mirë gjuhën arabe dhe retorikën e saj. Ky patjetër që është idiotizmi më i madh që

¹ Fjala e ajetit “anojnë”, në tekstin e Kur’anit “*julhidune*” është në kuptimin e ateizmit, domethënë animit të tyre nga e vërteta tek e gabuara. Kjo fjalë përdoret për çdo devijim; por qëllimi këtu është: gënjeshtarët duan t’ia atribuojnë Kur’anin një njeriu për të cilin ata pretendojnë se ai është mësuesi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

² Edhe fjala “joarab”, në tekstin e Kur’anit, “*a’xhemij’jun*”, është në kuptimin e tregimit me gisht për një të huaj. Kjo fjalë u përdor për atë person që ka mangësi në gjuhën që flet, qoftë arab ose joarab, duke vënë në konsideratë se arabët nuk e kuptonin gjuhën e joarabëve, prandaj fjala “aëxhem” është përdorur për joarabët.

shprehnin politeistët, për faktin e thjeshtë se është e pamundur që një person i cili nuk e zotëron arabishten në të gjitha hollësitë, të jetë mësues i kësaj retorike e qartësie, para së cilës s'kanë mundësi të afrohen as gjuhëtarët e mirëfilltë. Madje vetë Kur'ani Famëllartë i sfidon ata duke i thënë që të sjellin qoftë edhe një sure të vetme si suret e Kur'anit; por ata e kishin të pamundur të bënin këtë gjë, pa kërkuar që të sillnin të gjitha ajetet e Kur'anit!

Nëse pretendimi i politeistëve synonte të vërtetonte që përmbajtja e Kur'anit ishte prej një mësuesi joarab, hedhja poshtë e këtij pretendimi të rremë është shumë më i lehtë e shumë më i thjeshtë se hedhja poshtë e shpifjeve të tyre të mëparshme, pasi përmbajtja e Kur'anit i ka të gjitha shprehjet e fjalët të derdhura në një kallëp të veçantë, aq sa para fuqisë së retorikës dhe pamundësisë për të imituar Kur'anin, janë përulur edhe oratorët më të dëgjuar arabë. Pikërisht ky fakt na drejton dhe na bën të besojmë se Vënësi i Kur'anit zotëron atë fuqi shpjeguese që nuk mund ta zotërojë asnjë njeri. Pa dyshim që Kur'ani është vetëm vepër e All'Ilahut të Gjithëfuqishëm, All'Ilahut i kërkojmë të na falë për shokët e ortakët e rremë që ata i përshkruajnë Atij.

Me një shikim meditues e diagnostikues në përmbajtjen e Kur'anit, do të vërejmë se ai zotëron logjikë filozofike të thellë në vërtetimin e doktrinë së tij. Të njëjtën logjikë filozofike kanë edhe mësimet morale të Kur'anit për edukimin e shpirtit të njeriut, kështu qëndron edhe çështja e ligjeve shoqërore të kompletuara të Kur'anit. Çdo gjë që është në Kur'an, karakterizohet për fuqinë e nivelit të vërtetë që dallohet qartë nga mendimi njerëzor, madje nivelin e të vërtetave të Kur'anit e kanë të qartë edhe vetë lakuesit e shpifjeve të lartpërmendura, të cilët nuk i besojnë fjalët që thonë, prandaj shpifjet e tyre s'janë gjë tjetër përveçse djallëzi e fjalë

provokuese që ata synojnë të fusin në shpirtrat e njerëzve të zakonshëm.

Në të vërtetë, politeistët nuk gjenin dot në mesin e tyre asnjë person të cilit t'i atribuonin autorësinë e Kur'anit, prandaj ata u përpoqën të sajnin një person të njohur, për të cilin njerëzit nuk dinin asgjë me qëllim që Kur'anin t'ia atribuonin atij. Ata besonin se mbase me këtë mashtrim do të kishin mundësi të shfrytëzonin më me lehtësi shkujdesjen e sa më shumë njerëzve të zakonshëm.

Përveç këtyre që u thanë, këtu duhet të shtojmë edhe faktin se historia e jetës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vërteton se ai ka pasur komunikim të vazhdueshëm me këtë kategori njerëzish. Edhe nëse supozojmë që autori i stisur i Kur'anit ekziston, do të mjaftonte vetëm ky fakt për të detyruar Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të ishte gjithmonë e vazhdimisht në komunikim me atë autor të imagjinuar, por politeistët nuk donin më shumë se një diçka ku të kapeshin, ashtu siç thuhet, ai që është duke u mbytur në ujë, kapet edhe pas një fijeje bari.

Zbritja e Kur'anit Famëlartë në një mjedis injorance, përparësia e tij dhe fakti se është i paimitueshëm, është diçka që dallohet qartë. Për më tepër, Kur'ani vazhdon të ketë përparësi edhe në ditët tona, kur përparimi është arritur në fusha të shumta të qytetërimit njerëzor, duke shtuar edhe veprat e thella që pasqyrojnë forcën e mendimit të njeriut bashkëkohës.

Po, është plotësisht e vërtetë, sado që njeriu ka arritur të hartojë ligje e sisteme, Kur'ani është e do të vazhdojë të jetë superior e bashkëkohës.

Sejjid El Kutub ka përmendur në tefsirin e tij se një grup materialistësh në Rusi, kur deshën të zvogëlonin madhështinë e Kur'anit në një kongres të orientalistëve të mbajtur në vitin 1954 thanë: “Në të vërtetë, ky libër nuk është e mundur të jetë prodhim i mendjes së një njeriu të vetëm (Muhammedit), por detyrimisht ai është një arritje e punës së shumë njerëzve, të cilët nuk vërtetohet të ishin të gjithë banorë të Gadishullit Arabik, pasi rezultoi në mënyrë të prerë që një grup prej tyre ishin jashtë këtij gadishulli”.¹

Nga njëra anë ata po studionin komentimin materialist të kësaj çështjeje në përputhje me logjikën e tyre ateiste, nga ana tjetër nuk e kishin të pamundur të pranonin se Kur'ani është rezultat i ndriçimit të mendjes së një njeriu që ka jetuar në Gadishullin Arabik. Por mendësia e tyre ateiste i çoi ata të shtronin një komentim kaq qesharak e të pohonin se në hartimin e Kur'anit kishin marrë pjesë grupe të shumta njerëzish brenda e jashtë Gadishullit Arabik! Dihet se historia e mohon këtë konkluzion të tyre në tërësi e në detaje.

Në të gjitha gjendjet, ajeti i nderuar është një argument që vërteton paimitueshmërinë e Kur'anit nga ana e fjalëve dhe e brendisë, nga ana e ëmbëlsisë së fjalëve e të retorikës së tij apo nga ana e tërheqjes së njerëzve që dëgjojnë të vërtetat e padiskutueshme të Kur'anit. Harmonizimi që ekziston në fjalët e në shprehjet e Kur'anit, është fakt i pamohueshëm që tregojnë se fjalët e shprehjet kur'anore të Kur'anit Famëlartë qëndrojnë më lart se fuqitë e çdo njeriu. (Gjatë komentimit të ajetit 23 të sures “El Bekare” kemi

¹ “Fi Dhilalil Kur'an”, vëll. 5, f. 282.

komentuar në mënyrë të hollësishme mbi paimitueshmërinë e Kur'anit, referoju këtij komentimi.)

Kur'ani Famëlartë me gjuhën e kërcënuesit shpjegon se në vërtetë të këtilla akuza e devijime të së vërtetës kanë ardhur nga që në shpirtat e atyre njerëzve nuk gjendej besim dhe, Kur'ani njofton: **“S’ka dyshim se ata që nuk i besojnë ajetet (argumentet) e All’llahut, ata nuk i udhëzon All’llahu në rrugën e drejtë dhe kanë një dënim të dhimbshëm.”**.

Kështu ndodh me politeistët, sepse ata nuk janë të përshtatshëm për t’u udhëzuar në rrugën e drejtë, veç kësaj shpifësit politeistë nuk ishin në harmoni as me sistemin Hyjnor, për shkak të fanatizmit, mllëfit e armiqësisë që kanë ndaj së vërtetës.

Në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh njoftohet se ata që stisin gënjeshtër për argumentet e All’llahut, me të vërtetë janë gënjeshtarë: **“Gënjeshtër e trillojnë vetëm ata që nuk u besojnë argumenteve (ajeteve) të All’llahut dhe ata janë gënjeshtarët.”**. Ajeti e bën të qartë se trillues të gënjeshtërës janë ata dhe jo ti o Muhammed! Megjithëse i kanë para syve ajetet e All’llahut dhe argumentet e formës së prerë, ata përsëri vazhdojnë të trillojnë shpifje e gënjeshtër.

Cilat gënjeshtër janë më të mëdha se ato që trilluan ata kundër burrave që mbrojnë të vërtetën?! Trillimet e shpifjet e tyre kishin qëllim që gënjeshtër të hynin mes gënjeshtarëve dhe mes atyre që janë të etur për të vërtetat!

Hulumtime

1- E keqja e gënjeshtërs në këndvështrimin islam

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi e trajton çështjen e të keqes së gënjeshtërs me gjuhë të ashpër dhe gënjeshtarët i vë në gradën e atyre që nuk besojnë, që mohojnë argumentet e All'llahut!

Objekti i këtij ajeti në dukje trajton gënjeshtërsin e shpifjen kundër All'llahut e kundër Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*). Në të njëjtën kohë ajeti pa dyshim që trajton të keqen e gënjeshtërs në tërësi.

Për rëndësinë e madhe që ka kjo çështje, mësimet islame kanë trajtuar në kapituj të veçantë rëndësinë e domosdoshmërinë e fjalës së vërtetë dhe ndalimin e gënjeshtërs. Në vijim le të shikojmë një model të shkurtuar në formën e përmbajtjes së lëndës të këtij problemi.

Fjala e vërtetë dhe besnikëria janë prej shenjave dalluese të besimit dhe të plotësimit të njeriut, madje argumenti që këto dy cilësi tregojnë për besimin qëndron më lart se argumenti që tregon falja e namazit për besimin.

Transmetohet prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) se ai ka thënë: “Mos shikoni sa gjatë qëndron burri në ruku e në sexhde, sepse kjo është një çështje që ai e ka bërë zakon dhe, sikur të heqë

dorë prej tij do të egërsohet, por shikoni nëse ai thotë të vërtetën dhe shikoni besnikërinë e tij”.¹

Ajeti e ka përmendur fjalën e vërtetë së bashku me besnikërinë, sepse të dyja kanë të përbashkët një rrënjë të vetme; s’ka të vërtetë pa besnikëri në fjalë, ashtu siç nuk ka besnikëri pa të vërtetën në punë.

2- Gënjeshtra është burimi i të gjitha fajeve

Hadithet e nderuara e konsiderojnë gënjeshtren fillimin e të gjitha fajeve.

Prej Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: “E vërteta çon në mirësi dhe mirësia çon në Xhennet”.²

Prej Imam Bäkirit (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: “All’l-lahu i Gjithëfuqishëm ka bërë për të keqen dryna dhe çelësat e këtyre drynave janë pijet dehëse, por gënjeshtra është më e keqe se pijet dehëse”.³

Prej Imam Askeriut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: “Të gjitha punët e liga janë bërë si vendstrehim dhe çelësi i punëve të liga është bërë gënjeshtra”.⁴

Marrëdhënia ndërmjet gënjeshtres dhe fajeve të tjera përmbledhet në atë që gënjeshtra nuk ka mundësi të jetë e vërtetë,

¹ “Sefijnetul Bihâr”, lënda (sinjeriteti), cituar prej librit “El Kâfij”.

² “Mishkâtul Enuâr”, e Et Tabresij’jit, f. 157.

³ “Usûlul Kâfij”, vëll. 2, f. 254.

⁴ “Xhâmius Seâdât”, vëll. 2, f. 233.

sepse e vërteta e bën të detyrueshme diskreditimin e saj, prandaj zakonisht vërehet që gënjeshtari gënjen që të mbulojë gjurmët e fajeve që ka bërë.

Me fjalë të tjera: gënjeshtria i lëshon njeriut frerin që ai të bjerë në faje, kurse e vërteta i vë njeriut kufirin ndalues.

Të keqen e madhe të gënjeshtres Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) e ka konkretizuar me qartësi të plotë kur tek ai erdhi një burrë, i cili i tha: “O i Dërguar i All'llahut, unë nuk fal namazin, bëj punë të liga dhe gënjej, nga cila të heq dorë më parë?”

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) tha: “gënjeshtren” dhe burri u zotua para Profetit se nuk do të gënjente kurrë.

Pasi burri u largua, iu dha rasti të bënte një punë të ligë, ndërkaq ai tha me vete: “Nëse i Dërguari i All'llahut më pyet për punën time, çdo t'i them unë atij! Nëse do të mohoj, mohimi im do të jetë gënjeshtër, nëse i them të vërtetën, ai do të zbatojë mbi mua ligjin!”. Kështu ai hoqi dorë prej gënjeshtres dhe prej punëve të tij të liga, derisa i braktisi përfundimisht të gjitha.

Prandaj thuhet: lënia e gënjeshtres është rruga e lënies së fajeve.

3- Gënjeshtër është burimi i hipokrizisë

E vërtetë do të thotë përputhja e fjalës me zemrën, gënjeshtër do të thotë mospërputhje e fjalës me zemrën, ndërsa hipokrizia është kur e jashtmeja është e kundërta e së brendshmes.

Ajeti 77 i sures “Et Teube” e bën të qartë për ne këtë çështje kur thotë: **“Në zemrat e tyre All’llahu ngjit hipokrizinë deri Ditën kur ata do të takohen me Atë, për shkak se ata e thyen besën që i kishin dhënë All’llahut dhe sepse gënjenin”**.

4- S’ka harmonizim ndërmjet gënjeshtres dhe besimit

Kjo e vërtetë e qartë është pasqyruar shumë qartë në ajetin e nderuar, si dhe në shumë hadithe e transmetime.

Transmetohet se i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) është pyetur: “A mund të jetë besimtari frikacak?” Ai u përgjigj: “Po.”; “A është besimtari koprrac?” Ai tha: “Po”; “A është besimtari gënjeshtar?” Ai tha: “Jo.”.¹

Ndodh kështu për faktin se gënjeshtër është prej shenjave të hipokrizisë, mirëpo hipokrizia nuk mund të jetë së bashku me besimin.

¹ “Xhàmius Seàdàt”, vëll. 2, f. 322.

Me këtë kuptim është cituar prej Prijësit të Besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) kur ai ka theksuar pikërisht këtë kuptim të nxjerrë prej ajetit që është edhe objekt studimi tonë.

5- Gënjeshtër heq sigurinë

Ekzistenca e besimit dhe e sigurisë së ndërsjellë është prej punëve më të rëndësishme që i lidhin njerëzit me njëri-tjetrin, kurse gënjeshtër është prej veseve që kanë ndikim të madh në shthurjen e kësaj lidhjeje, për shkak se gënjeshtër përhap tradhtinë dhe animin sa nga njëra anë në tjetrën. Pikërisht për këtë, Islami e thekson me forcë përmbajtjen tek e vërteta dhe heqjen dorë prej gënjeshtres.

Prej haditheve të nderuara mësojmë se Imamët e ruajtur prej mëkateve na kanë ndaluar të shoqërohemi me grupe të caktuara njerëzish, ndër të cilët edhe me gënjeshtarët, sepse atyre nuk mund t'u besohet.

Prej Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: "Bëni kujdes dhe mos i merrni për të vërteta fjalët e gënjeshtarit, sepse gënjeshtër është si mirazhi, të afron atë që është larg dhe të largon atë që është afër".¹

Biseda rreth së keqe dhe filozofisë së gënjeshtres, shkaqeve shpirtërore që e favorizojnë atë dhe rrugët për luftimin e saj kanë nevojë për një trajtim të hollësishëm e të gjatë; por, në studimin tonë nuk është e mundur të përfshihen. Prandaj për më shumë informacion rreth këtyre çështjeve, lexo librat që trajtojnë moralet.²

¹ "Nehxhul Belàga", Fjalët e shkurtra, nr. 37.

² Referoju librit "El Hajātu fîj dauil akhlāk" - "Jeta nën dritën e moraleve".

Ajetet 106 - 111

﴿مَنْ كَفَرَ بِاللَّهِ مِنْ بَعْدِ إِيْمَانِهِ إِلَّا مَنْ أُكْرِهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ
بِالْإِيْمَانِ وَلَكِنْ مَنْ شَرَحَ بِالْكُفْرِ صَدْرًا فَعَلَيْهِمْ غَضَبٌ مِنَ اللَّهِ
وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ١٠٦ ذَلِكِ بِأَنَّهُمْ اسْتَحَبُّوا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا عَلَى الْآخِرَةِ
وَأَنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ ١٠٧ أُولَئِكَ الَّذِينَ طَبَعَ اللَّهُ عَلَى قُلُوبِهِمْ
وَسَمِعِهِمْ وَأَبْصَارِهِمْ وَأُولَئِكَ هُمُ الْغَافِلُونَ ١٠٨ لَا جَرَمَ أَنَّهُمْ فِي الْآخِرَةِ
هُمُ الْخَاسِرُونَ ١٠٩ ثُمَّ إِنَّ رَبَّكَ لِلَّذِينَ هَاجَرُوا مِنْ بَعْدِ مَا فُتِنُوا ثُمَّ
جَاهَدُوا وَصَبَرُوا إِنَّ رَبَّكَ مِنْ بَعْدِهَا لَغَفُورٌ رَحِيمٌ ١١٠ يَوْمَ تَأْتِي كُلُّ نَفْسٍ
تُجَادِلُ عَنْ نَفْسِهَا وَتُوَفَّى كُلُّ نَفْسٍ مَا عَمِلَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ١١١﴾

“Ai që mohon All’llahun pasi ka besuar, me përjashtim të atij që imponohet (të mohojë) dhe zemra e tij është e bindur plotësisht me besim; por fjala është për atë që i hap zemrën mohimit, mbi ata ka rënë zemërimi i All’llahut dhe ata kanë një dënim të madh.”

“Këtë (dënimin e madh) e kanë nga që më tepër deshën jetën e kësaj bote sesa jetën e Botës Tjetër, por All’llahu nuk i udhëzon mohuesit në rrugën e drejtë.”

“Të këtillëve All’llahu u mbyll zemrat, dëgjimin e shikimin dhe të tillë janë të shkujdesurit.”

“Është e vërtetë se në Botën Tjetër ata janë të humbur.”

“Pastaj Zoti yt, atyre që pasi u torturuan, emigruan dhe luftuan e qëndruan, pas gjithë këtyre vuajtjeve, padyshim që Zoti yt është Falësi, është i Gjithëmëshirshmi (do t’i falë e do t’i mëshirojë ata).

“Ditën kur çdo njeri do të përpiqet për veten e vet, secilit do t’i jepet ajo që meriton dhe atyre nuk u bëhet asnjë padrejtësi.”

Shkaku i zbritjes

Në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit të parë të këtij grupi ajetesh, disa interpretues të Kur’anit Famëlartë kanë thënë se ai ka zbritur për një grup myslimanësh, të cilët u imponuan të mohojnë me dhunë. Ata janë: Ammàri, baba i tij Jàseri, nëna e tij Sumejjeh, Suhajbi, Bilàli dhe Khabbàbi, të cilët u torturuan, baba dhe nëna e Ammàrit u vranë, kurse Ammari u dha tyre me fjalë atë çka deshën ata. Më pas i Gjithëfuqishmi njoftoi për këtë ndodhi të Dërguarin e Tij (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Disa njerëz thanë: “Ammàri mohoi!”, por i Dërguari i All’llahut u tha atyre: “Kurrë, Ammàri është i mbushur me besim nga maja e kokës deri në fundin e këmbëve, besimi është përzier me mishin e me gjakun e tij”. Ammàri erdhi tek i Dërguari i All’llahut duke qarë dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pyeti: “Çfarë ka prapa teje?”. Ammàri i tha: “E keqja

o i Dërguar i All'llahut, nuk më lanë derisa hoqa dorë prej teje dhe përmenda për të mirë zotat e tyre. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndërsa i fshinte sytë Ammàrit, thoshte: “Nëse ata rikthehen te ti, përsëritu atyre ato që u the”. Ndërkaq zbriti ajeti i mësipërm.

Komentimi

Ata që braktisin Islamin (renegatët)

Ky grup ajetesh plotëson atë çka njoftuan ajetet e mëparshme rreth politeistëve e mohuesve, si dhe punët që ata bënin, kurse grupi i ajeteve që janë objekt studimi trajton një shtresë tjetër mohuesish: renegatët.

Ajeti i parë thotë: **“Ai që mohon All'llahun pasi ka besuar, me përjashtim të atij që imponohet (të mohojë) dhe zemra e tij është e bindur plotësisht me besim; por fjala është për atë që i hap zemrën mohimit, mbi ata ka rënë zemërimi i All'llahut dhe ata kanë një dënim të madh”**.¹

¹ Interpretuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme në lidhje me frazën e ajetit **“kush mohon besimin në Allahun”**; dhe e kanë komentuar nga ana e sintaksës. Disa e kanë interpretuar si shpjegim të frazës së mëparshme dhe kanë thënë se kjo frazë është plotësuese e frazës **“Ata që nuk u besojnë ajeteve (argumenteve) të Allahut”**; disa të tjerë kanë thënë se kjo frazë është plotësuese e fjalës **“gënjeshtarët”**; interpretues të tjerë kanë thënë se kjo frazë është kryefjalë e një kallëzuesi të hequr dhe e kanë vlerësuar me ajetin: **“Ai që mohon pas besimit të tij... mbi ata ka rënë zemërimi i Allahut dhe ata kanë një dënim të madh”**; këtu

Ajeti tregon dy kategori prej atyre që mohuan pasi kishin besuar:

kategoria e parë: qenë ata që ranë në dorën e armikut të egër, përballuan poshtërimet e torturat e armikut, por nuk duruan presion e madh që ushtronin mbi ata armiq të Islamit. Në këtë gjendje ata shpallën heqjen dorë prej Islamit dhe deklaruan besnikërinë e tyre ndaj mohimit, por në të vërtetë gjithçka që ata pohuan ishte vetëm lëvizje e gjuhës, kurse zemra e tyre mbetej e mbushur me besim.

Kjo kategori pa dyshin që përfshihet në faljen e Zotit, madje prej tyre nuk ka dalë asnjë mëkat, sepse ata praktikuan mbrojtjen (et' tekij'jeh) e lejuar në Islam, me qëllim ruajtjen e jetës e të fuqive për të qenë më pas në shërbim të fesë së All'llahut të Gjithëfuqishëm;

kategoria e dytë: ata që me të vërtetë i hapën portat e zemrave të tyre për mohimin, ata që ndryshuan rrugën dhe hoqën dorë prej besimit të tyre; këta janë të përfshirë në zemërimin e All'llahut të Lartësuar e në dënimin e Tij të madh. Togfjalëshi i ajetit 99 **“zemërimin e All'llahut”** ka mundësi të tregojë se renegatët në jetën e kësaj botë janë të privuar prej mëshirës së All'llahut dhe prej udhëzimit në rrugën e drejtë, kurse togfjalëshi tjetër i ajetit **“dënimi i madh”** tregon për dënimin që i pret renegatët në Botën Tjetër. Siç

është hequr kushti i dënimit për të mos e treguar atë në ajetin vijues. Ka edhe një interpretim të katërt, që është interpretimi më i mirë; ata kanë thënë: është kryefjalë dhe kallëzuesi i kësaj kryefjale është në të njëjtin ajet, i pahequr. Kurse fraza e ajetit: **“zemra e tij është e plotësisht e hapur ndaj mohimit”**, është shpjegim i dytë për kryefjalën, pasi këtu ka ardhur një fjali përveçuese mes saj e fjaltive të tjera. Kjo lloj shprehjeje përdoret shpesh në gjuhën arabe, prandaj mendo.

shihet, ajeti u drejtohet renegatëve me një kërcënim të hapur e shumë të fortë.

Ajeti vijues flet për shkaqet që i çuan ata në renegatizëm dhe thotë: **“Këtë (dënimin e madh) e kanë ngaqë më tepër deshën jetën e kësaj bote sesa jetën e Botës Tjetër, por All’llahu nuk i udhëzon mohuesit në rrugën e drejtë”**, domethënë ata që këmbëngulin në mohimin e në arrogancën e tyre kundër Islamit.

Me pak fjalë, kur ata pranuan Islamin u dëmtuan materialisht dhe përkohësisht u vunë në rrezik interesat e tyre, por ngaqë kishin dashuri shumë të fortë për gjërat e kësaj bote, ata u penduan që kishin pranuar Islamin dhe u rikthyen në mohimin e tyre të poshtëruar.

Është e kuptueshme se ai që s’ka dëshirë të besojë dhe nuk lejon që besimi të hyjë në thellësi të shpirtit të tij, nuk përfshihet nga udhëzimi i All’llahut. Sepse udhëzimi në rrugën e drejtë ka nevojë për veprime paraprake, siç është puna për të merituar kënaqësinë e All’llahut të Gjithëfuqishëm dhe lufta në rrugën e Tij, ashtu siç e vërteton fjala e të Lartit në ajetin e fundit të sures “El Ankebût”: **“Ata që luftuan për hirin Tonë, patjetër që do t’i orientojmë në rrugët për te Ne.”**.

Ajeti i tretë i këtij grupi ajetesh shpjegon shkakun e mosorientimit të tyre në rrugën e drejtë dhe thotë: **“Të këtillëve All’llahu u mbyll zemrat, dëgjimin e shikimin”**. Domethënë se ata janë të privuar nga mirësia për të shikuar, për të dëgjuar dhe për të kuptuar të vërtetat, sepse: **“të këtillë janë të shkujdesurit”**.

Siç thamë edhe më sipër, fajet e punët e liga lënë gjurmë negative në fuqinë e njeriut për të kuptuar të vërtetat, mbi mendjen

e mbi shikimin e tij. Gradualisht prej tij hiqet mendimi i shëndoshë; sa më shumë ai hyn në rrugën e gabuar, aq më e trashë bëhet perdja e shkujdesjes që ka rënë mbi zemrën, mbi sytë e mbi veshët e tij. Megjithëse sytë i ka, por me ta nuk shikon, ka edhe veshët, por me ta nuk dëgjon, atij i mbyllen portat e shpirtit për të pranuar të gjitha të vërtetat, e humb shqisën e dallimit, pra fuqinë e dallimit të gjërave, pra ai humb mirësitë e larta të All'Ilahut.

Edhe fjala e ajetit *"tabea"* - **"i mbyll"**, është në kuptimin i vulos, i mbyll përfundimisht dhe tregon një mbyllje absolute. Për shembull, nëse një person të dojë të mbyllë një arkë në mënyrë të përsosur, që në atë arkë të mos arrijnë duart të tjera, patjetër që do ta lidhë atë me litarë e me gjëra të tjera. Pastaj i vendos edhe një vulë prej dylli mbi kapakun e arkës, me qëllim që të jetë i siguar edhe prej ndonjërit që mund t'i shkojë në mendje të hapë arkën e tij.

Më pas, ajeti në vijim shpalos fundin e punës së renegatëve dhe thotë: **"Është e vërtetë se në Botën Tjetër ata janë të humbur."**

Vallë mos këtu tregohet gjendja më e keqe për atë njeri që ka konsumuar të gjitha fuqitë e të gjitha mundësitë për të arritur lumturinë e përhershme duke ndjekur dëshirat e duke ngopur pasionet e tij.

Pasi u përmendën dy kategoritë e mësipërme, pra ata që me fjalë pohuan se janë mohues por që zërat i kishin të mbushur me besim, si dhe ata që me dëshirën e me zgjedhjen e tyre u rikthyen në mohimin e tyre të mëparshëm, ajeti vijues tregon edhe një kategori të tretë: njerëzit e thjeshtë e të mashtuar në fenë e tyre. Për këta ajeti thotë: **"Pastaj Zoti yt, atyre që pasi u torturuan, emigruan dhe luftuan e qëndruan, pas gjithë këtyre vuajtjeve, pa dyshim**

që Zoti yt është Falësi, është i Gjithëmëshirshmi (do t'i falë e do t'i mëshirojë ata).".¹

Ky ajet i nderuar është një argument i qartë që vërteton pranimin e pendimit të renegatëve, por thekson se ai që ishte idhujtar dhe më pas pranoi Islamin quhet renegat religjioz (fetar) dhe nuk është renegat natyral.²

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt i studimit tonë vjen që të bëjë një kujtesë të përgjithshme dhe thotë: **"Ditën kur çdo njeri do të përpiqet për veten e vet"**,³ domethënë që të shpëtojë veten prej ndëshkimit.

Disa herë ndodh që fajtori i mohon krejtësisht fajet që ka bërë dhe hiqet si ai që s'ka bërë asnjë faj. Ky fajtor vepron kështu me qëllim që të shpëtojë prej ndëshkimit. Ajeti 23 i sures "El En'àm" na njofton se si do të shfajësojnë fajtorët veten duke thënë: **"për All'llah, o Zoti ynë, ne nuk ishim idhujtarë"**. Sigurisht që nuk do

¹ Shumë interpretues të Kur'anit kanë thënë se fjala "*pas asaj*" ka të bëjë me sproven, kurse disa interpretues të tjerë kanë thënë se kjo fjalë i referohet emigrimit, luftës për hir të All'llahut dhe durimit, që u përmendën më sipër.

² Renegat natyral (elmurtedul fitrij) është personi i lindur prej dy prindërve myslimanë, por që e braktis Islamin pasi e ka pranuar atë; kurse renegati religjioz (elmurtedul melij'u) është personi i ngjizur prej dy prindërve jo myslimanë dhe që më pas e ka pranuar Islamin, por përsëri e braktis atë.

³ Interpretuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme në lidhje me fjalën "*ditë*"; disa kanë thënë se kjo fjalë i referohet një kryefjale të mbuluar dhe vlerësimi është se me fjalën "*ditë*", Kur'ani u kujton atyre Ditën e Gjykimit. Interpretues të tjerë janë shprehur se fjala "*ditë*" në këtë ajet është e varur me faljen e mëkateve dhe mëshirën, që në ajetin e mëparshëm u përmendën me dy emrat e bukur të Allahut "El Gafûrur Rrahimu". Gjithsesi, ne anojmë nga interpretimi i parë, sepse është më gjithëpërfshirës.

të kenë asnjë dobi prej mohimit të tyre, atëherë do të kthehen të qortojnë të parët e udhëheqësit e tyre duke thënë: **“O Zoti ynë, këta (paria) na çuan në rrugën e humbjes, prandaj shtoje dënimin e tyre në zjarr.”**. (sure “El A’ràf”, ajeti 38)

Por ata nuk do të kenë asnjë përfitim prej përpjekjeve të tyre sepse: **“çdo njeriu do t’i jepet ajo që meriton dhe atyre nuk u bëhet asnjë padrejtësi”**.

Dy Hulumtime

1- Maskimi dhe filozofia e tij

Myslimanët e parë, të cilët u edukuan prej dorës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i karakterizonte shpirti i lartë i rezistencës kundër armiqve të tyre dhe historia ka regjistruar format më të rralla të qëndrueshmërisë e të sfidimit. Ja për shembull, Jaseri nuk u dobësua dhe nga buzët e tij nuk doli as edhe një fjalë e rreme për armiq të tij, të cilët dëshironin të dëgjonin si i shqiptonte fjalët e mohimit. Por ai lakoi vetëm disa fjalë boshe, të cilat nuk lanë asnjë gjurmë në zemrën e tij të mbushur me përkushtim e me besim në All’llahun e Gjithëfuqishëm dhe me dashuri të sinqertë për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai bëri durim edhe në atë gjendje tepër të hidhur, arriti nderimin e veçantë të dëshmorit, shpirti i tij i mbushur me durim mori udhën për te Krijuesi i tij, duke llogaritur shpërblimin dhe me nijetin që të

ankohej vetëm tek Ai për mizorinë e pabesinë e armiqve të fesë së All'llahut.

Ja edhe djaloshi Ammâr, nën breshërinë e vërshëllimave të kamxhikëve që binin mbi trupin e tij dhe të dhimbjeve të forta që ndiente, prej gojës së tij dilte vetëm një tingull që mund të merrej si shenjë dobësie, kurse nga brenda ai vazhdonte të kishte siguri të plotë në vërtetimin e tij për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të cilit ai i kishte besuar. Por nga torturat ai u errësua aq shumë dhe gjymtyrët e trupit të tij vazhdonin të rrëqetheshin edhe gjatë kohës kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po i thoshte se ajo që ai kishte thënë, ishte thjesht për ruajtjen e jetës dhe vetëm kaq.

Nga historia e Bilalit mësojmë se kur ai përqafoi Islamin, vazhdoi të mbrojë thirrjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) prandaj idhujtarët e ashpërsuan dënimin mbi të. Ata e shtrinë Bilalin me kurriz të zhveshur mbi tokë nën rrezet përvëluese të diellit, por nuk u mjaftuan me kaq, i vunë mbi gjoks edhe një gur të madh. Në këtë gjendje i kërkonin të mohonte All'llahun, por Bilali nuk pranoi të plotësonte kërkesën e idhujtarëve dhe, pavarësisht se ishte nën torturë, thoshte pa pushim: (Ehad, Ehad) [Një, Një]. Pastaj tha: “Betohem në All'llahun, sikur të dija ndonjë fjalë tjetër që u rëndon më shumë se kjo, patjetër që do të shqiptoja edhe atë!”.

Lexojmë edhe historinë e Habib bin Zejdit, të cilin kur e zuri rob Musejlemeh Kedhdhàbi e pyeti: “A dëshmon se Muhammedi është i Dërguari i All'llahut?”

Ai tha: "Po."

E pyeti përsëri: "A dëshmon se unë jam i Dërguari i All'llahut?"

Ai iu përgjigj me tallje: "Nuk e dëgjova se ç'the!" dhe ata e prenë atë copa-copa.¹

Historia e Islamit ka shumë e shumë ndodhi të këtilla, veçanërisht historia e myslimanëve të parë dhe e ndjekësve të Imamëve të ruajtur prej mëkateve.

Për të gjitha këto, studiuesit kanë thënë: "Heqja dorë nga metoda e maskimit dhe mosdorëzimi në dorën e armiqve në të këtilla gjendje, është veprim i lejuar edhe sikur të çojë në rënien dëshmor, sepse qëllimi i sakrifikimit të jetës është tepër i lartë, është ngritja e flamurit të Njësimit (Teuhidit) dhe lartësimi i fjalës së Islamit. Veçanërisht kjo ishte një metodë lufte e lejuar në fillimet e thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur çështja e ruajtjes së jetës së myslimanëve ishte e një rëndësie të veçantë".

Maskimi në disa raste është veprim i lejuar, në disa të tjera është detyrim, sepse ruajtja e jetës në vendin e duhur nuk është shenjë dobësie, nuk tregon as frikë prej pushtetit e prej egërsisë së armikut, nuk është as dorëzim në dorën e armikut. Përkundrazi është një manovrim i llogaritur për ruajtjen e kapaciteteve njerëzore dhe mostejkalimin e masës në destinimin e individëve besimtarë të problemeve të vogla e më pak të rëndësishme.

¹ "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 5, f. 284.

Te të gjithë popujt është e njohur metoda e punës klandestine që përdorin grupet e vogla të luftëtarëve për maskimin e individëve dhe për të përgatitur kushtet që ato të shumohen. Për këtë qëllim, ata formojnë grupe sekrete, vënë për veten e tyre programe pune, të cilat nuk ua bëjnë të njohur të tjerëve, madje disa prej individëve të këtyre grupeve përpiqen të maskohen edhe falë veshjeve që mbajnë. Kur pushteti kundërshtar i parimeve të tyre arrin t'i arrestojë, ata me aq sa kanë mundësi, përpiqen të mohojnë të vërtetën e punës së tyre, me qëllim që grupet klandestine të mos e humbin të gjithë fuqinë e tyre, njëkohësisht të ruajnë edhe aftësinë për të vazhduar rrugën e luftës kundër dhunës edhe me ata pak që kanë mbetur prej tyre.

Në të këtilla gjendje, logjika nuk e pranon që grupet luftarake me numër të vogël luftëtarësh të dalin sheshit, ndryshe ata do të njiheshin prej armikut, i cili me egërsinë që e karakterizon dhe me fuqinë e mjetet që disponon, është në gjendje t'i asgjësojë të gjithë.

Maskimi (*et tekij'jeh*) para se të jetë një program islam, është një metodë logjike, metodë që e zbaton dhe punon me të ai që jeton në luftë me një armik të fuqishëm e me mundësi të shumta mposhtëse.

Në shumë hadithe të nderuara për metodën e maskimit (*et tekij'jeh*) është përdorur termi *mburojë*. Prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet se ai ka thënë: "Maskimi është mburoja e besimtarit, maskimi është sigurimi i lirisë për besimtarin".¹

¹ "Uesàilush Shijah", vëll. 11, hadithi nr. 6 prej kapitullit nr. 25 të korpusit: "Urdhërimi për punë të mirë".

(Për metodën e maskimit këtu është përdoruar fjala *mburojë*, sepse mburoja përdoret në sheshet e betejave të luftërave me armiq të për të mbrojtur forcat revolucionare.)

Kur konstatojmë se hadithet e nderuara e konsiderojnë maskimin (*et tekij'jeh*) prej shenjave të fesë e të besimit dhe e vlerësojnë atë me nëntë të dhjetat e fesë, në të vërtetë ky vlerësim vjen për shkakun e lartpërmendur.

Struktura e librit tonë është e atillë që këtu nuk mund të trajtohen hollësi rreth çështjes së maskimit (*et tekij'jeh*), madje edhe aq sa folëm rreth kësaj çështjeje, në të vërtetë ishte një shpjegim kalimthi për ata që e mohojnë dhe kundërshtojnë ruajtjen e jetës (*et tekij'jeh*) si metodë pune islame. Atyre u themi se ata s'kanë dijeni rreth kushteve kur mund të praktikohet metoda e maskimit dhe patjetër që nuk e njohin as filozofinë e ruajtjes së jetës.

Ka edhe raste kur metoda e maskimit (*et tekij'jeh*) është e ndaluar rreptësisht, si për shembull në rastet kur maskimi bëhet shkak për asgjësimin e vetë fesë ose për një shkatërrim të madh. Në këtë gjendje bëhet detyrim thyerja e rrethit të metodës së maskimit, njëkohësisht në përputhje me situatën, bëhet detyrim taksativ përballimi i çdo rreziku.¹

¹ Për më shumë sqarime rreth çështjes së maskimit (*et tekij'jeh*), dispozitave, filozofisë dhe argumenteve të saj, lexo librin tonë me titull: "El Kauàidul fikhij'jeh", pjesa e tretë.

2- Renegati natyral, renegati i ardhur prej jomyslimanëve dhe të mashtruarit

Islami nuk u kundërvihet ithtarëve të librave të mëparshëm (jehuditëve dhe të krishterëve) me ashpërsi, por u bën vazhdimisht thirrje dhe bisedon me ata me logjikë të shëndoshë. Kur ata nuk vetëbinden e janë të vendosur të qëndrojnë në fetë e veta përkatëse, atyre u jepet siguria dhe merret përsipër ruajtja e jetës, e pasurive dhe e interesave të tyre të ligjshme, vetëm pasi ithtarët e librave të mëparshëm e kanë pranuar marrëveshjen për të jetuar së bashku me myslimanët.

Për sa u përket jomyslimanëve që e pranojnë Islamin dhe më pas e braktisin atë, këtyre renegatëve Islami u kundërvihet me ashpërsi e me dhunë, sepse një veprim i këtillë çon në dëme shumë të mëdha që prekin shoqërinë islame. Thënë ndryshe, renegatizmi është një lloj lufte me armë kundër qeverisë islame. Shpeshherë prej renegatëve kanë dalë punë me pasoja shumë të këqija, duke i vënë sekretet e shoqërisë islame (pikat e fuqishme dhe të dobëta) në dorën e qarqeve armike, të cilat vazhdimisht qëndrojnë në vëzhgim të gjendjes së myslimanëve.

Ai që është ngjizur prej dy prindërve myslimanë (i linduri mysliman) dhe më pas gjykata islame vërteton se ai e ka braktisur Islamin, ekzekutimi i këtij renegati është i lejuar, pasuria e tij pjesëtohet ndër trashëgimtarët e tij, gruaja divorcohet prej tij, atij nuk i pranohet as pendimi (teubeja). Domethënë se këto tri dispozita janë vepruese në të drejtën e tij në të gjitha gjendjet; por kur ai pendohet singërisht, në të vërtetë pendimi i tij (teubeja) do të pranohet tek All'llahu i Lartësuar, kurse pendimi (teubeja) e gruas pranohet pa asnjë kusht.

Kur Islamin e braktis një i lindur prej jomyslimanëve, atij i kërkohet të pendohet dhe nëse ai pendohet me të vërtetë, pendimi i tij pranohet dhe ai shpëton prej dënimit.

Në vendimin politik të dalë në të drejtën e renegatit natyral (renegati i lindur prej dy prindërve myslimanë) mund të konstatohet një lloj ashpërsie, imponim të besimit dhe ndalim me dhunë i lirisë së mendimit. Por, në vërtetë këto dispozita janë të veçanta vetëm për atë që i shpall sheshit doktrinat e tij që janë në kundërshtim të hapur me Islamin, ose për atë që i propagandon këto doktrina. Tri dispozitat islame të lartpërmendura nuk shtrihen mbi mbartësit e doktrinave të këtilla, kur ata nuk i propagandojnë ato në mesin e njerëzve. Propagandimi i doktrinave që kundërshtojnë Islamin, në të vërtetë përfaqëson një luftë kundër sistemit shoqëror ekzistues. Për rrjedhojë, në këtë gjendje ashpërsia nuk është veprim i kotë, as nuk është në kundërshtim me lirinë e mendimit e të besimit, ashtu siç kemi thënë se një ligj i ngjashëm me këtë është veprues me disa ndryshime në shumë shtete arabe dhe në shumë shtete të lindjes.

Mjafton të tërheqim vëmendjen se pranimi i Islamit patjetër duhet të jetë në përputhje me logjikën. Ai që lind prej dy prindërve myslimanë dhe rritet në mjedis mysliman, e kupton përmbajtjen e Islamit. Për këtë arsye, renegatizmi dhe heqja dorë prej Islamit nga ana e tij janë të ngjashëm me tradhtinë nga ana e tij për të mos e kuptuar të vërtetën, prandaj ai e meriton plotësisht atë që është shkruar në lidhje me të drejtën e tij për t'u dënuar.

Zakonisht, dispozitat islame nuk janë të veçanta vetëm për një person ose për dy persona, por tek to përfshihet një grup i përgjithshëm.

Ajetet 112 - 114

﴿وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا قَرْيَةً كَانَتْ آمِنَةً مُطْمَئِنَّةً يَأْتِيهَا رِزْقُهَا رَغَدًا مِنْ كُلِّ مَكَانٍ فَكَفَرَتْ بِأَنْعُمِ اللَّهِ فَأَذَاقَهَا اللَّهُ لِبَاسَ الْجُوعِ وَالْخَوْفِ بِمَا كَانُوا يَصْنَعُونَ ١١٢ وَلَقَدْ جَاءَهُمْ رَسُولٌ مِنْهُمْ فَكَذَّبُوهُ فَأَخَذَهُمُ الْعَذَابُ وَهُمْ ظَالِمُونَ ١١٣ فَكُلُوا مِمَّا رَزَقَكُمْ اللَّهُ حَلَالًا طَيِّبًا وَاشْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ١١٤﴾

“All’l-lahu sjell shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit furnizimi i vinte nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) u treguan mosmirënjohës ndaj të mirave të All’l-lahut, atëherë All’l-lahu i veshi (i sprovoi ata) atyre rrobën e urisë dhe të frikës për shkak të punëve të tyre.”

“Atyre që u erdhi i Dërguari prej mesit të tyre, e përgënjeshtroan atë dhe ata i zuri dënimi për shkak se ishin despotë.”

“Ju (besimtarët) hani prej të mirave të lejuara e të pastra që u ka dhënë All’l-lahu dhe falënderoni për mirësitë e All’l-lahut nëse adhuron vetëm Atë.”

Komentimi

Të dënuarit për shkak të mosmirënjohjes:

Shpesh kemi përsëritur se kjo është surja e mirësive materiale, morale dhe mirësive në të gjitha fushat. Ato janë përmendur në shumë ajete të kësaj sureje të uruar.

Ajetet që i kemi objekt studimi na japin një panoramë të përfundimit të mosmirënjohjes ndaj mirësive të All'llahut në formën e një shembulli konkret.

Kjo panoramë kur'anore fillon duke sjellë një shembull për cilindo që nuk falënderon për mirësitë e All'llahut që i janë dhënë. Ajeti thotë: **“All'llahu sjell shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt”,** banorët e atij fshati s'ishin të detyruar të merrnin rrugët e emigracionit, por jetonin në siguri e të qetë, sepse, përveç kësaj, atyre: **“të cilit furnizimi i vinte nga të gjitha anët me bollëk”**.

Por gjendja e atij fshati më në fund ndryshoi: **“atëherë All'llahu u veshi (i sprovoi ata) atyre rrobën e urisë dhe të frikës për shkak të punëve të tyre”**.

All'llahu jo vetëm që u kishte plotësuar atyre mirësitë materiale, por kishte shtuar për ata edhe mirësitë morale. Kjo mundësonte për ta një gjendje të stabilizuar në jetën e kësaj bote që do të vazhdonte edhe në Botën Tjetër, pasi All'llahu prej mesit të tyre kishte dërguar tek ata Profetë dhe mësimet qiellore, ashtu siç thotë ajeti vijues: **“Atyre që u erdhi i Dërguari prej mesit të tyre, ata e përgënjeshtroan atë dhe ata i zuri dënimi për shkak se ishin despotë”**.

Edhe ju o besimtarë, kur lexoni këto shembuj konkretë prej popujve të mëparshëm, nxirrni mësim dhe mos ndiqni rrugën e atyre të shkujdesurve e mizorëve që ishin mosmirënjohës ndaj mirësive të All'llahut! Por: **“Ju (besimtarët) hani prej të mirave të lejuara e të pastra që u ka dhënë All'llahu dhe falënderoni për mirësitë e All'llahut nëse adhuron vetëm Atë.”**.

Hulumtime

1- Është shembull apo ngjarje historike

Ajetet e mësipërme e përshkruan zonën e banuar të përmendur në ajetin tonë si zonë me mirësi të shumta. Gjithashtu ajeti njofton se banorët e asaj zone u sprovuan me uri e me frikë sepse u treguan mosmirënjohës ndaj mirësive të All'llahut. Kjo e vërtetë është shprehur me fjalën *“methelen”* - **“shembull”**; përveç kësaj, konstatohet se në ajetin në fjalë, folja është përdorur në kohën e shkuar, çka tregon se ngjarja ka ndodhur konkretisht në të kaluarën. Por, pikërisht këtu ndeshemi edhe me mendimet e ndryshme të interpretuesve në lidhje me qëllimin e sqarimit kur'anor. Një pjesë mbështesin mendimin se qëllimi me fjalën *“shembull”* është thjesht sjellja e një shembulli në përgjithësi, kurse pjesa e dytë e tyre mbështesin mendimin se kjo fjalë shpjegon një ngjarje historike të njohur.

Mbështetësit e mendimit të parë kanë shkuar deri aty sa të kufizojnë edhe zonën në të cilën ka ndodhur ajo ngjarje, kurse disa

interpretues të tjerë janë shprehur se zona për të cilën flet ajeti është toka e Mekës, sepse ajeti thotë: **“të cilit furnizimi i vinte nga të gjitha anët me bollëk”**. Kjo frazë e ajetit e përforcon këtë mundësi, sepse është një argument që tregon se ajo është zonë e thatë dhe banorëve të asaj zone u vjen nga jashtë çdo gjë për të cilën kanë nevojë, siç tregohet edhe në ajetin 57 të sures “El Kasas”: **“aty sillen frutat të llojlojshme”**. Kjo frazë e këtij ajeti e përforcon kuptimin e parë, veçanërisht kur kemi parasysh se interpretuesit e Kur’anit Famëlartë ndajnë një mendim të përbashkët të formës së prerë se ajeti tregon se ai vend është Meka e nderuar.

Mirëpo ky pretendim hidhet poshtë nga fakti që në historinë e Mekës nuk dihet qartë të ketë ngjarë një ndodhi e tillë, sepse nuk dihet nëse banorët e saj kanë jetuar në bollëk, pastaj mbi ata të ketë ardhur thatësira e uria!

Interpretues të tjerë të Kur’anit kanë thënë: kjo histori ka ndodhur me një grup prej Beni Israilëve (jehuditëve) banorë të një zone, të cilët u sprovuan me thatësi e me frikë për shkak se u treguan mosmirënjohës ndaj mirësive të All’llahut.

Këtë mendim të fundit e përforcon transmetimi i ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Një grupi njerëzish prej Beni Israilëve u jepej ushqim me aq shumicë, sa ata prej këtij ushqimi bënë statuja nëpër qytetet e vendit të tyre. Në kushtet e urisë e të frikës me të cilat i sprovoi All’llahu, ata i përdorën statujat si mjete shpëtimi dhe, nga nevoja e madhe u

detyruan t'i shisnin e t'i hanin statujat e tyre, ashtu siç është fjala e All'Ilahut: **"All'Ilahu sjell shembull..."**.¹

Ka edhe transmetime të tjera të përafërta në përmbajtje, të transmetuara prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), si dhe tefsiri i Ali bin Ibrahim, por nuk është e mundur të realizohet vërtetimi i plotë i përcjellësve të këtyre transmetimeve, ndryshe çështja do të ishte e qartë.²

Ka edhe një mendim tjetër që thotë se ajeti tregon për popullin e Sebeit, të cilët kanë jetuar në Jemen. Kur'ani Famëlartë e përmend historinë e këtij populli në ajetet 15-19 të sures "Es Sebe" dhe tregon se ata banonin në një tokë të mbushur me fruta e mirësi të shumta. Jetonin në siguri e në paqe, derisa te ta u shfaqën arroganca, tirania, mendjemadhësia dhe mosmirënjohja ndaj mirësive të All'Ilahut, atëherë Ai i shkatërroi ata plotësisht dhe bëri që të tjerët të nxirrnin mësim prej pësimit të tyre.

Fraza e ajetit **"të cilit furnizimi i vinte nga të gjitha anët me bollëk"**, nuk përbën argument të formës së prerë që ai vend nuk ishte i banuar, pasi me fjalën **"nga të gjitha anët"**, qëllimi mund të jetë për rrethinat e atij vendi, ashtu siç dihet se prodhimet bujqësore të një rajoni të madh, transportohen në kryeqendrën e atij rajoni.

Duhet të rikujtojmë se s'ka asnjë pengues që theksimi i ajetit të mos përfshijë të gjitha mundësitë që u përmendën.

¹ Tefsiri "Nüruth Thekalejn", vëll. 3, f. 91. Konstatohet se transmetimi është cituar prej tefsirit të "El A'jashit", hadithet e të cilit janë të gradës "Mursel".

² Burimi i mësipërm.

Sido që të jetë, në komentin e këtij ajeti nuk është problemi vetëm një vend, pasi zonat e prekura nga të këtilla ndodhi janë të shumta gjatë historisë.

Mungesa e sigurisë së mjaftueshme si element për të përcaktuar vendndodhjen e asaj zone i kanë shtyrë disa interpretues të Kur'anit Famëlartë të marrin në konsideratë se vendi i përmendur është një shembull i përgjithshëm dhe jo thjesht një zonë e përcaktuar. Gjithsesi, ajeti që po studiojmë nuk është në harmoni me këtë interpretim, pasi tregon ekzistencën e një zone të përcaktuar dhe një ngjarje historike që ka ndodhur aty.

2- Lidhja ndërmjet sigurisë dhe furnizimit me bollëk

Tri ajetet që janë objekt studimi përmendën tri veçori të asaj zone të banuar të begatshme:

- a) siguria;
- b) vazhdimi i jetës në qetësi;
- c) ardhja e ushqimeve të shumta në atë vend.

Këto tri veçori kanë një lidhje tepër të fortë ndërmjet njëra-tjetrës. Sipas renditjes, secila veçori ka lidhje me veçorinë para saj. Nëse nuk do të ekzistonte siguria, njeriu nuk do të ishte i qetë për të vazhduar jetën e tij në një vend të caktuar dhe, nëse nuk do të ekzistonin as siguria, as qetësia, atëherë askush s'do të kishte dëshirë të punojë e të përmirësojë gjendjen ekonomike në atë vend.

Ajeti jep një mësim praktik për cilindo që ka dëshirë të jetojë në një vendbanim të lirë e të pavarur. Që njerëzit të jetojë në një vend, para së gjithash kanë nevojë për një gjendje sigurie, më pas vjen qetësia në zemrat e tyre në lidhje me të ardhmen e ekzistencës së tyre në atë zonë apo rajon. Vetëm pas sigurisë e qetësisë i vjen radha vënies në lëvizje të mekanizmave të ekonomisë.

Këto tri mirësi materiale i çojnë shoqëritë në shkallën e plotësimit të jetës së tyre materiale dhe të një jete të integruar në të gjitha anët, materiale e morale, por shoqëritë patjetër kanë nevojë edhe për mirësinë e madhe të besimit e të Njësimit (Teuhidit) - *besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm*. Prandaj pas përmendjes së këtyre mirësive, ajeti vijues thotë: **“Atyre që u erdhi i Dërguari prej mesit të tyre.”**.

3- Gjendja e urisë dhe e frikës

Ajeti shpjegon përfundimin e mosmirënjohësve ndaj mirësive të All'llahut dhe thotë: **“atëherë All'llahu u veshi** (i sprovoi ata) **atyre rrobën e urisë dhe të frikës”**. Nga njëra anë uria e frika janë shëmbëllyer me rrobën, nga na tjetër, ajeti thotë **“e bëri të shijojë”**, në vend që të thoshte “e veshi atë”.

Ky ndryshim në shprehje ka bërë që interpretuesit e Kur'anit Famëlartë të mendojnë mbi kuptimin e këtij ajeti.

Shprehja e ajetit thekson një kuptim gjuhësor tepër të hollë e të këndshëm. Ja një shembull ilustrues nga replika klasike e letrarit El Arabij me një mendjemadh:

“Ibn Err Rràuendij i tha letrarit Ibni Arabij: ‘A shijohet rroba?’

Ibni Arabiu tha: ‘S’ka problem e s’ka rrobë; o ti gjysmënjeri, zgjohu! Në të vërtetë, ti dyshon që Muhammedi nuk ishte profet ose nuk ishte arab!’”¹

Sido që të jetë, kjo shprehje e ajetit tregon se thatësira e frika ishin aq të mëdha, sikur të ishin një rrobë e cila kishte mbështjellë trupat e atyre njerëzve nga të gjitha anët, madje sikur trupat e tyre e preknin fizikisht thatësirën e frikën. Nga ana tjetër, gjendja e frikës dhe thatësira tek ata kishte arritur në atë shkallë, sa atyre i dukej sikur po e shijonin këtë gjendje me gjuhët e tyre.

Kjo shprehje tregon gjendjen më të rënduar të frikës dhe atë të varfërisë së tejskajshme që mund të prekë të gjithë qenien e njeriut.

Në fillim, e gjithë qenia e tyre ishte e rrethuar nga mirësia e sigurisë dhe e mirëqenies, por më pas këtë vend tek ata e zuri varfëria dhe frika. Ky ndryshim i gjendjes atyre u erdhi si rezultat i mosmirënjohjes ndaj mirësive të All’llahut.

¹ Tefsiri i “Fakhru Rràzijit, vëll. 20, f. 128.

4- Efekti i mosmirënjohjes ndaj mirësive në ngushtimin e gjithanshëm të dhuntive të Zotit

Në transmetimin e mësipërm pamë se si e pastronin ata që ishin në mirëqenie trupin e tyre me ushqimet, kur tek ata u bë zotëruese shkujdesja, e cila i çoi në arrogancë. Për rrjedhojë, All'llahu i sprovoi ata me thatësi të me frikë.

Shpalosja e kësaj ndodhie bëhet vetëm e vetëm që njerëzit dhe të gjitha kombet që i kanë mbuluar mirësitë e Zotit t'u tërhiqet vëmendja se shpërdorimi e shpenzimi i kotë, si dhe çuarja dëm e mirësive të All'llahut, nuk shpëtojnë dot prej dënimit e prej gjobës tepër të rëndë.

Patjetër që ajeti u tërheq vëmendjen edhe atyre që vazhdimisht e hedhin gjysmën e ushqimit të tyre në koshin e mbeturinave, sa herë që shtrojnë në tryezë më shumë nga sa kanë nevojë.

Gjithashtu është një tërheqje vëmendjeje edhe për ata që përgatisim ushqim të mjaftueshëm për njëzet vetë, ndërsa kanë vetëm katër miq, por ky ushqimi i tepërt nuk shkon për të ngopur të uriturit.

Ajeti u tërheq vëmendjen edhe atyre që grumbullojnë nëpër shtëpitë e tyre ushqime të tepërta për përdorim personal, si dhe atyre që mbushin magazinat me ushqime dhe i mbajnë aty në pritje të ngritjes së çmimit në treg, në një kohë që ishte e mundur të shiteshin me një çmim të arsyeshëm para se të prisheshin e të kalbeshin. Rezultati: askush nuk përfitoi prej atyre ushqimeve.

Po, asnjë punë nga ato që u përmendën nuk shpëton prej dënimit Hyjnor dhe, dënimi më i vogël me të cilin mund të dënohen shpërdoruesit e mosmirënjohësit është heqja e këtyre mirësive prej tyre.

Rëndësia e çështjes bëhet edhe më e qartë, sepse ne e dimë se ushqimet në të gjithë sipërfaqen e tokës janë relativisht të kufizuara, prandaj çdo teprim në të gjitha llojet e ushqimeve, patjetër do të çojë në privimin e një pjese të njerëzimit prej atyre ushqimeve.

Kjo çështje theksohet me forcë edhe në transmetimet e nderuara, ashtu siç transmetohet prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Baba im e konsideronte veprim të padenjë të fshinte dorën në shami kur në dorë kishte sadopak ushqim. Këtë e bënte për të treguar rëndësinë e ushqimit, prandaj ai e fuste në gojë edhe atë pak ushqim që mund të ishte në dorën e tij. Ai bënte të njëjtin veprim edhe kur pranë tij ndodhej një fëmijë dhe thoshte: ‘Unë e kam më të lehtë të futem brenda në havan dhe ta kontrolloj atë, pa le të qeshë shërbyesi’. Pastaj tha: ‘Banorëve të fshatit që kanë jetuar para jush, All’llahu u kishte dhënë aq shumë, sa ata u bënë tiranë dhe disa prej tyre u thanë të tjerëve: ‘Kur duam, ne pastrohemi prej jashtëqitjes me këto ushqime, në vend që të pastrohemi me gurë, pasi ato janë më të buta se gurët’. Në vijim ai tha: ‘Kur ata e bënë edhe këtë veprim të ulët, All’llahu hodhi në tokën e tyre një insekt të vogël që nuk la pa ngrënë bimë, asnjë pemë e gjithçka tjetër që ka krijuar All’llahu dhe, puna për ata arriti deri atyre sa të kthehen e të hanë atë ushqim me të cilin kishin pastruar jashtëqitjen’; ky është ai fshati për të cilin All’llahu i lartësuar thotë: ‘**All’llahu sjell shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë... për shkak të punëve të tyre.**’”.

Ajetet 115 - 119

﴿إِنَّمَا حَرَّمَ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةَ وَالدَّمَ وَلَحْمَ الْخِنْزِيرِ وَمَا أُهِلَّ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ فَمَنِ اضْطُرَّ غَيْرَ بَاغٍ وَلَا عَادٍ فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ﴾^{١١٥} وَلَا تَقُولُوا لِمَا تَصِفُ أَلْسِنَتُكُمُ الْكَذِبَ هَذَا حَلَالٌ وَهَذَا حَرَامٌ لِتَفْتَرُوا عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ إِنَّ الَّذِينَ يَفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ لَا يُفْلِحُونَ^{١١٦} مَتَاعٌ قَلِيلٌ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ^{١١٧} وَعَلَى الَّذِينَ هَادُوا حَرَّمْنَا مَا قَصَصْنَا عَلَيْكَ مِنْ قَبْلُ وَمَا ظَلَمْنَاهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ^{١١٨} ثُمَّ إِنَّ رَبَّكَ لِلَّذِينَ عَمِلُوا السُّوءَ بِجَهَالَةٍ ثُمَّ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ وَأَصْلَحُوا إِنَّ رَبَّكَ مِنْ بَعْدِهَا لَغَفُورٌ رَحِيمٌ﴾^{١١٩}

“Ai ka ndaluar (ka bërë haram) për ju cofëtinat, gjakun, mishin e derrit dhe atë (kafshën) që nuk theret me emrin e All’llahut (nuk flijohet për hir të All’llahut) dhe, kush detyrohet (të hajë prej këtyre të ndaluarave) duke mos qenë dhunues dhe pa e tepruar (në ngrënie), All’llahu është Falësi (i mëkatit) dhe Mëshiruesi.”

“Mos thoni për rrenën që lakojnë gjuhët tuaja, kjo është hallall dhe kjo është haram, e të shpifni rrena ndaj All’llahut; pa dyshim ata që shpifin rrenën ndaj All’llahut nuk kanë shpëtim.”

“Pak kënaqësi (në këtë jetë) dhe për ata do të ketë një dënim shumë të dhimbshëm.”

“Jehuditëve u patën ndaluar (bërë haram) ato që të kemi treguar më parë; Ne nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata i bënë vetes padrejtësi.”

“Pastaj Zoti yt për ata që nga padija bënë punë të këqija dhe më pas u penduan e bënë punë të mira, s’ka dyshim që Zoti yt pas kësaj është Falësi e Mëshirëploti.”

Komentimi

S’ka shpëtim për gënjeshtarët

Ajetet e mësipërme trajtuan çështjen e mirësive të Zotit dhe atë të falënderimit për mirësitë; kurse ajetet që janë objekt studimi flasin për pjesën e fundit të temës dhe shtrojnë çështjen e gjërave të ndaluara konkrete e jokonkrete, për të ndarë fenë e vërtetë prej sajësave që janë bërë mbi fenë e All’llahut. Ajeti fillon me fjalën: **“Ai ka ndaluar** (ka bërë haram) **për ju cofëtinat, gjakun, mishin e derrit dhe atë (kafshën) që nuk theret me emrin e All’llahut** (nuk flijohet për hir të All’llahut).”¹

¹ Në tekstin e Kur’anit fjala *“nuk theret”*, ka ardhur me fjalën *“uhil’le”*, rrënja e kësaj fjale është fjala *“hilâl”* - fillimi i daljes së hënës së re - në kuptimin e ngritjes së zërit në çastin e shikimit të hënës së re. Duke ditur që idhujtarët kur thernin

Çështjen e bërjes haram të cofëtinave, gjakut dhe mishit të derrit e kemi trajtuar në mënyrë të hollësishme në interpretimin tonë të ajetit 173 të sures “El Bekare”.

S’ka njeri që në ditët tona të mos e dijë që këto tri gjëra janë të ndotura: cofëtinat janë burim për lloje të ndryshme mikrobesh; gjaku është prej lëndëve të trupit që e pranon më shumë ndotjen me mikrobe, kurse mishi i derrit konsiderohet shkak për shumë sëmundje të rrezikshme. Përveç kësaj (ashtu siç kemi thënë në komentimin tonë të sures “El Bekare”), ngrënia e mishit të derrit dhe gjakut kanë efekt shumë të rrezikshëm për gjendjen shëndetësore e morale të njeriut, për shkak të efektit që këto dy lloje gjërash të ndaluara lënë në hormonet e trupit (te cofëtina ndotja shumëfishohet, për shkak të mostherjes dhe daljes së gjakut prej saj).

Për sa i përket filozofisë së ndalimit (bërjes haram) të kafshës që nuk është therur me emrin e All’llahut (kur politeistët flijonin kafshën, në vend që të përmendnin emrin e All’llahut, përmendnin emrat e idhujve të tyre ose nuk thoshin asnjë fjalë). Mishrat e këtyre kafshëve nuk janë të shëndetshme për ngrënie, madje nuk janë të mira as nga ana morale. Ne nuk e dimë plotësisht shkakun e bërjes hallall e haram në Islam, por dimë se krahas problemit shëndetësor të gjërave të ndaluara, ato janë të ndaluara edhe për dëmin moral që sjellin. Ato janë bërë haram që të edukohet shpirtit dhe të shikohet edhe në anën morale të gjërave të ndaluara. Ndalimi në disa gjendje mund të vijë edhe për të ruajtur sistemin shoqëror.

kafshët kushtuar idhujve, thërrisnin me zë të lartë emrat e idhujve të tyre, prandaj në Kur’an fjala “theret” ka ardhur me fjalën “uhil’le”.

Bërja haram e mishit të therur pa përmendur emrin e All'llahut (pa thënë *Bismil'làh, All'llahu Ekber*), në të vërtetë është bërë haram nga këndvështrimi moral. Nga njëra anë, ky ndalim është një luftë e hapur kundër politeizmit dhe adhurimit të idhujve, nga ana tjetër është një thirrje për të besuar vetëm në Krijuesin e këtyre mirësive.

Nga përmbajtja e përgjithshme e këtij ajeti dhe e ajeteve vijuese mësohet se Islami porosit ngrënien e mishrave me masë. Myslimanët nuk janë si ata që i ndaluan (i bënë haram) vetes ngrënien e mishrave dhe hanë vetëm ushqime me bazë bimore (vegjetarianët), por nuk janë as si ata që i lejuan vetes (bënë hallall) të hanë të gjitha mishrat, ashtu siç bënin ata të kohës së injorancës para Islamit dhe ashtu siç bëjnë në ditët tona disa që pretendojnë qytetërimin, që lejojnë ngrënien e mishit të këlyshëve të vegjël që kanë humbur nënën, gaforres e të disa lloje krimbash.

Anë të një pyetjeje

Këtu lind pyetja: ajeti i nderuar përmendi katër lloje kafshësh të ndaluara të hahen, e gjithë kafsha ose disa pjesë të saj. Ne dimë se llojet e mishrave të ndaluara janë më shumë nga sa janë përmendur, pasi në disa sure të Kur'anit janë përmendur më shumë se katër lloje, ashtu siç thuhet në ajetin 3 të sures "El Mâide".

Atëherë përse në këtë ajet janë bërë haram vetëm katër lloje mishrash?

Përgjigjja: ashtu siç kemi thënë edhe në interpretimin e ajetit 145 të sures "El En'am", kufizimi që gjendet në ajetin tonë, është një

kufizim shtesë. Domethënë se qëllimi i përdorimit të parafjalës “*in’nemà*” është pikërisht për të saktësuar kufizimin, për të mohuar e për të hedhur poshtë sajemat e shpifjet që bënëin politeistët kur bënëin haram mishin e disa kafshëve. Nga këtu, sikur Kur’ani u thotë atyre: “Këto gjëra janë haram, jo, ç’thoni kështu!”.

Ka edhe një mundësi tjetër, në kuptimin që këto katër lloje mishrash të ndaluara janë themelore, pasi edhe kafsha e mbytur nga litari e përmendur në ajetin e sures “El Màide” me fjalën “*el munkhanikah*”, hyn në njërën prej këtyre katër kategorive të ndaluara, konkretisht në atë të cofëtinave.

Për sa u përket llojeve të kafshëve të tjera të ndaluara, si për shembull bishat, këto vijnë në shkallë të dytë, kështu që dispozita për ndalimin e mishit të bishave ka ardhur me synetin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Prandaj edhe nëse do të kufizohemi në bërjen haram të vetëm këtyre katër gjërave të përmendura në ajetin tonë, ajeti tregon një kufizim të vërtetë, por ti mendo.

Në fundin e ajetin dhe në përputhje me metodën kur’ànore, në Kur’àn përmenden edhe gjendjet e përveçme kur mund të lejohet ngrënia e mishrave të ndaluara. Ajeti thotë: “**dhe, kush detyrohet** (të hajë prej këtyre të ndaluarave)”, si për shembull për atë që gjendet në shkretëtirë dhe s’ka ushqim, por “**duke mos qenë dhunues dhe pa e tepruar** (në ngrënie), **All’llahu është Falësi** (i mëkatit) **dhe Mëshiruesi**”.

Fjala *dhunues* në tekstin e Kur’ànit ka ardhur me fjalën “*bàgin*” në kuptimin e kërkimit të shijes ose të bërjes hallall të asaj që All’llahu e ka bërë haram.

Kurse fjala *pa e tepruar* ka ardhur me fjalën “àdin” – “tejkalim”, këtu është në kuptimin e ngrënies nga gjërat e ndaluara më shumë nga sa është e domosdoshme.

Në hadithet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) fjala “el bàgij” është komentuar në kuptimin *dhunuesi* e mizori, kurse fjala “el àdij” në kuptimin *rrëmbyesi*. Gjithashtu, fjala “el bàgij” është komentuar edhe në kuptimin e atij që del kundër Imamit të kohës së tij, kurse fjala “el àdij” është komentuar edhe me vjedhësin.

Bazuar në transmetimet e përmendura bëhet e mundur mbartja e këtyre kuptimeve për rastet e ndryshme të gjendjes së detyruar që mund të ndodhë gjatë udhëtimit. Për shembull, kur një person udhëton me qëllim për të bërë mizori me qëllim grabitjeje apo vjedhjeje, por më pas ai detyrohet të hajë prej këtyre gjërave të ndaluara, faji i këtij personi nuk falet edhe nëse ai ka ngrënë nga ato për të ruajtur jetën nga vdekja e sigurt prej urisë.

Sido që të jetë, këto që u thanë nuk janë në kundërshtim me ato që kanë ardhur në tefsiret në lidhje me kuptimin e përgjithshëm të ajetit, pasi është plotësisht e mundur që këto kuptime të mblidhen së bashku.

Ajeti vijues shtron çështjen e bërjes haram prej politeistëve të disa mishrave pa asnjë shkak e pa asnjë argument. Më sipër, Kur’ani Famëlartë e ka prekur këtë çështje jo drejtpërdrejtë, kurse ajeti në fjalë e shtron qartë dhe thotë: **“Mos thoni për gënjeshtren**

që lakojnë gjuhët tuaja, kjo është hallall dhe kjo është haram, e të shpifni rrena ndaj All'llahut".¹

Domethënë: këto fjalë që thoni ju janë gënjeshtër e thënë sheshit, janë fjalë që lakojnë gjuhët tuaja sipas dëshirave që ju keni për të bërë hallall një send dhe për të shpallur haram një send tjetër! (Ajeti thekson se politeistët disa bagëti i kishin shpallur të ndaluara (haram) për veten e tyre, kurse disa të tjera i kishin bërë hallall, pasi më parë një pjesë prej mishit të atyre bagëtive e kishin ndarë për idhujt e tyre).

Vallë, All'llahu u ka dhënë të drejtën për të vënë ligje? Apo mendimet tuaja të devijuara dhe traditat tuaja të verbra ju shtyjnë të bëni sajesa të këtilla? A nuk është ky veprim i juaji rrenë dhe shpifje kundër All'llahut!

Në ajetin 136 të sures "El En'àm" thuhet qartë: **"Nga ajo që Ai krijoi prej drithërave e prej kafshëve shtëpiake, ata (idhujtarët) ndanë një pjesë për All'llahun sipas mendimit të tyre të gabuar thanë: kjo është për All'llahun, kurse kjo pjesa tjetër është për idhujt tonë; pjesa që ishte për idhujt, nuk shkon te All'llahu, kurse pjesa që ishte për All'llahun shkonte te idhujt e tyre; sa keq gjykonin ata."**

Edhe ajeti 148 i sures "El En'àm" njofton po të njëjtën çështje: **"Politeistët (mushrikët) thoshin: nëse do të donte All'llahu, ne nuk do t'i bënim atij shok dhe, as ne e as prindërit tanë nuk do të ndalonim asnjë send."** Ata i jepnin vetes të drejtën për të vënë ligje dhe për të bërë hallall e për të bërë haram, duke menduar se

¹ Nisur nga struktura e fjalisë në tekstin e Kur'anit dhe bazuar në rregullat e gjuhës arabe, kuptimi i ajetit është: *"Mos thoni kjo është hallall e kjo tjetra është haram, ashtu siç e përshkruajnë gjuhët tuaja gënjeshtrenë"*.

All'Ilahu e mbështet sajësën e tyre! (Bazuar mbi këtë mendim, ata i jepnin përparësi sajësës së tyre, bënin hallall e haram, pastaj këtë sajësë të tyre ia atribuonin All'Ilahut, kështu ata bënin edhe një shpifje tjetër).¹

Në fundin e ajetit që kemi objekt studimi, Kur'ani Famëlartë paralajmëron: **“pa dyshim ata që shpifin rrenën ndaj All'Ilahut nuk kanë shpëtim”**.

Pa dyshim se prej shkaktarëve kryesorë të së keqes është rrena e shpifja e bërë për cilindo prej njerëzve, pa mendo kur rrena e shpifja bëhen për All'Ilahun e Lartësuar!? Më e pakta që mund të thuhet për këtë gjendje, është dyfishimi i efekteve të këqija të rrenës e të shpifjes.

Ajeti vijues sqaron humbjen që kanë pësuar politeistët dhe thotë: **“Pak kënaqësi (në këtë jetë) dhe për ata do të ketë një dënim shumë të dhimbshëm”**.

Fjala e Kur'anit *pak kënaqësi* ka mundësi të tregojë viçat e qengjat e ngordhur në barkun e kafshëve të tyre, që ata i kishin bërë hallall për veten e tyre. Pra, ata e hanin mishin e viçave e të qengjave që lindnin të ngordhur, ose mund të tregojë mbingopjen e tyre me dashurinë e adhurimin ndaj vetvetes falë sundimit që ushtronin mbi njerëzit për njëfarë kohe. Të gjitha këto janë vetëm *pak kënaqësi* e cila do të pasohet nga **“dënimi shumë i dhimbshëm”**.

¹ Shpifjet e tyre kanë ardhur të përforcuara me parafjalën e gjuhës arabe “le”. Kjo parafjalë vihet në fillim të fjalës për të theksuar rezultatin dhe qëllimin e sajësave të tyre.

Mund të shtrohet edhe pyetja vijuese: përse për jehuditët janë bërë haram edhe gjëra të tjera?

Ajeti vijues vjen edhe si përgjigje për pyetjen e shtruar kur thotë: **“Jehuditëve u patën ndaluar (bërë haram) ato që të kemi treguar më pare.”**.

Ajeti thekson atë që është përmendur në ajetin 146 të sures “El En’àm”: **“Atyre që janë jehuditë Ne u kemi ndaluar çdo kafshë thundrake; prej lopëve e deleve u kemi ndaluar dhjamin e tyre, përveç dhjamt të shpinës e dhjamt të përbrendshmeve, si dhe dhjamin e përzier me kockën; këtë (ndalim) e bëmë si dënim mbi ata për shkak të mëkatit të tyre; padyshim që Ne jemi të vërtetë (në atë që themi).”**.

Fjala e ajetit **“thundrake”** përfshin kafshët njëthundrake, si kuajt; kurse fjala e ajetit **“dhjamt të shpinës”**, do të thotë dhjamin që është në zonën e shpinave të atyre kafshëve.

Për sa i përket fjalës së ajetit **“havàjà” të përbrendshmeve**, është qëllimi për dhjamin anash zorrëve dhe dy anëve të brinjëve.

E vërteta e këtyre ndalimeve shtesë është dënim për jehuditët, për shkak të padrejtësive që bënë. Për këtë, Kur’ani Famëlartë thotë në fundin e ajetit objekt i studimit tonë: **“Ne nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata i bënë vetes padrejtësi.”**.

Gjithashtu mëkati i jehuditëve ka ardhur edhe në ajetet 160 dhe 161 të sures “En Nisà”: **“Për shkak të mizorisë që bënë jehuditët, si dhe për shkak se ata penguan shumë nga rruga e All’llahut, Ne u ndaluam (bëmë haram për ata) disa (lloje ushqimesh) të mira që u ishin lejuar. Edhe për shkak se ata hanin**

kamatë, megjithëse e kishin të ndaluar dhe ngaqë hanin pasurinë e njerëzve padrejtësisht.”.

Çdo ndalim i një kategorie mishrash për jehuditët ishte një dënim i shkallës së dytë, pa pasur politeistët fuqi as të protestojnë për këtë.

Kurse ajo që e ndalonin (e bënë haram) vetë politeistët, nuk ishte gjë tjetër veçse një sajese prej miteve dhe veprimeve të tyre të mbrapshta, sepse gjithçka që bënë politeistët, në të vërtetë ishte provuar edhe te jehuditët, por jo te myslimanët. Mundet që fjala e ajetit të jetë një shenjë që çon në këtë kuptim, domethënë se ju e keni bërë atë çka nuk përputhet me asnjë libër qiellor.

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve, në përshtatje me metodën kur'anore të trajtimit të çështjeve, fillon me hapjen e portave të pendimit për të mashtruarit dhe për ata që kishin rënë në rrugën e humbjes: **“Pastaj për ata që nga padija bënë punë të këqija dhe më pas u penduan e bënë punë të mira, s’ka dyshim që Zoti yt pas kësaj është Falësi e Mëshirëploti.”.**

Në këtë ajet konstatohen tri fakte:

a) është vënë në konsideratë shkaku i bërjes së fajit, që në ajet përmendet mospasja dijeni. Fajtori që nuk ka dijeni kthehet në rrugën e drejtë pasi prej tij kalon kjo gjendje. Të këtillë nuk janë ata që shkojnë në rrugën e humbjes duke e ditur se ku shkojnë, por që shkojnë në rrugën e humbjes nga mendjemadhësia, arroganca, fanatizmi e mllëfi që i ka mbërthyer dhe nuk e pranojnë udhëzimin në rrugën e drejtë;

b) ajeti nuk e kufizon çështjen vetëm me pendimin me zemër, por thekson efektin e pendimit (teubes) nga ana praktike, kurse përmirësimin e konsideron plotësues të pendimit. Me këtë bën pa asnjë vlerë pretendimin e rremë që thotë se është e mundur fshirja e mijërave fajeve vetëm duke shqiptuar frazën *“Estagfirull’llah”* - *I kërkoj All’llahut faljen e mëkateve*. Në të njëjtën kohë thekson edhe detyrimin për të përmirësuar punët praktikisht dhe për të riparuar atë çka është prishur në shpirtin e individit ose të shoqërisë që bën të këtilla mëkate e fajve, si dhe për të treguar se kërkohet një pendim (teube) i vërtetë, jo një pendim vetëm me fjalë;

c) ajeti thekson gjithëpërfshirjen e mëshirës Hyjnore dhe të faljes së mëkateve për fajtorët e mëkatarët, por vetëm pas pendimit e përmirësimit: ***“s’ka dyshim që Zoti yt pas kësaj është Falësi e Mëshirëploti”***.

Pra, çështja e pranimit të pendimit (teubes) vjen vetëm pas pendimit e përmirësimit. Këtë fakt, ajeti e ka përmendur me tri shprehje të ndryshme:

- 1- duke përdorur ndajfoljen *“thum’me”* - *“pastaj”*;
- 2- duke përdorur togfjalëshin *“min ba’di dhàlike”* - *“pas kësaj”*;
- 3- duke përdoruar ndajfoljen *“pas”* të bashkuar me përemrin e vetës së tretë asaj, *“min ba’dihà”* - *“pas saj”*.

Qëllimi i këtyre shprehjeve është që fajtorët e mëkatarët të reflektojnë dhe të heqin dorë prej atij mendimi tepër të gabuar kur thonë: *“Shpresojmë në dashamirësinë e në butësinë e All’llahut, shpresojmë që Ai të na i falë fajet e mëkatet, shpresojmë në mëshirën e Tij”*. Ndërkaq ata vazhdojnë të bëjnë fajve e mëkate.

Ajetet 120 - 124

﴿إِنَّ إِبْرَاهِيمَ كَانَ أُمَّةً قَانِتًا لِلَّهِ حَنِيفًا وَلَمْ يَكُ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ۚ شَاكِرًا
لِلنِّعَمِ اجْتَبَاهُ وَهَدَاهُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ۚ وَآتَيْنَاهُ فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً
وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ ۚ ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَنْ اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ
حَنِيفًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ۚ إِنَّمَا جُعِلَ السَّبْتُ عَلَى الَّذِينَ اخْتَلَفُوا
فِيهِ وَإِنَّ رَبَّكَ لَيَحْكُمُ بَيْنَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ
يَخْتَلِفُونَ ۚ﴾

“Me të vërtetë, Ibrahim i ishte simbol i cilësive më të mira, adhures i All’llahut, besimtar i drejtë dhe nuk ishte prej idhujtarëve.”

“Falënderues për të mirat e Tij (All’llahut), Ai e zgjodhi atë dhe Ai e udhëzoi atë në rrugën e drejtë.”

“Atij (Ibrahimit) Ne i dhamë të mira në këtë botë dhe në Botën Tjetër ai është prej njerëzve të mirë.”

“Pastaj Ne të shpallëm ty: ‘Ndiq fenë e drejtë të Ibrahimit, i cili nuk ishte prej idhujtarëve.’”

“E shtuna u caktua vetëm për ata që kishin kundërshtime rreth saj dhe Zoti yt do të gjykojë në mes tyre Ditën e Gjykimit për atë që ata kishin kundërshtime.”

Komentimi

Ibrahimi ishte simbol i cilësive më të mira

Shpeshherë kemi thënë se kjo është sure e mirësive. Qëllimi i kësaj sureje është vënia në lëvizje te njeriu e ndjenjës së falënderimit, në atë mënyrë që ta shtyjë njeriun të njohë sa më mirë Krijuesin e Dhuruesin e këtyre mirësive.

Grupi i ajeteve që janë objekt studimi flet për modelin e plotësuar të robit që e falënderon shumë All'llahun për mirësitë e dhëna. Ky është Ibrahimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*); Ibrahimi është kampioni i besimit në Njësimin e All'llahut (Teuhidit), është modeli i parë që duhet të ndjekin myslimanët në përgjithësi dhe arabët në veçanti.

Ajetet theksojnë pesë prej cilësive të lavdëruara me të cilat ishte stolisur Ibrahimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*):

1- “Me të vërtetë, Ibrahimi ishte simbol i cilësive më të mira”.

Interpretuesit e Kur'anit kanë përmendur shkaqe të shumta në lidhje me shprehjen që e cilëson Ibrahimin (*Paqja e All'llahut qoftë*

mbi të!) simbol të cilësive më të mira dhe ndër më të rëndësishmet kanë veçuar katër shkaqe:

a) Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte një personalitet i kompletuar. Ishte ky personalitet që e bënte atë simbol të cilësive më të mira; ai ishte pishtar i personalitetit të njeriut. Një personalitet i këtillë ka peshë shumë të madhe, aq sa bëhet zotërues jo vetëm mbi një, mbi dy apo edhe mbi një grup individësh, por që barazohet me personalitetin e një populli të tërë.

b) Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte udhëheqës e shembull i mirë për t'u ndjekur dhe mësues i madh për njerëzimin. Pikërisht për këtë thuhet se ai ishte simbol i cilësive më të mira, cilësim që thuhet vetëm për personin, të cilin njerëzit e marrin si model për të ndjekur dhe e dëgjojnë me vëmendje.

Këtu kemi edhe një lidhje morale të veçantë ndërmjet kuptimit të parë e kuptimit të dytë. Domethënë, personi i cili ka arritur në gradën që të jetë simbol i së vërtetës dhe i rrugës së drejtë për një popull të tërë dhe pjesëmarrës në punët e individëve të atij populli, është vetë ky popull.

c) Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte monoteist në një mjedis ku s'kishte asnjë të tillë dhe ku të gjithë ishin të zhytur në batakun e politeizmit e adhurimit të statujave. Në këtë gjendje, përballë politeistëve që ishin rreth tij, Ibrahim ishte simbol i cilësive më të mira.

ç) Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte burim për ekzistencën e cilësive më të mira. Pikërisht për këtë, Kur'ani Famëlartë e cilëson atë me fjalën "ymeten" - simbol i cilësive më të mira.

Ky togfjalësh i përmbledh të gjitha kuptimet e përmendura.

Po, Ibrahim (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ishte simbol i cilësive më të mira dhe prijës i madh; ai ishte farkëtues i një populli, ishte thirrës për besimin tek All'llahu, Zotin Një e të Vetëm (Teuhid) në një mjedis shoqëror në të cilin nuk kishte asnjë monoteist.¹

Poeti në vargjet e tij ka thënë:

Askush nuk mund të mohojë

Që All'llahu e mbledh botën në një grusht

2- Cilësia e dytë me të cilën e përshkruajnë këto ajete Ibrahimin (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) është se ai ka qenë: **“adhurues i All'llahut”**.

3- Ai gjithmonë ishte në rrugën e drejtë, gjithmonë ecte në rrugën e All'llahut, në rrugën e vërtetë dhe që në Kur'an ka ardhur me fjalën **“besimtar i drejtë”**.

4- **“Dhe nuk ishte prej idhujtarëve”**; përkundrazi, besimi vetëm tek All'llahu ishte drita që mbushte gjithë jetën e mendimin e Ibrahimit dhe kjo dritë kishte hyrë në çdo qoshe të zemrës së tij.

¹ Në transmetimet e ardhura prej të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) thuhet se “Abdul Mut'talibi do të ringjallet Ditën e Gjykimit me cilësitë më të mira, me madhështinë e mbretërve dhe me cilësitë e Profetëve”, sepse ai ishte mbrojtës i Njësismit (Teuhidit) në një mjedis ku zotërues ishte politeizmi e adhurimi i statujave “Sefijnetul Bihâr”, vëll. 2, f. 139.

5- Pas të gjitha këtyre cilësive të larta, ai ishte edhe: **“Falënderues për të mirat e Tij (All’llahut)”**.

Pasi shpalos këto pesë cilësi të larta, Kur’ani Famëlartë shpjegon edhe rezultatet shumë të rëndësishme të cilësive të Ibrahimit dhe thotë:

a- **“Ai e zgjodhi atë”**, Profet për të kumtuar thirrjen Tij.

b- **“Ai e udhëzoi atë në rrugën e drejtë”**, Ai e ruajti atë prej çdo devijimi nga e vërteta, sepse udhëzimi në rrugën e drejtë nuk i vjen askujt rastësisht dhe për të duhet patjetër një përgatitje e mirë, si dhe kapacitet për ta mbajtur.

c- **“Atij (Ibrahimit) Ne i dhamë të mira në këtë botë”**.

Fjala *“të mira”* në kuptimin e përgjithshëm përshtin të gjitha të mirat e të gjitha punët e mira, në vazhden e dhënies së pozitës së profetësisë duke kaluar në mirësitë materiale, në mirësinë e dhënies së fëmijëve dhe të mirësive të tjera të ngjashme me këto.

d- **“Dhe në Botën Tjetër ai është prej njerëzve të mirë”**.

Përveç kësaj Ibrahimit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ishte kreu i njerëzve të mirë në këtë botë, patjetër që ashtu do të jetë edhe në Botën Tjetër, ashtu siç na njofton për këtë vetë Kur’ani Famëlartë. Në të vërtetë, ky është edhe argument për pozitën e madhe e të lartë që kanë njerëzit e mirë, derisa vetë Ibrahimit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) e ka dëshiruar këtë pozitë kaq të lartë për veten në Botën Tjetër. Përse të mos jetë kështu, kur vetë Ibrahimit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) i ka kërkuar Zotit të tij ta bashkojë me njerëzit e mirë. Ajeti njofton: **“O Zoti im, më dhuro mua urtësi dhe më bashko me të mirët.”** (sure “Esh Shuarà”, ajeti 83)

e- Mirësitë e bukura të All'llahut të Gjithëfuqishëm për Ibrahimin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) mbyllen me mirësinë e madhe: All'llahu i Lartësuar e ka bërë fenë me të cilën erdhi Ibrahimimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) fe të përgjithshme edhe për ata që do të vijnë pas tij në kohë, veçanërisht për myslimanët. Domethënë se fenë e tij, All'llahu i Lartësuar nuk e ka bërë të posaçme vetëm për njerëzit e kohës së Ibrahimit. I Gjithëfuqishmi njofton: **"Pastaj Ne të shpallëm ty: 'Ndiq fenë e drejtë të Ibrahimit!'".**¹

Menjëherë pas kësaj ritheksohet se Ibrahimimi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishte ai: **"i cili nuk ishte prej idhujtarëve"**.

Duke parë ajetet e mësipërme, neve na duket sikur shtrohet pyetja: nëse feja islame është e njëjtë me fenë e Ibrahimit dhe myslimanët ndjekin rregullat e fesë së Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në shumë çështje, ndër të cilat edhe respektimin e ditës së Xhuma, përse jehuditët kundërshtuan për ditën e Shtunë që ishte për ata ditë feste, në vend të ditës së Xhuma? Ditën e Shtunë, jehuditët bënë pushim dhe i linin të gjitha punët e tyre.

Ajeti i fundit prej grupit të ajeteve që po studiojmë i përgjigjet kësaj pyetjeje dhe njofton: **"E Shtuna u caktua vetëm për ata që kishin kundërshtime rreth saj."** Pra, ndalimi (bërja haram)

¹ Fjala e tekstit të Kur'anit "*hanifen*", është në kuptimin e atij që lë çdo lloj devijimi dhe udhëzohet vetën në rrugën e drejtë, bën punë të mira dhe nuk shikon në fetë e në gjendjet e reformuara e të devijuara. Orientohet vetëm në rrugën e drejtë të Allahut, në fenë që është në përputhje me fenë e pastër me të cilën është krijuar njeriu (Teuhid) - *besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm* - dhe pikërisht për këtë kjo rrugë është emërtuar "*rrugë e drejtë*", pasi edhe fjala "*hanifen*" ndër kuptimet e saj, ka brenda edhe kuptimin e Njësimi (Teuhidit), krijimi i pastër, feja e vërtetë me të cilën u krijua njeriu.

ditën e Shtunë, ishte një dënim për jehuditët, sepse ata vetë patën kundërshtime rreth ditës së Shtunë, pati prej tyre që pranuan, por pati edhe që e neglizhuan fare ditën e Shtunë.

Në disa transmetime thuhet se Mùsàì (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i bëri thirrje popullit të tij, Beni Israilëve, që të respektonin ditën e Xhuma dhe në respekt të saj të linin të gjitha punët e tyre e të bënë pushim, pasi kjo ishte edhe feja e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Por jehuditët nuk e bënë pushim ditën e Xhuma dhe parapëlqyen që ditë pushimi për ata të ishte e Shtuna. Atëherë, All'llahu e caktoi ditën e Shtunë vetëm për jehuditë, si përjashtim me karakter dënues. Argumenti më i mirë për këtë çështje është se vetë jehuditët patën kundërshtime në mes tyre në lidhje me ditën e tyre të zgjedhur: disa e respektuan, kurse disa të tjerë e kundërshtuan dhe vijuan punën e tregtinë edhe në këtë ditë, derisa mbi ta ra dënimi i All'llahut.

Ka edhe një mundësi tjetër që ajeti të tregojë lidhjen me sajësën që bënë politeistët për problemin e ushqimeve me bazë shtazore, sepse ajetet e mësipërme e trajtuan këtë problem në kuadrin e përgjigjes për pyetjen: përse në Islam nuk janë ndaluar (nuk janë bërë haram) gjërat që ishin të ndaluara në fenë e jehuditëve? Përgjigja erdhi se ai ndalimi që një dënim për jehuditët, prandaj e shtron pyetjen edhe një herë tjetër rreth mosndalimit të peshkimit ditën e Shtunë në dispozitat e fesë islame, në një kohë që peshkimi ditën e Shtunë ishte i ndaluar (ishte bërë haram) për jehuditët. Përgjigja është: edhe ky ndalim gjithashtu ishte dënim për jehuditët.

Duke parë lidhjen ndërmjet këtyre ajeteve dhe ajeteve 163-166 të sures "El A'ràf", ku flitet për "njerëzit e së shtunës", se si ata

peshkonin dhe si u ndaluan të peshkojnë ditën e Shtunë. Gjithashtu në këto ajete tregohet se disa prej jehuditëve e kundërshtuan këtë urdhër, për pasojë mbi ta ra dënimi vetëm pas këtij provimi Hyjnor.

Duhet të tërheqim vëmendjen se fjala e ajetit “*es’seltu*” - “**e Shtunë**”, në rrënjën e fjalës, është në kuptimin e lënies së punëve për të pushuar. Prandaj, kjo ditë është emërtuar me fjalën “*es’seltu*”, *pushim*, ditë në të cilën lihen të gjitha punët, pasi jehuditët në të këtë ditë i linin punët e tyre. Kështu që ky emërtim mbeti të përdorej për këtë ditë edhe pas ardhjes së Islamit, por në dispozitat e Islamit dita e Shtunë nuk është ditë pushimi.

Në fundin e ajetit, Kur’ani Famëlartë thotë: “**dhe Zoti yt do të gjykojë në mes tyre Ditën e Gjykimit për atë që ata kishin kundërshtime**”.

Ashtu siç kemi theksuar më sipër, njëra prej veçorive të Ditës së Gjykimit do të jetë edhe përfundimi i kundërshtimeve në të gjitha rrafshet dhe kthimi në Teuhidin, në Njësimin, në besimin se All’llahu është Zoti Një e i Vetëm. Sepse Dita e Gjykimit është e Dita e daljes në shesh e të vërtetave, Dita e zbulimit të sekreteve dhe e punëve të brendshme, Dita e heqjes së mbulesës dhe e ngritjes së perdes.

Ajetet 125 - 128

﴿ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ﴾^{١٢٥} وَإِنْ عَاقَبْتُمْ فَعَاقِبُوا بِمِثْلِ مَا عُوقِبْتُمْ بِهِ وَلَئِنْ صَبَرْتُمْ لَهُوَ خَيْرٌ لِلصَّابِرِينَ^{١٢٦} وَاصْبِرْ وَمَا صَبْرُكَ إِلَّا بِاللَّهِ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ وَلَا تَكُ فِي ضَيْقٍ مِمَّا يَمْكُرُونَ^{١٢٧} إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ^{١٢٨} ﴿

“Bëj thirrje për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e me këshillë të mirë dhe polemizo me ata me mënyrën që është më e mira; Zoti yt di më mirë për atë që është larguar prej rrugës së Tij dhe Ai di më mirë për të udhëzuarit në rrugën e drejtë.”

“Nëse dënoni, atëherë dënoni në atë masë që u dënuat edhe ju dhe, nëse duroni, pa dyshim që kjo është shumë mirë për ata që bëjnë durim.”

“Bëj durim dhe durimi yt është vetëm me ndihmën e All’lilaut, ti mos u hidhëro për ata, as mos u brengos për dredhitë që ata bëjnë.”

“Patjetër që All’lilahu është me ata që janë të devotshëm dhe me ata që janë bamirës.”

Komentimi

Dhjetë rregulla morale, armët e thirrësit tek e vërteta

Ajetet e kësaj sureje trajtojnë çështje të shumëllojshme; trajtojnë politeistët, jehuditët dhe kategoritë e kundërshtarëve, herë me gjuhë të butë, herë me mënyrë qortimi të ashpër. Në mënyrë të veçantë, ajetet e mësipërme dallohen për thellësi e për ashpërsi në krahasim me ajetet e mëparshme të kësaj sureje të uruar.

Ajetet e fundit të sures janë edhe ajetet përmbyllëse të studimeve e të bisedave të sures “En Nahl”. Këto ajete shpjegojnë vetitë morale thelbësore me të cilat duhet të jemi të pajisur që të jemi të mbrojtur me bazë logjike kur të ballafaqohemi me kundërshtarët. Gjithashtu, këto ajete shpjegojnë çështjen e dënimit, e faljes, e qëndrueshmërisë përballë kompleteve të kundërshtarëve, si dhe çështje të tjera të ngjashme me këto.

Të gjitha këto në Islam mund të emërtohen bazë taktike e program ballafaqimi kundër kundërshtarëve. Këto baza taktike e ky program Islam duhen konsideruar një ligj i përgjithshëm e gjithëpërfshirës, me të cilin është detyrë të punohet në çdo kohë e në çdo vend.

Ky program Hyjnor përmbledhet në dhjetë baza të renditura sipas radhës, që janë përmendur në ajetet që janë objekt studimi:

1- “Bëj thirrje për në rrugën e Zotit tënd me urtësi”:

Fjala e ajetit “**me urtësi**”, është në kuptimin me dituri, me logjikë dhe argumentim, që në fakt është në kuptimin e ndalimit, por është përdorur në kuptimin e diturisë, logjikës e argumentimit

për fuqinë që ato kanë për të ndaluar njeriun nga shthurja e devijimi.

Hapi i parë në rrugën e thirrjes për në të vërtetën është mundësia e argumentimit në përputhje me logjikën e shëndoshë, si mundësi për të depërtuar në brendësi të mendimit të njerëzve dhe si një përpjekje për të vënë në lëvizje e për të zgjuar mendjet e tyre. Ky është hapi i parë në këtë rrugë.

2- “e me këshillë të mirë”:

Ky është hapi i dytë i thirrjes për në rrugën e All’llahut. Duke përfituar prej vënies në lëvizje të emocioneve njerëzore, falë këshillës së mirë dhe të efektit të hollësishëm e veprues që ka ajo mbi ndjenjat e njeriut, gjithmonë me qëllim orientimin e shtresave të ndryshme të njerëzve për tek e vërteta.

S’ka dyshim që fjala “**me urtësi**” tregon për shfrytëzimin e dimensioneve të mendjes së njeriut, kurse “**këshilla e mirë**” bashkëvepron me dimensionin e ndjenjave të tij.¹

Në të vërtetë, kushtëzimi i këshillës me termin “**më të mirë**” mund të tregojë edhe këshillën, edhe predikimin, me kusht që këshilla është e zhveshur nga çdo formë ashpërsie, epërsie e

¹ Disa interpretues të Kur’anit Famëlartë janë shprehur në lidhje me dallimin ndërmjet fjalëve të ajetit: “**me urtësi**”, “**me këshillë të mirë**” dhe “**polemizo me ata me mënyrën që është më e mira**” dhe kanë thënë se fjala “**me urtësi**”, tregon argumentin e formës së prerë. Shprehja “**këshillë të mirë**” tregon argumentet hipotetike, kurse fraza “**polemizo me ata me mënyrën më të mirë**”, tregon argumentet që kanë qëllim të bëjë të heshtin kundërshtarët nëpërmjet asaj që ata pranojnë; por ajo që ne kemi thënë më sipër na rezultuan se është më e përshtatshme për qëllimin.

përbuzjeje. Përndryshe do të përçojë në palën ballafaquese ndjenjën e mllëfit, inatit, zemërimit dhe të tjera të ngjashme me këto.

Sa e sa këshilla kanë dhënë të kundërtën e asaj që shpresohet me atë këshillë! E gjitha kjo vetëm për shkak të metodës si është shtruar ajo këshillë, për rrjedhojë pala ballafaquese është ndier e përbuzur dhe e poshtëruar, siç mund të jetë një këshillë e dhënë në prani të të tjerëve e shoqëruar me urrejtje, ose prej këshillës fryn erë epërsie mbi personin që këshillohet. Rezultati: pala ballafaquese ndihet krenare për mëkatën e kryer dhe nuk reagon ndaj këshillave të këtilla.

Por efekti i këshillës është pozitiv kur këshilla është e **“mirë”**.

3- “dhe polemizo me ata me mënyrën më të mirë”.

Hapi i tretë ka të veçantë heqjen plotësisht të dyshimeve prej mendjeve të palës kundërshtuese, pasi ato dyshime qëndrojnë të varura në mendimet e ashpra dhe për rrjedhojë pala kundërshtare do të jetë e gatshme të takohet me të vërtetën sapa ta shohë atë.

Vetëkuptohet se polemika e diskutimi me brumë kur është: **“me mënyrën më të mirë”**, pra kur në polemikë është dominuese e vërteta, drejtësia, saktësia, besnikëria e sinqeriteti. Dhe kur në polemikë s’ka poshtërim, urrejtje, mendjemadhësi e gabime. Thënë me fjalë më të përgjithshme, kur polemizuesit ruajnë gjatë diskutimit të gjitha spektet e shëndosha të mirësjelljes njerëzore.

Në fundin e ajetit të parë që kemi objekt studimi, Kur’ani Famëlartë thotë: **“Zoti yt di më mirë për atë që është larguar prej**

rrugës së Tij dhe Ai di më mirë për të udhëzuarit në rrugën e drejtë”.

Ajeti i nderuar thekson se detyra juaj është të bëni thirrje për në rrugën e vërtetë sipas tri mënyrave që u thanë më sipër, kurse çështjen se cili do të udhëzohet në rrugën e drejtë dhe cili do të mbetet në rrugën e tij të humbjes, e di vetëm All’llahu i Lartësuar, e di vetëm Ai të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s’ka nevojë për asgjë.

Ekziston edhe një mundësi tjetër në lidhje me qëllimin e kësaj fjalie dhe që konsiston në shpjegimin e tri orientimeve të mëparshme. Domethënë, i Plotpushtetshmi që ka urdhëruar këto tri rrugë, padyshim që Ai e di edhe mënyrën si ndikojnë ato tek ata që kanë rënë në rrugën e humbjes për t’i orientuar dhe për t’i udhëzuar në rrugën e drejtë.

4- Në tri bazat e mësipërme, biseda u shtri në rrafshin e studimit logjik, në mënyrën e prekjes së ndjenjave dhe diskutimit me maturi me kundërshtarët. Por, kur edhe pas ballafaqimit, ata nuk e pranojnë të vërtetën, madje hidhen edhe në sulm, pikërisht këtu vjen edhe baza e katërt: “Nëse dënoni, atëherë dënoni në atë masë që u dënuat edhe ju”.

5- “Nëse duroni, padyshim që kjo është shumë mirë për ata që bëjnë durim”.

Transmetimet njoftojnë se ky ajet ka zbritur në luftën e Uhudit, kur i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pa me dhimbje rënien dëshmor të xhaxhait të tij Hamza bin Abdul Mutalibit, madje pa se armiqtë nuk u mjaftuan vetëm me vrasjen, por me barbarinë më të egër e me shumë ashpërsi filluan të masakrojnë trupin e tij, i çanë gjoksin,

i nxorën mëlçinë, ose zemrën dhe i prenë veshët e hundën. Në këto çaste Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u hidhërua shumë dhe tha: “O Zoti im, falënderimi e lavdërimi është vetëm për Ty, te Ti dhe vetëm Ty të kërkoj ndihmë për këtë që po më shohin sytë!”. Pastaj tha: “Nëse do të fitoj, patjetër do të masakroj, patjetër do të masakroj, patjetër do të masakroj!” dhe, në një transmetim tjetër thuhet: “patjetër do të masakroj shtatëdhjetë prej tyre”. Ndërkaq zbriti ajeti: **“Nëse dënoni, atëherë dënoni në atë masë që u dënuat edhe ju dhe, nëse duroni, pa dyshim që kjo është shumë mirë për ata që bëjnë durim”**. Atëherë i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Po duroj, po duroj!”.¹

Patjetër që ato çaste ishin nga më të rëndat në jetën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por ai e mblodhi veten menjëherë dhe zgjodhi rrugën e dytë: atë të faljes dhe të durimit.

Historia tregon për ne si veproji i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur çliroi Mekën: sapo këmba triumfuese e myslimanëve shkeli mbi tokën e Mekës, Profeti i mëshirës (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shpalli amnistinë e përgjithshme për ata njerëz zemërgurë, njëkohësisht mbajti edhe besën që i kishte dhënë vetes në Betejën e Uhudit.²

¹ Tefsiri i “El A’jashij” dhe tefsiri “Ed Durr’rrul Menthûr”, në komentimin e ajetit (bazuar mbi atë që është përmendur në tefsirin “El Mizàn”).

² Në disa transmetime konstatohet se në të vërtetë përmendja e fjalës “masakrime” më shumë se një herë, është thënë prej disa myslimanëve (referohu në tefsirin “Et Tibjân”, vëll. 6, f. 44).

Kur njeriu shikon modelin e gjallë më të lartë, tek ai fillojnë të lëvizin ndjenjat njerëzore, ai ka parasysh tregimet e Betejës së Uhudit dhe aksionin për çlirimin e Mekës për të bërë krahasime, në të njëjtën kohë bën edhe lidhjen në mes atyre dy betejave historike.

Nuk di që historia të tregojë për ndonjë popull fitues që e ka trajtuar armikun e mundur ashtu siç e trajtoi i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët idhujtarët e mposhtur të Mekës. Pavarësisht se vetë myslimanët ishin bij të atij mjedisi, se tek ata vlonte ndjenja e hakmarrjes dhe e urrejtjes për të depërtuar e për t'u shtruar këmbëkryq mbi atë shoqëri. Veç kësaj, urrejtja trashëgohej nga njëri brez te tjetri dhe puna arrinte deri aty sa heqja dorë nga hakmarrja konsiderohej një e metë shumë e madhe, e pamundur të mbulohej!

Prej frutave të amnistisë e të tolerancës së Islamit ishte se ai popull injorant e kryeneç u lëkund në thellësitë e veta e u zgjua prej gjumit të shkujdesjes. Individë prej asaj popullsie, ashtu siç thotë Kur'ani Famëlartë, filluan të: **“po hyjnë në fenë e All'Ilahut grupe-grupe”**. (Sure “En Nasr”, ajeti 2)

6- “Bëj durim dhe durimi yt është vetëm me ndihmën e All'Ilahut”.

Në të vërtetë, durimi lë gjurmë dhe është veprues, kur me të synohet të arrihet kënaqësia e të Lartit dhe tek ai nuk shikohet asgjë tjetër veç këtij qëllimi.

A ka mundësi çdo njeri të bëjë durim në raste katastrofash që të këpusin zemrën, pa pasur një qëllim moral dhe pa një forcë Hyjnore që jep fuqi për të mbajtur ato vuajtje të mëdha dhe për të mos e humbur ekuilibrin? Po! Në rrugën e kërimit të kënaqësisë

së All'llahut, të gjitha gjërat bëhen më të lehta, sepse mbarësia e lehtësimit vjen vetëm prej të Gjithëpushtetshmit.

7- Kur as durimi nuk sjell dobi në procesin e kumtimit e të thirrjes në rrugën e All'llahut, madje as falja e as toleranca, përsëri në zemrën e besimtarit s'ka vend për të humbur shpresën, s'ka vend për shqetësim e për të humbur durimin. Në të kundërt, pikërisht në një gjendje të këtillë, besimtari e ka detyrim të vazhdojë kumtimin e thirrjen për tek All'llahu me zemërgjerësi dhe me qetësi. Për këtë gjendje, Kur'ani Famëlartë thotë në bazën e shtatë: **“ti mos u hidhëro për ata”**.

Sepse hidhërimi dhe humbja e shpresës për shkak se kokëfortët nuk besojnë, lë te njeriun njërin prej dy gjurmëve: ose ai do të humbasë shpresën përgjithmonë, ose hidhërimi do ta shtyjë atë të humbë shpresën, të zemërohet dhe të mos ketë fuqi të përballojë gjendje të këtilla. Për rrjedhojë, ndalimi i hidhërimit në të vërtetë është ndalim për të dy urdhrat së bashku. Prandaj, të gjithë ata që bëjnë thirrje për të besuar All'llahun, patjetër që nuk duhet as të hidhërohen, as të humbasin shpresën.

8- “As mos u brengos për dredhitë që ata bëjnë”.

Sado të mëdha, të holla e të rrezikshme të jenë intrigat e armikut, kurrë nuk duhet të heqësh dorë nga sheshi i thirrjes, duke menduar se ke rënë shumë ngushtë dhe në një rrethim arbitrar. Në të kundërt, patjetër duhet të mbështetesh vetëm tek All'llahu dhe shumë shpejt do të shikosh se të gjitha intrigat do të dështojnë. Falë forcës së besimit, qëndrueshmërisë, logjikës e urtësisë, intrigat nuk do të kenë asnjë efekt.

Ajeti i fundit i sures “En Nahl” shtron dy çështje: të nëntën dhe të dhjetën.

9- Ai thotë: “Patjetër që All’llahu është me ata që janë të devotshëm”.

Devotshmëria në të gjitha dimensionet e në të gjitha kuptimet e saj të gjera, prej të cilave: devotshmëri në ballafaqimin me kundërshtarët, kujdes dhe respekt i bazave moraleve islame gjatë gjithë ballafaqimit, krahas mosvështirësimit të punëve, gjithnjë duke treguar kujdes në trajtimin e bazave të Islamit. Ndërsa me ata që kanë devijuar, patjetër që duhet treguar maturi, edukatë, kujdes të madh prej fjalëve të rreme e prej akuzave. Në sheshin e betejës, patjetër që kundërshtari duhet të trajtohet nën dritën e direktivave ushtarake dhe në përputhje me maturinë e rregullave islame. Për shembull, nuk lejohet të sulmohet i veçuari prej armiqve, ndalohet të preken fëmijët, gratë dhe të pafuqishmit, ndalohet të dëmtohen kafshët e të shkatërrohen të mbjellat, gjithashtu nuk lejohet që armikut t’i pritët uji. Në mënyrë të përmbledhur: është detyrim të bëhet kujdes në ruajtjen e bazave të drejtësisë si me armikun, ashtu edhe me mikun e me shokun. (Është normale që në disa raste, këto dispozita të kenë përjashtime, por jo si rregull).

10- “Dhe me ata që janë bamirës”.

Kur’ani Famëlartë në shumë ajete të formës së prerë thekson se besimtari përballë të keqes së injorantit vendos bamirësinë, duke shpresuar që injoranti do të ketë turp nga qëndrimi i tij konfrontues. Me këtë sjellje të lartë e të shkëlqyer, shpresohet që

edhe ky injorant mund të shndërrohet nga **“armiku më i egër”** në një **“mik të dashur”**!

Kur thirrësi në rrugën e All'llahut punon me bamirësi aty ku duhet e në kohë të përshtatshme, ajo është metoda më e mirë për t'u ballafaquar me kundërshtarin. Historia islame na paraqet shembuj të shkëlqyer në këtë fushë. Ja edhe disa shembuj: qëndrimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndaj idhujtarëve të Mekës, trajtimi që i bëri Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vrasësit të Hamzait, Vahshiut; trajtimi nga ana e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) robërve të betejës së Bedrit; mirëtrajtimi që u bëri i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) jehuditëve të kohës së tij, pavarësisht se ata e kishin munduar e fyer me të gjitha rrugët e mënyrat që kishin pasur mundësi; një qëndrim të ngjashëm e gjejmë të mishëruar praktikisht në jetën Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) edhe në marrëdhëniet e tij me të tjerët, po kështu ka qenë edhe qëndrimi i të gjithë Imamëve të ruajtur prej mëkateve. Të gjitha këto shembuj nxjerrin në dukje rëndësinë e madhe të bamirësisë në jetën e njeriut të parë nga këndvështrimi islam.

Një shprehje shumë të goditur në këtë fushë gjejmë në “Nehxhul Belàga” në kuadrin e hytbes së mirënjohur “Hytbeja e Hemmàmit”, atij burri të përkorë e adhuruës, i cili i kërkoi Prijësit të Besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) të përshkruante për atë të devotshmit. Prijësi i Besimtarëve u mjaftua me përmendjen e ajetit të nderuar prej Kur'anit Famëlartë dhe tha: “Kije frikë

All'Ilahun dhe bëj bamirësi, sepse: **“Patjetër që All'Ilahu është me ata që janë të devotshëm dhe me ata që janë bamirës”**.¹

Por etjen e këtij pyetësi të dashuruar me të Vërtetin nuk e shoi ky shpjegim i shkurtër, çka e detyroi Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) të bënte për atë një shpjegim të hollësishëm, derisa prej gojës së tij të uruar doli e plotë hytbeja që përshkruan të devotshmit. Në atë hytbe ai shpalosi më shumë se njëqind cilësi për të përshkruar të devotshmit, por përgjigjja e tij e shkurtër e shpjegon qartë se ajeti i nderuar i Kur'anit Famëlartë, edhe pse me fjalë fare të shkurtra, ka përmbledhur të gjitha cilësitë e të devotshmëve.

Me një vështrim të vëmendshëm në dhjetë bazat e përmendura bëhet fare e qartë se në të gjitha linjat kryesore e dytësore të mënyrës së ballafaqimit me kundërshtarët, do të gjejmë se këto baza në të vërtetë përmbajnë të gjitha themelet logjike të ndjenjave shpirtërore e të mënyrave taktike, si dhe çdo gjë që çon në depërtimin në thellësi të shpirtit të kundërshtarëve për të reaguar pozitivisht ndaj thirrjes për të hyrë në rrugën e drejtë.

Megjithëkëtë, të mjaftuarit vetëm me logjikën e me shtrimin e argumenteve gjatë ballafaqimit me armiq të në situatat për të cilat nuk flitet në dispozitat e Islamit, nuk jep rezultat. Prandaj, shumë herë nevoja e bën të domosdoshme të hyhet praktikisht në sheshin e ballafaqimit me armiq të, madje disa herë gjendja konkrete e kërkon që kjo gjë të bëhet jo vetëm me shembuj, por edhe me mjete të forcës kundrejt përdorimit të forcës nga ana e armiqve, duke marrë të gjitha masat që dikton situata e punëve që ndërmarrin

¹ “Nehxhul Belàga”, hutbeja 193.

armiqtë. Por bazat e drejtësisë, devotshmëria dhe moralet islame mbeten detyrim të zbatohen në të gjitha gjendjet.

Nëse myslimanët do të kishin vepruar në përputhje me këtë program gjithëpërfshirës, me siguri që Islami do të ishte zotërues në të gjitha tokat e banuara ose, të paktën, në pjesën më të madhe të tokave të banuara.

Mbyllja e fjalës për suren “En Nahl”, e quajtur “surja e mirësive”

Ajo që bie në sy në këtë sure të uruar – ashtu siç kemi thënë edhe më sipër – është fakti se në atë përmenden shumë prej mirësive të All'llahut, mirësi materiale e morale, të dukshme e të padukshme, individuale e shoqërore. Kjo gjë ka bërë që interpretuesit e Kur'anit Famëlartë ta emërtojnë këtë sure me emrin “surja e mirësive”.

Duke studiuar ajetet e kësaj sureje, për ne bëhet e qartë se mirësitë e përmendura aty arrijnë në kufijtë e numrit dyzet, mirësi të mëdha e mirësi të vogla, të shpërndara në brendinë e gjithë sures. Në vijim po vendosim një tregues të mirësive të përmendura në këtë sure. Duke theksuar qëllimin e përmendjes së mirësive në këtë sure, dallojmë dy çështje:

e para: jepet mësim për Njësimin (Teuhidin) – besimi se All'llahu është Zoti Një e i Vetëm –dhe shpjegohet madhështia e Krijuesit.

E dyta: forcimi i dashurisë e i lidhjes së njeriut me Krijuesin e tij dhe vënia në lëvizje të njeriu e ndjenjës së falënderimit. Ja dhe treguesi:

1- **“Krijimi i qiejve”.**

2- **“Krijimi i tokës”.**

3- **“Kafshët shtëpiake dhe krijimi i tyre”.**

4- Përfitimi prej leshit e prej lëkurës së kafshëve **“për ju në ato ka ngrohtësi”.**

5- **“Dhe dobi”.**

6- **“Prej tyre (kafshëve) ju hani”.**

7- Përfitimi nga bukuria e pavarësisë ekonomike **“për ju në ato ka bukuri”.**

8- **“ato mbajnë barrët tuaja – dhe kuajt, mushkat e gomerët që ju të hipni mbi ato”.**

9- Udhëzimi në rrugën e drejtë **“udhëzimi në rrugën e drejtë është në dorën e All’Ilahut”.**

10- **“Ai, i Cili zbret prej qiellit ujin për ju, prej atij ju pini”.**

11- Krijimi i kullotave **“prej tij (ujit) keni pemë e kullotë”.**

12- **“me atë (ujin) keni të mbjellat, ullinjat, hurmat, rrushtë dhe nga të gjitha frutat”.**

13- **“Për ju ai nënshtroi natën e ditën”.**

14- **“dhe diellin e hënën”.**

15- “edhe yjet”.

16- “dhe për atë që Ai krijoi prej tokës për ju lloje të ndryshme (bagëti, bimë, pemë, minerale etj)”.

17- “Ai për ju nënshtroi detin, prej të cilit hani mish të freskët dhe prej tij nxirrni stoli që ju i vishni”.

18- “ti sheh anijet të lundrojnë në të (det)”.

19- “Ai vuri në tokë male të forta që ajo të mos lëkundet me ju”.

20- “edhe lumenj”.

21- “edhe rrugë”.

22- “edhe shenja për të njohur rrugët”.

23- “dhe me yjet ata orientohen”, që njerëzit të njohin rrugët natën.

24- “All’lillahu lëshon ujë prej qiellit dhe me atë ngjallë tokën pasi ajo ishte e vdekur”.

25- “Ne u japim të pini prej asaj që ka në barqet e tyre (kafshëve) në mes ushqimit e gjakut, qumësht shumë të pastër e të shijshëm për ata që e pinë”.

26- “Prej frutës së hurmës e të rrushit ju nxirrni pije dhe ushqim të mirë”.

27- Mjalti “në të ka shërim”.

28- "All'Ilahu krijoi për ju bashkëshorten nga vetë lloji juaj".

29- "dhe prej bashkëshorteve tuaja Ai bëri për ju fëmijë e nipa".

30- "dhe u furnizoi ju me të mira", në kuptimin më të gjerë të fjalës të "mira".

31- "Ai u pajisi me dëgjim".

32- "dhe me shikim".

33- "edhe me zemër".

34- "All'Ilahu bëri për ju prej shtëpive tuaja vendbanim të qetë", shtëpi të qëndrueshme.

35- "Ai bëri për ju prej lëkurëve të kafshëve shtëpi", shtëpi të transportueshme.

36- "dhe prej leshit të kafshëve, prej qimeve e prej leshit të tyre të egër, (bëri) rroba e shtroje (që ju i shfrytëzoni) deri në një kohë".

37- Mirësia e hijeve "All'Ilahu nga ato që Ai krijoi, bëri për ju hije".

38- Mirësia e ekzistencës së vendstrehimeve të sigurta në male "Ai për ju bëri në male vendstrehime".

39- "Ai bëri për ju rroba që u mbrojnë nga të nxehtët".

40- "dhe veshje që u mbrojnë ju në luftë".

Në mbyllje të këtyre mirësive thotë: **“kështu i plotëson All'illahu për ju mirësitë e Tij që ju të nënshtroheni”**.

Qëllimi i përmendjes së mirësive

Nuk është nevoja të tërhiqet vëmendja për të thënë se përmendja e mirësive Hyjnore në Kur'anin Famëlartë s'ka qëllim as mburrjen për mirësitë e dhëna, as që të fitojë autoritet dhe as për të arritur përfitime të tjera të ngjashme. Qëllimi i Filluesit të të gjitha gjërave pa dyshim është shumë më i lartë, sepse vetëm Ai është i Pasuri, pa të Cilin s'mund të ketë pasuri. Prandaj themi se përmendja e mirësive në Kur'anin Famëlartë ka ardhur në kuadrin e metodës edukuese të programuar, me qëllim që njeriu të arrijë shkallët më të larta të mundshme të plotësimit nga ana materiale e morale. Argumenti më i fuqishëm për këtë ka ardhur në shumë ajete që pamë më sipër. Në ato ka shprehje të shumëllojshme, të cilat derdhin në shpirtin e njeriut orientimin edukues të kërkuar.

Menjëherë pas përmendjes së mirësisë së nënshtërimit të deteve, Kur'ani Famëlartë në ajetin 14 të sures që është objekt studimi thotë: **“që ju të udhëzoheni në rrugën e drejtë”**.

Pas një shpjegimi të zgjeruar të mirësive morale (mirësia e zbritjes së Kur'anit), në ajetin 44 të kësaj sureje Kur'ani thotë: **“që ju të mendoni”**.

Pas përmendjes së mirësive të rëndësishme që mundësojnë njohjen me realitetin (dëgjimi, shikimi, zemra), ajeti thotë: **“që ju të falënderoni”**.

Pasi thekson plotësimin e mirësive të All'llahut, në ajetin 81 të kësaj sureje, Kur'ani thotë: **“që ju të nënshtroheni”**.

Pas përmendjes së disa çështjeve në fushën e drejtësisë, e bamirësisë, e luftimit të imoralitetit, e punëve të urryera dhe e dhunës, ajeti 90 i kësaj sureje thotë: **“që ju të kujtoheni”**.

Në të vërtetë, Kur'ani Famëlartë ka theksuar pesë qëllime falë përmendjes së gjashtë burimeve që u thanë më sipër:

- 1- falënderimi;
- 2- udhëzimi në rrugën e drejtë;
- 3- të menduarit;
- 4- nënshtrimi ndaj së vërtetës;
- 5- kujtimi.

Pa dyshim që këto pesë qëllime janë të ndërlidhura shumë ngushtë me njëri-tjetrin: njeriu fillon me mendimin, pastaj në të vihet në lëvizje ndjenja e falënderimit për Dhuruesin e mirësive që ai gëzon. Kështu, para tij hapet porta që ai të udhëzohet në rrugën e drejtë dhe së fundi, njeriu u nënshtrohet urdhreve të Zotit të tij.

Nga sa u tha, rezulton se pesë qëllimet janë hallka të ndërlidhura në rrugën e plotësimit. Kur ecet sipas rregullave të dhëna, patjetër që do të arrihen rezultate frutdhënëse e të larta.

O Zoti im, mirësitë Tuaja kanë rrethuar trupin tonë, ne jemi në mes detit të mirësive që Ti ke dhënë për ne, por ne akoma nuk të njohim Ty!

O Zoti im, dhuro për ne sy e shikim që me ato të shohim rrugën që të të njohim Ty e dashurinë Tëndë, bëje mbarë për ne të ecim vetëm në rrugën ku fitohet kënaqësia Jote dhe bëj që ne të arrijmë pozitën e vërtetë të falënderuesve!

O Zoti im! Askush përveç Teje s'ka dijeni për nevojat tona, Ti di më shumë se ne për ato që ne duam, bëj mirësi për ne që të jemi ashtu siç dëshiron Ti të jemi, bëj për ne më të mirën që mund të mendojnë njerëzit, me të vërtetë Ti je Dëgjuesi dhe vetëm Ti i përgjigjesh lutjes sonë! Amin!

Përktheu: Haxhi Selim Stafa

PËRMBAJTJA

Surja “El Hixhr”	5
Përmbajtja e sures.....	6
Ajetet 1 - 5	8
Komentimi	9
Shpresat e rreme!.....	9
Hulumtim	14
Pavëmendshëmria dhe shpresa e gjatë	14
Ajetet 6 - 8.....	16
Komentimi	16
Kërkesa për zbritjen e engjëjve.....	16
Ajeti 9	21
Komentimi	21
Ruajtja e Kur’anit nga shtrembërimi	21
Një kërkim rreth pamundësisë së shtrembërimit të Kur’anit Famëlartë	23
Argumentet që tregojnë se Kur’ani nuk është shtrembëruar	26
Transmetimet e shtrembërimit.....	32
2- Transmetimet që tregojnë “shtrembërimin shpirtëror” të Kur’anit.....	33

3- Transmetimet e fabrikuara	34
Ajetet 10 - 15	38
Komentimi	39
Kokëfortësia dhe fanatizmi.....	39
Hulumtime	42
Ajetet 16 - 18.....	47
Komentimi	47
Hulumtim	55
Ajetet 19 - 21	60
Komentimi	60
Dy hulumtime	66
1- Cilat janë depozitat e All'Ilahut të Lartësuar?	66
2- Zbritja në hapësirë dhe në pozitë	68
Përmbyllje.....	68
Ajetet 22 - 25.....	69
Komentimi	70
Roli i erërave dhe i shiut	70
Hulumtim	73
Cilët janë “ata para nesh” dhe “ata pas nesh”?	73
Ajetet 26 - 44.....	75
Komentimi	77
Krijimi i njeriut	77
Hulumtime	83

1- Mendjemadhësia dhe egoja janë shkatërruese të mëdha.....	83
2- Mbi kë sundon shejtani?	86
3- Dyert e Xhehennemit.....	86
4- Balta e thatë dhe e zezë pa formë dhe fryma (shpirti) e All'Ilahut të Lartësuar.....	87
5- Kush janë “ <i>el xhânn</i> ”?	89
6- Kur'ani dhe krijimi i njeriut.....	91
Argumentet e atyre që thonë për përsosmërinë	93
Përgjigje ndaj atyre që flasin për konstatimin e specieve.....	94
Teoria e përsosjes dhe besimi në Zot.....	96
Kur'ani dhe çështja e përsosmërisë	98
Ajetet 45 - 50.....	102
Komentimi	103
Tetë mirësitë e Xhennetit.....	103
Hulumtime	106
1- Kopshtet dhe burimet e Xhennetit	106
2- Mirësitë materiale dhe jomateriale.....	106
3- Urrejtja dhe zilia janë dy armiqtë e vëllazërisë	107
4- Shpërblimi i plotë.....	108
5- Ejani të punojmë të gjithë së bashku, që ta bëjmë këtë botë Xhennet!.....	109
Ajetet 51 - 60.....	110
Komentimi	111
Mysafirë të çuditshëm!	111

Ajetet 61 – 77	117
Komentimi	119
Dënimi i keqbërësve të popullit të Lutit	119
Hulumtime	127
1- Çfarë nënkuptohet me frazën “pasi të kalojë një pjesë e natës”?	127
2- Kuptimi i fjalës së All’llahut të Lartësuar: “por vazhdoni në drejtimin e urdhëruar!”	128
3- Lidhja ndërmjet frazës “që i kuptojnë ata” dhe fjalës “besimtarët”	129
4- Dehja e pasionit dhe vetëkënaqësia	130
Komentimi	133
Përfundimi i banorëve të Ejkes dhe i banorëve të Hixhrës.....	133
Cilët ishin banorët e Ejkes?	133
Ajetet 85 - 91.....	139
Komentimi	140
Hulumtime	148
1- Kur’ani është një dhuratë e madhe e All’llahut	148
2- Lakmia është burimi i degradimit.....	149
3- Modestia e udhëheqësit	150
4- Cilët janë ata që bënë ndarjen (e librave të mëparshëm)?.....	151
Ajetet 92 - 99.....	154
Komentimi	155
Prediko haptazi atë që të është urdhëruar!	155

Hulumtime	160
1- Fillimi i predikimit të Islamit haptazi	160
2- Ndikimi shpirtëror në përkujtimin e All'llahut të Lartësuar ..	161
3- Adhurimi dhe përsosmëria	162
Sure "En Nahl"	164
Përmbajtja e sures.....	165
Mirësia e sures	168
Ajetet 1 - 2	169
Komentimi	170
Erdhi urdhri i All'llahut:	170
Ajetet 3 - 8.....	174
Komentimi	175
Kafsha, kjo krijesë dhënëse	175
Rëndësia e madhe e bujqësisë dhe e blegtorisë	183
Ajetet 9 - 13.....	187
Komentimi	188
Çdo gjë është në shërbim të njeriut	188
Hulumtime	194
1- Mirësitë materiale dhe morale	194
2- Përse ulliri, hurma e rrushi dhe jo frutat e tjera:	195
3- Të menduarit, të logjkuarit dhe të kujtuarit	199
Ajetet 14 - 18	202
Komentimi	203

Mirësia e maleve, e deteve dhe e yjeve	203
Hulumtime	214
Rruga, shenja, drejtuesi	214
Ajetet 19 - 23.....	217
Komentimi	218
Zota që nuk ndiejnë	218
Hulumtime	223
Cilët janë mendjemëdhenjtë?.....	223
Ajetet 24 - 29.....	225
Shkaku i zbritjes.....	226
Komentimi	227
Mbajtja e barrës së të tjerëve.....	227
Dy Hulumtime	237
1- Ka vetëm dy rrugë: e mirë ose e keqe.....	237
2- Dorëzimi pas kalimit të kohës	241
Ajetet 30 - 32	243
Komentimi	244
Përfundimi i të devotshmëve dhe i punëmirëve	244
Ajetet 33 - 37.....	249
Komentimi	251
Kumtimi qartë i mesazhit, misioni i Profetëve	251
Dy Hulmtime	264
1- Ç'është kumtimi i qartë?.....	264

2- Për çdo popull një të dërguar?	265
Ajetet 38 – 40	267
Shkaku i zbritjes.....	268
Komentimi	268
Ringjallja është fundi i mosmarrëveshjeve.....	268
Ajetet 41 – 42	274
Shkaku i zbritjes.....	274
Komentimi	275
Shpërblimi i emigrantëve.....	275
Hulumtime	276
Ajetet 43 – 44	281
Komentimi	281
Pyetni nëse nuk dini:	281
Hulumtime	286
Cilët janë dijetarët (<i>ehlu dh'dhikri</i>)?	286
Ajetet 45 - 47	291
Komentimi	292
Për çdo faj, një dënim	292
Ajetet 48 – 50	297
Komentimi	298
Të gjitha krijesat i bëjnë sexhde vetëm All'Ilahut të	
Gjithëpushtetshëm:	298
Efekti i hijeve në jetën tonë	299

Ajetet 51 – 55	305
Komentimi	306
Vetëm një fe e vërtetë dhe vetëm Një i Adhuruar:.....	306
Ajetet 56 - 60.....	313
Komentimi	314
Koha kur lindja e vajzës konsiderohej turp.....	314
Hulumtime	317
1- Përse idhujtarët i konsideronin engjëjt vajza të All'llahut?	317
2- Përse u përhap zakoni për varrosjen gjallë e vajzave në kohën e injorancës para Islamit?	319
Roli i Islamit në riaftësimin e gruas.....	324
Ajetet 61 - 64.....	328
Komentimi	329
Mëshira e All'llahut është më e gjerë se zemërimi i Tij.....	329
Hulumtime	332
Ç'është afati i caktuar?	332
Ajetet 65 – 67	338
Komentimi	339
Ujërat, frutat dhe kafshët shtëpiake	339
Hulumtime	343
1- Si formohet qumështi?	343
2- Lëndët ushqyese më të rëndësishme të qumështit	345
3- Qumështi, ushqim i pastër dhe lehtësisht i tretshëm	346

Ajetet 68 – 69	349
Komentimi	350
1- Ç'është inspirimi?	350
2- A është i veçantë inspirimi instiktiv vetëm për bletët?	351
3- Detyra e parë në jetën e bletëve	352
4- Ku është vendi i bletëve?	353
Hulumtime	355
1- Përbërësit e mjaltit	355
2- Udhët e nënshtruara	356
3- Ku fabrikohet mjalti?	356
4- Ngjyrat e ndryshme të mjaltit	357
5- Mjalti, shërues sëmundjesh	358
6- “Për njerëzit”	361
7- Konstatime të rëndësishme për mjaltin	362
8- Çuditë e jetës së bletëve	364
Ajetet 70 - 72	367
Komentimi	368
Shkaku i diferencimit në furnizim	368
A është drejtësi favorizimi në furnizim?	370
Dy hulumtime	377
1- Shkaqet e furnizimit	377
2- Dashamirësia ndaj të tjerëve	382
Ajetet 73 – 74	384

Komentimi	384
Mos i bëni All'llahut të ngjashëm	384
Ajetet 75 - 77	388
Komentimi	389
Dy shembuj, për besimtarin dhe për mohuesin:	389
Hulumtime	394
1- Njeriu ndërmjet lirisë dhe robërisë	394
2- Roli i drejtësisë dhe i rrugës së drejtë në jetën e njeriut	396
3-Transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit	397
Ajetet 78 - 83.....	399
Komentimi	401
Llojet e mirësive materiale e morale.....	401
Hulumtime	402
1- Kur fillon të kuptojë njeriu	402
2- Mirësia e mjeteve të njohjes.....	403
3- Që ju të falënderoni	406
4- Sekretet e fluturimit të shpendëve në qiell	408
5- Lidhja ndërmjet ajeteve të Kur'anit.....	411
6- Hijet, banesat, mbulesat	414
7- Fjalët e interpretuesve të Kur'anit	420
8- Konflikti i së vërtetës me të gabuarën	420
Ajetet 84 - 89.....	423
Komentimi	424

Kur përpara mizorëve do të mbyllen portat	424
Dy Hulumtime	434
1- Kur'ani është sqarues për çdo send	434
2- Katër fazat e udhëzimit në rrugën e drejtë	439
Ajeti 90	441
Komentimi	441
Programi shoqëror më i plotë.....	441
Ajetet më gjithëpërfshirëse të së mirës e të së keqes	448
Ajetet 91 - 94.....	451
Shkaku i zbritjes.....	452
Komentimi	453
Mbajtja e besës së dhënë është argument që vërteton besimin ...	453
Dy Hulumtime	455
1- Filozofia e respektimit të marrëveshjes	455
Çfarë nuk pranohet në prishjen e marrëveshjeve.....	459
Ajetet 95 – 97	461
Shkaku i zbritjes.....	462
Komentimi	463
Çmimi i jetës së mirë.....	463
Hulumtime	466
1- Burimet e përjetësisë.....	466
2- Barazia mes burrit dhe gruas	467
3- Rrënjët e punës së mirë vaditen prej besimit	468

4- Cila është jeta e mirë?	471
Ajetet 98 – 100	473
Komentimi	473
Ja kështu lexoje Kur'anin	473
Hulumtime	475
1- Ndaluesit e njohjes.....	475
2- Përse të kërkohet mbrojtje “prej djallit të mallkuar”	477
3- Ndërmjet ngjyrave të së vërtetës dhe të së gabuarës.....	478
4- Rregullat e leximit të Kur'anit.....	479
Ajetet 101 - 105.....	483
Shkaku i zbritjes.....	484
Komentimi	485
Shpifja	485
Hulumtime	494
1- E keqja e gënjeshtërs në këndvështrimin islam.....	494
2- Gënjeshtër është burimi i të gjitha fajeve	495
3- Gënjeshtër është burimi i hipokrizisë	497
4- S'ka harmonizim ndërmjet gënjeshtërs dhe besimit.....	497
5- Gënjeshtër heq sigurinë	498
Ajetet 106 - 111.....	499
Shkaku i zbritjes.....	500
Komentimi	501
Ata që braktisin Islamin (renegatët)	501

Dy Hulumtime.....	506
1- Maskimi dhe filozofia e tij	506
2- Renegati natyral, renegati i ardhur prej jomyslimanëve dhe të mashtruarit.....	511
Ajetet 112 - 114.....	513
Komentimi	514
Të dënuarit për shkak të mosmirënjohjes:.....	515
Hulumtime	516
1- Është shembull apo ngjarje historike	516
2- Lidhja ndërmjet sigurisë dhe furnizimit me bollëk	519
3- Gjendja e urisë dhe e frikës	520
4- Efekti i mosmirënjohjes ndaj mirësive në ngushtimin e gjithanshëm të dhuntive të Zotit.....	522
Ajetet 115 - 119.....	524
Komentimi	525
S'ka shpëtim për gënjeshtarët	525
Anë të një pyetjeje	527
Ajetet 120 - 124	535
Komentimi	536
Ibrahimi ishte simbol i cilësive më të mira.....	536
Ajetet 125 - 128.....	543
Komentimi	544
Dhjetë rregulla morale, armët e thirrësit tek e vërteta.....	544

Komentimi i Përsosur i Kur'anit.....Xhuzi i katërmbëdhjetë

Mbyllja e fjalës për suren “En Nahl”, e quajtur “surja e mirësive”
..... 554

Qëllimi i përmendjes së mirësive..... 558

PËRMBAJTJA..... 561

تفسير الأمثل الجزء الرابع عشر

أالمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الرابع عشر

الترجمة الى اللغة الألبانية: آگيم رچای و حاجى سليم اصطفى (ره)

تيرانا: 2021

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء چهاردهم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آیه الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: آگیم رچای و حاجی سلیم اصطفی (ره)

زیر نظر: وُلُئْتُ مَرِيًا

ویرایش: کلودیانا اسمایلی و دورینا باشا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2021